1. HYRJE

Tema e disertacionit që kam zgjedhur të trajtoj **"Mbi të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare Aktuale"** ka në fokus të saj çështje të së drejtës ndërkombëtare humanitare, duke filluar me parimet e përgjithshme të së drejtës së luftës, përpjekjet e hershme të kombeve për humanizimin e jetës ndërkombëtare, historikun e zhvillimit të kësaj të drejte dhe aktet kryesore që e përbëjnë atë.

Në disertacion trajtohet me hollësi përmbajtja e akteve ndërkombëtare, që përbëjnë të drejtën e luftës, duke filluar nga llojet e konflikteve që njeh e drejta ndërkombëtare humanitare, personat dhe objektet e mbrojtura, parime të konflikteve të armatosura ndërkombëtare dhe atyre të brendshme, çështje të konfliktit të brendshëm dhe sovranitetit. Vëmendja kryesore, përsa i përket parimeve, i kushtohet parimit të proporcionalitetit, sipas të cilit në planifikimin e një sulmi kërkohet një përllogaritje e viktimave të mundshme, si ushtarake ashtu dhe civile dhe të dëmeve, të krahasuara me përfitimin e veçantë ushtarak të pritur nga sulmi. Pra, kërkohet që humbjet e jetëve dhe dëmtimet e pronave nuk duhet të kalojnë masën, në raport me avantazhin ushtarak të fituar. Parimi i domosdoshmërisë ushtarake, nga ana tjetër kërkon që e gjithë veprimtaria ushtarake duhet të justifikohet me motivet ushtarake, sepse veprimtaria që nuk është ushtarakisht e domosdoshme nuk duhet të kryhet.

Në disertacion trajtohet gjithashtu kuptimi i mbrojtjes dhe kufizimet në mjetet dhe metodat e luftës, si dy prej fushave kryesore që mbulon e drejta ndërkombëtare humanitare. Ky trajtim përfshin shpjegimin e koncepteve, objekte civile, objektiva ushtarake, armët dhe metodat e ndaluara të luftimit, sipas akteve ligjore përkatëse. Një vend të veçantë zë themelimi i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar dhe kontributi i tij në nxitjen dhe mbështetjen e zhvillimeve të njëpasnjëshme të së drejtës ndërkombëtare humanitare.

Më poshtë jepet jepet sfondi ligjor i operacioneve për mbështetjen e paqes dhe zhvillimi i operacioneve të Kombeve të Bashkuara për paqen, përfshirë kategoritë e operacioneve paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara. Sqarohet ndryshimi ndërmjet paqeruajtjes, (e cila përfshin aktivitetet që zbatohen nga trupat ushtarake të vendosura në territorin e shtetit pritës me pëlqimin e këtij shteti, të cilat mund të përdorin një forcë të kufizuar për vetëmbrojtje, me qëllimin e mbrojtjes së paqes dhe sigurisë ndërkombëtare) dhe zbatimit të paqes, (masë kjo me karakter shtrëngues, që realizohet sipas kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara edhe në mungesë të pëlqimit të palëve në konflikt, për të mbrojtur, ose rindërtuar paqen). Zbatimi i paqes, siç parashikohet në kapitullin VII të Kartës, nuk duhet ngatërruar me paqeruajtjen e fuqishme. Paqeruajtja e fuqishme përfshin përdorimin e forcës në nivel taktik, me autorizimin e Këshillit të Sigurimit dhe pëlqimin e kombit pritës, ose pëlqimin e palëve kryesore në konflikt. Në të kundërt, zbatimi i paqes nuk kërkon pëlqimin e palëve kryesore dhe mund të përfshijë përdorimin e forcës ushtarake në nivel strategjik, ose ndërkombëtar, e cila normalisht ndalohet për shtetet anëtare nga neni 2(4) i Kartës, përveç rasteve kur autorizohet nga Këshilli i Sigurimit.

Misionet e zbatimit të paqes, veçanërisht në konfliktet brenda shtetit, influencojnë në konceptin tradicional të sovranitetit absolut kombëtar. Ajo që mund të përkufizohet si "ndërhyrje humanitare" nga Kombet e Bashkuara dhe disa kombe të tjerë, mund të konsiderohet si ndërhyrje në punët e brendshme të atij kombi nga shumë vende të tjera.

Një vend të rëndësishëm zë trajtimi i shkeljeve të së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe reagimi ndaj këtyre shkeljeve, si dhe përgjegjësia për to. Përgjegjësia për krimet e luftës është në radhë të parë personale, që nënkupton se një person i cili planizon, nxit, urdhëron, kryen, ose në njëfarë mënyre mbështet planizimin, përgatitjen, ose ekzekutimin e një krimi, duhet të përgjigjet individualisht për krimin. Por ekziston gjithashtu edhe përgjegjësia e drejtuesit ushtarak për krimet e kryera nga forcat nën komandën e tij, ose autoritetin e tij efektiv në rastet kur drejtuesi ushtarak e dinte, ose sipas rrethanave të kohës, duhet ta dinte që forcat po kryenin krime, si dhe kur drejtuesi ushtarak nuk merr të gjitha masat e nevojshme dhe të arsyeshme, brenda pushtetit të tij, për të parandaluar, ose shtypur kryerjen e krimeve, ose nuk ia paraqet çështjen për shqyrtim autoriteteve kompetente për hetim, ose ndjekje penale.

Trajtohet asistenca humanitare, si veprim emergjent që synon të sigurojë mbijetesën e atyre personave që janë prekur nga konflikti i armatosur i brendshëm, ose ndërkombëtar, si dhe nga fatkeqësitë natyrore. Trajtohen gjithashtu parimet e asistencës humanitare, rrethanat në të cilat mohimi i asistencës humanitare mund të përbëjë krim sipas të drejtës ndërkombëtare dhe asistenca ushtarake në shpërndarjen e ndihmës humanitare.

Shtetet në konflikt duhet të lejojnë asistencën humanitare kurdoherë që nevojat bazë të popullsisë civile nuk janë plotësuar. Asistenca humanitare mund të jepet vetëm me pëlqimin e shtetit në nevojë, megjithatë mosdhënia e pëlqimit për ndihmën humanitare të ofruar kufizohet nga norma dhe parime të ndryshme të së drejtës ndërkombëtare. Refuzimi do të ishte ekuivalent me shkeljen e rregullit që ndalon përdorimin si mjet lufte të shkaktimit të vdekjes nga uria. Asistenca humanitare nuk duhet ngatërruar me ndërhyrjet humanitare. Ndryshe nga asistenca humanitare, qëllimi i ndërhyrjeve humanitare është ndalimi i dhunimeve të mëdha dhe të përhapura të të drejtave të njeriut.

Pas një paraqitjeje të zgjeruar të çështjeve kryesore, që kanë të bëjnë me të drejtën ndërkombëtare humanitare, kalohet në zhvillimet aktuale të kësaj të drejte dhe në tendencat e saj të zhvillimit. Këtu përfshihen aspekte të ndërhyrjeve humanitare në mbrojtje të të drejtave njerëzore, brenda shteteve të veçanta, me ose pa autorizimin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. E drejta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për të autorizuar ndërhyrjet humanitare është tashmë një e drejtë e njohur dhe e gjithëpranuar nga komuniteti ndërkombëtar**.** Hartuesit e Kartës së Kombeve të Bashkuara përgjegjësinë kryesore për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare ia besuan Këshillit të Sigurimit. Ky organ vendos ekzistencën e ndonjë kërcënimi të paqes, shkelje të paqes, ose akti agresioni dhe bën rekomandimet, ose vendos se çfarë masash të detyrueshme duhet të ndërmerren, në pajtim me nenin 41, (që nuk përfshin përdorimin e forcës së armatosur) dhe nenin 42, (që parashikon fillimin e aksionit ushtarak). Sipas kapitullit VII të Kartës, Këshilli i Sigurimit mund të veprojë vetë, ose mund të përdorë organizatat rajonale për aksione force nën autoritetin e tij.

Megjithatë asnjë aksion force nuk mund të ndërmerret pa marrë më parë autorizimin e Këshillit të Sigurimit.

Në praktikën e tij Këshilli i Sigurimit, gjithnjë e më shumë i ka konsideruar shkeljet në shkallë të gjerë të të drejtave njerëzore si bazë ligjore për aksion ndërkombëtar. Në disa raste, nevoja për mbrojtjen e të drejtave njerëzore dhe ruajtjen e paqes ka çuar në ndërhyrje humanitare. Ndërhyrja humanitare është një çështje shumë e debatuar, për faktin se disa mbrojnë parimet e sovranitetit shtetëror dhe mosndërhyrjes, duke argumentuar se këto parime janë të ruajtura në Kartën e Kombeve të Bashkuara, e cila vlerësohet si një burim autoritar në rregullin ligjor ndërkombëtar. Të tjerë theksojnë se ndërhyrja humanitare parimisht nuk kërcënon integritetin territorial dhe pavarësinë politike të shteteve. Më shumë se për të destabilizuar një shtet të caktuar dhe për t'u përzier në punët e tij, ndërhyrja humanitare ka për qëllim të rindërtojë shtetin ligjor dhe të çojë përpara trajtimin njerëzor të individëve.
Analizohen me hollësi disa nga ndërhyrjet e fundit ndërkombëtare humanitare, të zhvilluara pas Luftës së Ftohtë, ku përfshihet ndërhyrja humanitare në Bosnjë & Hercegovinë, ndërhyrja në Irak në vitin 1991, ndërhyrja e Kombeve të Bashkuara në Somali në vitin 1992, ndërhyrja në Sudan, në Republikën Demokratike të Kongos, probleme të ndërhyrjes ushtarake në Afganistan dhe historia e abuzimit me të drejtat njerëzore, krimet që talebanët kryejnë ndaj afganëve dhe ndërhyrja ushatrake në Irak në vitin 2003 me problemet që ajo paraqiti deri në momentin kur forcat e koalicionit u tërhoqën nga Iraku në 31 gusht 2010.

Pas pasqyrimit të problemeve kryesore që paraqitën këto ndërhyrje, vijohet me një analizë të mësimeve që komuniteti ndërkombëtar nxori nga sukseset dhe dështimet e ndërhyrjeve të mëparshme humanitare dhe me debatet ndërkombëtare që këto ndërhyrje kanë shkaktuar kryesisht në drejtim të ligjshmërisë dhe pasojave të tyre .

Një nga ndërhyrjet ushtarake më të debatuara, përveç ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, ka qenë ndërhyrja e koalicionit në Irak, në 20 mars 2003. Justifikimet kryesore që u përdorën për fillimin e kësaj ndërhyrje ishin: posedimi nga ana e qeverisë irakene i armëve të shkatërrimit në masë, lidhjet e deklaruara të saj me rrjetet terroriste, si dhe mizoria e Sadam Husenit ndaj njerëzve të tij. Human Rights Watch, duke u shprehur kundër ndërhyrjes në Irak, ka pretenduar se: Vrasjet e asaj kohe në Irak nuk mund të justifikonin një ndërhyrje të tillë, ndërhyrja nuk ishte opsioni i fundit i arsyeshëm për të ndaluar barbarizmat në Irak, ndërhyrja nuk ishte motivuar nga arsye humanitare dominuese dhe nuk u zhvillua në mënyrë që të pajtohej maksimalisht me të drejtën e konfliktit të armatosur. Për më tepër ndërhyrja nuk ishte aprovuar nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara.

Kritikët e ndërhyrjes në Irak kanë ngritur pyetjen nëse veprimi ushtarak parandalues kundër Irakut është i ligjshëm sipas të Drejtës Ndërkombëtare. Një tjetër çështje që ka ngritur pikëpyetje lidhur me veprimin e koalicionit në Irak ka qenë përdorimi i kontraktuesve privat ushtarakë dhe i statusit të tyre ligjor.

1.1 OBJEKTI I KËRKIMIT SHKENCOR

Tashmë është i njohur fakti se paqja dhe stabiliteti janë qëllimet kryesore të marrëdhënieve të sotme ndërkombëtare. Paqja ndërkombëtare dhe siguria janë të ndërvarura nga njëra-tjetra. Ndërsa paqja është kërkesë e domosdoshme për gëzimin e të drejtave njerëzore, mungesa e këtyre të fundit mundet të çojë në një kërcënim serioz për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Fundi i Luftës së Ftohtë, në kundërshtim me çfarë pritej, nuk u pasua nga paqja dhe stabiliteti, por nga konflikte të shumta kryesisht të brendshme, të cilat çuan në kriza humanitare dhe shkelje masive të të drejtave njerëzore. Në disertacionin tim të doktoraturës i kam kushtuar rëndësi të gjitha çështjeve që lidhen me të drejtën ndërkombëtare humanitare, si një vazhdimësi e punimit të temës së masterit "Zhvillime aktuale në të drejtën ndërkombëtare humanitare". Tema sjell risi sidomos në çështjet e të drejtës për ndërhyrje humanitare dhe veçanërisht në drejtim të nevojës për ndryshim të së drejtës humanitare në interes të mbrojtjes së të drejtave njerëzore.

Në punim jam përpjekur të pasqyroj në mënyrë të detajuar dhe të plotë parimet dhe standardet ndërkombëtare për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare, si dhe rolin e organizatave ndërkombëtare në këtë fushë. Është trajtuar në këtë kuadër edhe mundësia e veprimit të organizatave rajonale të krijuara sipas kapitullit VIII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, për zgjidhjen e konflikteve, në qoftë se shterojnë të gjitha mjetet diplomatike, të parashikuara në aktet ndërkombëtare për zgjidhjen e konflikteve, në mënyrë që t'i jepet fund katastrofave humanitare, të krijohen kushtet në të cilat njerëzit të mund të jetojnë të qetë dhe të sigurohet drejtësi për viktimat.

Sovraniteti është një ndër parimet themelore të vendosura në Kartën e Kombeve të Bashkuara. Megjithatë, asnjëherë më shumë se dy dhjetëvjecarët e fundit koncepti i sovranitetit, nuk është vënë në diskutim. Mbështëtur në zhvillimet e fundit ndërkombëtare, lidhur me krizat humanitare, kur parimi i sovranitetit shtetëror i ka lënë vendin përgjegjësisë ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave njerëzore të dhunuara në mënyrë masive dhe sistematike, e pashë me vend që punën kërkimore ta fokusoja në analizën e legjislacionit që rregullon konfliktin e armatosur, kryesisht në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të personave dhe objekteve që mbrohen në mënyrë të posaçme nga aktet që përbëjnë të drejtën e luftës, angazhimit ndërkombëtar në paqeruajtje, të shprehur në operacionet paqeruajtëse më të fundit të Kombeve të Bashkuara dhe organizatave të tjera, të drejtën për të ndërhyrë në një shtet në emër të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve pa pëlqimin e këtij shteti etj.

Disa nga çështjet kryesore që janë shqyrtuar në këtë punim të doktoraturës, lidhur me reagimin ndërkombëtar ndaj krizave humanitare janë:

- Në çfarë mënyre komuniteti ndërkombëtar mund t'i përgjigjet efektivisht krizave humanitare që përbëjnë kërcënim për paqen?

- A mundet një qeveri, në çfarëdo lloj rrethanash, ta konsiderojë "të ligjshme" të masakrojë popullsinë e vet, mbi bazën e asaj që çdo gjë që ndodh brenda vendit të vet është një "çështje e brendshme"?

- A mund të ndërhyjë komuniteti ndërkombëtar, në emër të të drejtave të njeriut, pa marrë autorizimin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara?

- Komuniteti ndërkombëtar po përballet me një dilemë të dhimbshme. Të respektosh sovranitetin do të thotë të bëhesh bashkëpunëtor në dhunimin e të drejtave njerëzore. Të bazohesh në sanksione ekonomike dhe presion diplomatik dhe të argumentosh që Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara duhet të japë pëlqimin për luftë humanitare, do të thotë se ke dështuar në ushtrimin e dhunës kundër regjimeve të dhunës. Të përdorësh forcë në mënyrë të njëanshme, do të thotë të akuzohesh për shkeljen e të drejtës ndërkombëtare.

Nëpërmjet përzgjedhjes së kësaj teme, kam synuar të trajtoj idenë se përgjegjësia për mbrojtjen e të drejtave njerëzore i takon në radhë të parë çdo shteti sovran, megjithatë mbrojtja e të drejtave njerëzore është një çështje që mbetet jashtë juridiksionit ekskluziv të shteteve**.** Sovraniteti nuk është një e drejtë e lindur e shteteve, por buron nga të drejtat individuale. Koncepti i sovranitetit nuk mund të përdoret nga qeveritë për të mbrojtur veten nga përgjegjësia për shkelje të mëdha të këtyre të drejtave, ose nga shmangia e detyrimeve lidhur me mbrojtjen dhe trajtimin e civilëve në situatat e konfliktit ndërshtetëror. Kur sovraniteti vjen në kundërshtim me të drejtat e njeriut, këto të fundit duhet të kenë përparësi.

Në mënyrë të veçantë, në këtë temë disertacioni kam pasur si qëllim të trajtoj gjerësisht çështjet kryesore që lidhen me ndërhyrjet humanitare, të cilat kanë qenë në fakt objekt i shumë debateve. Pra, qëllimi kryesor i këtij studimi është të analizojë nga pikëpamja juridike, konceptin e ndërhyrjes humanitare, si ndërhyrje që kryhet nga një shtet, ose grup shtetesh në territorin e një shteti pa pëlqimin e këtij të fundit, për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve të këtij shteti, kur shteti vetë nuk është në gjendje t'i mbrojë, ose ai është shkaktar i këtyre shkeljeve.

Në disertacion janë analizuar disa prej ndërhyrjeve humanitare të zhvilluara pas Luftës së Ftohtë, përfshirë ndërhyrjen në Bosnjë, Kosovë, Afganistan dhe Irak. Janë analizuar gjithashtu debatet mbi ligjshmërinë e ndërhyrjeve humanitare dhe janë bërë disa sugjerime mbi sukseset dhe dështimet e ndërhyrjeve të mëparshme humanitare, duke arritur deri tek nevoja për ndryshimin e normave ndërkombëtare. Nëpërmjet analizës së ndërhyrjeve të mëparshme humanitare, krahasimit të ideve pro dhe kundër përdorimit të ndërhyrjeve humanitare në mbrojtje të të drejtave njerëzore, jam përpjekur të jap mendimin tim mbi ligjshmërinë e përdorimit të forcës ndërkombëtare në raste krizash humanitare, duke theksuar se më problematike dhe të debatueshme janë ndërhyrjet që ndërmerren jashtë Kombeve të Bashkuara, të cilat rrezikojnë të minojnë sistemin aktual të sigurisë, të garantuar në Kartën e Kombeve të Bashkuara.

Duke qenë se pjesa më e madhe e konflikteve sot zhvillohen brenda një shteti, kam synuar të nxjerr në pah ndryshimet mes konflikteve të armatosura të brendshme dhe atyre ndërkombëtare, ndryshimet mes konflikteve të armatosura të brendshme dhe situatave të tensioneve të brendshme që nuk arrijnë në konflikt të armatosur, sidomos në mënyrën e zgjidhjes së tyre, si dhe të analizoj tiparet kryesore të operacioneve paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara. Është i njohur fakti se përpjekjet paqeruajtëse të kombeve u finalizuan me të drejtën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për të krijuar operacione paqeruajtëse, si një mjet efikas për mbështetjen e zgjidhjeve paqësore të konflikteve ndërkombëtare. Sfidat me të cilat përballen operacionet paqeruajtëse, për shkak të mjediseve të vështira ku ato vendosen, i kanë detyruar Kombet e Bashkuara që shpeshherë t'iu japin këtyre operacioneve, mandate të "fuqishme", me qëllim që të përmbushet misioni. Praktika e paqeruajtjes pas viteve '90, ka diktuar nevojën e shmangies në njëfarë mase nga parimet bazë të operacioneve tradicionale paqeruajtëse, kryesisht në drejtim të paanësisë dhe mospërdorimit të forcës.

Ndërsa mospërdorimi i forcës ishte normë për operacionet e Kombeve të Bashkuara gjatë Luftës së Ftohtë, dështimet e ndërhyrjeve humanitare në fillim të viteve 1990 çuan në njohjen e faktit se mandatet e forta të kapitullit VII janë të nevojshme në misionet ku kërcënimi për rifillimin e dhunës, ose vijimin e konfliktit është i qartë. Operacioneve të zbatimit të paqes duhet t'iu jepen mjetet dhe autorizimi për të zbatuar forcën në rast nevoje. Përdorimi i fundit i forcës në Bosnjë ndryshoi rrjedhën e konfliktit, gjë që tregoi se kursi i gjithë konfliktit mund të kishte ndryshuar nëse forca do të ishte përdorur 3 vjet më parë.

Duhet të theksoj se punimi nuk është ndalur në mënyrë të thelluar në analizën e shkaqeve që çojnë në shkelje të të drejtave njerëzore, në situata tensionesh dhe shqetësimesh të brendshme dhe në disa raste deri në konflikte të armatosura të brendshme. Punimi nuk është fokusuar as në paraqitjen e plotë të situatave të krijuara në shtete të ndryshme si rezultat i krizave humanitare dhe shumë pak janë trajtuar zhvillimet konkrete të ngjarjeve para, gjatë dhe pas realizimit të ndërhyrjeve, si dhe masat konkrete që janë ndërmarrë për zgjidhjen e krizave të ndryshme humanitare.

Teza kryesore që unë kërkoj të mbroj në këtë punim disertacioni është se konflikte ndodhin, pavarësisht se e drejta ndërkombëtare ka vendosur një ndalim absolut të përdorimit të forcës në vitin 1928 me Paktin e Parisit, të njohur ndryshe si Pakti Briand – Kellog dhe tashmë në nenin 2(4) të Kartës së Kombeve të Bashkuara mbi ndalimin e luftës. Konfliktet e sotme kanë në qendër të tyre abuzimin dhe shkeljen masive të të drejtave njerëzore, të njohura dhe të pranuara nga komuniteti ndërkombëtar. Këto shkelje masive dhe sistematike të të drejtave njerëzore duhen kontrolluar jo vetëm se ato mund të shkaktojnë rreziqe për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, por edhe për faktin se është detyrim njerëzor mbrojtja e individëve të dhunuar. Në këtë drejtim merr rëndësi të madhe vendosja e kritereve ndërkombëtare, në mënyrë që të mos kalohet në abuzime nga ana e shteteve më të fuqishme dhe të mos cënohet sistemi i sigurisë i vendosur në Kartën e Kombeve të Bashkuara pas Luftës së Dytë Botërore.

1.2 METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur gjatë punimit të disertacionit bazohet kryesisht në **analizën e thelluar ligjore** të akteve ndërkombëtare, që përbëjnë të drejtën ndërkombëtare humanitare. Një analizë e thelluar është realizuar për dokumentat ndërkombëtare që përcaktojnë parimet dhe qëllimet kryesore të së drejtës së luftës, ku përfshihen konventat e Hagës dhe ato të Gjenevës, si dhe protokollet shtesë të konventave të Gjenevës. Sipas këtyre akteve, e drejta ndërkombëtare humanitare është krijuar për të mbrojtur personat që nuk marrin pjesë, ose nuk marrin më pjesë në veprime luftarake, si dhe për të zvogëluar sa të jetë e mundur vuajtjet e dëmtimet mbi pjesëtarët e forcave të armatosura. Ajo ka si qëllim kryesor zbutjen e pasojave të luftës, nëpërmjet kufizimit të mjeteve e metodave, gjatë kryerjes së operacioneve luftarake, dhe ndalimin e ushtrimit të dhunës së panevojshme për arritjen e qëllimit të luftës, që është dobësimi i rezistencës së kundërshtarit. E drejta ndërkombëtare humanitare, gjithashtu ka për qëllim të pajtojë dy parimet që në kohë konfliktesh të armatosura shpesh përplasen: humanizmi dhe domosdoshmëria ushtarake, ose e thënë ndryshe të vendosin ekuilibër ndërmjet kërkesave të operacioneve ushtarake dhe nevojave humane.

Është analizuar gjithashtu baza ligjore që buron nga Karta e Kombeve të Bashkuara për të drejtën e shteteve për vetëvendosje, për mundësinë e zgjidhjes së problemeve të brendshme në mënyrë të pavarur, që ka të bëjë kryesisht me parimet e sovranitetit dhe të mosndërhyrjes në punët e brendshme, të vendosura në Kartën e Kombeve të Bashkuara. Është analizuar e drejta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për të ndërhyrë në një shtet në mbrojtje të të drejtave njerëzore, shkelja e të cilave mund të përbëjë kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Këtë të drejtë Këshilli i Sigurimit mund ta ushtrojë vetë, ose mund të autorizojë shtete të ndryshme, ose organizatat rajonale të krijuara sipas kapitullit VIII të Kartës.

Gjithashtu punimi është mbështetur në **metodën krahasimore**, sidomos për çështje që lidhen me debatet e shumta që janë bërë dhe bëhen lidhur me doktrinën e ndërhyrjes humanitare dhe në veçanti rreth të drejtës së shteteve për të ndërhyrë ushtarakisht në një shtet tjetër, pa autorizimin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, me qëllim parandalimin e shkeljeve të mëdha të të drejtave njerëzore dhe të së drejtës ndërkombëtare humanitare. Ajo që del nga debati është një tension midis vlerave të sigurimit të respektimit për të drejtat themelore njerëzore dhe përparësisë së normave të sovranitetit dhe mosndërhyrjes, të cilat konsiderohen si faktorë kryesorë në ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Janë shoqëruar veçanërisht me debate teorike ndërhyrjet në Bosnjë 1995, në Kosovë 1999 dhe në Irak 2003.

Nje metodë tjetër nëpërmjet së cilës kam arritur në konkluzione mbi mënyrat më të përshtatshme që mund të përdoren për të patur rezultat ndërhyrjet ndërkombëtare në mbrojtje të të drejtave njerëzore, duke synuar në zgjidhjen e krizave humanitare dhe në arritjen e rezultateve pozitive afatgjata, ka qenë **studimi dhe krahasimi** i strategjive dhe

taktikave të përdorura në ndërhyrjet humanitare të zhvilluara që nga fundi i Luftës së Ftohtë, si dhe krahasimi i rezultateve që strategjitë dhe taktikat e ndryshme kanë pasur në situata të ndryshme krizash humanitare. Bëhet fjalë për ndërhyrjen e bërë me shumë vonesë në Bosnjë, për ndërhyrjen e paautorizuar të NATO-s në Kosovë e cila çoi faktikisht në zgjidhjen e krizës, për dështimin e Operacionit të Rindërtimit të Shpresës në Somali, për strategjinë e mbajtjes së anës ndaj një pale të konfliktit që rezultoi e dobishme në Timorin Lindor etj.

Punimi ka arritur të japë një panoramë të plotë të çështjeve më kryesore që lidhen me angazhimin ndërkombëtar në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit, si dhe me mbrojtjen e të drejtave njerëzore në shtete të veçanta, në sajë të **përshkrimit** të disa prej aksioneve më tipike ndërkombëtare, përshkrim që ka të bëjë me karakteristikat e ndryshme që kanë paraqitur situatat e ndryshme humanitare, marrjen e vendimit për fillimin e aksionit ndërkombëtar, sigurimin dhe vendosjen e forcave dhe mjeteve të nevojshme, si dhe përcaktimin e momenteve të sukseseve apo dështimeve të aksioneve të mëparshme.

Punimi ka arritur në nxjerrjen e konkluzioneve edhe nëpërmjet **identifikimit** të problemeve kryesore që kanë rezultuar nga ndërhyrjet e zhvilluara në vende të ndryshme. Problemet kryesore që kanë rezultuar nga këto ndërhyrje, kanë qenë:

- Mungesa e një force ndërhyrëse të Kombeve të Bashkuara, e aftë për çdo lloj ndërhyrje të shpejtë nga ana e Kombeve të Bashkuara, mungesë kjo që ka çuar shpesh në vonesa të pajustifikuara të vendosjes së trupave, kur në fakt kërkoheshin masa të shpejta për zgjidhjen e krizave, siç rezultoi në krizën e Ruandës.

- Domosdoshmëria e reagimit të komunitetit ndërkombëtar për të zgjidhur krizat humanitare në rastet kur Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara dështon në realizimin e misionit të tij në ruajtje të paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, siç ndodhi në krizën e Kosovës.

- Limitet e strategjisë që u përdor në operacionin e Kombeve të Bashkuara në Bosnjë, në të cilin u zbatua paqeruajtja tradicionale, që bazohej në doktrinën e paanësisë, pavarësisht nga agresioni i hapur dhe shkeljet e shumta të pushimeve të zjarrit nga Serbia. Rezultati i mosmbajtjes së anës ndaj një pale të konfliktit nuk ishte dhënia fund e dhunës, por vite të një loje ushtarake dhe gjakderdhje e ngadalshme.

- Dobia e mbajtjes së një ane të konfliktit, strategji kjo e përdorur në Timorin Lindor, ku u pa qartë se në disa situata, ndërhyrësit ndërkombëtarë duhet të jenë të përgatitur të zgjedhin që të mbajnë anën e një pale të konfliktit dhe duhet të kenë si qëllim të ndihmojnë në mposhtjen ushtarake të luftuesve të tjerë. Duhet theksuar se kjo strategji mund të përdoret vetëm nëse forca ndërhyrëse është dukshëm më e fortë ushtarakisht se luftuesit që cilësohen si "armiq".
- Vështirësitë kronike që kanë përjetuar Kombet e Bashkuara për vendosjen e shpejtë të forcave në raste emergjencash humanitare, që burojnë nga natyra ad-hoc e paqeruajtjes, përfshirë mungesën e një force të qëndrueshme dhe kundërshtimin e shteteve anëtare për të siguruar trupa dhe materiale në kohën e duhur, më kanë çuar në konkluzionin se drejtimi i aksioneve ndërkombëtare nga një komb përbën në disa raste opsionin më të mirë për operacionet e zbatimit të paqes.

Këto metoda ndërthuren përgjatë disertacionit, duke krijuar një tablo të qartë të problemeve që shkaktojnë konfliktet e armatosura, të brendshme, ose ndërkombëtare, nevojës së menaxhimit të këtyre konflikteve me qëllim që të sigurohet gëzimi i lirive dhe të drejtave themelore të shtetasve në këto vende, mënyrave konkrete që janë përdorur në situata të ndryshme dhe pasojave që kanë sjellë ndërhyrjet.

Analiza e problemeve kryesore me të cilat është përballur komuniteti ndërkombëtar vitet e fundit, si dhe e debateve kryesore të bëra lidhur me përgjegjësinë ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave njerëzore, më ka çuar në përcaktimin e vështirësive që ekzistojnë lidhur me zbatimin e të drejtës humanitare për shkak të një mosfunksionimi perfekt të qeverisjes ndërkombëtare të sotme, si dhe të tendencave kryesore për ndryshimin e normave të së drejtës ndërkombëtare humanitare.

1.3 TERMINOLOGJIA

Mendoj se sqarimi i disa prej termave që janë përdorur në mënyrë të vazhdueshme në këtë disertacion, i shërben lehtësimit të leximit, si dhe eviton ngatërresat konceptuale të disa termave.

Kuptimi që këto terma marrin në këtë punim të doktoraturës, është identik me atë të dhënë në fjalorët ndërkombëtar dhe literaturën vendase mbi të drejtën ndërkombëtare humanitare.

- **Agresion:** Përdorimi i forcës së armatosur nga një shtet, kundër sovranitetit, tërësisë territoriale, ose pavarësisë politike të një shteti tjetër. Shteti që është viktimë e agresionit gëzon të drejtën e vetëmbrojtjes. Aktet e kryera në ushtrimin e

së drejtës së vetëmbrojtjes së njerëzve, ose kurndër sundimit kolonial, pushtimit të huaj, ose regjimeve raciste, nuk quhen akte agresinoni.

- **Anijembytyr:** Personat, qofshin ushtarakë apo civilë, të cilët janë në rrezik në det ose në ujëra të tjera, si pasojë e një fatkeqësie që godet ata, ose anijen, apo avionin që i transporton dhe që nuk kryejnë ndonjë veprim armiqësor luftarak.

- **Anije spitalore:** Një anije e ndërtuar, e shndëruar, ose e pajisur posaçërisht dhe vetëm me qëllim dhënien e ndihmës për të burgosurit, të sëmurët dhe anijembyturit, si dhe për trajtimin e transportimin e tyre.

- **Anije tregtare:** Një anije private e përdorur për transportin e mallrave dhe personave civilë. Ajo nuk duhet të kryejë veprime luftarake dhe nuk mund të sulmohet. Megjithatë, anija tregtare bëhet objekt vizite, kontrolli dhe në rast zënie rob, konfiskimi.

- **Aparteid:** Ky term përfshin aktet e mëposhtme, të kryera me qëllim vendosjen dhe ruajtjen e sundimit nga një grup njerëzish të një race të caktuar, mbi një grup njerëzish të një race tjetër dhe shtypjen sistematike të tyre. (a) mohimi i së drejtës së jetës dhe të lirisë; (b) imponimi i qëllimtë i kushteve të jetës, që shkaktojnë shkatërrimin fizik; (c) moslejimi i jetës politike, ekonomike dhe kulturore; (d). ndarja në linja raciale, krijimi i lagjeve dhe shpronësimi; (f) persekutimi i personave dhe organizatave. Aparteidi i ushtruar gjatë një konflikti të armatosur ndërkombëtar është krim lufte.

- **Armë:** Çdo pajisje e furnizuar nga shteti për forcat e armatosura të tij, me qëllim që në konflikt të armatosur ato mund të veprojnë me dhunë kundër armikut dhe përdorimi i së cilës brenda kufijve të justifikuar nga domosdoshmëria ushtarake dhe pa qenë në kundërshtim me nderin ushtarak është i përligjur në kohë lufte.

- **Armë baktereologjike:** Armët që përdorin insekte të dëmshme, ose organizma të tjerë të gjallë, apo të ngordhur, ose produktet toksike të tyre, për të shkaktuar sëmundje dhe ndryshime patologjike te njerëzit dhe kafshët. Gjithashtu ato mund të shkatërrojnë, ose dëmtojnë edhe të mbjellat.

- **Armë kimike:** Armët që shkaktojnë dëmtime të llojeve dhe shkallëve të ndryshme te njerëzit dhe kafshët, nëpërmjet përdorimit të një lënde të ngurtë, të gaztë, ose lënde kimike, toksike, ngacmuese, paralizuese, ose me cilësi katalitike. Përdorimi, prodhimi dhe ruajtja e tyre ndalohet

- **Armë zjarrvënëse:** Armë, ose municione që kënë si qëllim parësor vënien e zjarrit në objekte, ose shkaktimin e djegieve të njerëzve, përmes veprimit të flakëve, nxehtësisë, ose kombinimit të tyre, të shkaktuara nga një reaksion kimik i një substance të hedhur mbi objektiv.

- **Asnjanësia:** Parim për të ruajtur besimin e të gjithëve, në mosmarrjen pjesë në luftime, ose në polemika me natyrë raciale, fetare, politike, ose filozofike. Asnjanësia nuk nënkupton as indiferencë ndaj vuajtjeve, as pranim të luftës, por është kusht i domosdoshëm për veprimtarinë humanitare.

- **Automjet mjekësor:** Çdo mjet mjekësor transporti, nga toka.

- **Aviacion mjekësor:** Çdo mjet mjekësor transporti, nga ajri, i synuar për evakuimin e të plagosurve, të sëmurëve, ose anijembyturve dhe për transportin e personelit, ose pajisjeve mjekësore.

- **Bllokadë:** Operacion që përfshin angazhimin e forcave ajrore dhe detare, me anën e të cilit një palë ndërluftuese parandalon plotësisht hyrje-daljen nëpërmjet detit nga një port, ose breg që i përket një pale kundërshtare, ose është që pushtuar prej saj.

- **Domosdoshmëri ushtarake:** Është një ndër parimet kryesore të të drejtës së konfliktit të armatosur. Ajo nënkupton kryerjen e veprimeve të domosdoshme për të arritur qëllimet e luftës. Domosdoshmëria ushtarake përgjithësisht bie ndesh me kërkesat humanitare. Për rrjedhojë, qëllimi i së drejtës humanitare është vendosja e një ekuilibri midis domosdoshmërisë ushtarake dhe nevojave humane të cilat kërkojnë shmangien e vuajtjeve të panevojshme.

- **Dredhi lufte:** Metodë e lejueshme lufte, e cila përbëhet nga veprime që synojnë ta çorientojnë kundërshtarin, ose ta nxisin atë të veprojë pa u matur. Dredhitë e luftës nuk shkelin ndonjë rregull të së drejtës ndërkombëtare dhe nuk përbëjnë pabesi. Shembuj të dredhisë në luftë janë maskimi, gracka, veprimet e rreme, keqinformimi, befasia, prita dhe bastisjet e shkallës së vogël.

- **E drejtë humanitare:** Term i përdorur për të theksuar qëllimet humanitare të së drejtës së konfliktit të armatosur.

- **Emblema dhe shenja dalluese:** Qëllimi i emblemave dhe shenjave dalluese është të tregojnë se personat që i mbajne, ose objektet ku janë vendosur gëzojnë të drejtën e mbrojtjes së veçantë ndërkombëtare dhe nuk mund të bëhen objekt dhunimi. Përdorimi i papërshtatshëm, ose shpërdorues i emblemave, ose shenjave dalluese ndalohet.

- **Fuqitë mbrojtëse:** Fuqitë mbrojtëse që kanë për qëllim lehtësimin dhe mbikqyrjen e zbatimit të rregullave humanitare, për të mbrojtur interesat e palëve në një konflikt.

- **Fuqi ndaluese:** Në një konflikt të armatosur ndërkombëtar, fuqia që mban anëtarët e forcave të armatosura që janë të sëmurë, të plagosur dhe anijembytur, personelin mjekësor dhe fetar, të internuarit civilë, ose robërit e luftës që i përkasin palës kundërshtare.

- **Fëmijë:** E drejta ndërkombëtare e konfliktit të armatosur u jep fëmijëve mbrojtje të përgjithshme, si persona civilë, që nuk marrin pjesë në luftime dhe mbrojtje të veçantë, si qënie veçanërisht të dobëta.

- **Forca të armatosura:** Në bazë të së drejtës ndërkombëtare, forcat e armatosura të një pale ndërluftuese, që marin pjesë në një konflikt të armatosur ndërkombëtar përbëhen nga të gjitha forcat e armatosura, grupet dhe njësitë e organizuara që janë nën komandën e kësaj pale, përgjegjëse për sjelljen e vartësve të saj edhe nëse kjo palë përfaqësohet nga një qeveri, ose autoritet që nuk njihet nga pala kundërshtare.

- **Fuqi mbrojtëse:** Fuqia, detyra e së cilës është të mbrojë interesat e palëve në konflikt dhe të shtetasve të tyre, në territorin e armikut. Rregullimi i zgjidhjes dhe veprimtarisë së këtyre fuqive dhe të aleatëve të tyre, në se ka, bëhet me rregulllore të veçanta.

- **Humanizëm:** Një ndër parimet themelore të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Ky parim mbështetet në respektimin për qëniet njerëzore dhe është i pandarë nga ideja e paqes. Humanizëm do të thotë të jesh i ndjeshëm ndaj vuajtjeve të të tjerëve, t'i ndash ato me ta, t'i parandalosh dhe t'i lehtësosh. Qëllimi i tij është të mbrojë jetën kundër dhunës. Ai është hapi i parë drejt parandalimit dhe shmangies së luftës dhe faktor themelor i paqes së vërtetë, që nuk mund të arrihet as me sundim, as me epërsi ushtarake.

- **I Përhershëm:** Termi zbatohet për personelin mjekësor dhe fetar, njësitë mjekësore dhe mjetet mjekësore të transportit, të caktuara për qëllime mjekësore për një periudhë të pacaktuar.

- **I Përkohshëm:** Termi përdoret për personelin mjekësor dhe fetar, njësitë mjekësore dhe mjetet mjekësore të transportit, të përdorura për qëllime mjekësore për periudha të kufizuara.

- **Konflikt i armatosur:** Një konflikt i armatosur ekziston sa herë që ka përdorim të forcës së armatosur ndërmjet shteteve, ose dhunë të armatosur të tejzgjatur midis autoriteteve qeveritare dhe grupeve të armatosura, të organizuara brenda një shteti. E drejta ndërkombëtare humanitare zbatohet qysh në nisje të konflikteve të armatosura dhe shtrihet përtej pushimit të luftimeve, deri në arritjen e përgjithshme të paqes ose, në rastin e konflikteve të brendshme, deri sa të arrihet një zgjidhje paqësore. Deri në këtë moment, e drejta ndërkombëtare humanitare vazhdon të zbatohet në tërë territorin nën kontrollin e një pale, si kur ka luftim konkret ashtu dhe jo.

- **Konflikt i armatosur jondërkombëtar:** Sinonim i termit "luftë civile", karakterizohet nga lufta midis forcave të armatosura të një shteti dhe forcave të armatosura disidente, ose kryengritëse.

- **Plaçkitje:** Përvetësimi sistematik dhe me dhunë nga pjesëtarët e forcave të armatosura i pasurisë së luajtshme, publike, ose private, që i përket shtetit armik, të plagosurve, të sëmurëve, anijembyturve, ose robërve të luftës. Plaçkitja është krim lufte.

- **Pushtim:** Hyrja me dhunë e forcave ushtarake nga një shtet në territorin e një shteti tjetër, për qëllime që mund të jenë politike dhe ushtarake, domethënë strategjike, ose thjesht taktike.

- **Luftë guerrilase:** Një teknikë lufte, taktike dhe strategjike, zakonisht mësymëse, e përdorur në territorin e pushtuar nga armiku, (a) në lidhje me operacionet tradicionale nga forcat aleate; (b) në mënyrë të pavarur, si pjesë e mbrojtjes territoriale.

- **Luftë për çlirim kombëtar:** Luftërat për çlirim kombëtar janë konflikte të armatosura në të cilat popujt luftojnë kundër sundimit kolonial, pushtimit të huaj, ose kundër regjimeve raciste në ushtrimin e të drejtës së tyre për vetëvendosje të mishëruar në Kartën e Kombeve të Bashkuara.

- **Luftues:** Pjesëtarët e forcave të armatosura të një pale në konflikt, përveç personelit mjekësor dhe fetar, janë luftues, domethënë kanë të drejtë të marrin pjesë drejtpërdrejt në luftime.

- **Luftime:** Akte dhune nga një palë ndërluftuese kundër një armiku, me qëllim që t'i japë fund qëndresës së tij dhe të imponojë bindjen.

- **Masë disiplinore:** (a) Masat që zbatohen ndaj të internuarve civilë dhe robërve të luftës, përgjegjës për shkeljet e normave, rregullave dhe urdhërave të përgjithshme që duhet të zbatojnë, ose (b) sanksionet që zbatohen ndaj komandantëve përgjegjës për mosveprim.

- **Mbrojtje:** Termi "mbrojtje" përdoret shpesh në të drejtën e konfliktit të armatosur në lidhje me termin "respekt" dhe zbatohet sa herë që synimi është të mbrohen personat ose pasuria nga pasojat e luftimeve.

- **Metoda të luftës:** Taktika, ose strategjia e përdorur në luftime për të mposhtur armikun, duke përdorur informacionin e disponueshëm për të, së bashku me armët, lëvizjet dhe befasinë.

- **Mjete të luftës:** Armët dhe sistemet e armëve, me anën e të cilave ushtrohet dhunë kundër armikut.

- **Mjete të transportit dhe të transportit mjekësor:** Çdo mjet transporti, qoftë ushtarak apo civil, i përhershëm apo i përkohshëm, i ngarkuar tërësisht me transportimin mjekësor dhe nën kontrollin e një autoriteti kompetent. Ai mund të jetë automjet mjekësor, anije apo mjet detar mjekësor, ose mjet ajror mjekësor.

- **Mosndërhyrje:** Parimi i cili ndalon veprimin që cënon sovranitetin e një shteti, ose përgjegjësine e një qeverie për të ruajtur, ose rivendosur rendin publik, ose për të mbrojtur unitetin kombëtar dhe tërësinë territoriale të shtetit me të gjitha mjetet e përligjura.

- **Objekt civil:** Çdo objekt që nuk është objektiv ushtarak. Objektet civile përfshijnë: (a) Qytetet dhe fshatrat; (b) Ndërtesat dhe ambjentet e përdorura nga civilët, sa kohë që ato nuk përdoren për qëllime ushtarake, si trojet e shtëpive dhe shtëpitë, pallatet dhe apartamentet, fabrikat, punishtet që prodhojnë mallra jo për përdorim ushtarak, zyrat, dyqanet, aviacionin publik, vendet e kultit, automjetet, trenat etj; (c) Ushqimet dhe zonat e prodhimit të mallrave ushqimore, puset dhe burimet e tjera ujore. Objektet civile nuk mund të bëhen objekt sulmesh, ose raprezaljesh.

- **Objekte jetike për mbijetesën e popullsisë civile:** Lëndët ushqimore, tokat bujqësore për prodhimin e lëndëve ushqimore, të mbjellat, bagëtia, rrjetet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe veprat vaditëse.

- **Objektiv ushtarak:** Një objekt që nga natyra, vendndodhja, qëllimi, ose përdorimi i tij, jep një kontribut të efektshëm për veprimtarinë ushtarake dhe shkatërrimi i plotë, apo i pjesshëm, ose kapja apo neutralizimi i tij, përbëjnë përfitim ushtarak.

- **Pabesi:** Aktet që synojnë të fitojnë besimin e kundërshtarit dhe ta bëjnë atë të besojë se ka të drejtën, ose detyrimin e pranimit, të mbrojtjes në bazë të së drejtës ndërkombëtare në konfliktin e armatosur, me synimin për ta tradhëtuar këtë besim, përbëjnë pabesi. Vrasja, dëmtimi, ose zënia rob e kundërshtarit, me anë të pabesisë ndalohet.

- **Peng:** Në të kaluarën pengjet zakonisht dërgoheshin në territorin e pushtuar, për të siguruar zbatimin e rregullave të vendosura nga Fuqia Pushtuese, p.sh. rekuizimet. Kohët e fundit, pengjet dërgohen kryesisht për të parandaluar veprimet armiqësore kundër forcave pushtuese.

- **Persona të vdekur:** Trupat e personave të vrarë në një aksion, ose që kanë vdekur për shkak të plagëve, ose sëmundjeve të marra gjatë luftimeve, duhet të respektohen. E drejta ndërkombëtare përcakton rregullat për respektimin dhe shënimin e varreve, si dhe masat që duhet të merren për këto qëllime në fund të luftimeve.

- **Person i humbur:** E drejta ndërkombëtare i kërkon çdo pale në konflikt të kërkojë për persona të shpallur të humbur nga një palë kundërshtare, sapo që rrethanat e lejojnë.

- **Person që nuk merr pjesë në luftime:** Në konfliktet e armatosura jondërkombëtare, të gjithë personat që nuk marrin pjesë drejtpërdrejt në luftime, ose kanë pushuar së marri pjesë, gëzojnë te drejtën e respektit për personin, nderin,

bindjen dhe praktikat fetare të tyre dhe të trajtimit në mënyrë njerëzore, pa ndonjë dallim të kundërt.

- **Rekuizim:** Një kërkesë e detyrueshme imperative nga një shtet për përdorimin e përkohshëm, ose të përhershëm të pasurisë së luajtshme, ose të paluajtshme, kundrejt shlyerjes së zhdëmtimit.

- **Rob lufte:** Luftues në një konflikt të armatosur ndërkombëtar, i cili bie në duart e armikut, ose më saktësisht të fuqisë armike, por jo të individëve, ose njësive ushtarake që e kanë zënë atë rob.

- **Siguri:** Në të drejtën e konfliktit të armatosur ky term i referohet sigurisë, (a) së fuqisë pushtuese; (b) të shtetit; (c) të palëve në konflikt.

- **Sulm pa dallim:** Sulm i cili, (a) nuk drejtohet mbi një objektiv ushtarak të veçantë; (b) përdor një metodë, ose mjet lufte që nuk mund të drejtohet mbi një objektiv ushtarak të posaçëm; ose (c) përdor një mjet, ose metodë lufte pasojat e së cilës nuk mund të kufizohen.

- **Shkelje:** Një veprim i ndëshkueshëm, i cili ndonëse jo shkelje e rëndë, është në kundërshtim me të drejtën e konfliktit të armatosur.

- **Shkelje e rëndë:** Shkelje të së drejtës së konfliktit të armatosur, të cilën shtetet janë të detyruara ta parandalojnë. Shkeljet e rënda vlerësohen si krime lufte. Ato janë të renditura në konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe në Protokollin e I-rë Shtesë të vitit 1974.

- **Shfarosja:** Shfarosja interpretohet si vrasje në shkallë të gjerë. Komisioni Ndërkombëtar i Ligjeve i Kombeve të Bashkuara e ka shpjeguar ndryshimin mes vrasjes dhe shfarosjes, si më poshtë: Shfarosja është një krim i cili nga natyra e tij drejtohet kundër një grupi individësh. Akti i shfarosjes përfshin një element të shkatërrimit në masë, i cili nuk kërkohet për vrasjen. Ndryshe nga genocidi, shfarosja zbatohet në situata në të cilat disa pjesëtarë të grupit vriten ndërsa të tjerëve i kursehet jeta. E drejta e konfliktit të armatosur ndalon shfarosjen, me qëllim që të mbrohen të plagosurit, të sëmurët, anijembyturit, robërit e luftës dhe personat e tjerë të mbrojtur.

- **Territor i pushtuar:** Në të drejtën ndërkombëtare, territori konsiderohet i pushtuar kur vendoset konkretisht nën autoritetin e ushtrisë kundërshtare.

- **Tension i brendshëm:** Situata të cilat nënkuptojnë, (a) një numër të madh arrestimesh; (b) një numër të madh të ndaluarish politikë, ose të sigurisë; (c) keqtrajtimin e mundshëm të të ndaluarve; (d) shpalljen e një gjendjeje të jashtëzakonshme; (e) pretendime për zhdukje të njerëzve. Tensionet e brendshme ndryshojnë nga trazirat e brendshme pasi në këto të fundit kryengritësit janë të

organizuar dhe të identifikueshëm. Në tensionet e brendshme opozita rrallë është e organizuar në një shkallë të dukshme.

- **Të drejtat e njeriut:** Liritë, që të gjithë njerëzit duhet të jenë në gjendje t'i gëzojnë në marrëdhëniet e tyre me individë të tjerë, ose me shtetin. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka mbrojtur parimin që të drejtat e njeriut duhet të respektohen edhe në periudha konflikti të armatosur.

- **Të plagosur dhe të sëmurë:** Persona ushtarakë, ose civilë, të cilët për shkak të traumës, sëmundjes, të ndonjë çrregullimi tjetër fizik apo mendor, ose për shkak të paaftësisë, kanë nevojë për kujdes mjekësor dhe që nuk kryejnë ndonjë veprim ushtarak. Termat i plagosur dhe i sëmurë përfshijnë edhe rastet e shtatëzanisë, të nënave me fëmijë të porsalindur dhe personave të tjerë të cilët mund të kenë nevojë për ndihmë ose kujdes mjekësor të menjëhershëm.

- **Vetëmbrojtje:** Karta e Kombeve të Bashkuara e autorizon çdo shtet anëtar të Kombeve të Bashkuara që është viktimë e një agresioni të ushtrojë të drejtën e tij të vetëmbrojtjes, në mënyrë që ai e gjykon të nevojshme, deri sa Këshilli i Sigurimit të miratojë masat e domosdoshme për zgjidhjen e situatës. Shteti viktimë e një agresioni kërkohet të njoftojë menjëherë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për çdo masë të marrë për këtë qëllim.

- **Zbatim:** Tregon (a) zbatimin e instrumentave të së drejtës së konfliktit të armatosur nga një shtet asnjëanës, ose një shtet që nuk është palë në konflikt; (b) zbatimin e këtyre instrumentave nga palët ndërluftuese; (c) ligjet dhe rregulloret e vendosura nga shtetet për të siguruar zbatimin e tyre; (d) marrjen përsipër të respektimit të tyre nga një autoritet që përfaqëson një popull të angazhuar në luftë për çlirim kombëtar.

- **Zyra kombëtare e informacionit**: Eshtë organi që duhet të ngrejë çdo palë në një konflikt të armatosur, ndërkombëtar për mbledhjen e informacionit, për robërit e luftës nën autoritetin e saj, që t'ia paraqesë atë pastaj Fuqisë së interesuar, përmes ndërmjetësimit të Fuqive Mbrojtëse dhe Agjensisë Qendrore të Kërkimit.

- **Zyra qendrore e kërkimit:** Eshtë një institucion i formuar nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, për të mbledhur të gjithë informacionin e mundshëm, nëpërmjet kanaleve zyrtare, ose private, duke respektuar roberit e luftës dhe për t'ia përcjellë atë vendit të origjinës të robërve të luftës, ose Fuqisë nga e cila varen.

2. E DREJTA NDËRKOMBËTARE HUMANITARE NË ZHVILLIMIN E SAJ HISTORIK

E drejta ndërkombëtare humanitare është një degë e së drejtës ndërkombëtare, e cila ka si objekt rregullimin e marrëdhënieve të ndryshme që krijohen gjatë konflikteve të armatosura.

Qëllimi i saj është zbutja e pasojave të luftës, nëpërmjet kufizimit të mjeteve e metodave, gjatë kryerjes së operacioneve luftarake, si dhe detyrimit të palëve ndërluftuese për të kursyer jetën e personave që kanë dalë jashtë luftimit për shkak të dëmtimeve, rënies rob, ose që janë tërhequr nga pjesëmarrja në veprime armiqësore.

E drejta ndërkombëtare humanitare, gjithashtu ka për qëllim të zvogëlojë sa të jetë e mundur vuajtjet e dëmtimet, kryesisht mbi anëtarët e forcave të armatosura.

E drejta ndërkombëtare humanitare njihet gjithashtu edhe si e drejta e luftës, ose e drejta e konfliktit të armatosur.[1]

Në situata konflikti të armatosur, për çfarëdo arsye që të ketë filluar, ajo përpiqet të lehtësojë sa të jetë e mundur efektet shkatërrimtare të luftës, duke mos penguar kryerjen me sukses të operacioneve ushtarake. Për të arritur këtë qëllim ajo duhet të ekuilibrojë kërkesat e shteteve për të zhvilluar operacionet e tyre ushtarake me efektivitet, me interesat njerëzore, të cilat diktojnë shmangien e vuajtjeve të panevojshme.

A kanë të drejtë shtetet të përdorin forcën, për të realizuar qëllimet e tyre në arenën ndërkombëtare?

E drejta e shtetit për të përdorur forcën rregullohet nga Karta e Kombeve të Bashkuara.

Neni 2/4 i Kartës së Kombeve të Bashkuara ndalon luftën, madje ndalon edhe cënimin për përdorim force kundër tërësisë territoriale ose pavarësisë politike të çdo shteti. Në jetën ndërkombëtare mosmarrëveshjet midis shteteve, në çdo rrethanë duhet të zgjidhen me mjete paqësore. Pra, lufta ndalohet nga e drejta ndërkombëtare ekzistuese.

E drejta humanitare, pavarësisht nga ndalimi i përdorimit të forcës, është gati të ndërhyjë, kurdo që lufta shpërthen, pa marrë parasysh nëse ajo është luftë e përligjur ose jo. Pra, e drejta ndërkombëtare humanitare zbatohet në konflikte të armatosura, pavarësisht nga fakti se shteti ka të drejtë të përdorë forcën apo jo.

E drejta humanitare nuk merret me çështjen e ligjshmërisë së luftës.

---

1. Hans Peter Gasser, "E Drejta Ndërkombëtare Humanitare", Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Dhjetor 2000.f.5 & Jean Pictet, "Zhvillimi dhe Parimet e së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare", Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Tiranë 2001.

Në të drejtën ndërkombëtare klasike përdorimi i forcës nga një shtet, për të arritur qëllimet e tij në marrëdhënie me shtete të tjera, konsiderohej i ligjshëm. Pas Luftës së Parë Botërore, Statuti i Lidhjes së Kombeve përcaktoi se një shtet kishte të drejtë të bënte luftë "për të ruajtur të drejtën dhe drejtësinë".[2] Shihet qartë që ky përkufizim linte mundësi për interpretime të ndryshme të së drejtës së përdorimit të forcës së armatosur dhe për abuzime me këtë të drejtë.

Për herë të parë shtetet angazhohen të heqin dorë nga përdorimi i luftës si mjet i politikës së jashtme në Paktin e Parisit, të 27 gushtit 1928, i njohur ndryshe si pakti Briand-Kellog. Ky Pakt u nënshkrua fillimisht midis Francës dhe SHBA dhe u ratifikua nga një numër i madh shtetesh, duke përfshirë Fuqitë e Mëdha. Pakti Briand-Kellog[3] është përdorur kundër të akuzuarve në gjyqet e luftës së Nurembergut në Gjermaninë e pas Luftës së Dytë Botërore, për kryerjen e një lufte agresive.

Pakti i Parisit, megjithëse konsiderohet si akti i parë ndërkombëtar që e ndalon luftën si mjet të politikës së jashtme, dështoi.

Dështimi i kësaj përpjekjeje të kufizimit të përdorimit të forcës u demonstrua në mënyrë tragjike më pak se një dekadë më vonë, ndërsa konflikti u ndez në të gjithë globin gjatë Luftës së Dytë Botërore. Pas kësaj lufte, komuniteti ndërkombëtar bëri edhe një tjetër përpjekje për të nxjerrë jashtë ligji përdorimin e forcës, këtë herë në Kartën e Kombeve të Bashkuara.

Pra, e drejta e shtetit për të bërë luftë nuk njihet nga e drejta ndërkombëtare e sotme. Çdo shtet që bën një agresion dhe përdor luftën për qëllimet e politikës së tij të jashtme, kryen një shkelje të së drejtës ndërkombëtare humanitare.[4] Neni 2/4 i Kartës së Kombeve të Bashkuara ndalon vetëm luftërat pushtuese, ato që synojnë përvetësimin e pasurive të shteteve të tjera dhe jo luftërat vetëmbrojtëse. Luftërat vetëmbrojtëse nga një agresion nuk mund të cilësohen të paligjshme.

Karta e Kombeve të Bashkuara nuk cënon të drejtën e një shteti të përdorë forcën në ushtrimin e së drejtës së tij për t'u vetëmbrojtur, ose të drejtën e shteteve të tjera për t'i ardhur në ndihmë shtetit të sulmuar, (e drejta e vetëmbrojtjes kolektive).

2. Arben Puto, E Drejta Ndërkombëtare Publike, 2002, f. 500.

3. Quhet Pakti i Parisit sepse u nënshkrua në Paris. Ministri i jashtëm francez Aristide Briand propozoi një pakt paqeje, si një marrëveshje dypalëshe ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Francës, për të nxjerrë jashtë ligji luftën ndërmjet tyre. E goditur rëndë nga Lufta e I-rë Botërore, Franca ndjehej vazhdimisht e pasigurt nga fqinji i saj Gjermania dhe kërkoi aleanca për të siguruar mbrojtjen e saj.
Sekretari amerikan i shtetit Frank Kellog nuk dëshironte që marrëveshja kundër luftës të mund të interpretohej si një aleancë dypalëshe, e cila do të detyronte Shtetet e Bashkuara të ndërhynin nëse Franca kërcënohej. Për të shmangur këtë, ai sugjeroi që dy kombet të ftonin të gjitha kombet e tjera të bashkoheshin me ta për të nxjerrë jashtë ligji luftën. Përfshirja në këtë pakt e kombeve të tjera u prit mirë në arenën ndërkombëtare. Në 27 gusht 1928, 15 kombe nënshkruan Paktin e Parisit. Më vonë, u bashkuan edhe 47 kombe të tjera, kështu që pakti u nënshkrua nga pjesa më e madhe e kombeve të botës. Ky pakt është një traktat i rëndësishëm shumëpalësh sepse shërbeu si një prej bazave ligjore që krijuan normat ndërkombëtare mbi kërcënimin ose përdorimin e forcës ushtarake në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.

4. Arben Puto, E Drejta Ndërkombëtare Publike, 2002, f. 501.

Neni 51 i Kartës së Kombeve të Bashkuara parashikon shprehimisht të drejtën e vetëmbrojtjes: "Derisa Këshilli i Sigurimit të marrë masat e nevojshme për ruajtjen e paqes dhe të sigurimit ndërkombëtar. Asnjë dispozitë e kësaj Karte nuk cënon të drejtën e natyrshme të vetëmbrojtjes së ligjshme, individuale ose kolektive, në rast se një anëtar i Kombeve të Bashkuara bëhet objekt i një sulmi të armatosur".

E drejta ndërkombëtare humanitare, nisur nga objekti dhe vendi i miratimit të akteve kryesore të saj, ndahet nga doktrina në dy degë, njëra mban emrin e Gjenevës, ndërsa tjetra atë të Hagës.

E drejta e Gjenevës, ose e drejta humanitare, ka qëllim mbrojtjen e personave ushtarakë të dalë jashtë luftimit, si dhe personave civilë.

E drejta e Hagës, ose e drejta e luftës, ka për qëllim të përcaktojë të drejtat dhe detyrat e palëve ndërluftuese gjatë zhvillimit të operacioneve ushtarake, si dhe të kufizojë zgjedhjen e mjeteve të dëmtimit.

E drejta e luftës dallohet për karakterin e saj human. Objekti kryesor i të drejtës së luftës është zbutja e fatkeqësive të luftës dhe dhunës së panevojshme për arritjen e qëllimit të luftës, që është dobësimi i rezistencës së kundërshtarit.

Thuhet se akti i parë i së drejtës së luftës u shkrua në Shën Peterburg më 1868.[5] Car Aleksandri i II i alarmuar nga shpikja e një tipi plumbi që shpërthente me të ndeshur objektin, propozoi thirrjen e një konference me qëllim "zbutjen, sa më shumë që të ish e mundur, të fatkeqësive të luftës". Në vitin 1899, u thirr në Hagë, Konferenca e Parë e Paqes, me qëllim kufizimin e fatkeqësive të luftës dhe ndalimin e prodhimit dhe përdorimit të armëve të reja.

Konventat e Hagës orientuan zhvillimin e mjaft luftërave gjatë shekullit të 20 – të dhe disa nga nenet e tyre janë ende në fuqi. Ato përcaktonin të drejtat dhe detyrat e palëve ndërluftuese gjatë konflikteve, mënyrën e veprimit të forcave ushtarake, si dhe kufizimin në zgjedhjen e armëve.

Në Konferencën e Parë të Hagës, të vitit 1899 u përpunua një konventë "Mbi normat dhe rregullat e luftës në tokë". Në Konferencën e dytë të Hagës të vitit 1907 u nënshkruan 13 konventa dhe u lëshua një deklaratë për luftën ajrore[6]. Konferenca e dytë e Hagës u mor

kryesisht me problemin e zgjidhjes paqësore të konflikteve ndërkombëtare dhe kjo u pasua nga nënshkrimi i dy konventave. Konventat e tjera[7] përcaktuan rregulla të luftës në tokë dhe në det. Deklarata për luftwn ajrore[8] ndalonte bombardimet ajrore, por ajo nuk pati ndonjë vlerë praktike sepse nuk u ratifikua nga një numër i madh shtetesh.

5. Jean Pictet, Zhvillimi dhe parimet e së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare, Tirane 2001, f.53.
6. Arben Puto, E Drejta Ndërkombëtare Publike, 2002, f. 508.
7. Hague Conventions of 1907, www.enotes.com › History
8. **The First Rules of Air Warfare**, Hague Peace Conferences, www.airpower.au.af.mil/airchronicles/aureview/1984/.../wyman.html

Në mjaft pika konventat e përpunuara në Konferencat e Hagës u plotësuan, ose u zëvendësuan nga Konventat e Gjenevës, të vitit 1949 dhe nga protokollet e tyre shtesë, të vitit 1977. Protokolli i Parë Shtesë përcakton rregulla të hollësishme për mbrojtjen e popullsisë civile, të burimeve e mjeteve të jetesës, të mjediseve, të instalimeve që përmbajnë lëndë të rrezikshme, të vlerave kulturore në konfliktet e armatosura ndërkombëtare. Ky protokoll kërkon që të mbahet parasysh përparësia e rrezikut për civilët, në krahasim me avantazhet ushtarake dhe ndalon raprezaljet.[9]

Protokolli i dytë merret kryesisht me luftërat civile. Sipas këtij protokolli, palët në konflikt duhet të respektojnë frymën e përgjithshme të humanizmit edhe kur situata të caktuara nuk gjejnë pasqyrim në tekstin e tij.

Fundi i Luftës së Dytë Botërore, i përballi popujt me një armë të tmerrshme, me bombën bërthamore. Bomba të këtij lloji, që u përdorën kundër njerëzve në Hiroshima dhe Nagasaki, në 6 dhe 9 gusht 1945, shkaktuan shumë të vdekur dhe të plagosur. Që nga ajo kohë, hija e llojit të ri të luftës ka vazhduar të errësojë horizontin e racës njerëzore.

Tashmë nuk bëhet fjalë se rrezikohet vetëm ekzistenca e një numri individësh, por vetë mbijetesa e njerëzimit, për këtë arsye, që prej asaj kohe vazhdimisht ka qenë në qendër të vëmendjes çështja e ndalimit të armëve bërthamore. Në vitin 1961, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi një deklaratë, në të cilën përcaktohet se "përdorimi i armëve shfarosëse në masë, i armëve bërthamore dhe termobërthamore është në kundërshtim të hapur me parimet e të drejtës ndërkombëtare".

2.1 BURIMET E TË DREJTËS SË LUFTËS

Përpjekjet për të përcaktuar dhe rregulluar sjelljen e individëve, kombeve dhe aktorëve të tjerë në luftë dhe për të lehtësuar efektet më të këqija të luftës kanë një histori të gjatë. Në Evropën mesjetare kisha katolike romake përhapi mësime mbi luftën e drejtë, të reflektuar në njëfarë mase në lëvizje si Paqja dhe Qetësia e Zotit[10]. Nxitja për të kufizuar gjerësinë e luftës dhe veçanërisht për të mbrojtur jetët dhe pasurinë e jo luftuesve vazhdoi me Hugo Grocin dhe përpjekjet e tij për të shkruar ligjet e luftës.
E drejta e luftës ka dy burime kryesore:

- Traktatet dhe konventat

- Zakonin.

2.1.1 E drejta zakonore e luftës

E drejta ndërkombëtare humanitare konsiston në traktatet, marrëveshjet ndërkombëtare, të cilët iu ngarkojnë detyrime shteteve nënshkruese të traktateve, si dhe në normat zakonore që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e shteteve jo nënshkrues të traktateve.

---

9. "Raprezalje" do të thotë shkelje e rregullave të luftës në përgjigje të një shkeljeje të këtyre rregullave nga kundërshtari, me qëllim dhënien fund të dhunës së kundërshtarit. Raprezaljet kundër civilëve dhe objekteve civile; robërve të luftës; të plagosurve, të sëmurëve dhe anijembyturve; personave dhe objekteve të mbrojtura në mënyrë të vecantë; objekteve të domosdoshme për mbijetesën e popullsisë civile; mjedisit natyror janë të ndaluara.
10. The Peace and Truce of God was a medieval European movement of the Catholic Church en.wikipedia.org/wiki/Peace_and_Truce_of_God

E drejta ndërkombëtare zakonore [11] është krijuar nga praktika e përgjithshme e shteteve dhe nga fakti se shtetet e kanë pranuar zbatimin e kësaj praktike si detyrim ligjor. Normat e kësaj të drejte u përdornën në gjyqet e luftës të Nurembergut e Tokios.

Edhe në kohërat më antike lufta është kryer sipas praktikave dhe marrëveshjeve që përmbanin elementë humanitarë, të vendosur për të mbrojtur shtetet që merrnin pjesë në luftë. Ndonëse këto zakone antike ishin pranuar kryesisht për qëllime praktike, taktike apo ekonomike, në fund efektet rezultonin që ato zakone ishin humanitare. Për shembull, një nga zakonet më antike, ndalimi i helmimit të puseve, që ishte shumë i zakonshëm në ligjin tradicional afrikan, ishte një rregull praktik nga i cili përfitonin të dyja palët. Një gjë e ngjashme ishte ndalimi i vrasjes së robërve të luftës, më tepër për të garantuar sigurimin e skllevërve të ardhshëm, ose për të kërkuar një shpërblim për lirinë, se sa të kursenin jetët e ish-luftëtarëve në një mënyrë fisnike. Këto dhe zakone, ose praktika të tjera të ngjashme ekzistonin në kulturat, rajonet dhe qytetërimet e ndryshme në Azi, Afrikë, Amerikë dhe Evropë.

Përsa i përket të drejtës zakonore dhe sjelljes në luftë – Karl von Klauzeviç[12], filozofi prusian i luftës, ka thënë: "Nëse gjejmë kombe të qytetëruar që nuk i dënojnë me vdekje të dënuarit e tyre, që nuk shkatërrojnë qytete ose vende, kjo ndodh sepse inteligjenca e tyre ushtron një influencë më të madhe në mënyrën e bërjes së luftës dhe që u ka mësuar më shumë mjete të efektshme të zbatimit të forcës se sa këto akte të ashpra të instikteve të egra".[13]

E drejta ndërkombëtare zakonore është e detyrueshme për të gjitha shtetet. Prandaj formulimi në traktate që shpall parimet e së drejtës zakonore është i detyrueshëm edhe për shtetet që nuk janë palë në këto traktate. Gjykata Ndërkombëtare Ushtarake në Nuremberg vendosi që rregullat bashkëngjitur Konventës Nr. IV të Hagës të vitit 1907, (Rregullat e Hagës), pasqyronin të drejtën ndërkombëtare zakonore dhe, për rrjedhojë ishin të detyrueshme për Gjermaninë, si shtet palë edhe pse e angazhuar në konflikt të armatosur me Çekosllavakinë, e cila nuk ishte shtet palë i Konventës.[14]

E drejta ndërkombëtare zakonore është gjithashtu e rëndësishme për rregullimin e çështjeve, të cilat nuk janë të mbuluara nga traktatet e së drejtës së konfliktit të armatosur. Për shembull, pak nga rregullat e zbatueshme në konfliktet e armatosura jondërkombëtare janë kodifikuar, por është një tërësi e konsiderueshme e së drejtës ndërkombëtare zakonore që drejton zhvillimin e operacioneve në situata të tilla konfliktuale.[15]

11. L.R. Penna, "Customary International Law and Protocol I" in C. Swinarski (ed.), Studies and Essays on International Humanitarian Law and Red Cross Principles, ICRC (1984); A. Cassese, "The Geneva Protocols of 1977 on the Humanitarian Law of Armed Conflict and Customary International Law", 3 UCLA Pacific Basin Law Journal (1984), p.55; D. Fleck, "The protocols Additional to the Geneva Conventions and Customary International Law", 29 RDMDG (1990), p. 497; C. Greenwood, "Customary Law Status of the 1977 Geneva Protocols" in A.J.M. Delissen & G.J. Tanja (ed.), Humanitarian Law of Armed Conflict: Challenges Ahead, Nijhoff (1991), p.93.
12. Carl von Clausewitz, Theory of War, http://en.wikipedia.org/wiki/Carl_ von_Clausewitz.
13. Karl von Klauzeviç, (1 korrik 1780- 16 nëntor 1831)-oficer prusian dhe teoricien ushtarak gjerman, i cili theksoi aspektet morale dhe politike të luftës. Në veprën e tij "Mbi luftën" Klauzeviç e konceptoi luftën si një përmbledhje politike, sociale, ekonomike dhe ushtarake, e cila përfshin të gjithë popullsinë e një kombi në luftë. Ai dha përkufizime të ndryshme, ku më i famshmi nga të cilët është se lufta është një vazhdim i politikës me mjete të tjera.
14. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Për Forcat e Armatosura, Manual Model Mbi të Drejtën e Konfliktit të Armatosur, Dhjetor 2003, (Libri B, Kreu 23-25, f.9).
15. KNKK, E drejta e konfliktit të armatosur, Dosje mësimore për instruktorët, Qershor 2002,"Njohuritë bazë", f. 20.

Kodifikimi i mëtejshëm i rregullave ekzistuese të së drejtës ndërkombëtare zakonore në traktate ose konventa nuk do të thotë që rregullat zakonore pushojnë së ekzistuari ose nuk merren më parasysh. Në fakt, ato vazhdojnë të ekzistojnë dhe të zhvillohen përmes normave të traktateve.

Në hyrjen e Konventës IV të Hagës të vitit 1907, duke respektuar rregullat dhe zakonet e luftës, ka një klauzolë të njohur me emrin klauzola Martens, sipas Profesor Frederick von Martens [16], (1845 – 1909), delegat i Car Nikollës II të Rusisë në konferencat e paqes të Hagës, që parashikon parimin: "… në rastet që nuk janë përfshirë në Rregullore …, banorët dhe ndërluftuesit mbeten nën mbrojtjen dhe sundimin e parimeve të së drejtës së kombeve, të cilat burojnë nga zakonet e vendosura ndërmjet popujve të qytetëruar, nga ligjet e humanizmit dhe kërkesat e ndërgjegjes publike."[17]

E drejta ndërkombëtare zakonore ka rëndësi shumë të madhe. Prej kohësh ajo përbën gurin themeltar të së drejtës moderne të traktateve. Ajo është zhvilluar nga e drejta e traktateve dhe ndonjëherë ka mbushur hapësirat kur nuk ka ekzistuar e drejta e traktateve. Për më tej, vërteton qartë natyrën universale të së drejtës së konfliktit të armatosur, duke qenë se kjo e drejtë, (e drejta zakonore) nuk është as ligj perëndimor dhe as ligj lindor.

2.1. 2 Traktatet për të drejtën e luftës

Ndonëse themelet e të drejtës së konfliktit të armatosur janë shumë të vjetra, vetëm në pjesën e dytë të shekullit të XIX parimet zakonore filluan të kodifikohen nëpërmjet marrëveshjeve multilaterale. Arsyeja e fillimit të kodifikimit të së drejtës ishte se shtetet panë nevojën për vendosjen e rregullave preçize, duke qenë se rregullat e shkruara ofrojnë qartësi më të madhe dhe se nganjëherë e drejta zakonore ishte shumë e përgjithshme.

Shpesh është debatuar mbi faktin se pse duhen nxjerrë ligje për diçka kriminale dhe të paligjshme si lufta. Përderisa ajo ka dalë jashtë ligjit, duket sikur nxjerrja e ligjeve të luftës e ligjëron atë. Sidoqoftë, bazuar në të drejtën ndërkombëtare zakonore, nga palët e

implikuara në luftë gjatë viteve është krijuar ideja se kodifikimi i ligjeve të luftës mund të jetë i vlefshëm.

Ndërmjet çështjeve të tjera, e drejta e luftës trajton deklarimin e luftës, pranimin e dorëzimit dhe trajtimin e robërve të luftës, domosdoshmërinë ushtarake, dallimin ndërmjet objektivave të ligjshme dhe të paligjshme, proporcialitetin dhe ndalimin e disa armëve johumane që shkaktojnë vuajtje të panevojshme.

Është shkelje e të drejtës së luftës të përfshihesh në luftim pa plotësuar disa kërkesa, ndërmjet të cilave mbajtja e një uniforme të dallueshme, ose shenjave të tjera që dallohen për së largu dhe mbajtja haptazi e armëve. Të shtiresh si ushtar i palës tjetër duke veshur uniformën e armikut lejohet, megjithëse të luftosh me atë uniformë, si dhe të luftosh nën një flamur të bardhë, përbën pabesi e cila është e ndaluar siç është e ndaluara edhe marrja e pengjeve.

16. Shih, (KGJ I, neni 63; KGJ II, neni 158; P I, neni 1; P II, Hyrja; KGJA, Preambuli).
17. KNKK, Manual model "Mbi të drejtën e konfliktit të armatosur", Libri B, kreu 23 - 25, f.10.

E drejta e luftës vendos limite në ushtrimin e pushtetit të ndërluftuesve, që nënkupton se ndërluftuesit duhet të kufizohen në zbatimin e çdo lloji dhe shkalle të dhunës që nuk është e domosdoshme për qëllimet ushtarake.

E drejta e luftës nuk është e detyrueshme vetëm për shtetet si të tilla, por edhe për individët, në veçanti për anëtarët e forcave të tyre të armatosura.

2.1. 3 Aktet që përbëjnë të drejtën ndërkombëtare humanitare

Pjesa më e madhe e të drejtës ndërkombëtare humanitare përmbahet në katër konventat e Gjenevës të vitit 1949. Pothuajse të gjitha shtetet janë palë të këtyre konventave. Konventat janë zhvilluar dhe plotësuar nga dy marrëveshje të mëtejshme: Protokollet shtesë të vitit 1977, të përpunuara nga Konferenca Diplomatike Ndërkombëtare mbi të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare, që u zhvillua në Gjenevë në vitet 1974-1977. Konferenca kishte si qëllim plotësimin e Konventave të Gjenevës të vitit 1949, me dispozita që do të plotësonin mangësitë e tyre.

Marrëveshje të tjera ndalojnë përdorimin e disa armëve dhe taktikave ushtarake dhe mbrojnë kategori të caktuara njerëzish dhe të mirash.

Këto marrëveshje përfshijnë:

1. Deklarata e Shën Petërburgut e vitit 1868;
2. Deklarata e Hagës për plumbat Dum – dum e vitit 1899;
3. Konventat e Hagës të vitit 1899 dhe 1907;
4. Protokolli i Gjenevës për Gazet i vitit 1925;
5. Konventa e Gjenevës për të Plagosurit e vitit 1949, (KGJ I);
6. Konventa e Gjenevës për Anijembyturit e vitit 1949 (KGJ II);
7. Konventa e Gjenevës për Robërit e Luftës e vitit 1949, (KGJ III);
8. Konventa e Gjenevës për Civilët e vitit 1949, (KGJ IV);
9. Konventa e Gjenevës për Pasurinë Kulturore e vitit 1954;

10. Konventa e Gjenevës për Armët Biologjike e vitit 1972;
11. Protokolli i I-rë i Gjenevës i vitit 1977;
12. Protokolli i II-të i Gjenevës i vitit 1977;
13. Konventa e Gjenevës për Armët Konvencionale e vitit 1980 me protokollet e mëposhtme:
    a. Protokolli për ciflat e pazbulueshme;
    b. Protokolli mbi ndalimin ose kufizimin e përdorimit të minave, minave-kurthe dhe mjeteve të tjera shpërthyese;
    c. Protokolli mbi ndalimin ose kufizimin e përdorimit të armëve zjarrvënëse
    d. Protokolli mbi armët verbuese me rreze lazer;
14. Konventa e Gjenevës për Armët Kimike e vitit 1993;
15. Konventa për Minat e vitit 1997, (Traktati i Otavës);
16. Protokollin Fakultativ të vitit 2000 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve, që ka të bëjë me angazhimin e fëmijëve në konflikt të armatosur.

2.2 PËRPJEKJE TË HERSHME PËR HUMANIZIMIN E JETËS NDËRKOMBËTARE

Mbrojtja e njeriut nga fatkeqësitë dhe trajtimi arbitrar nuk është ide e re.[18]

Rregullat e para me natyrë humanitare për mbrojtjen e tij janë shumë të vjetra. Eshtë shumë vështirë të dihet me saktësi kur dhe ku janë shfaqur për herë të parë rregullat e së drejtës ndërkombëtare në këtë fushë.

Në shumë vepra të lashta madhore të kulturës ndërkombëtare, (për shembull, epika indiane *Mahâabharata*), në libra fetare (*si Bibla apo Kurani*), ose në rregullat e artit të luftës (rregullat e *Manu – së,* ose kodi japonez i sjelljes, *Bushido*), gjenden rregulla ligjore me natyrë humanitare.[19]

Bushido, kodi mesjetar i nderit të kastës së luftëtarëve të Japonisë, përfshinte rregullin që humanizmi duhet të ushtrohet në betejë madje dhe ndaj robërve të luftës.

Fillesa të normave të para në Babiloni, mund t'i gjejmë në kodin e famshëm të mbretit të Babilonisë, Hamurabit, që fillon me fjalët, "Unë i vendosa këto ligje për të parandaluar të fuqishmit të shtypnin të dobëtit".[20]

Interesante dhe me vlera të jashtëzakonshme, përsa i përket gjetjes së fillesave të së drejtës ndërkombëtare, janë tekstet e vjetra të Indisë, në të cilat përcaktohej se luftëtarëve u ndalohej të vrisnin armiq që janë të paaftë të mbrohen dhe që dorëzohen, ndërsa të plagosurit duhet të dërgohen në vendin e tyre pasi të jenë shëruar. Parim mjaft i përhapur për atë kohë ishte ndalimi i disa mjeteve të luftimit, si armët me majë dhe të helmuara, shigjetat e ndezura etj. Ky parim do të ndeshet më vonë në konventat e Hagës të vitit 1907 mbi të drejtën e luftës.[21]

Mund të përmenden nga kultura egjiptiane, "Shtatë Veprat e Mëshirës së Vërtetë", të cilat i udhëzonin lexuesit "të ushqejnë të uriturit, t'u japin ujë të eturve, të veshin të zhveshurit, të strehojnë udhëtarët, të lirojnë të burgosurit, të kujdesen për të sëmurët, të varrosin të vdekurit".[22]

Greqia e lashtë jep shembuj tipikë të shoqërisë së organizuar. Tek Iliada, Homeri përshkruan beteja në të cilat nuk mungonte ndershmëria, armëpushimet gjatë betejave dhe respekti për armikun, doemos sipas koncepteve të asaj kohe.[23]

Perandoria romake përhapi nëpër botë kulturën e saj, të drejtën dhe dobinë e paqes. Roma mbretëroi nëpërmjet forcës, organizimit dhe ligjit.

---

18. Jean Pictet, "Zhvillimi dhe Parimet e së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare", Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Tiranë 2001.f.10.
19. Hans Peter Gasser, " E Drejta Ndërkombëtare Humanitare", Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Dhjetor 2000.
20. Jean Pictet, "Zhvillimi dhe Parimet e së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare", Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Tiranë 2001.f.10.
21. Jean Pictet, "Zhvillimi dhe Parimet e së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare", Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Tiranë 2001.f.10
22. **The Book of The Prophet Isaiah**, Chapter 58/7, Biblescripture.Net/Isaiah.Html
23. **Homer's Iliad**, **Honor is** essential to the **Homeric** heroes, ablemedia.com/ctcweb/netshots/homer.htm

Edhe në trojet shqiptare ndeshen rregulla strikte në këtë fushë. Në gojëdhëna dhe legjenda shqiptare, në këngë të rapsodëve popullorë shqiptarë, përmenden vlera të armikut, raste marrëveshjesh, faljesh dhe mirëtrajtimi.

Te Kanuni i Lekë Dukagjinit[24] predikohet se "Kanuni i Malevet të Shqypnís shliron e përjashton ndoren e ndermjetsín i a ruen.... Hjekës thirret aj, i cilli me ndermjetsí të mbrapshtë e per nen dhé i ep ndimë tjetrit per me bâ ndo'i rrênim a ndo'i faqe të zezë tjeter në katund të vet".

Në zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare humanitare një rol të caktuar ka luajtur edhe tradita fetare.

Kultura fetare historikisht ka predikuar dhembshuri për njeriun, mëshirë dhe ndihmë të ndërsjelltë. Në Bibël[25] bëhet fjalë për të falur armiqtë që dorëzohen, për mëshirë ndaj të plagosurve, grave, fëmijëve dhe të moshuarve.

Islami gjithashtu pranon kërkesat themelore të humanizmit. Profeti vetë, si komandant ushtarak vendosi rregulla të rrepta për zhvillimin e luftimeve duke përfshirë respektin për luftëtarët e mundur, gratë, fëmijët dhe pronën. Në urdhërat e tij për komandantët, Kalihu i parë, Abu Bakr[26], përcakton se "gjaku i grave, fëmijëve, të moshuarve nuk do të njollosë fitoren tuaj. Mos shkatërroni asnjë pemë, as mos digjni shtëpi ose të mbjellat, mos prisni asnjë pemë frutore. Ju nuk duhet të therni bagëti ose kope për mbijetesën tuaj.

Në mesjetë vërehet një prirje për ta parë jetën pak a shumë si një fazë kalimtare në rrugën drejt jetës së përtejme. Njerëzit përpiqeshin të shpëtonin më tepër shpirtërat se sa trupat e tyre.

E njëjta dukuri shprehet edhe në legjendën shqiptare të Gjergj Elez Alisë, ku bëhet fjalë për mentalitetin e trimave shqiptarë: "Me mbajt besën, nderën e burrninë asht e nevojshme, me u mbajt i gjallë jo." [27]

Në zhvillimin e së drejtës humanitare ndihmoi edhe kalorësia[28] si institucion me prejardhje gjermanike, i cili sundoi gjatë epokës së feudalizmit[29] Deklaratat e luftës, statusi i atyre që mbajnë flamurin e armëpushimit dhe ndalimi i disa armëve, janë pjesë e trashëgimisë së kavalerisë.

Në fundin e shekullit të 14 – të, në fushën e betejës u futën armët e zjarrit. Luftërat me njëri – tjetrin dolën jashtë modës.[30] Në këtë periudhë ka shembuj të një përkujdesje më të madhe ndaj robërve, të cilët gjithnjë e më shpesh liroheshin kundrejt shpërblimit, si dhe ndaj të plagosurve të cilët mblidheshin në fushën e betejës dhe mjekoheshin nga shërbimet mjekësore.

---

24. Kanuni i Lekë Dukagjinit, vepër e Shtjefën Gjeçovit ribotohet sipas botimit të vitit 1933 shtypur në Shkodër, L I B R I I D H E T Ë T *K A N U N I K U N D R A M B R A P S H I T Ë V E T*, KRYE I NJIZETËT., HJEKSIJA.§.766.
25. Quotations from the Bible, 9 Sep 2010, www.quotegarden.com/bible.html
26. Abu Bakr (Abdullah ibn Abi Quhafa), *en.wikipedia.org/wiki/Abu_Bakr*
27. Folklor: Gjergj Elez Alia, www.albasoul.com/vjeter/modules.php
28. **Cavalier - definition and meaning**, www.wordnik.com/words/cavalier
29. Jean Pictet, KNKK, Zhvillimi dhe parimet e së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare, Tirane 2001, f.21
30. Jean Pictet, "Zhvillimi dhe Parimet e së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare", Komiteti Nërkombëtar i Kryqit të Kuq, Tiranë 2001.f.24.

Në shekullin e 16–të, vihet re dukuria e zhvillimit të një sistemi marrëveshjesh kapitullimi dhe shkëmbimi të robërve midis komandave të ushtrive armike.[31] Një marrëveshje e këtij lloji është edhe më e hershme. Ajo i përket vitit 1393 dhe është lidhur midis Kantoneve të Zvicrës. Marrëveshja, që njihet me emrin "Letra e grave", përmban dispozita ku përcaktohet se gratë duhet të mbahen larg luftës, ndërsa të plagosurit të respektoheshin dhe t'u mbrohej prona.

Në shekullin e 17–të, në periudhën e iluminizmit, filozofët mendonin se të gjithë njerëzit kanë të drejta të barabarta e të patjetërsueshme. Shtetet kishin detyrimin e sigurimit të këtyre të drejtave. Qëllimi kryesor ishte të fitohej sa më shumë lumturi, për një numër sa më të madh njerëzish.

Më vonë, në shekullin e 18–të, lufta u vu nën kontrollin e njeriut. Civilët nuk ishin më drejtpërdrejt të përfshirë në luftë, sepse lufta zhvillohej ndërmjet ushtrive profesioniste, me numër të vogël ushtarësh. Metodat mizore e të pabesa u ndaluan.

Një dokument i njohur i kësaj periudhe ishte "Traktati i miqësisë dhe i paqes", i arritur nga Frederiku i Madh dhe Benjamin Franklin,[32] në vitin 1785, i cili përmbante nene që u ngritën në nivelin e parimeve e ku për herë të parë gjejmë idetë se palët "zotohen në mënyrë të ndërsjelltë dhe përpara gjithësisë" dhe se qëllimi i konventës midis shteteve ishte për të vendosur se sa viktima do të trajtoheshin. [33] Në këtë dokument robërit e luftës do të ushqeheshin dhe strehoheshin në të njëjtat kushte me ushtarët e forcës që i mbante rob dhe se një njeri i besuar do të lejohej t'i vizitonte dhe t'u lehtësonte vuajtjet.

Marrëveshje të tilla dëshmojnë përpjekje për humanizimin e luftës, megjithatë këto marrëveshje ishin të vlefshme vetëm për konflikte të veçanta.

Në vitin 1745, në betejën e Fontenuasë, [34] Luigjin e 15 – të e pyetën se si duheshin të trajtoheshin armiqtë e plagosur. Përgjigja ishte: "Njëlloj si njerëzit tanë, sepse kur janë të plagosur, ata nuk janë më armiqtë tanë".

Në vitin 1762, Zhan Zhak Rusoi, një nga mendimtarët më të mëdhenj të kohës, shprehej kështu në kontratën shoqërore: [35] "Lufta nuk është marrëdhënie midis njerëzve, por midis shteteve dhe individët janë armiq krejt të rastësishëm, jo si njerëz apo qytetarë, por si ushtarë, jo si shtetas të vendit të tyre, por si mbrojtësit e tij.... Meqë objekti i luftës është shkatërrimi i shtetit armik, pala tjetër ka të drejtë të vrasë mbrojtësit e tij gjatë kohës që ata mbajnë armë, por me të hedhur armët dhe me t'u dorëzuar, ata pushojnë se qëni armiq, apo vegla të armikut dhe bëhen përsëri thjesht njerëz, jetët e të cilëve askush s'ka të drejtë t'i marrë".

---

31. Jean Pictet, "Zhvillimi dhe Parimet e së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare", Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Tiranë 2001.f.24.
32. Benjamin Franklin (17 janar 1706 - 17 prill 1790), është konsideruar si një prej baballarëve themelues të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ai është një njeri i shquar që kishte njohuri në shumë fusha. Si shkencëtar, ai ishte një figurë madhore në historinë e fizikës për zbulimet dhe teoritë e tij në lidhje me elektricitetin. Si diplomat, gjatë revolucionit amerikan, ai siguroi aleancën franceze që ndihmoi në arritjen e pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në vitin 1776, ai u emërua ambasador i SHBA në Francë dhe arriti në vitin 1778 të siguronte një aleancë ushtarake me Francën.
33. "Treaty of Friendship and Peace.", www.cnchl-cncdh.ca/main.asp?id=009204
34. **Historical Research 5: Fontenoy 1745**, www.twcenter.net › ... › **The Rights of Man**
35. Jean Jacques Rousseau (1762). The Social Contract Or Principles of Political Right. etching of Rousseau., www.marxists.org/reference/.../rousseau/social-contract/index.htm

Kështu Rusoi hedh themelet për dallimin që duhet bërë midis luftuesve dhe joluftuesve të palës armike, duke qenë se qëllimi i luftës është shkatërrimi i forcave të armatosura armike dhe jo shkatërrimi i krejt kombit armik. Forca mund të përdoret vetëm kundër luftuesve të armatosur. Të plagosurit që nuk mund të luftojnë më për shkak të plagëve, nuk janë më objekt i veprimeve luftarake dhe nuk duhen parë më si armiq.

Vazhdimi i këtyre ideve janë "Parimet e pavdekshme" të Revolucionit francez të 1789, i cili shpallte me madhështi në Kushtetutë se "Çdo qënie njerëzore zotëron të drejta të patjetërsueshme dhe të shenjta" dhe miratoi të parën Deklaratë të të Drejtave të Njeriut.[36]

Për herë të parë në historinë e luftërave u vendos shërbimi i detyrueshëm ushtarak për të gjithë dhe shërbimi mjekësor i rregullt në rradhët e ushtrisë franceze. Ky shërbim kishte për detyrë të kujdesej edhe për të plagosurit e të sëmurët e palës kundërshtare, të kapur gjatë veprimeve ushtarake. Në Francë, në vitin 1792, për herë të parë në histori shpallej se robërit e luftës viheshin nën mbrojtjen e ligjit.[37]

Me përmbysjen e revolucioni francez të vitit 1789, parimet revolucionare u sprapsën dhe filloi epoka e luftërave të egërsisë së shfrenuar. Shërbimi shëndetësor ushtarak nuk përmendej më. Marrëveshje nënshkruheshin shumë rallë dhe pothuajse nuk zbatoheshin. U hoq dorë nga mbrojtja e spitaleve fushore, mjekëve të kapur rob dhe të plagosurve.
Në fushatën e tij në Egjipt, Napoleoni urdhëroi të vriteshin 4000 ushtarë turq të një garnizoni (të Jafas), të cilëve iu ishte premtuar se do t'iu falej jeta po qe se dorëzoheshin.

"Luftërat e pashmangshme janë gjithmonë luftëra të drejta", shpallte Napoleoni. Pushtuesi i madh s'e vriste shumë mendjen për pasojat e luftës. Ajo ç'ka ai kish nevojë ishte mishi i ri për të ushqyer ambicjen e tij drejt lavdisë. Për këtë arsye vdekshmëria në

ushtri ishte tmerrësisht e lartë dhe vuajtjet e të plagosurve të lemerishme. Mjafton të përmenden tmerret e tërheqjes nga Rusia, ende të freskëta, megjithë tmerret që kanë ndodhur më pas. Dramat e mëdha kanë edhe anët e tyre të fëlliqura dhe pikërisht për këtë Austerlici[38] është përshkruar si një "Vaterlo mjekësore".[39] Beteja e Vaterlosë (1815), ishte një betejë që ndryshoi përgjithmonë faqen e Europës. Një ditë luftimesh të ashpra që shkatërroi ëndrrat e Napoleonit dhe e çliroi kontinentin nga kërcënimi i ambicjeve të tij.

2.2.1 Marrëveshjet reciproke

Deri në mes të shekullit të XIX, marrëveshjet për mbrojtjen e viktimave të luftës kishin karakter të rastësishëm dhe vepronin vetëm ndaj palëve kontraktuese dhe në bazë të një reciprociteti të përpiktë.

---

36. **Declaration of the Rights of Man and of the Citizen**, of 29 October **1789**, en.wikipedia.org/.../Declaration_of_the_Rights_of_Man_and_of_the_Citizen
37. Arben Puto, E Drejta Ndërkombëtare Publike, f.527.
38. Në dhjetor 1805 në Austerlic, ushtritë austriake dhe ruse u shkatërruan plotësisht. Kjo ishte fitorja më e madhe e Napoleonit. Austerlici ishte një betejë e përgjakshme që pati efekt të thellë në rrjedhën e historisë europiane.
    Në vitin 1812, Napoleon Bonaparti ndërmori një aventurë të madhe, pushtimin e Rusisë, me një ushtri prej më se 650.000 trupash, më e madhja që bota kishte parë ndonjëherë. Progresi i parezistueshëm i Perandorit në brendësi të Rusisë u shoqërua me shumë konflikte brutale, përfshirë betejën e Borodinos, një prej luftimeve më të përgjakshme në histori. Napoleoni nuk do të ishte mposhtur po të mos kishte qenë dinakëria ruse dhe bora e egër e dimrit rus. Edhe sot përmendet tërheqja famëkeqe nga Moska, për vuajtjet e ushtarëve.
39. Dr.Andre Soubiran, Napoleoni dhe një milion të vdekurit, Paris, 1969.

Traktatet e hershme të konfliktit të armatosur shpesh përmbanin klauzola të njohura si klauzolat e pjesëmarrjes, të cilat kishin kuptimin që traktati në fjalë nuk zbatohej në qoftë se të gjithë ndërluftuesit nuk ishin palë e tij. Kështu në qoftë se një shtet jo palë nënshkruese e traktatit implikohej në luftë të gjithë pjesëtarët e tjerë shkarkoheshin nga bashkëveprimi me traktatin. Pra rregullat e përcaktuara në traktate zbatoheshin vetëm ndërmjet palëve kontraktuese dhe vetëm atëhere kur të gjithë ndërluftuesit ishin palë të një traktati.

Një shembull është neni 2 i Konventës Nr.IV të Hagës të vitit 1907, ku u parashikua se: "Dispozitat e përmbajtura në Rregulloret e përmendura në nenin 1, si dhe në këtë Konventë nuk zbatohen përveç se midis palëve kontraktuese dhe atëherë vetëm në rast se të gjitha palët ndërluftuese janë palë në këtë Konventë".

Në Protokollin e Gjenevës të vitit 1925, shtetet nënshkruese vendosën të zbatonin protokollin derisa edhe armiku ta zbatonte atë. Pohimi i Francës ishte më tipiku. Protokolli i Gazit[40] nuk do të zbatohet nga qeveria e Republikës së Francës ndaj një shteti armik, forcat e armatosura të të cilit, ose aleatët e tij nuk respektojnë parashikimet e vendosura në këtë protokoll.[41]

Konventat e Gjenevës të vitit 1949 ishin një pikë orientuese përsa i përket problemit të marrëveshjeve reciproke. Ato parashikonin që edhe në qoftëse një nga ndërluftuesit nuk është palë e konventave, ndërluftuesit e tjerë që janë palë duhet të zbatojnë detyrimet e Konventës në marrëdhëniet e tyre reciproke.[42]

Palët e konventave janë gjithashtu të detyruar të zbatojnë konventën edhe kur shtetet që nuk janë palë i pranojnë dhe i zbatojnë detyrimet e Konventave. Natyrisht ata që nuk janë palë nënshkruese të konventave mund të bëjnë deklarata bashkëpunimi dhe pastaj të mos i zbatojnë. Në qoftëse ndodh kështu konventa nuk do të zbatohet. Nga ana tjetër, në qoftë se shtetet që nuk janë palë e konventave bashkëpunojnë përgjegjshmërisht, pra e zbatojnë konventën, me përjashtim të ndonjë shkarje të rastit, konventa do të zbatohet.

Konventat e Gjenevës janë të vlefshme në të gjitha rrethanat. Asnjë nga palët ndërluftuese nuk mundet me qëllim të shkelë parashikimet e konventave, duke vrarë ose keqtrajtuar robër lufte për faktin se pala kundërshtare është fajtore për akte të tilla. Konventat e Gjenevës kanë si parim themelor humanizmin. Mosrespektimi për arsye reciprociteti i konventave të Gjenevës nga palët ndërluftuese do të sillte vuajtje për të pafajshmit e pambrojtur. Neni 60 i Konventës së Vjenës të 25 majit 1969 mbi "Të Drejtën e Traktateve", thekson se një dhunim thelbësor i një traktati shumëpalësh nga një prej palëve i jep të drejtë palëve të tjera të ndërpresin zbatimin e traktatit, pjesërisht apo plotësisht. Megjithatë, i njëjti nen përmban një përjashtim nga ky rregull, përsa i përket masave që përmbahen në traktate me karakter humanitar në lidhje me mbrojtjen e njerëzve.

---

40. Protokolli për ndalimin dhe përdorimit në luftë të lëndëve mbytëse, helmuese, ose gazrave të tjera dhe të metodave bakteriologjike të luftës, Gjenevë, 17 qershor 1925.
41. Turkish General Staff, Guide to the law of Armed Conflict of Armed Forces, Ankara, June 2001, f.19.
42. Common article 2, para. 3 of the Geneva Conventions of 1949.

2.3 KUR ZBATOHET E DREJTA NDËRKOMBËTARE HUMANITARE?

E drejta ndërkombëtare humanitare zbatohet vetëm në konflikt të armatosur. Ajo nuk merret me tensione të brendshme ose shqetësime, siç janë aktet e izoluara të dhunës. Ajo zbatohet vetëm pasi fillon konflikti dhe për të gjitha palët njëlloj, pa marrë parasysh se kush i filloi luftimet.

Pra, arsyeja e përdorimit të forcës, nëse rrëmbimi i armëve është i përligjur ose jo, nëse përbën një akt të pastër agresioni, apo nëse pala e sulmuar bën ose jo rezistencë, nuk ka asnjë rëndësi për të drejtën ndërkombëtare humanitare. Në momentin që fillon një konflikt i armatosur palët duhet të zbatojnë konventat përkatëse.[43] E drejta ndërkombëtare humanitare humbet çdo ndikim, kur konflikti mbaron, gjë që praktikisht nënkupton se të gjithë robërit e luftës janë riatdhesuar, të gjithë të internuarit civilë janë liruar dhe të gjithë territoret e pushtuara janë çliruar.[44]

E drejta ndërkombëtare njeh së paku katër lloje të ndryshme të situatave të konfliktit dhe secila prej tyre ka norma ligjore të veçanta.[45]

1. Situatat e tensionit dhe shqetësimet
2. Konfliktet e armatosura ndërkombëtare
3. Luftërat për çlirim kombëtar
4. Konfliktet e armatosura të brendshme

Situatat e tensioneve dhe shqetësimeve të brendshme[46]

Termi "tensione dhe shqetësime të brendshme" i referohet situatave që nuk arrijnë në konflikt të armatosur, por përfshijnë përdorimin e forcës dhe masave të tjera represive nga një qeveri për të ruajtur ose rivendosur rregullin dhe qetësinë publike. Në situata të tilla zbatohet vetëm e drejta ndërkombëtare që merr në mbrojtje të drejtat e njeriut. Megjithatë qeveritë lejohen të kufizojnë të drejtat e njeriut në këto situata tensioni.

Konfliktet e armatosura ndërkombëtare

Termi "konflikt i armatosur ndërkombëtar" i referohet situatave që përfshijnë dy ose më shumë shtete të angazhuara në konflikt të armatosur. Në situata të tilla vepron e drejta ndërkombëtare humanitare, veçanërisht ajo që përfshihet në katër konventat e Gjenevës dhe në Protokollin e Parë Shtesë. Mbeten gjithashtu të zbatueshme në këto situata garancitë e të drejtave njerëzore, përveç disa kufizimeve që u lejohen qeverive në situata tensionesh.

43. Jean Pictet, in his commentary to this clause of common article 2, states: "Any difference arising between two States and leading to the intervention of armed forces is an armed conflict within the meaning of Article 2, even if one of the Parties denies the existence of a state of war. It makes no difference how long the conflict lasts, or how much slaughter takes place. The respect due to human personality is not measured by the number of victims. Nor, incidentally, does the application of the Convention necessarily involve the intervention of cumbrous machinery. It all depends on circumstances". J. S. Pictet (dir.), Commentary: Geneva Convention for the Amelioration of the Condition of the Wounded and Sick in Armed Forces in the Field, Genève, CICR (1952), p.32
44. Konventa (IV) e Gjenevës për Mbrojtjen e Personave civilë në kohë lufte,12 gusht 1949, neni 44 & Protokolli i I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës të12 gushtit 1949, neni 73.
45. International Law and International Armed Conflicts, Mark Flaerman, September 2000, f.2.
46. D. Schindler, "The different types of armed conflicts according to the Geneva Conventions and Protocols", RCADI, vol, 163 (1979-II), p. 117; H.-P. Gasser, "Internationalized non-international armed conflict", 33 Am. Univ. L. Rev. (1983), p.145; Y. Sandoz, loc. Cit. note 11, section 2.4.1.

Luftërat për çlirim kombëtar

Termi "luftëra për çlirim kombëtar" i referohet konflikteve të armatosura, në të cilat "popujt luftojnë kundër sundimit kolonial, okupimit të huaj dhe regjimeve raciste, në zbatim të së drejtës për vetvendosje".[47] Në përgjithësi të njëjtat parashikime të së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe të drejtës ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, që zbatohen në konfliktin e armatosur ndërkombëtar, që merr në mbrojtje të drejtat e njeriut, zbatohen edhe në luftërat për çlirim kombëtar.

Konfliktet e armatosura të brendshme

Termi "konflikt i armatosur i brendshëm" i referohet të gjitha konflikteve të armatosura, të cilat nuk mund të konsiderohen as si konflikte të armatosura ndërkombëtare dhe as si luftëra për çlirim kombëtar. Protokolli i Dytë Shtesë i vitit 1977, parashikon që konfliktet e armatosura të brendshme zhvillohen në territorin e një pale të lartë kontraktuese ndërmjet forcave të saj të armatosura dhe forcave të armatosura disidente, ose grupeve të armatosura e të organizuara, të cilët nën udhëheqjen e një komandanti përgjegjës, ushtrojnë në një pjesë territori një kontroll të tillë që u lejon atyre të ndërmarrin operacione ushtarake të vazhdueshme e të planifikuara dhe të zbatojnë këtë protokoll.[48] Në konfliktet e armatosura të brendshme zbatohet neni i përbashkët 3 i katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949 dhe Protokolli i Dytë Shtesë i vitit 1977.

2.3.1 Konflikti i armatosur i brendshëm dhe sovraniteti

Në qoftëse bëhet një krahasim ndërmjet konfliktit të armatosur të brendshëm dhe atij ndërkombëtar rezulton se pika e referimit që i dallon është kufiri shtetëror. Luftërat midis dy ose më shumë shteteve konsiderohen konflikte të armatosura ndërkombëtare, ndërsa përleshjet me armë që ndodhin në territorin e një shteti të vetëm janë konflikte të armatosura jondërkombëtare, (të brendshme), ose siç njihen zakonisht, luftëra civile.[49]

Historikisht shtetet kanë hartuar pa mbarim akte që rregullojnë marrëdhëniet midis tyre, qoftë edhe në kohë luftë. Por kur bëhet fjalë për "luftë civile", ata pretendojnë se është çështje e brendshme.

Konfliktet e armatosura jondërkombëtare, si konflikte të armatosura që ndodhin brenda territorit të një shteti, pra midis qeverisë nga njëra anë dhe grupeve të armatosura kryengritëse nga ana tjetër, ndodhin për shkaqe të ndryshme. Kryengritësit ose forcat rebele, sido që të quhen, luftojnë për të arritur pavarësi brenda shtetit të tyre, për të marrë pushtetin, ose për t'u ndarë dhe krijuar shtetin e tyre. Çdo interes ndërkombëtar në ngjarje që shkaktojnë prishjen e paqes brenda një shteti, pengohet nga pretendimi i qeverive se në punët e tyre të brendshme duhet përjashtuar ndërhyrja nga jashtë.

---

47. Paragraph 1 of article 43 of Protocol I provides that: "The armed forces of a Party to a conflict consist of all organized armed forces, groups and units which are under a command responsible to that Party for the conduct of its subordinates, even if that Party is represented by a government or an authority not recognized by an adverse Party. Such armed forces shall be subject to an internal disciplinary system which, inter alia, shall enforce compliance with the rules of international law applicable in armed conflict".
48. Protokolli i II-të Shtesë i konventave të Gjenevës të12 gushtit 1949, që lidhet me mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura jondërkombëtare, 8 qershor 1977, neni 1.
49. Hans Peter Gasser, E drejta Ndërkombëtare Humanitare, Dhjetor 2000, f.26.

Në rast se pjestarët e këtyre grupeve të armatosura bien në duart e palës që është në pushtet, ata nuk gëzojnë të drejtën e statusit të robit të luftës dhe gjykohen në bazë të së drejtës së vendit për çdo shkelje që mund të kenë kryer gjatë operacioneve të tyre të armatosura. Në mënyrë të ngjashme, në rast se një pjestar i forcave të armatosura bie në duart e kryengritësve, ai nuk është rob lufte.

Sovraniteti shtetëror tashmë është një çështje e debatueshme në komunitetin ndërkombëtar. Dihet rëndësia e sovranitetit shtetëror në krijimin e kushteve brenda një vendi, sipas gjykimit të qeverisë së atij vendi. Mirëpo, konfliktet e brendshme shkaktojnë po aq plagë dhe shkatërrime sa edhe konfliktet midis shteteve. Mund të thuhet se luftërat civile sjellin më shumë vuajtje se luftërat ndërkombëtare, për shkak të urrejtjes dhe egërsisë së tyre. Kjo ndodh sepse në një luftë civile kundërshtarët e njohin mirë njëri-tjetrin dhe kanë arsye personale për t'u urryer gjë që përjashtohet në përleshjet midis kombeve, ku ushtarët nuk kanë arsye vetjake kundër armikut.

Ideja e zbatimit të së drejtës ndërkombëtare humanitare në rast përplasjesh të brendshme nuk është diçka e pabazuar. Neni 3 i përbashkët i konventave të Gjenevës të vitit 1949, trajton pikërisht konfliktet e armatosura jondërkombëtare, po ashtu edhe protokolli i dytë shtesë i vitit 1977. Megjithatë, në praktikë ekzistojnë mosmarrëveshje mbi zbatimin e të drejtës ndërkombëtare humanitare, në rast konfliktesh midis qeverisë dhe një lëvizjeje kryengritëse.

Kriteri që përdoret në këtë rast është intensiteti i dhunës dhe nevoja për mbrojtjen e viktimave. Shpesh herë qeveritë nuk duan të diskutojnë këtë çështje, duke u justifikuar se trazirat janë një çështje e brendshme shtetërore.

Neni 3 i Konventave të Gjenevës zbatohet kur qeveria dhe kryengritësit kundërshtojnë njëri-tjetrin në përleshje kolektive, duke përdorur forcën e armëve. Qeveria përdor forcat e armatosura sepse forcat e zakonshme të policisë nuk janë më në gjendje të kryejnë funksionin e tyre. Kryengritësit luftojnë kundër rendit, janë të organizuar dhe udhëhiqen nga persona përgjegjës për operacionet e tyre.

Protokolli i II-të ka qartësuar se "turbullirat dhe tensionet e brendshme", "përleshjet", "aktet e izoluara dhe sporadike të dhunës" si dhe "aktet e tjera të një natyre të ngjashme", në vetvete nuk përbëjnë një konflikt të armatosur dhe prandaj nuk janë subjekt i të drejtës ndërkombëtare humanitare.[50]

Për të bërë të mundur detyrimin e palëve të një konflikti të arrijnë një marrëveshje mbi zbatimin e të drejtës ndërkombëtare është e nevojshme marrja e një vendimi nga Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Shtetet e treta mundet gjithashtu të ushtrojnë presion mbi shtetin në konflikt.

---

50. The term is partially defined in article 1(a) of Protocol II of 1977 relating to the Protection of Victims of Non-international armed conflicts. At signature the UK made a statement indicating that "armed conflict" implies a certain level of intensity; p.467. For discussion of the term, see M. Both, K.J. Partsch and W.Solf, New Rules for Victims of Armed Conflicts, Nijhoff (1982); Y. Sandoz, C. Swinarski & B. Zimmermann (ed.), Commentary on the Additional Protocols, ICRC (1987).

2.4 FUSHAT QË MBULON E DREJTA NDËRKOMBËTARE HUMANITARE

E drejta ndërkombëtare humanitare mbulon dy fusha:

- mbrojtjen e atyre që nuk marrin pjesë, ose nuk marrin më pjesë në luftime;
- kufizimet në mjetet dhe metodat e luftës.

2.4.1 Çfarë është mbrojtja? [51]

E drejta ndërkombëtare humanitare mbron ata që nuk marrin pjesë në luftim, siç janë civilët dhe personeli mjekësor dhe fetar. Ajo gjithashtu mbron ata që nuk marrin më pjesë në luftim, siç janë të plagosurit, anije mbyturit, luftuesit e sëmurë dhe robërit e luftës.

Këto kategori personash gëzojnë të drejtën e respektit për jetën e tyre dhe për integritetin e tyre fizik dhe mendor. Ata gjithashtu gëzojnë garanci ligjore. Ata duhet të mbrohen dhe të trajtohen në mënyrë njerëzore në çdo rrethanë, pa asnjë dallim.

Në mënyrë më të specifikuar: Eshtë e ndaluar të vritet, ose plagoset një armik që dorëzohet ose që nuk është në gjendje të luftojë. Të plagosurit dhe të sëmurët duhet të grumbullohen dhe të ndihmohen nga pala në duart e të cilës ndodhen. Personeli mjekësor, pajisjet, spitalet dhe ambulancat duhet të mbrohen të gjitha. Ka gjithashtu rregulla të

detajuara që merren me kushtet e ndalimit për robërit e luftës dhe mënyrës sipas të cilës duhet të trajtohen civilët kur janë nën autoritetin e fuqisë armike. Kjo përfshin sigurimin e ushqimit, strehimit dhe kujdesit mjekësor dhe të drejtën për të shkëmbyer mesazhe me familjet e tyre.

E Drejta Humanitare vendos një numër simbolesh krejt të dallueshme, të cilat mund të përdoren për të identifikuar njerëzit, vendet dhe objektet e mbrojtura. Emblemat kryesore janë Kryqi i Kuq, Gjysmëhëna e Kuqe dhe simbolet që identifikojnë pasurinë kulturore dhe ambjentet e mbrojtjes civile.

Sipas nenit 58 të Protokollit të Parë të Gjenevës duhet të bëhet dallim midis luftuesve dhe joluftuesve. Luftuesit lejohen të marrin pjesë drejtpërdrejtë në luftime. Joluftuesit nuk lejohen. Luftuesit mund të sulmohen. Joluftuesit mbrohen nga sulmi, por e humbasin mbrojtjen e tyre në rast se marrin pjesë drejtpërdrejt në luftime.

Dallimi duhet të bëhet edhe ndërmjet objektivave ushtarake që mund të sulmohen[52] dhe objekteve civile që nuk mund të sulmohen. Objektet civile duhet të respektohen.

Objekt civil është çdo objekt që nuk është një objektiv ushtarak.

Objektet civile përfshijnë:[53]

51. Shih: Pietro Verri," Fjalor i së Drejtës Ndërkombëtare të Konfliktit të Armatosur", Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Tiranë 2001, f.89.
52. Konventa IV e Gjenevës për mbrojtjen e personave civilë në kohë lufte,12 gusht 1949, neni 4 & Protokolli I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës, nenet 44, 48.
53. Shih protokolli I-rë shtesë i konventave të Gjenevës, neni 52.

a. qytetet dhe fshatrat;
b. ndërtesat dhe ambjentet e përdorura nga civilët, sa kohë që ato nuk përdoren për qëllime ushtarake, si trojet e shtëpive dhe shtëpitë, pallatet dhe apartamentet, fabrikat, punishtet që prodhojnë mallra jo për përdorim ushtarak, zyrat, dyqanet, aviacionin publik, vendet e kultit, automjetet, trenat etj;
c. ushqimet dhe zonat e prodhimit të mallrave ushqimore, puset dhe burimet e tjera ujore.

Një ndërtesë civile bëhet objektiv ushtarak në rast se përdoret për qëllime ushtarake, për shembull, në rast se një bllok zyrash përdoret për zyrat e shtabit ushtarak, ose një shtëpi përdoret si një pikë snajperi, ose një plevicë përdoret për parkimin dhe maskimin e automjeteve ushtarake.

Objektet ku civilët kryejnë punë me natyrë ushtarake si për shembull, një fabrikë municionesh në të cilën punojnë vetëm civilë, mund të bëhen objektiva ushtarake.

Në rast dyshimi nëse një objekt që normalisht u është kushtuar qëllimeve civile (për shembull, një vend kulti, një shtëpi, një vendbanim tjetër apo një shkollë) është apo jo një objekt ushtarak, ai duhet të konsiderohet objekt civil.

Objektivat ushtarake kufizohen në ato objekte që nga natyra, vendndodhja, qëllimi ose përdorimi i tyre japin një ndihmesë të efektshme në aksionin ushtarak dhe shkatërrimi i plotë ose i pjesshëm, zënia rob ose neutralizimi i tyre, në rrethanat mbizotëruese në atë kohë, përbën një përfitim ushtarak të padiskutueshëm.

Objektivat ushtarake përfshijnë:

a. forcat e armatosura, përveç personelit dhe objektivave mjekësore dhe fetare;
b. repartet, ndërtesat dhe pozicionet, ku janë vendosur forcat e armatosura apo materialet e tyre, (për shembull, pozicionet e luftimit, kazermat, depot).

Objektivat ushtarakë[54] nuk janë vetëm objekte me natyrë ushtarake, si tanket apo aviacioni ushtarak, por edhe objekte me natyrë civile që japin një ndihmesë të efektshme në aksionin ushtarak si për shembull, linjat dhe objektet e komunikimit, objektivat në prapavijë, larg luftimit konkret.

Një objektiv ushtarak mbetet i tillë edhe nëse në të ka persona civilë.
Civilëve që ndodhen brenda një objekti të tillë, ose në rrethinat më të afërta të tij, u kanoset i njëjti rrezik ndaj të cilit është ekspozuar ky objektiv.

Kur sulmohen objektivat ushtarake, civilët dhe objektet civile duhet të ruhen në maksimumin e mundshëm ndaj dëmtimeve të rastit. Dëmtimet e rastit nuk duhet të jenë të tepruara në lidhje me përfitimin e drejtpërdrejtë dhe konkret ushtarak të pritur nga një sulm mbi një objektiv ushtarak. (Parimi i proporcionalitetit)

---

54. Protokolli i I-rë i Gjenevës, neni 43, 52.

Parimi i proporcionalitetit kërkon një përllogaritje të viktimave të mundshme, si ushtarake ashtu dhe civile dhe të dëmeve, të krahasuara me përfitimin e veçantë ushtarak të pritur nga sulmi. Ai kërkon të bëhet një vlerësim i rrezikut, pasojave të keqfunksionimit të armëve dhe të gabimeve njerëzore, por jo të çështjeve të cilat sulmuesi nuk mund t'i kontrollojë dot, siç janë pasojat e sulmit të kundërshtarit. Pra, sipas këtij parimi humbjet e jetëve dhe dëmtimet e pronave nuk duhet të kalojnë masën në raport me avantazhin ushtarak të fituar.

Parimi i domosdoshmërisë ushtarake[55] nga ana tjetër kërkon që e gjithë veprimtaria ushtarake duhet të justifikohet me motivet ushtarake sepse veprimtaria që nuk është ushtarakisht e domosdoshme nuk duhet të kryhet.

Në parathënien e Deklaratës së Shën Petërburgut të vitit 1868, përsa i përket parimit të domosdoshmërisë ushtarake, thuhet: "I vetmi objektiv i ligjshëm të cilin shtetet duhet të përmbushin gjatë luftës, është të dobësojnë forcat ushtarake të armikut. Për këtë qëllim është e mjaftueshme të bësh të paaftë, mundësisht, numrin më të madh të burrave". Sot ne sigurisht mund të përfshijmë edhe gratë.[56]

Ky parim është tërësisht praktik. Ai pranon realitetin e betejës dhe lejon çfarëdo: force të arsyeshme që është e nevojshme, është e ligjshme dhe mund të jetë e justifikuar nga ana

operacionale në luftime për ta bërë kundërshtarin të dështojë. Aktivitetet të cilat janë haptazi të panevojshme ushtarakisht, janë të ndaluara.

2.4.2 Kufizimet në përdorimin e armëve dhe metodave të luftës

Qëllimi i luftës është mposhtja e rezistencës së kundërshtarit. Por kjo nuk mund të arrihet me të gjitha mjetet e mundshme.[57] E drejta e shteteve për të zgjedhur mjetet dhe metodat e luftimit nuk është e pakufizuar.[58]

E Drejta Ndërkombëtare Humanitare ka vendosur standarde të qarta për sjelljen në operacionet ushtarake dhe kufizon metodat dhe mjetet e lejueshme të luftës. Këto standarde ndalojnë përdorimin e armëve që nuk bëjnë dallim ndërmjet objektivave ushtarake dhe objekteve civile dhe që shkaktojnë dëme dhe vuajtje të panevojshme.[59]

E drejta ndërkombëtare humanitare ndalon të gjitha mjetet dhe metodat e luftës, të cilat:[60]

- Nuk bëjnë dallim ndërmjet atyre që marrin pjesë në luftime dhe atyre, siç janë civilët, që nuk marrin pjesë. Qëllimi është që të mbrohet popullsia civile, individët civilë dhe pasuria civile.
- Shkaktojnë dëmtime të tepërta ose vuajtje të panevojshme.

55. F.J. Hampson, "Proportionality and Necessity in the Gulf Conflict", American Society of International Laë, Proceedings of the 86th Annual Meeting, Ëashington, 1992, p. 45, at p.54.
56. KNKK, E drejta e konfliktit të armatosur, Dosje mësimore për instruktorët, Qershor 2002,Libri "Njohuritë bazë", f. 13.
57. Rregullat në lidhje me respektimin e ligjeve dhe zakoneve të luftës në tokë, Hagë, 18 Tetor 1907, neni 22.
58. Protokolli i I-rë i Gjenevës, neni 35.
59. Shih, ICRC (ed.), Symposium on anti-personnel mines, Montreux (21-23 April 1993); and "Report of the International Committee of the Red Cross for the Revieë Conference of the 1980 United Nations Convention on Prohibitions or Restrictions on the Use of Certain Conventional Weapons which may be Deemed to be Excessively Injurious or to Have Indiscriminate Effects", IRRC (1994), pp. 132-182.
60. What is International Humanitarian Law? Advisory service ICRC 2004 f.2.

- Synojnë ose priten të shkaktojnë dëmtime në masë, afatgjata dhe të rënda të mjedisit natyror.[61]

2.4.2. a Parime të përgjithshme mbi përdorimin e armëve

E drejta humanitare e ka ndaluar përdorimin e shumë armëve, duke përfshirë plumbat që shpërthejnë në trupin e njeriut, helmet ose armët helmuese, armët kimike dhe biologjike, plumbat që zgjerohen ose petëzohen në kontakt me trupin e njeriut, armët që të plagosin kryesisht me copëza të padiktueshme, armët verbuese me lazer dhe minat anti-njeri.
Protokolli i I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës të 1949, për shembull, ndalon sulmet me armë dhe municione që dëmtojnë pa dallim.[62] Kjo do të thotë se janë të ndaluara armët dhe municionet që godasin objektiva ushtarake dhe civilë ose objekte civile pa dallim, sepse në çdo rast drejtimi i tyre kundër një objektivi ushtarak mund të mos jetë i kontrollueshëm. Sipas nenit 35(2) të Protokollit të I-rë "Është gjithmonë e ndaluar të përdoren armë dhe predha të një natyre që shkaktojnë plagë të tepërta apo vuajtje të panevojshme".

E drejta e konfliktit të armatosur ndalon përdorimin e disa armëve dhe kufizon përdorimin e disa armëve të tjera. Para futjes në përdorim të armëve të reja, shtetet duhet të vlerësojnë nëse përdorimi i tyre do të binte ndesh me të drejtën ndërkombëtare.[63]

Që në lashtësi kishte prirje për të ndaluar përdorimin e disa lloj armësh, si armëve me helm ose shigjetave me zjarr, të topuzëve etj. Në Mesjetë, Kisha bëri përpjekje të ndalonte disa armë, sidomos arbaletën.

Konferenca e Shën Peterburgut e vitit 1868 dhe konferencat e Hagës të 1899 dhe 1907, shpallën ndalime të veçanta kundër armëve dhe municioneve që shkaktojnë dëmtime që nuk janë të domosdoshme për të arritur objektivat ushtarake. Pra, formuluan parime që ndalonin armët që shkaktonin dëmtime të panevojshme dhe në përpjestim të zhdrejtë me qëllimet e luftës.

Deklarata e Shën Peterburgut[64] (1868), ndalon përdorimin e municionit shpërthyes dhe djegës, ndërsa Konferenca e Parë e Paqes e Hagës (1899), deklaronte paligjshmërinë e përdorimit të plumbave "dum-dum" [65] dhe armëve të helmuara. Konferenca e Dytë e Paqes e Hagës (1907), vendosi kufizime që lidheshin me luftën detare, veçanërisht me vendosjen e minave.

---

61. H.P. Gasser, "For better protection of the natural environment in armed conflict: a proposal for action", 89 AJIL (1995), pp. 637-644, ëith the text of the "Guidelines for military manuals and instructions on the protection of the environment in times of armed conflict".
62. Protokolli i I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949, që lidhet me mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura ndërkombëtare, 8 qershor 1977, neni 51.
63. Protokolli i I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës të12 gushtit 1949, që lidhet me mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura ndërkombëtare, 8 qershor 1977,neni 36.
64. Ajo e ka origjinën në shpikjen, në vitin 1863, nga autoritetet ushtarake ruse të një plumbi që shpërthente në kontakt me substancat e forta. Meqë një plumb i tillë përbënte një instrument johuman të luftës, qeveria ruse, duke qenë e pavullnetshme për ta përdorur vetë ose për të lejuar ndonjë shtet tjetër që të kishte përparësinë e përdorimit të saj, sugjeroi që përdorimi i plumbit të ndalohej me marrëveshje ndërkombëtare. Deklarata, që u adoptua në vitin 1868 dhe kishte forcën e ligjit, konfirmonte rregullin zakonor sipas të cilit përdorimi i armëve, predhave dhe materialeve të një natyre që shkaktojnë vuajtje të panevojshme është e ndaluar. Deklarata e Shën Peterburgut nxiti adoptimin e deklaratave të mëtejshme të një natyre të ngjashme në dy konferencat e paqes të Hagës të vitit 1899 dhe vitit 1907.
65. Deklarata e IV e Hagës e vitit 1899 ka për qëllim ndalimin e plumbave dum-dum, të cilët quhen kështu sipas depos së armëve (arsenalit), afër Kalkutës në Indi nga kapiteni Neville Bertieclay ku plumbi u prodhua për herë të parë. Një plumb që zgjerohet është një plumb i dizenjuar për t'u zgjeruar në kontakt, duke u rritur në diametër për të kufizuar penetrimin dhe për të prodhuar një plagë me diametër më të madh.

Lufta e Parë Botërore njihej si lufta e gazit. Gazrat helmuese shkaktuan vuajtje të papërshkrueshme gjatë Luftës së Parë Botërore. Pas luftës për të eleminuar rrezikun e tmerrshëm të gazit helmues, u hartua Protokolli i Gjenevës[66] i 1925, i cili ndalonte përdorimin në luftë të gazrave asfiksues, helmues dhe gazrave të tjerë të ngjashëm.

Protokolli i Gjenevës i 1925 ndaloi gjithashtu përdorimin e armëve baktereologjike. Dispozitat mbi ndalimin e përdorimit të armëve kimike dhe baktereologjike zbatohen jo vetëm për përdorimin e drejtpërdrejtë kundër ushtarëve të palës kundërshtare, por gjithashtu për ndotjen toksike të ujit, të instalimeve të furnizimeve me ujë, të ushqimeve dhe përdorime të tjera të ngjashme.

Konventa mbi Ndalimin e Zhvillimit, Prodhimit dhe Depozitimit të Armëve Baktereologjike (biologjike) dhe Lëndëve Helmuese dhe mbi Shkatërrimin e tyre e 10 prillit 1972 ndalon këto armë jashtë mase mizore dhe përmban dispozita për verifikimin e zbatimit të tyre. Traktati i Armëve Kimike i vitit 1993, ndalon jo vetëm përdorimin, por gjithashtu edhe prodhimin dhe zotërimin e armëve kimike.

Zotërimi dhe përdorimi i armëve bërthamore rregullohet nga parimet e përgjithshme të së drejtës së konfliktit të armatosur. Ka gjithashtu një numër konventash që rregullojnë

disa aspekte të armatimit bërthamor. Mund të përmendim Traktatin e mospërhapjes së armëve bërthamore të 1 korrikut 1968, ose ndalimin mbi vendosjen e këtyre armëve në hapësirë, të përfshirë në Traktatin e eksplorimit të hapësirës, të 27 janarit 1967, dhe traktatin mbi heqjen e armëve bërthamore nga fundi i detit, të 11 shkurtit 1971. Traktati i Moskës, i datës 5 gusht 1963[67], që ndalon provat me armë bërthamore në hapësirën e brendshme, ose të jashtme, ose nën ujë. Traktati i Londrës, Moskës dhe Uashingtonit, të datës 1 korrik 1965, për mospërhapjen e armëve bërthamore.

Në Konferencën Diplomatike në të cilën u hartua Protokolli i I-rë i Gjenevës, çështja e armëve bërthamore[68] u përjashtua. Bisedimet u mbështetën në një projekt-tekst të përgatitur nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, në të cilin deklarohej shprehimisht se ai nuk synonte të merrej me çështjen e armëve bërthamore.

Konsiderohet si fakt shumë i rëndësishëm miratimi i rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në 1961, e cila e dënoi përdorimin e energjisë bërthamore në luftë si dhunim të parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe të humanizmit.

---

66. Protokolli "Mbi ndalimin në luftë të gazrave asfiksuese ose helmuese dhe metodave baktereologjike të luftës", zakonisht i quajtur Protokolli i Gjenevës, është një traktat që ndaloi për herë të parë përdorimin e armëve kimike dhe biologjike. Ai u nënshkrua në Gjenevë në 17 qershor 1925 dhe hyri në fuqi në 8 shkurt 1928. Ai ndalon përdorimin e armëve kimike dhe biologjike, por nuk përmban dispozita rreth prodhimit, magazinimit ose transferimit. Këto aspekte u mbuluan më vonë me konventën e vitit 1972 për Armët Biologjike dhe me atë të vitit 1993 mbi Armët Kimike.
67. On August 5, 1963, the Limited Test Ban Treaty was signed by the United States, Great Britain, and the Soviet Union. After Senate approval, the treaty that ëent into effect on October 10, 1963, banned nuclear weapons testing in the atmosphere, in outer space, and under water. http://www.ourdocuments.gov/doc.php?flash=true&doc=95
68. Në vitin 1996 Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë dha një opinion këshillues mbi "ligjshmërinë e kërcënimit ose përdorimit të armëve nukleare". U bë e qartë, në paragrafët 54, 55 se e drejta ndërkombëtare mbi armët helmuese, (Deklarata e Dytë e Hagës e 29 korrikut 1899, konventa IV e Hagës e 18 Tetorit 1907 dhe Protokolli i Gjenevës i 17 qershorit 1925), nuk mbulojnë armët nukleare, sepse përdorimi i tyre primar, ose ekskluziv nuk ishte të helmonin ose asfiksonin.

Përveç armëve atomike, baktereologjike dhe kimike, ekzistojnë edhe armët konvencionale[69], që munden gjithashtu të kenë efekt shfarosës, që veprojnë pa dallim dhe shkaktojnë vuajtje të panevojshme. Të tilla janë armët djegëse, (napalmi dhe flakëhedhëset), armët plasëse (bombat plastike, predhat e kalibrit të vogël me shpejtësi të madhe të cilat mund të shkaktojnë pasoja të ngjashme me ato të plumbave dum-dum) dhe armët tinzare (bombat me plasje të vonuar të cilat pengojnë ndërhyrjet e shpëtimit, minat tokësore dhe minat surprizë).

Nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara në vitet 1979 dhe 1980, u thirr një Konferencë Ndërkombëtare, e cila më 10 tetor 1980, miratoi Konventën "Mbi Ndalimin ose Kufizimin e Përdorimit të Disa Armëve Konvencionale, të cilat mund të rezultojnë jashtëzakonisht të dëmshme, ose që sjellin dëmtime pa bërë dallim". Konventa vetë përmbante rregullat e procedurës dhe parimet më të rëndësishme ligjore. Ajo u plotësua me tre protokolle shtesë që përmbanin nenet bazë.

Protokolli i I-rë ndalon përdorimin e predhave që pas plasjes krijojnë copëza që nuk zbulohen në trupin e njeriut as me rreze X dhe që mundet për këtë arsye të jenë

jashtëzakonisht të vështira për t'u gjetur dhe për t'u hequr me rrugë kirurgjikale.[70] Protokolli është një zbatim i parimit të ndalimit të armëve që shkaktojnë plagë të tepërta ose vuajtje të panevojshme. Armë të tilla vështirësojnë trajtimin dhe shërimin, prandaj përdorimi i tyre nuk ka asnjë justifikim ushtarak.

Protokolli i II-të dënon përdorimin e minave, minave surprizë dhe çdo mjeti tjetër kundër popullsisë civile, ose në mënyrë të tillë që nuk bën dallim në shkaktimin ndaj civilëve të dëmtimeve të rastësishme, të cilat janë të tepërta në raport me dobinë konkrete dhe të drejtpërdrejtë që kërkohet prej tyre.[71] Protokolli gjithashtu nxjerr jashtë ligjit, në të gjitha situatat, minat surprizë të ndërtuara për të shkaktuar vuajtje të panevojshme. Sidomos ai ndalon vendosjen e minave surprizë në objekte fare të padëmshëm, duke përfshirë lodrat e fëmijëve, një veprim ky që ishte kryer më parë.

Protokolli i III-të bëri një hap të madh përpara, duke kufizuar përdorimin e armëve djegëse.[72] Ndalimi i përdorimit të tyre, në të gjitha rrethanat, kundër civilëve, u shtri më tej, duke përfshirë edhe objektivat ushtarake të vendosura pranë vendbanimeve civile, pyjeve dhe sipërfaqeve të gjelbra, përveç rasteve kur elementë të tillë natyrorë përdoren për të fshehur luftëtarë, ose objekte ushtarake.

Në 13 tetor 1995 Konventës iu shtua Protokolli IV, i cili ndalon përdorimin e armëve me rreze lazer[73], një prej funksioneve të të cilave është të shkaktojë verbim të përhershëm, ose zvogëlim të të parit.[74]

69. Shih: Y. Sandoz, "A neë step forëard in international laë: prohibitions or restrictions on the use of certain conventional weapons", IRRC (1981), pp. 3-18.
70. Protokoll për ciflat e pazbulueshme, (Protokolli I), Gjenevë, 10 Tetor 1980.
71. Protokolli mbi ndalimin, ose kufizimin e përdorimit të minave, minave surpizë dhe mjeteve të tjera shpërthyese, (Protokolli II i Konventës së vitit 1980, i ndryshuar në 3 maj 1996).
72. Protokolli mbi ndalimin, ose kufizimin e përdorimit të armëve zjarrvënëse, (Protokolli III i Konventës së vitit 1980).
73. See: e.g. ICRC (ed.), Blinding Weapons, Reports of the meetings of experts convened by the International Committee of the Red Cross on battlefield laser weapons 1989-1991, Geneva (1993).
74. L. Doswald-Beck (ed.), San Remo Manual on international law applicable to armed conflicts at sea, Cambridge, 1995 (with commentary), Text of the Manual to be published by International review of the Red Cross, 1995 (November-December). See also L. Doswald-Beck (ed.), "The San Remo Manual on international law applicable to armed conflicts at sea", 89 AJIL (1995), pp. 192-208.

Konventa e 1997 mbi "Ndalimin e përdorimit, magazinimit, prodhimit dhe transferimit të minave antipersonel dhe shkatërrimit të tyre", e njohur ndryshe si Traktati i Otavës, nuk është pjesë e konventës mbi armët konvencionale. Ajo është konsideruar si një konventë referuese që ka për qëllim eleminimin njëherë e përgjithmonë të vuajtjeve dhe aksidenteve të shkaktuara nga minat antipersonel.[75]

2.4.3 Metodat e ndaluara të luftimit

Metodat e ndaluara të luftimit përfshijnë në rradhë të parë pabesinë. "Pabesi" do të thotë kryerja e një veprimi luftarak nën mbulimin e një mbrojtjeje ligjore.

Pabesia është përcaktuar si "veprime që synojnë besimin e kundërshtarit, që e shtyjnë të besojë se ai ka të drejtë, ose është i detyruar të japë mbrojtje sipas rregullave të së drejtës ndërkombëtare humanitare, me qëllim për ta tradhëtuar këtë besim".[76]

Veprimet e mëposhtme janë shembuj të pabesisë.

- pretendimi sikur synohet zhvillimi i bisedimeve nën flamurin e armëpushimit,
- pretendimi i dorëzimit,
- pretendimi i daljes jashtë luftimit për shkak plagosjeje ose sëmundjeje,
- pretendimi sikur je civil ose jondërluftues,
- pretendimi sikur ke statusin e mbrojtjes duke përdorur flamurët, emblemat ose uniformat e Kombeve të Bashkuara ose të shteteve asnjanëse.

Konsiderohet shkelje e të drejtës së luftës të vrasësh, dëmtosh, apo kapësh kundërshtarin duke pretenduar se dorëzohesh, ose duke sajuar mbytjen e anijes, sëmundjet, plagët apo statusin e civilit. Një sulm i papritur nga një person që shtiret si i mbytur, i sëmurë apo i plagosur shkel statusin e mbrojtjes për ata që janë me të vërtetë të paaftë për të luftuar.

Sipas Protokollit të I-rë të Gjenevës të 1977 shpërdorimi i emblemës, (psh përparimi ushtarakisht nën mbrojtjen e Kryqit të Kuq[77], ose transportimi i armëve me anë të ambulancave të shenjuara, ose automjete të ngjashme), është i ndaluar dhe i dënueshëm. Kjo sepse, një sjellje e tillë në përgjithësi shkatërron besimin në emblemat mbrojtëse, rrezikon sigurinë e palëve joluftuese dhe imunitetin e aktiviteteve dhe strukturave të mbrojtura.

Në të drejtën ndërkombëtare humanitare bëhet dallimi ndërmjet dredhisë dhe pabesisë në luftë.

"Dredhi lufte", ose "manovër" do të thotë çdo veprim që ka për synim mashtrimin e armikut nëpërmjet kurtheve të luftës me qëllimin për ta gënjyer atë, për ta dekurajuar atë nga ndërmarrja e veprimeve, ose për ta nxitur të veprojë pa mend.[78]

---

75. KNKK, E drejta e konfliktit të armatosur, Dosje mësimore për instruktorët, qershor 2002, Libri "Armët", f. 13.
76. Protokolli I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës të vitit 1949, neni 37.
77. Protokolli I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës të vitit 1949, neni 38.
78. Frederic De Mulinen, Manual mbi rregullat e luftës për forcat e armatosura, f.91.

Dredhitë e luftës të lejuara në një konflikt të armatosur përfshijnë mashtrime të tilla si:[79]

- Maskimet, si ato natyrale, ose në formën e kamuflazhit me rrjeta, ngjyra kamuflazhi, ose tym për të mbuluar lëvizjet;
- Lëvizje, ose sulme mashtruese, tërheqje të sajuara, sulme të fshehta, sulme nga krahët për të kapur kundërshtarin në befasi;
- përdorimi i armatimeve të rreme, p.sh. tanke dhe anije fallco, forca të simuluara, për të ngatërruar, ose keqorientuar kundërshtarin në mënyrë që të mos dijë forcën dhe vendndodhjen aktuale;
- transmetimi i mesazheve ngatërruese, përdorimi i frekuencave të radiove të armikut, prishja e fjalëkalimeve dhe kodeve, përdorimi i kodeve të armikut;
- informacioni i rremë, ose operacionet psikologjike për të ngatërruar, ose dobësuar moralin, nëse nuk ka për qëllim të shpërndajë terror midis popullsisë civile.

Forcat detare në sipërfaqe dhe nën ujë mund të përdorin ngjyrat e armikut dhe të mbajnë shenjat e tij, për ta mashtruar armikun. Sidoqoftë, luftëanijet duhet të tregojnë ngjyrat e tyre të vërteta para fillimit të betejës.

Dredhitë e luftës lejohen nga e drejta ndërkombëtare humanitare.

Ndryshimi midis rasteve të:

a. maskimit të një tanku, me qëllim që kundërshtari të kalojë pranë pa u bërë i vetëdijshëm për ekzistencën e tij dhe kundër tij të hapet zjarr nga një rreze e shkurtër dhe vdekjeprurëse (dredhisë), dhe
b. pabesisë,

është se në rastin e parë ekipazhi i tankut nuk u shtir aspak, se gëzon status të mbrojtur, ndërsa në rastin e dytë ushtari e joshi kundërshtarin drejt rrezikut, duke i dhënë pamjen se ai është jashtë luftimit.

Një rast i paligjshëm i metodave të luftës do të ishte të arrihej një marrëveshje për pezullimin e luftimit, me synimin për ta sulmuar kundërshtarin në befasi.

Përdorimi i rrjetave, gjetheve etj., për të fshehur një pozicion armësh në terren përbën një dredhi lufte dhe si e tillë lejohet. Përdorimi i mbulesave që mbajnë kryqin e kuq, ose gjysmëhënën e kuqe, për të fshehur një pozicion armësh, duke lënë të kuptohet që aty ka një qendër mjekësore, ose që ushtari të shtiret si i plagosur, me qëllim që të hapë zjarr kundër një ushtari të kundërshtarit, që i vjen në ndihmë nuk lejohet, sepse këto raste përbëjnë **pabesi**.

E drejta humanitare ndalon gjithashtu si metodë lufte **shkaktimin e vdekjes nga uria**. Ndalohet që t'u mohohen civilëve artikujt, ose objektet tek të cilët varet mbijetesa e tyre.[80] Ndalohet sulmi, shkatërrimi, ose nxjerrja jashtë përdorimi e objekteve të domosdoshme për mbijetesën e popullsisë civile si për shembull, ushqimet, të mbjellat, bagëtia, rrjetet dhe furnizimi i ujit të pijshëm dhe veprat vaditëse.

---

79. KNKK, E drejta e konfliktit të armatosur, Dosje mësimore për instruktorët, qershor 2002, "Zhvillimi i operacioneve", pjesa B, f. 2.
80. Protokolli i I-rë i Gjenevës, neni 54.

Fjala "moho" është mjaft e gjerë dhe përfshin sulmin, shkatërrimin, marrjen, ose bërjen të padobishme të objekteve.

Ndalohet përdorimi i dhunës, ose kërcënimet për përdorimin e dhunës me qëllimin parësor të mbjelljes së terrorit në radhët e popullsisë civile. Ndalohet gjithashtu dhënia e urdhërit që të mos ketë të mbijetuar, kërcënimi i kundërshtarit me këtë dhe kryerja e operacioneve mbi këtë bazë[81] . Ata që janë jashtë luftimit, nuk mund të sulmohen. Jeta e tyre duhet kursyer. Sipas nenit 41 të Protokollit të I-rë të Gjenevës, "Vrasja e një ushtari armik që haptaz hedh armët, është thjesht një krim".

Plaçkitja[82] është një tjetër metodë lufte e ndaluar nga e drejta ndërkombëtare humanitare.

Plaçkitja nuk është veçse vjedhje. Nëse në kohërat e shkuara plaçkitja konsiderohej si një shpërblim i ligjshëm për të qënit ushtar. Ajo tashmë është në mënyrë universale e ndaluar. Ajo është një shenjë dalluese e ushtarëve të padisiplinuar dhe e komandantëve shumë të varfër, të cilët përfitojnë nga kaosi i betejës dhe përdorin fuqinë e tyre mbi luftëtarët, ose civilët e pambrojtur për fitime personale. Vjedhja është një krim sipas të drejtës së brendshme dhe mbetet një krim edhe në operacione ushtarake. Pra, vjedhja

është një vepër e dënueshme, si në kohë paqe, ashtu dhe në kohë lufte. Plaçkitja nuk duhet zbatuar jo vetëm ndaj pasurisë civile, por të plagosurit, të sëmurët dhe të vdekurit, ashtu si personat e ndaluar, duhet të mbrohen gjithashtu nga plaçkitja.

Pajisjet ushtarake si radiot, mjetet, armët etj., njihen si plaçkë lufte dhe mund të mblidhen si duhet, të numërohen, ose të përdoren nga ushtarët e palës kundërshtare. Ndërsa sendet joushtarake si bizhuteritë, orët, të mirat shtëpiake etj., nuk mund të merren.

Sulmet pa dallim janë:

a. Ato që nuk drejtohen kundër një objektivi ushtarak të posaçëm, si bombardimi i një zone.
b. Ato që përdorin metoda, ose mjete luftimi që nuk mund të drejtohen kundër një objektivi ushtarak të posaçëm.
c. Ato që përdorin metoda, ose mjete luftimi pasojat e të cilave nuk mund të kufizohen, siç kërkohet nga e drejta e konfliktit të armatosur.

Sulmet pa dallim janë absolutisht të ndaluara, si metoda lufte. [83]

81. Protokolli I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës,neni 40.
82. Shih: KGJ I,II,III, neni 8; H.IV.R. neni 28; H. PK, neni 4.
83. Protokolli I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës, neni 51.

2.5 ZBATIMI I TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE HUMANITARE

Ka ekzistuar gjithmonë një debat rreth qëllimit të ekzistencës së të drejtës humanitare dhe janë ngritur shumë çështje të pazgjidhura, si p.sh:

- Pse duhen nxjerrë rregulla për luftën, kur tashmë dihet se lufta ka dalë jashtë ligjit me nenin 2/4 të Kartës së Kombeve të Bashkuara?
- A kontribuon ekzistenca e ligjit të konfliktit të armatosur në përjetësimin e fenomenit të luftës?
- A zgjat lufta e zhvilluar sipas rregullave humanitare më shumë se një luftë e zhvilluar pa kufizime të tilla?
- A duhen hequr gjithë këto kufizime?
- Çfarë do ishte më e preferuar, një luftë më e gjatë apo një luftë më e keqe?

Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve mund të themi se argumenti që e drejta ndërkombëtare humanitare mund të zgjasë luftën, është i pabazuar dhe çon në mohimin e qëllimit bazë të së drejtës ndërkombëtare, që është ruajtja e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

Pa kufizime ligjore, lufta mund të degjenerojë në barbarizma absolute, që shkaktojnë vështirësi të mëdha në rindërtimin e paqes ndërmjet palëve, pas përfundimit të luftës. Natyrisht, përpjekjet primare duhen bërë që të mos ketë luftë, që të mos ndodhin konflikte dhe në fakt kjo është detyrë e veçantë për të gjitha shtetet, detyrë e caktuar nga Kombet e Bashkuara. Por, në të njëjtën kohë shtetet kanë detyrimin të bëjnë gjithçka të nevojshme për të kufizuar fatkeqësitë, nëse lufta shpërthen. Është logjike dhe e domosdosshme të zbutësh një fatkeqësi, nëqoftëse kemi mundësi ta bëjmë këtë gjë.

Megjithëse, Karta e Kombeve të Bashkuara ndalon përdorimin e forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare, lufta është një mundësi reale dhe del e nevojshme të ekzistojnë normat e zhvillimit të saj, në mënyrë që të shmangen mizoritë dhe vuajtjet e panevojshme. Pra, megjithëse komuniteti ndërkombëtar e ka ndaluar luftën, kjo nuk do të thotë që s'do të ketë më luftë. Historia dëshmon se konflikte kanë shpërthyer në shumë anë të globit edhe pas ndalimit të luftës si mjet i politikës së jashtme të shteteve. Zhvillimi i të drejtës humanitare në të vërtetë, nënkupton që luftërat janë akoma të mundshme.

Por a ka ndonjë arsye se përse e drejta ndërkombëtare humanitare nuk respektohet gjithmonë dhe shkeljet nuk dënohen gjithmonë?

Kjo pyetje mund të marrë përgjigje të ndryshme. Disa pretendojnë se e ka fajin mosnjohja e të drejtës, të tjerët ia vënë fajin natyrës së luftës, apo ndoshta mungesës së një sistemi efektiv, të centralizuar të zbatimit të sanksioneve të së drejtës ndërkombëtare dhe si rrjedhim edhe asaj humanitare ndërmjet të tjerash, për shkak të strukturës së sotme të komunitetit ndërkombëtar. Sidoqoftë disa masa në nivel ndërkombëtar janë mirëpritur, si p.sh. ndëshkimi penal i krimeve të luftës, i cili mund të shihet si një nga mënyrat e zbatimit të së drejtës humanitare.

Përveç gjykatave ad-hoc, të ngritura për të gjykuar krimet e luftës në ish-Jugosllavi [84] dhe Ruanda[85], komuniteti ndërkombëtar ka krijuar një Gjykatë Ndërkombëtare Penale Permanente, e cila është kompetente të gjykojë krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe genocidin.

2.5.1 Veprimi në përputhje me të drejtën e konfliktit të armatosur

Lufta nënkupton padyshim përdorimin e forcës, por jo të forcës pa kufi. Lufta nuk duhet të hedhë poshtë të gjitha lidhjet midis kombeve dhe as moralin e përgjithshëm e të mirat materiale të njerëzimit që janë fituar me shumë mundim. Rregullat që përbëjnë të drejtën e luftës janë krijuar si rezultat i arsyes dhe i ndjenjave më të thella të njerëzimit. Ato qëndrojnë përmbi dhunën që shkakton lufta dhe duhet të respektohen nga të gjithë njerëzit në të gjitha kohërat.

E drejta e konfliktit të armatosur duhet të zbatohet sepse palët nënshkruese të konventave të Gjenevës kanë marrë përsipër të respektojnë dhe të garantojnë respektimin e konventave në të gjitha rrethanat.

Veprimi në përputhje me të drejtën e konfliktit të armatosur, ose zbatimi i të drejtës ndërkombëtare humanitare:

- Nënvizon profesionalizmin e anëtarëve të forcave të armatosura.
- Rrit moralin dhe disiplinën.
- Siguron mbështetjen e popullsisë civile në vendin e tyre dhe në teatrin e veprimeve.
- Ndikon në trajtimet reciproke të të plagosurve, të sëmurëve dhe robërve të luftës.
- Rrit perspektivën e kthimit të paqes.
- Siguron që përpjekjet ushtarake të përqëndrohen në mposhtjen e forcave ushtarake armike.

Njerëzit kanë nevojë për udhëheqje dhe rregullat e parimet e vendosura nga e drejta e konfliktit të armatosur, sigurojnë një udhëheqje të tillë për ata që janë përfshirë në luftë.

Një nga arsyet praktike më detyruese për të vepruar në përputhje me të drejtën e konfliktit të armatosur është nevoja për të patur mbështetjen e popullsisë, si në zonën e luftës dhe kur të kthehen në vendin e tyre. Në qoftë se gjatë luftës kryhen barbarizma, ushtritë përgjegjëse sigurisht do humbin mbështetjen e popullsisë lokale dhe gjithashtu të popullsisë së vendit të tyre, gjë që çon në një rënie serioze të moralit të forcave të armatosura. Morali i lartë është një nga faktorët më të rëndësishëm në një fushatë ushtarake të suksesshme.[86]

84. Security Council resolution 827 (1993).
85. Security Council resolution 955 (1994).
86. Turkish General Staff, Guide to the law of Armed Conflict of Armed Forces, Ankara, June 2001, f.26.

Nëqoftëse njëra palë në një konflikt të armatosur zbaton të drejtën e konfliktit të armatosur, pala tjetër ka më shumë të ngjarë që të bëjë të njëjtën gjë. Nëqoftëse dihet nga armiku se pala tjetër i trajton mirë robërit e luftës, ata ka më shumë të ngjarë që të dorëzohen. Do ishte krejt ndryshe nëqoftëse ato besonin se rënia në dorë të armikut do të thoshte torturë ose sakatim.

Zhvillimi i operacioneve në përputhje me të drejtën e konfliktit të armatosur rrit perspektivat e kthimit më të shpejtë të paqes dhe të marrëdhënieve normale ndërmjet vendeve të implikuara në luftë. Respekti për të drejtën ndërkombëtare humanitare ndihmon për të vendosur themelet mbi të cilat mund të gjendet një zgjidhje paqësore me të mbaruar konflikti. Mundësitë për një paqe të qëndrueshme janë shumë më të mëdha nëse palët ndërluftuese respektojnë të drejtat themelore dhe dinjitetin e njeriut në mënyrë reciproke gjatë gjithë konfliktit. Zemërimi që mundon ose ndjenja e hakmarrjes për shkak të masakrave ndaj civilëve ose trajtimit të keq të robërve minon procesin e paqes dhe rrit mundësinë që konflikti të shfaqet përsëri.

Fatkeqësisht ka shembuj të panumërt të shkeljes së të drejtës ndërkombëtare humanitare. Gjithnjë e më shumë, viktimat e luftës janë civilët. Sidoqoftë ka raste të rëndësishme ku e drejta humanitare ka bërë një ndryshim në mbrojtjen e civilëve, të plagosurve dhe të sëmurëve, dhe në kufizimin e përdorimit të armëve barbare.

Duke pranuar që kjo e drejtë zbatohet në kohë konflikti të armatosur, pra në kushtet e dhunës ekstreme, është e kuptueshme që përmbushja e saj do të jetë gjithnjë shumë e vështirë.

2.5.2 Çfarë duhet bërë për të zbatuar këtë të drejtë?

Dihet tashmë se ekziston një ndryshim i madh midis të drejtës së brendshme dhe asaj ndërkombëtare, përsa i përket nivelit të zbatimit. Çdo shtet ka mekanizma për zbatimin e të drejtës në territorin e tij (administratë, gjykatë, polici etj), ndërsa në komunitetin ndërkombëtar shtetet dhe organizatat ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara, janë së bashku përgjegjëse për zbatimin e së drejtës ndërkombëtare humanitare, por kanë në dispozicion mjete të kufizuara për sigurimin e autoritetit të tyre.[87]

Zbatimi i të drejtës ndërkombëtare humanitare në praktikë varet në një masë të madhe nga parimi i reciprocitetit. Kjo do të thotë se çdo palë e përfshirë në konflikt duhet t'i përmbahet detyrimeve në mënyrë që të presë të njëjtën gjë nga pala tjetër. Reciprociteti është nxitës i fuqishëm në dobi të zbatimit të së drejtës humanitare.

Një faktor shumë i rëndësishëm është marrja e masave për të siguruar respektimin e të drejtës humanitare. Shtetet kanë obligimin[88] që t'ua mësojnë rregullat e të drejtës ndërkombëtare humanitare, forcave të tyre të armatosura dhe publikut në përgjithësi. E drejta ndërkombëtare humanitare mund të respektohet vetëm nga ata që e njohin atë. [89] Ushtarët duhet të dinë jo vetëm se si t'i përdorin armët, por duhet gjithashtu të jenë të ndërgjegjshëm se çfarë munden dhe nuk mund të bëjnë me to.

87. Hans Peter Gasser, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, "E Drejta Ndërkombëtare Humanitare", Dhjetor 2000, f.100.
88. KGJ I, neni 47; KGJ II, neni 48; KGJ III, neni 144; PGJ I, neni 84; PGJ II, neni 19.
89. Hans Peter Gasser, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, "E Drejta Ndërkombëtare Humanitare", Dhjetor 2000, f.103.

Përgatitja ushtarake në çdo shtet duhet të synojë jo vetëm aftësimin për të ndjekur operacionet ushtarake, por edhe dhënien e njohurive për të respektuar kufizimet e vëna nga e drejta ndërkombëtare humanitare.[90] Rëndësi të madhe ka përgatitja e udhëzimeve dhe manualëve mësimdhënës për stërvitjen e pjesëtarëve të forcave të armatosura, sipas niveleve dhe detyrave të tyre.[91] Ndërsa për një ushtar të zakonshëm mjafton që të zotërojë pak rregulla themelore mbi mënyrën e sjelljes së armikut që dorëzohet dhe ndaj civilëve, komandantët dhe stafi operacional duhet të njohin rregullat që vendosin kufij në kryerjen e operacioneve ushtarake.[92] E njëjta gjë vlen edhe për autoritetet civile, që janë të interesuar për zbatimin e së drejtës ndërkombëtare humanitare, si psh anëtarët e qeverisë, ose autoritete të tjera kombëtare. Sigurimi i këtyre njohurive në kohë paqeje është parakusht për respektimin e detyrimeve në kohë lufte.

Shtetet duhet t'i parandalojnë shkeljet ose t'i ndëshkojnë ato në qoftë se edhe pse janë parandaluar prapë ndodhin. Në veçanti, ata duhet të shpallin ligje, rregullore dhe udhëzime për ndëshkimin e shkeljeve serioze të Konventave të Gjenevës dhe

Protokolleve Shtesë, të cilat konsiderohen si krime lufte[93]. Masa ndëshkuese duhet të përfshihen në Kodin Penal vendas të çdo shteti, ose në rregulloret disiplinore që zbatohen nga forcat e armatosura, si dhe duhen përcaktuar ndëshkimet për shkeljet.[94]

Masa duhen marrë gjithashtu në nivel ndërkombëtar. Dihet tashmë se janë krijuar gjykata për të ndëshkuar aktet e kryera në konfliktet në ish Jugosllavi dhe Ruanda etj. Një gjykatë penale ndërkombëtare me përgjegjësinë e shtypjes së krimeve të luftës u krijua nga statuti i Romës i vitit 1998.

Protokolli i I-rë i Gjenevës ka parashikuar një sërë masash bashkëpunimi midis shteteve për të siguruar respektimin e së drejtës së konfliktit të armatosur.[95]

Këto masa përfshijnë:

a. Mbledhjen për diskutimin e problemeve të zbatimit.[96]

b. Shkëmbimin e përkthimit të teksteve të traktateve dhe të ligjeve implementuese.[97]

c. Ndihmën në çështjet penale, që përfshin ndihmën me dëshmi e prova dhe ekstradimin e shkelësve.[98]

d. Bashkëpunimin me Kombet e Bashkuara në rastin e shkeljeve të rënda.[99]

---

90. Humanitarian Laë in Armed Conflicts, Manual, Edited by The Federal Ministry of Defence of the Federal Republic of Germany, VR II 3, August 1992. p.126.

91. Protokolli I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës, neni 82.

92. Humanitarian Laë in Armed Conflicts, Manua, Edited by The Federal Ministry of Defence of the Federal Republic of Germany, VR II 3, August 1992. p.127.

93. Konventa e Parë, neni 49; Konventa e Dytë, neni 50; Konventa e Tretë, neni 129; Konventa e Katërt, neni 146; Protokolli I, neni 80.

94. Ëhat is International Humanitarian Laë? Advisory service ICRC 2004 f.2.

95. Protokolli I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës, neni 80.

96. Protokolli I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës, neni 7.

97. Protokolli I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës, neni 84.

98. Protokolli I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës, neni 88.

99. Protokolli I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës, neni 89.

2.6 KOMITETI NDËRKOMBËTAR I KRYQIT TË KUQ

Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq është një organizatë humanitare, joqeveritare e vendosur në Gjenevë të Zvicrës.

Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq ka luajtur rol kryesor në zhvillimin e të drejtës ndërkombëtare humanitare. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq është bërë nxitësi dhe mbështetësi i zhvillimeve të njëpasnjëshme të së drejtës ndërkombëtare humanitare.

Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq ka luajtur gjithashtu rol shumë të rëndësishëm në sigurimin e respektit të së drejtës së konfliktit të armatosur.[100] Konventat e Gjenevës të vitit 1949 njohin statusin e veçantë të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe i kanë përcaktuar detyra specifike për të kryer.

Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq gëzon mbrojtje të veçantë për përmbushjen e detyrave të tij. Personeli i Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq gëzon të njëjtën mbrojtje si civilët.[101]

Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq:

- Ka në funksionim Agjencinë Qendrore të Kërkimit, qëllimi i së cilës është dhënia e ndihmës në përcaktimin e vendodhjes së personave të humbur dhe ribashkimin e familjeve që janë ndarë nga lufta.
- Mban të dhëna për robërit e luftës, inspekton kampet e tyre dhe u ofron ndihmë.
- Siguron ndihmë humanitare për popullsinë civile të vendeve në luftë dhe më e rëndësishmja:
- Punon në prapavijë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe ndihmon shtetet të sigurojnë pajtueshmërinë me të drejtën e konfliktit të armatosur.

Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq ka si mandat: "Të marrë pjesë në mënyrë aktive në veprimtarinë për përhapjen e njohurive[102] në fushën e së drejtës ndërkombëtare humanitare, ndër të tjera, me anë të:

- botimit të materialeve ndihmëse, qarkullimit të informacionit të duhur;
- organizimit të seminareve dhe kurseve, bashkëpunimit për këtë qëllim me shtetet dhe institucionet përkatëse.

---

100. Shih: Statutet e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar dhe Gjysmëhënës së Kuqe, Tetor 1986, neni 5, para.2g.
101. Shih: KGJ I, neni 38; KGJ II, neni 41; PGJ I, neni 8; PGJ II, neni 12.
102. Humanitarian Law in Armed Conflicts, Manual, Edited by The Federal Ministry of Defence of the Federal Republic of Germany, VR II 3, August 1992. p.127.

2.6.1 Themelimi i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar

Bazat e origjinës së Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe humanitarizmit u vendosën në Solferino, në rajonin italian të Lombardisë, në 24 qershor 1859, ku ushtritë austriake dhe franceze ishin angazhuar në betejën vendimtare për unifikimin italian.

Në luftën midis austriakëve dhe forcave italo – franceze, në qershor të vitit 1859, një nga betejat më të përgjakshme ishte beteja e Solferinos, në Itali. Në këtë betejë humbën jetën 22.000 austriakë dhe 17.000 francezë. Pjesa më e madhe e të plagosurve vdiqën. Përveç spikatjes politike dhe historike për rajonin, beteja e Solferinos tërhoqi vëmendjen globale, sepse krejt rastësisht, u bë i famshëm një djalë i ri.[103] Ky djalë ishte Henri Dynant, i lindur në Gjenevë, në maj 1828.

Që në moshë të re, Henri Dynant ishte i angazhuar në organizata të ndryshme bamirësie lokale, ndërsa në të njëjtën kohë përpiqej të bënte karrierë në biznesin bankar. Ndërsa udhëtonte me një mision biznesi në Itali, Dynant rastësisht arriti në Kastilione de la Pieve në të njëjtën ditë të qershorit 1859, kur Beteja e Solferinos po zhvillohej aty afër.

Kur qyteti u mbush me fatkeqësi dhe shërbimet mjekësore rezultuan të papërshtatshme. Dynant menjëherë u bashkua me popullsinë lokale duke u përpjekur të lehtësonte dhembjen dhe vuajtjen e të plagosurve. Në kujtimet e tij të asaj dite në Lombardi, Dynant shkruante: "Këtu zhvillohet një luftë ballë për ballë në të gjithë horrorin dhe frikën e saj. Austriakët dhe aleatët shkelin njëri-tjetrin me këmbë, vrasin njëri-tjetrin mbi pirgjet e trupave të përgjakur, qëllojnë armiqtë e tyre me qytat e pushkëve, shtypin kafka. Eshtë një luftë ndërmjet bishave të egra, të tërbuara me gjak dhe furi. Madje edhe të plagosurit luftojnë deri në grahmat e fundit. Kur ata nuk kanë armë ata i kapin armiqtë e tyre nga fyti dhe i shqyejnë me dhëmbë".[104]

Këto eksperienca të tmerrshme në Itali ndryshuan komplet kursin e jetës së Henri Dynant, i cili u trondit thellë nga mungesa e çdo forme ndihme për të plagosurit dhe për ata në agoni. Ai ia dedikoi pjesën tjetër të jetës së tij gjetjes së mënyrave të parandalimit dhe lehtësimit të vuajtjeve të tilla në luftërat e ardhshme. Duke u kthyer në Gjenevë, ai shkroi "Një Kujtim nga Solferino", në të cilin ai nuk u ndal shumë në faktin që ushtarët e plagosur u keqtrajtuan apo që u vranë njerëz të pambrojtur, por propozoi "që në çdo vend të ngrihej një shoqatë vullnetare ndihme, e cila të stërvitej dhe të përgatitej në kohë paqe, të ndihmonte shërbimin shëndetësor të ushtrisë dhe e dyta që shtetet të takoheshin në një kongres dhe të miratonin një parim ndërkombëtar të pacënueshëm për mbrojtjen e spitaleve ushtarake dhe personelit mjekësor".[105] Propozimi i tij çoi në krijimin e Kryqit të Kuq, si dhe në hartimin e Konventës së Gjenevës të vitit 1864.

---

103. Violence and humanitarian assistance:Reflections on an intricate relationship, Birgitte Refslund Sorensen f. 4.
104. A Memory of Solferino, Henry Dunant, Published by the International Committee of the Red Cross, Geneva 1986.

105. Zhvillimi dhe parimet e së Drejtes Ndërkombëtare Humanitare, Jean Pictet, Tiranë, 2001, f.31.

Më 17 Shkurt 1863 u mblodh një komitet, që e shpalli veten institucion të përhershëm, duke u bërë kështu organi themelues i Kryqit të Kuq dhe frymëzuesi i Konventës së Gjenevës të 1864.

Po atë vit, një grup i vogël individësh të zakonshëm, por të nxitur nga një ndjenjë e fortë humanizmi, ftuan shtetet e botës të dërgojnë përfaqësuesit e tyre në Gjenevë. Rezultati ishte përfaqësimi i 16 kombeve në konferencën përgatitore, që u zhvillua në tetor 1863, duke krijuar bazën për atë çka do të quhej Kryqi i Kuq, i cili shihej ende si një mjet për të lehtësuar dhimbjet e ushtarakëve të plagosur. Në vitin 1880 ai mori emrin e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq.

Një vit më vonë u thirr Konferenca Diplomatike, e cila miratoi Konventën e Gjenevës të 22 Gushtit 1864, "Për përmirësimin e kushteve të të plagosurve në fushën e betejës". Kjo Konventë përfaqëson themelimin e të drejtës ndërkombëtare humanitare moderne. Përpjekjet e Dynant u njohën gjerësisht në Europë dhe në vitin 1901 ai u nderua me çmimin Nobel për Paqen.

Dynant hyri në histori si një hero dhe model për stafin ndërkombëtar të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq. Megjithëse nuk ka një marrëveshje absolute rreth përkufizimit të termit "Humanitarian", thelbi i tij janë sigurimi i asistencës në raste emergjence dhe mbrojtja e të drejtave themelore humane[106]. Në përkufizimin e Dynant dhe të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, asistenca dhe mbrojtja duhet të jenë neutrale, që nënkupton se duhet të sigurohen pavarësisht nga background-i social, kulturor, religjioz i një personi, gjendja e tij ekonomike ose bindja politike.

Përveç procesit të filluar nga Henri Dunant dhe Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq për kodifikimin e rregullave për mbrojtjen e të plagosurve, të sëmurëve dhe ushtarëve të rënë në duart e armikut, pati edhe zhvillime të tjera. Në 1863 në kohën e themelimit të Kryqit të Kuq, Shtetet e Bashkuara të përfshira në luftë civile, miratuan një kod të quajtur "Udhëzime për Qeverinë e Ushtrive të Shteteve të Bashkuara në fushën e betejës". Presidenti Abraham Linkoln i kërkoi një juristi të quajtur Fransis Lieber, të përmblidhte në disa rregulla sjelljen në luftë që të vihej në përdorim të trupave gjatë Luftës Civile Amerikane. Këto urdhëra të përgjithshme të botuara në vitin 1863 dhe që njihen me emrin "Kodi i Lieberit", kishin qëllim të ndikonin në sjelljen e ushtarëve gjatë luftës dhe mbështeteshin në konceptin e përgjithshëm se lufta ishte e ligjshme deri në masën ku ajo zhvillohej duke respektuar disa rregulla. Kodi i Lieberit[107] megjithëse kishte karakter kombëtar, pati ndikim të gjerë kudo. Ai vendosi një bazë për libra të tjerë ushtarakë dhe shërbeu si pikënisje për zhvillime të së drejtës ndërkombëtare humanitare në drejtim të nxjerrjes së rregullave mbi sjelljen në luftë.

106. Violence and humanitarian assistance: Reflections on an intricate relationship, Birgitte Refslund Sorensen f. 5.
107. Instructions for the Government of Armies of the United states in the Field,Prepared by Francis Lieber and revised by a board of officers, Washington, April 1863.

2. 7 PËRFUNDIME

1. E drejta ndërkombëtare humanitare e njohur ndryshe si e drejta e luftës, ose e drejta e konfliktit të armatosur nuk merret me çështjen e ligjshmërisë së luftës. Ajo zbatohet në konflikte të armatosura, pa marrë parasysh nëse një luftë është e përligjur, ose jo dhe pavarësisht faktit në se shteti ka të drejtë apo jo të përdorë forcën.

2. E drejta e shtetit për të bërë luftë nuk njihet nga e drejta ndërkombëtare e sotme. Çdo shtet që bën një agresion dhe përdor luftën për qëllimet e politikës së tij të jashtme, kryen një shkelje të së drejtës ndërkombëtare humanitare. Megjithatë, Karta e Kombeve të Bashkuara nuk cënon të drejtën e një shteti të përdorë forcën në ushtrimin e së drejtës së tij për t'u vetëmbrojtur, ose të drejtën e shteteve të tjera për t'i ardhur në ndihmë shtetit të sulmuar, (e drejta e vetëmbrojtjes kolektive).

3. E drejta ndërkombëtare humanitare zbatohet vetëm në konflikt të armatosur ndërkombëtar, ose të brendshëm dhe nuk merret me situatat shqetësimeve e tensioneve të brendshme, të cilat nuk arrijnë deri në konflikt të armatosur.

4. E drejta ndërkombëtare humanitare zbatohet vetëm pasi fillon konflikti dhe për të gjitha palët njëlloj, pa marrë parasysh se kush i filloi luftimet. Ajo humbet çdo ndikim kur konflikti mbaron, gjë që praktikisht nënkupton se të gjithë robërit e luftës janë riatdhesuar, të gjithë të internuarit civilë janë liruar dhe të gjithë territoret e pushtuara janë çliruar.

5. Rregullat e të drejtës ndërkombëtare humanitare, që zbatohen në konfliktet e armatosura të brendshme, janë shumë të pakta krahasuar me ato që zbatohen në konfliktet e armatosura ndërkombëtare, megjithëse problemet që dalin nga pikpamja humanitare janë të njëjta. Kjo shpjegohet me faktin se shtetet nuk duan ndërhyrje nga jashtë kur është fjala për çështje të tyre të brendshme.

6. E drejta ndërkombëtare humanitare, nisur nga fakti se qëllimi i luftës është mposhtja e rezistencës së kundërshtarit dhe se ky qëllim nuk mund të arrihet me të gjitha mjetet e mundshme, ka vendosur standarde të qarta për sjelljen në operacionet ushtarake, duke kufizuar mjetet dhe metodat e lejueshme të luftës.

7. Të gjitha shtetet kanë detyrë të veçantë, të caktuar nga Kombet e Bashkuara, që të bëjnë përpjekje për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve mes tyre, me qëllim që ato të mos kthehen në konflikte dhe të mos ketë luftë. Por, në të njëjtën kohë shtetet kanë detyrimin të bëjnë gjithçka të nevojshme për të kufizuar fatkeqësitë, nëse lufta shpërthen.

8. Duke qenë se lufta është një mundësi reale, pavarësisht ndalimit të përdorimit të forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare, nga Karta e Kombeve të Bashkuara, ekziston nevoja e zhvillimit të normave të së drejtës së luftës, me qëllim që të shmangen mizoritë dhe vuajtjet e panevojshme. Pa kufizime ligjore, lufta mund të

degjenerojë në barbarizma absolute, që shkaktojnë vështirësi të mëdha në rindërtimin e paqes ndërmjet palëve, pas përfundimit të luftës.

9. Zbatimi i të drejtës ndërkombëtare humanitare, gjatë zhvillimit të operacioneve ushtarake ka rëndësi të madhe, sepse rrit perspektivat e kthimit të paqes dhe të marrëdhënieve normale ndërmjet vendeve të implikuara në luftë. Respektimi i kësaj të drejte ndihmon për të vendosur themelet mbi të cilat mund të gjendet një zgjidhje paqësore me të mbaruar konflikti. Zemërimi që mundon, ose ndjenja e hakmarrjes për shkak të masakrave ndaj civilëve, ose trajtimit të keq të robërve minon procesin e paqes dhe shërben si bazë për rifillimin e konfliktit.

10. Një faktor shumë i rëndësishëm në drejtim të sigurimit të respektimit të së drejtës ndërkombëtare humanitare është marrja e masave nga shtetet për njohjen e gjerë të rregullave të drejtës ndërkombëtare humanitare, si nga forcat e tyre të armatosura dhe nga publiku në përgjithësi. Përgatitja ushtarake në çdo shtet duhet të synojë jo vetëm aftësimin për të ndjekur operacionet ushtarake, por edhe dhënien e njohurive për të respektuar kufizimet e vëna nga e drejta ndërkombëtare humanitare, sipas niveleve dhe detyrave të pjesëtarëve të forcave të armatosura.

3. DISA ZHVILLIME TË SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE HUMANITARE

Në të shkuarën, kur luftërat zhvilloheshin nga ushtritë në marshim, popullsitë civile ishin të ekspozuara direkt ndaj luftimit dhe vuanin plaçkitjen, përdhunimin, mungesën e strehimit, në qoftë se qytetet e rrethuara nuk dorëzoheshin. Trajtimi i të plagosurve ishte primitiv. Ushtarët që kapeshin përballeshin me një të ardhme të pasigurtë. Ushtarët e kapur nuk kishin asnjë të drejtë. Ata që hynin në fushën e betejës zakonisht shkonin më tepër në kërkim të plaçkës për të grabitur, se sa në ndihmë të të plagosurve.

Megjithatë kishte shumë shembuj të sjelljes njerëzore. Ishin këto sjellje njerëzore, që pavarësisht arsyes që kishin, me kalimin e kohës u bënë rregulla ligjore. Juristët u përpoqën të përzgjidhnin nga praktika parimet ligjore, në bazë të të cilave vepronin shtetet dhe hartuan akte ligjore që do të orientonin sjelljen në luftë.

Braktisja e ushtarëve të plagosur në fushën e betejës mbetej problem serioz. Numri i fatkeqësive i tejkalonte mundësitë e shërbimeve mjekësore ushtarake. Me zgjidhjen e këtij problemi u mor Konferenca e Gjenevës e vitit 1864, e cila hartoi Konventën e Parë të Gjenevës, të vitit 1864.

Përpjekja për të zbutur egërsinë e luftës me rregulla ka një histori të gjatë. Një seri traktatesh u nënshkruan në vitet 1864, 1899, 1907 dhe 1929, të sponsorizuara dhe të inicuara nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, i cili vazhdon të jetë një survejues i asaj që quhet e drejta humanitare. Por, këto marrëveshje nuk u nënshkruan nga shumë shtete dhe nuk u zbatuan gjatë Luftës së Dytë Botërore.[1] Sot, katër konventat e Gjenevës të vitit 1949, bashkë me Konventën e Genocidit të vitit 1948, janë ndër traktatet ndërkombëtare më të ratifikuara.

Parashikimet e traktateve humanitare kanë si qëllim të pajtojnë dy parimet, që në kohë konfliktesh të armatosura shpesh përplasen: humanizmi dhe domosdoshmëria ushtarake, ose e thënë ndryshe të vendosin ekuilibër ndërmjet kërkesave të operacioneve ushtarake dhe nevojave humane. Pra, ajo që është e nevojshme për të mposhtur armikun lejohet, por shkaktimi i vuajtjeve të panevojshme ndalohet.

E drejta ndërkombëtare humanitare është pasuruar vazhdimisht, si rezultat i rritjes së kërkesave për norma ligjore humanitare që kanë sjellë konfliktet e ndryshme. Kështu, p.sh., Lufta e Parë Botërore nxori nevojën e rregullave më të detajuara për mbrojtjen e robërve të luftës; Lufta e Dytë Botërore për mbrojtje më të madhe të popullsisë civile në territoret e pushtuara, si dhe të pasurisë kulturore; lufta në Vietnam nxori nevojën e mbrojtjes së popullsisë civile në zonën e luftimit dhe të disa kufizimeve në përdorimin e armëve; lufta e viteve 1992–1995 në ish Jugosllavi ndriçoi nevojën e rregullave të konfliktit të armatosur të brendshëm.

1. KNKK, Kuptimi i së Drejtës Humanitare, Tiranë, Dhjetor 2000, f.14.

3.1 E DREJTA HUMANITARE NËPËRMJET KONVENTAVE NDËRKOMBËTARE

Në procesin e formulimit të normave të shkruara për të drejtën ndërkombëtare humanitare, akti i parë i plotë dhe koherent në këtë fushë ishte Konventa e Gjenevës, e vitit 1864.

Konventa e vitit 1864 përmbante vetëm 10 nene, megjithatë rëndësia e saj ishte e madhe, sepse këto nene trajtonin elemente thelbësore si:

- Ambulancave ushtarake dhe spitaleve t'u mbrohej dhe respektohej asnjanësia.
- Kapelanët[2], gjithashtu të gëzonin të njëjtën asnjanësi gjatë kryerjes së detyrës. Nëse ata binin në duart e palës kundërshtare, duhet të përjashtoheshin nga kapja rob dhe të lejoheshin të ktheheshin në ushtrinë e tyre.
- Civilët që futeshin në fushën e betejës për të asistuar të plagosurit duhej gjithashtu të respektoheshin.
- Ushtarët e plagosur duhej të mjekoheshin, pavarësisht se cilës palë i takonin.
- Spitalet dhe personeli mjekësor duhej të tregonin një kryq të kuq në një sfond të bardhë, si një emblemë që do t'u siguronte atyre mbrojtje.

Pra, Konventa e Gjenevës e vitit1864-ës, për herë të parë në histori, bëri atë që shtetet në një dokument formal e të qëndrueshëm të pranonin kufizimin e fuqisë së tyre, në dobi të interesit të individit. Konventa e vitit 1864 u pranua brenda një kohe shumë të shkurtër nga të gjitha shtetet e pavarura të asaj kohe dhe në vitin 1882 edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Parashikim tjetër i Konventës së Gjenevës, "Për Përmirësimin e Kushteve të të Plagosurve në Fushën e Betejës", ishte përjashtimi i mjekëve dhe infermierëve nga kapja rob. Mjekët e infermierët, në rast tërheqje, mund të liheshin pas, midis të plagosurve, të cilët nuk do të braktiseshin më, siç ishte vepruar në të kaluarën, duke qenë se nuk shiheshin si luftëtarë nga armiku.

Vetëm 2 vjet pas përfundimit të saj, Konventa e Gjenevës u përball me luftën austro – prusiane të vitit 1866.[3]

Konventa e Gjenevës dëshmoi fuqishëm vlerat e saj në një betejë pothuaj po aq të përgjakshme sa ajo e Solferinos. Prusia, në zbatim të Konventës, kishte spitale të organizuara mirë dhe Kryqi i Kuq prusian ishte në punë kudo ku nevojitej, ndërsa Austria, e cila nuk e kish firmosur këtë Konventë, gjatë tërheqjes së trupave të saj, i la të plagosurit pas, gjë që rezultoi katastrofale për të plagosurit që vdiqën nga mungesa e mjekimit.

---

2. Kapelanët janë priftërinj, pastorë, ose klerikë të tjerë që i shërbejnë një grupi njerëzish, të cilët nuk janë të organizuar si një mision ose kishë, ose nuk janë në gjendje të shkojnë në kishë për arsye të ndryshme, siç është shëndeti, burgosja, ose detyrat ushtarake ose civile. Një kapelan bashkohet shpesh me një njësi ushtarake, anije, burg, spital, shkollë të lartë etj. Fillimisht termi kapelan përdorej vetëm për kristianët. Në kohën e sotme ai përdoret për njerëz të besimeve të tjera që luajnë të njëjtin rol.Megjithëse konventat e Gjenevës nuk pohojnë nëse kapelanët mund të mbajnë armë, ato specifikojnë se kapelanët janë joluftues, (Protokolli i I – rë, neni 43/2). Kapelanët e kapur nuk konsiderohen si robër lufte dhe duhet të kthehen në kombin e tyre nëqoftëse nuk mbahen për t'i shërbyer robërve të luftës, (Konventa e III-të e Gjenevës, neni 33).
3. Jean Pictet, Zhvillimi dhe parimet e së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare, Tiranë 2001, f.34.

Duke qenë se Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq u bë nxitësi dhe mbështetësi i zhvillimeve të njëpasnjëshme të së drejtës ndërkombëtare humanitare, mbas vitit 1870, Konventa e Gjenevës e vitit 1864 iu nënshtrua disa ndryshimeve, në përputhje me realitetet e reja.

Një rishikim tjetër iu bë kësaj Konvente në vitin 1929. U shtua, ndër të tjera, një nen, sipas të cilit Konventa nuk ishte e zbatueshme nëse të dy palët ndërluftuese nuk e kishin nënshkruar atë. Në Konferencën Diplomatike të vitit 1929 u njoh e drejta e vendeve myslimane që të përdorin një gjysëm hënë të kyqe mbi një sfond të bardhë në vend të kryqit të kuq.

Faktikisht Turqia kishte vendosur përdorimin e një gjysmëhëne të kuqe në sfond të bardhë menjëherë pasi kryqi i kuq u pranua si shenjë mbrojtëse në vitin 1864, duke e përligjur këtë me faktin se kryqi i kuq fyente ndjenjat fetare të myslimanëve. Megjithatë, duhet thënë, se në praktikë përdorimi i shenjave të ndryshme mund të sjellë ngatërrime dhe nuk është i nevojshëm, sepse emblemat qoftë kryqi i kuq, qoftë gjysmëhëna e kuqe nuk kanë patur kurrë dhe nuk duhet të kenë kuptim fetar.

Pas Luftës së Dytë Botërore, Konferenca Diplomatike e zhvilluar në Gjenevë në vitin 1949, miratoi një konventë të re mbi trajtimin e të plagosurve në kohë lufte. Kjo konventë, e njohur si Konventa e I-rë e Gjenevës e vitit 1949, plotësoi dhe përmirësoi konventat e viteve 1864, 1906 dhe 1929. Në hartimin e saj u mor parasysh trajtimi çnjerëzor i të plagosurve dhe të sëmurëve në kampet e përqëndrimit, përfshirë këtu praktikën e kryerjes ndaj tyre të eksperimenteve biologjike.

Konventa e I-rë e Gjenevës e vitit 1949 ”Për Përmirësimin e fatit të të plagosurve dhe të sëmurëve në forcat e armatosura në luftë”, e shtriu veprimin e saj edhe ndaj pjesëtarëve të reparteve vullnetare, si dhe ndaj personave që janë në shërbim të përmbushjes së nevojave jetësore të forcave të armatosura, por që nuk hyjnë në përbërjen e tyre.

Vite më vonë, Konferenca Diplomatike e viteve 1974–1977 solli përmirësime të arsyeshme dhe të mirëpritura. Personelit mjekësor civil, me kusht që të punojë nën kontrollin e shtetit, iu dha mbrojtje e ngjashme me atë që gëzonte personeli mjekësor ushtarak, që nga viti 1864. Për këtë arsye iu dha e drejta të mbante shenjën e kryqit të kuq. Paprekshmëria u shtri edhe mbi organizatat e mbrojtjes civile që u vinin në ndihmë viktimave të bombardimeve ajrore.

3.1.1 Personat dhe objektet e mbrojtura nga konventat

3.1.1. a Luftuesit

Luftues quhet çdo pjesëtar i forcave të armatosura, me përjashtim të personelit mjekësor dhe personelit fetar.

Në angazhimin në veprime luftarake ose në një operacion ushtarak në parapërgatitje të tyre, luftuesit meqë janë objekt sulmi duhet ta dallojnë veten nga popullsia civile që mbrohet nga sulmi.[4]

4. Protokolli i I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës, nenet 48, 49-58.

Efektivat e forcave të armatosura, të rregullta, normalisht e dallojnë veten me uniformat e tyre. Efektivat e forcave të tjera të armatosura veshin një shenjë dalluese të palëvizshme e të dallueshme dhe i mbajnë armët e tyre haptas.

Luftuesit që marrin pjesë në luftime pa e dalluar veten nga civilët, e humbasin statusin e tyre të luftuesit dhe të drejtën për statusin e robërve të luftës. Kjo do të thotë që, me t'u zënë rob, ata mund të gjykohen për krimin e luftës të pjesëmarrjes drejtpërdrejt në mënyrë të paligjshme në luftime.

Protokolli i I-rë Shtesë i Konventave të Gjenevës përcakton se të gjithë personat që i përkasin forcave të armatosura të organizuara, grupeve apo njësive të cilat veprojnë nën një komandë që është përgjegjëse për sjelljen e tyre, janë luftues. Kjo nënkupton se ata lejohen të përfshihen në luftim, të përdorin forcën dhe të arrijnë deri në vrasje të njerëzve dhe shkatërrim të objekteve, pa qenë përgjegjës individualisht për këto akte.[5] Kur kapen, luftuesit kanë të drejtën e statusit të robit të luftës.

Banorët e një territori të papushtuar, të cilët me përparimin e kundërshtarit rrëmbejnë armët në mënyrë spontane dhe në formë masive për t'u bërë qëndresë forcave pushtuese, pa patur kohë të organizohen në njësi të armatosura, konsiderohen si ndërluftues, me kusht që t`i mbajnë armët haptas dhe të respektojnë ligjet dhe zakonet e luftës. Por, sipas Konventës së III-të të Gjenevës, ata e humbasin këtë të drejtë sapo forcat e armikut marrin në kontroll zonën në fjalë. Personat që jetojnë në një territor të pushtuar dhe që nuk u përkasin forcave të armatosura, nuk lejohet t'i bëjnë rezistencë të armatosur ushtrisë pushtuese.[6]

3.1.1. b Civilët

Person civil është çdo person që nuk i përket forcave të armatosura dhe që nuk merr pjesë në luftime. Civilët që rrëmbejnë armët e humbasin mbrojtjen dhe ndaj tyre mund të përdoret forca.[7]

Konventa e IV e Gjenevës e vitit 1949 "Mbi mbrojtjen e popullsisë civile" ndalon përdorimin e civilëve si mburojë për të ruajtur disa zona ose instalime, zakonisht të një rëndësie ushtarake të veçantë nga sulmi i armikut.

Dënimi kolektiv i civilëve dhe masat që synojnë frikësimin ose terrorizimin e popullsisë civile, plaçkitjen, marrjen peng dhe ndëshkimet ndaj civilëve, gjithashtu janë të ndaluara.

Në rast dyshimi, nëse një person është civil apo jo, ky person duhet të konsiderohet si civil. Popullsia civile përfshin të gjithë njerëzit që janë popullsi civile. Prania e individëve jocivilë brenda popullsisë civile nuk ia heq popullsisë karakterin e saj civil.

---

5. Protokolli i I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës, neni 43.
6. Hans Peter Gasser, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, "E Drejta Ndërkombëtare Humanitare", dhjetor 2000, f.68.
7. Shih: KGJ IV, neni 5; P I, nenet 45, 51; P II, neni 13.

Gazetarët që punojnë në teatrin e luftës, konsiderohen gjithashtu si civilë dhe gëzojnë të njëjtën mbrojtje si civilët. Ata duhet të respektojnë detyrimet e parashikuara për civilët dhe veçanërisht duhet të shmangen nga pjesëmarrja në luftim.

Për të mbrojtur popullsinë civile, në raste të veçanta krijohen zona të sigurta.

3.1.1. c Të plagosurit, të sëmurët, anijembyturit

I plagosur dhe i sëmurë është çdo person,[8] ushtarak apo civil, i cili për shkak të tronditjes, sëmundjes, ose ndonjë paaftësie apo çrregullimi tjetër fizik a mendor, ka nevojë për ndihmë, ose kujdes mjekësor dhe që nuk kryen asnjë veprim luftarak. Termat i plagosur dhe i sëmurë përfshijnë edhe rastet e shtatëzanisë, të nënave me fëmijë të porsalindur dhe personave të tjerë të cilët mund të kenë nevojë për ndihmë ose kujdes mjekësor të menjëhershëm.

Të plagosurit dhe të sëmurët nuk mund të sulmohen. Ata duhet të trajtohen në mënyrë humane. Dhuna dhe eksperimentet biologjike ndaj tyre janë të ndaluara. Gratë duhet të trajtohen me respekt, në përputhje me seksin e tyre. Ndërluftuesit duhet t'u sigurojnë të plagosurve dhe të sëmurëve kujdesin mjekësor. Ata nuk mund të lihen me qëllim pa asistencë mjekësore dhe as të ekspozohen ndaj sëmundjeve ngjitëse ose infeksioneve.

Mjetet ushtarake ose civile që përdoren për transportin e të plagosurve dhe të sëmurëve gëzojnë mbrojtje të plotë.[9] Të njëjtën mbrojtje gëzon edhe transportimi i personelit mjekësor dhe i furnizimeve. Automjetet që përdoren për këto lloj transportesh nuk mund të sulmohen dhe nuk mund të përdoren për qëllime të ndryshme nga ato mjekësore.

Në çdo kohë dhe veçanërisht pas sulmeve, të plagosurit dhe të sëmurët duhet të kërkohen dhe të mblidhen. Duhet gjithashtu të vendosen armëpushime me qëllim që të bëhet e mundur mbledhja dhe evakuimi i të plagosurve nga fushëbeteja dhe nga zonat e rrethuara. Këto obligime duhet të zbatohen pa asnjë dallim bazuar në seksin, racën, kombësinë, besimin, bindjet politike, ose kritere të tjera të ngjashme.

Të plagosurit dhe të sëmurët duhet të kufizohen në kryerjen e akteve armiqësore, sepse përndryshe humbasin statusin mbrojtës. Ndërluftuesit duhet të mbajnë të dhëna të detajuara për të plagosurit dhe të sëmurët e palës kundërshtare që bien në duart e tyre. Ky informacion duhet t'i përcillet byrosë informative kombëtare. Zyrë Kombëtare Informacioni[10] duhet të ngrihen në çdo vend të implikuar në një konflikt të armatosur në mënyrë që të mblidhet dhe përhapet informacion mbi të plagosurit dhe të sëmurët, të vdekurit, robërit e luftës dhe të internuarit.

Në qoftë se një palë ndërluftuese është e detyruar të braktisë të plagosurit dhe të sëmurët e saj, ajo duhet të lerë me ta një pjesë të personelit mjekësor dhe paisjeve të nevojshme për të përmbushur nevojat e tyre. [11] Kjo pjesë e personelit mjekësor nuk kthehet në rob lufte, por mbahet nga pala kundërshtare për aq kohë sa të jetë e nevojshme për të asistuar të plagosurit dhe të sëmurët.

---

8. Shih: KGJ I, neni 12, 13; KGJ II, neni 12, 13; PGJ I, neni 8.
9. KNKK, Rregullat themelore të konventave të Gjenevës dhe të protokolleve të tyre shtesë, f. 53.
10. Shih: KGJ III, nenet 122-124; KGJ IV, nenet 136-141.

11. Shih: Protokolli i I-rë i konventave të Gjenevës, të vitit 1949, neni 12.

Për mbrojtjen e të plagosurve dhe të sëmurëve, të të moshuarve, fëmijëve, nënave shtatzëna dhe nënave me fëmijë të vegjël krijohen **zonat e sigurta**. [12] Zonat e sigurta janë relativisht zona të vogla dhe janë të mbrojtura. Ato mund të krijohen në mënyrë të njëanshme në kohë paqe ose lufte, ose me marrëveshje mes palëve në konflikt.

Palët në konflikt mundet gjithashtu të krijojnë **zona të neutralizuara**[13] për mbrojtjen e të plagosurve, ose të sëmurëve, si ndërluftues ashtu edhe civilë, si dhe të civilëve që nuk marrin pjesë në luftime dhe nuk kryejnë punë me natyrë ushtarake.

Këto zona krijohen pas shpërthimit të luftimeve me marrëveshje midis palëve në konflikt, duke përfshirë vendndodhjen dhe shtrirjen e tyre, mënyrën e administrimit, furnizimin me ushqime, mbikqyrjen dhe kohëzgjatjen.

Anijembytur konsiderohen personat që janë në rrezik në det si rezultat i zhytjes, përplasjes apo ndonjë dëmtimi tjetër të anijes së tyre, ose si rezultat i rrëzimit të ndonjë aeroplani. Nuk ka rëndësi fakti nëse rreziku shkaktohet nga sulmi i armikut, apo nga shkaqe joushtarake.

Në anijembyturit nuk përfshihet personeli ushtarak që merr pjesë në sulmet nënujore amfibe apo sulmet ajrore, përveç rasteve kur ata janë në rrezik shumë të qartë dhe duan ndihmë. Këto persona cilësohen si anijembytur vetëm nëse pushojnë të gjithë aktivitetin e tyre ushtarak dhe kundërshtarit i krijohet mundësia e njohjes më të mirë të gjendjes së tyre të rrezikut.

Të vdekurit: Kujdes duhet treguar edhe për të vdekurit, pas një beteje. Të vdekurit duhet të mbrohen nga gjymtimi dhe plaçkitja. Sendet me vlerë të të vdekurve duhet të dërgohen në Byronë Kombëtare të Informacionit. Varrimi i të vdekurve duhet bërë vetëm pas një ekzaminimi të mëparshëm të mjekut. Në raste të rrezikshme për higjenën, trupat e të vdekurve mund të digjen. Varreve duhet t'u vihen shenja dalluese dhe duhen rregjistruar. Armët, municionet dhe pajisjet ushtarake të tyre duhet t'u dorëzohen autoriteteve ushtarake dhe të mos mbahen si suvenire nga ushtarët e palës kundërshtare.

Persona të humbur

Në raste fatkeqësish, siç është edhe konflikti i armatosur merr rëndësi të jashtëzakonshme sigurimi i lajmeve për të afërmit. Protokolli i I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës të vitit 1949, ka njohur të drejtën e familjeve për të ditur fatin e të afërmve të tyre në periudhat e konfliktit të armatosur. Çdo palë ndërluftuese është e detyruar të grumbullojë të dhëna për të plagosurit dhe të vrarët, si dhe të kërkojë njoftime për personat që deklarohen të humbur. [14] Për këtë qëllim, menjëherë pas shpërthimit të luftës, palët në konflikt duhet të ngrenë zyra informacioni. Me këtë çështje merret edhe Agjensia Qendrore e Kërkimit[15] e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq.[16]

12. Y Sandoz, "The Establishment of Safety Zones for Persons Displaced ëithin their Country of Origin", Conference on International Legal Issues arising under the United Nations Decade of International Laë, Qatar, march 1994, pp.22-25.
13. Shih: KGJ IV, neni 15.
14. Shih: KGJ III, neni 19; KGJ IV, neni 133; PGJ I, neni 33.
15. Shih: KGJ III, neni 123; KGJ IV, neni 140.

16. KNKK, Rregullat themelore të konventave të Gjenevës dhe të Protokolleve të tyre shtesë, f. 14.

3.1.1. d Personeli mjekësor

Personeli mjekësor përbëhet nga personat, ushtarakë apo civilë, të cilët janë ngarkuar vetëm me detyra mjekësore nga një palë në konflikt. Personel i përhershëm mjekësor janë personat e përfshirë vetëm në mbledhjen, transportin, ose trajtimin e të plagosurve dhe të sëmurëve, ose në parandalimin e sëmundjeve.

Personeli mjekësor ndihmës përfshin punonjësit me orar pune të kufizuar, si sanitarë, infermierë, barrelë-mbajtës, ose shoferë, zakonisht efektiv të njësisë së luftimit që kanë një farë përgatitjeje mjekësore, (ose janë të aftë në dhënien e ndihmës së parë), por për të cilët detyrat mjekësore janë vetëm veprimtari dytësore.

Personeli mjekësor i përhershëm mbrohet nga sulmet. Personeli ndihmës gëzon të njëjtën mbrojtje vetëm kur kryen detyra mjekësore. [17] Në çdo rast ata e humbasin mbrojtjen në qoftë se marrin pjesë drejtpërdrejt në luftime.

Personeli mjekësor mund të përdorë armë të lehta individuale për vetëmbrojtje dhe për mbrojtjen e pacientëve nga sulmet e paligjshme. Në armë të lehta përfshihen pistoletat, pushkët dhe automatikët, por jo mitralozët, mortajat dhe armët kundërtanke.

P.sh., në qoftë se ushtarët armiq hyjnë në një ambjent mjekësor dhe sulmojnë personelin mjekësor, ose të plagosurit, personeli mjekësor ka të drejtë të përdorë armët, pa humbur mbrojtjen e veçantë si personel mjekësor.

Në qoftë se individë nga personeli mjekësor bien në duart e palës kundërshtare, duhet të lejohen të vazhdojnë funksionet e tyre mjekësore, derisa fuqia që i ka kapur të ketë mundësi t'i kryejë vetë shërbimet mjekësore. Ata nuk mund të detyrohen të kryejnë punë jomjekësore.

Personeli mjekësor i përhershëm duhet të jetë i pajisur me kartë të veçantë identiteti, me fotografinë dhe firmën e mbajtësit të saj. Personeli mjekësor ndihmës duhet të ketë kartë të veçantë identiteti që konfirmon trajnimin e tyre mjekësor dhe natyrën e përkohëshme të detyrave të tyre. Personeli mjekësor duhet të mbajë në krah një shirit të bardhë me shenjën e kryqit të kuq, ose gjysmëhënës së kuqe. Në rastet kur ky shirit nuk mund të shihet prej së largu, ata mund të përdorin flamurë të kryqit të kuq, ose gjysmëhënës së kuqe mbi pajisjet, ose automjetet e tyre, ose të vendosin shenjat mbrojtëse sipër veshjeve të tyre.

Transportet mjekësore janë të gjitha llojet e transporteve, civile ose ushtarake, të përhershme, ose të përkohëshme, të destinuara vetëm për transport mjekësor dhe nën kontrollin e një autoriteti kompetent të një pale të konfliktit.

Transportet mjekësore nuk lejohet të sulmohen, por ato e humbasin këtë mbrojtje në qoftë se përdoren për qëllime të tjera, psh nëse transportojnë pajisje ushtarake.

17. Shih: KGJ I; KGJ II; KGJ IV, nenet 56, 57; P I, nenet 8-31; P II, nenet 7-12.

3.1.1. e Personeli fetar dhe objektet fetare

Personel fetar janë ushtarakë apo civile, të tillë si kapelanë, të angazhuar vetëm me shërbesa fetare dhe që u bashkangjiten:

a) forcave të armatosura;
b) shërbimit mjekësor;
c) mbrotjes civile.

Bashkëngjitja e personelit fetar me këto njësi mund të jetë e përkohshme.

Priftërinjtë, që kryejnë misionin e tyre në forcat e armatosura, gëzojnë status të barabartë mbrojtjeje me atë të personelit mjekësor, por nuk mund të mbajnë armë të vogla.

Priftërinjtë duhet të tregojnë emblemën dalluese të Kryqit të Kuq kur janë duke kryer aktivitetet e tyre fetare. Kur bien në duart e armikut, ata nuk bëhen robër lufte. Nëse nuk nevojiten për t'u kujdesur për robërit e luftës priftërinjtë duhet të riatdhesohen në momentin më të mundshëm, pra kur situata luftarake të lejojë një gjë të tillë.

Objekte fetare[18] janë objekte dhe artikuj me karakter fetar, si për shembull libra, shkrime lutjesh dhe objekte të përdorura vetëm nga personeli fetar ushtarak, (për shembull, mjete transporti).

3.1.1. f Pasuria kulturore

Pasuria kulturore nuk duhet të përdoret për qëllime ushtarake, pasi në këtë mënyrë do të ekzistojë nevoja për të organizuar një sulm kundër saj. Kështu një kullë kishe, ose minare xhamije nuk duhet të përdoret si pikë ushtarake vëzhgimi.[19]

Mund të ketë raste të rralla kur përdorimi i pasurisë kulturore për qëllime ushtarake është vendimtar, (për shembull, një urë historike që është e vetmja rrugë për kalimin e lumit). Këto raste ndodhin vetëm kur nuk ka ndonjë zgjidhje të mundshme midis përdorimit të pasurisë kulturore për qëllime ushtarake dhe një metodë tjetër të efektshme për sigurimin e një përfitimi të ngjashëm ushtarak.

Rregullat e Hagës u kërkojnë atyre që organizojnë rrethime dhe bombardime të ruajnë, sa më shumë që të jetë e mundur, ndërtesat kushtuar fesë, artit, ose shkencës dhe monumentet historike[20], sa kohë që ato nuk përdoren për qëllime ushtarake. Protokolli i Gjenevës e përforcon dhe e zgjeron këtë kërkesë duke shpallur se pasuria kulturore nuk duhet të bëhet objekt i veprimeve të sulmit ose raprezaljeve, as të përdoret në mbështetje të veprimeve ushtarake.

18. Shih: KGJ III, neni 33, 72; KGJ IV, neni 58.
19. Konventa mbi mbrojtjen e pasurisë kulturore, në rast konflikti të armatosur, Hagë, 14 maj 1954.

20. Shih: PGJ I, neni 53.

Krahas kësaj, për mbrojtjen e pasurisë kulturore në kohë lufte ekziston edhe një konventë e posaçme, Konventa e Hagës për pasurinë kulturore e vitit 1954. Në bazë të kësaj Konvente pasuria kulturore nuk duhet të përdoret në mënyrë të tillë sa t'i ekspozohet para shkatërrimit, ose dëmtimit, në rast konflikti të armatosur dhe veprimet ushtarake nuk duhet të drejtohen kundër kësaj pasurie.[21] Pasuria kulturore mban një emblemë të posaçme mbrojtëse. Pasuria kulturore që ka rëndësi të veçantë, regjistrohet në një regjistër ndërkombëtar dhe mban një emblemë për mbrojtje të trefishtë.[22]

Autoritet shtetërore të vendit ku ndodhet pasuria kulturore ngarkohen me shumë më tepër përgjegjësi në hartimin dhe botimin e listave, regjistrimin e pasurisë nën mbrojtje të posaçme, ose të përforcuar, shënjimin e pasurisë, marrjen e masave të emergjencës kundër zjarrit, ose dëmtimeve strukturore, hartimin e planeve për transferimin e pasurisë në strehime, ose për sigurimin e mbrojtjes në vend, ngritjen e vendstrehimeve, dhe caktimin e një autoriteti përgjegjës për mbrojtjen e pasurisë kulturore.[23]

Objekt kulturor nën mbrojte të posaçme[24] është një objekt me rëndësi të madhe për trashëgiminë kulturore të çdo populli, të tillë si:

- monumentet e arkitekturës, artit ose historisë, qendrat arkeologjike, grupe ndërtesash të cilat si një e tërë kanë interes historik apo artistik;
- ndërtesat, qëllimi kryesor i të cilave është ruajtja e objekteve kulturore të lëvizshme, të tilla si muzeumet, bibliotekat e mëdha, arkivat, vendstrehimet e objekteve kulturore;
- qendrat që përmbajnë një sasi të madhe objektesh kulturore të palëvizëshme.

Imuniteti i objekteve kulturore nën mbrotje të veçantë mund të hiqet vetëm në raste përjashtimore të domosdoshmërisë ushtarake të pashmangshme dhe vetëm për aq kohë sa të zgjasë kjo domosdoshmëri.

Objektet kulturore të transferuara gjatë luftës duhet t'i kthehen palës ndërluftuese në territorin e së cilës ndodheshin më parë këto objekte.

3.1.2 Robërit e luftës

Konsiderohen si aktet e para ndërkombëtare që trajtojnë rregjimin e robërve të luftës, Konventat e Hagës të viteve 1889 dhe 1907, mbi rregullat dhe normat e luftës në tokë.[25] Konventa e Hagës e vitit 1907 ka qenë akti ndërkombëtar kryesor nga i cili duhej të udhëhiqeshin palët ndërluftuese gjatë Luftës së Parë Botërore, përsa i përket trajtimit të robërve.

21. Konventa mbi mbrojtjen e pasurisë kulturore, në rast konflikti të armatosur, Hagë, 14 maj 1954, neni 53.
22. Protokolli i II-të i Konventës mbi mbrojtjen e pasurisë kulturore në rast konflikti të armatosur, Hagë, 14 maj 1954, nenet 10-14.
23. KNKK, Disa konventa të Hagës dhe traktate të tjera. shtator 2001, f. 52.
24. KNKK, Rregullat themelore të konventave të Gjenevës dhe të protokolleve të tyre shtesë, f. 37.

25. Arben PUTO, E drejta Ndërkombëtare Publike, Tirane 2002, f.525.

Hapa cilësore për vendosjen e rregullave të trajtimit të robërve të luftës u bënë në Konventën e Gjenevës të vitit 1929. Kjo Konventë, përveçse ripohonte parimet e hershme, trajtoi edhe parime të tjera si ndalimin e hakmarrjes ndaj personave të mbrojtur, duke rregulluar kushtet e punës dhe dënimet penale.

U ngrit gjithashtu një sistem kontrolli nga ana e atyre që quheshin Fuqitë Mbrojtëse, për verifikimin e zbatimit të Konventës.

Konventa e Gjenevës e vitit 1929, shumë shpejt do të përballej me Luftën e Dytë Botërore. Mund të thuhet se për shumë robër ajo siguroi një mbrojtje reale dhe rregjim burgimi më të mirë se në periudhën e Luftës së Parë Botërore. Aty ku Konventa ishte në fuqi, vdekshmëria midis të burgosurve nuk i kalonte kuotat normale, ndërsa në kampet ushtarake ku nuk njihej, si dhe në kampe përqëndrimi civilësh të pambrojtur, vdekshmëria ishte shumë e lartë. Pra edhe kur nuk zbatohet plotësisht një konventë ndërkombëtare, ajo bëhet pengesë e domosdoshme kundër keqpërdorimit të pushtetit.

Shteteve, si ish BRSS, që nuk ishte palë në Konventën e Gjenevës të vitit 1929, mbi "Trajtimin e robërve të luftës", iu refuzuan përfitimet e Konventës. Mund të përmenden robërit sovjetikë në Gjermani dhe robërit e luftës në ish BRSS. Nga të dy anët e frontit ushtarët e kapur rob nuk kishin mbrojtje ligjore dhe vdekshmëria kapte shifra të frikshme. Nga tre milion robër lufte në ish BRSS, rreth një e treta e tyre vdiqën. Në Gjermani kishte të dhëna për një vdekshmëri edhe më të lartë, duke arritur deri në tre të pestat, (3.3 milion nga 5.7 milion robër).[26]
Parashikimi i rregullave të trajtimit të robërve të luftës vazhdon me Konferencën Diplomatike të vitit 1949.

3.1.2. a Statusi i robërve të luftës

Konventa e III-të e Gjenevës e vitit 1949, trajton deri në detaje problemin e robërve të luftës. Sipas kësaj konvente "Robërit e luftës duhet të trajtohen me humanizëm në çdo kohë. Gjatë robërisë, robërit e luftës ruajnë statusin e tyre ligjor, si pjesëtarë të forcave të armatosura. Kjo shprehet në faktin që ata lejohen të mbajnë veshur uniformat e tyre dhe vazhdojnë t'u binden oficerëve të tyre, që edhe vetë janë robër lufte".[27]
Një parim shumë i rëndësishëm që duhet mbajtur parasysh nga palët në trajtimin e robërve të luftës, është se ata janë robër, jo të individëve të veçantë apo njësive ushtarake, por të shtetit armik. Është pikërisht shteti ai që mban përgjegjësi për trajtimin e robërve të luftës, në përmbushje të detyrimeve të tij ndërkombëtare.

Robërit e luftës, menjëherë pas kapjes së tyre, janë të detyruar të japin informacion për emrin, gradën ushtarake, datën e lindjes dhe numrin personal. Ata në asnjë rrethanë nuk janë të detyruar të japin informacione të karakterit ushtarak.[28]

26. J. Pictet, Zhvillimi dhe parimet e së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare, 2001, f.41.
27. Konventa e III-të e Gjenevës, për trajtimin e robërve të luftës, 12 gusht 1949, neni 16.
28. Konventa e III-të e Gjenevës, për trajtimin e robërve të luftës, 12 gusht 1949, neni 17.

Pas kapjes së robit të luftës, plotësohet fleta e robërisë,[29] e cila i dërgohet zyrës së informacionit zyrtar të vendit të origjinës së robit, nëpërmjet Agjencisë Qendrore të Kërkimit, të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq.[30]

3.1.2. b Evakuimi i robërve të luftës

Robërit e luftës duhet të evakuohen sa më shpejt që të jetë e mundur nga zona e luftimit dhe të vendosen në një vend të sigurt. [31]Ata nuk duhet t'i ekspozohen rrezikut në mënyrë të panevojshme. Gjatë evakuimit duhet të merren masa në lidhje me sigurinë e robërve të luftës, duke i mbrojtur veçanërisht kundër akteve të dhunës, ose të kërcënimit dhe kundër fyerjeve dhe kureshtjes publike. Forca që i mban rob duhet të sigurojë furnizimin me ushqim, ujë të pijshëm të mjaftueshëm, veshmbathje të nevojshme dhe kujdesin mjekësor gjatë evakuimit.

Robërit e luftës duhet të grumbullohen në mjedise sipas kombësisë, gjuhës dhe zakoneve të tyre. Ata që kanë shërbyer në të njëjtat forca të armatosura nuk duhet të ndahen, përveçse me pëlqimin e tyre.

Mjediset e grave duhet të jenë të ndara nga ato të burrave dhe duhet të jenë nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të grave.[32]

Fëmijët nuk duhet të akomodohen në mjediset e të rriturve, përveç rasteve kur familjet sistemohen në të njëjtin vend si një familje e tërë. [33]

Autoritetet e ndalimit[34] kanë mundësinë e transferimit të robërve të luftës në një vend tjetër. Kjo zakonisht ndodh nëse është e pamundur të përmbushen detyrimet e palës që i mban rob, sipas Konventës së III-të të Gjenevës. Për shembull, nëse ka shumë robër lufte për t'u marrë me ta, nëse nuk ka materiale për të ofruar kujdesin e përshtatshëm, ose nëse pala është e paaftë të ofrojë vëmendjen e duhur mjekësore për robërit e luftës të sëmurë, ose të plagosur.

Në një situatë aleance një vend mund të dalë vullnetar për të mbajtur të gjithë robërit e luftës. Robërit e luftës munden gjithashtu të transferohen në një vend asnjanës.[35]

Fuqia Ndaluese[36] mund të përdorë punën e robërve të luftës që janë fizikisht të aftë për të punuar. Puna duhet të jetë e përshtatshme, duke patur parasysh aftësitë fizike të robërve të luftës, ndërsa kushtet e punës së tyre nuk duhet të jenë më të këqija se ato të shtetasve të Fuqisë Ndaluese.

---

29. Konventa e III-të e Gjenevës për trajtimin e robërve të luftës, 12 gusht 1949, neni 130 & Protokolli i II-të Shtesë i konventave të Gjenevës, neni 85.
30. Konventa e III-të e Gjenevës për trajtimin e robërve të luftës, 12 gusht 1949, neni 122.
31. Konventa e III-të e Gjenevës për trajtimin e robërve të luftës, 12 gusht 1949, neni 19, 25.
32. Shih: KGJ III, neni 25; PGJ I, neni 75.
33. Shih: PGJ I, neni 77.
34. Pietro Verri, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, "Fjalor i së Drejtës Ndërkombëtare të Konfliktit të Armatosur", Tiranë 2001, f.4.
35. KNKK, E drejta e konfliktit të armatosur, Dosje mësimore për instruktorët, qershor 2002,"Logjistika dhe zonat e prapavijës", f. 23.
36. Në një konflikt të armatosur ndërkombëtar, fuqia që mban anëtarët e forcave të armatosura që janë të sëmurë, të plagosur dhe anijembytur, personelin mjekësor dhe fetar, të internuarit civilë ose robërit e luftës që i përkasin palës kundërshtare.

Oficerët nuk duhet të detyrohen të punojnë, megjithatë ata mund të kërkojnë të kryejnë një punë të përshtatshme nëse dëshirojnë. Nënoficerëve mund t'u kërkohet të bëjnë vetëm punë mbikqyrëse, por me dëshirën e tyre mund të bëjnë edhe lloje të tjera punësh.

Robërve të tjerë mund t'u kërkohet të bëjnë punë që nuk janë të dëmshme për shëndetin[37], joposhtëruese, të parrezikshme, ose pa karakter apo qëllim ushtarak.

Robërit e luftës pasi vendosin lidhjet me familjet dhe të afërmit, nëpërmjet zyrës së informacionit zyrtar të vendit të tyre, lejohen të shkëmbejnë korrespondenca, të marrin pako individuale, ose dërgesa kolektive.[38]

Robërit e luftës u nënshtrohen ligjeve, rregulloreve dhe urdhërave në fuqi që zbatohen nga forcat e armatosura të Fuqisë Ndaluese.[39] Një rob lufte që kapet përsëri pas një tentative arratisjeje, duhet të dënohet vetëm me masë disiplinore. Pala që i mban robërit e luftës mund t'i dënojë për shkelje të kryera përpara kapjes (p.sh. krime të mundshme të kryera në një territor të pushtuar, ose në fushën e betejës),[40] por ky gjykim duhet të bazohet në një proces të ndershëm dhe nëse dënohen ata mbajnë përsëri statusin e tyre ligjor si robër lufte. Riatdhesimi i të dënuarve mund të shtyhet deri sa të kryejnë dënimin.

3.1.2. c Kushtet për robërit e luftës

Ushqimi i përditshëm duhet të jetë në sasi dhe cilësi të mjaftueshme dhe i përshtatshëm, në mënyrë që robërit e luftës të mbahen në gjendje të mirë shëndetësore.

Veshmbathjet e tyre, përfshirë të brendshme dhe këpucë, duhet të jenë të përshtatshme për kushtet klimatike. Robërit e luftës që punojnë duhet të pajisen me veshje të përshtatshme për punën. Në rast se robërit rrezikohen nga sulmi, ose pasojat e luftës bërthamore, bakterologjike, ose kimike, atëhere duhet të pajisen me veshmbathjet dhe pajisjet e domosdoshme mbrojtëse, nëse nuk i kanë vetë ato.

Robërit e luftës duhet të lejohen të mbajnë të veshur uniformën e forcave të tyre. Për këtë qëllim mund të përdoren uniformat e kapura nga fuqia ndaluese.

Robërit e luftës duhet të lejohen të ndjekin ritet fetare. Për kryerjen e shërbesave fetare duhet të sigurohen ambjente të përshtatshme.

Robërit e luftës duhet të nxiten për të zhvilluar veprimtari intelektuale, edukative dhe argëtuese dhe të bëjnë ushtrime fizike. Atyre duhet t'u krijohen kushtet e nevojshme për këto veprimtari.

---

37. Konventa e III-të e Gjenevës për trajtimin e robërve të luftës, 12 gusht 1949, nenet 49-57.
38. Konventa e III-të e Gjenevës për trajtimin e robërve të luftës, 12 gusht 1949, neni 72.
39. Konventa e III-të e Gjenevës për trajtimin e robërve të luftës, 12 gusht 1949, neni 82, 108.
40. KNKK , Rregullat themelore të konventave të Gjenevës dhe të protokolleve të tyre shtesë. f. 29.

Përfaqësuesit e Fuqive Mbrojtëse[41] dhe Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, kanë të drejtë të hyjnë në të gjitha vendet dhe ambjentet ku ndodhen robërit e luftës. Ata kanë liri të plotë të zgjedhin vendet që dëshirojnë të vizitojnë. Lejohen të vizitojnë robërit e

luftës në transferim, të intervistojnë robërit e luftës pa dëshmitarë dhe mund të ndihmojnë robërit e luftës në rast ndjekjeje gjyqësore.[42]
Vdekja e një robi lufte në situata të paditura dhe të dyshimta, p.sh. gjatë një tentative për ikje, ose në duart e një robi tjetër lufte, duhet të hetohet plotësisht nga autoritetet ushtarake dhe të raportohet mbi informacionin e dërguar tek fuqitë mbrojtëse.[43]
Një raport i plotë mbi vdekjen, dokumentet e rëndësishme për të afërmit, paratë dhe të gjitha sendet personale duhet të dërgohen në zyrën kombëtare të informacionit.
Në përfundim të luftimeve aktive, robërit e luftës duhet të lirohen dhe të riatdhesohen pa vonesë. Neni 118 i Konventës së III-të të Gjenevës të vitit 1949 nuk bën asnjë përjashtim për dërgimin e robërve në vendin e tyre, që nënkupton se ata nuk mund të refuzojnë riatdhesimin.[44] Riatdhesimi mund të mos jetë gjithmonë i dëshiruar nga robërit e luftës, sidomos në rastin kur robërit me t'u kthyer në vendin e tyre mund të përndiqen, si rezultat i ndryshimit të regjimit politik pas kapjes së robërve. Detyrimi i palëve në konflikt për të riatdhesuar robërit e luftës në mbarim të armiqësive duhet zbatuar sepse, nëse robërit do të lejoheshin të vendosnin vetë për rikthimin ose jo të tyre në atdhe, atëherë edhe forca që i mban rob do të kërkonte të drejtën për të vendosur në lidhje me riatdhesimin dhe mund të ushtronte presion ndaj robërve për t'i detyruar ata të qëndrojnë.
Personeli ushtarak mjekësor[45] i kundërshtarit mund të mbahet për aq kohë sa e kërkon gjendja shëndetësore dhe numri i robërve të luftës.
Personeli ushtarak mjekësor i kundërshtarit, mbajtja e të cilit nuk është e domosdoshme duhet të riatdhesohet sapo të hapet rruga për kthimin e tij dhe sapo ta lejojnë kërkesat ushtarake.
Personeli fetar i kundërshtarit mund të mbahet vetëm për aq kohë sa e kërkojnë nevojat shpirtërore dhe numri i robërve të luftës.[46] Roli i personelit fetar të mbajtur në një kamp robërish lufte është:

- të ruajë moralin e robërve të luftës duke kryer shërbesa për ta;

- të ketë përgjegjësi vetjake së bashku me oficerin e lartë të robërve të luftës, ose përfaqësuesin e robërve dhe oficerin e lartë mjekësor të mbajtur, për mirëqënien e robërve të luftës, duke siguruar zbatimin nga fuqia ndaluese të Konventës për robërit e luftës.

41. Shih: KGJ II, neni 8; KGJ III, neni 8; KGJ IV, neni 9; H KP R, nenet 3, 5, 8, 9-11, 17.
42. Shih: KGJ III, neni 87.
43. Shih: KGJ III, neni 121.
44. Geneva Convention relative to the Treatment of Prisoners of War, of 12 August 1949, article 118.
45. Konventa Gjenevës I, nenet 28, 30; Konventa Gjenevës II, neni 37.
46. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, E Drejta e Konfliktit të Armatosur, (Logjistika dhe Zonat e Prapavijës), Dosje mësimore për instruktorët, Tiranë, qershor 2002, f.19-7.

Konventa e III - të e Gjenevës e vitit 1949, ka përcaktuar kategoritë e tjera të personave që gëzojnë të njëjtin status me pjesëtarët e forcave të armatosura, duke filluar me pjesëtarët e lëvizjes së rezistencës.[47] Pjesëtarët e lëvizjes së rezistencës, nëse duan të trajtohen si robër lufte duhet të kenë një komandant përgjegjës, të mbajnë shenjë dalluese, t'i mbajnë armët haptazi dhe të kryejnë operacione luftarake në përputhje me të drejtën e luftës.

Personat e autorizuar për të shoqëruar forcat e armatosura, por pa bërë pjesë në to, si pjesëtarët civilë të ekuipazheve të anijeve ose avionëve, korrespondentët e luftës duhet

gjithashtu të trajtohen si robër lufte. Këtu bëjnë përjashtim gazetarët, që duhen trajtuar si civilë, në bazë të përcaktimeve të Protokollit të I-rë shtesë të konventave të Gjenevës.

Gëzon statusin e robërve të luftës edhe ajo pjesë e popullsisë civile që në mënyrë spontane rrëmben armët për t'i rezistuar afrimit të forcave të armikut, në rast se pjesëtarë të kësaj force kapen nga kundërshtari.

Në zonën e luftës mund të veprojnë civilë, si zyrtarët e Kombeve të Bashkuara, delegatët e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, anëtarët e organizatave joqeveritare të ndihmës, ose pjesëtarët e medias, të cilët nuk janë të akredituar si korrespondentë të luftës. Këta persona janë thjesht civilë që nuk duhet të marrin pjesë në luftime, nuk duhet të shoqërojnë, ose të punësohen prej forcave të armatosura të një pale në konflikt, ose të ndërmarrin në emër të një pale detyra me natyrë ushtarake. Ata nuk janë robër lufte kur bien në duart e një pale në konflikt dhe duhet të lirohen, megjithëse ndaj lirisë së lëvizjes së tyre duhet të vendosen kufizime, në rast se prania e tyre do të ndërhynte në zhvillimin e operacioneve ushtarake, ose do t'i vinte ato në rrezik.

3.1.2. d Spiunimi

Një spiun është ai person i cili në territorin e kontrolluar nga armiku kërkon të marrë informacion duke vepruar si palë joluftuese, ose nën statusin e forcave mike, me qëllimin për ta kaluar atë informacion tek një palë tjetër kundërshtare.

Spiunimi[48] gjatë konfliktit të armatosur nuk është shkelje e të drejtës ndërkombëtare, por spiunët kur kapen nuk e gëzojnë të drejtën e statusit të robërve të luftës. Vendi që i kap mund t'i gjykojë dhe dënojë spiunët, në përputhje me ligjin e tij të brendshëm. Nëse spiuni arrin të shpëtojë dhe të kthehet në një territor mik, kushti për t'a dënuar mbaron. Nëse kapet sërish gjatë veprimeve të mëvonshme ushtarake, ish-spiuni nuk mund të gjykohet dhe dënohet për aktet e mëparshme të spiunazhit.

Spiunët nuk duhen ngatërruar me forcat ushtarake të cilat mund të dërgohen në misione zbulimi, ose në operacione të forcave speciale në thellësi të territorit armik.[49] Këto njësi veshin uniforma dalluese dhe zakonisht janë pjesëtarë të forcave të armatosura që mbledhin informata sekrete në territorin e kontrolluar nga kundërshtari.

---

47. Konventa e III - të e Gjenevës, 1949, neni 4.
48. Espionage, http://en.wikipedia.org/wiki/Espionage
49. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, E Drejta e Konfliktit të Armatosur, (Integrimi i Ligjit në Operacionet Ushtarake), Dosje mësimore për instruktorët, Tiranë, qershor 2002, f.2-6.

3.1.2. e Veprimtaria e fuqive mbrojtëse

Konfliktet e armatosura përgjithësisht ndërpresin lidhjet që ekzistonin në kohë paqe ndërmjet palëve kundërshtare. Ndërpriten marrëdhëniet diplomatike, mbyllen kufijtë, ndërpritet trafiku dhe telekomunikacionet. Në këto situata bëhet e nevojshme veprimtaria e ndërmjetësve, që zakonisht janë Fuqitë Mbrojtëse.

Fuqi Mbrojtëse konsiderohet një shtet asnjanës, që është caktuar nga një palë në konflikt, që është pranuar nga pala kundërshtare dhe ka rënë dakort të kryejë funksionet që i ngarkohen Fuqisë Mbrojtëse në bazë të rregullave të luftës.

Veprimtaritë e Fuqisë Mbrojtëse[50] duhet të kryhen nga personeli i saj diplomatik, konsullor ose personel tjetër i caktuar posaçërisht për këtë qëllim.

Në veçanti, Fuqia Mbrojtëse ka këto detyra:

- të vizitojë dhe kontrollojë kampet e robërve të luftës dhe të civilëve të internuar;
- të kontrollojë dhe nëse është e nevojshme të marrë masa në rastet e internimit të civilëve të huaj, ose të përndjekjes penale të robërve të luftës dhe të civilëve të huaj;
- të verifikojë kushtet e furnizimit në territorin e pushtuar;
- të japë deklarata dhe të bëjë hetime në lidhje me shkeljet e mbrojtjes së objekteve kulturore;
- të ofrojë shërbime të mira në rast mosmarrëveshjeje në lidhje me zbatimin e rregullave të luftës.[51]

Në mungesë të një marrëveshjeje mbi një Fuqi Mbrojtëse, në vend të saj, do të caktohet një organizatë humanitare e paanshme si p.sh., Komuniteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq.

Kjo organizatë humanitare, e paanshme mund të ofrojë shërbimet e saj të mira edhe në drejtim të caktimit të Fuqisë Mbrojtëse.

3.1.3 Mbrojtja e civilëve nga trajtimi arbitrar

Në historinë shekullore të luftërave, konsideroheshin armiq jo vetëm ushtritë e shteteve në konflikt, por edhe banorët e këtyre shteteve. Për këtë arsye, popullsia civile lihej në mëshirë të forcës fitimtare. Civilët vriteshin, ose detyroheshin të bënin punë të detyruar, u grabitej pasuria dhe nuk iu respektoheshin të drejtat e tyre themelore.

Për herë të parë, në shekullin e XVI, u shfaq ideja e mbajtjes së civilëve larg nga lufta, por ajo arriti të zerë rrënjë vetëm në shek e XVIII. Në shek e XX pati një zhvillim të jashtëzakonshëm të mjeteve të luftës, të cilat i ekspozuan civilët edhe më shumë ndaj rrezikut të luftërave. Kjo nuk solli ndryshim në parimin e mbrojtjes së civilëve, por vështirësoi zbatimin e këtij parimi.

---

50. Protokolli i I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës, 12 gusht 1949, neni 5.
51. KGJ II, neni 8; KGJ III, neni 8; KGJ IV, neni 9; H KP R, nenet 3, 5, 8, 9-11, 17.

Në kohën tonë ekziston tendenca e zhvillimit të veprimeve luftarake vetëm kundër forcave të armatosura kundërshtare, pra pa cënuar popullsinë civile.[52]

Me problemin e paprekshmërisë së popullsisë civile, në kohë lufte, u morën fillimisht konferencat e Hagës të viteve 1899 dhe 1907. Konventat e përpunuara në këto konferenca kanë disa nene bazë, të zbatueshme për civilët. P.sh. në to përcaktohet se forcat pushtuese

duhet të respektojnë "nderin dhe të drejtat e familjes, jetët e personave dhe pronën private". Por sidoqoftë, kjo mbrojtje ofrohet vetëm në rast pushtimi të territorit.

Arritje të madhe, në drejtim të mbrojtjes së civilëve, përfaqëson Konferenca Diplomatike e Gjenevës e vitit 1949. Ajo shpallte parimin e madh se respekti për njeriun do të sigurohej në të gjitha rrethanat, prandaj ndaloheshin kërcënimet, torturat, dënimet kolektive, hakmarrjet, marrja peng dhe shpërnguljet me forcë. [53]

Ndodh që shpërthimi i luftës gjen shtetas të njërit shtet në shtetin tjetër. Duke qenë se traktatet që rregullojnë marrëdhëniet paqësore mes shteteve zakonisht bien nga fuqia me fillimin e veprimeve luftarake, shtetasit e huaj në territorin e shtetit tjetër e humbasin mbrojtjen e tyre diplomatike. Konventa e IV e Gjenevës e vitit 1949, rregulloi situatën e këtyre personave, të cilët më parë mbeteshin pa mbrojtje ligjore.[54]

Sipas Konventës së IV të Gjenevës "Për mbrojtjen e popullsisë civile", banorët e huaj, të cilët dëshirojnë të largohen nga territori në fillim të luftës, ose gjatë saj, e kanë këtë të drejtë për aq kohë sa largimi i tyre nuk bie ndesh me interesat kombëtare të shtetit. Pra, Konventa njeh të drejtën e të huajve të largohen nga vendi ku fillon konflikti, por e kufizon këtë të drejtë me mundësinë e refuzimit të lejes për t'u nisur për persona të veçantë, (p.sh. kur kanë dijeni mbi sekrete të rëndësishme).

Personave të cilëve u është refuzuar leja për t'u nisur, duhet të kenë mundësi të menjëhershme t'i drejtohen një gjykate që të marrë në shqyrtim çështjen. Ata duhet të lejohen të kenë një jetë normale.

Në territoret e pushtuara civilët nuk duhet të detyrohen të punojnë, nëse janë nën 18 vjeç dhe nuk duhet të detyrohen të marrin pjesë në operacione ushtarake.
Fëmijët përfitojnë arsim, përfshirë atë fetar dhe edukimin moral, në përputhje me dëshirat e prindërve dhe të kujdestarëve të tyre.

Duhet të merren të gjitha masat për ribashkimin e familjeve që janë ndarë përkohësisht.

Fëmijët nën moshën 15 vjeç nuk duhet të rekrutohen në forcat e armatosura, ose grupet e armatosura, as të lejohen të marrin pjesë në luftime, por edhe sikur të marrin pjesë, ata nuk e humbasin mbrojtjen e posaçme të tyre.[55]

---

52. Shih: KGJ III, neni 4; KGJ IV; P II, neni 13.
53. Shih: KGJ IV, neni 27; PGJ I, neni 48.
54. Shih: KGJ IV, neni 35, 36.
55. Protokolli i I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës, 12 gusht 1949, neni 77.

Në rast se është e nevojshme, fëmijët duhet të evakuohen përkohësisht nga zonat e luftimit në zonat më të sigurta brenda vendit, në rast se është e mundur, me pëlqimin e prindërve ose kujdestarëve të tyre. Në këto raste ata duhet të shoqërohen nga persona përgjegjës për sigurinë dhe mirëqenien e tyre. Dënimi me vdekje nuk mund të zbatohet ndaj adoleshentëve që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç në kohën e kryerjes së krimit.

Një ecje përpara u arrit duke kërkuar që të gjithë civilët, të cilëve u ish mohuar liria e tyre, për çfarëdo arësye, të mundeshin këtej e tutje të përfitonin nga trajtimi i përmirësuar në detaje, i barabartë në thelb me trajtimin e robërve të luftës.[56]

Protokolli i I-rë shtesë bëri përcaktimin e popullsisë civile[57] dhe të objekteve civile, të cilat u konsideruan si të pacënueshme, ndryshe nga personeli ushtarak dhe objektivat ushtarake. U përcaktua qartë se popullsia civile nuk duhej të sulmohej dhe u parashikuan masat e nevojshme për të ndaluar dëmtimin e popullsisë.[58] Kjo nënkuptonte identifikimin e objektivave ushtarake para sulmeve, në mënyrë që të shmangej rreziku për zonat me popullsi civile të pambrojtur.

U ndalua përdorimi i vdekjes nga uria, si metodë lufte dhe për këtë arsye u ndalua sulmi mbi sipërfaqet bujqësore, bagëtinë, mbi instalimet e ujit dhe objekte të tjera të domosdoshme për mbijetesën e popullsisë civile. U ndalua sulmi mbi punime që përmbajnë forca të rrezikshme, si diga, argjinatura dhe centralë bërthamorë, çlirimi i të cilave mund të dëmtojë rëndë popullsinë.

Pasojat e drejtpërdrejta të luftës janë gjithmonë mungesat në furnizime me ushqime, strehim dhe shërbime mjekësore. Konventa e IV e Gjenevës e vitit 1949, përcakton se palët e përfshira në konflikt dhe çdo palë e tretë jo e përfshirë në konflikt, duhet të lejojë kalimin e lirë të furnizimeve për civilët në nevojë.[59] Shteti që lejon kalimin e furnizimeve ka të drejtë të kontrollojë përmbajtjen dhe të ndjekë destinacionin e furnizimeve të ndihmës dhe mund të mos lejojë kalimin e tyre në se ka arsye të forta për të dyshuar se ato nuk do t'u dorëzohen civilëve, por do të përdoren për qëllime ushtarake.

3.1.3. a Mbrojtja civile

Sipas nenit 23 të Konventës së IV të Gjenevës të vitit 1949, nga ndihmat përfitojnë një grup i vogël, megjithëse i pambrojtur i popullsisë, si të sëmurët, të plagosurit, fëmijët, nënat shtatzëna dhe me fëmijë në gji. Neni 70 i Protokollit të I-rë Shtesë të vitit 1977 e zgjeroi kategorinë e personave që përfitojnë nga operacionet e ndihmës, duke përfshirë gjithë popullsinë në nevojë të palëve ndërluftuese. Ky protokoll ishte akti i parë ndërkombëtar që bëri përcaktimin e **mbrojtjes civile**, duke e përkufizuar atë si "kryerja e detyrave humanitare që kanë për qëllim të mbrojnë popullsinë civile nga rreziqet dhe ta ndihmojë atë të shërohet nga pasojat e menjëhershme të armiqësive, ose fatkeqësive, si dhe të krijojë kushtet e nevojshme për mbijetesën e saj".[60]

---

56. Protokolli i I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës, 12 gusht 1949, parag. 75, siguritë themelore.
57. Protokolli i I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës, 12 gusht 1949, neni 50.
58. Shih: KGJ III, neni 4; KGJ IV; P II, neni 13.
59. Konventa IV e Gjenevës për mbrojtjen e personave civilë në kohë lufte,12 gusht 1949, neni 23.
60. Protokolli i I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës, 12 gusht 1949, neni 61.

Mbrojtja civile përfshin një gamë të gjerë veprimtarish, që nga kontrolli i maskimit të ndriçimit, sigurimi i strehimeve dhe organizimi i evakuimit, te shërbimet e urgjencës mjekësore, të zjarrfikësve dhe riparimeve, deri te shërbimet e eleminimit të ndotjeve dhe shënjimit të zonave të rrezikshme.

Shërbimet e mbrojtjes civile realizohen nga organizatat e mbrojtjes civile, të cilat duke qenë krejtësisht civile në karakterin e tyre nuk i nënshtrohen zinxhirit ushtarak të komandimit, por vetëm autoriteteve civile.[61] Organizatat e mbrojtjes civile duhet të lejohen të kryejnë shërbimet e tyre edhe në rast pushtimi të territorit. Atyre duhet t'u krijohen kushtet e përshtatshme dhe lehtësitë e nevojshme që zakonisht mungojnë në një territor ku vazhdon konflikti i armatosur. Këto organizata, personeli dhe paisjet e tyre janë krejtësisht të mbrojtura. Emblema që siguron mbrojtjen e tyre është një trekëndësh blu, në një sfond ngjyrë portokalli.[62]

Personeli i mbrojtjes civile mund të armatoset me pistoleta për vetmbrojtje, por ai dhe njësitë e mbrojtjes civile nuk lejohen të marrin pjesë drejtpërdrejt në luftime. Në rast se marrin pjesë në luftime atëherë e humbasin mbrojtjen.[63]

3.1.3. b Lufta guerrilase

Mbas Luftës së Dytë Botërore, Konferenca Diplomatike e viteve 1974 – 1977 u mor me një problem, i cili po merrte një rëndësi të madhe dhe që s'mund të shpërfillej, me viktimat e guerrileve. Në këtë kuadër, iu kushtua rëndësi e veçantë marrjes në mbrojtje të viktimave civile.[64]

Lufta guerrile karakterizohet nga fakti që luftëtarët shpesh punojnë në fshehtësi, duke kryer sulme e prita dhe duke u përpjekur të krijojnë pasiguri. Guerrilasit lulëzojnë kur terreni u siguron mbulim, qoftë ky në male, pyje dhe tokë kënetore, ose në qytete.

Grupet guerrile krijohen kryesisht aty ku ekziston një pabarazi e madhe midis forcave kundërshtare, trupa të rregullta të armatosura rëndë nga njëra anë dhe grupe të vogla nga ana tjetër, që mundohen të zbutin pafuqinë e tyre me operacione klandestine dhe madje edhe me terrorizëm. Në raste të tilla, forcat qeveritare përdorin të gjitha burimet e tyre për t'i shtypur egërsisht, duke shkelur edhe ato të drejtën ndërkombëtare.

Forcat e rregullta janë lehtësisht të identifikueshme, të përqëndruara nën një strukturë të qartë komandimi, zotërojnë armë të fuqishme dhe mbështetje logjistike dhe në lëvizjen e tyre mbështeten me aviacion dhe automjete.[65]

---

61. Protokolli i I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës, 12 gusht 1949, neni 62.
62. Protokolli i I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës, 12 gusht 1949, neni 66.
63. Protokolli i I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës, 12 gusht 1949, nenet 61-67.
64. Protokolli i I-rë shtesë i konventave të Gjenevës parashikon se "Në rastet që nuk mbulohen nga ky protokoll, ose nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare, civilët dhe luftuesit mbeten nën mbrojtjen dhe autoritetin e personave të së drejtës ndërkombëtare që buron nga zakonet e krijuara, nga parimet e humanizmit dhe nga ajo që dikton ndërgjegjia publike".
65. KNKK, Manual model Mbi të drejtën e konfliktit të armatosurdhjetor 2003, libri B, kreu 23-25, f.20.

Forcat e parregullta parapëlqejnë të mos jenë lehtësisht të identifikueshme, kështu që shpërndahen në grupe, ose celula të vogla. Ato kanë një strukturë komandimi të paqëndrueshme dhe i lihet shumë hapësirë nismës lokale. Këto forca janë të armatosura lehtë, varen nga popullsia civile për mbështetjen logjistike të tyre, përdorin pak, në mos

asnjë automjet ushtarak dhe, për rrjedhojë dislokohen në këmbë dhe herë mbajnë e herë nuk mbajnë uniformë.[66]

Forca më e dobët, që pothuajse gjithmonë lufton në territorin e saj, nuk është e aftë të rrezikojë ndeshjen e drejtpërdrejtë me kundërshtarin, sepse kjo do të thotë pothuajse humbje e sigurtë. Kështu që ajo duhet të përdorë në mënyrë sa më të plotë njohjen e terrenit nga ana e saj dhe zbulimin e dislokimeve të kundërshtarit, e ndihmuar nga popullsia civile, për t'u fshehur prej tij dhe për të siguruar pozitë më të favorshme se ai. Guerrilasit priren ndaj armatimeve që janë lehtësisht të arritshme, me teknologji dhe kosto të ulët. Ato bazohen kryesisht në taktikat e njësisë së vogël që përfshin konceptin "godit dhe largohu". Kjo situatë i çon në luftë me intensitet të ulët. Rregullat e luftës guerrile janë të luftojnë pak dhe pastaj të tërhiqen.

Guerrilasit mund të ngrenë postblloqe për të penguar lëvizjen në rrugë të armikut. Ata mund të përdorin masa të paligjshme, siç janë sulmet ndaj zyrtarëve, ose bashkëpunëtorëve të kombësive të huaja dhe ndaj trupave paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara, duke aplikuar gjithashtu marrjen peng të tyre.[67]

Forcat e rregullta kundërshtare mund të mos jenë vendase në zonën ku zhvillohen luftimet. Nganjëherë ato përdorin masa të paligjshme, si torturën për të marrë informacion, ose kryejnë raprezalje për t'i penguar civilët që të ndihmojnë guerrilasit. Kjo mund t'i përkeqësojë gjërat. Për më tepër, meqë guerrilasit janë pak në numër dhe ka mundësi që të fshihen në mes të popullsisë civile, sulmet kundër tyre, veçanërisht me armë të rënda nga forcat e rregullta, mund të shkaktojnë vdekje, plagosje dhe dëmtime. Për këtë qëllim, sasia e forcave dhe lloji i armëve që përdoren ka rëndësi të madhe.

Popullsia civile luan një rol të rëndësishëm në luftën guerrile. Të dyja palët në konflikt kanë nevojë për mbështetje nga ana e popullsisë civile. Nga ana tjetër, vetë popullsia civile është në rrezik të dyfishtë. Duke patur mundësi që të ketë dijeni për lëvizjet, si të forcave të rregullta dhe atyre të parregullta, ajo mund të jetë nën presion për të dhënë informacion nga të dyja palët dhe mund të ndëshkohet nga të dyja palët.[68]

Rregullat e të drejtës së konfliktit të armatosur zbatohen në mënyrë të njëjtë edhe në luftën guerrile. Drejtuesit ushtarakë kanë obligimin e veçantë që të vendosin dhe të detyrojnë zbatimin e standardeve profesionale të sjelljes, duke përfshirë parime të qarta për trajtimin e popullsisë civile dhe **rregulla angazhimi**[69], për të vepruar ndaj guerrilasve.

---

66. KNKK,Manual model Mbi të drejtën e konfliktit të armatosur, dhjetor 2003, libri B, kreu 23-25, f.21.
67. Shih: KGJ I-IV, neni 3 i përbashkët; KGJ IV, neni 34, 147; OKB 1950; P I, neni 75; OKB 1979/2, neni12.
68. KNKK, Manual model Mbi të drejtën e konfliktit të armatosur, dhjetor 2003, libri B, kreu 23-25, f.22.
69. NATO – ROE, Rules of engagement, http://en.wikipedia.org/wiki/Rules_of_engagement,

3.1.3. c Rregullat e angazhimit

Në operacionet ushtarake, ose policore, rregullat e angazhimit vendosin se kur, ku dhe si duhet përdorur forca. Këto rregulla janë si të përgjithshme, ashtu dhe specifike. Rregullat

e angazhimit duhet të jenë në pajtim me ligjin ushtarak të pranuar përgjithësisht. Rregullat e angazhimit marrin dy forma:

a. aksione që një drejtues ushtarak mund të ndërmarrë pa u konsultuar me një autoritet më të lartë, përveçse kur është shprehimisht e ndaluar dhe

b. aksione që mund të ndërmerren vetëm nëse urdhërohen shprehimisht nga një autoritet më i lartë.

Rregullat e angazhimit janë jashtëzakonisht të rëndësishme:

1. Ato sigurojnë një standard të qëndrueshëm, të kuptueshëm dhe të vazhdueshëm mbi mënyrën e veprimit të forcave. Zakonisht ato përcaktohen në detaje përpara një angazhimi dhe mund të mbulojnë një numër skenaresh me rregulla të ndryshme për secilin.

2. Ato ndihmojnë në sikronizimin e komponenteve politiko-diplomatik dhe ushtarak të një strategjie, duke bërë të mundur që drejtuesit politik të kuptojnë, të parashikojnë dhe të përshtasin aksionet e një force më të mirë.

Rregullat e angazhimit janë udhëzues për komandantët, pasi tregojnë rrethanat dhe kufizimet nën të cilat forcat e armatosura mund të përdoren për të arritur objektiva ushtarake që mbështesin politikën. Rregullat e angazhimit janë një sërë parametrash që informojnë komandantët në operacionet e mbështetjes së paqes për kufizimet e nënkuptuara, ose lirinë e lejuar gjatë kohës që janë duke përmbushur detyrat e ngarkuara. Rregullat e angazhimit hartohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë se përdorimi i forcës është i kontrolluar në mënyrë të përshtatshme.

Rregullat e angazhimit përcaktohen për çdo operacion të veçantë, bazuar në objektivat e misionit. Ato hartohen nga ushtarakët, në përputhje me parimet e ligjit kombëtar e ndërkombëtar dhe që më pas miratohen nga institucionet politike, (parlamenti, ose qeveria).

Komandantët, në operacionet e mbështetjes së paqes, kanë të drejtë të kërkojnë ndryshime në rregullat e angazhimit, për shkak të ndryshimit të rrethanave ose modifikimit të këndvështrimit.

Rregullat e angazhimit janë mjete që përdoren nga civilët dhe komandantët ushtarakë për të rregulluar veprimet ushtarake.[70] Pa rregullat e angazhimit ka shanse që një ushtar si individ ose një njësi ushtarësh të shkelin të drejtat njerëzore të civilëve, robërve apo të të plagosurve.

70. KNKK, Manual model mbi të drejtënd e konfliktit të armatosur, dhjetor 2003, libri A, kreu 17-22, f.33.

Rregullat e angazhimit janë direktiva të nxjerra nga autoriteti kompetent, që qartësojnë rrethanat dhe kufizimet nën të cilat forcat fillojnë, apo vazhdojnë luftimin me forcat kundërshtare. Qëllimi i rregullave të angazhimit është të kontrollojë veprimet luftuese në kohë lufte në mënyrë që përveç të tjerave, të mos shkelen të drejtat e njeriut. Gjithashtu ato nxirren për të dhënë udhëzime të qarta për kohën e paqes në mënyrë që forcat e

armatosura të mos fillojnë pa shkak një konflikt të armatosur. Rregullat e angazhimit duhet të jenë në përputhje me të drejtën e brendshme dhe me të drejtën e konfliktit të armatosur.

Rregullat e angazhimit nuk kufizojnë të drejtën e natyrshme për vetëmbrojtje. Kur përdorimi i forcës nuk është bazuar në vetmbrojtje, atëherë e drejta për përdorimin e saj duhet të jetë e bazuar në rregullat e angazhimit. Në çdo rast dhe në çfarëdo rrethanë aplikohen parimet e proporcionalitetit dhe të nevojës ushtarake.

Të gjithë duhet të jenë të qartë se rregullat e angazhimit hartohen në mënyrë të përgjithshme dhe si pasojë nuk ofrojnë zgjidhje për çdo problem. Individi mbetet përgjegjës për veprimet e tij.

3.1.3. e Pushtimi ushtarak[71]

Kodifikimi i parë i rregullave ndërkombëtare që kanë të bëjnë me pushtimin ushtarak mund të gjendet në rregulloret e Hagës të viteve 1899 dhe 1907. Nga krimet e kryera në territoret e pushtuara të Evropës dhe Lindjes së Largme, gjatë Luftës së Dytë Botërore, janë nxjerrë shumë mësime që më pas u përfshinë në Konventën e IV të Gjenevës të vitit 1949, e cila kodifikoi një pjesë të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare moderne të zbatueshme për pushtimin ushtarak. Kjo e drejtë u fuqizua më tutje nga garancitë themelore, të vendosura në nenin 75 të Protokollit të Parë Shtesë të vitit 1977. Janë gjithashtu të zbatueshme në rast pushtimi territori edhe elementët e së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Neni 42 i Konventës së Hagës të vitit 1907 "Mbi rregullat e luftës në tokë", përcakton se "një territor quhet i pushtuar kur vendoset nën autoritetin e një ushtrie armike. Pushtimi shtrihet vetëm mbi atë pjesë të territorit ku një autoritet i tillë është vendosur dhe mund të ushtrohet efektivisht".[72]

Pushtimi ushtarak është masë ushtarake me karakter të përkohshëm. Pushtimi përfundon kur forcat pushtuese janë tërhequr, ose evakuohen nga territori. Mbas pushtimit efektiv të territorit, anëtarët e forcave të armatosura, të cilët nuk janë dorëzuar mund t'i rezistojnë pushtimit duke organizuar lëvizje rezistence, ose lëvizjeje për çlirim kombëtar. Nëse e bëjnë këtë, ata duhet ta dallojnë veten nga popullsia civile, ose në bazë të Protokollit I të Gjenevës, të mbajnë së paku armët e tyre haptaz gjatë sulmeve dhe lëvizjeve.[73]

---

71. A Roberts, "What is a Military Occupation?", 55 BYIL (1984), p. 249, at pp. 249-255, and 290-291; E. Benvenisti, The International Law of Occupation, Princeton, 1993, pp. 3-5, 100-105; G. von-Glahn, The Occupation of Enemy Territory, Minneapolis, 1957.
72. Regulation 42 of the Regulations annexed to the 1907 Hague Convention (IV), provides: "Territory is considered occupied when it is actually placed under the authority of the hostile army" (Regulations Respecting the Laës and Customs of War on Land annexed to the Hague Convention (IV) Respecting the Laws and Customs of War on Land, 18 October 1907, in Carnegie Endowment for International Peace, The Hague Conventions and Declarations of 1899 and 1907, New York, Oxford University Press, 1915, p.100.
73. Protokolli I-rë i Gjenevës, neni 43, 44.

Pjesëtarët e forcave të armatosura të vendit të pushtuar, të cilët vazhdojnë të luftojnë, janë luftues dhe duhen trajtuar si të tillë. Nëse kapen, ata gëzojnë statusin e robit të luftës dhe trajtimin e përcaktuar në Konventën III të Gjenevës të vitit 1949. Ata nuk mund të gjykohen për faktin e thjeshtë të marrjes pjesë në luftime, por nëse kryejnë shkelje të së drejtës së konfliktit të armatosur, ata mund të bëhen objekt i ndjekjes penale.

Civilët që marrin pjesë në luftime të tilla e humbasin mbrojtjen ndaj sulmeve, për kohën e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, por nuk humbasin statusin e tyre civil. Civilët që marrin pjesë drejtpërdrejt në luftime kundër fuqisë pushtuese mund të ndiqen penalisht.[74] Mbështetja indirekte për lëvizjen rezistente, siç janë dhënia e informacionit, ose furnizimi joushtarak, nuk përbën marrje pjesë të drejtpërdrejtë në luftime. Sidoqoftë, ata mund të jenë në kundërshtim me ligjet e sigurisë të fuqisë pushtuese. Në këtë rast, ata mund të gjykohen dhe dënohen, ose t'iu kufizohet liria e lëvizjes.

Legjislacioni kombëtar i vendit të pushtuar vazhdon të jetë në fuqi.[75] Autoritetet vendase, përfshirë edhe gjykatat duhet të jenë në gjendje të vazhdojnë veprimtarinë e tyre. Forcat e policisë vendore duhet të vazhdojnë të përdoren për të ruajtur rendin publik në territorin e pushtuar.

Megjithatë, forca pushtuese mund të nxjerrë ligjet e saj, në qoftë se e gjykon të domosdoshme për të siguruar ligjin dhe rendin në territorin e pushtuar, për të garantuar sigurinë e saj, ose për të mundësuar përmbushjen prej saj të detyrimeve që ajo ka sipas konventave të Gjenevës lidhur me mbrojtjen civile në kohë lufte.[76]

Ajo mundet gjithashtu të ngrejë gjykatat e saj, për të gjykuar shkeljet ndaj sigurimit të saj, por personat e mbrojtur mund të dënohen në këto lloj gjykatash vetëm mbi bazën e një procesi të rregullt gjyqësor.

Fuqia pushtuese është e detyruar të respektojë të drejtat themelore të popullsisë së territorit të pushtuar.[77] Banorët e zonave të pushtuara nuk mund të largohen duke u dërguar në pjesët e papushtuara të vendit të tyre, ose në territorin e fuqisë pushtuese. Gjithashtu, nuk mund të vendosen banorë të ardhur nga territoret e fuqisë pushtuese në territorin e pushtuar prej saj, masë kjo që parandalon aneksimin, ose kolonizimin e territorit të pushtuar.

Në të drejtat themelore të popullsisë[78] përfshihet edhe e drejta e pronës private, e cila nuk mund të preket, ose të shkatërrohet nga forcat pushtuese, përveçse në rastet e domosdoshmërisë ushtarake.[79]

---

74. Konventa III e Gjenevës për trajtimin e robërve të luftës, 12 gusht 1949, neni 4.
75. Shih: H. IV, Rr, neni 43.
76. Shih: KGJ IV, neni 64.
77. A. Roberts, "What is Military Occupation?", 55 BYIL (1984), p. 249.
78. Shih: KGJ IV, neni 47.
79. Shih: H. IV, Rr. neni 46, 55.

Burimet dhe shërbimet civile mund të rekuizohen në territoret e pushtuara, në përputhje me rregulla strikte. Ata duhet të rekuizohen vetëm nëse janë të nevojshme për forcat e armikut, ose shërbimet e nevojave publike, apo për të ushqyer, strehuar, veshur, transportuar, ose kujdesur për popullsinë e vendit të pushtuar. Ushqimet, artikujt e

përgjithshëm dhe furnizimet mjekësore nuk duhet të rekuizohen përveçse kur kërkesat për popullsinë civile janë kryer si duhet.[80]

Rekuizimi i burimeve dhe shërbimeve civile pa autorizimin e oficerit komandues është i ndaluar në të gjitha rrethanat. Sasia e gjërave dhe shtrirja e shërbimeve të rekuizuara për ushtrinë e pushtuesit duhet të jetë në proporcion me burimet territoriale, që do të thotë se territori i pushtuar nuk mund të zhvatet tërësisht. Artikujt duhet të paguhen në kesh sa më shumë që të jetë e mundur.[81]

E drejta e pushtimit është shumë e detajuar rreth konfiskimit të pasurisë qeveritare, ushtarake dhe pronës private.

Siç u theksua edhe më lart, prona private nuk mund të konfiskohet. Mund të bëhet një përjashtim vetëm për sendet që mund të përdoren për qëllime ushtarake, si dhe për linjat ajrore, hekurudhat, rrjetin e transporteve rrugore dhe telekomunikacionet. Mbasi ka mbaruar konflikti, pronat e konfiskuara të këtij tipi duhet të kthehen dhe nëse është e mundur të paguhet kompensim.

Pasuria e përdorur për qëllime fetare, për bamirësi, për arsim, ose art dhe shkenca duhet të trajtohet si një pasuri private, madje edhe kur ajo i përket shtetit. Është e ndaluar të konfiskosh, shkatërrosh, ose të dëmtosh me dëshirë një pasuri të tillë. E njëjta gjë zbatohet për monumentet historike dhe pasurinë kulturore.

Përsa i përket spitaleve civile, ata mund të konfiskohen vetëm nëse nevojat civile janë pothuajse të plotësuara. Ata mund të konfiskohen vetëm për trajtimin e duhur dhe të mënjëhershëm mjekësor të anëtarëve të plagosur dhe të sëmurë të forcave të armatosura të fuqisë pushtuese, ose robërve të luftës dhe vetëm për aq kohë sa ekziston kjo nevojë imediate.[82]

Pasuria ushtarake publike e territorit të pushtuar është në dispozicion absolut të fuqisë pushtuese, derisa të zgjatë pushtimi, por dëmtimi, ose shkatërrimi duhet të shkaktohet vetëm në rast se kjo gjë bëhet e domosdoshme nga operacionet ushtarake.[83]

Pasuria publike joushtarake e territorit të pushtuar, që përbëhet nga toka dhe ndërtesa, mundet gjithashtu të përdoret përkohësisht nga fuqia pushtuese, por duke evituar dëmtimin dhe shkatërrimin e saj në rastet kur ky dëmtim nuk është i domosdoshëm në përputhje me nevojat ushtarake.

---

80. Shih: KGJ IV, nenet 55, 57; PGJ I, neni 14.
81. Shih: H. IV, Rr. neni 48.
82. Konventa IV e Gjenevës, neni 56, 57. Protokolli i I-rë i Gjenevës, neni 14.
83. Shih: H IV R, nenet 23, 47; KGJ I, nenet 15, 50; KGJ II, nenet 18, 51; KGJ IV, nenet 16, 33, 53, 143; P I, nenet 51, 52, 57, 58.

Banorët e territorit të pushtuar nuk mund të vihen në punë të detyruar dhe as mund të detyrohen të shërbejnë në forcat e armatosura armike, kundër vendit të tyre.[84]

Forca pushtuese është e detyruar të sigurojë furnizime me ushqim dhe ilaçe, funksionimin e shërbimeve publike dhe ruajtjen e shëndetit të popullit. Kur nuk është në gjendje ta bëjë këtë, duhet të pranojë dërgimin e ndihmave nga jashtë.[85]
Fuqia pushtuese duhet gjithashtu të kujdeset për fëmijët, në bashkëpunim me autoritetet lokale dhe shkollat duhet të vazhdojnë të funksionojnë.

3.1.4 Lufta detare

U desh një katastrofë detare, gjatë luftës amerikano–spanjolle, në vitin 1898, për të përshtatur luftimet detare me parimet e Konventës të vitit 1864. Përsa i përket luftës detare, Komiteti i Gjenevës përgatiti një projekt konventë, e cila siguronte mbrojtjen, por jo përjashtimin nga kapja rob të anijeve spital. Kjo konventë s'u nënshkrua kurrë.

Zhvillime të mëtejshme, përsa i përket vendosjes së rregullave të zhvillimit të luftës detare, solli Konventa e Gjenevës e vitit 1906, duke u dhënë anijembyturve të njëjtën mbrojtje që më parë u ishte dhënë vetëm të plagosurve. Anijet spital ishin të paprekshme dhe këtë radhë ato u përjashtuan nga kapja rob, duke përfshirë personelin mjekësor dhe anëtarët e ekipazhit, përderisa marrja e tyre rob do t'i linte anijet të braktisura dhe pa shpresë.

Zhvillimi i metodave të luftës në det bëri të nevojshëm rishikimin e herëpashershëm të rregullave të zhvillimit të luftës detare, të cilat vazhduan deri në vitin 1977.

Në kohën tonë anijet spital janë ndihmë e një rëndësie të dorës së parë. Në betejat detare ato ndjekin flotën dhe mbledhin viktimat pas betejës. Në betejat tokësore ato sigurojnë mundësinë për evakuimin e të plagosurve dhe të sëmurëve.

Forcat detare janë të detyruara të zbatojnë të njëjtat rregulla themelore për zhvillimin e luftimit si ato që zbatohen për forcat tokësore dhe ato ajrore.[86]

Të plagosurit, të sëmurët dhe anijembyturit në det trajtohen në të njëjtën mënyrë si ata që janë jashtë luftimit në luftën tokësore. Edhe personeli mjekësor dhe fetar gëzon të njëjtin status si në luftën tokësore.

Në luftën detare duhet të bëhet dallimi ndërmjet objekteve civile dhe objekteve ushtarake. Sulmet duhet të kufizohen vetëm ndaj objekteve ushtarake. Sulmet pa dallim janë të ndaluara. Duhen marrë gjithashtu masa të përshtatshme gjatë sulmeve, në mënyrë që të parandalohen dëmtimet aksidentale.[87]

---

84. Shih: KGJ IV, neni 51.
85. Shih, KGJ IV, nenet 23, 59-61; PGJ I, neni 70.
86. L. Doswald-Beck (ed.), "The San Remo Manual on International Laë applicable to Armed Conflicts at Sea", 89 AJIL (1995). (para. 38-46).
87. Shih: L. Doswald-Beck (ed.), San Remo Manual on International Law applicable to Armed Conflicts at Sea, Cambridge, 1995, Text of the Manual to be published by International review of the Red Cross, 1995, November-December.

Në det, të gjitha tipet e anijeve mund të përdoren për të transportuar të plagosurit dhe të sëmurët si dhe për të shpëtuar anijembyturit, me kusht që anije të tilla të kenë shenja të qarta.[88]

Ekuipazhi i anijeve spital nuk mund të kapet gjatë kohës që shërben në këto anije. Ekipet e shpëtimit nuk duhet të kapen ndërkohë që marrin pjesë në operacione shpëtimi. Anijet spital, si dhe transportet e tjera mjekësore janë të mbrojtura nga sulmi. Rregullat për spitalet që lidhen me armët dhe municionet e marra nga të plagosurit, të sëmurët dhe mbi armatosjen për vetëmbrojtje për personelin mjekësor zbatohen në mënyrë të njëjtë edhe për anijet spital.[89]

Njëlloj si në luftën në tokë, në luftën detare pabesia është e ndaluar, ndërsa dredhitë e luftës lejohen.[90]

Në luftën detare, luftanijet dhe anijet ndihmëse ndalohen:

- të ndërmarrin një sulm kur nuk kanë ngritur flamurin e shtetit të tyre;
- të shtiren se kanë statusin e anijeve spitalore, mjeteve të shpëtimit bregdetar ose mjeteve mjekësore të transportit, anijeve me misione humanitare, anijeve me udhëtarë civilë, anijeve të OKB-së, anijeve që transportojnë robër lufte ose pasuri kulturore nën mbrojtje të veçantë.

Luftanijet e kundërshtarit janë objektiva ushtarakë dhe mund të sulmohen. Luftanija është një anije që i përket forcave të armatosura të një shteti, mban shenjat e jashtme dalluese të shtetit përkatës, është nën komandën e një oficeri të emëruar nga qeveria e atij vendi emri i të cilit figuron në listën e rregullt të shërbimit të oficerëve, përbëhet nga një ekuipazh që zbaton disiplinën e rregullt të forcave të armatosura.

Përjashtohen nga sulmi dhe zënia rob:[91]

- anijet spitalore;
- mjetet e lundrimit të përdorura për operacionet e shpëtimit në bregdet dhe si mjete mjekësore të transportit;
- anijet të cilave u është garantuar lundrim i sigurtë me marrëveshje midis palëve ndërluftuese;
- anijet e angazhuara në transportimin e pasurive kulturore që gëzojnë mbrojtje të posaçme;
- Anijet e ngarkuara me misione fetare, joushtarake, shkencore (anijet që mbledhin të dhëna shkencore që ka mundësi të kenë zbatim ushtarak nuk mbrohen);
- Anijet e vogla të peshkimit në bregdet dhe varkat e vogla që merren me tregëtinë bregdetare lokale, (por ato iu nënshtrohen rregulloreve të një komandanti detar të palës ndërluftuese që vepron në këtë zonë dhe inspektimit);
- Anijet e përshtatura vetëm për të reaguar ndaj incidenteve të ndotjes në mjedisin detar.

88. Konventa II e Gjenevës për përmirësimin e fatit të të plagosurve, të sëmurëve dhe të anijembyturve të forcave të armatosura në det, 12 gusht 1949, neni 38 & Protokolli i II-të Shtesë i konventave të Gjenevës, neni 22, 23.
89. KGJ II, nenet 22-34; PGJ I, nenet 22,23.
90. San Remo Manual on International Law applicable to Armed Conflicts at Sea, Cambridge, 1995, para. 110,111.
91. San Remo Manual on International Law applicable to Armed Conflicts at Sea, Cambridge, 1995, para. 47,136.

Anijet tregtare të kundërshtarit mund të sulmohen vetëm nëse janë objektiva ushtarake.[92]

Veprimtaritë e mëposhtme mund ta shndërrojnë një anije tregtare[93] të kundërshtarit në objektiv ushtarak.[94]

- Angazhimi në veprime ushtarake në emër të kundërshtarit.
- Veprimi si ndihmëse e forcave të armatosura të kundërshtarit, për transportimin e trupave ose rifurnizimin e luftanijeve.
- Përfshirja në sistemin e kundërshtarit për mbledhjen e informatave sekrete ose dhënien e ndihmës për të.
- Lundrimi nën një kolonë luftanijesh, ose avionësh ushtarakë të kundërshtarit.
- Mospranimi i një urdhri për të ndalur, ose bërja e qëndresës ndaj vizitës, kontrollit, ose zënies rob.
- Armatimi deri në atë masë sa mund t'i shkaktojë dëme një luftanije.
- Dhënia e ndihmës për aksion ushtarak.

3.1.4. a Bllokada detare

Bllokimi i brigjeve të armikut në mënyrë që të pengohet hyrja e mjeteve të armikut është një metodë e lejuar e luftës detare, në qoftë se plotëson këto kushte:

- është efektive, është deklaruar dhe i është komunikuar të gjitha palëve ndërluftuese dhe shteteve neutrale,
- nuk zbatohet me qëllimin për të shkaktuar vdekjen nga uria të popullsisë, ose mohimin e materialeve thelbësore për mbijetesën e popullsisë. Dëmtimi i popullsisë civile nuk pritet të jetë ekstrem në raport me avantazhet e drejtpërdrejta ushtarake që priten nga bllokada.

Deklarimi i bllokadës duhet të përfshijë përcaktimin e fillimit të saj, kohëzgjatjen, zonën e zbatimit dhe kohën limit që u lihet në dispozicion anijeve neutrale për t'u larguar nga gjatësia e bregdetit ku do të vendoset bllokada.[95]

Bllokada duhet të zbatohet në mënyrë të paanshme ndaj anijeve të të gjitha shteteve dhe duhet bërë në mënyrë të tillë që të lejojë hyrjen në portet dhe brigjet neutrale.[96]

Pala që vendos bllokadën duhet të lejojë kalimin e lirë të pajisjeve thelbësore mbështetëse për popullsinë civile ose paisjet mjekësore.

92. San Remo Manual on International Law applicable to Armed Conflicts at Sea, Cambridge, 1995, para. 59.
93. Pietro Verri, KNKK, " Fjalor i së Drejtës Ndërkombëtare të Konfliktit të Armatosur", Tiranë 2001.
94. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Manual Model Mbi të Drejtën e Konfliktit të Armatosur, dhjetor 2003, f.47.
95. San Remo Manual on International Law applicable to Armed Conflicts at Sea, Cambridge, 1995, para. 93-102.
96. Turkish General Staff, Guide to the Law of Armed Conflict of Armed Forces, Ankara, June 2001, p.78.

3.1.5 Lufta ajrore

Aeroplanët nuk janë përdorur si armë deri në Luftën e Parë Botërore.

Për herë të parë në historinë e luftërave, gjatë Luftës së Parë Botërore, mjetet ajrore të luftës u përdorën gjerësisht dhe shkaktuan pasoja të rënda, kryesisht në kurriz të popullsisë civile.

Megjithëse lufta ajrore shkaktoi pasoja të rënda gjatë Luftës së Parë Botërore, asnjë marrëveshje nuk u arrit pas luftës për të rregulluar luftën ajrore. Në periudhën mes dy luftërave, juristët dhe diplomatët kthyen vëmendjen e tyre nga kufizimi i efekteve shkatërrimtare të luftës ajrore. Arritja kryesore në drejtim të përpjekjeve për të kufizuar luftën ajrore ishte krijimi i një komisioni juristësh në vitet 1922 dhe 1923, të cilët hartuan një projektkod mbi luftën ajrore.[97]

Projektkodi përmbante rregulla mbi përdorimin e mjeteve ajrore kundër forcave ushtarake të armikut, kundër luftanijeve dhe objekteve të tij ushtarake, si dhe rregulla për mbrojtjen e popullsisë civile që ishte drejtpëdrejt e ekspozuar ndaj bombardimeve. U konsideruan të ligjshme në këtë projektkod vetëm bombardimet kundër objekteve ushtarake dhe u përfshi në të një listë me objektiva ushtarake, por ai nuk shkoi më tej se sa faza e projektit. Për pasojë gjatë Luftës së Dytë Botërore, të dyja palët bombarduan qytetet me një mospërfillje në rritje për sigurinë e civilëve dhe objekteve joushtarake.

Duke qenë se që nga viti 1940, lufta ajrore mori përmasa të tmerrshme dhe shkaktoi shkatërrime të papara, gjatë Luftës së Dytë Botërore, përpjekjet për të hartuar rregulla mbi zhvillimin e luftës ajrore vazhduan edhe pas Luftës së II-të Botërore. Konventa e Gjenevës e vitit 1949 "Mbi përmirësimin e fatit të të plagosurve dhe të sëmurëve në kohë lufte", në nenin 36 të saj përcakton mbrojtjen e avionëve shëndetsorë. Konventa IV e Gjenevës e vitit 1949 "Për mbrojtjen e personave civilë në kohë lufte", përmban gjithashtu rregulla të zbatueshme për transportin ajror, si dhe kërkon që spitalet civile të mos jenë objekt i sulmeve ajrore.

Përdorimi i avionëve mjekësor krijonte probleme shumë të mëdha, sepse një avion i shpejtësisë së lartë nuk mund të dallohej nëse ishte mjekësor me sy të lirë. Pra një avion mjekësor i cili është i mbrojtur nuk mund të dallohej nga një avion që është me mision ushtarak.[98]

Bazuar në përvojën e përdorimit të aviacionit mjekësor në konfliktet e ndryshme, që nga Lufta e Dytë Botërore, Konferenca e viteve 1974-1977 krijoi një sistem të plotë mbrojtjeje për transportin ajror të të plagosurve dhe të sëmurëve.[99]

Kërkesa për respektimin dhe mbrojtjen e avionëve mjekësorë u bazua në zhvillimin e teknikave të reja, që bënin të mundur identifikimin e menjëhershëm të avionit në fluturim.[100]

---

97. Arben Puto, "E Drejta Ndërkombëtare Publike", botuar nga "Marin Barleti", 2009, f 536.
98. Hans Peter Gasser, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, "E Drejta Ndërkombëtare Humanitare", dhjetor 2000, f.42.
99. Protokolli i I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës,2 gusht 1949, neni 25.
100. Protokolli i I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës, 12 gusht 1949, aneksi I, rregulloret mbi identifikimin.

Rregullat e së drejtës së konfliktit të armatosur, veçanërisht ato për armët, pabesinë, shfarosjen, përpjestueshmërinë, sulmet që nuk bëjnë dallim etj., zbatohen njëlloj edhe për luftën ajrore.[101]

Rregullat kryesore të zhvillimit të luftës ajrore mund të renditen si më poshtë:

Avionët ushtarakë të kundërshtarit, (që nuk janë avionë mjekësorë dhe avionë të cilëve u është garantuar lëvizje e sigurtë në bazë të një marrëveshje midis palëve), janë objektiva ushtarake dhe mund të sulmohen.

Aviacioni civil i kundërshtarit nuk mund të sulmohet, përveçse në rastet kur ai e humbet mbrojtjen dhe kthehet në objektiv ushtarak.[102]

Aviacioni civil i kundërshtarit konsiderohet objektiv ushtarak[103] nëse:

- angazhohet në akte lufte në emër të kundërshtarit;
- vepron si avion ndihmës për forcat e armatosura të kundërshtarit;
- fluturon nën mbrojtjen e luftanijeve, ose avionëve ushtarakë shoqërues të kundërshtarit;
- nuk i bindet një urdhri për t'u identifikuar, për t'u shmangur nga rrugëkalimi i tij, ose për t'u ulur për kontroll në një pistë të forcave ndërluftuese, që është e sigurtë për llojin e avionit të përfshirë dhe ku mund të ulesh në mënyrë të arsyeshme;
- si dhe kur jep ndihmë konkrete në veprimin ushtarak.

Në planifikimet që bëjnë drejtuesit ushtarakë duhet të mbajnë parasysh çdo informacion për rrugët e përcaktuara të avionëve civilë dhe të paralajmërojnë avionët civilë që hyjnë në zonat e veprimtarisë ushtarake të rrezikshme.[104]

Autoritetet e aviacionit civil duhet të parandalojnë fluturimin e avionëve civilë në zonat e rrezikshme për shkak të zhvillimit të operacioneve ushtarake. Pilotët e avionëve civilë duhet të veprojnë sipas udhëzimeve të dhëna nga palët ndërluftuese.

Avionët civilë të kundërshtarit, (përveç avionëve mjekësorë dhe avionëve të cilëve u është dhënë statusi i lëvizjes së sigurt me marrëveshje midis palëve) dhe mallrat në bord mund të zihen rob jashtë hapësirës ajrore asnjanëse.[105]

Avionët civilë para se të zihen rob, urdhërohen të ulen në një pistë ushtarake që është e sigurt dhe në këtë rast ekuipazhi dhe pasagjerët, konsiderohen si robër lufte.

Avionët e përjashtuar nga zënia rob e humbasin mbrojtjen e tyre në rast se kryejnë vepra të dëmshme për një palë ndërluftuese, pengojnë lëvizjet e ndërluftuesve, ose nuk i nënshtrohen urdhërave të dhëna nga palët ndërluftuese.[106]

---

101. Protokolli i I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës, 12 gusht 1949, neni 85.
102. San Remo Manual on International Law applicable to Armed Conflicts at Sea, Cambridge, 1995, para. 62.
103. San Remo Manual on International Law applicable to Armed Conflicts at Sea, Cambridge, 1995, para. 63.
104. San Remo Manual on International Law applicable to Armed Conflicts at Sea, Cambridge, 1995, para. 74,77.
105. San Remo Manual on International Law applicable to Armed Conflicts at Sea, Cambridge, 1995, para. 141.
106. Protokolli i I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës, 12 gusht 1949, që lidhet me mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura ndërkombëtare, 8 qershor 1977, neni 31.

3.2 KONFLIKTI I ARMATOSUR I BRENDSHËM

Neni 3 i përbashkët i të katër konventave të Gjenevës të vitit 1949, përfaqëson përpjekjen e parë për të vendosur rregulla që drejtonin konfliktet e armatosura jondërkombëtare. Ai është përshkruar si një" konventë në miniaturë", sepse përmban standardet minimale bazë të së drejtës ndërkombëtare humanitare, të zbatueshme në situatë konflikti.

Protokolli i II-të është përfundimi i përpjekjeve serioze për të përcaktuar më në detaje mbrojtjen e dhënë në konfliktet e armatosura jondërkombëtare. Qëllimi i tij është të zhvillojë dhe të plotësojë nenin 3 të përbashkët të Konventave të Gjenevës.

Kur shtetet miratuan nenin 3 të përbashkët dhe Protokollin e Dytë Shtesë të konventave të Gjenevës, ata nuk parashikuan dënim penal për shkeljet. [107] Kjo u bë ngaqë ngurronin të ndërhynin në punët e brendshme të shtetit. Sot gjërat kanë ndryshuar. Krimet e kryera në konfliktet e brendshme janë gjykuar tashmë nga gjykatat ndërkombëtare për Ruandën dhe ish- Jugosllavinë. Sipas statutit të Romës të vitit 1998 të Gjykatës Penale Ndërkombëtare, kjo Gjykatë ka të drejtë të regjistrojë shkelje të ligjit të zbatueshëm në konfliktet e armatosura jondërkombëtare.[108]

Në paragrafin II, të nenit I, të Protokollit të II-të shtesë të Konventave të Gjenevës, aktet e izoluara, individuale të dhunës, si dhe çrregullimet e brendshme janë përkufizuar si "tensione dhe çrregullime të brendshme" dhe janë përjashtuar nga koncepti i "konfliktit të armatosur jondërkombëtar". Në këtë kontekst duhet theksuar se gjatë tensioneve dhe çrregullimeve të brendshme, fakti që qeveria mund t'i drejtohet policisë dhe forcave të tjera të brendshme të sigurisë dhe madje edhe forcave ushtarake me qëllim që të rivendosë rendin, nuk e bën këtë situatë konflikt të armatosur të brendshëm.[109]

Ajo pjesë e të drejtës që merret me trajtimin e konfliktit të armatosur të brendshëm nuk i referohet konceptit të statusit të luftuesit.[110] Arsyeja është që legjislacioni vendas e quan rebelimin një krim dhe në këtë bazë askush nuk ka të drejtë të "marrë pjesë në luftime". Por, pjesëmarrja në luftime është tipar kryesor i statusit të luftuesit. Forcat e armatosura të ligjshme të një shteti mund sigurisht të luftojnë rebelimin sipas legjislacionit vendas, por ata të cilët i kundërshtojnë (forcat rebele), për arsye të përmendura më sipër, nuk kanë të drejtë të marrin armët.

---

107. Për ndjekjen penale të krimeve të luftës, konventat e Gjenevës krijojnë përgjegjësi penale vetëm për shkeljet e kryera në konfliktet e armatosura ndërkombëtare. Sidoqoftë, zhvillimet e kohëve të fundit kanë treguar mundësinë e ndjekjes penale të krimeve të luftës në konfliktet e brendshme, pa patur nevojë të gjendet njëfarë lidhje me një luftë ndërkombëtare, mbështetur në statutet e veçanta dhe të drejtën ndërkombëtare zakonore. Së pari, Statuti i Gjykatës së Ruandës shprehimisht i jep juridiksion gjykatës mbi shkeljet serioze të nenit të përbashkët 3 dhe protokollit të II-të shtesë, së dyti, Gjykata e Jugosllavisë ka interpretuar Statutin e saj të lejojë për juridiksion mbi shkeljet serioze të nenit të përbashkët 3 dhe shkeljeve të tjera serioze të ligjeve dhe zakoneve të luftës në konfliktet e brendshme, dhe së treti, Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Penale në mënyrë specifike parashikon për përgjegjësi mbi shumë akte të kryera në konfliktet e brendshme.
108. Statute of the International Criminal Court, done at Rome, on 17 July 1998.
109. Protokolli II Shtesë i konventave të Gjenevës, 1949, neni 1/2.
110. Për faktin se qeveritë kanë çdo të drejtë të shtypin rebelimet që bëhen kundër tyre, në konfliktin e armatosur të brendshëm nuk ekziston asnjë status ose privilegj luftuesi. Një rebel mund të ndiqet penalisht vetëm për faktin se është rebel, madje edhe nëse i ka zbatuar me përpikmëri rregullat e të drejtës ndërkombëtare humanitare. Kështu p.sh., qeveria e Afganistanit ka çdo të drejtë të burgosë një ushtar taleban edhe nëse ai ushtar nuk ka kryer asnjë krim lufte.

Mosgëzimi i statusit të luftuesit për rebelët në një konflikt të armatosur të brendshëm, ndodh gjithashtu sepse në një konflikt të tillë të armatosur vazhdon të zbatohet e drejta e

brendshme e shtetit ku ndodh konflikti. P.sh. një pjesëtar i grupeve të armatosura disidente, i cili vret një pjesëtar të forcave të sigurisë, ose të një fraksioni kundërshtar, ose një civil tjetër kryen krim sipas të drejtës penale të brendshme dhe është subjekt i ndjekjes penale. Kur kapen pjesëtarët e forcave të armatosura disidente nuk e gëzojnë statusin e luftuesit.

Pjesëtarët e forcave të armatosura disidente nuk e gëzojnë statusin e robit të luftës. Në të njëjtën mënyrë, në qoftë se një pjesëtar i forcave qeveritare kapet nga rebelët, as ai nuk është rob lufte. Në qoftë se rebelët kontrollojnë një zonë gjysëm autonome, duke patur sistemin e tyre ligjor dhe gjykatat, ata munden padyshim të gjykojnë personat e kapur për çdo veprim të tyre. Përndryshe, në se rebelët nuk kanë kontroll mbi territorin dhe janë të detyruar të zhvillojnë aktivitetet e tyre në mënyrë të fshehtë, meqë ata nuk kanë ndërtesa të përshtatshme për të ndaluar personat, ata nuk mund të kenë alternativë tjetër, përveçse t'i çarmatosin, t'i marrin në pyetje dhe t'i lirojnë të ndaluarit.

Në konfliktin e armatosur jondërkombëtar personat që nuk marrin pjesë në veprime ushtarake nuk mund të sulmohen. Ata duhet të mbrohen dhe të respektohen.[111] Kjo përfshin jo vetëm civilët, të cilët nuk marrin pjesë në veprime, por gjithashtu edhe personat që janë dorëzuar, ose që janë jashtë luftimit për shkak të sëmundjes, plagëve, ndalimit, ose arësye të tjera.[112] Ndalohet që të bëhet dallim për shkak të racës, ngjyrës, besimit, seksit, pasurisë, ose ndonjë kriter tjetër të ngjashëm.

Të ndaluarit në konfliktin e armatosur të brendshëm nuk gëzojnë statusin e robit të luftës. Trajtimi i të ndaluarve rregullohet nga ligji i brendshëm i vendit të ndalimit dhe në parimet humanitare bazë.

Të ndaluarit në konfliktin e armatosur të brendshëm duhen trajtuar në çdo rrethanë në mënyrë njerëzore, pa asnjë dallim.[113] Përsa i përket këtyre personave ndalohet: dhuna ndaj jetës, shëndetit dhe mirëqënies fizike; ndëshkimet kolektive; marrja e pengjeve; aktet e terrorizmit; shkeljet e dinjitetit personal, në veçanti poshtërimi dhe trajtimi poshtërues dhe degradues; përdhunimi, sterilizimi, ose shtatzania e detyruar; skllavërimi; dhënia e dënimeve dhe ekzekutimet e tyre pa asnjë gjykim të përshtatshëm nga një gjykatë e rregullt. Askush nuk mund të dënohet për një shkelje, përveçse mbi bazë të përgjegjësisë penale personale. Dënimi me vdekje nuk mund të jepet ndaj një të akuzuari i cili nuk ka mbushur moshën 18 vjeç në kohën e kryerjes së krimit dhe nuk mund të zbatohet ndaj grave shtatzëna, ose me fëmijë në gji.[114]

111. Përsa i përket marrjes së jetës neni i përbashkët 3 parashikon që: Personat që nuk marrin pjesë drejtpërsëdrejti në luftime, bashkë me pjesëtarët e forcave të armatosura që kanë dorëzuar armët si dhe ata që janë nxjerrë jashtë luftimit për shkak sëmundjeje, plagosjeje, zënie rob, ose për çdo shkak tjetër qoftë, në të gjitha rrethanat duhet të trajtohen njerëzisht pa asnjë dallim race, ngjyre, feja ose besimi, seksi, lindjeje ose pasurie, ose çdo kriteri tjetër analog. Për këtë qëllim kundrejt personave të lartpërmendur janë dhe mbeten të ndaluara në çdo kohë e në çdo vend;
    a. dhunimet kundër jetës ose tërësisë trupore, sidomos vrasja në të gjitha format, gjymtimet, trajtimet mizore, torturat dhe ndëshkimet;
    b. dënimet e dhëna dhe ekzekutimet e bëra pa një gjykim paraprak të dhënë prej një gjykate të formuar rregullisht dhe të veshur me ato garanci gjyqësore që janë njohur si të domosdoshme prej gjithë popujve të qytetëruar.
112. Protokolli II Shtesë i konventave të Gjenevës, 1949, neni 4/1.
113. Protokolli i II-të Shtesë i Konventave të Gjenevës, 12 gusht 1949, që lidhet me mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura jondërkombëtare, 8 qershor 1977, neni 4.
114. Po aty, neni 6.

Pjesëtarët e forcave të armatosura kundështare që kapen, duhen trajtuar në mënyrë njerëzore. Ata nuk mund të ndëshkohen, përveçse pas një dënimi të dhënë nga një gjykim i drejtë.

Ndaj civilëve dhe ushtarakëve të ndaluar[115], për arsye që lidhen me konfliktin e armatosur zbatohen rregullat e mëposhtme:

- Të plagosurit dhe të sëmurët duhet të trajtohen.
- Të ndaluarit duhet të lejohen të marrin dërgesa individuale ose kolektive.
- Të ndaluarit duhet të sigurohen me ujë dhe ushqim, mjedise të përshtatshme për shëndetin dhe higjenën, dhe strehë nga moti dhe rreziqet e konfliktit të armatosur.
- Ata duhet të lejohen të praktikojnë besimin e tyre dhe të kenë asistencën e personelit fetar.
- Përveçse kur familjet akomodohen së bashku, gratë duhet të qëndrojnë në mjedise të ndara nga burrat dhe të mbikqyren nga gra.
- Vendet e ndalimit duhet të jenë larg nga zona e luftimit dhe në se i ekspozohen rrezikut, të ndaluarit duhet të evakuohen në zona më të sigurta dhe evakuimi të jetë i sigurt.
- Të ndaluarve duhet t'iu sigurohet ekzaminim dhe trajtim mjekësor, në përputhje me gjendjen e tyre shëndetësore.
- Të ndaluarit, kur lirohen, duhet të sigurohen, që nënkupton se nëse i dorëzohen fraksionit të gabuar kjo mund të shkaktojë vdekjen e tyre.

Kur personat e burgosur dhe të internuar lirohen, autoritetet që i kanë mbajtur janë të detyruar të marrin hapat e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e tyre, pasi mund të rrezikohen rëndë nëse lihen mes atyre që janë besnikë ndaj autoriteteve.

Në përgjithësi, ekziston një heshtje mbi armët në konfliktet e armatosura të brendshme. Kjo për arsye se shtetet kanë refuzuar sistematikisht të pranojnë propozime të cilat i shtrijnë kufizimet mbi përdorimin e armëve në konfliktet e armatosura jondërkombëtare. Sidoqoftë, kohët e fundit, ka pasur një ndryshim të vogël në qëndrimin e tyre.

Protokolli mbi ndalimin ose kufizimin e përdorimit të minave, minave surprizë dhe paisjeve të tjera, i përmirësuar më 3 maj 1996, (Protokolli II),[116] zbatohet gjithashtu në konfliktin e armatosur jondërkombëtar. Ai ndalon në veçanti minat antipersonel, të cilat janë të pazbulueshme dhe të hedhura nga largësia dhe minat antipersonel të hedhura nga largësia pa mekanizma vetshkatërrimi.

Traktati i Otavës së minave tokësore i 1997-ës ndalon minat anti-njeri në konfliktet e armatosura, si ndërkombëtare ashtu dhe jondërkombëtare.

---

115. Protokolli i II-të Shtesë i Konventave të Gjenevës, 12 gusht 1949, që lidhet me mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura jondërkombëtare, 8 qershor 1977, neni 5.
116. Protokolli mbi ndalimin, ose kufizimin e përdorimit të minave, minave-surpizë dhe mjeteve të tjera shpërthyese, (Protokolli II i Konventës së vitit 1980, i ndryshuar në datë 3 maj 1996).

Në konfliktin e armatosur jondërkombëtar zbatohen rregulla të veçanta për mbrojtjen e fëmijëve.[117]

- Fëmijët duhet të arsimohen, përfshirë edukimin moral dhe fetar, në përputhje me dëshirat e prindërve ose kujdestarëve të tyre.
- Duhen ndërmarrë të gjithë hapat e duhur me qëllim që të ribashkohen familjet që kanë qenë përkohësisht të ndara. Këtu mund të kujtojmë përpjekjet e bëra nga organizatat humanitare, siç janë Save the Children dhe Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për refugjatët dhe Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq gjatë krizës në Ruandë dhe Kosovë.[118]
- Fëmijët nën 15 vjeç nuk duhet të rekrutohen në forcat e armatosura dhe as lejohen të marrin pjesë në veprimet armiqësore, sidoqoftë në se ata veprojnë ndryshe, nuk e humbasin mbrojtjen e veçantë.[119]
- Në se është e nevojshme fëmijët duhet të evakuohen përkohësisht nga zonat e luftës në zona më të sigurta brenda vendit, në qoftë se është e mundur, me pëlqimin e prindërve ose kujdestarëve, por ata duhet të jenë të shoqëruar nga persona përgjegjës për sigurinë dhe mirëqënien e tyre.

Shkaktimi i vdekjes nga uria, si metodë lufte është i ndaluar. Eshtë e ndaluar të sulmohen, shkatërrohen, të zhvendosen ose të bëhen të padobishme objektet e domosdoshme për mbijetesën e popullsisë civile.[120] Zhvendosja e popullsisë civile nuk duhet urdhëruar për arsye që lidhen me konfliktin e armatosur, veçse për sigurinë e tyre, ose për arsye ushtarake objektive dhe kjo të vazhdojë vetëm për kohën e nevojshme. Në rastet kur zhvendosja është e domosdoshme, duhen marrë të gjitha masat që popullsia civile të ketë kushte të kënaqshme strehimi, higjene, shëndeti, sigurie dhe ushqimi.

Megjithëse mund të jetë e nevojshme të evakuohen përkohësisht civilët nga zonat e rrezikut, nga zonat e rrethuara, është e ndaluar zhvendosja e tyre për arsye bazuar në racën, ngjyrën, besimin, seksin, pasurinë, ose ndonjë kriter tjetër të ngjashëm.[121]

Në konfliktet e armatosura të kohëve të fundit është zbatuar praktika e "spastrimit etnik", ku njerëzit e një lloj origjine racore, ose besimi fetar janë vrarë ose përzënë nga shtëpitë e tyre, të cilat janë shkatërruar. Këto praktika shkelin parimet bazë të së drejtës së konfliktit të armatosur mbi mosdiskriminimin dhe trajtimin njerëzor të atyre që janë jashtë luftimit, si dhe parimet bazë të ligjit mbi të drejtat e njeriut, mbi jodiskriminimin në lirinë e mendimit, ndërgjegjies dhe besimit.

Përsa i përket pasurisë kulturore e cila përfshin vendet e adhurimit, institucionet e besimit, arsimimit, bamirësisë, monumentet e artit, shkencës, monumentet historike, si dhe veprat e artit e të shkencës është e ndaluar:

---

117. Manual model mbi të drejtën e konfliktit të armatosur, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, dhjetor 2003, libri A, kreu 17-22, f.40.
118. E drejta e konfliktit të armatosur, Dosje mësimore për instruktorët, KNKK qershor 2002,"Konfliktet e armatosura jondërkombëtare", f. 5.
119. Protokolli i II-të Shtesë i konventave të Gjenevës, 12 gusht 1949, që lidhet me mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura jondërkombëtare, 8 qershor 1977, neni 4/3.
120. Protokolli i II-të Shtesë i konventave të Gjenevës, 12 gusht 1949, që lidhet me mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura jondërkombëtare, 8 qershor 1977, neni 14.
121. Po aty, neni17.

- Të përdoret pasuria kulturore për qëllime që mund të shkaktojnë ekspozimin ndaj dëmtimit ose shkatërrimit në konflikt të armatosur.
- Të vjedhësh, plaçkitësh, shpërdorosh, konfiskosh, ose të dëmtosh me qëllim pasurinë kulturore.[122]

Përkufizimi i objekteve civile nuk gjendet në traktatet që trajtojnë konfliktin e armatosur jondërkombëtar, por parimi i nevojës ushtarake kërkon që sulmet të kufizohen mbi objektivat ushtarake dhe kështu përjashton sulmet ndaj banesave civile, dyqaneve, shkollave, vendeve të çlodhjes, transportit, spitaleve dhe njësive të tjera mjekësore kur ato nuk përdoren për qëllime ushtarake.[123]

Popullsia civile, si dhe individët civilë nuk mund të jenë objekt i sulmeve. Civilët e gëzojnë këtë imunitet derisa ata nuk marrin pjesë në veprime armiqësore.[124] Sulmet që kanë për qëllim terrorizimin e civilëve janë të ndaluara.

Sulmet që nuk bëjnë dallim janë të ndaluara. Në këto sulme përfshihen:

- Sulmet që nuk drejtohen kundër një objekti ushtarak të veçantë, si bombardimi ajror.
- Ata të cilët përdorin një forcë shumë të madhe të papërshtatshme për t'u drejtuar ndaj një objekti ushtarak të veçantë.
- Ata që përdorin metoda luftimi efekti i të cilave nuk mund të kufizohet siç kërkohet në të drejtën e konfliktit të armatosur.

Raprezaljet janë të ndaluara rreptësisht në konfliktet e armatosura ndërkombëtare, por koncepti nuk zbatohet në konfliktet e armatosura jondërkombëtare si i tillë. Raprezaljet kurrë nuk mund të përdoren për të justifikuar një sjellje të jashtëligjshme në konfliktet e armatosura jondërkombëtare.[125]

Të gjithë të plagosurit, të sëmurët dhe anijembyturit që kanë marrë apo jo pjesë në konflikt të armatosur, duhet të respektohen dhe të mbrohen. Në të gjitha rrethanat ata duhet të trajtohen në mënyrë njerëzore dhe duhet të gëzojnë kujdesin mjekësor që kërkojnë kushtet e tyre pa asnjë vonesë. Nuk duhet të bëhen dallime ndërmjet tyre.

Palët në konflikt janë të detyruara kurdo që rrethanat e lejojnë dhe veçanërisht pas një sulmi:

---

122. Protokolli i II-të Shtesë i konventave të Gjenevës, 12 gusht 1949, që lidhet me mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura jondërkombëtare, 8 qershor 1977, neni 16; Konventa mbi mbrojtjen e pasurisë kulturore në rast konflikti të armatosur, Hagë, 14 maj 1954, neni 19.
123. Turkish General Staff Ankara, Partnership for Peace Training Center Command, Guide to the Law of Armed Conflict of Armed Forces, Ankara, Turkey, July 2001.
124. Protokolli i II-të Shtesë i konventave të Gjenevës, 12 gusht 1949, që lidhet me mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura jondërkombëtare, 8 qershor 1977, neni 13.
125. KNKK, E drejta e konfliktit të armatosur, (konfliktet e armatosura jondërkombëtare), Tiranë, qershor 2002, f. 19-10.

- Të marrin të gjitha masat e mundshme pa vonesë për të kërkuar dhe grumbulluar të plagosurit, të vdekurit dhe anijembyturit.
- T'i mbrojnë ata nga plaçkitja dhe keqtrajtimi.
- T'iu sigurojnë kujdesin e përshtatshëm.
- Të kërkojnë të vdekurit, të parandalojnë që ata të grabiten dhe t'i sistemojnë në mënyrë të denjë.

Personeli mjekësor, njësitë dhe transportet mjekësore, në konfliktin e brendshëm gëzojnë mbrojtje të ngjashme me atë të konfliktit të armatosur ndërkombëtar.[126] Ata duhet të tregojnë emblemën mbrojtëse të kryqit të kuq ose gjysmëhënës së kuqe, mbi një sfond të bardhë.

Mbrojtja dhe shpërndarja e ndihmave materiale duhet të sigurohet nga marrëveshje të arritura ndërmjet shtetit përkatës dhe organizatave të ndihmës humanitare për njerëzit në nevojë.

Megjithëse është e nevojshme marrja e pëlqimit nga vendi ku po zhvillohet konflikti i armatosur i brendshëm, palët në konflikt duhet të rregullojnë aktivitetet e organizatave të ndihmës, siç janë aktivitetet e ndihmës së popullsisë civile, së bashku me organizatat kombëtare të Kryqit të Kuq ose Gjysmëhënës së Kuqe.[127]

Personeli i mbrojtjes civile, ndërtesat dhe pajisjet nuk janë përmendur në rregullat që drejtojnë konfliktin e armatosur jondërkombëtar. Sidoqoftë, si organizata civile, ata duhet të mbrohen dhe grupet opozitare duhet t'i lejojnë ata të vazhdojnë punën e tyre pa vonesë. Në mënyrë të ngjashme, personeli ushtarak i emëruar vetëm për detyrat e mbrojtjes civile duhet të respektohet dhe të mbrohet prej grupeve kundërshtare. Përsa kohë janë në këtë detyrë, ata duhet të veshin shenjën dalluese ndërkombëtare për mbrojtjen civile.

3.3 OPERACIONET E SIGURISË SË BRENDSHME

Roli i forcave të armatosura të një shteti është të mbrojë territoret kombëtare kundër kërcënimeve të jashtme ose të merret me situatat e konflikteve të armatosura jondërkombëtare. Sidoqoftë, në disa raste, forcat e armatosura mund të kërkohen që të ndihmojnë autoritetet civile, të merren me nivele më të ulëta të tensioneve të brendshme, dhunës ose trazirave, p.sh, të ndihmojnë policinë civile në ruajtjen dhe vendosjen e ligjit dhe rregullit. Forcat e armatosura përfshihen shpeshherë në operacione të tilla, në rrethanat e tyre kombëtare ose në kuadrin e operacioneve të mbështetjes së paqes të Kombeve të Bashkuara.

Kur forcat e armatosura përfshihen në këto lloj operacionesh, roli parësor i tyre nuk është zhvillimi i luftimeve kundër një kundërshtari të organizuar e të armatosur por dhënia e ndihmës në rivendosjen dhe ruajtjen e rendit dhe të qetësisë.

126. Protokolli i II-të Shtesë i konventave të Gjenevës, 12 gusht 1949, që lidhet me mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura jondërkombëtare, 8 qershor 1977, neni 9.
127. Po aty, neni 18.

Termi "trazira të brendshme "përfshin situatat në të cilat nuk ka konflikt të armatosur jondërkombëtar, por në vend ekziston një konfrontim i brendshëm që karakterizohet nga një vazhdimësi e sigurtë dhe që përfshin aktet e dhunës.[128] Këto mund të marrin forma të ndryshme, nga akte spontane të revoltave deri në beteja midis grupeve pak a shumë të organizuara dhe autoriteteve në fuqi. Në këto situata, që nuk degjenerojnë patjetër në një luftë të hapur, autoritetet në fuqi thërrasin një forcë policie të gjerë ose madje forca të armatosura për të rivendosur rregullin e brendshëm. Numri i madh i viktimave që shkaktohen nga këto konfrontime ka bërë të nevojshëm zbatimin e disa rregullave humanitare.

Termi "tensione të brendshme" i referohet situatave të një tensioni të rëndë, (politik, fetar, social, ekonomik etj), ose pasojave të një konflikti të armatosur ose të trazirave të brendshme. Këto situata mund të paraqesin karakteristikat e mëposhtme:[129]

- Arreste në masë;
- një numër të madh personash të ndaluar për arsye sigurie;
- keqtrajtim të mundshëm, torturë ose kushte psikologjike të ndalimit që mund të jenë të dëmshme për integritetin fizik, mendor ose moral të të ndaluarve;
- të ndaluar që mbahen të izoluar për një kohë të gjatë;
- masa shtypëse ndaj të afërmve të personave që u është hequr liria;
- pezullim i garancive juridike themelore nga shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme;
- një rritje në numrin e akteve të dhunës, (siç është rrëmbimi dhe marrja peng), të cilat rrezikojnë personat e pambrojtur ose përhapin terror midis popullsisë civile.

E drejta ndërkombëtare humanitare nuk zbatohet në situatat e tensioneve dhe trazirave të brendshme, ose të quajtura ndryshe operacione të sigurisë së brendshme. Në këto situata zbatohet ligji vendas, e drejta ndërkombëtare zakonore dhe e drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Qëllimi parësor i operacioneve të sigurisë së brendshme (për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë), është rivendosja dhe ruajtja e paqes civile.

Në përpjekje për realizimin e këtij qëllimi, forcave të armatosura mund t'iu kërkohet të marrin përsipër funksione që normalisht ushtrohen nga punonjësit e zbatimit të ligjit. Këto përfshijnë:[130]

a. Mbrojtjen e personave dhe të pasurisë.
b. Kapjen e shkelësve të ligjit.
c. Sigurimin e respektimit të ligjit.
d. Parandalimin e përkeqësimit të dhunës.

128. KNKK, E drejta e konfliktit të armatosur, Dosje mësimore për instruktorët, " Operacionet e sigurisë së brendshme", pjesa A, qershor 2002," f. 6.
129. KNKK, E drejta e konfliktit të armatosur, Dosje mësimore për instruktorët, " Operacionet e sigurisë së brendshme", pjesa A, qershor 2002," f. 6-11.
130. KNKK, Manual model mbi të drejtën e konfliktit të armatosur, libri A, kreu 17-22, dhjetor 2003, f.50.

Për pasojë dhe ndryshe nga misionet luftarake, forcat e armatosura mund të përdoren për të shpërndarë demonstratat dhe grumbullimet e paligjshme, për shtypjen e trazirave, vendosjen e shtetrrethimeve dhe kryerjen e arrestimeve. Në këto situata është e qartë se një pjesëtar i forcave të armatosura nuk mund të veprojë si të ishte ndërluftues i angazhuar në luftime në fushën e betejës.

E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut vendos një sërë parimesh, që duhet të zbatohen nga forcat pjesëmarrëse në operacionet për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë.

Këto përfshijnë:

a) Askujt nuk duhet t'i privohet jeta në mënyrë arbitrare.[131]
b) Askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës, trajtimit çnjerëzor ose poshtërues.
c) Askush nuk duhet të mbahet në skllavëri ose robëri.
d) Askush nuk duhet t'i nënshtrohet arrestimit ose paraburgimit arbitrar.
e) Të gjithë personat, të cilëve u është privuar liria duhet të trajtohen në mënyrë njerëzore dhe me dinjitet.
f) Çdo njeri ka të drejtën e njohjes si person para ligjit dhe të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe të fesë.
g) Çdo njeri ka të drejtën e grumbullimit paqësor dhe lirinë e organizimit dhe bashkimit me të tjerët në shoqata.

Në operacionet për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë, forca duhet të përdoret vetëm për qëllime të përligjura të zbatimit të ligjit, si për shembull:[132]

- në vetëmbrojtje;
- për të mbrojtur të tjerët nga lëndimet;
- për të parandaluar një krim;
- për të kryer një arrestim.

Forca duhet të përdoret vetëm në rast se nuk japin rezultat mjete të tjera siç janë: bisedimet, ndërmjetësimi, ose bindja gojore.

Cilado qoftë situata, të gjitha format e trajtimit të egër, çnjerëzor dhe poshtërues, përfshirë torturën, gjymtimin, përdhunimin, sulmin e pahijshëm dhe poshtërimin janë të ndaluara.[133]

Në operacionet për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë, përdorimi i forcës nuk zë të njëjtin pozicion si në operacionin ushtarak.[134] Në operacionet ushtarake forca është mjeti kryesor për vendosjen e pushtetit mbi kundërshtarin ose për neutralizimin e objektivave ushtarake. Ndërsa në rastin e zbatimit të ligjit forca është një mjet përjashtimor dhe mund të përdoret vetëm pasi të kenë dështuar mjetet e tjera më pak të dhunshme.

131. Konventa ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike,1966, neni 6/1, neni 7.
132. KNKK, Manual model mbi të drejtën e konfliktit të armatosur, libri A, kreu 17-22, dhjetor 2003, f.51.
133. Parimet bazë për përdorimin e forcës dhe të armëve të zjarrit. Miratuar nga kongresi i tetë i Kombeve të Bashkuara mbi parandalimin e krimit dhe trajtimit të kriminelëve, Havanë, Kubë, 27 gusht-7 shtator 1990, parimi 6.
134. KNKK, Manual model "Mbi të drejtën e konfliktit të armatosur", Libri A, kreu 17 - 22, f.35.

Një aspekt i përdorimit të forcës në operacionet e sigurisë së brendshme ka të bëjë me:

3.3.1 Grumbullimet e paligjshme[135]

Deklarata universale e të drejtave të njeriut përcakton që kushdo ka të drejtë për grumbullimet dhe shoqërimet paqësore. Këto të drejta përsëriten në konventën ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike.[136]

Ashtu si në aspektet e tjera të sigurisë së brendshme, forcat e armatosura duhet të përdoren vetëm si burim i fundit për t'iu përgjigjur grumbullimeve të paligjshme. Në fillim duhet të provohen mjetet e padhunshme, siç janë bisedimet, ndërmjetësimi ose bindja gojore. Sigurisht, vetëm shfaqja e ushtrisë mund të krijojë frikë ose panik në turmë. Policia ose njësitë paraushtarake duhet të dërgohen të parat. Ushtria mund të dërgohet nëse situata rëndohet, ose të bllokojnë pozicionet larg nga qendra e trazirave dhe për të parandaluar grumbullimin e turmave të mëtejshme.

Për shpërndarjen e grumbullimeve që janë të paligjshme, por jo të dhunshme, përdorimi i forcës duhet të mënjanohet ose, kur kjo nuk është praktike, të kufizohet në shtrirjen e nevojshme minimale.

Në shpërndarjen e grumbullimeve të dhunshme, armët e zjarrit mund të përdoren vetëm kur mjete më pak të rrezikshme nuk janë praktike[137] dhe vetëm në minimumin e nevojshëm.

Pjesëtarëve të forcave të armatosura nuk iu kërkohet zakonisht të merren me grumbullimet e paligjshme, pra ata nuk janë të stërvitur ose të pajisur për këtë rol. Kjo përfaqëson një dimension të ri për ta. Nëse shteti kërkon që forcat e tij të armatosura të veprojnë në këtë mënyrë, në rast urgjence, ai duhet të sigurohet që ata kanë autoritet të ligjshëm dhe mjetet për ta bërë një gjë të tillë. Forcat e armatosura duhet të sigurojnë që janë të stërvitura për aktivitete të tilla. Nëse ata nuk janë të stërvitura si duhet në atë që pritet, ose në teknikat e përfshira në shpërndarjen e grumbullimeve të paligjshme, ato mund të bëjnë gabime që mund të kenë pasoja shkatërrimtare. Ato mund të mbireagojnë dhe të veprojnë shpejt në përdorimin e forcës vdekjeprurëse.

Meqenëse është plotësisht e qartë që armët e zjarrit duhet të përdoren si një burim i fundit, forcat e armatosura duhet të kenë në dispozicion një grup pajisjesh që i bëjnë ata të sigurojnë përgjigjen e shkallëzuar.

Stërvitja për kontrollin e rebelimeve është e një rëndësie të jashtëzakonshme. Një forcë e stërvitur mirë dhe e disiplinuar, nga vetë prania dhe sjellja profesionale, normalisht do të kenë sukses në shpërndarjen ose së paku në qetësimin e turmave, pa dashur të përdorë burimet e përdorimit të forcës, duke lënë mënjanë forcën vdekjeprurëse.[138]

---

135. KNKK, E drejta e konfliktit të armatosur, (operacionet e sigurisë së brendshme), libri B, Tiranë, qershor 2002, f. 2-12.

136. Deklarata Universale e të drejtave të njeriut – Nju Jork, 10 dhjetor 1948, neni 20; Konventa Ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike, 1966, neni 21, 22.

137. Parimet bazë për përdorimin e Forcës dhe të armëve të zjarrit. Miratuar nga kongresi i tetë i Kombeve të Bashkuara, mbi parandalimin e krimit dhe trajtimit të kriminelëve, Havanë, Kubë, 27 gusht-7 shtator 1990, parimi 14.

138. KNKK, E drejta e konfliktit të armatosur, Dosje mësimore për instruktorët, ”Operacionet e sigurisë së brendshme”, pjesa B, qershor 2002, f. 5.

Këto operacione janë një peshë e konsiderueshme mbi drejtuesit ushtarakë, sepse një vendim, ose aksion i gabuar nga një komandant i një niveli të ulët, mund të ketë pasojat që tërheqin vëmendjen politike dhe madje ndërkombëtare.[139]

Trajnimi i vartësve në zhvillimin e operacioneve të sigurisë së brendshme është përgjegjësi e çdo komandanti brenda sferës së tij të përgjegjësisë.

Bindja ndaj një superiori nuk është mbrojtje nëse një pjesëtar i forcave të armatosura e dinte që urdhëri për përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit, që çon në vdekje ose plagosje serioze, ishte i jashtëligjshëm, dhe ai kishte një mundësi të arsyeshme për të refuzuar zbatimin e tij.[140]
Edhe personat, që në hierarkinë e komandës ndodhen më lart se ata që e përdorin forcën në mënyrë të paligjshme, janë përgjegjës para ligjit në rast se kishin dijeni, ose duhej të kishin patur dijeni që vartësit e tyre po përdornin ose kishin përdorur në mënyrë të paligjshme forcën ose armët e zjarrit dhe nuk morën të gjitha masat në kompetencë të tyre për ta parandaluar ose raportuar këtë përdorim.[141]

139. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Manual model mbi të drejtën e konfliktit të armatosur, dhjetor 2003.
140. Parimet bazë për përdorimin e Forcës dhe të armëve të zjarrit. Miratuar nga kongresi i tetë i Kombeve të Bashkuara, mbi parandalimin e krimit dhe trajtimit të kriminelëve, Havanë, Kubë, 27 gusht-7 shtator 1990, parimi 26.

141. Po aty, parimi 24.

4. E DREJTA NDËRKOMBËTARE HUMANITARE NË VEPRIMTARINË E ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA

4.1 LIDHJA E KOMBEVE DHE ORGANIZATA E KOMBEVE TE BASHKUARA

Një prej hapave më të rëndësishëm që ka ndërmarrë njerëzimi, në drejtim të humanizimit të jetës ndërkombëtare ka qënë krijimi i Lidhjes së Kombeve. Iniciativat e para paqësore, që do të çonin në krijimin e Lidhjes së Kombeve, mund të gjenden në Angli dhe SHBA.

Pas Luftës së Parë Botërore, filloi të lindte ideja e krijimit të një organizate ndërkombëtare, e cila do të bashkonte shtete paqedashëse dhe do të sillte paqe dhe mirëkuptim midis kombeve.[1]
Statuti i Lidhjes së Kombeve u miratua në prill të vitit 1919. Qëllimi kryesor i Lidhjes së Kombeve ishte ruajtja e paqes, sigurimi ndërkombëtar, si dhe zhvillimi i bashkëpunimit ndërkombëtar. Sipas nenit 10 të Statutit të Lidhjes së Kombeve, "anëtarët e saj angazhohen të respektojnë dhe të ruajnë, kundër çdo sulmi nga jashtë, tërësinë territoriale dhe pavarësinë politike të të gjithë anëtarëve të Lidhjes". Përmbajtja e këtij neni garanton "vetëmbrojtje kolektive" ndaj një agresioni. Megjithatë, gjatë viteve të ekzistencës së Lidhjes së Kombeve "vetëmbrojtja kolektive" nuk gjeti zbatim në praktikë.

Pas Luftës së Parë Botërore, në një kohë me organizatën ndërkombëtare të asaj kohe - Lidhjen e Kombeve, u krijua Dhoma Permanente e Drejtësisë Ndërkombëtare, si Gjykata e Parë Ndërkombëtare. Dhoma Permanente e Drejtësisë Ndërkombëtare nuk ishte e njëjtë me Dhomën Permanente të Arbitrazhit. Arbitrazh ndërkombëtar do të thotë rregullim i mosmarrëveshjes midis shteteve me anë të një vendimi që jepet nga një ose më shumë arbitra, ose nga një organ i zgjedhur mes palëve.[2]

Arbitrazhi nuk është një mënyrë e detyrueshme për zgjidhjen e konflikteve ndërshtetërore. Megjithatë, kur ai pranohet si mënyrë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, vendimi i tij është i detyrueshëm për palët. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për Gjykatën Ndërkombëtare.

Historikisht arbitrazhi ka qenë krijuar si një organ ad-hoc, pra për t'i dhënë zgjidhje një rasti konkret.

Në Konferencën e Parë të Hagës, të vitit 1899, u vendos krijimi i Dhomës Permanente të Arbitrazhit, ndërsa në Konferencën e Dytë të Hagës, të vitit 1907, u përcaktua se "arbitrazhi ndërkombëtar ka për objekt rregullimin e grindjeve midis shteteve nga gjyqtarë të zgjedhur prej tyre dhe mbi bazën e respektimit të normave të së drejtës". Pra si Gjykata Ndërkombëtare, ashtu edhe arbitrazhi para saj, përbëjnë përpjekje të shteteve për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve.

---

1. Turkish General Staff Ankara, Partnership for Peace Training Center Command, Guide to the Law of Armed Conflict of Armed Forces, Ankara, Turkey, July 2001. p.45

2. Arben PUTO, E drejta Ndërkombëtare Publike, Tiranë 2002, f.438.

Lidhja e Kombeve, megjithëse vlerësohet si një eksperiencë pozitive, dështoi. Pas shpërndarjes së Lidhjes së Kombeve, në prill të vitit 1946, rradhën e kish Organizata e Kombeve të Bashkuara.

OKB, e cila u krijua si rezultat i shkatërrimit të forcave të fashizmit, gjatë Luftës së Dytë Botërore, në San Francisko, me delegatë të frymëzuar nga planet ushtarake të SHBA, filloi aktivitetin me më shumë potencial se paraardhësja e saj e dështuar, Lidhja e Kombeve, pikërisht sepse u angazhuan Shtetet e Bashkuara të Amerikës.[3]

Organizata e Kombeve të Bashkuara përcaktoi si qëllim kryesor të saj "ruajtjen e paqes dhe të sigurimit ndërkombëtar". Për të realizuar këtë qëllim,[4] neni i parë i Kartës së Kombeve të Bashkuara parashikon marrjen e masave kolektive, të efektshme për të parandaluar dhe larguar rreziqet që kërcënojnë paqen, ndalimin e çdo akti agresioni, si dhe zgjidhjen me mjete paqësore të çdo mosmarrëveshje ose situate që mund të çojë në prishjen e paqes.

Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara është organi i vetëm që merret me përcaktimin e rasteve të kërcënimit, të shkeljes së paqes, apo të akteve të agresionit dhe vendos se çfarë masash duhen marrë për të ruajtur paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Këshilli i Sigurimit është i vetmi organ i Kombeve të Bashkuara, vendimet e të cilit për çështjet e paqes e të sigurimit ndërkombëtar, janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët e Organizatës.

Sipas dispozitave të Kreut V të Kartës, Këshilli i Sigurimit ka për detyrë të hetojë për çdo grindje apo situatë që mund të shkaktojë konflikte ose mosmarrëveshje ndërkombëtare; të kërkojë nga palët e interesuara që të zbatojnë masat e propozuara prej tij[5], për ndalimin e keqësimit të mëtejshëm të situatës; të përcaktojë se çfarë masash, veç përdorimit të forcave të armatosura, duhen zbatuar për realizimin e vendimeve të tij.[6]

Këshilli i Sigurimit ka të drejtë dhe detyrë që të ndërmarrë veprime konkrete për ruajtjen e paqes dhe sigurimit ndërkombëtar, duke vënë në përdorim edhe forcat ushtarake, kur ai e çmon të nevojshme këtë masë.

Përdorimi i forcës autorizohet nga Karta e Kombeve të Bashkuara në situata të parashikuara në kapitullin VII. Në pajtim me nenin 39, Këshilli i Sigurimit duhet të vendosë për rastet e kërcënimit të paqes, ose aktet e agresionit dhe të bëjë rekomandime, si dhe të vendosë se çfarë masash duhet të ndërmerren në pajtim me nenet 41 dhe 42.

---

3. Eric Walberg, Peacemaker or Puppet?, *22* August 2007, www.oocities.org/walberg2002/Egypt/articles.html
4. UN Charter, articles 1, para. 3. See also article 55, subpara. c.
5. Professor Morrison defines "enforcement actions" or "enforcement measures» in the context of Chapter VII of the Charter as: "any action which would itself be a violation of international law, if taken without either some special "justification" or without contemporaneous consent or acquiescence of the target State. The concept of "justification" is borrowed from the criminal law. It connotes some special authority, such as a Security Council authorization under Article 41, or 42 of the Charter".

6. Arben PUTO, E drejta Ndërkombëtare Publike, Tiranë 2002, f.489.

Neni 42 pohon: "Në qoftëse mjetet paqësore nuk kanë sukses në sigurimin e zbatimit të vendimeve të Këshillit të Sigurimit, ai mund të ndërmarrë veprime nga ajri, deti, ose toka si të jenë të nevojshme për të ruajtur dhe rindërtuar paqen dhe sigurinë ndërkombëtare". Kështu Këshilli i Sigurimit mund të autorizojë përdorimin e forcës. Për të bërë këtë ai duhet të pajtohet me parimet kushtetuese të Kombeve të Bashkuara, me objektivat dhe qëllimet e Kartës.

67 vjet më parë, kur u hartua Karta e Kombeve të Bashkuara, përgjegjësia kryesore për ruajtjen e paqes iu ngarkua Këshillit të Sigurimit, gjë që nuk ishte bërë në Lidhjen e Kombeve, në të cilën Këshilli dhe Asambleja kishin pak a shumë po ato kompetenca. Organizata e Kombeve të Bashkuara përcaktoi qartë dhe bëri dallim midis kompetencave të Këshillit të Sigurimit dhe të Asamblesë së Përgjithshme.

Fuqitë kryesore, që dolën fitimtare nga Lufta e Dytë Botërore, morën nga një vend permanent në Këshillin e Sigurimit dhe bashkë me të edhe të drejtën e vetos, që do të thotë se asnjë vendim që ka të bëjë me ruajtjen e paqes nuk mund të merret, po qe se vë veton, qoftë edhe njëra prej këtyre fuqive. Kështu shumë vendime të Këshillit të Sigurimit nuk u zbatuan pikërisht për shkak të vetos së ushtruar nga anëtarët e përhershëm. Kjo ndodhi sidomos pas fillimit të Luftës së Ftohtë, gjë që bllokoi çdo ndërhyrje të Këshillit të Sigurimit në shumë raste.

Kombet e Bashkuara u bllokuan gjatë gjithë periudhës së Luftës së Ftohtë, aq sa edhe konflikte të tilla si ai i Vietnamit nuk u futën ndonjëherë në rendin e ditës të Këshillit të Sigurimit.

Neni 24/1 i Kartës së Kombeve të Bashkuara pohon se kompetenca primare për mbrojtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare i përket Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Megjithatë Këshilli i Sigurimit nuk është i vetmi organ që merret me kërcënimet e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Mund të argumentohet që në rast se Këshilli i Sigurimit dështon në veprimet e tij, kompetencat i kalojnë shteteve anëtare, por neni 24/1 i Kartës së Kombeve të Bashkuara gjithashtu përmend qëllimin e rolit që i është dhënë Këshillit, i cili është sigurimi i efektivitetit të Kombeve të Bashkuara. Kështu që përpara se shtetet të mund të ndërmarrin veprime, organe të tjera të Kombeve të Bashkuara duhet të thërriten, sipas nenit 24/1 të Kartës, për të ndërmarrë veprime me qëllim mbrojtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara mund ta marrë këtë rol sipas nenit 12/1 i Kartës, pasi Këshilli ka dështuar në efektivitetin e tij për të vepruar. Megjithëse ky rol është sekondar krahasuar me atë të Këshillit të Sigurimit. Asambleja ka mundësi të veprojë sipas nenit 24/1, nenit 1/1, nenit 12/1, në rastet kur Këshilli dështon në përmbushjen e detyrës së tij për mbrojtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

Në të drejtën e sotme ndërkombëtare përdorimi i forcës në një situatë konkrete duhet të bazohet në një shkak dhe motiv ligjor të legjitimuar.[7] Përpjekje u bënë ndërmjet dy luftërave botërore, në traktate të ndryshme për t'i bindur shtetet që të mos përdornin luftën, përveçse për vetëmbrojtje. Më i rëndësishëm ishte Pakti i Parisit, i vitit 1928, i cili u nënshkrua nga të gjitha fuqitë kryesore.

7. Turkish General Staff, Guide to the law of Armed Conflict of Armed Forces, Ankara, June 2001, f.23.

Pas Luftës së Dytë Botërore, ndalimi i luftës, si mjet i politikës së jashtme të shteteve, u kthye në normë ligjore nga Kombet e Bashkuara.

Karta e Kombeve të Bashkuara, si dokumenti bazë i organizatës,[8] në të cilën janë përcaktuar qëllimet, parimet, struktura dhe mënyra e funksionimit të OKB – së, në nenin 2/4 të saj ndalon përdorimin e forcës kundër integritetit territorial dhe pavarësisë politike të ndonjë shteti, si dhe kërcënimin për përdorim force në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Dy përjashtimet kryesore nga ky ndalim i përgjithshëm janë:

- e drejta e një shteti për të përdorur forcë në vetëmbrojtje, ose vetëmbrojte kolektive, sipas nenit 51 të Kartës[9] dhe
- e drejta e Këshillit të Sigurimit, sipas nenit 42, për të autorizuar përdorimin e forcës, "që të ruhet dhe rivendoset paqja dhe siguria ndërkombëtare".[10]

Çfarë do kuptojmë me kërcënim për përdorim force?

Një kërcënim për përdorim force është p.sh. paralajmërimi i një akti dhune, siç është një ultimatum me anë të të cilit një shtet lajmëron se do t'i drejtohet masave ushtarake, në qoftë se kërkesa të caktuara nuk pranohen. Forca nënkupton forcë të armatosur dhe jo ndonjë formë tjetër të presionit ekonomik, ose politik. Neni 2/4 ndalon përdorimin e forcës së armatosur, por ai nuk ndalon presionin politik, (p.sh. refuzimin për të ratifikuar një traktat, ose ashpërsinë e marrëdhënieve diplomatike), ose presionin ekonomik, (p.sh. një bojkot tregtar ose bllokimin e një llogarie bankare).

Çështja e kërcënimit për përdorimin e forcës[11] gjithashtu u rishfaq në Deklaratën mbi Parimet e të Drejtës Ndërkombëtare, në vitin 1970, duke krijuar një mosmarrëveshje ndërmjet shteteve kryesore perëndimore, të cilat argumentuan se ndalohej vetëm forca e armatosur dhe Shteteve të Europës Lindore, si dhe pjesës më të madhe të shteteve në zhvillim, të cilat pretenduan se "të gjitha format e presionit, përfshirë ato të karakterit ekonomik ose politik, që kanë efekt kërcënues për integritetin territorial dhe pavarësinë politike të ndonjë shteti" ishin të ndaluara.

Përveç parimit të mospërdorimit të forcës, Karta e Kombeve të Bashkuara vendos një parim tjetër themelor,[12] atë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me mjete paqësore. Ajo pohon: "Anëtarët e organizatës duhet t'i zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre ndërkombëtare me mjete paqësore, në mënyrë që të mos vihen në rrezik paqja, sigurimi ndërkombëtar dhe drejtësia."

8. Karta e Kombeve të Bashkuara, 26 qershor 1945, neni 2/4.
9. Po aty, neni 51
10. Po aty, neni 42
11. Declaration on Principles of International Law Concerning Friendly Relations and Co-operation among States in accordance with the Charter of the United Nations, G.A. res. 2625, Annex, 25 UN GAOR, Supp. (No. 28), U.N. Doc. A/5217 at 121 (1970).

12. Karta e Kombeve të Bashkuara, 26 qershor 1945, neni 2/3.

Kjo nënkupton që përdorimi i forcës justifikohet vetëm aty ku nuk ka më mjete paqësore të vlefshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, sepse shtetet janë të detyruara, sipas të drejtës ndërkombëtare t'i zgjidhin mosmarrëveshjet me mjete paqësore.[13]

Neni 37 i Kartës i kërkon shteteve, që kur të kenë shteruar mjetet paqësore të zgjidhjes së një mosmarrëveshje, t'ia referojnë çështjen Këshillit të Sigurimit.[14]

Neni 2/7 përcakton parimin e mosndërhyrjes në çështjet e brendshme. Ai parashikon që: "Asnjë dispozitë e kësaj Karte nuk i autorizon Kombet e Bashkuara të ndërhyjnë në çështje që i përkasin kryesisht juridiksionit kombëtar të një shteti, as nuk i detyron anëtarët të shtrojnë çështje të kësaj natyre, për t'i zgjidhur sipas një procedure të parashikuar në këtë Kartë. Megjithatë ky parim nuk cënon aspak zbatimin e masave shtrënguese, të parashikuara në kreun VII."

Efekti i neneve 2/3 dhe 2/4 është, që përdorimi i forcës, mund të justifikohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht nga Karta dhe vetëm në situata ku pajtohet me qëllimet e Kombeve të Bashkuara.

4.1.1 E drejta për vetëmbrojtje individuale ose kolektive

Neni 51 i Kartës së Kombeve të Bashkuara i rezervon shteteve të drejtën e vetëmbrojtjes. Kjo e drejtë plotëson parashikimet e nenit 42 si një përjashtim i ndalimit të përdorimit të forcës. Një shtet nuk ka nevojë për autorizim të Këshillit të Sigurimit me qëllim që të mbrohet duke përdorur forcën.

Sipas nenit 51: "Derisa Këshilli i Sigurimit të marrë masat e nevojshme për ruajtjen e paqes dhe të sigurimit ndërkombëtar, asnjë dispozitë e kësaj Karte nuk cënon të drejtën e natyrshme të vetëmbrojtjes së ligjshme, individuale ose kolektive, në rast se një anëtar i Kombeve të Bashkuara bëhet objekt i një sulmi të armatosur".

Forca mund të përdoret në vetëmbrojtje vetëm kundër një shteti ligjërisht përgjegjës për sulmin e armatosur.[15] Për më tepër, çdo përdorim i forcës për vetëmbrojtje duhet të respektojë parimet e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit. Domosdoshmëria e kufizon përdorimin e forcës ushtarake në arritjen e qëllimit të ligjshëm. Proporcionaliteti kërkon që fatkeqësitë e mundshme civile duhet të vihen në balancë. Në qoftë se humbja e jetës së të pafajshmëve ose shkatërrimi i pasurisë civile është jashtë proporcionit të rëndësisë së objektivit, sulmi duhet të braktiset.

13. Karta e Kombeve të Bashkuara, 26 qershor 1945, neni 2/3.
14. Po aty, neni 37
15. Security Council resolution 307 (1971) of 21 December 1971 (Bangladesh); Security Council resolution 864 (1993) of 15 September 1995 (Angola); Security Council resolution 639 (1991) 0f 20 May 1991 in conjunction with UN Doc, S/21541 of 16 August 1990 (El Salvador); Security Council resolution 912 (1994) of 21 April 1994 (Rwanda); Security Council resolution 918 (1994) of 1 July 1994 (Rwanda); Security Council resolution 764 (1992) of 13 July 1992 (Yugoslavia); Security Council resolution 771 (1992) of 13 August 1992 (Yugoslavia); Security Council resolution 780 (992) of 6 October 1992 (Yugoslavia); Security Council resolution 941 (1994) of 23 September 1994 (Tribunal).

Ashtu si përdorimin individual të forcës, neni 51 parashikon të drejtën e vetëmbrojtjes kolektive. Në rastin e vetëmbrojtjes individuale, ushtrimi i të drejtës i përket shtetit, i cili ka qenë viktimë e një sulmi të armatosur. Mbështetja në vetëmbrojtjen kolektive nuk e heq nevojën për vetëmbrojtje individuale. Nuk ekziston asnjë rregull që lejon ushtrimin e

vetëmbrojtjes kolektive, në mungesë të një kërkese nga shteti që e konsideron veten si viktimë të një sulmi të armatosur.

Kështu hartuesit e Kartës së OKB–së, përmes kapitullit VII, kishin si qëllim të krijonin një sistem të centralizuar të sigurisë kolektive. Përgjegjësia kryesore për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare iu besua Këshillit të Sigurimit. Ky organ vendos ekzistencën e ndonjë kërcënimi të paqes, shkelje të paqes, ose akti agresioni dhe bën rekomandimet, ose vendos se çfarë masash të detyrueshme duhet të ndërmerren në pajtim me nenin 41, (që nuk përfshin përdorimin e forcës së armatosur) dhe neni 42 që parashikon fillimin e aksionit ushtarak. Shtetet, sidoqoftë kërkojnë një rezolutë të Këshillit të Sigurimit me qëllim që të përdorin forcën për vetëmbrojtje kolektive kundër një shteti tjetër. Vetëm në qoftëse rezolutat autorizojnë përdorimin e forcës mund të ekzistojë një bazë ligjore për aksion ushtarak.[16]
Raste të tilla të autorizimit të përdorimit të forcës nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara kanë qenë: Rezoluta 678 (14 mars 2005), e Këshillit të Sigurimit që autorizonte përdorimin e "të gjitha mjeteve të nevojshme" për çlirimin e Kuvajtit; Rezoluta 794 (3 dhjetor 1992), që autorizonte "të gjitha mjetet e nevojshme" për të krijuar sa më shpejt që të ishte e mundur një mjedis sigurie për operacione humanitare në Somali; Rezoluta 929 (22 qershor 1994), që autorizonte Francën të përdorte "të gjitha mjetet e nevojshme për të ruajtur civilët në Ruanda;[17] Rezoluta 770 (15 maj 2004), që autorizonte shtetet të ndërmerrnin "të gjitha masat e nevojshme" për të lehtësuar asistencën humanitare dhe të detyronin zonën jo fluturuese në Bosnjë.

Sipas nenit 52/1: "Asnjë dispozitë e kësaj Karte nuk përjashton ekzistencën e marrëveshjeve, ose organizatave rajonale për rregullimin e çështjeve që kanë të bëjnë me ruajtjen e paqes dhe të sigurimit ndërkombëtar dhe që parashikojnë një veprim me karakter rajonal, me kusht që këto marrëveshje, ose organizata dhe veprimtaria e tyre të jenë në përputhje me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara."

Karta e Kombeve të Bashkuara në kapitullin VII parashikon, që Këshilli i Sigurimit mund të përdorë organizatat rajonale për aksione force nën autoritetin e tij.

Pra Karta e Kombeve të Bashkuara nuk përjashton mundësinë e veprimit të organizatave dhe institucioneve rajonale,[18] të cilat mund t'i shërbejnë ruajtjes së paqes dhe sigurimit ndërkombëtar. Në aktet kushtetuese të organizatave rajonale si p.sh. Uniteti Afrikan, Lidhja Arabe, NATO, zgjidhja paqësore e mosmarrëveshjes përcaktohet si një ndër qëllimet e tyre kryesore. Gjithsesi vihet në dukje se nuk mund të ndërmerret asnjë aksion force pa marrë autorizimin e Këshillit të Sigurimit. Nga kjo del se detyrimet në bazë të Kartës së Kombeve të Bashkuara janë një kategori juridike superiore në krahasim me detyrimet që kanë shtetet në bazë të traktateve rajonale.

16. F. J. Leon Diaz, Humanitarian Intervention issues2002, p.23.
17. Security Council resolution 872 (1993) of 5 October 1993.
18. Karta e Kombeve të Bashkuara, 26 qershor 1945. neni 53.
Neni 53/1 shton: Këshilli i Sigurimit përdor, sa herë del e nevojshme, marrëveshjet ose organizatat rajonale për zbatimin e masave shtrënguese që merr ai vetë.

Kështu Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara mund të ushtrojë të drejtën e tij për ndërhyrje humanitare në dy mënyra. Ai mund të ndërhyjë me Helmetat Blu,[19] duke

mbajtur komandën operacionale, ose mund të autorizojë një palë të tretë të ndërhyjë. Meqënëse Këshilli i Sigurimit varet nga shtetet anëtare për kontribute në trupa, ndërhyrjet e Këshillit nuk janë një detyrë e thjeshtë. Sidoqoftë, ka ndryshim në se Këshilli ushtron të drejtën drejtpërdrejt ose ia kalon palëve të tjera. Autorizimi i një pale të tretë për të ndërhyrë të krijon përshtypjen se janë në fakt dy mbajtës të mundshëm të së drejtës për të ndërhyrë: Këshilli i Sigurimit dhe pala e tretë e autorizuar.[20]
Megjithatë sot flitet për aftësitë e dobëta të organizatave rajonale. Praktikisht, pjesa më e madhe e rajoneve nuk kanë aftësitë e mjaftueshme dhe organizata sigurimi të afta për të zbatuar një operacion paqeruajtje dhe operacion zbatimi të paqes.

Sot për sot vetëm NATO, EU kanë aftësi për të detyruar zbatimin e të drejtave njerëzore jashtë kuadrit të Kombeve të Bashkuara.[21]

4.1.2 Vetëmbrojtja paraprake

Një çështje tjetër që meriton vëmendje është ajo e vetëmbrojtjes paraprake. A e lejon e drejta ndërkombëtare vetëmbrojtjen kundër një sulmi të mundshëm, por që nuk ka filluar ende?

Neni 51 i Kartës nuk shprehet rreth faktit nëse "vetëmbrojtja" përfshin përdorimin parandalues të forcës, në plotësim të përdorimit të forcës në përgjigje të një sulmi. Përgjithësisht mund të thuhet se një sulm duhet të jetë gati ose të ketë filluar në mënyrë që të zbatohet e drejta e vetëmbrojtjes së njëanshme. Çdo përgjigje paraprake ndaj një sulmi të mundshëm kërkon aprovimin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Neni 51 është interpretuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në disa raste dhe nga interpretimi del që aty ku një shtet kërcënohet për përdorim force, por pa u përballur me një sulm të armatosur, ai duhet t'iu drejtohet masave që nuk arrijnë në vetëmbrojtje të armatosur, ose duhet të kërkojë autorizimin e Këshillit të Sigurimit për të bërë më shumë.

E drejta e vetëmbrojtjes është e kufizuar në të drejtën e përdorimit të forcës për të zbrapsur një sulm në progres, për të parandaluar sulmet e ardhshme të armikut që pasojnë një sulm të filluar, ose për t'iu ndërruar drejtimin pasojave të një sulmi të armatosur, siç është dhënia fund e një pushtimi.[22] Shteti që vepron në vetëmbrojtje duhet të kërkojë shkatërrimin e një force sulmuese të armikut në qoftëse është e nevojshme dhe proporcionale me mbrojtjen e tij.

19. Në praktikën e tij Këshilli i Sigurimit ka kërkuar që Sekretari i Përgjithshëm dhe shtetet përkatëse t'i raportojnë rregullisht Këshillit për zbatimin e rezolutave dhe arritjen e objektivave të kërkuara. Kjo bëhet e qartë në rezolutën e Këshillit të Sigurimit me të cilën autorizohet operacioni i krijimit të një mjedisi të sigurt në Somali (UNITAF, SC res. 794 (1992), operacioni i krijimit të sigurisë dhe mbrojtjes së personave të zhvendosur, refugjatëve dhe civilëve të rrezikuar në Ruanda ("Operation Turquoise", SC res. 929, 19940, dhe operacioni për rindërtimin e demokracisë në Haiti, (SC res. 940,1994).
20. Hannes Peltonen, Right And Responsibility, What Kind Of Right Is The Right Of Humanitarian, Intervention? EUI Working Papers, SPS No. 2006/03, cadmus.eui.eu/bitstream/handle/1814/4357/SPS%202006.03.pdf?.
21. Stefan Kirchner, The Human Rights Dimensions of International Peace and Security: Humanitarian Intervention after 9/11, 15 Oct 2003, www.ssrn.com/abstract=445124
22. F. J. Leon Diaz, Humanitarian Intervention issues, 2002, www.javier-leon-diaz.com/docs/humanIntervIssues.htm

Praktika e shteteve është e dyshimtë, megjithatë ajo tenton të sygjerojë që përdorimi paraprak i forcës nuk konsiderohet përgjithësisht i ligjshëm. P.sh. kur Izraeli bombardoi reaktorin nuklear që po ndërtohej në Osirik, Irak në vitin 1981, Këshilli i Sigurimit në unanimitet e dënoi bombardimin, pa marrë parasysh kërcënimin që armët nukleare në duart e Sadam Huseinit mund të shkaktonin për Izraelin. Këshilli I Sigurimit e gjeti "sulmin ushtarak nga Izraeli në kundërshtim të hapur me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe normat ndërkombëtare të sjelljes."[23]

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë dha një opinion këshillues për posedimin e armëve nukleare nga një shtet duke thënë se nuk është e ligjshme sipas të drejtës ndërkombëtare zakonore. Posedimi pa një kërcënim për përdorim nuk përbën një sulm të armatosur të paligjshëm thuhet në opinionin këshillues mbi Ligjshmërinë e Kërcënimit ose Përdorimit të Armëve Nukleare në vitin 1996.

Pra, e drejta ndërkombëtare ndalon vetëmbrojtjen paraprake. Me fjalë të tjera, një shtet nuk mund të ndërmarrë veprime ushtarake kundër një shteti tjetër kur një sulm është vetëm një mundësi dhe nuk ka filluar akoma.

4.2 MBROJTJA E TË DREJTAVE DHE E LIRIVE THEMELORE TË NJERIUT NË KARTËN E KOMBEVE TË BASHKUARA

Karta e Kombeve të Bashkuara, e nënshkruar në qershor 1945, në preambulën e saj përmban zotimin e organizatës për të riafirmuar besimin në të drejtat njerëzore më themelore, ndërsa neni 1/3 pohon: "Qëllimet e Kombeve të Bashkuara janë "... të sigurojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në çuarjen përpara dhe inkurajimin e respektit për të drejtat njerëzore dhe liritë themelore për të gjithë."

Neni 55 pohon: "Kombet e Bashkuara duhet të mbështesin respektimin e përgjithshëm dhe efektiv të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjithë pa dallim race, seksi, gjuhe dhe feje."

Sipas nenit 56, "Të gjithë anëtarët zotohen të ndërmarrin veprime të përbashkëta, ose të veçuara në bashkëpunim me këtë organizatë, për të arritur qëllimet e shpallura në nenin 55."

Në këtë mënyrë Karta e Kombeve të Bashkuara vendosi bazat për një ndryshim radikal të konceptit tradicional për të drejtat njerëzore. Anëtarët e Kombeve të Bashkuara tashmë zotohen "të ndërmarrin veprime të përbashkëta dhe të veçanta në bashkëpunim me organizatën".[24] Arritja e respektit të përgjithshëm për të drejtat njerëzore është një çështje ndërkombëtare.

---

23. Rezoluta 487 e Këshillit të Sigurimit, 19 qershor 1981.
24. Karta e Kombeve të Bashkuara, 26 qershor 1945, neni 56.

Pra promovimi dhe mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave njerëzore u bë një qëllim i Kombeve të Bashkuara, pas Luftës së II-të Botërore. Nenet mbi të drejtat e njeriut që përmban Karta e Kombeve të Bashkuara shtruan rrugën për zhvillimin e të drejtës ndërkombëtare që fokusohet mbi individin më shumë se mbi shtetin. Të drejtat njerëzore janë konsideruar një çështje që mbetet jashtë juridiksionit ekskluziv të shteteve.

Deklarata Universale e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Njeriut në vitin 1948 e zhvilloi më tej çështjen e respektimit të të drejtave njerëzore dhe ndërkombëtarizimit të këtyre të drejtave, duke e konsideruar respektimin e të drejtave njerëzore si të nevojshëm për ruajtjen e paqes ndërkombëtare.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut nuk ishte e detyrueshme për t'u zbatuar nga shtetet. Megjithatë gjatë viteve parimet e deklaratës janë konsideruar si të detyrueshme dhe janë zhvilluar më tej në instrumenta të tjera. Organe të ndryshme të Kombeve të Bashkuara i kanë kërkuar shteteve që të respektojnë deklaratën.

4.2.1 Shkeljet e mëdha të të drejtave njerëzore, si një kërcënim potencial për paqen dhe sigurinë.

Që nga koha e ndërhyrjes së NATO-s në Jugosllavi, sovraniteti nuk është më diçka absolute, por i kushtëzuar. Sot, kërkesa e një qeverie për sovranitet mund të varet nga mënyra se si respektohen të drejtat bazë njerëzore të qytetarëve nga kjo qeveri.

Sugjerimi që respekti për sovranitetin është i kushtëzuar nga respekti për të drejtat njerëzore është reflektuar në praktikën e Këshillit të Sigurimit, i cili gjithnjë e më shumë i ka konsideruar konfliktet e brendshme dhe shkeljet në shkallë të gjerë të të drejtave njerëzore si bazë ligjore për aksion ndërkombëtar. Që nga fundi i Luftës së Ftohtë, Këshilli i Sigurimit ka vlerësuar "të drejtën për ndërhyrje humanitare", duke adoptuar një sërë rezolutash të cilat në mënyrë progresive kanë zgjeruar përkufizimin e një "kërcënimi për paqe dhe siguri ndërkombëtare" sipas nenit 39 të Kartës për të lejuar që Këshilli i Sigurimit të mandatojë ndërhyrje ushtarake në përgjigje të krizave të mëdha humanitare[25] edhe ku kriza të tilla kanë qenë krejt të brendshme në natyrën e tyre. Kjo është ajo çfarë Këshilli i Sigurimit bëri në rastin e Bosnjës (Rezoluta 770 e 13 gushtit 1992),[26] Somalisë (Rezoluta 794 e 3 dhjetorit 1992), Haitit (Rezoluta 940 e 31 korrikut 1994)[27] dhe Ruandës (Rezoluta 929 e 22 gushtit 1994). Në mënyrë të ngjashme ai në zbatim të Kapitullit VII të Kartës, miratoi misionet paqeruajtëse në Kosovë dhe Timorin Lindor, si dhe në Sierra Leone.

---

25. Security Council resolution 666 (1990) of 13 September 1990 (embargo against Iraq); Security Council resolution 787 (1992) of 16 November 1992 (embargo against former Yugoslavia) and Security Council resolution 816 (1993) of 31 March 1993 (no flight zones over Bosnia and Herzegovina).
26. Security Council resolution 929 (1994) of 22 June 1994.
27. Përsa i përket Haitit u autorizuan operacione paralele. Nëpërmjet rezolutës 867 (1993), të 23 shtatorit 1993 Këshilli i Sigurimit krijoi një mision paqeruajtës të quajtur "United Nations Mission in Haiti" (UNMIH). Në 31 korrik 1994, Këshilli i Sigurimit duke vepruar sipas Kapitullit VII të Kartës, nëpërmjet rezolutës 940 (1994), autorizoi shtetet anëtare të krijonin një forcë shumëkombëshe nën një komandë të unifikuar dhe të përdornin të gjitha mjetet e nevojshme për të lehtësuar largimin nga Haiti të lidershipit ushtarak, dhe kthimin e presidentit të zgjedhur si dhe rindërtimin e autoritetit legjitim të Qeverisë së Haitit. Në këtë rast, megjithatë, personeli i UNMIH nuk u angazhua në operacion dhe as nuk ishte present në Haiti.

Kjo prirje sugjeron që parimi i mosndërhyrjes në punët e brendshme është zëvendësuar nga parimi që shkeljet masive dhe të shumëpërhapura të të drejtave të njeriut, ose të së drejtës humanitare që burojnë nga aktet qeveritare, ose konfliktet e brendshme dhe rëndësia e vuajtjes njerëzore që ata shkaktojnë mund të përbëjnë një kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Në këto rrethana, Këshilli i Sigurimit mund të ndërmarrë

masa të përshtatshme, përfshirë përdorimin e forcës për mbrojtjen e operacioneve humanitare.

Siç u përmend më lart, nxitja e të drejtave njerëzore është një prej qëllimeve primare të Kombeve të Bashkuara, që kontribuon në ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare në sistemin e krijuar nga Karta e Kombeve të Bashkuara. Kështu disa autorë argumentojnë se Karta lejon përdorimin e forcës në rrethana të tjera, përveç atyre të parashikuara në nenet 51 dhe 42 të Kartës.

Kjo metodë e ndjekur nga Këshilli i Sigurimit, për të konsideruar shkeljet e gjëra të të drejtave njerëzore si një kërcënim, ose shkelje e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare pas Luftës së Ftohtë ka bërë që të konsiderohen konfliktet e brendshme dhe katastrofat humanitare si kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Këshilli i Sigurimit mund të ndërmarrë masa detyruese pa marrë parasysh parimin e përgjithshëm të mosndërhyrjes në punët e brendshme të një shteti kur vendos nëse një situatë e veçantë është një kërcënim për paqen dhe sigurinë.

4.3 PAQERUAJTJA E SOTME

Eshtë e rëndësishme të identifikohet se si humanitarizmi ushtarak i sotëm ndryshon nga pikëpamja dhe qëndrimet tradicionale të Kombeve të Bashkuara. Forcat e sotme të Kombeve të Bashkuara po përpiqen të bëjnë më shumë se ç'kanë bërë më parë dhe përgjithësisht në rrethana shumë të vështira.

Kombet e Bashkuara edhe më parë kanë kaluar në shtigje të pashkelura nga pikëpamja juridike. Për shembull paqeruajtja tradicionale e Kombeve të Bashkuara në kohën e luftës së ftohtë nuk ishte e përkufizuar askund në Kartën e Kombeve të Bashkuara, por u shfaq si mënyrë pragmatike, në të cilën komuniteti ndërkombëtar mbështeti zgjidhjet paqësore të konflikteve ndërkombëtare.

Parimet dhe praktika e sotme e operacioneve të përgjithshme paqeruajtëse janë krejt të ndryshme nga forma tradicionale e paqeruajtjes.[28] Detyra kryesore e paqeruajtjes tradicionale ishte pozicionimi i trupave të Kombeve të Bashkuara ndërmjet palëve në konflikt, të cilat po prireshin drejt pushimit të zjarrit. Operacionet e sotme paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara ndryshojnë nga paqeruajtja e Luftës së Ftohtë, nga pikëpamja e parimeve, praktikës dhe mjedisit ku zhvillohen. Forcat Paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara ndërhyjnë në mes të luftërave civile më shumë se në luftërat ndërshtetërore kur ato janë duke mbaruar.

---

28. Luigi Condorelli, Anne-Marie La Rosa, Sylvie Scherrer, 'The United Nations and International Humanitarian Law", Actes du Colloque international A l'occasion du cinquantieme anniversaire de l'ONU, Editions Pedone, Paris, 1996.

Një tjetër tipar i ri që paraqet paqeruajtja e sotme, në ndryshim nga ajo tradicionale është mundësia që operacionet e Kombeve të Bashkuara të fillojnë nën komandën e një kombi të vetëm dhe jo në formën e një komande kolektive të Kombeve të Bashkuara. Në Afrikë u zbatua një operacion i tillë, në Somali vetëm nga Shtetet e Bashkuara dhe në Ruanda

nga francezët. Drejtimi dhe kontrolli i operacioneve të Kombeve të Bashkuara nga një komb i vetëm është një ndryshim nga kontrolli kolektiv i paqeruajtjes tradicionale.

Në vitin 1992, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Butros Butros Gali nxori dokumentin e titulluar "Një axhendë për paqen". Ky dokument përmbante parimet kryesore mbi të cilat Kombet e Bashkuara do të bazoheshin për të drejtuar diplomacinë parandaluese, zbatimin e paqes, ruajtjen e paqes dhe ndërtimin e paskonfliktit.[29]

Në thelb të Axhendës për Paqe qëndron politika e përdorimit gjithnjë në rritje të forcës ushtarake të Kombeve të Bashkuara dhe rolit të saj në zbatimin e strategjive të reja. Kjo axhendë ishte parathënia e faktit që "koha e sovranitetit absolut dhe ekskluziv ka kaluar". Më shumë se kurrë më parë axhenda për paqe konfirmoi të drejtën e Kombeve të Bashkuara për të ndërhyrë në një shtet, sipas kapitullit të VII të Kartës, në emër të të drejtave të qytetarëve.

Operacionet ushtarake u zbatuan në emër të ruajtjes së paqes, zbatimit të paqes, rindërtimit të paqes pas konfliktit dhe asistencës humanitare në vende si Somalia, [30] ish Jugosllavia,[31] Kamboxhia, Mozambiku, Ruanda[32] dhe në Angola.

4.3.1 Nevoja e krijimit të forcës ndërhyrëse të Kombeve të Bashkuara

Qysh në vitin 1992, Sekretari i Përgjithshëm ka theksuar nevojën urgjente që shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara të krijojnë seksione të veçanta të forcave të tyre të armatosura, të cilat të jenë të gatshme për çdo lloj ndërhyrje të shpejtë nga ana e Kombeve të Bashkuara. Pavarësisht nga optimizmi fillestar i vitit 1992, Organizata e Kombeve të Bashkuara ende edhe sot nuk ka ndonjë kriter të përcaktuar qartë për ndërhyrje humanitare ushtarake dhe as ndonjë kapacitet efektiv për të kryer ndërhyrje të tilla. Këshilli i Sigurimit nuk ka zhvilluar ende një doktrinë të përgjithshme të ndërhyrjes humanitare, por procedon rast pas rasti.

---

29. Hugo Slim, Military humanitarianism and the new peace keeping. An agenda for peace? IDS Bulletin Vol 27 No 3 1996, onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1111/j.1759-5436.1996...x/pdf
30. M. Sahnoun, Somalia–The Missed Opportunities, United States Institute of Peace Press (1994); African Rights, Somalia, Operation Restore Hope: A Preliminary Assessment, London (1992); Human Rights Watch/Africa, Somalia Faces the Future, vol.7, n° 2, New York, 1995.
31. S. Jacobi, "UNPROFOR – Mission impossible", 2. International Peacekeeping (1995), n° 2/3, p. 39. U. Palwankar, op. cit. note 4. On the need for adequate resourcing of such operations, see Supplement to the Agenda for Peace: the Position Paper of the Secretary-General on the Occasion of the Fiftieth Anniversary of the United nations (A/50/60 – S/1995/1) 0f 3 January 1995, para. 35.
32. Security Council resolution 929 (1994) of 22 June 1994; M. Bothe & C. Jury, "Rwanda: A creeping sense of security", 1. International Peacekeeping (1994), n° 3, p.100.

Ish sekretarja amerikane e shtetit Madeleine Albright, e cila ishte një prej arkitekteve të ndërhyrjes humanitare në Kosovë, ka thënë se komuniteti ndërkombëtar duhet të krijojë një forcë ushtarake që të jetë në gatishmëri për të ndërhyrë kundër genocidit dhe vrasjeve në masë. Sipas pikëpamjes së Albright, organizatat humanitare janë tepër të vlefshme për

të ndihmuar me ushqime, ujë dhe ndihma mjekësore zonat e prekura nga kriza humanitare.

Masakra e vitit 1994 në Ruandë[33] çoi në vdekjen e mijëra personave. Dështimi në ndalimin e genocidit në Ruanda në vitin 1994 shpesh shihet si një nga momentet më të dobëta të Kombeve të Bashkuara. Ishte mungesa e vullnetit politik nga anëtarët kryesorë të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, si dhe argumentet mbi faktin se kush do t'i siguronte burimet dhe do të shlyente koston e aksionit ushtarak, ato që çuan në dështimin e ndërhyrjes në kohë. Pasoja ishte humbja e 800.000 jetëve në tre muaj. Kombet e Bashkuara përbëhen nga shtete individuale dhe ata të gjithë kanë përgjegjësi të sigurojnë veprimin efektiv të Kombeve të Bashkuara. Shtetet anëtare duhet t'i japin fund pengimit të Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Sigurimit përmes përdorimit politik të vetos, dështimit në plotësimin e detyrimeve financiare ndaj organizatës, ose bllokimit të reformave të propozuara, në mënyrë që më pas të mos i fajësojnë Kombet e Bashkuara për mosveprim.

Reagimi ndërkombëtar në genocidin e Ruandës ishte një dështim i dukshëm. Kombet e Bashkuara kishin dijeni se një genocid po planifikohej. Ky informacion duket sikur humbi në burokraci.

Në fillim të genocidit, pas vrasjes së presidentit të Ruandës dhe atij të Burundit[34] më 6 Prill 1994, Komuniteti Ndërkombëtar ndërmori pak veprime.[35] Në fakt pjesa më e madhe e trupave paqeruajtëse në Ruanda u tërhoqën. Në 17 Maj Këshilli i Sigurimit e zgjeroi misionin e Kombeve të Bashkuara në Ruanda. Por trupat e caktuara për mision nuk u vendosën në kohë. Asnjë masë e dhunshme për të ndaluar genocidin dhe për të mbrojtur viktimat nuk u ndërmor deri në momentin që francezët, duke vepruar sipas mandatit të kapitullit të VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, ndërhynë në një pjesë të vendit në muajin qershor. Kjo ishte një ndërhyrje e kufizuar dhe lidhej me interesat franceze në Ruanda.[36] Përveç kësaj Komuniteti Ndërkombëtar nuk ndërmori asnjë veprim force për të ndaluar genocidin.

Qysh nga ajo kohë është folur që të mos lejohet më kurrë përsëritja e ngjarjeve të tilla. Por gjëra të ngjashme po ndodhin përsëri. Gjatë dekadës së fundit dhuna sporadike në Republikën Demokratike të Kongos[37] ka çuar në vdekjen e miliona personave.

---

33. Security Council resolution 955 (1994) of 8 November 1994.
34. Security Council resolution 1012 (1995), and Un Doc. S/1995/631 of 28 July 1995 and S/1995/825 of 27 September 1995.
35. K. Mills, The legitimacy of humanitarian access and intervention, Published July 4, 1997, sites.tufts.edu/jha/archives/tag/*intervention*
36. African Rights, Rwanda: Death, Despair and Defiance, London (1994), pp. 667-672, 698-711.
37. Damian Lilly, No war, no peace: a protection crisis continues in the DRC, November 2005, sites.tufts.edu/jha/files/2011/04/a182.pdf

Sipas ish sekretares amerikane të shtetit Madeleine Albright, bota nuk arriti të hyjë në këto konflikte jo për shkak të mungesës së vlerave morale, por për shkak të mungesës së një force të gatshme ushtarake që udhëheqësit e botës mund ta aktivizojnë kur ka shpërthime konfliktesh, si dhe të mungesës së kuadrit juridiko – ndërkombëtar.

Albright theksonte se për fat të keq komentet dhe kryeartikujt e gazetave nuk shpëtojnë jetë njerëzish. Vizitat e anëtarëve të Kongresit në rajon nuk shpëtojnë jetë njerëzish. As rezolutat e Kombeve të Bashkuara nuk bëjnë dot gjë, pa u mbështetur në përdorimin e forcës. Vrasjet e civilëve nga forcat ushtarake, janë një problem ushtarak ku forcat ushtarake duhet të luajnë rol.[38]

Një pengesë tjetër për ndërhyrje të shpejta humanitare është koha që i duhet Kombeve të Bashkuara për t'iu përgjigjur krizave humanitare. P.sh. pasi Këshilli i Sigurimit kaloi Rezolutën 918, në maj 1994, e cila rriti sasinë e trupave të Kombeve të Bashkuara në Ruanda me 5.500 trupa, kaluan pothujse 6 muaj përpara se kjo forcë të vendosej. Sipas United Nations Association, në çdo operacion të madh paqeruajtës të Kombeve të Bashkuara ndërmjet viteve 1991 dhe 1999, ka patur një interval prej 3-6 muaj ndërmjet adoptimit të rezolutës së Kombeve të Bashkuara, që autorizonte misionin dhe momentit të vendosjes së forcës.[39]

Vonesa të tilla kanë nxjerrë në pah nevojën për zhvillimin e një force ushtarake të qëndrueshme të Kombeve të Bashkuara si një forcë ndërkombëtare permanente e rekrutuar, e stërvitur dhe e vendosur në vendin e misionit direkt nga Kombet e Bashkuara. Kjo forcë e stërvitur e reagimit të shpejtë mund të ishte përherë në dispozicion të Këshillit të Sigurimit, e aftë për t'iu përgjigjur shpejt krizave humanitare dhe në gjendje për t'u vendosur brenda një kohe të kufizuar.

Ndërhyrje të tilla do të kërkonin një kontigjent të madh trupash, të pajisur mirë dhe me një mandat për të ndaluar vrasjet dhe për t'i hapur rrugë operacioneve humanitare.

E thënë më thjesht kjo do të kërkonte përzgjedhjen e njësive ushtarake nga vende të ndryshme, të motivuara dhe të pajisura për t'ju përgjigjur krizave humanitare. Në një rast ideal, këto forca duhet të kishin edhe aftësi të tjera, të kishin mundësi të stërviteshin së bashku, të pajiseshin me mjete komunikuese dhe armë, si dhe të ishin të gatshme të ndërhynin brenda një kohe të shkurtër. Kjo forcë duhet të veprojë nën autoritetin e Kombeve të Bashkuara dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. Duhet pranuar se krijimi i kësaj force kërkon fonde të shumta, planifikim rajonal dhe global, dhe ripërcaktimin e konceptit të sovranitetit kombëtar.[40]
Ndërsa mungon vullneti politik për të krijuar një force ushtarake të qëndrueshme të Kombeve të Bashkuara, vëmendje më e madhe i duhet kushtuar rolit që organizatat rajonale, (p.sh. Bashkimi Afrikan ose Bashkimi Europian), mund të luajnë në vendosjen e shpejtë të trupave, veçanërisht në qoftë se Këshilli i Sigurimit dhe Asambleja e Përgjithshme dështojnë t'i përgjigjen një krize humanitare që po shfaqet.

38. Jarosllav Anders, Krijimi i forces ushtarake kunder genocidit, 19. 03. 2005, f.2.
39. Chris Abbott, Rights and Responsibilities. Resolving the Dilemma of Humanitarian Intervention, September 2005, sites.tufts.edu/jha/files/2011/04/a180.pdf
40. Jarosllav Anders, Krijimi i forces ushtarake kunder genocidit, 19. 03. 2005, f.5.

4.4 OPERACIONET E PAQES TË KOMBEVE TË BASHKUARA

4.4.1 Sfondi ligjor i operacioneve për mbështetjen e paqes

Shteteve u kërkohet t'i zgjidhin mosmarrëveshjet ndërkombëtare ndërmjet tyre me mjete paqësore. Ata duhet të frenohen në kërcënimet ose përdorimin e forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare, por gëzojnë të drejtën e qenësishme të vetëmbrojtjes individuale ose kolektive, në rast se ndodh ndonjë sulm.

Mjetet paqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve përfshijnë bisedimet, ndërmjetësimin, procedurën gjyqësore, ndoshta para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, ose mbështetjen në organizata rajonale ose vetë Organizatën e Kombeve të Bashkuara, komisionet mikste etj.[41]

Shteteve që ushtrojnë të drejtën e tyre të vetëmbrojtjes u kërkohet të raportojnë para Këshillit të Sigurimit për masat e marra dhe e drejta e vetëmbrojtjes zgjat deri sa Këshilli i Sigurimit të vendosë situatën nën kontroll. Organizatat rajonale mund të marrin masa për rivendosjen e paqes dhe mund të justifikohen me të drejtën e vetëmbrojtjes kolektive.

Në disa traktate për mbrojtjen rajonale, sulmi ndaj një shteti anëtar konsiderohet si sulm ndaj të gjitha shteteve anëtare. Megjithatë mjaft shpesh është Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara ai që vendos për marrjen e masave për rivendosjen ose lehtësimin e vuajtjeve të luftës.

Organizata e Kombeve të Bashkuara duhet t'u kërkojë shteteve anëtare të saj të sigurojnë kontigjentet e nevojshme për mbështetjen e paqes. Vitet e fundit, organizatat rajonale të mbrojtjes kanë siguruar mbështetje ushtarake për kontigjentet e Kombeve të Bashkuara në specialitete të veçanta si ato të komandimit dhe kontrollit, logjistikës, mbështetjes nga ajri dhe forcave të ndërhyrjes së shpejtë.

Megjithëse në të drejtën ndërkombëtare ka një parim të përgjithshëm të mosndërhyrjes në punët e brendshme, kjo nuk e përjashton Këshillin e Sigurimit nga marrja e masave në rast se përcakton që ngjarjet brenda një shteti përbëjnë kërcënim për paqen.

4.4.2 Zhvillimi i operacioneve të Kombeve të Bashkuara për paqen

Shtete të ndryshme kanë nxitur përpjekjet paqeruajtëse që nga kohët e lashta. Në vitin 1899 dhe 1907 shumë shtete morën pjesë në Konferencat e Paqës të Hagës për të nxitur standartet ndërkombëtare dhe kontrollin e përdorimit të konfliktit të armatosur. Më pas, në periudhën pas Luftës së Parë Botërore, shumë vende formuan Lidhjen e Kombeve për të nxitur paqen botërore nëpërmjet bisedimeve, pajtimeve dhe diplomacisë. Megjithëse Lidhja e Kombeve nuk zgjati shumë, ajo la si trashëgimi të saj konceptin që shtetet e botës kanë autoritetin, të drejtën morale dhe kompetencat ligjore për të diskutuar, gjykuar dhe reaguar ndaj sjelljes së shteteve të tjera.

41. Humanitarian Law in Armed Conflicts, Manual, Edited by The Federal Ministry of Defence of the Federal Republic of Germany, VR II 3, August 1992.p.126.

Komuniteti ndërkombëtar në vitin 1945, pra në përfundim të Luftës së Dytë Botërore krijoi Organizatën e Kombeve të Bashkuara.[42] Megjithatë, në vitet e Luftës së Ftohtë polarizimi ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit e pengoi Këshillin e Sigurimit të Kombeve të

Bashkuara për të ushtruar me efikasitet pushtetin e tij. Si rezultat, operacionet e paqes të Kombeve të Bashkuara përgjithësisht u kufizuan në përpjekjet ushtarake për ruajtjen e paqes pas pushimit të zjarrit, ose në ndihmën dhe përkrahjen e marrëveshjeve dhe zgjidhjeve.[43]

4.4.3 Operacionet paqeruajtëse shumë - dimensionale të Kombeve të Bashkuara

Sot operacionet e paqes përfshijnë një rang të gjerë misionesh, të gjitha me qëllimin përfundimtar të nxitjes së paqes dhe stabilitetit ndërkombëtar. Në shumë raste operacionet e paqes përfshijnë çështjet ushtarake dhe ato civile. Misionet e operacioneve të paqes mund të përfshijnë: [44]

1. Mbikqyrjen e pushimit të zjarreve;
2. Çmobilizimin e luftëtarëve dhe ndihmën për integrimin e tyre në shoqërinë civile;
3. Mbrojtjen e palëve joluftuese nga agresioni;
4. Çarmatimin dhe shkatërrimin e armëve;
5. Mbrojtjen dhe riatdhesimin e refugjatëve dhe personave të shpërngulur;
6. Ndihmën humanitare;
7. Krijimin e infrastrukturës qeveritare, forcave të policisë civile dhe institucioneve ligjore;
8. Vlerësimin e të drejtave të njeriut;
9. Vëzhgimin e zgjedhjeve të lira.

Transformimi i mjedisit ndërkombëtar i ka dhënë nxitje operacioneve të reja paqeruajtëse "shumë-dimensionale" të Kombeve të Bashkuara. Këto operacione vendosen në periudhën e rrezikshme pas përfundimit të një konflikti të brendshëm të dhunshëm dhe mund të përfshijnë një përzierje të aftësive ushtarake, policore dhe civile për të mbështetur zbatimin e një marrëveshjeje të përgjithshme paqeje.

Disa operacione paqeruajtëse "shumë-dimensionale" të Kombeve të Bashkuara janë vendosur pas një kërkese nga autoritetet kombëtare për të mbështetur kalimin në qeveri legjitime, në mungesë të një marrëveshjeje formale paqeje. Në rrethana të veçanta, Këshilli i Sigurimit ka autorizuar operacione paqeruajtëse "shumë-dimensionale" të Kombeve të Bashkuara për të marrë përkohësisht funksionet legjislative dhe administrative të shtetit, në mënyrë që të mbështetet transferimi i autoritetit nga një bashkësi sovrane tek një tjetër, ose derisa çështjet e sovranitetit të zgjidhen plotësisht, ose për të ndihmuar shtetin të krijojë struktura administrative që nuk kanë ekzistuar më parë.

42. Megjithëse nuk është parashikuar në Kartë, praktika e paqeruajtjes filloi në vitin 1948, kur vëzhguesit e parë ushtarakë të Kombeve të Bashkuara u vendosën në Lindjen e Mesme.
43. Gjatë viteve pasuese të Luftës së Ftohtë, qëllimet e paqeruajtjes së Kombeve të Bashkuara ishin të kufizuara në ruajtjen e armëpushimeve dhe stabilizimin e situatave në tokë, kështu që përpjekjet mund të bëheshin në nivel politik për të zgjidhur konfliktin në mënyra paqësore. Operacionet paqeruajtëse tradicionale të Kombeve të Bashkuara janë vendosur si një masë e përkohshme për të ndihmuar menaxhimin e një konflikti dhe për të krijuar kushte në të cilat të mund të fillojnë bisedimet e një zgjidhjeje afatgjatë. Operacionet paqeruajtëse tradicionale normalisht nuk luajnë rol direkt në përpjekjet politike për zgjidhjen e konfliktit.
44. Executive Program for Albania, Phase 7, Quality Force Management, Defense Institute of International Legal Studies, December 1995. Kapitulli (Operacionet e paqes të Kombeve të Bashkuara), p.12,1.

Operacionet paqeruajtëse "shumë-dimensionale" të Kombeve të Bashkuara të vendosura pas një konflikti të brendshëm përballen me një ambjent të veçantë sfidues. Kapaciteti i shtetit për të siguruar siguri për popullsinë e tij dhe për të ruajtur rendin publik është

shpesh i dobët dhe dhuna mund të jetë akoma në vazhdim në pjesë të ndryshme të vendit. Infrastruktura bazë ka shumë mundësi të jetë shkatërruar dhe seksione të mëdha të popullsisë mund të jenë zhvendosur. Shoqëria mund të jetë ndarë në linja etnike, fetare dhe rajonale dhe abuzime të rënda me të drejtat e njeriut mund të kenë ndodhur gjatë konfliktit, përpjekje të mëtejshme për të arritur pajtimin kombëtar.

Në ndryshim me operacionet paqeruajtëse tradicionale të Kombeve të Bashkuara, operacionet paqeruajtëse "shumë-dimensionale" të Kombeve të Bashkuara zakonisht luajnë një rol direkt në përpjekjet politike për të zgjidhur konfliktet dhe shpesh janë mandatuar nga Këshilli i Sigurimit për të siguruar shërbime të mira, ose për të çuar përpara dialogun politik kombëtar dhe pajtimin.

Ndërsa vendosja e një operacioni paqeruajtës "shumë-dimensionale" të Kombeve të Bashkuara mund të ndihmojë në zvogëlimin e dhunës në një periudhë të shkurtër, nuk ka shumë mundësi të rezultojë në një paqe të qëndrueshme po të mos shoqërohet nga programe të krijuara për të parandaluar rifillimin e konfliktit.

Çarmatimi, çmobilizimi dhe riintegrimi i luftuesve: Operacionet paqeruajtëse "shumë-dimensionale" të Kombeve të Bashkuara zakonisht mandatohen për të asistuar në zhvillimin dhe zbatimin e programeve kombëtare të çarmatimit, çmobilizimit dhe riintegrimit. Kjo mund të përfshijë parashikimin e këshillimit teknik, sigurimin e çarmatimit dhe mbledhjen e shkatërrimin e armëve, municionit dhe materialeve të tjera të ish-luftuesve.

Aksioni i minave: Në shumë zona pas konfliktit, paisjet, minat tokësore dhe mjete të tjera të pashpërthyera përbëjnë kërcënim për sigurinë e civilëve dhe paraqesin një pengesë madhore në kthimin me sukses në gjendjen normale pas konfliktit. Aksioni i minave është kështu i nevojshëm për të rikrijuar një ambjent të sigurt për të ndihmuar një jetë normale dhe zhvillimin.

Reforma e sektorit të sigurisë : Bazuar në mandatin e tij një operacion paqeruajtës "shumë-dimensional" i Kombeve të Bashkuara mund të krijohet për të asistuar në rindërtimin, reformën dhe trajnimin e policisë dhe forcave të armatosura kombëtare. Operacioni paqeruajtës "shumë-dimensional" i Kombeve të Bashkuara gjithashtu luan rol në forcimin e sistemit gjyqësor kombëtar dhe mund të mandatohet për të çuar përpara reformën ligjore ose për të mbështetur zhvillimin e legjislacionit bazë.

Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave njerëzore: Abuzimi dhe shkelja e të drejtave njerëzore është në qendër të shumë konflikteve moderne dhe është gjithashtu pasojë e tyre. Shumë prej shkeljeve më të rënda të të drejtave njerëzore ndodhin gjatë konfliktit të armatosur dhe mbrojtja e të drejtave njerëzore duhet të jetë në themel të aksionit. Pjesa më e madhe e operacioneve paqeruajtëse "shumë-dimensionale" të Kombeve të Bashkuara janë mandatuar për të nxitur dhe mbrojtur të drejtat njerëzore nëpërmjet monitorimit dhe duke ndihmuar në investigimin e shkeljeve të të drejtave njerëzore dhe në zhvillimin e kapaciteteve të anëtarëve dhe institucioneve kombëtare për të vepruar vetë.

Rindërtimi i autoritetit të shtetit: Në mënyrë që të krijojë të ardhura dhe të sigurojë shërbimet bazë të popullsisë, shteti duhet të jetë në gjendje të ushtrojë kontroll mbi territorin e tij kombëtar. Operacionet paqeruajtëse "shumë-dimensionale" të Kombeve të Bashkuara mund të mbështesin rindërtimin e autoritetit të shtetit duke krijuar një mjedis sigurie, duke siguruar lidership politik ose duke koordinuar përpjekjet e anëtarëve të tjerë ndërkombëtar.

Asistenca elektorale: Operacionet paqeruajtëse "shumë-dimensionale" të Kombeve të Bashkuara zakonisht mandatohen për të luajtur një rol direkt në përpjekjet për të organizuar, monitoruar dhe zhvilluar zgjedhje të lira dhe të drejta përmes parashikimit të sigurisë, këshillimit teknik, mbështetjes logjistike dhe formave të tjera të asistencës elektorale.

Kryerja me sukses e operacioneve të paqes mund të çojë në pushimin e zjarrit, në zgjidhjen e konflikteve të vështira, në shpëtimin e jetëve të panumurta dhe në nxitjen e stabilitetit ndërkombëtar.

Në qoftë se nuk planifikohen si duhet dhe në qoftë se nuk zhvillohen nën një kontroll të rreptë operacionet e paqes të Kombeve të Bashkuara , mund të rezultojnë në humbje të panevojshme të jetës së njerëzve, shpërdorimin e burimeve ushtarake dhe në ngjalljen e pakënaqësive kombëtare. Një mision jo i suksesshëm i Kombeve të Bashkuara mundet gjithashtu të zvogëlojë përkrahjen kombëtare për Operacionet e Paqes dhe të dobësojë rolin e Kombeve të Bashkuara në nxitjen e paqes dhe stabilitetit ndërkombëtar.

4.4.4 Arsyet pse shtetet marrin pjesë në operacionet e paqes

Shtetet marrin pjesë në operacionet e paqes të Kombeve të Bashkuara sepse Kombet e Bashkuara kanë nevojë për shumë vende që të marrin pjesë në operacionet e paqes për të siguruar paqen ndërkombëtare.

Forcat shumëkombëshe janë e vetmja mënyrë praktike që komuniteti ndërkombëtar mund të përballojë për të nxitur paqen në mënyrë aktive dhe për të parandaluar një kthim në epokat e errëta të luftës së gjithanshme dhe të papërmbajtur kundër qytetërimit.[45]

Megjithëse të kushtueshme, operacionet e paqes së Kombeve të Bashkuara kushtojnë më pak në para dhe fuqi njerëzore sesa kostoja e një konflikti të plotë.

Operacionet e paqes sigurojnë një mundësi për forcat ushtarake të shteteve pjesëmarrëse në këto operacione të Kombeve të Bashkuara që të fitojnë përvojë direkte në një sërë situatash. Kualifikimi dhe përvoja nxit fuqinë dhe gatishmërinë e forcave të armatosura të një shteti si dhe rrit sigurinë e këtij shteti.[46]

45. Executive Program for Albania, Phase 7, Quality Force Management, Defense Institute of International Legal Studies, December 1995, p.12-8.

46. Po aty, p.12-3

Operacionet e paqes të Kombeve të Bashkuara përbëjnë gjithashtu një mundësi për shtetet që të marrin pjesë direkt dhe dukshëm në komunitetin ndërkombëtar. Duke marë përsipër një pjesë të përgjegjësisë ndërkombëtare për nxitjen e paqes në mënyrë aktive, një shtet sado i vogël të jetë pakëson mbështetjen te fuqitë e mëdha dhe fiton respekt botëror.

4.4.5 Kategoritë e operacioneve të Kombeve të Bashkuara për paqen

Operacionet e paqes përkufizohen si operacione, të cilat kryhen nga forcat shumëkombëshe për paqeruajtje dhe zbatim të paqes. Operacionet e paqes janë operacione të paanëshme, të cilat mbështesin aktivitetet diplomatike dhe humanitare me qëllim që të arrihen qëllimet politike dhe objektivi. Parandalimi i konfliktit, paqebërja, paqeruajtja dhe operacionet e zbatimit të paqes përfshihen në këto operacione. Siç shihet, operacionet e paqes përfshijnë gjithashtu elementë të zbatimit të paqes.[47]

Meqë Karta e Kombeve të Bashkuara nuk ka një përcaktim direkt lidhur me operacionet e mbështetjes së paqes, metodat e menaxhimit të konfliktit të përfshira në konceptin e mbështetjes së paqes janë renditur dhe përkufizuar në kategori të ndryshme si në literaturë dhe në publikimet zyrtare.[48] Në Raportin e 31 janarit 1992, të quajtur "Një axhendë për paqen", që u zhvillua nga ish-sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara Butros Gali, metodat e operacioneve të paqes përkufizohen si më poshtë:

- Diplomacia parandaluese
- Paqebërja
- Paqeruajtja
- Rindërtimi pas konfliktit.[49]

Në 30 korrik u 1999 u aprovua "Marrëveshja mbi Forcën Paqeruajtëse Shumëkombëshe në Evropën Juglindore". Në paragrafin (n) të nenit I të kësaj Marrëveshjeje, i cili titullohet "Përkufizimet", termi mbështetje e paqes është përkufizuar si: "Mbështetja e paqes janë operacionet e mbështetjes së paqes. Operacionet e mbështetjes së paqes janë operacione shumëkombëshe të zhvilluara në mënyrë të paanshme në mbështetje të misioneve të Kombeve të Bashkuara/OSBE-së që kanë forca ushtarake, elementë diplomatikë dhe ushtarakë me qëllim që të sjellin një zgjidhje afatgjatë ose të përmbushin kërkesat e tjera të përcaktuara në mision". Këto operacione përfshijnë parandalimin e konfliktit, paqebërjen, ndërtimin e paqes dhe operacionet humanitare përveç paqeruajtjes dhe zbatimit të paqes.[50]

47. Luigi Condorelli, Anne-Marie La Rosa, Sylvie Scherrer, 'The United Nations and International Humanitarian Law", Actes du Colloque international A l'occasion du cinquantieme anniversaire de l'ONU, Editions Pedone, Paris, 1996, f. 177.
48. Turkish General Staff, Guide to the law of Armed Conflict of Armed Forces, Ankara, June 2001, p.40
49. An Agenda for Peace, Report of January 31, 1992, http://disarm.igc.org/index.php?.
50. The Agreement on the South-eastern Europe Multi-national Peacekeeping force, July 30, 1999; and The Additional Protocol of The South-eastern Europe Multi-national Peacekeeping force, August 6, 1999.

Operacionet e lartpërmendura megjithëse plotësojnë njëri-tjetrin, përbëjnë lloje të ndryshme të operacioneve të mbështetjes së paqes, si më poshtë:

4.4.5. a Diplomacia parandaluese

Diplomacia parandaluese, janë aktivitete të zhvilluara me qëllim që të zgjidhen mosmarrëveshjet ndërmjet palëve dhe të parandalohet kthimi i mosmarrëveshjeve në një konflikt.

Diplomacia parandaluese konsiston në aktivitete diplomatike që zhvillohen para se të ndodhin konfliktet, ose që kanë për qëllim të parandalojnë përhapjen e konfliktit pasi ai fillon, në mënyrë që të mos kthehet në krizë të mundshme dhe të eleminojnë problemet që shkaktojnë konfliktet. [51] Ulja e tensionit midis palëve, vazhdimi i dialogut, ndërtimi i një mjedisi besimi reciprok, vendosja e një force me qëllim frenimi, krijimi i zonave të cmilitarizuara përfshihen në aktivitetet e Diplomacisë parandaluese.

Parandalimi i konfliktit[52] normalisht nënkupton aktivitete të zhvilluara brenda kuadrit të Kapitullit VI të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Këto aktivitete mund të përfshijnë një veprimtari që fillon nga iniciativat diplomatike deri në vendosjen e një force parandaluese me qëllim që të parandalohet një shkallëzim ose përhapje e konfliktit. Në të njëjtën kohë, ajo mund të përfshijë gjithashtu misione të grumbullimit të informacionit, këshillime, paralajmërime, inspektime dhe vëzhgime.

4.4.5. b Aktivitetet paqebërëse

Aktivitetet paqebërëse[53] konsistojnë në aktivitete që zhvillohen për të zgjidhur mosmarrëveshjet ndërmjet kundërshtarëve përmes masave të parashikuara në kapitullin VI të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Aktivitetet paqebërëse janë aktivitete diplomatike që kanë për qëllim të sigurojnë pushimin e zjarrit pas fillimit të një konflikti dhe të gjejnë zgjidhje paqësore ndërmjet palëve. Aktivitetet paqebërëse përfshijnë iniciativat e mira zyrtare, ndërmjetësimin, pajtimin, presionin diplomatik, izolimin ose sanksionet. Megjithëse aktivitetet paqebërëse zbatohen përmes mënyrave diplomatike, ato gjithashtu mund të përmbajnë përdorim direkt ose indirekt të elementëve ushtarakë. Aktivitetet paqebërëse konsiderohen si aktivitete diplomatike që zbatohen me qëllim që "të sigurojnë pushimin e zjarrit pas fillimit të konfliktit, ose një zgjidhje paqësore të menjëhershme".

---

51. D.Shraga & R. Zacklin, "The Applicability of International Humanitarian Law to UN peace-keeping operations" in Palwankar, op.cit. note 4, p.39, at p.43. See also U. Palwankar, "Applicability of international humanitarian law to United nations peace-keeping forces", 294 IRCC (1993), p. 227.
52. The Agreement on the South-eastern Europe Multi-national Peacekeeping force", July 30, 1999, article 1, para b.
53. Turkish General Staff Ankara, Partnership for Peace Training Center Command, Guide to the Law of Armed Conflict of Armed Forces, Ankara, Turkey, July 2001.p.131

4.4.5. c Paqeruajtja

Meqë Karta e Kombeve të Bashkuara nuk përmban një klauzolë përsa i përket operacionit paqeruajtës, ai është përkufizuar në mënyra të ndryshme. Ai është përkufizuar si operacion shumëkombësh dhe i shumëanshëm. Kapitulli VI i Kartës së Kombeve të Bashkuara, merret me zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve ndërkombëtare, ndërsa Kapitulli VII merret me ruajtjen dhe rindërtimin e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, brenda kontekstit të autoriteteve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Operacionet paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara mund të përkufizohen si aktivitete që zbatohen nga trupat ushtarake të vendosura në territorin e shtetit pritës me pëlqimin e këtij shteti, të cilat mund të përdorin një forcë të kufizuar për vetëmbrojtje, me qëllimin e mbrojtjes së paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Në një tjetër këndvështrim, më të gjerë, operacionet paqeruajtëse përkufizohen si aktivitete ushtarake dhe joushtarake[55] të zhvilluara gjithashtu nga elementë civilë me qëllim që të krijojnë paqe dhe siguri, përveç trupave paqeruajtëse dhe grupeve vëzhguese ushtarake.

Operacionet paqeruajtëse janë përgjithësisht operacione të ndërmarra dhe të zhvilluara me qëllim që të sigurohet dhe monitorohet përmbushja e marrëveshjes së paqes me pëlqimin e të gjitha palëve në një konflikt brenda kornizës së Kapitullit VI të Kartës së Kombeve të Bashkuara.[56] Siç pohohet qartë edhe në këtë përkufizim, operacionet paqeruajtëse kanë si qëllim të sigurojnë dhe monitorojnë zbatimin e marrëveshjes së paqes duke konkluduar në përfundimin e mosmarrëveshjeve ose konfliktit.

4.4.5. d Zbatimi i Paqes

Zbatimi i Paqes realizohet në përputhje me parashikimet e Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Ai ka karakter shtrëngues. Zbatohet edhe në mungesë të pëlqimit të palëve në konflikt. Planifikohet për të mbrojtur ose rindërtuar paqen ose për të përmbushur parashikimet e vendosura në mandat.

Operacioni i zbatimit të paqes është një ndërhyrje e armatosur dhe forcat pjesëmarrëse mund të mos jenë nën komandën e Kombeve të Bashkuara.[57]

---

54. J. Mackinlay & J. Chopra, "Second Generation Multinational Operations", 15 Washington Quarterly (1992), p.113; A. James, "Is there a second generation of peacekeeping?", 1 International Peacekeeping (1994), n° 4, p.110; shih kryesisht, U. Pawlankar (ed.), Symposium on Humanitarian Action and Peace-keeping Operations, ICRC (1994).
55. Eshtë një teknikë për të ruajtur paqen, sado e dobët të jetë ajo, pasi luftimet janë ndalur dhe për të mbështetur zbatimin e marrëveshjes së arritur nga paqebërësit. Për gjatë viteve, paqeruajtja ka evoluar nga një model fillestar ushtarak i vëzhgimit të armëpushimeve dhe ndarjes së forcave pas luftërave ndërshtetërore, të inkoporojë një model kompleks të disa elementëve: ushtarak, policor dhe civil, që punojnë së bashku për të ndihmuar shtrimin e themeleve për një paqe të qëndrueshme.
56. Self-defence has been broadly interpreted to mean "resistance to attempts by forceful means to prevent the force from discharging its duties under the mandate of the Security Council" (UN Doc. S/12611, p. 61; UN Doc. S/24540).
57. ONUC (United Nations Operation in the Congo) and UNOSOM II (United Nations Operation in Somalia).

Sipas paragrafit (k) të nenit I të Marrëveshjes mbi "Forcën Paqeruajtëse Shumëkombëshe në Evropën Juglindore", operacioni i zbatimit të paqes është krijimi i paqes nëpërmjet përdorimit të forcës. Në të njëjtin paragraf, operacioni i zbatimit të paqes përkufizohet si "një operacion i kryer nën kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara në rastet kur ka një mungesë ose pasiguri të pëlqimit nga të gjitha palët në konflikt, i cili ka një karakter detyrues, dhe i cili ka për qëllim të ndërtojë ose rindërtojë paqen".

Misionet e zbatimit të paqes, veçanërisht në konfliktet brenda shtetit, influencojnë në konceptin tradicional të sovranitetit absolut kombëtar. Ajo që mund të përkufizohet si "ndërhyrje humanitare" nga Kombet e Bashkuara dhe disa kombe të tjerë, mund të konsiderohet si ndërhyrje në punët e brendshme të atij kombi nga shumë vende të tjera.

4.4.5. e Operacionet e ndihmës humanitare[58]

Asistenca humanitare mund të zbatohet si në kohë paqe dhe në kohë konflikti të armatosur. Ndihma humanitare nënkupton të gjitha llojet e mbështetjes dhe shërbimit që i sigurohen njerëzve në zonat e konfliktit në raste ku autoritetet kompetente nuk munden, ose nuk kanë vullnetin e mirë për të siguruar mbështetjen e njerëzve, në konflikte të brendshme ose në luftëra civile, ku të drejtat dhe liritë themelore cënohen, ose ku ka shkelje të rënda të të drejtave njerëzore.

Ky lloj operacioni përfshin minimizimin e efekteve shkatërrimtare dhe mbrojtjen e të drejtave njerëzore.

Mbrojtja dhe asistenca ndërkombëtare që i sigurohet atyre që janë zhvendosur dhe janë detyruar të kërkojnë strehim për arsye të diskriminimit, ose shkeljes së të drejtave njerëzore që shkojnë deri në genocid në bashkëpunim me Komisionerin e Lartë për Refugjatët të Kombeve të Bashkuara, përfshihen në aktivitetet e ndihmës humanitare.

Pa një autorizim nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara ndërhyrja humanitare me iniciativën e një shteti ose të një grupi shtetesh është një çështje e debatueshme.

4.4.5. f Ndërtimi i paqes

Ndërtimi i paqes[59] është një prej metodave të menaxhimit të konfliktit dhe ka për qëllim promovimin e një mjedisi politik, ekonomik, social dhe psikologjik në rajonin e konfliktit duke pasuar sigurimin e paqes.

Ndërtimi i paqes gjithashtu përfshin aktivitetet si parandalimi i shpërthimit të konflikteve të reja, shmangien e përhapjes së propagandës së luftës dhe përkeqësimit të strukturës ekonomike, vendosjen e ligjeve dhe rendit publik, sigurimin e transparencës në procesin e vendimmarrjes dhe vendosjen e një sistemi politik efektiv dhe të qëndrueshëm.

---

58. The Agreement on the South-eastern Europe Multi-national Peacekeeping force", July 30, 1999, article 1, para g.
59. Turkish General Staff Ankara, Partnership for Peace Training Center Command, Guide to the Law of Armed Conflict of Armed Forces, Ankara, Turkey, July 2001, p.135.

Metoda e ndërtimit të paqes kërkon gjithashtu që të ndërmerren masa politike, ekonomike, sociale dhe ushtarake në mënyrë që të mbështeten zgjidhjet politike në drejtim të parandalimit të rifillimit të konflikteve. Në të njëjtën kohë, kjo metodë përfshin sigurimin e paqes, krijimin e mjedisit të sigurisë, vendosjen e mekanizmave me qëllim sigurimin e ristrukturimit në fushën e mirëqënies dhe ekonomisë. Padyshim, civilët gjithashtu marrin pjesë në krijimin e paqes, përveç ushtrisë.

Operacionet e ndërtimit të paqes synojnë eleminimin e shkaqeve të një konflikti, konsolidimin dhe fuqizimin e zgjidhjes politike, si dhe zhvillimin e aktiviteteve që përfshijnë masa ekonomike, sociale dhe ushtarake".

4.4.6 Kryerja e operacioneve të paqes

Shumica e konflikteve sot janë brenda një shteti, jo ndërmjet shteteve. Në vend që të merren me konflikte ndërmjet shteteve që janë në luftë Kombet e Bashkuara duhet të përballojnë konflikte më vdekjeprurëse dhe më komplekse ndërmjet grupeve etnike, fetare, politike dhe social – ekonomike brenda një shteti ose rajoni të vetëm.[60]

Në këtë realitet krijohen situata të tilla ku asnjë institucion shtetëror nuk është në gjendje të sigurojë qeverisje, udhëheqje, autoritet, ose shërbimet bazë shoqërore. Shteti nuk ka asnjë person përgjegjës për të realizuar funksionet e tij. Asnjë sistem efektiv policor ose juridik nuk është në gjendje të ndalojë ose dënojë aktivitetin kriminal.

Si rezultat forcave të Kombeve të Bashkuara mundet nga nevoja t'u jepet detyra e vendosjes dhe zbatimit të ligjit civil bazë, përveç detyrave të tyre për zgjidhjen e konfliktit.

Këta faktorë të marrë së bashku, mund të shkaktojnë një situatë të pakontrolluar, në të cilën forca bëhet i vetmi ligj.

Operacionet për mbështetjen e paqes janë në thelb të ndryshme nga operacionet ushtarake tradicionale dhe kërkojnë shprehi dhe aftësi force të ndryshme.[61] Forcat e Kombeve të Bashkuara duhet të marrin udhëzime të qarta se si ato duhet të reagojnë dhe të veprojnë ndaj situatave të paparashikuara. Ato duhet të kualifikohen për të kryer misionin e kërkuar, meqë dihet tashmë se natyra e operacioneve të paqes është shumë e ndryshme nga misionet për mbrojtjen kombëtare. Forcat e armatosura duhet të fitojnë aftësitë dhe reflekset e domosdoshme për të siguruar se mund ta kryejnë me sukses misionin.[62]

60. Patricia Chilton, Dan Plesch, Jamie Patten (1994) NATO, peacekeeping and the United Nations. & United Nations, Department of Peacekeeping Operations, Department of Field Support (2008) United Nations peacekeeping operations. Principles and guidelines.
61. Manual model "Mbi të drejtën e konfliktit të armatosur", Libri B, kreu 23 - 25, f.46.
62. Model Agreement between the United Nations and Member States contributing personnel and equipment to United Nations peace-keeping operations, Un Doc. A/46/185, Annex, para. 28.

Për të arritur këtë qëllim forcat e angazhuara në operacionet e paqes duhet të armatosen dhe furnizohen plotësisht për të gjithë misionin e propozuar. Më tej ato duhet të jenë në gjendje të mirëmbajnë pajisjet dhe armatimet që do të marrin. Në disa raste edhe pse pajimet ushtarake mund të sigurohen nga shtete të tjerë të cilët mund të preferojnë të marrin pjesë në operacionet e mbështetjes së paqes vetëm nëpërmjet dhënies së pajisjeve ushtarake. Forcat e armatosura duhet të jenë në gjendje t'i përdorin, mirëmbajnë, riparojnë dhe të bazohen në këto pajisje.

Në një sërë operacione të paqes, forcave të Kombeve të Bashkuara mund t'iu lindë nevoja e ndërrimit të mandatit dhe misionit. Një operacion që mund të fillojë me qëllimin strikt humanitar, mund t'i lindë nevoja e forcave për vetëmbrojtje.

Shtimi i mandateve të tjera për një mision që ka filluar mund të krijojë një sërë problemesh dhe rreziqesh. Një mandat që kërkon përdorimin e forcës kundër një pale, logjikisht nuk mund të kombinohet me një mision të autorizuar, që është bazuar në pëlqimin e palëve. Një forcë në terren kërkon aftësi ushtarake të ndryshme dhe më të fuqishme për të kryer veprimet imponuese, se sa për veprimet paqeruajtëse.

Rreziku dhe kostoja që përfshihen në operacionet e zbatimit të paqes, janë në përgjithësi më të mëdha se sa ato në paqeruajtje, si në humbje të rënda ashtu edhe në para. Shtetet që i sigurojnë këto burime mund të mos kenë dëshirë të marrin mbi vete këto rreziqe dhe shpenzime shtesë, duke krijuar kështu probleme ndërmjet shteteve pjesëmarrëse dhe duke rrezikuar të gjithë misionin.

4.4.7 Përfundime

Operacionet paqeruajtëse "shumë-dimensionale" të Kombeve të Bashkuara vendosen me pëlqimin e palëve kryesore në konflikt. Kjo kërkon një angazhim nga palët në një proces politik dhe pranimin nga ana e tyre të një operacioni paqeruajtës të mandatuar për të mbështetur këtë proces. Pëlqimi i palëve kryesore i siguron operacionit paqeruajtës të Kombeve të Bashkuara lirinë e nevojshme të veprimit, si fizik dhe politik, për të zbatuar detyrat e mandatit të tij. Në mungesë të këtij pëlqimi, operacioni paqeruajtës i Kombeve të Bashkuara rrezikon të bëhet një palë në konflikt dhe të priret drejt aksionit të zbatimit të forcës, duke u larguar kështu nga roli i tij strikt i paqeruajtjes.

Operacionet paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara duhet të përmbushin mandatin e tyre pa favore, ose paragjykime ndaj ndonjërës palë. Paanshmëria është e domosdoshme për të ruajtur pëlqimin dhe bashkëpunimin me palët kryesore, por nuk duhet të ngatërrohet me neutralitetin, ose paveprueshmërinë. Operacionet paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara duhet të jenë të paanshme në raportet e tyre me palët në konflikt, por jo neutrale në ekzekutimin e mandatit të tyre.

Mjediset ku operacionet paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara vendosen shpesh karakterizohen nga prezenca e forcave paraushtarake, kriminelëve dhe keqbërësve të tjerë, të cilët mund të kërkojnë aktivisht të minojnë procesin e paqes, ose përbëjnë një kërcënim për popullsinë civile. Në situata të tilla, Këshilli i Sigurimit i ka dhënë

operacioneve paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara mandate "të fuqishme" duke i autorizuar që "të përdorin të gjitha mënyrat e nevojshme" për të zvogëluar përpjekjet e dhunshme që synojnë pengimin e procesit politik, të mbrojnë civilët nga kërcënimi i dukshëm i sulmit fizik dhe të asistojnë autoritetet kombëtare në ruajtjen e ligjit dhe të rregullit.

Kjo paqeruajtje e fuqishme nuk duhet ngatërruar me zbatimin e paqes, siç parashikohet në Kapitullin VII të Kartës. Paqeruajtja e fuqishme përfshin përdorimin e forcës në nivel taktik me autorizimin e Këshillit të Sigurimit dhe pëlqimin e kombit pritës, ose pëlqimin e palëve kryesore në konflikt. Në të kundërt, zbatimi i paqes nuk kërkon pëlqimin e palëve kryesore dhe mund të përfshijë përdorimin e forcës ushtarake në nivel strategjik ose ndërkombëtar, e cila normalisht ndalohet për shtetet anëtare nga neni 2(4) i Kartës, përveç rasteve kur autorizohet nga Këshilli i Sigurimit.

Fillimisht paqeruajtësit nuk pritej që të luftonin. Si rregull i përgjithshëm, ata dislokoheshin atëherë kur kishte armëpushime dhe palët në konflikt kishin dhënë pëlqimin e tyre. Ato dislokoheshin për të vëzhguar nga toka dhe raportonin paanësisht lidhur me pushimin e zjarrit, tërheqjen e trupave ose elementë të tjerë të marrëveshjes së paqes. Kjo i jepte kohë dhe hapësirë përpjekjeve diplomatike në lidhje me gjetjen e shkaqeve të konfliktit. Sapo arrihej një marrëveshje paqeje palët e implikuara mund të kërkonin një forcë paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara për të mbikqyrur elementë të ndryshëm të planit për të cilin ishte rënë dakort.

Një operacion paqeruajtës i Kombeve të Bashkuara duhet të përdorë forcën vetëm si një masë të fundit kur metodat e tjera të bindjes kanë shteruar. Qëllimi përfundimtar i përdorimit të forcës është të influencojë dhe të pengojë keqbërësit që punojnë kundër procesit të paqes ose kërkojnë të dëmtojnë civilët; dhe jo të kërkojnë mposhtjen ushtarake të tyre.

Legjitimiteti ndërkombëtar është një prej anëve më të rëndësishme në një operacion paqeruajtës të Kombeve të Bashkuara. Legjitimiteti ndërkombëtar i operacionit paqeruajtës të Kombeve të Bashkuara buron nga fakti se ai është krijuar pasi ka marrë një mandat nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, i cili ka përgjegjësinë primare për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

Kredibiliteti i operacionit paqeruajtës të Kombeve të Bashkuara është një reflektim direkt i besimit të komunitetit lokal dhe ndërkombëtar në aftësinë e misionit për të arritur mandatin e tij. Kredibiliteti është një funksion i aftësisë së misionit, efektivitetit dhe aftësisë për të menaxhuar dhe për të arritur synimet e pritura. Me qëllim që të jetë i besueshëm, operacioni paqeruajtës i Kombeve të Bashkuara duhet të vendoset sa më shpejt që të jetë e mundur, të ketë burimet e duhura dhe të përpiqet të mbajë një qëndrim mirëbesimi, aftësie dhe të unifikuar.

4.5 E DREJTA NDËRKOMBËTARE HUMANITARE DHE E DREJTA MBI TE DREJTAT E NJERIUT

E drejta humanitare dhe e drejta mbi të drejtat e njeriut janë dy degë të ndara, por plotësuese të njëra tjetrës dhe bëjnë pjesë në të drejtën ndërkombëtare publike.

E drejta për të drejtat e njeriut i mbron shtetasit kundër autoriteteve të shtetit. E drejta humanitare ose e drejta e konfliktit të armatosur mbron individët që ndodhen nën pushtetin e palëve të treta.[63] Megjithëse e drejta mbi të drejtat njerëzore dhe e drejta humanitare janë të ndryshëm përsa i përket origjinës, të dy grupet e së drejtës kanë qëllime të përafërta. Ato kanë të bëjnë me mënyrën se si e ushtrojnë autoritetin e tyre personat në pushtet, si dhe me trajtimin human të njerëzve. Objekti i të dy llojeve të të drejtave është mbrojtja e qënieve njerëzore.

Sot e drejta ndërkombëtare humanitare po perceptohet gjithnjë e më shumë si pjesë e të drejtës mbi të drejtat e njeriut, i zbatueshëm në konflikt të armatosur. Kjo për faktin se e drejta humanitare mbron të drejtat e njeriut, të cilat shtetet nuk mund t'i zvogëlojnë as në raste ekstreme, siç është rasti i konfliktit të armatosur.[64]

Me qëllim që të kuptohet lidhja ndërmjet të drejtës humanitare dhe të drejtave njerëzore, ngjashmëritë dhe ndryshimet ndërmjet tyre, bashkë me qëllimin dhe zbatimin, si dhe të bëjmë të dukshme vijën e hollë të ndryshimit ndërmjet të drejtës humanitare dhe ligjit mbi të drejtat njerëzore, duhet të ndiqen gjurmët historike të dy koncepteve, si dhe të bëhet analiza e ndryshimeve ndërmjet tyre.

E drejta humanitare ka shumë të përbashkëta[65] me të drejtën mbi të drejtat e njeriut, meqë rregullat e të dy llojeve të të drejtave kanë të bëjnë me mbrojtjen e individëve.

E drejta ndërkombëtare humanitare dhe e drejta mbi të drejtat e njeriut janë të zbatueshme në konflikte të armatosura ndërkombëtare dhe mund të zbatohen njëkohësisht.

Disa nga rregullat e të drejtës humanitare dhe të së drejtës ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut janë të ngjashme, p.sh.:

- -Mosdiskriminimi[66] - një nga parimet kryesore të së drejtës ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut është gjithashtu një koncept kryesor i konventave të Gjenevës.
- -E drejta e jetës[67] - e drejta ndërkombëtare humanitare bën thirrje, sa më shumë që të jetë e mundur, për të drejtën e jetës gjatë armiqësive dhe ndalon vrasjet, ose ekzekutimet arbitrare të personave nën pushtetin e një autoriteti.
- -Të dy llojet e të drejtave ndalojnë torturën në të gjitha rrethanat. [68]

63. KNKK, Manual Model Mbi të Drejtën e Konfliktit të Armatosur, f. 4.
64. Roopam Verma, Humanitarian Laws and Human Rights Law, 2006, law.*bepress.com/cgi/viewcontent.cgi?article=4770&context.*
65. Hans-Peter Gasser, The International Committee of the Red Cross and the United Nations involvment in the implementation of international humanitarian law, p. 259.
66. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike,1966, neni 26.
67. Konventa Ndërkombëtare për tw Drejtat Civile dhe Politike,1966, neni 6/1.
68. Deklarata Universale e të drejtave të njeriut – Nju Jork, 10 dhjetor 1948. neni 5; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike,1966, neni 4, 7.

4.5.1 E drejta ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut

Të drejtat e njeriut i referohen të drejtave dhe lirive bazë, të cilat i gëzojnë të gjitha qëniet njerëzore, ku përfshihen e drejta e jetës dhe e lirisë, liria e fjalës dhe e shprehjes, si dhe barazia para ligjit.

Ideja e të drejtave njerëzore buron nga ideja filozofike e të drejtave natyrore. Për disa nuk ka ndonjë dallim ndërmjet të drejtave njerëzore dhe atyre natyrore, ndërsa të tjerë kanë zgjedhur që t'i ndajnë këto terma. Xhon Loku është ndoshta filozofi më i rëndësishëm, që zhvilloi këtë teori.

E frikësuar nga barbarizmat e Luftës së Dytë Botërore, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara adoptoi Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut, në vitin 1948. Deklarata Universale e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat njerëzore pohon: "Të gjitha qëniet njerëzore kanë lindur të lira dhe të barabarta në dinjitetin dhe të drejtat e tyre. Ato kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen në mënyrë vëllazërore ndaj njëri-tjetrit."

Megjithëse nuk ishin të detyruar ligjërisht, ajo i nxiti kombet anëtare të zhvillonin një numër të drejtash humane, civile, ekonomike dhe sociale, duke i vlerësuar këto të drejta si shumë të rëndësishme për lirinë, drejtësinë dhe paqen në botë. Kjo deklaratë ishte përpjekja e parë ligjore ndërkombëtare për të kufizuar sjelljen e shteteve. Disa shtete kërkuan që të shkonin përtej deklaratës mbi të drejtat njerëzore dhe të krijonin konventa, të cilat do t'i detyronin më shumë shtetet që të ndiqnin normat e të drejtave njerëzore.

E drejta ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut është e përbërë nga instrumente ndërkombëtarë dhe rajonalë, që mund të kenë formën e deklaratave, traktateve, protokolleve dhe instrumenteve të tjera. Të gjitha së bashku, ato sigurojnë një kuadër ligjor, gjithmonë në zhvillim për mbrojtjen mbarëbotërore dhe për çuarjen përpara të të drejtave të njeriut.

Parimeve universale të vendosura në Deklaratën Universale mbi të drejtat e njeriut të vitit 1948 u është dhënë një formë ligjore më preçise në dy konventa, Konventa ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike, (1966), dhe Konventa ndërkombëtare mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, (1966). Këto tre instrumente njihen si e drejta ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.

Më vonë, konventa të tjera u përpunuan, në mënyrë që të plotësonin të drejtën ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Ato përfshijnë:

- Konventën ndërkombëtare mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial, (1969).
- Konventën mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave, (1979).
- Konventën kundër torturës dhe trajtimeve, ose ndëshkimeve të tjera mizore, johumane, ose degraduese, (1987).
- Konventën mbi të drejtat e fëmijëve, (1989).

Çdo shtet është i detyruar të zbatojë standardet e këtyre instrumenteve që ka ratifikuar. Disa instrumente të të drejtave njerëzore ndërkombëtare janë bërë pjesë e të drejtës ndërkombëtare zakonore dhe si të tilla janë të detyrueshme për të gjitha shtetet, pra edhe për ato që nuk i kanë ratifikuar këto instrumente.[69] Janë krijuar gjithashtu mekanizma për monitorimin e zbatimit të gjashtë traktateve kryesore mbi të drejtat e njeriut. (Konventa ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike, Konventa ndërkombëtare mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore dhe katër konventat e përmendura më lart).

Kombet e Bashkuara kanë krijuar një numër organizmash për monitorimin dhe studimin e të drejtave njerëzore, nën drejtimin e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut, (UNHCHR).

Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut, (UNHCHR) është organi kryesor përgjegjës i Kombeve të Bashkuara për promovimin e të drejtave të njeriut. Mandati i saj buron nga Karta e Kombeve të Bashkuara dhe Deklarata e Vjenës. Ndërmjet të tjerash, ajo koordinon aktivitetet mbi të drejtat e njeriut në të gjithë sistemin e Kombeve të Bashkuara, përgjigjet për shkeljet serioze të të drejtave njerëzore dhe ndërmerr veprimtari dhe operacione, si dhe programe të asistencës teknike dhe edukative në fushën e të drejtave të njeriut.[70]

Ka gjithashtu disa marrëveshje dhe organizata rajonale, që merren me të drejtat e njeriut, duke përfshirë Gjykatën Evropiane për të drejtat e njeriut, e cila është e vetmja gjykatë ndërkombëtare që ka juridiksion për t'u marrë me çështjet e ngritura nga individët; Komisionin Afrikan mbi të drejtat humane; Komisionin Ndëramerikan mbi të drejtat njerëzore; Gjykata Ndëramerikane mbi të drejtat njerëzore dhe Qendrën Iraniane të mbrojtjes së të drejtave njerëzore.

Me përjashtim të të drejtave të pandryshueshme, (katër më të rëndësishmet janë e drejta e jetës, e drejta për të qenë i lirë nga skllavëria, e drejta për të qenë i lirë nga tortura dhe e drejta për të qenë i lirë nga zbatimet e ligjeve penale prapavepruese), Kombet e Bashkuara njohin mundësinë e kufizimit ose të lënies mënjanë të të drejtave njerëzore në periudha emergjencash kombëtare. Megjithatë "emergjenca duhet të jetë aktuale, të ketë efekt mbi tërë popullsinë dhe të ketë kërcënim për vetë ekzistencën e kombit. Shpallja e emergjencës mundet të jetë gjithashtu mjet i fundit dhe masë e përkohshme."

69. Gender, Human Rights and International Law, ICRC, 2003, DP Forsythe - 2006 - books.google.com
70. Human Rights Legislation –Wikipedia, the free encyclopedia, 2007, en.*wikipedia.org/wiki/International_human_rights_law*

4.5.2 Ndryshimi i të drejtës ndërkombëtare humanitare nga e drejta ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut

E drejta humanitare dhe e drejta mbi të drejtat e njeriut i mbrojnë qëniet njerëzore në rrethana të ndryshme dhe në mënyra të ndryshme.

E drejta mbi të drejtat e njeriut i vendos kufij fuqisë së shtetit për të respektuar të gjithë personat që i nënshtrohen autoritetit të tij, kufij këto që zbatohen në çdo kohë. E drejta ndërkombëtare humanitare , nga ana tjetër, është një e drejtë e veçantë e krijuar për të ndikuar në marrëdhëniet midis palëve ndërluftuese në kohë lufte, me qëllim që të sigurohen të drejtat themelore të personave nën pushtetin e kundërshtarit.[71]

E drejta ndërkombëtare humanitare zbatohet në situatë konflikti të armatosur, ndërsa të drejtat e njeriut zbatohen në kohë paqeje dhe disa prej tyre, të drejtat themelore në kohë paqeje dhe lufte.

Ndryshimi ndërmjet dy llojeve të të drejtave mund të shihet edhe në mënyrën me të cilën e drejta humanitare dhe traktatet mbi të drejtat e njeriut janë formuluar. Shteti bëhet palë në një traktat mbi të drejtat e njeriut, brenda kufijve të parashikimeve të traktatit, ndërsa traktatet humanitare kanë aplikim më të gjerë. Traktatet humanitare diktojnë se si një palë në konflikt duhet të trajtojë njerëzit që janë në mëshirën e saj, ndërsa ligji mbi të drejtat e njeriut përqendrohet në të drejtat e pjesëmarrësve në një marrëveshje të caktuar.

Përsa i përket formës së paraqitjes së traktateve, tekstet e të drejtës humanitare janë të gjata dhe komplekse, ndërsa traktatet mbi të drejtat e njeriut janë relativisht të shkurtra dhe të thjeshta.[72] Ka gjithashtu një fenomen në të drejtat e njeriut, që nuk vërehet tek e drejta humanitare, e cila lidhet me një ekzistencë konkuruese të traktateve universale dhe atyre rajonale. Këto traktate gjithashtu bëjnë dallimin ndërmjet të ashtuquajturave "të drejta civile dhe politike" dhe "të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore".

Ndryshimi më i rëndësishëm, përsa i përket të drejtës humanitare, është fakti që përdorimi i luftës nuk është më një mënyrë ligjore e zgjidhjes së konfliktit. Në përgjithësi, e drejta humanitare sot perceptohet më shumë si një mënyrë për të larguar joluftuesit sa më shumë që të jetë e mundur nga tmerret e luftës, se sa si një kod nderi për luftuesit.

Justifikimi kryesor i zbatimit të së drejtës humanitare sot është që pjesa më e madhe e rregullave kanë si qëllim mbrojtjen e personave në nevojë në konflikt të armatosur. Nga pikëpamja e të drejtave të njeriut, përdorimi i forcës përbën në vetvete shkelje të të drejtave humane.[73]

---

71. Hans Peter Gasser, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, " E drejta ndërkombëtare humanitare", dhjetor 2000, f.99.
72. Roopam Verma, Humanitarian Laws and Human Rights Law, 2006, law.*bepress.com/cgi/viewcontent.cgi?article=4770&context.*
73. Po aty, p.4

A mund të zbatohet ligji mbi të drejtat e njeriut edhe në konflikt të armatosur? Baza filozofike e të drejtave të njeriut mbështet parimin se në sajë të faktit që njerëzit janë qënie humane, ata i gëzojnë gjithmonë të drejtat e tyre. E drejta mbi të drejtat e njeriut i mbron personat si në kohë paqe ashtu edhe në kohë lufte. Përgjigjja në një farë kuptimi është që të drejtat njerëzore vazhdojnë të aplikohen edhe në konflikt të armatosur, sepse disa prej tyre njihen si të drejta themelore. Bëhet fjalë për ato të drejta të cilat në të gjitha traktatet konsiderohen si të pacënueshme. Të drejtat themelore shtetet janë të detyruar t'i respektojnë në të gjitha rrethanat. Por, në kushte emergjence, kur kërcënohet jeta e një kombi, lejohen shmangie nga ligji mbi të drejtat e njeriut. Në situata konflikti të armatosur, e drejta e konfliktit të armatosur ka prioritet ndaj të drejtave të njeriut.[74]

4.6 SHKELJA E TË DREJTAVE NJERËZORE

Tashmë është pothuajse universal konsensusi që të gjithë individët gëzojnë disa të drejta bazë, në çfarëdolloj rrethanash, ku përfshihen liritë civile dhe të drejtat politike, më kryesore nga të cilat është e drejta e jetës dhe siguria fizike.

Nga njëra anë, të mbrosh të drejtat humane domethënë të sigurosh që njerëzit e gëzojnë trajtimin njerëzor në një shkallë të përshtatshme. Të shkelësh të drejtat njerëzore bazë, nga ana tjetër, domethënë t'ju mohosh individëve të drejtat morale themelore. Në njëfarë mënyre, ti trajtosh ata sikur janë diçka më pak se njerëz dhe nuk meritojnë respekt e dinjitet.[75]

Aktet që përfshijë genocidin, torturën, skllavërinë, përdhunimin, sterilizimin e detyrueshëm, ose eksperimentet biologjike dhe shkaktimin e vdekjes nga uria konsiderohen si "krime kundër njerëzimit".[76] Për shkak se këto politika nganjëherë zbatohen nga qeveritë, kufizimi i pushtetit të pakufizuar të shtetit është një pjesë e rëndësishme e të drejtës ndërkombëtare.

Sipas Deklaratës Universale të të Drejtave Njerëzore, të drejtat themelore humane dhunohen kur:[77]

- Një race, besimi apo feje të caktuar i mohohet njohja si e tillë, (neni 2, 6).
- Burrat dhe gratë nuk trajtohen në mënyrë të njëjtë, (neni 2).
- Grupe të ndryshme racore apo fetare nuk trajtohen njëlloj, (neni 2).
- Një person shitet ose përdoret si skllav, (neni 4).
- Kryhen ndëshkime mizore, johumane ose degraduese, siç është tortura ose ekzekutimi, (neni 5).
- Viktimave të abuzimit i mohohet një zgjidhje e drejtë ligjore, (neni 8).

74. Turkish General Staff, Ankara, Guide to the Law of Armed Conflict of Armed Forces, june 2001, f. 17.
75. Michelle Maiese, Human Rights Violations, July 2003, www.beyondintractability.org/bi-essay/human-rights-violations
76. Krimet kundër njerëzimit u njohën për herë të parë në Kartën dhe gjykimin e Gjykatës së Nurembergut. Këto krime drejtohen kundër popullsisë civile dhe janë të ndaluara pa marrë parasysh nëse kryhen në një konflikt të armatosur, ndërkombëtar ose të brendshëm. Krimet kundër njerëzimit u referohen veprimeve çnjerëzore të një karakteri tejet të rëndë, si vrasje e qëllimshme, torturë ose përdhunim, të kryera si pjesë e një sulmi në shkallë të gjerë ose sistematik kundër çdo popullsie civile mbi baza kombëtare, politike, etnike, racore ose fetare. Në konfliktin në territorin e ish-Jugosllavisë veprime të tilla çnjerëzore kanë marrë trajtën e të ashtuquajturit "spastrim etnik' dhe të përdhunimit në shkallë të gjerë, sistematik dhe të formave të tjera të sulmit seksual, duke përfshirë prostitucionin e imponuar.
77. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut,1948.

- Ndëshkimet jepen në mënyrë arbitrare, pa gjykim të drejtë dhe të përshtatshëm, (neni 11).
- Kryhen ndërhyrje arbitrare te personat ose jetët private, nga agjentët e shtetit, (neni 12).

- Qytetarëve i ndalohet të largohen ose të kthehen në vendin e tyre, (neni 13).
- Mohohet liria e fjalës ose e besimit, (neni 18, 19).
- Mohohet e drejta për arsimim, (neni 26).

Përgjegjësia për mbrojtjen e të drejtave të njeriut i takon së pari, vetë shteteve. [78] Të gjitha kombet kanë detyrimin që të promovojnë respektin botëror për të drejtat e njeriut. Megjithatë, në shumë raste, autoritetet e larta publike dhe zyrtare zhvillojnë politika që cënojnë të drejtat njerëzore themelore. Këto abuzime me pushtetin nga ana e drejtuesve politike dhe autoriteteve shtetërore, kanë efekte shkatërrimtare, duke përfshirë genocidin, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit.

Abuzimi me të drejtat njerëzore shpesh çon në konflikt dhe konflikti në shkelje të të drejtave humane. Prandaj nuk është suprizuese që abuzimet me të drejtat njerëzore janë shpesh në qendër të luftërave dhe që mbrojtja e të drejtave njerëzore është kryesore në zgjidhjen e konflikteve.

Në rastet kur kanë ndodhur shkelje ekstreme të të drejtave humane pajtimi dhe ndërtimi i paqes bëhen më të vështira. Çështjet e pazgjidhura të shkeljes së të drejtave njerëzore mund të shërbejnë si pengesa në bisedimet për paqe. Kjo për shkak se është e vështirë për palët të ecin drejt shuarjes së konfliktit dhe faljes, kur kujtimet e shkeljeve të rënda dhe barbarizmat janë ende primare në mendjet e tyre.

Shumë iniciativa paqeruajtëse dhe të parandalimit të konfliktit kanë dështuar, si në mbrojtjen e të drejtave njerëzore, ashtu dhe në dhënien e ndihmës ndaj palëve drejt zgjidhjes së konfliktit. Kjo pjesërisht është për shkak të faktit se ndërsa luftërat ndërmjet shteteve janë zhdukur, luftërat brenda shteteve janë përshkallëzuar. Genocidi, krimet kundër njerëzimit dhe agresioni kundër civilëve janë bërë pjesë qendrore e luftës në këto konflikte të brendshme. [79]

78. The Responsibility to Protect, December 2001, Report of the International Commission on Intervention and State Sovereignty. http://en.wikipedia.org/wiki/Responsibility_to_protect

79. United Nations, Department of Peacekeeping Operations, Department of Field Support (2008) United Nations peacekeeping operations. Principles and guidelines.

4.6.1 Çështja e ndërhyrjes humanitare

Ka dy lloj ndërhyrjesh humanitare, që përfshijnë forcat e armatosura. Ndërhyrjet e njëanshme nga një shtet i vetëm dhe ndërhyrjet kolektive nga një grup shtetesh. Për shkak

se pak shtete kanë forca të mjaftueshme dhe kapacitete për të ndërhyrë vetëm, pjesa më e madhe e ndërhyrjeve moderne janë kolektive.[80]

Disa mbrojnë parimet e sovranitetit shtetëror dhe mosndërhyrjen, si dhe argumentojnë që shtetet e tjera duhet të lejohen të vendosin sipas mënyrës së tyre. Ata theksojnë se parimet e sovranitetit shtetëror dhe mospërdorimit të forcës janë të ruajtura në Kartën e Kombeve të Bashkuara, e cila vlerësohet si një burim autoritar në rregullin ligjor ndërkombëtar. Sipas tyre shtetet e ndryshme kanë koncepte të ndryshme për drejtësinë dhe bashkekzistenca ndërkombëtare varet nga një etike pluraliste, sipas së cilës secili shtet mund të ruajë konceptin e tij mbi të mirën.

Sipas këtij koncepti shtetet që marrin përsipër të gjykojnë shkeljet e të drejtave të njeriut në shtete të tjera ndërhyjnë në të drejtën kombëtare të vetëvendosjes. Supozohet se duke i kërkuar një vendi të respektojë të drejtat njerëzore, ka mundësi që të krijohen fërkime që çojnë në mosmarrëveshje. Kështu, aktet e ndërhyrjes mund të përçajnë rregullin ndërshtetëror dhe të çojnë në konflikte të mëtejshme.[81] Vuajtje më të mëdha njerëzore mund të shkaktohen në qoftë se shtetet e lenë mënjanë normën e mosndërhyrjes.

Të tjerë theksojnë se ndërhyrja humanitare parimisht nuk kërcënon integritetin territorial dhe pavarësinë politike të shteteve. Më shumë se për të destabilizuar një shtet të caktuar dhe për t'u përzier në punët e tij, ndërhyrja humanitare ka për qëllim të rindërtojë shtetin ligjor dhe të çojë përpara trajtimin njerëzor të individëve.[82]

Për më tepër, përkrahësit e kësaj pikëpamjeje pretendojnë se "vetëm syri vigjilent i komunitetit ndërkombëtar mund të sigurojë ruajtjen e standardeve ndërkombëtare, në interes jo të një shteti, por të vetë individëve". Ata mbështesin pikëpamjen se shkeljet masive të të drejtave njerëzore, si genocidi dhe krimet kundër njerëzimit, lejojnë ndërhyrjen edhe nëse ajo shkakton disa tensione ose mosmarrëveshje.

Në qoftë se, përmes aksioneve të tij barbare, një shtet shkatërron jetët dhe të drejtat e qytetarëve të tij, ai përkohësisht humbet të drejtën për të pretenduar legjimitet dhe sovranitet.[83]

Qeveritë janë shpesh në dilemë për angazhim ose jo të forcave ushtarake dhe burimeve ushtarake për mbrojtjen e të drejtave njerëzore në shtete të tjera. Për më tepër përdorimi i dhunës për t'i dhënë fund shkeljeve të të drejtave njerëzore shkakton një dilemë morale për faktin se ndërhyrje të tilla mund të çojnë në humbje të mëtejshme të jetëve të pafajshme. Kështu që është e detyrueshme që të përdoret sa më pak forca e nevojshme për arritjen e objektivave humanitare dhe ndërhyrja të ketë efekte pozitive.

---

80. Michael Venthey, "International Humanitarian Law and the Restoration and Maintenance of Peace", African Review, vol 7, no.5. Institute for security Studies, 1998.
81. Helena Kennedy, "Conflict Resolution and Human Rights: Contradictory or Complementary?", May 23, 2001, www.beyondintractability.org/bi-essay/human-rights-violations
82. Antonio Cassese, Human Rights in a changing world, (Philadelphia: Temple University Press 1999).
83. Don Hubert and Thomas G. Weiss, The responsibility to protect, 2001, web.idrc.ca › Publications › IDRC Books › All our books

4.7 PËRFUNDIME

1. Neni 51 i Kartës së Kombeve të Bashkuara i rezervon shteteve të drejtën e vetëmbrojtjes. Kjo e drejtë plotëson parashikimet e nenit 42, si një përjashtim i ndalimit të përdorimit të forcës. Një shtet nuk ka nevojë për autorizim të Këshillit të Sigurimit me qëllim që të mbrohet duke përdorur forcën.

2. Forca mund të përdoret në vetëmbrojtje vetëm kundër një shteti ligjërisht përgjegjës për sulmin e armatosur. Për më tepër, çdo përdorim i forcës për vetëmbrojtje duhet të respektojë parimet e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit.

3. Karta e Kombeve të Bashkuara nuk përjashton mundësinë e veprimit të organizatave dhe institucioneve rajonale, në drejtim të ruajtjes së paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Megjithatë asnjë aksion force nuk mund të ndërmerret pa marrë më parë autorizimin e Këshillit të Sigurimit.

4. Në praktikën e tij Këshilli i Sigurimit, gjithnjë e më shumë i ka konsideruar konfliktet e brendshme dhe shkeljet në shkallë të gjerë të të drejtave njerëzore si bazë ligjore për aksion ndërkombëtar. Që nga fundi i Luftës së Ftohtë, Këshilli i Sigurimit ka vlerësuar "të drejtën për ndërhyrje humanitare", duke adoptuar një sërë rezolutash të cilat në mënyrë progresive kanë zgjeruar përkufizimin e një "kërcënimi për paqe dhe siguri ndërkombëtare", sipas nenit 39 të Kartës për të lejuar që Këshilli i Sigurimit të mandatojë ndërhyrje ushtarake në përgjigje të krizave të mëdha humanitare edhe ku kriza të tilla kanë qenë krejt të brendshme në natyrën e tyre. Kjo prirje sugjeron që parimi i mosndërhyrjes në punët e brendshme është zëvendësuar nga parimi që shkeljet masive dhe të shumëpërhapura të të drejtave të njeriut, ose të së drejtës humanitare, që burojnë nga aktet qeveritare, ose konfliktet e brendshme dhe rëndësia e vuajtjes njerëzore që ata shkaktojnë, mund të përbëjnë një kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

5. Humanitarizmi ushtarak i sotëm ndryshon nga pikëpamja dhe qëndrimet tradicionale të Kombeve të Bashkuara. Detyra kryesore e paqeruajtjes tradicionale ishte pozicionimi i trupave të Kombeve të Bashkuara ndërmjet palëve në konflikt, të cilat po prireshin drejt pushimit të zjarrit. Operacionet e sotme paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara ndryshojnë nga paqeruajtja e Luftës së Ftohtë, nga pikëpamja e parimeve, praktikës dhe mjedisit ku zhvillohen. Forcat Paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara ndërhyjnë në mes të luftërave civile më shumë se në luftërat ndërshtetërore kur ato janë duke mbaruar.

6. Një tjetër tipar i ri që paraqet paqeruajtja e sotme, në ndryshim nga ajo tradicionale është mundësia që operacionet e Kombeve të Bashkuara të fillojnë nën komandën e një kombi të vetëm dhe jo në formën e një komande kolektive të Kombeve të Bashkuara.

7. Vonesat në vendosjen e trupave paqeruajtëse në situata krizash humanitare kanë nxjerrë në pah nevojën për zhvillimin e një force ushtarake të qëndrueshme të

Kombeve të Bashkuara, si një forcë ndërkombëtare permanente e rekrutuar, e stërvitur dhe e vendosur në vendin e misionit direkt nga Kombet e Bashkuara. Kjo forcë e stërvitur e reagimit të shpejtë mund të ishte përherë në dispozicion të Këshillit të Sigurimit, e aftë për t'iu përgjigjur shpejt krizave humanitare dhe në gjendje për t'u vendosur brenda një kohe të kufizuar.

8. E drejta mbi të drejtat e njeriut i mbron personat, si në kohë paqe ashtu edhe në kohë lufte. Të drejtat njerëzore vazhdojnë të aplikohen edhe në konflikt të armatosur, sepse disa prej tyre njihen si të drejta themelore. Bëhet fjalë për ato të drejta të cilat në të gjitha traktatet konsiderohen si të pacënueshme dhe për këtë arsye shtetet janë të detyruar t'i respektojnë në të gjitha rrethanat. Megjithatë, në kushte emergjence, kur kërcënohet jeta e një kombi, lejohen shmangie nga e drejta mbi të drejtat e njeriut.

9. Përgjegjësia për mbrojtjen e të drejtave të njeriut i takon në radhë të parë vetë shteteve. Të gjitha shtetet kanë detyrimin që të promovojnë respektin botëror për të drejtat e njeriut. Por, në shumë raste, autoritetet e larta publike dhe zyrtare zhvillojnë politika që cënojnë të drejtat njerëzore themelore. Këto abuzime me pushtetin nga ana e drejtuesve politike dhe autoriteteve shtetërore, kanë efekte shkatërrimtare, duke përfshirë genocidin, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit.

10. Abuzimi me të drejtat njerëzore shpesh çon në konflikt dhe konflikti në shkelje të të drejtave njerëzore. Prandaj nuk është suprizuese që abuzimet me të drejtat njerëzore janë shpesh në qendër të luftërave dhe që mbrojtja e të drejtave njerëzore është kryesore në zgjidhjen e konflikteve.

5. REAGIMI NDËRKOMBËTAR NDAJ SHKELJEVE TË SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE HUMANITARE

5.1 SHKELJET E TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE HUMANITARE

Shkeljet e rënda[1] të së drejtës së konfliktit të armatosur vlerësohen si **krime lufte**.

Krimet e luftës janë të dënueshme si nga pikëpamja etike, morale dhe fetare, mbi bazën e faktit që ato përbëjnë shkelje të normave ligjore, rezultojnë në dëme kundrejt të pafajshmëve dhe të pambrojturve, degradojnë qëllimet dhe parimet e mira, dobësojnë disiplinën brenda forcave ushtarake, krijojnë ndjenjën e fajit tek ato që i kryejnë këto shkelje, dëmtojnë marrëdhëniet e një shteti me të tjerët dhe mund të provokojnë raprezalje nga kundërshtarët.

Shkeljet e rënda[2] janë të renditura në Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe në Protokollin e I-rë Shtesë të Gjenevës, të vitit 1977.

Ato përfshijnë:

1. Vrasjet[3] me dashje, shkaktimin me qëllim të vuajtjeve të mëdha ose dëmtimeve serioze të trupit ose shëndetit, torturën[4], ose trajtimin jonjerëzor, duke përfshirë eksperimentet biologjike, të kryera kundër personave që mbrohen nga konventat e Gjenevës dhe Protokolli i I-rë i Gjenevës.[5]
2. Shkatërrimet e gjera dhe përvetësimin e pasurisë të mbrojtura nga konventat e Gjenevës ose Protokolli i I-rë të pajustifikuara nga nevojat ushtarake dhe të zbatuara në mënyrë të paarsyeshme.

---

1. Pietro Verri, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq,"Fjalor i së Drejtës Ndërkombëtare të Konfliktit të Armatosur", Tiranë 2001, f. 134.
2. E Drejta e Konfliktit të Armatosur, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, (Përgjegjësia e Komandës), Tiranë, qershor 2002, f.3-6.
3. Vrasja është një krim i kuptuar qartë dhe i përcaktuar mirë në të drejtën e brendshme të çdo shteti. Vrasja është një krim lufte si në konfliktet e armatosura ndërkombëtare dhe në ato jondërkombëtare. Konventat e Gjenevës dhe Protokollet e tyre shtesë përdorin termin "vrasje me dashje" në kontekstin e një konflikti të armatosur ndërkombëtar, ku ajo konsiderohet si shkelje e rëndë dhe "vrasje" në kontekstin e një konflikti të armatosur të brendshëm.
4. Trajtimi johuman, shkaktimi me qëllim i vuajtjeve të mëdha ose dëmtimeve serioze të trupit ose shëndetit janë shkelje të rënda sipas Konventave të Gjenevës. Në konfliktin e armatosur të brendshëm neni 3, paragrafi 1 dhe protokolli II, neni 4 paragrafi 2, ndalon"trajtimin mizor" dhe "torturën". Tortura si në kontekstin e konfliktit të armatosur ndërkombëtar dhe jondërkombëtar ka të njëjtin kuptim.
   Tortura është penalisht e ndëshkueshme si në konfliktet e brendshme dhe në ato ndërkombëtare. Ajo përkufizohet nga Konventa mbi torturën e 1984 si "çdo akt i cili i shkakton një personi dhimbje të ndryshme ose vuajtje fizike ose mendore me qëllim që të nxirren pre tij informata, duke e ndëshkuar atë për një akt që ai ose një person i tretë ka kryer ose dyshohet të ketë kryer, ose duke frikësuar atë ose një person të tretë, ose për ndonjë arsye të bazuar mbi diskriminime të çfarëdolloji, duke i shkaktuar dhimbje ose vuajtje.
   Statuti i Gjykatës Penale Ndërkombëtare përmban përkufizimin e mëposhtëm: "Tortura nënkupton shkaktimin e qëllimshëm të dhimbjeve të ndryshme ose vuajtjeve fizike ose mendore ndaj një personi të arrestuar ose që mbahet nën kontroll.
5. Konventa e parë, nenet 49 dhe 50; Konventa e dytë, nenet 50 dhe 51; Konventa e tretë, nenet 129 dhe 130; Konventa e katërt, nenet 146 dhe 147; Protokolli I, neni 85.

3. Shkeljet e qëllimshme të Protokollit të I-rë të Gjenevës, nëpërmjet shkaktimit të vdekjes ose dëmtimit serioz dhe që rezultojnë nga sulmet kundër civilëve, zonave të pambrojtura[6], zonave të çmilitarizuara[7], ose personave që kanë dalë jashtë luftimit, humbjet e tepërta të civilëve ose objekteve civile nga sulme që nuk bëjnë

dallim ose sulme kundër veprave që përmbajnë forca të rrezikshme, keqpërdorimit të emblemës dalluese të Kryqit të Kuq, Gjysmëhënës së Kuqe ose shenjave të tjera mbrojtëse.

4. Shkeljet e qëllimshme të konventave të Gjenevës ose Protokollit të I-rë të Gjenevës, që rezultojnë nga: internimi ose transferimi i paligjshëm i popullsisë, marrja e pengjeve, vonesa e pajustifikuar në riatdhesimin e robërve të luftës ose civilëve, disa raste të dëmtimit të pasurisë kulturore të mbrojtur në mënyrë të veçantë dhe privimi i personave të mbrojtur nga e drejta e një gjykimi të drejtë.

Shkeljet serioze të rregullave dhe të zakoneve të luftës në konfliktet e armatosura të brendshme përbëjnë gjithashtu krime lufte.[8]

Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Penale për Ruandën përfshin krimet e luftës në konfliktet e armatosura të brendshme. Neni 4 i këtij statuti parashikon se gjykata ka kompetencën të përndjekë personat që kryejnë ose urdhërojnë kryerjen e shkeljeve të rënda të nenit 3, të përbashkët të katër konventave të Gjenevës dhe të Protokollit të II-të Shtesë të tyre.[9]
Këto shkelje përfshijnë por nuk kufizohen në:

a. Dhunën ndaj jetës, shëndetit dhe mirëqënies fizike ose mendore të personave në veçanti, vrasjen dhe trajtimin e egër, si përshembull, torturën, gjymtimin ose çdo formë tjetër të ndëshkimit trupor;
b. Ndëshkimet kolektive[10];
c. Marrjen e pengjeve;
d. Aktet e terrorizmit;
e. Dhunimet ndaj dinjitetit personal, në veçanti trajtimin përulës, ose poshtërues, përdhunimin, prostitucionin e detyruar dhe çdo formë sulmi të pahijshëm;

6. Këto janë vende që janë lënë me qëllim të pambrojtura në mënyrë që të ruhet popullsia civile dhe pronat e tyre nga plagosja dhe dëmtimi.Këto zona vendosen me një deklaratë të njëanshme të palës kundërshtare ose mund të jenë subjekt i një marrëveshjeje të vecantë nëse kërkohet nga të dyja palët. Në këto marrëveshje përcaktohen kufijtë e zonës së pambrojtur e cila është e hapur për pushtim dhe që forcat e armatosura të kundërshtarit mund të hyjnë dhe ta marrin. Zonat e pambrojtura janë të vendosura pranë ose brenda zonave të luftimit. Aty nuk duhet të ketë personel ushtarak, armë ushtarake dhe as pajisje ushtarake të lëvizshme. Këto zona nuk duhet të përdoren për të mbështetur operacionet ushtarake.
7. Këto janë zona ku nuk kryhen luftime, të krijuara për të mbrojtur popullsinë civile nga sulmi. Ato mund të jenë qytete ose vende, madje dhe rripa toke që ndajnë palët kundërshtare. Ato krijohen me marrëveshje ndërmjet palëve. Gjithë personeli ushtarak, pajisjet ushtarake të lëvizshme dhe armët duhet të hiqen nga këto zona, të cilat gjithashtu nuk duhet të pushtohen nga kundërshtari ose të përdoret për qëllime ushtarake.
8. Turkish General Staff, Guide to the Law of Armed Conflict of Armed Forces, Ankara, June 2001.
9. Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Penale të Ruandës, neni 4.
10. Ndëshkimet kolektive, neni 33 i katër konventave të Gjenevës dhe neni 4, paragrafi 2 i Protokollit të dytë shtesë ndalon ndëshkimet kolektive, të cilat përkufizohen si"ndëshkime të çdo lloji të dhëna ndaj personave ose grupeve të tëra në kundërshim me parimet themelore humanitare, për akte që këto persona nuk i kanë kryer".

f. Plaçkitjen;
g. Dhënien e dënimeve dhe kryerjen e ekzekutimeve pa patur një vendim gjyqësor të shpallur më parë nga një gjykatë e krijuar në mënyrë të rregullt, që siguron të gjitha garancitë gjyqësore që njihen si të domosdoshme nga popujt e qytetëruar;
h. Kërcënimet për të kryer çdonjërin prej akteve të mësipërme.

Në përkufizimin e tij të krimeve të luftës Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Penale të Romës përfshin edhe shkeljet e rënda të nenit 3 të Përbashkët për Konventat e Gjenevës dhe shkelje të tjera të rënda të ligjeve dhe rregullave të zbatueshme në konfliktet e armatosura të brendshme.

5.1.1 Raprezalja

Raprezaljet janë shkelje të ligjit nga një palë, si përgjigje e një shkelje nga një kundërshtar. Qëllimi i vetëm i një raprezalje është ta detyrojë kundërshtarin të pushojë aktivitetin e tij joligjor dhe t'i përmbahet të drejtës së luftës.

Raprezalja është një masë që konsiston në një akt i cili në rrethana të tjera do të ishte i paligjshëm, por që justifikohet si përgjigje ndaj akteve joligjore të armikut. Përdorimi i raprezaljes për të ndëshkuar palët përgjegjëse për shkeljet e ligjit është i ndaluar.

Të gjitha Konventat e Gjenevës të vitit 1949, i ndalojnë raprezaljet kundër respektivisht: fatkeqësive në fushën e betejës, të mbijetuarve nga mbytja e një anije, robërve të luftës dhe civilëve, si dhe kundër disa ndërtesave dhe pasurisë. Në protokollin e vitit 1977 zgjerohet kjo sferë mbulimi duke u shtrirë edhe mbi monumentet historike, veprat e artit dhe vendet e adhurimit.

Sipas të drejtës ndërkombëtare raprezaljet mund të ndërmerren kundër forcave të armatosura kundërshtare.[11] Mundësia e raprezaljeve është shumë e kufizuar[12] nga e drejta humanitare. Raprezaljet mund të urdhërohen vetëm në rrethana të kufizuara:

- Raprezalja duhet të urdhërohet nga autoritetet më të larta politike ose ushtarake të palës luftuese.
- Duhet t'i përgjigjet akteve joligjore të luftës të kryera nga pala kundërshtare, drejtuesit e saj ushtarakë, apo ushtarët për të cilët kjo palë është përgjegjëse. Raprezalja nuk mund të bazohet në hamendësi.
- Kur është e mundur, raprezalja duhet paraprirë nga një kërkesë drejtuar kundërshtarit që ai të tërhiqet nga aktet e tij joligjore.
- Qëllimi i raprezaljes duhet të jetë detyrimi i kundërshtarit që të pushojë aktivitetin e paligjshëm. Raprezalja nuk mund të ndërmerret për arsye hakmarrjeje.
- Raprezalja duhet përdorur si mundësi e fundit kur të gjitha masat e tjera kanë dështuar apo nuk kanë patur dobi.
- Çdo raprezalje duhet të jetë në proporcion me shkeljen fillestare të kryer nga kundërshtari.
- Raprezalja duhet të ndërpritet menjëherë sapo kundërshtari të tërhiqet nga veprimet e tij joligjore dhe vendos të zbatojë të drejtën e konfliktit të armatosur.

11. Konventa e parë, neni 46; Konventa e dytë, neni 47; Konventa e tretë, neni 13; Konventa e katërt, neni 33.
12. Protokolli i I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës, 12 gusht 1949, neni 51 ,52.

Praktikisht, pak shtete kryejnë raprezalje të tilla, për arsye se raprezaljet mund të çojnë në rritje të raprezaljeve dhe më vonë në kundër-raprezalje të cilat janë në dëm të të dyja palëve ndërluftuese.

5.2 PËRGJEGJËSIA PENALE NDËRKOMBËTARE SIPAS TË DREJTËS

NDËRKOMBËTARE

Gjatë luftës civile amerikane, (1861-1865), Presidenti Abraham Linkoln nxori në qarkullim Kodin e Lieberit, (instruksione për drejtimin e ushtrive të Shteteve të Bashkuara në fushën e betejës, General Orders Nr.100, 24 prill 1863).[13] Ky tekst i përgatitur nga Francis Lieber, profesor i të drejtës në Kolegjin Columbia në Nju York dhe i rishikuar nga një bord oficerësh, përfaqëson një ndër përpjekjet e para drejt kodifikimit të së drejtës së luftës.

Sipas nenit 44, të kodit të Lieberit "çdo shkelje e paarsyeshme e kryer kundër personave në vendet e pushtuara, shkatërrimet e pasurisë, grabitjet, plaçkitjet" dhe "përdhunimet, plagosja, gjymtimi ose vrasja e këtyre banorëve", janë të ndëshkueshme. Në nenin 47 të po këtij kodi, "krimet e ndëshkueshme nga çdo kod penal si "vënia e zjarrit, vrasja, gjymtimi, sulmimet, grabitjet në rrugë, vjedhjet, mashtrimi, falsifikimi dhe përdhunimi" të kryera nga një ushtar amerikan në territorin e një shteti armik konsiderohen si të kryera në vendin e tij dhe ndëshkohen rëndë. Megjithëse ishte i destinuar vetëm për ushtarët amerikanë dhe vinte detyrime vetëm mbi ta, kodi i Lieberit gjithashtu pati influencë të rëndësishme në rregullimet ushtarake të ushtrive të tjera.

Një hap i mëtejshëm në drejtim të ngarkimit me përgjegjësi të personave për shkelje të së drejtës së luftës u bë në shekullin e njëzetë. Pas Luftës së Parë Botërore, Traktati i Parë i Versajës i 28 qershorit 1919, në nenet e tij 228 dhe 229, krijoi të drejtën e Fuqive Aleate të kërkojnë dhe të ndëshkojnë individët përgjegjës për "shkelje të ligjit dhe zakoneve të luftës". Në veçanti, neni 228 deklaronte që "Qeveria gjermane njihte të drejtën e aleatëve për të sjellë para gjyqit ushtarak persona të akuzuar për kryerjen e akteve që përbëjnë shkelje të ligjeve dhe zakoneve të luftës".[14]
Konventat e Hagës të vitit 1899 dhe 1907, si dhe Konventa e Gjenevës e vitit 1929, që kishte të bënte me trajtimin e robërve të luftës përmbanin parashikime mbi ndëshkimin e individëve që shkelnin rregullat e tyre.

Krimet e tmerrshme të kryera nga nazistët dhe japonezët gjatë Luftës së Dytë Botërore çuan në një konkluzion të shpejtë të lidhjes së marrëveshjeve ndërmjet fuqive aleate dhe në krijimin më pas të gjykatave ndërkombëtare ushtarake të Nurembergut dhe të Tokios për gjykimin e kriminelëve të luftës.[15]

13. Edoardo Greppi, ICRC, The evolution of individual criminal responsibility under international law, September 1999, Vol 81, Nr. 835, f.535.
14. Po aty, f.535.
15. Agreement for the Prosecution and Punishment of the Major War Criminals of the European Axis, Charter of the International Military Tribunal, 8 August 1945, 82 UNTS, p.280. Judgment of the International Military Tribunal at Nuremberg in Nazi Conspiracy and Aggression, Opinion and Judgment (1947).

Në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, fuqitë aleate fitimtare filluan bisedimet për të përcaktuar masat që do të merreshin kundër kriminelëve të luftës. Filloi në këtë mënyrë debati rreth çështjes nëse e drejta ndërkombëtare mund të shtrijë veprimin e saj drejtpërdrejt mbi persona të veçantë.

Në zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare, në drejtim të ngarkimit me përgjegjësi të personave të veçantë etapë të re përfaqësojnë gjyqet e Nurenbergut e të Tokios.

Deri në këtë pikë e drejta ndërkombëtare ka mbrojtur sovranitetin e shtetit, i cili mund të bëjë çfarë të dojë me popullin e tij. Kështu kur qeveria gjermane vendosi të vrasë të gjithë çifutët gjermanë, (si dhe çifutët e vendeve të tjera), kjo ishte një punë e brendshme e Gjermanisë. Ishte e para thyerje kur Nurembergu tha "Jo më. Ne ju kemi paralajmëruar".[16] Ishte e shkruar në një mori traktatesh që lufta nuk është e ligjshme. Ata që mbanin përgjegjësi u dënuan nga një gjykatë e përbërë nga juristë të shkëlqyer, të cilët shpjeguan bazat e juridiksionit të tyre dhe faktin se nuk ishte ligji i pasluftës dhe as drejtësia e të fituarve kundër të mundurve që i dënoi, por shkeljet e tyre ligjore.

Për herë të parë në nenin 7 të marrëveshjes mbi ngritjen e Gjyqit të Nurenbergut, nga katër Fuqitë e Mëdha (SHBA, BS, Britania e Madhe dhe Franca), u vendos që: "Pozita zyrtare e të pandehurve, qofshin edhe kryetarë shtetesh apo zyrtarë të lartë të dikastereve qeveritare, nuk do të merret si një rrethanë që i liron ata nga përgjegjësia ose që zbut masën e dënimit".

Në vendimin e gjyqit të Nurenbergut thuhet: "Krimet kundër të drejtës ndërkombëtare kryhen nga njerëz, jo nga entitete abstrakte, dhe vetëm duke ndëshkuar individët që kryejnë krime të tilla mund të vihen në vend normat e së drejtës ndërkombëtare".[17]

Zhvillimi i së drejtës ndërkombëtare në drejtim të ngarkimit me përgjegjësi direkte të individëve të veçantë vazhdoi me Konventën kundër genocidit, që u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, në Dhjetor 1948.

Në nenin 4 të Konventës u vu theksi te përgjegjësia individuale dhe u theksua se personat që kryejnë krimin e genocidit duhet të ndëshkohen, "qofshin ata qeveritarë të përgjegjshëm në bazë të kushtetutës, persona zyrtarë apo individë private". Zhvillime të reja janë edhe ngjarjet e Bosnjës, kur liderë civilë dhe ushtarakë serbë u vunë përpara përgjegjësisë penale ndërkombëtare në Gjykatën e Hagës, në vitet '90.

Pra mund të themi se në kohën e sotme përgjegjësia kolektive i ka lënë vendin përgjegjësisë individuale të udhëheqësve të shteteve fajtorë për një kategori të caktuar krimesh, krime në shkallë ndërkombëtare që i kapërcejnë kufijtë e kriminalitetit brenda për brenda shteteve.

16. B. B. Ferenez, The development of Interntational Law and Human Rights Law, p.43.
17. Arben PUTO, E drejta Nderkombetare Publike, Tirane 2002, f.100.

5.2.1 Evolucioni i rregullave mbi përgjegjësinë individuale penale, sipas të drejtës ndërkombëtare.

Ekzistonte më parë pikëpamja e përgjithshme se individët nuk mund të jenë subjekte të së drejtës ndërkombëtare. Sot pranohet që individët mund të jenë subjekte të disa të drejtave dhe detyrimeve të caktuara sipas të drejtës ndërkombëtare, por në mënyrë më të kufizuar se shtetet.

Gjykatat e krijuara për gjykimin e krimeve të luftës në Nurenberg dhe Tokio, pas Luftës së Dytë Botërore vlerësuan se individë të caktuar mund të jenë direkt përgjegjës për krime të kryera sipas të drejtës ndërkombëtare dhe nuk mund të kërkojnë pafajësi duke pretenduar se kanë vepruar në përputhje me të drejtën e tyre të brendshme. Këto gjykata u pasuan nga gjykatat ad - hoc për ish-Jugosllavinë dhe Ruandën. Ndërsa Gjykata Ndërkombëtare Penale ka juridiksion, siç përcaktohet në statutin e saj mbi individët, për genocid, krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.[18]

Neni 6 i Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare Ushtarake të Nurembergut përcaktoi bazën ligjore për gjykimin e individëve të akuzuar për aktet e mëposhme:

- Krimet kundër paqes: Planifikimi, përgatitja, fillimi ose kryerja e një lufte agresive, ose e një lufte në shkelje të traktateve ndërkombëtare, marrëveshjeve ose pjesëmarrja në një plan të përbashkët, ose bashkëpunimi për kryerjen e akteve të mësipërme.
- Krimet e luftës: Shkeljet e ligjeve dhe zakoneve të luftës, ku përfshihen vrasja, keqtrajtimi ose dërgimi në punë skllavëruese të popullsisë civile të territoreve të okupuara, vrasja ose keqtrajtimi i robërve të luftës ose i personave në dete, vrasja e pengjeve, plaçkitja e pasurisë publike ose private, shkatërrimet e paarsyeshme të qyteteve ose fshatrave, ose shkatërrimet e pajustifikuara nga nevojat ushtarake.
- Krimet kundër njerëzimit: Vrasja, shfarosja,[19] skllavërimi, internimi dhe akte të tjera jonjerëzore të kryera kundër popullsisë civile përpara, ose gjatë luftës ose persekutimi[20] mbi baza politike, racore ose fetare në lidhje me çdo krim brenda juridiksionit të gjykatës, që ka ose jo lidhje me shkeljen e të drejtës së brendshme të vendit ku kryhet shkelja.

Në 9 Dhjetor 1948, në prag të adoptimit të Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut, një zhvillim i rëndësishëm i konceptit të krimeve kundër njerëzimit çoi në adoptimin e Konventës mbi Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Genocidit. Konventa, e cila hyri në fuqi më 12 janar 1951, e klasifikoi genocidin e kryer në kohë paqe ose lufte si një krim ndërkombëtar.

---

18. Matt Fawkner, Charter Garraway, Michael Schmitt, International Military Course on the Law of Armed Conflict,2000, p.9.
19. Shfarosja interpretohet normalisht si vrasje në shkallë të gjerë. Komisioni Ndërkombëtar i Ligjeve i Kombeve të Bashkuara e ka shpjeguar ndryshimin mes vrasjes dhe shfarosjes si më poshtë: shfarosja është një krim i cili nga natyra e tij drejtohet kundër një grupi individësh. Akti i shfarosjes përfshin një element të shkatërrimit në masë i cili nuk kërkohet për vrasjen. Ndryshe nga genocidi, shfarosja zbatohet në situata në të cilat disa pjesëtarë të grupit vriten ndërsa të tjerëve i kursehet jeta.
20. Termi persekutim nuk ka qenë asnjëherë i përkufizuar saktë në të drejtën ndërkombëtare penale, por megjithatë ai konsiderohet se mbulon çdo privim të rëndë dhe të qëllimshëm të të drejtave themelore të anëtarëve të një grupi të identifikueshëm. Statuti i Gjykatës Penale Ndërkombëtare e përkufizon persekutimin si "privim i rëndë dhe i qëllimshëm i të drejtave themelore në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare për shkak të identitetit të grupit, mbi baza politike, racore, nacionale, etnike, kulturore, religjioze ose mbi baza të tjera që njihen përgjithësisht si të palejueshme nga e drejta ndërkombëtare.

Neni 2 i kësaj konvente e përcakton genocidin si "akt i kryer me qëllim për të shkatërruar tërësisht ose pjesërisht një grup kombëtar, etnik, racor a fetar", (siç janë vrasja e anëtarëve të grupit, cënimi i rëndë i integritetit fizik a mendor të anëtarëve të grupit, nënshtrimi me vetëdije i grupit në kushte të tilla jetësore që çojnë në shkatërrimin e tij fizik të plotë a të pjesshëm, masat që synojnë pengimin e lindjeve brenda grupit, transferim i detyruar i fëmijëve të një grupi në një grup tjetër).

Neni 4 i Konventës mbi Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Genocidit vendos obligimin për të ndëshkuar jo vetëm drejtuesit ose zyrtarët publikë, por gjithashtu edhe personat privatë, ndërsa neni 6 u jep kompetencë gjykatave kompetente të shtetit në territorin e të cilit është kryer vepra dhe gjykatave penale ndërkombëtare për gjykim të atyre që kanë kryer krimin e genocidit.

Konventa e Hagës e 14 Majit 1954 "Për Mbrojtjen e Pasurisë Kulturore në Rast Konflikti të Armatosur", i detyron palët kontraktuese që të mbrojnë atë që quhet "pasuri kulturore e të gjithë njerëzimit". Palët kontraktuese duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm brenda kuadrit të tyre penal të brendshëm për të vendosur sanksione penale, ose disiplinore ndaj personave që kryejnë ose urdhërojnë kryerjen e shkeljeve të Konventës.

Një hap i rëndësishëm në procesin e gjatë të zhvillimit të rregullave mbi përgjegjësinë individuale penale sipas të drejtës ndërkombëtare u ndërmor me ngritjen e dy gjykatave ad-hoc për ndjekjen e krimeve të kryera respektivisht në ish-Jugosllavi dhe në Ruanda. Këto gjykata përfaqësojnë një progres të madh në drejtim të institucionalizimit të një juridiksioni permanent.

Nenet 2, 3, 4 dhe 5 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë paraqesin një listë të krimeve të ndryshme që janë në juridiksionin e kësaj gjykate. Neni 2 i jep gjykatës të drejtën të gjykojë personat që kanë kryer shkelje ose kanë urdhëruar shkeljet e parashikuara si shkelje të rënda në Konventat e Gjenevës të vitit 1949. Neni 3 shkon më tutje, duke përfshirë edhe shkeljet e ligjeve dhe zakoneve të luftës. Neni 4 riprodhon nenet 2 dhe 3 të Konventës së vitit 1948 mbi genocidin. Neni 5 e autorizon gjykatën të ndjekë persona përgjegjës për krime të kryera kundër civilëve në konfliktet e armatosura ndërkombëtare ose të brendshme.

Statuti i Gjykatës së Ruandës paraqet disa ndryshime, por parashikimet e tij të përgjithshme nuk paraqesin ndryshime thelbësore.

Ky korpus i madh parimesh dhe rregullash, gjithë kjo trashëgimi ligjore tashmë është kodifikuar në mënyrë organike në një instrument të vetëm, në Statutin e Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare, të adoptuar nga Konferenca Diplomatike e Kombeve të Bashkuara në 17 korrik 1998.

Nenet 5 deri 8 të Statutit merren me përkufizimin e krimeve që janë në juridiksionin e kësaj gjykate. Ato janë "krimet më serioze" dhe lidhen "me komunitetin ndërkombëtar në tërësi", (neni5). Ky është një përkufizim i plotë i cili përfshin si "shkeljet e rënda" ashtu dhe "dhunimet serioze" të konventave të Gjenevës dhe të ligjeve e zakoneve të luftës në përgjithësi.
Statuti i Romës ka adaptuar një tipologji të re krimesh me katër kategori në vend të tre kategorive të mëparshme[21]:

a. genocid,
b. krime kundër njerëzimit,
c. krimet e luftës dhe
d. krimet e agresionit.

Struktura e nenit 7 të këtij statuti, me dy pjesët e tij, reflekton një risi. Pjesa e parë rendit aktet që përbëjnë krime kundër njerëzimit dhe e dyta jep përkufizimet e disa prej tyre. Përfshirja e vrasjes, shfarosjes, skllavërimit dhe transferimit konfirmon trashëgiminë nga Nurembergu. Ajo që në Kartën e Nurembergut përgjithësohet si "akte të tjera johumane[22] të kryera kundër një popullsie civile", në Statutin e Romës bëhet një listë aktesh që merr për bazë eksperiencën dramatike të popullsisë në 50 vitet e fundit, si në konfliktet ndërkombëtare dhe në ato të brendshme, si dhe në kohët e ashtuquajtura paqe[23], ku përfshihen:

1. burgosja ose çdo privim tjetër i lirisë në shkelje të rregullave themelore të të drejtës ndërkombëtare,
2. tortura,
3. përdhunimi,
4. detyrimi për prostituim,
5. shtatëzania e detyruar,
6. sterilizimi i detyruar,
7. çdo lloj tjetër forme e dhunës seksuale e një rëndësie të ngjashme,
8. aparteidi.[24]

21. Edoardo Greppi, The evolution of individual criminal responsibility under international law, september 1999, vol 81, Nr.835, p.544.
22. Kategoria e "akteve të tjera johumane, siguron që forma të reja krimesh kundër njerëzimit nuk do t'i shpëtojnë përgjegjësisë penale ndërkombëtare. Aktet e tjera johumane përfshijnë vetëm aktet që kanë natyrë të ngjashme me ato të përmendura më parë, si vrasja, shfarosja, skllavërimi, transferimi dhe tortura. Këto akte duhet të shkaktojnë dëmtime fizike ose mendore të qënieve njerëzore, ose të cënojnë dinjitetin njerëzor. Në Statutin e GJ.P.N. aktet e tjera johumane janë përmendur në fund të listës së krimeve kundër njerëzimit. Privimi nga asistenca humanitare mund të jetë një shembull i një akti johuman, n.q.s. ai me qëllim shkakton vuajtje të mëdha ose dëmtime serioze të trupit, të shëndetit fizik ose mendor.
23. Edoardo Greppi, The evolution of individual criminal responsibility under international law, september 1999, vol 81, Nr.835, f.546.
24. Pietro Verri, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq," Fjalor i së Drejtës Ndërkombëtare të Konfliktit të Armatosur", Tiranë 2001, f. 22.

5.2.2 Përgjegjësia për kryerjen e krimeve të luftës

5.2.2. a Përgjegjësia e çdo komandanti

Pjesëtarët e forcave të armatosura, në poste komandimi kanë për detyrë[25]

a) Të mbajnë disiplinë të rreptë por të drejtë.

b) Të përgatisin personelin nën komandën e tyre për zbatimin e rregullave të së drejtës së konfliktit të armatosur në përputhje me pozitën dhe misionin e tyre.[26]
c) Të japin urdhra të ligjshëm dhe të shprehur qartë.
d) Të marrin vetë përgjegjësinë për vendime të vështira.
e) Të sigurojnë zbatimin e urdhërave në mënyrë të ligjshme nga vartësit e tyre.
f) Të raportojnë për çdo shkelje të kryer në zinxhirin e komandimit.

Vetë komandanti duhet të sigurohet që:

a. vartësit e tij janë të ndërgjegjshëm për detyrimet e tyre, në bazë të rregullave të luftës;
b. janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar shkeljet e rregullave të luftës.

5.2.2. b Përgjegjësia personale për krimet e luftës

Në aktet ndërkombëtare përgjegjësia personale[27] për krimet e luftës trajtohet si më poshtë:

Neni 7 i Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish - Jugosllavinë dhe neni 6 i Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale për Ruandën, parashikojnë që një person i cili planizon, nxit, urdhëron, kryen ose në njëfarë mënyre mbështet planizimin, përgatitjen ose ekzekutimin e një krimi, duhet të përgjigjet individualisht për krimin.

Neni 25 i Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale (të Romës), konfirmon se një individ është përgjegjës për një krim lufte në qoftë se ai:

a. Urdhëron, përkrah, ose nxit një krim që është kryer, ose që u përpoqën ta kryejnë.

b. Kontribuon në kryerjen, ose përpjekjet për të kryer një krim nga një grup personash duke vepruar me një qëllim të përbashkët me ta.

25. Manual model "Mbi të drejtën e konfliktit të armatosur", Libri A, kreu 1 – 9, f.9.
26. KGJ I-IV, neni 1; P I, neni 1.
27. Çdo pjesëtar i forcave të armatosura ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për shkeljet e kryera prej tij. (H IV, neni 3; KGJ I, nenet 47, 49-51; KGJ II, nenet 48, 50-52; KGJ III, nenet 127, 129-131; KGJ IV, nenet 144, 146-148; P I, nenet 83, 85-87, 91; P II, neni 15).

5.2.2. c Përgjegjësia e drejtuesve për krimet e kryera nga vartësit e tyre

Neni 28 i Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale e trajton përgjegjësinë e komanduesve si më poshtë:

Një drejtues ushtarak do të jetë përgjegjës për krimet e kryera nga forcat nën komandën e tij, ose nën kontrollin, ose autoritetin e tij efektiv në këto raste:

1. Kur drejtuesi ushtarak e dinte, ose sipas rrethanave të kohës, duhet ta dinte që forcat po kryenin krime të tilla.

2. Kur drejtuesi ushtarak nuk merr të gjitha masat e nevojshme dhe të arsyeshme, brenda pushtetit të tij, për të parandaluar, ose shtypur kryerjen e krimeve, ose t'ja paraqiste çështjen për shqyrtim autoriteteve kompetente për hetim ose ndjekje penale.

Pra, është e qartë se komandanti mban përgjegjësi penale në rast se merr pjesë vetë në kryerjen e një krimi lufte (përgjegjësi individuale). Por edhe në rast se nuk merr pjesë drejtpërdrejt, fakti që shkelja kryhet nga një vartës nuk e liron eprorin nga përgjegjësia në rast se ai e dinte, ose duhej ta kishte ditur sipas rrethanave në atë kohë, se po kryhej kjo shkelje dhe nuk ka bërë asgjë për ta parandaluar atë, ose për ta nxjerrë autorin para drejtësisë.

Përgjegjësia mund t'i vishet komandantit[28] edhe në rast se ai nuk ka pasur faktikisht dijeni për veprimet e vartësve të tij por duhej të kishte pasur dijeni për to. Dështimi i tij në këtë drejtim përbën mospërmbushje të detyrës nga ana e tij, për shembull, nëse ai është njoftuar por nuk arrin të bëjë asgjë për këtë. Mosndëshkimi i krimeve të luftës të kryera nga personat nën komandën e tij mund ta bëjë komandantin palë në këto krime sepse ai dështon në këtë rast në përmbushjen e detyrimit të tij për të gjykuar dhe ndëshkuar autorët ose për të raportuar tek autoritetet kompetente për shkeljet. Mosmarrja e masave për ndëshkimin e atyre që shkelin rregullat e luftës, në qoftë se përsëritet në mënyrë të vazhdueshme krijon klimën e mospërfilljes të së drejtës së konfliktit të armatosur.

Ndonjëherë një komandant i ndërmjetëm anashkalohet dhe urdhërat kalohen drejtpërdrejt nga një komandant i lartë tek njësia më e ulët. Përgjegjësia e komandantit të ndërmjetëm do të ishte e padiskutueshme në rast se do t'i kishte përcjellë urdhërat vetë, ose në rast se do t'i kishte zbatuar në ndonjë mënyrë tjetër.

28. Protokolli i I-rë Shtesë i konventave të Gjenevës, 12 gusht 1949, nenet 86, 87.

5.2.2. d Përgjegjësia e oficerëve të shtabit

Oficerët e shtabit, ndonëse ata nuk kanë përgjegjësi të komandimit operacional, ata përsëri kanë përgjegjësi penale, nëse vihen në dijeni për krimet e luftës që ndodhin ose që kanë ndodhur dhe që nuk i parandalojnë ato ose nuk i raportojnë tek superiorët e tyre.[29]

Një person është fajtor për një krim lufte, vetëm në qoftë se ai e kryen atë me qëllim dhe dijeni.[30]

Gjykata Penale Ndërkombëtare specifikon që një person i akuzuar mund të dënohet për shkeljen e tij në qoftë se ajo është kryer me qëllim dhe dijeni. Një i akuzuar ka qëllim në qoftë se përsa i përket sjelljes, ai ka për qëllim të kryejë atë sjellje ose veprim dhe përsa i përket pasojës, ai ka si qëllim të shkaktojë atë pasojë ose është i ndërgjegjshëm që ajo mund të ndodhë në rrjedhën e zakonshme të ngjarjeve.

Natyra e luftës e bën disiplinën ushtarake të detyrueshme. Kjo do të thotë se çdo pjesëtar i forcave të armatosura është i detyruar që t'i bindet urdhërave. Se cili është detyrimi i ushtarit kur këto urdhëra janë joligjore, kjo është një çështje shumë më e vështirë në praktikë, sesa në teori. [31] Një ushtar, i cili zbaton një urdhër që konsiderohet i paligjshëm sipas të drejtës së konfliktit të armatosur është fajtor i një krimi lufte, duke menduar se ai ishte i ndërgjegjshëm për rrethanat në të cilat është dhënë urdhëri i jashtëligjshëm. Kjo është një çështje shumë e thjeshtë për t'u thënë, por është shumë e vështirë për ushtarët që faktikisht duhet të zbatojnë urdhërin.[32] Do të thotë që ata duhet t'i refuzojnë komandantit nëse ata besojnë që urdhëri është i paligjshëm. Ushtarët duhet të jenë besnikë dhe të bindur ndaj komandantëve të tyre, megjithatë ata kanë edhe detyrimin tjetër të besnikërisë së qartë dhe të lartë ndaj shtetit dhe ligjeve të tij.

Sipas të drejtës ndërkombëtare çdo njeri ka për detyrë të mos pranojë t'i bindet një urdhëri për kryerjen e një shkeljeje të së drejtës së konfliktit të armatosur.

Fakti që një ushtar ka vepruar në bazë të urdhërave të një eprori nuk e liron atë nga përgjegjësia vetjake në rast se, për pasojë, ai kryen një krim lufte,[33] ndonëse këto urdhra mund të jenë të rëndësishme për të vërtetuar se ai kishte një qëllim kriminal, ose kjo mund të jetë e rëndësishme në mbrojtje që lidhen me gabimin faktik ose kanosjen dhe mund të merren parasysh në zbutjen e masës se dënimit.

---

29. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, E Drejta e Konfliktit të Armatosur, (Përgjegjësia e Komandës), Tiranë, qershor 2002, f. 5-6.

30. Turkish General Staff, Guide to the law of Armed Conflict of Armed Forces, Ankara, June 2001, p.180.

31. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, E Drejta e Konfliktit të Armatosur, (Përgjegjësia e Komandës), Tiranë, qershor 2002, f. 4-6.

32. Manual model "Mbi të drejtën e konfliktit të armatosur", Libri B, kreu 23 - 25, f. 69.

33. Statute of the International Criminal Court, done at Rome on 17 July 1998, neni 33.

5.3 KUNDËRVEPRIMI NDAJ SHKELJES SË NORMAVE TË SË DREJTËS HUMANITARE

Kapitulli VII, mbi operacionet e zbatimit të paqes nuk duhet ngatërruar me paqeruajtjen sipas kapitullit VI të Kartës.[34] Forcat ushtarake angazhohen në paqeruajtje vetëm me pëlqimin e shtetit pritës dhe përgjithësisht nuk janë të autorizuara të përdorin forcën përveçse në rast vetmbrojtje. Në të kundërt, kapitulli VII lejon Këshillin e Sigurimit të autorizojë operacione për ruajtjen e paqes dhe sigurisë pa pëlqimin e shtetit ku do kryhet operacioni duke përfshirë edhe përdorimin e forcës.

Bërja e dallimit ndërmjet operacioneve detyruese "të zbatimit të paqes" dhe operacioneve konsensuale "të ruajtjes së paqes" është shumë e nevojshme.

Misionet "e zbatimit të paqes" janë ato në të cilat ndërhyhet duke hyrë në një zonë luftimi, ku një ose më shumë palë të një konflikti janë të përfshira në dhunë, me qëllim që të ndalohen luftimet, si dhe të stabilizohet situata. Të dallosh "zbatimin e paqes" nga format e tjera të ndërhyrjes, siç janë "paqeruajtja" dhe "ndërtimi i paqes" është njëkohësisht e nevojshme dhe çorientuese. Eshtë e nevojshme sepse dështimi në njohjen e kërkesave detyruese të një operacioni të "zbatimit të paqes", (si dhe dështimi në sigurimin e mjeteve të nevojshme dhe mandatit për t'u marrë me një ambjent të tillë), është baraz me një fatkeqësi që kërcënon sigurinë si të ndërhyrësve ashtu edhe të popullsisë lokale. Zbatimi i paqes është një mision ushtarak i fuqishëm dhe duhet trajtuar si i tillë. Mosmarrja parasysh e një gjëje të tillë mund të çojë në tragjedi.

Në të njëjtën kohë, përfytyrimi se ekziston një humnerë e dukshme ndërmjet paqeruajtjes dhe zbatimit të paqes është çorientues, sepse dështon në njohjen e skenareve të panumurta që munden shumë shpejt të çojnë një forcë ndërhyrëse jo detyruese, (paqeruajtëse) në mes të një konflikti të rifilluar. Kjo mund të ndodhë kur një ose disa palë shkelin marrëveshjen e paqes.

Proçesi i autorizimit të përdorimit të forcës, sipas kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, vjen pas konstatimeve të Këshillit të Sigurimit për kërcënime të paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. P.sh. në 2 gusht 1990, në ditën kur Iraku pushtoi Kuvajtin, Këshilli i Sigurimit e deklaroi këtë veprim si një shkelje dhe i kërkoi Irakut të tërhiqet. [35]

Pas kësaj, në 6 gusht 1990, Këshilli i Sigurimit i kërkoi shteteve anëtare të ndalonin importimin ose eksportimin e mallrave me Irakun ose Kuvajtin.[36] Megjithatë nuk u autorizua përdorimi i forcës për zbatimin e embargos deri pas disa javëve.

---

34. Michael Schmitt, The use of force in International Law, 1999, p.1.
35. Në luftën mes Kuvaitit dhe Irakut, forca shumëkombëshe veproi sipas Kapitullit VII. Megjithatë operacioni, nuk ishte nën komandën dhe kontrollin e Kombeve të Bashkuara.
36. Security Council resolution 661 (1990), 666 (1990), and 687 (1991), para. 20-29, and others. Përsa i përket sanksioneve ekonomike dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare shih, N. Schrijver, "The use of economic sanctions by the UN Security Council: an International law perspective", and comments by V. Gowlland-Debbas, H.P. Gasser and K. Wellens, in H.H.G. Post (ed.), International economic law and armed conflict, Dordrecht/Boston/London (1994), pp. 123-182.

Nëqoftëse Këshilli i Sigurimit vendos që masat sipas nenit 41 nuk kanë qënë të suksesshme atëherë ai, në përputhje me nenin 42, ndërmerr veprime nga ajri, deti ose toka në përputhje me nevojat e ruajtjes ose rindërtimit të paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Në këtë mënyrë Këshilli i Sigurimit mund të angazhojë trupa nën komandën e Kombeve të Bashkuara (Helmetat Blu), ose t'i japë mandat një shteti të kryejë veprime. Në përgjigje të pushtimit të Kuvajtit, Këshilli i Sigurimit aprovoi Rezolutën Nr. 678, më 29 nëntor 1990.[37] Duke cituar kapitullin VII, ai autorizoi shtetet anëtare të përdornin të gjitha mjetet e duhura për të përzënë Irakienët n.q.s. ata nuk largoheshin deri më 15 janar 1991. Kur Iraku nuk e zbatoi urdhërin, forcat e koalicionit sulmuan në 17 janar.[38]
Ndërsa qëllimi i operacionit të zbatimit të paqes është zakonisht ndërprerja e luftimeve, kjo nuk barazohet me krijimin e kushteve për një paqe afatgjatë. Arsyeja kryesore që ndërhyrja ushtarake dështon në arritjen e zgjidhjes së konfliktit në pjesën më të madhe të rasteve është se ajo merret me simptomat e konfliktit (luftimin), pa u marrë me shkaqet e vërteta që çojnë në fillimin e dhunës. Është e rëndësishme të kujtojmë se konflikti i brendshëm është "një problem politik, ekonomik dhe social" dhe se zgjidhja e vërtetë e konfliktit kërkon që të merresh me këto shkaqe bazë. Ndërsa ndërhyrja ushtarake mund të ketë sukses në ndalimin e përkohshëm të luftimit dhe shtypjen e dhunës, kjo nuk do me thënë se u zgjidh konflikti.

Ndërhyrje ushtarake të suksesshme quhen ato të cilat prodhojnë një paqe afatgjatë, madje edhe pas lëvizjes (ose zvogëlimit të dukshëm) të aparatit ndërkombëtar të sigurisë. Në realitet disa situata luftërash civile janë të tilla që shkatërrimi bëhet aq i tmerrshëm, (siç është një fushatë genocidi), sa që ndërhyrja edhe në qoftë se dështon në arritjen e një zgjidhje komplete ose të përkohëshme të konfliktit, është e preferuar përpara dhunës që nuk pakësohet. Kjo kategori përfshin misionet, (siç është KFOR në Kosovë), ku prezenca e vazhdueshme e trupave të huaja besohet të jetë e nevojshme për të parandaluar rindezjen e konfliktit. Dështimet përkufizohen si ndërhyrje që kanë dështuar në ndalimin e një shkalle të madhe dhune ose ku konflikti u ndalua ndërsa ishin prezent ndërhyrësit, por rifilloi pas largimit të tyre.[39]

Opsionet ndërkombëtare në rastet ku një ose më shumë prej luftuesve janë të vendosur për vazhdimin e luftimit janë më të kufizuara dhe plot rreziqe.

Në rastet kur jo të gjitha palët janë të angazhuara në vendosjen e paqes, ndërhyrjet e jashtme ushtarake përballen me shumë sfida që e bëjnë të pamundur arritjen e suksesit në zgjidhjen e vërtetë të konfliktit. Dështimi në marrjen parasysh të këtyre sfidave karakterizoi përpjekjet për ndërhyrje në fillim të viteve 1990, të cilat nënvleftësuan dukshëm vështirësitë që do të haseshin për të detyruar palët që të bëjnë paqe.[40]

---

37. H. Lauterpacht et al (ed.), The Kuwait Crisis: Basic Documents, Grotius (1991); P. Rowe, The Gulf war 1990-91 in International and English Law, Routledge and Sweet and Maxwell (1993); M. Weller, "The Kuwait Crisis: A Survey of some legal issues", 3 Rev.
38. "Situations of human rights in occupied Kuwait", report of 16 January 1992, E/CN.4/1992/26, reprinted in W. Kalin, op. cit. note 5, pp. 69-138.

39. Joshua G. Smith, The Responsibility to reflect. Learning lessons from past Humanitarian, Military Interventions, 2007, p.7.
40. Po aty, p. 4.

Ndërsa aty ku fraksionet pjesëmarrëse kanë vendosur të pushojnë luftimet dhe të punojnë për zhvillimin e një kompromisi, për përfundimin e konfliktit ekzistojnë shumë kushte në të cilat aktorët e jashtëm mund të luajnë një rol konstruktiv duke ndihmuar në lehtësimin e negociatave dhe zbatimin e marrëveshjeve të paqes për t'i dhënë fund luftrave civile. Përmes asistencës në çarmatimin, monitorimin dhe raportimin e veprimeve të të dyja palëve, dhe duke ndihmuar rindërtimin e institucioneve shtetërore, fuqitë e jashtme mund të ndërhyjnë në zvogëlimin e dilemës së sigurisë, që shpesh shoqëron pushimet e zjarrit dhe ndihmon për të krijuar një të ardhme të qëndrueshme për vendet që dalin nga konflikti. Ekzistojnë gjithashtu shumë mënyra nëpërmjet të cilave komuniteti ndërkombëtar mund t'i ndihmojë palët të ndërmarrin hapa gjatë rrugës së vështirë të një paqeje afatgjatë.

Një çështje e debatueshme është ndërhyrja që mund të ndodhë në dy forma:

- Ndërhyrja për të mbrojtur shtetasit e vet në një shtet tjetër, ndërkohë që shteti pritës është i paaftë t'i mbrojë ato siç duhet. Qëllimi është mbrojtja (dhe jo dredhia) dhe qëllimi i ndërhyrjes është i kufizuar në nevojat e arësyeshme sipas rrethanave.[41]

- Ndërhyrja humanitare, e cila ka të bëjë me mbrojtjen ose ndihmën e qytetarëve të shtetit në të cilin ndodh ndërhyrja.

Vlefshmëria e ndërhyrjes është në pikëpyetje sepse ajo shkel integritetin e territorit dhe sovranitetin e shtetit ku kryhet kjo ndërhyrje. Ato që e kundërshtojnë këtë ndërhyrje, argumentojnë se aksione të tilla duhen ndërmarrë vetëm me autorizimin e Këshillit të Sigurimit, sipas kapitullit VII. Ato që mbështesin parimin, argumentojnë se kur Këshilli i Sigurimit dështon në veprimet e tij, parimet humanitare kërkojnë disa forma përgjigjeje ndaj vuajtjeve ekstreme njerëzore.

Mirëpo, aktualisht Këshilli i Sigurimit po përjeton një moment krize. Kriza e Kosovës e ka nxjerrë fare qartë në shesh se kjo rrugë institucionale është inefiçente në fazën aktuale. Vullneti i shumicës dërrmuese të komunitetit ndërkombëtar nuk mund të anullohet me vullnetin e dy ose tri fuqive. Ishte domethënës një votim që u bë në Këshillin e Sigurimit, në Mars 1999, kur Rusia paraqiti një projekt rezolutë që dënonte ndërhyrjen në Kosovë. Nga 15 anëtarët e Këshillit, vetëm 2 votuan pro, 12 të tjerë votuan kundër.

Vakuumi i pushtetit në OKB ka sjellë si rezultat një dimension të ri të Paktit të Atlantikut Verior.[42] Angazhimi i NATO–s nuk kufizohet me rolin mbrojtës të hapësirës gjeopolitike që mbulojnë aktet e saj themelore. Procesi që po përjeton vitet e fundit Aleanca Atlantike i ka dhënë asaj gjithnjë e më shumë rolin e një force ndërkombëtare të mbështetjes së paqes, të rendit ndërkombëtar, një force ekzekutive e komunitetit ndërkombëtar.

41. Michael Schmitt, The use of force in International Law, 1999, p. 3.
42. Profesor Arben PUTO, E drejta Ndërkombetare Publike, Tiranë 2002, f.11

Fillimi i Luftës së Ftohtë çoi në krijimin e NATO–s, në vitin 1949, për të përballuar kërcënimin sovjetik. Sidoqoftë, kur "kërcënimi sovjetik" u zhduk roli i NATO–s u bë edhe më i qartë, me më shumë ndërhyrje të saj, aty ku Kombet e Bashkuara kishin frikë të shkelnin, si p.sh. në Kosovë, Afganistan dhe Irak.[43]

NATO në Ballkan ka luajtur një rol vendimtar në zgjidhjen e krizave dhe në mbështetje të operacioneve paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara.

NATO ndërhyri në Ballkan për të ndaluar katastrofat humanitare dhe për të krijuar paqe dhe stabilitet. Ndërhyrja e NATO-s ishte vendimtare për zgjidhjen e konflikteve në Bosnjë & Hercegovinë[44] dhe Kosovë.

Në Bosnjë & Hercegovinë dhe Kosovë, Aleanca ndërhyri me forcë për t'i dhënë fund konflikteve dhe më pas vendosi trupa për të parandaluar një rikthim të armiqësive, si dhe për të krijuar kushtet në të cilat mund të fillonte procesi i paqes.

Veprimet e NATO-s kontribuuan në arritjen e rezultateve efektive dhe të qëndrueshme. Vlerësimi i ndërhyrjeve humanitare varet jo vetëm nga çfarë ndodh gjatë dhe menjëherë pas ndërhyrjes, por gjithashtu nga rezultatet afatgjata që ajo krijon.

Ndërhyrjet e NATO-s në Bosnjë & Hercegovinë dhe Kosovë i dhanë fund politikës së spastrimit masiv etnik dhe përmirësuan perspektivat për paqe dhe drejtësi.

Paqja dhe stabiliteti mbizotëruan në Ballkan pas ndërhyrjeve të NATO-s. Njerëzit nuk jetojnë më me frikë dhe nuk vrasin njëri-tjetrin vetëm për shkak të ndryshimeve etnike.[45]

Një varg faktesh në jetën ndërkombëtare dëshmojnë gjithnjë e më qartë se nuk jemi thjesht në sferën e ideve të përgjithshme, por drejt një tendence të evolucionit të së drejtës ndërkombëtare në etapën e sotme, përsa i përket mënyrave të kundërveprimit ndaj shkeljeve të së drejtës humanitare.

Ka mjaft shembuj domethënës në këtë drejtim. Gjermania e Danimarka kanë nxjerrë para gjyqit dhe kanë dënuar kriminele të luftës nga ngjarjet e Bosnjës. Gjykata e Hagës për krimet e luftës ka vendosur më 1997 se edhe krimet e kryera gjatë konflikteve civile të brendshme, si p.sh. në Kili gjatë diktaturës së Gjeneralit Pinoçet, duhet t'i nënshtrohen juridiksionit ndërkombëtar.

Një rast edhe me domethënës është Kosova. Në hartën politike Kosova, ishte pjesë e Serbisë dhe po t'i përmbaheshim pikëpamjes tradicionale, asnjë fuqi e jashtme nuk do të kishte të drejtën të ndërhynte në ato që qeveria e Beogradit quan "punët e brendshme".

43. Eric Walberg, Peacemaker or Puppet?, *22* August 2007, p.*3,* www.oocities.org/walberg2002/Egypt/articles.html
44. Rezoluta 787 (1992) e Këshillit të Sigurimit, adoptuar më 16 nëntor 1992, para. 12.

45. Rezoluta 770 (1993) e Këshillit të Sigurimit, adoptuar më 13 gusht 1993, para. 2.

Mirëpo ndërhyrja e komunitetit ndërkombëtar flet për një etapë të re në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ndërhyrja e NATO–s në ngjarjet e Kosovës është mjeti me anën e të cilit komuniteti ndërkombëtar imponon opsionet e tij. Mediatori amerikan Holbrooke e quajti veprimin e NATO–s si një precedent, "Rasti i parë në histori që një organizatë ushtarake i njohu vetes të drejtën e ndërhyrjes në një vend sovran kundër udhëheqjes së tij".

5.3.1 Juridiksioni i brendshëm dhe universal

Në rezolutën 764, të datës 13 korrik 1992, Këshilli i Sigurimit riafirmoi se të gjitha palët në konflikt janë të detyruara t'ju përmbahen detyrimeve të tyre sipas të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe sidomos konventave të Gjenevës të datës 12 gusht 1949 dhe se personat që kryejnë ose urdhërojnë kryerjen e shkeljeve të rënda të konventave mbajnë përgjegjësi individuale për shkelje të tilla.[46]

Për gjykimin e kriminelëve të luftës është parë e nevojshme të krijohen gjykata ad - hoc, d.m.th. gjykata të krijuara pikërisht për ngjarje të veçanta, siç janë:

Gjykata Ndërkombëtare për ish–Jugosllavinë, e cila u krijua me vendim të Këshillit të Sigurimit në vitin 1993 për të gjykuar krimet, genocidin dhe spastrimin etnik gjatë konfliktit, që pasoi shthurjen e Federatës Jugosllave dhe Gjykata ad-hoc, e krijuar me vendim të Këshillit të Sigurimit më 1994, për të gjykuar individë përgjegjës për ushtrim genocidi dhe shkelje të së drejtës ndërkombëtare humanitare në territorin e Ruandës.

Duke vënë para përgjegjësisë individë pavarësisht prej postit të tyre, Gjykata Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë ka shkatërruar traditën e mosndëshkimit të krimeve të luftës. Gjykata ngriti akuza në lidhje me një kryetar shteti, kryeministra, shefa shtabi të ushtrisë, ministra të punëve të brendshme dhe shumë udhëheqës të tjerë nga të gjitha palët në konflikt. Kjo gjykatë e ka vërtetuar se drejtësia ndërkombëtare kompetente dhe transparente është e realizueshme.

Duke gjykuar individët në bazë të përgjegjësisë së tyre individuale, Gjykata Ndërkombëtare Penale e ish-Jugosllavisë e individualizon fajin.[47] Udhëheqësit e akuzuar dhe vartësit e tyre nuk mund të fshihen më pas "kombit" të tyre. Ata duhet të përgjigjen për veprimet e tyre. Kjo mbron bashkësitë etnike nga fajësimi. Gjithashtu kontribuoi në masë të madhe në parandalimin e urrejtjes së ndërsjelltë dhe promovoi pajtimin në mes të shoqërive të shkatërruara nga lufta në ish-Jugosllavi.

Që nga themelimi Gjykata Penale Ndërkombëtare e ish-Jugosllavisë ka zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike të drejtën ndërkombëtare. Puna dhe arritjet e Gjykatës frymëzuan krijimin e gjykatave të tjera penale ndërkombëtare, duke përfshirë Gjykatën Penale Ndërkombëtare për Ruandën dhe Gjykatën Speciale për Sierra Leonen.

46. Raport i Sekretarit të Përgjithshëm, 3 maj 1993, (S/25704), f.2.

47. Agreement for the Prosecution and Punishment of the Major War Criminals of the European Axis, Charter of the International Military Tribunal, 8 August 1945, 82 UNTS, p.280. Judgment of the International Military Tribunal at Nuremberg in Nazi Conspiracy and Aggression, Opinion and Judgment (1947).

Përveç këtyre gjykatave ad-hoc, në përndjekjen e krimeve kundër njerëzimit është krijuar Gjykata Penale Ndërkombëtare – një organizëm permanent i drejtësisë ndërkombëtare. Gjykata Penale Ndërkombëtare ka kompetencë të gjykojë krimet më të rënda që kanë të bëjnë me komunitetin ndërkombëtar: agresionin, krimet e luftës, genocidin dhe krimet kundër njerëzimit.

Megjithëse u shfaqën barbarizma të shumta, vitet 1990 kanë qënë të mbushura me përpjekje për të sjellë fajtorët e krimeve të njerëzimit dhe krimeve të luftës para drejtësisë, përpjekje këto shumë të rëndësishme që pas gjyqeve të Nurenbergut dhe Tokios.

Përveç juridiksionit të karakterit universal, si ai që përfaqëson Gjykata Penale Ndërkombëtare ose gjykatat ad-hoc, është afirmuar mundësia që fajtorët për krime ndërkombëtare, sidomos krimet kundër njerëzimit dhe genocidi, të dënohen edhe në procese penale të brendshëm. Ky është quajtur "juridiksion kombëtar universal", që mund të karakterizohet nga dy elementë:

- Çdo gjykatë është kompetente të gjykojë një të akuzuar për krime kundër njerëzimit.

- Nuk është e domosdoshme që midis të akuzuarit dhe shtetit ku zhvillohet procesi të ketë ndonjë lidhje.[48]

Parimi i mësipërm i juridiksionit kombëtar universal u ka dhënë mundësi, disa gjykatave të brendshme që të gjykojnë kriminelë të akuzuar për këto krime, edhe pse këta mund të jenë të huaj.

Rasti më i njohur i zbatimit të juridiksionit kombëtar universal është ai që ka ndodhur me ish–diktatorin kilian Pinoçet, të akuzuar për krimet e kryera gjatë kohës që ishte në fuqi, 1973 – 1990.

Policia e Londrës e arrestoi gjeneralin dhe një numër vendesh kërkuan ekstradimin e tij pikërisht për ta gjykuar në bazë të parimit të juridiksionit kombëtar universal.

Gjykatat e Jugosllavisë dhe Ruandës, arrestimi i Pinoçetit dhe krijimi i gjykatës ndërkombëtare të përhershme janë të gjitha përpjekje për imponimin e përgjegjësisë penale ndërkombëtare.

Ky lloj juridiksioni do të kërkojë vite që të përsoset, megjithatë dy gjykatat kanë treguar se diçka mund të bëhet. Alternativa për ata që kryejnë krime të rënda botërore duket gjithmonë e më e keqe.[49]

48. Profesor Arben PUTO, E drejta Ndërkombëtare Publike, Tiranë 2002, f. 261.
49. David Morison, The World is watching: A survey of human rights law, 1998, p.17.

Kombet duhet të pranojnë që një botë njerëzore më e paqtë mund të krijohet duke zëvendësuar forcën e luftës me forcën e ligjit.[50] Paqja dhe mirëqenia e secilit është lidhur përgjithësisht me paqen dhe mirëqënien e të gjithëve. Bota është e mbushur me vuajtje njerëzore, por është gjithashtu e bekuar nga shumë njerëz, të cilët janë të vendosur ta bëjnë atë një vend më të mirë për të gjithë.

5.3.2 Gjykata ndërkombëtare për ish Jugosllavinë dhe themelimi i saj

Shpërbërja e ish–Jugosllavisë rezultoi në disa prej shkeljeve më të tmerrshme të të drejtave themelore të njerëzimit, qysh prej Luftës së Dytë Botërore.[51]

Në rezolutën 771, të datës 13 gusht 1992, Këshilli i Sigurimit shprehu shqetësim të thellë lidhur me raportet e vazhdueshme për shkelje në një shkallë të gjerë të së drejtës ndërkombëtare humanitare që po kryheshin në territorin e ish–Jugosllavisë[52] dhe sidomos në Bosnjë & Hercegovinë, duke përfshirë raportet për dëbime dhe deportime masive me dhunë të civilëve, burgosjen dhe keqtrajtimin e civilëve nëpër qendra të burgimit, sulme të qëllimshme ndaj joluftuesve, spitaleve dhe ambulancave, pengimin e furnizimit të popullsisë civile me ushqim dhe artikuj mjekësorë, si dhe shkatërrimin e asgjësimin pa kufi të pronës.

Këshilli i Sigurimit dënoi ashpër çdo shkelje të së drejtës ndërkombëtare humanitare, duke përfshirë ato që ishin pjesë e praktikës së "spastrimit etnik" dhe kërkoi që të gjitha palët në konfliktin në ish–Jugosllavi të heqin dorë nga të gjitha shkeljet e së drejtës ndërkombëtare humanitare. Ai u bëri thirrje shteteve dhe organizatave humanitare ndërkombëtare që të përpilonin informacion lidhur me shkeljet e së drejtës humanitare, duke përfshirë shkelje të rënda të konventave të Gjenevës, që po kryheshin në territorin e ish–Jugosllavisë dhe ta vinin këtë informacion në dispozicion të Këshillit.[53]

Më tej Këshilli i Sigurimit vendosi, duke vepruar sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, se të gjitha palët dhe të tjerët që kanë lidhje me ish–Jugosllavinë dhe të gjitha forcat ushtarake në Bosnjë & Hercegovinë, duhej t'iu përmbaheshin dispozitave të asaj rezolute sepse përndryshe Këshilli do të detyrohej të merrte masa të mëtejshme në bazë të Kartës.[54]

Rezoluta 808, (1993), përbën një hap të mëtejshëm të ndërmarrë nga Këshilli i Sigurimit në një vazhdë rezolutash lidhur me shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare të kryera në territorin e ish–Jugosllavisë.

---

50. B. B. Ferenez, The development of International Humanitarian Law, p.6.
51. Pasic, Amir and Weiss, Thomas 1999, "The Politics of Rescue: Yugoslavia's Wars and the Humanitarian Impulse," pp.296-333 in Ethics and International Affairs, ed. Joel H. Rosenthal, 2nd ed.,Georgetown University Press, Washington, DC.

52. Security Council resolution 764, 1992.
53. Security Council resolution 724, 1991.
54. ICRC Annual Report, 1991, pp. 87-88.

Më në fund, Këshilli i Sigurimit deklaroi në rezolutën 808 (1993),[55] se ishte i bindur se në rrethanat e posaçme të ish–Jugosllavisë, themelimi i një gjykate ndërkombëtare do të arrinte qëllimin e dhënies fund të këtyre krimeve dhe të marrjes së masave efektive për të sjellë para drejtësisë personat përgjegjës për to dhe do t'i kontribuonte rivendosjes dhe ruajtjes së paqes.

Më 25 Maj 1993, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën Nr.827, me të cilën themelohej Gjykata Penale Ndërkombëtare e Jugosllavisë. Në këtë Rezolutë Këshilli i Sigurimit shprehu shqetësimin për raportet e vazhdueshme të shkeljes së gjerë dhe flagrante të së drejtës ndërkombëtare humanitare që ndodhën brenda territorit të ish-Jugosllavisë duke përfshirë raporte të vrasjeve masive, burgosjes dhe dhunimit të organizuar e sistematik të grave dhe vazhdimin e zbatimit të "spastrimit etnik".

Miratimi i kësaj Rezolute, që themelonte Gjykatën sipas Kapitullit të VII të Kartës së Kombeve te Bashkuara, nënkuptonte që Këshilli i Sigurimit e vlerësonte konfliktin në ish-Jugosllavi si kërcënim ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare dhe që krijimi i Gjykatës do të ishte mjet i rivendosjes së paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.[56]

5.3.2. a Juridiksioni i gjykatës

Juridiksioni gjeografik i Gjykatës është i kufizuar në territorin e shteteve të dala pas shpërbërjes së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavi së. Gjykata është e autorizuar për ndjekje penale për krimet që janë kryer prej vitit 1991 e tutje dhe kështu nuk ka kufizim kohor. Ndryshe nga gjykatat ushtarake të Nurembergut dhe Tokios, Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë mund të ndjekë penalisht vetëm individë në bazë të përgjegjësisë së tyre individuale penale, pa marrë parasysh përbërjen e tyre etnike, ose bashkimin në një grup ose qeveri.[57]

Kështu Gjykata nuk mund të ndjekë penalisht grupe shoqërore, fetare, etnike apo politike, ose institucione siç janë forcat e armatosura, partitë politike ose shtetet. Me akuzimin e individëve me përgjegjësi penale për krime të rënda të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë, Gjykata mënjanoi çdo formë të "fajësisë kolektive".

Objekti i juridiksionit të Gjykatës përfshin:

- shkeljet e rënda[58] të Konventave të Gjenevës, të vitit 1949,
- shkeljet e ligjeve dhe zakoneve të luftës[59],
- genocidin,[60]
- krimet kundër njerëzimit.

55. Raport i Sekretarit të Përgjithshëm, 3 maj 1993, (S/25704), f. 7.
56. Security Council resolution 808 (1993) of 22 February 1993 and 827 (1993) of 25 may 1993.
57. Security Council resolution 764 (1992) of 13 July 1992.
58. Geneva Convention for the Amelioration of the Condition of the Wounded and Sick in Armed Forces in the Field, 12 August 1949. Geneva Convention for the Amelioration of the Condition of the Wounded, Sick and Shipwrecked Members of Armed Forces at Sea, 12 August 1949, 75 UNTS, p.85; Geneva Convention relative to the Treatment of Prisoners of War, 12 August 1949, 75 UNTS, p. 135; Geneva Convention relative to the Protection of Civilian Persons in Time of War, 12 August 1949, 75 UNTS, p.287.

59. Regulations respecting the Laws and Customs of War on Land annexed to the Hague Convention (IV) respecting the Laws and Customs of War on Land, 18 October 1907, in Carnegie Endowment for International Peace, The Hague Conventions and Declarations of 1899 and 1907 (1915), p.100.
60. Convention on the Prevention and Punishment of the Crime of Genocide, 9 December 1948, 78 UNTS, p.278.

Ndryshe nga gjykatat e Nurembergut dhe Tokios, Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë nuk ka juridiksion mbi "krimet kundër paqes" ose krimin e agresionit.

Duke themeluar një gjykatë për ndjekjen penale të personave përgjegjës për shkelje të rënda të kryera në territorin e ish–Jugosllavisë prej vitit 1991, Këshilli i Sigurimit nuk kishte ndër mend të përjashtonte ose të ndalonte ushtrimin e juridiksionit të gjykatave kombëtare lidhur me veprime të tilla. Në të vërtetë gjykatat kombëtare duhet të inkurajohen që të ushtrojnë juridiksionin e tyre në përputhje me ligjet kombëtare dhe procedurat e tyre përkatëse.

Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë ka "juridiksion të njëkohshëm" me gjykatat vendore, gjë që nënkupton se edhe Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë edhe gjykatat vendore mund të ndjekin penalisht të akuzuar për krime lufte dhe shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare. Megjithatë Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë ka përparësi ndaj gjykatave vendore. Kjo përparësi i jep asaj të drejtën që të kërkojë nga gjykatat kombëtare që t'ia bartin kompetencat për çfarëdo shqyrtim të tyre.

Si rrjedhim kuptohet se Gjykata Ndërkombëtare dhe gjykatat kombëtare kanë juridiksion të njëkohshëm. Mirëpo ky juridiksion i njëkohshëm është i kushtëzuar nga përparësia e Gjykatës Ndërkombëtare. Në çdo fazë të procedurës, Gjykata Ndërkombëtare mund të kërkojë zyrtarisht nga gjykatat kombëtare që t'ia transferojnë kompetencat Gjykatës Ndërkombëtare.

Një person nuk do të gjykohet dy herë për të njëjtin krim.[61] Në këtë konteks, duke marrë parasysh përparësinë e Gjykatës Ndërkombëtare përjashtohet gjykimi i mëvonshëm para një gjykate kombëtare. Megjithatë nuk mund të përjashtohet një gjykim i mëvonshëm para Gjykatës Ndërkombëtare në këto dy rrethana:

a. kur cilësimi i veprës nga gjykata kombëtare nuk përputhet me cilësimin e saj sipas statutit,
b. kur kushtet e paanshmërisë, pavarësisë, ose mundësisë së gjykimit efektiv nuk garantoheshin në procedurat para gjykatave kombëtare.

Fillimisht, Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë përqëndroi përpjekjet në dy kategori individësh: në persona në pozita të larta dhe në persona që supozohej që ishin fajtorë për sjellje kriminale.

Me 23 korrik 2002, Këshilli i Sigurimit i Kombeve te Bashkuara prezantoi strategjinë e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë për përqëndrimin e punës kryesisht në ndjekjen penale të liderëve të lartë politikë e ushtarakë.

61. Raport i Sekretarit të Përgjithshëm, 3 maj 1993, (S/25704), f.15.

Duke vënë individë para përgjegjësisë për krimet e kryera në ish-Jugosllavi që nga viti 1991, gjykata ka sjellë drejtësi për viktimat. Gjykata ka ngritur aktakuza kundër shumë të akuzuarve për krime të kryera kundër mijëra e mijëra viktimave nga të gjitha palët në konfliktet në Kroaci (1991-1995), në Bosnjë & Hercegovinë (1992-1995), në Kosovë (1998-1999) dhe në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (2001).

Gjykata Penale Ndërkombëtare e ish-Jugosllavisë nuk është i vetmi organ juridik i themeluar me qëllim shqyrtimin e shkeljeve të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare në një konflikt të posaçëm. Gjykata Penale Ndërkombëtare për Ruandën, e themeluar me Rezolutë të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, në nëntor 1994, u themelua për ndjekjen penale të personave përgjegjës për genocid dhe shkelje të tjera serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare të kryera në territorin e Ruandës prej 1 janarit 1994 deri më 31 dhjetor 1994.

Ekzistojnë edhe gjykata të tjera, të përziera, që janë të sponzorizuara dhe financuara ndërkombëtarisht siç është p.sh. Gjykata Speciale e Sierra Leones,[62] ose gjykatat e rregulluara nga UNMIK-u në Kosovë dhe natyrisht Gjykata Penale Ndërkombëtare që hyri në fuqi më 1 korrik 2002. Ky institucion i përhershëm i themeluar përmes një traktati ndërkombëtar do të plotësojë gjykatat kombëtare që nuk janë në gjendje ose nuk dëshirojnë të sjellin para gjyqit ekzekutuesit e genocidit, krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit.

5.3.2.b Gjykatat e përbashkëta kombëtare–ndërkombëtare dhe shembulli i Gjykatës Speciale të Sierra Leones

Gjykatat e përbashkëta kombëtare – ndërkombëtare janë gjykata si ato të krijuara në Timorin Lindor ose Sierra Leone, të cilat veprojnë në territor kombëtar por zbatojnë të drejtën ndërkombëtare, ose një përzierje të së drejtës ndërkombëtare dhe kombëtare dhe janë të përbëra nga gjyqtarë ndërkombëtarë dhe kombëtarë. Ato mund të konsiderohen edhe si gjykata të brendshme të ndërkombëtarizuara.

Vlefshmëria e imponimit të pushteteve të secilës prej këtyre gjykatave ndryshon në përputhje me dokumentet e tyre bazë, por ndryshimi më i madh qëndron ndërmjet imponimit të urdhërave brenda shtetit në të cilin vepron gjykata dhe imponimit jashtë shtetit.

Në marrëveshjen me të cilën u krijua Gjykata Speciale e Sierra Leones, për shembull, qeveria e Sierra Leones e angazhon veten me një angazhim të përgjithshëm me gjykatën dhe legjislacioni i zbatueshëm parashikon që urdhërat e lëshuara nga gjykata do të kenë të njëjtën forcë ose efekt si një urdhër i lëshuar nga një gjykatë e brendshme.

62. Rule 54 of the Rules of Procedure and Evidence respectively of the International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia, the International Criminal Tribunal for Rwanda and the Special Court for Sierra Leone, Article 64 (6) of the Statute of the International Criminal Court.

Është e mundshme që policisë së Sierra Leones t'i kërkohet të mbajë nën arrest një anëtar të një organizate humanitare që vepron në territor me qëllim që ta sjellë atë para gjyqit për të dëshmuar. Ky juridiksion nuk shtrihet mbi punonjësit humanitarë jashtë vendit.

Nuk ka asnjë obligim mbi shtetet e tjera për të zbatuar një urdhër të Gjykatës Speciale. Ekzekutimi i një urdhëri të tillë do të varej nga marrëveshjet ndërmjet Gjykatës Speciale dhe shtetit të huaj të implikuar. Ndërsa shtetet mund të binden që t'ia dorëzojnë personat e akuzuar një gjykate të tillë, është më pak e mundshme të dëshirojnë të mbajnë nën arrest një dëshmitar,[63] ndoshta veçanërisht një dëshmitar nga një organizatë ndërkombëtare.

5.3.2.c Gjykata Penale Ndërkombëtare

Gjykata Penale Ndërkombëtare e Romës bazohet mbi një traktat të cilin shtetet vendosin nëse duan apo jo ta ratifikojnë. Shtetet që e ratifikojnë janë të detyruara të zbatojnë parashikimet e traktatit, ndërsa shtetet jo ratifikuese nuk janë të lidhura me këto parashikime. Krejt natyrshëm, shtetet ratifikuese janë të detyruara të bashkëpunojnë me kërkesat e gjykatës. Sidoqoftë, ndërsa ky detyrim është pohuar në terma të përgjithshme në statutin e gjykatës, një listë shtesë më e detajuar kërkesash me të cilat një shtet ratifikues duhet të bashkëpunojë nuk përjashton urdhërat për pjesëmarrje të dëshmitarëve, por i referohet "lehtësimit të pjesëmarrjes vullnetare të personave si dëshmitarë ose ekspertë para gjykatës".[64] Mundet pra, që të ketë mosmarrëveshje mbi obligimin e shteteve ratifikuese që të zbatojnë në mënyrë detyruese një urdhër për të dëshmuar të nxjerrë kundër dëshirës së dëshmitarëve.

Shtetet që nuk janë ratifikuese të traktatit nuk janë të detyruara të bashkëpunojnë me kërkesat. Nëse ata janë të detyruar nga ndonjë marrëveshje e mëparshme për të bashkëpunuar, mosbashkëpunimi i tyre mund t'i referohet ose Asamblesë së Shteteve Ratifikuese ose, nëse ndjekja penale është iniciuar nga Këshilli i Sigurimit, atij organi për veprim të mëtejshëm.

Gjykata Ndërkombëtare Penale[65] ka kompetencë të ndjekë penalisht personat përgjegjës për krimet e renditura më poshtë, kur kryhen gjatë një konflikti të armatosur, qoftë me karakter ndërkombëtar apo të brendshëm dhe të drejtuar kundër çfarëdo popullsie civile:

- vrasje,
- shfarosje,
- robërim,
- deportim,
- burgim,
- torturë,
- përdhunim,
- përndjekje mbi baza politike, racore dhe fetare,
- vepra të tjera çnjerëzore.

63. T.C. van Boven, loc. cit. note18, p.511, who speaks of the "Mistaken assumption that the United Nations and the ICRC are in rival positions". Gjithashtu, Condorelli who sees as a result of the Gulf War the UN's increased support for international humanitarian law and its willingness to cooperate with the ICRC.L.Condorelli, " Le droit humanitaire dans la crise et la guerre du Golfe",in B.Stern (ed.), Paris (1991), p.194.
64. Kate Mackintosh,How far can humanitarian organizations control co-operation with international tribunals? Mars2004, p.2.
65. Statute of the International Criminal Court, done at Rome on 17 July 1998.

6. E DREJTA NDËRKOMBËTARE HUMANITARE: "PËR TË DREJTËN E NDËRHYRJES HUMANITARE"

6.1 DETYRIMI PËR TË BASHKËPUNUAR NË EMËR TE PAQES DHE SIGURISË NDËRKOMBËTARE

Humanitarizmi është një shprehje solidariteti me ata që i ka goditur fatkeqësia. Humanitarizmi gjithashtu kërkon një qëndrim përkrah atyre që luftojnë kundër shtypjes dhe mbështje të luftës së tyre për dinjitet, për të drejtat më themelore njerëzore.

Marrëdhëniet e sotme ndërkombëtare bazohen në një parim themelor: Detyrimi për të bashkëpunuar në emër të paqes dhe sigurisë ndërkombëtare dhe për të përkrahur mirëqënien dhe stabilitetin e përgjithshëm, si dhe progresin ekonomik në tërë botën. Kjo nënkupton që shtetet duhet të përpiqen për paqen dhe sigurinë në të gjitha mënyrat e mundshme. Një prej këtyre mënyrave është asistenca humanitare.[1]

Asistenca humanitare përkufizohet si veprim emergjent që synon të sigurojë mbijetesën e atyre personave që janë prekur nga konflikti i armatosur, i brendshëm, ose ndërkombëtar, si dhe nga fatkeqësitë natyrore. Ajo përfshin ndihmë materiale, ushqim, ujë, veshje, ilaçe, zjarr, strehë, shtretër, paisje spitalore, si dhe shërbimet e njerëzve të specializuar. Në mënyrë që asistenca të jetë me natyrë humanitare, qëllimi i vetëm i saj duhet të jetë parandalimi dhe lehtësimi i vuajtjeve njerëzore. Përfituesit e ndihmës humanitare duhet të jenë civilët, përfshirë të internuarit dhe robërit e luftës.[2]

Detyrimi kryesor për plotësimin e nevojave të popullsisë civile në një konflikt të armatosur bie mbi palët që kanë kontrollin efektiv të territorit në të cilin jeton popullsia. Vetëm në qoftë se këto palë nuk janë në gjendje të përmbushin detyrimet e tyre mund të ndërmerren veprime nga jashtë.

Pra, qëllimi përfundimtar i asistencës humanitare është të lehtësojë vuajtjet e njerëzve brenda një shteti, (konflikt i armatosur, apo fatkeqësi natyrore). Asistenca humanitare zakonisht kryhet nga organizata private[3], ose publike që dëshirojnë të shpëtojnë jetë njerëzish, t'i ushqejnë ata, të organizojnë tranzitin, zhvendosjen, ose rivendosjen e tyre. Me fjalë të tjera t'i mbështesë ato në nevojat e jetës së tyre të përditshme.

E drejta ndërkombëtare humanitare përmban shumë parashikime që kanë si qëllim lehtësimin e ndihmës humanitare për personat në nevojë, parashikime të cilat caktojnë detyrime si mbi palët në konflikt, ashtu dhe mbi shtetet e tjera. Shtetet në konflikt duhet të lejojnë asistencën humanitare kurdoherë që nevojat bazë të popullsisë civile, duke përfshirë ushqimin, nuk janë plotësuar dhe një organizatë humanitare e paanshme ofron një mbështetje të tillë.[4]

1. George Foulkes, Questions for a new humanitarism, *12 March 1998, p.2* www.odi.org.uk/events/docs/4031.pdf
2. KGJ IV, nenet 23,59; PGJ I, nenet 69,70.
3. J. Macrae & A. Zwi, War and Hunger, Zed Books, 1994.
4. Niko Krisch, Legality, morality and dilemma of humanitarian Intervention after Kosovo, April 02, p.7, gupea.ub.gu.se/bitstream/2077/2013/1/200422.pdf

Në të vërtetë asistenca humanitare, sipas të drejtës ndërkombëtare, mund të jepet vetëm me pëlqimin e shtetit në nevojë. Megjithatë mosdhënia e pëlqimit për ndihmën humanitare të ofruar kufizohet nga norma dhe parime të ndryshme të së drejtës ndërkombëtare.

Organizatat humanitare kanë të drejtë t'i ofrojnë ndihmë shteteve dhe kjo nuk vlerësohet si ndërhyrje në punët e brendshme të një shteti.[5] Praktikisht, organizatat humanitare duhet të kenë pëlqimin e një shteti jopalë në konflikt, i cili ka de facto kontrollin e territorit ku do zbatohet operacioni. Në komentarin e Protokolleve Shtesë të 8 qershorit 1977, të konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 thuhet: "Në qoftë se mbijetesa e popullsisë kërcënohet dhe një organizatë humanitare duke plotësuar kushtet e kërkuara të paanësisë dhe mosdiskriminimit është në gjendje të përmirësojë situatën, duhet të ndërmerren veprime. Refuzimi do të ishte ekuivalent me shkeljen e rregullit që ndalon përdorimin si mjet lufte të shkaktimit të vdekjes nga uria.

Refuzimet për pranimin e kësaj ndihme duhet të justifikohen në mënyrë bindëse, meqenëse këto refuzime mund të krijojnë shkelje të të drejtave të njeriut, përsa i përket parashikimeve të tij mbi të drejtën e të ushqyerit dhe të drejtën e jetës. Refuzimet mund të çojnë në vdekje të popullsisë nga uria, krime lufte, genocid ose krime kundër njerëzimit të ndëshkueshme nga e drejta ndërkombëtare.

Mohimi i asistencës humanitare[6] mund të përkufizohet si një situatë në të cilën, si rezultat i një sjelljeje të qëllimshme të personave të caktuar, asistenca humanitare nuk arrin në destinacionin e duhur.

Aktorë të ndryshëm mund të jenë përgjegjës për pengimin e asistencës, si agjentë të qeverisë, përfaqësues të grupeve jo-qeveritare dhe banditë. Nganjëherë, pjesëtarë të popullsisë civile, të cilët nuk parashikohen të jenë përfitues të kësaj asistence, implikohen në mohimin e ndihmës ndaj personave në nevojë.

Ka mënyra të ndryshme për të penguar arritjen e ndihmës humanitare tek përfituesit e saj.[7] Një qeveri mundet psh të ndalojë agjensitë e ndihmës që të hyjnë në vend dhe kështu bën që ndihma të mos jepet.

Një mënyrë shumë efektive për të ndaluar dhënien e ndihmës nga organizatat humanitare është pohimi që siguria e tyre nuk mund të garantohet.

Agjentë të shtetit, forca rebele, grupe të tjera joqeveritare, banditë ose civilë mund të pengojnë shpërndarjen e asistencës duke frikësuar punonjësit e ndihmës dhe shpërndarësit, ose duke sulmuar karvanet e ndihmave, anijet, avionët ose personelin ndihmës.

---

5. Neni i përbashkët 3 i katër konventave të Gjenevës, neni 70 i Protokollit të I – rë shtesë. Aktivitetet e KNKK përmenden gjithashtu në nenet 9/9/9/10 të konventave.

6. D. Plattner, "Assistance to the civilian population: the development and present state of international humanitarian law", 288 IRRC (1992), p. 249; C. Sommaruga, "Assistance to victims of war in international humanitarian law and humanitarian practice", 289 IRRC (1992), p.373.
7. Christa Rottensteiner, ICRC, The denial of humanitarian assistance as a crime under international law, September 1999, Vol. 81, Nr.835, p.559.

Mohimi i asistencës humanitare mund të ketë qëllime të ndryshme. Në raste kur në shënjestër janë civilët, mohimi i asistencës humanitare çon në zhvendosje masive të popullsisë ose në shkaktimin e vdekjes nga uria, gjë që realizon politikën e "spastrimit etnik".

Palët ndërluftuese mund të konfiskojnë ndihmën, me qëllim që të furnizojnë trupat e tyre. Pasoja e mohimit të asistencës humanitare është përkeqësimi i kushteve të jetesës për civilët. Kjo mund të çojë në kequshqyerje, përhapje të sëmundjeve ose vdekje.

Ndryshe nga asistenca humanitare, qëllimi i **ndërhyrjes humanitare** është ndalimi i dhunimeve të mëdha dhe të përhapura të të drejtave të njeriut. Pra asistenca humanitare nuk duhet ngatërruar me ndërhyrjet humanitare.[8] Detyra morale për t'i dhënë ndihmë viktimave të pafajshme të konfliktit të armatosur dhe fatkeqësive natyrore është e shtrirë në të gjithë komunitetin ndërkombëtar, ndërsa përdorimi i forcës aty ku është i nevojshëm duhet të autorizohet nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Këshilli i Sigurimit vendos të hyjë në një konflikt të armatosur ose në një situatë të caktuar, vetëm nëse një e drejtë është dhunuar, për shembull e drejta për të qënë i lirë nga një agresion i jashtëm, të drejtat ndërkombëtare njerëzore.[9]

Kur nuk ka asnjë sulm të armatosur kundër një shteti sovran, por ekziston një situatë në kërcënim të paqes, vetëm Këshilli i Sigurimit ka pushtetin, sipas Kartës, të përdorë ose të autorizojë përdorimin e forcës. Në çdo situatë autorizimi i Këshillit të Sigurimit duhet të kërkohet në fillim dhe jo pas veprimeve rajonale të zbatimit të paqes.

6.1.1 Parimet e asistencës humanitare

- Humanizmi

Sipas të drejtës humanitare civilët kanë një të drejtë themelore për t'u mbrojtur nga sulmi, tortura dhe trajtimet e tjera jo njerëzore. Asistenca humanitare nënkupton respekt për jetën dhe dinjitetin njerëzor. Ajo ka si qëllim humanizimin e konflikteve të armatosura.

- Paanësia

Parimi i dytë bazë që udhëheq asistencën humanitare është paanësia. Lëvizjet humanitare nuk duhet të bëjnë ndonjë diskriminim bazuar në racën, kombësinë, besimin, opinionet publike ose ndonjë kriter tjetër.

- Neutraliteti

8. Noelle Quenivet, Humanitarian assistance: a right or a policy?, 3 June 2000, p.14, http://www.jha.ac/articles/a030.htm
9. Po aty, p.21.

Parimi i tretë i asistencws humanitare është neutraliteti. Kjo nënkupton që pwrpjekjet humanitare nuk duhet të integrohen në një proces politik apo të lidhen me ndonjë përdorim të fuqisë ushtarake.[10] Asistenca humanitare vetëm i shërben interesit të të gjithë viktimave dhe organizatat humanitare nuk duhet të implikohen në debatet me natyrë politike, fetare ose ideologjike.

Në të kaluarën, asnjë lëvizje humanitare nuk do t'i kishte mbështetur njerëzit, nëse shteti shprehimisht e refuzonte ndihmën nga jashtë. Sot zhvillimet në fushën e të drejtës humanitare dhe të të drejtave të njeriut kanë treguar se ka disa kushte që e sfidojnë sovranitetin.

Qëkurse të drejtat njerëzore nuk i përkasin më vetëm një shteti, shtetet nuk mund t'i drejtohen më juridiksionit të tyre të brendshëm, me qëllim që të pengojnë komunitetin ndërkombëtar ose shtetet e tjera për të mbrojtur ose siguruar të drejtat dhe liritë themelore.[11]

"Avokatët e një morali kozmopolitan" argumentojnë se interesi human duhet të zëvendësojë interesin kombëtar, se sovraniteti nuk është një e mirë absolute, se e mira morale e sovranitetit duhet me raste të dorëzohet ndaj urdhërimeve superiore të humanizmit global. Shtetet kanë një obligim moral të lehtësojnë vuajtjet njerëzore. Ata duhet të paktën të obligohen në ndihmën dhe asistencën e njerëzve në nevojë.

6.1.2 Rrethanat në të cilat mohimi i asistencës humanitare mund të përbëjë krim sipas të drejtës ndërkombëtare.

6.1.2.a Krimet e luftës

Një krim lufte i kryer nga ndonjë person fizik, civil ose ushtarak, është një shkelje serioze e ndëshkueshme nga e drejta ndërkombëtare humanitare. Që një akt të quhet krim lufte është e domosdoshme që të ekzistojë një konflikt i armatosur.[12]

Një tjetër kriter është që akti duhet të kryhet kundër një personi të mbrojtur nga e drejta ndërkombëtare humanitare. Në rastin e mohimit të asistencës humanitare, viktimat e akteve të tilla do të jenë civilët, duke përfshirë këtu individët të cilëve u është mohuar liria, si dhe robërit e luftës, (në një konflikt të armatosur ndërkombëtar).

Mohimi i asistencës humanitare mund të përbëjë krim lufte si në konflikt ndërkombëtar ashtu dhe jondërkombëtar.[13]

10. Komiteti Ndërkombwtar i Kryqit të Kuq, E Drejta e Konfliktit të Armatosur, (Asnjanësia), Tiranë, Qershor 2002, f. 10-8.

11. Yoram Dinstein, From the Naval War College Review, Autumn 2000, The Right to Humanitarian Assistance, IHL Research, ihl.ihlresearch.org/index.cfm?fuseaction=page.viewPage...808

12. Konventat e Gjenevës, nenet 49/50/129/146, që flasin vetëm për akte të kryera nga "personat"; Statutet e Gjykatës së Nurembergut, neni 6, i gjykatës së Tokios, neni 5, statutet e GJ.P.N.J., nenet 6 dhe 7 dhe GJ.N.P.R., nenet 5 dhe 6; si dhe statuti i Gjykatës Penale Ndërkombëtare, neni 25.

13. Konventa e IV e Gjenevës, nenet 23, 59. 18, 109, Protokolli I Shtes), nenet 69, 70.

Ndalimi i shkaktimit të vdekjes nga uria, si metodë lufte, përfshihet në nenin 54 të Protokollit të Parë dhe në nenin 14 të Protokollit të II-të Shtesë të konventave të Gjenevës.

Statuti i Gjykatës Penale Ndërkombëtare shprehimisht përmend mohimin e asistencës humanitare, si shembull të një akti që mund të çojë në vdekje nga uria. Sipas parashikimit përkatës "shkaktimi me qëllim i vdekjes nga uria si metodë lufte, duke i privuar njerëzit nga objektet e domosdoshme për mbijetesën e tyre", është një shkelje serioze e ligjeve dhe zakoneve të luftës. Sidoqoftë, shkaktimi i vdekjes nga uria është përfshirë në juridiksionin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare vetëm përsa i përket konflikteve të armatosura ndërkombëtare.

6.1.2.b Krimet kundër njerëzimit

Jurisprudenca ndërkombëtare e kohëve të fundit dhe adoptimi i Statutit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare ka ndihmuar në zhvillimin e përkufizimit të krimeve kundër njerëzimit, i cili ka qenë objekt debatesh që nga Karta e Nurembergut. Tashmë është pranuar se duhen plotësuar këto kushte për të patur krime kundër njerëzimit:

- aktet duhet të kryhen kundër çfarëdo popullsie civile, në mënyrë shumë të përhapur dhe sistematike dhe
- duhet të bazohen në politikën e një shteti, një organizate, ose një grupi. Nuk kërkohet më lidhja me një konflikt të armatosur.

Me qëllim që mohimi i asistencës humanitare të bëhet krim kundër njerëzimit, duhet gjithashtu të jetë sistematik, shumë i përhapur dhe i bazuar mbi një politikë. Kjo përjashton aktet e rëndomta të pengimit të ndihmës humanitare që nuk kryhen si pjesë e një plani ose politike të gjerë.

Në rastin e mohimit të asistencës humanitare mund të jetë veçanërisht e vështirë të provohet nëse ajo përbën apo jo krim kundër njerëzimit, meqënëse është vështirë të gjesh lidhjen ndërmjet aktit të pengimit të ndihmës dhe rezultatit, por është edhe më e vështirë të provosh se rezultati i dëshiruar i mohimit të ndihmës humanitare është shkatërrimi i një grupi të veçantë.[14]

Mohimi i asistencës humanitare mund të krahasohet me kategoritë e "vrasjes së anëtarëve të grupit", "shkaktimin e dëmtimeve serioze të trupit ose trurit së anëtarëve të grupit" dhe

"krijimin e kushteve jetësore të tilla që e çojnë grupin në shkatërrimin fizik të plotë ose të pjesshëm".

14. Christa Rottensteiner, ICRC, The denial of humanitarian assistance as a crime under international law, September 1999, Vol. 81, Nr.835, p.578.

6.1.3 Asistenca ushtarake në shpërndarjen e ndihmës humanitare

Tradicionalisht, ndihma humanitare në situata konflikti ka qënë fushë veprimtarie e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, të cilit i është dhënë mandati i mbrojtjes të së drejtës humanitare nga konventat e Gjenevës. Neutraliteti dhe paanshmëria janë parimet vepruese të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe pritej që duke demonstruar neutralitet strikt, punonjësit humanitarë do të lejoheshin të hynin në zonat e konfliktit. Një element thelbësor në arsyetimin për ndihmën humanitare neutrale ishte se të gjitha palët do të konkludonin se lejimi i ndihmës ishte në avantazhin e tyre.

Lloji i konfliktit që ka karakterizuar periudhën pas Luftës së Ftohtë e sfidoi këtë supozim. Ndihma në shumë konflikte, është bërë një armë e vlefshme. Veçanërisht në Bosnjë, ku rrethimi u kthye në një nga mënyrat kryesore të luftimit, ndihma për të lehtësuar rrethimet rrallë shihej si neutrale ose e paanshme.

Në Somali ndihma ishte një mall i vlefshëm dhe fraksionet shpesh e kthyen kapjen e saj në një qëllim kryesor të veprimeve ushtarake. Tashmë ushtritë tradicionale shtetërore janë zvendësuar nga forcat ushtarake rezerviste dhe fraksionet si aktorët kryesorë në konflikt. Kompleksiteti në rritje dhe rënia e disiplinës në përgjithësi që ka shoqëruar këtë ndryshim, e ka bërë edhe më të vështirë ndarjen e ndihmës.

Në mënyrë që një operacion asistence humanitare të jetë efektiv, duhet që atij t'i sigurohet asistencë ushtarake.

Në periudhën pas Luftës së Ftohtë forcat ushtarake janë përdorur në një shkallë të madhe në një vend ose rajon të vetëm për të mbrojtur, përmes forcës, shpërndarjen e ndihmës humanitare.

Shembuj kryesorë janë operacionet multilaterale në Irakun Verior, Bosnjë dhe Somali.[15] Në Irakun Verior, forcat nga koalicioni i aleatëve krijuan një zonë sigurie, transportuan refugjatët nga malet e Turqisë në Irak, ngritën kampe dhe siguruan asistencë direkte. Operacioni u justifikua sipas kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe kishte për qëllim të përdorte edhe forcën në mbështetje të objektivave humanitare.

Në rastin e ish–Jugosllavisë, forcat e Kombeve të Bashkuara hynë fillimisht si paqeruajtëse, duke monitoruar një pushim zjarri të vendosur ndërmjet forcave kroate dhe serbe. Me përhapjen e konfliktit në Bosnjë, paqeruajtësit u zhvendosën në atë vend me një mandat të përcaktuar qartë humanitar. Paqeruajtësit duhet të ruanin aeroportin e Sarajevës në mënyrë që pasojat e ndihmës të arrinin në qytet dhe të mbronin karvanet e

ndihmave humanitare në vend. Ndërsa konflikti vazhdoi, mandati i UNPROFOR – it u zgjerua duke përfshirë mbrojtjen e "zonave të sigurta".[16]

15. The United Nation Operation in Somalia (UNOSOM I) was established as a humanitarian relief effort by Security Council resolution 751 (1992). It was later taken over by the "United Task Force" (UNITAF), authorized under Chapter VII to use all necessary means to establish a secure environment for humanitarian operations in Somalia (SC res. 794 (1992), and following a transition period, an expanded United nations Operation in Somalia (UNOSOM II) was establish under Chapter VII (SC res. 814 (1993).
16. Zonat e sigurta janë të mbrojtura. Ato krijohen nga palët në konflikt për mbrojtjen e të plagosurve dhe të sëmurëve, të moshuarve, fëmijëve, nënave shtatzëna dhe nënave me fëmijë të vegjël. Këto zona, që janë relativisht zona të vogla, mund të krijohen në mënyrë të njëanshme në kohë paqe ose lufte, ose me marrëveshje mes palëve në konflikt, të cilat nxiten të arrijnë një marrëveshje mes tyre.

Gjatë kohës së tij në Bosnjë, UNPROFOR – i mori një mandat sipas kapitullit VII dhe ju dha e drejta të përdorte forcën për të arritur qëllimet e tij humanitare.[17]

Një forcë ndërhyrëse e udhëhequr nga amerikanët (UNITAF), hyri në Somali në dhjetor 1991, me qëllimin e pohuar të mbrojtjes së shpërndarjes së ndihmës dhe aty ku ishte e nevojshme do të shpërndante vetë ndihmën. Pas disa muajsh UNITAF ia dorëzoi operacionin UNOSOM, një operacion ky i Kombeve të Bashkuara, që mori përgjegjësinë e sigurimit të shpërndarjes së ndihmës, si dhe disa përgjegjësi të tjera politike. Si UNITAF ashtu dhe UNOSOM i kishin mandatet sipas kapitullit VII të Kartës dhe ishin autorizuar të përdornin forcën në përmbushje të qëllimeve të tyre humanitare.[18]

Duket pra që ushtria ka një avantazh të dukshëm në krijimin e sigurisë. Kjo u pa qartë në Bosnjë dhe Somali. Në të dy rastet, ushtria pati një masë suksesi. Në Somali prezenca ushtarake lejoi shpërndarjen e ndihmës në zonat e Somalisë, të cilat kishin qënë të izoluara prej muajsh. Eskortat ushtarake për karvanet dhe prezenca ushtarake në zonat e ushqimit dhe në depot e mallrave zvogëloi dukshëm grabitjet që kishin qënë të zakonshme përpara vendosjes së trupave. Në Bosnjë, efekti i eskortave ushtarake ishte më pak i qartë, megjithëse është e padiskutueshme se në shumë raste ndihma hyri për shkak të prezencës ushtarake. Ushtria në Bosnjë[19] siguroi gjithashtu mbështetjen e nevojshme duke riparuar rrugët dhe urat.

Nga këndvështrimi civil, ushtria nganjëherë rriste pasigurinë duke bërë që ndihma e mbrojtur të bëhej një shënjestër për ata që e kundërshtojnë prezencën ushtarake. Ekzistonte gjithashtu frika se lidhja e ngushtë me ushtrinë mund të minonte neutralitetin, paanshmërinë dhe pavarësinë që karakterizon ndihmën humanitare. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq rrallë ka pranuar eskortat ushtarake për karvanet e tij dhe të njëjtën gjë kanë bërë edhe agjensitë e tjera të ndihmës në disa raste, në veçanti ato në të cilat ushtria ishte e angazhuar në operacione detyruese.

Mund të themi që, pa rolin e forcave të armatosura në krijimin e sigurisë, agjensitë humanitare mund ta gjejnë veten në një pozitë ku ato ose duhet të pranojnë rreziqet e shpërndarjes se ndihmës në një mjedis konflikti, ose të gjejnë burime alternative të sigurisë. Një alternativë e mundshme është përdorimi i forcës policore ndërkombëtare. Në Kamboxhia dhe Bosnjë forcat e policisë ndërkombëtare kanë qënë një element i dukshëm i operacioneve të Kombeve të Bashkuara. Këto forca policore kanë qënë pajisur zakonisht me funksione monitorimi dhe kanë qënë ose të paarmatosura, ose të armatosura lehtë.

Në vitet e fundit ka patur propozime për krijimin e një force speciale të Kombeve të Bashkuara me mandat sigurimin e mbrojtjes së asistencës humanitare. Komisioneri i Lartë për Refugjatët i Kombeve të Bashkuara kohët e fundit e ka diskutuar këtë në konteksin e një kampi sigurie për refugjatët. Konsensusi për nevojën e një force të tillë është ende i largët dhe veprimi edhe më i largët.

---

17. Security Council resolution 836, of 4 June 1993.
18. Conflict, peace and development co–operation, Report Nr.1, Civilian and military means of providing and supporting humanitarian assistance during conflict, Paris 1998, p.9.
19. Security Council resolution 836, of 4 June 1993.

Angazhimi ushtarak në operacionet e fundit humanitare ka qënë rezultat i tre faktorëve: magnituda e disa krizave të fundit dhe pamundësia e kapaciteteve civile për të plotësuar të gjitha nevojat, nevoja për siguri më shumë prej këtyre krizave dhe dëshira e qeverive për t'u dukur aktive përballë nevojës humanitare.

Forcat e armatosura zotërojnë kapacitete unike që mund të kërkohen në operacionet e asistencës humanitare gjatë konfliktit. Këtu përfshihet aftësia për të krijuar siguri, duke përfshirë pastrimin e minave, kapacitetet e specializuara të fluturimeve ajrore, burimet detare, kapacitetet e zbulimit, aftësia për të arritur efektivitetin e shpejtë të rrjetit të komunikimit dhe teknologjinë për tu mbrojtur nga kërcënimet nukleare, biologjike dhe kimike. Ushtritë kombëtare ndryshojnë shumë përsa i përket kapaciteteve. Janë ushtritë e kombeve të zhvilluara ato që mund të sigurojnë kapacitete të përparuara logjistike dhe zbulimi.

Në rastet kur forcat e armatosura marrin pjesë në operacione të tilla humanitare është mirë që autoritetet civile t'ju sigurojnë drejtimin e nevojshëm për integrim në këto përpjekje. Kjo kërkon krijimin e kanaleve të përshtatshme dhe të strukturave integruese.

E drejta e asistencës humanitare ashtu siç ekziston në të drejtën ndërkombëtare të sotme është mjaft e kufizuar. Nuk ka dyshim se kërkesa e opinionit botëror për zgjerim të kësaj të drejte po vjen në rritje. Një zgjerim i tillë do të kërkojë legjislacion të ri ndërkombëtar në formën e një traktati, i cili do merrej me zgjidhjen e problemeve që dalin si në kohë paqeje ashtu edhe në rast konflikti të armatosur.

6.2 KUSHTET NË TË CILAT MUND TË KRYHEN NDËRHYRJET HUMANITARE

Luftërat civile që po shpërthejnë në shumë anë të globit janë kryesisht rezultat i konfliktit ndërshtetëror, ose i dhunës etnike dhe shpesh karakterizohen nga rënia e institucioneve shtetërore dhe shkelja e ligjit dhe e rregullit.[20] Në këto luftëra, civilët janë bërë shënjestra kryesore dhe kanë rezultuar vuajtje njerëzore të panumërta dhe shpesh kriza humanitare shkatërrimtare.

Ka pasur debate të shumta rreth doktrinës së ndërhyrjes humanitare dhe në veçanti rreth të drejtës së shteteve për të ndërhyrë ushtarakisht në një shtet tjetër, pa autorizimin e Këshillit të Sigurimit, me qëllim parandalimin e shkeljeve të mëdha të të drejtave themelore humane dhe të të drejtës humanitare ndërkombëtare. Ajo që del nga debati

është një tension midis vlerave të sigurimit të respektimit për të drejtat themelore njerëzore dhe përparësisë së normave të sovranitetit dhe mosndërhyrjes, të cilat konsiderohen si faktorë kryesorë në ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.[21] Këto vlera janë vendosur në Kartën e Kombeve të Bashkuara si parimet themelore të Kombeve të Bashkuara.

---

20. Patricia Chilton, Dan Plesch, Jamie Patten (1994) NATO, Peacekeeping and the United Nations. United Nations, Department of Peacekeeping Operations, Department of Field Support (2008) Principles and Guidelines.
21. F. J. Leon Diaz, Humanitarian Intervention issues, 2002, p.1, www.javier-leon-diaz.com/docs/humanIntervIssues.htm

Sipas Human Rights Watch, (2004), represioni në Irak në vitin 2003, ishte i rëndë, por ka qenë edhe më i rëndë në vende të tjera. P.sh. tre milion persona, madje edhe më shumë, humbën jetën nga dhuna, sëmundjet në vitet e fundit gjatë konfliktit në Republikën Demokratike të Kongos, megjithatë ndërhyrja u bë me shumë vonesë dhe krahasuar me Irakun ishte shumë modeste.[22]

Përvoja e ish-presidentit jugosllav Sllobodan Milosheviç dhe ish-presidentit Liberian Charles Taylor sugjeron se një akt padi ndërkombëtare diskretiton edhe një udhëheqës të pamëshirshëm, diktatorial. Ky veprim ka për qëllim të minojë mbështetjen e drejtuesit si brenda dhe jashtë vendit. Në rastin e Irakut duke e lejuar Sadam Huseinin të qeveriste pa asnjë lloj padie për genocid dhe krime kundër njerëzimit, komuniteti ndërkombëtar nuk bëri asnjë hap që do të kontribuonte në largimin e tij nga pushteti dhe në një zvogëlim të abuzimeve qeveritare.

Ndërhyrja humanitare është diskutuar gjerësisht që nga mesi i viteve 1970. Ky diskutim është fokusuar në lidhjen ndërmjet rregullit të mosndërhyrjes dhe të drejtës për ndërhyrje humanitare si një përjashtim nga ky rregull. Për më tepër, lidhja ndërmjet të drejtës për ndërhyrje humanitare dhe një përgjegjësie të mundshme për të ndërhyrë, ose për të mbrojtur ka tërhequr vëmendjen vitet e fundit dhe ka bërë që të kalojë vëmendja nga shtetet tek viktimat e krizave humanitare.

Në qoftë se pranojmë se ekziston e drejta për ndërhyrje humanitare, kush janë mbajtësit e kësaj të drejte ?

Në një kuptim të përgjithshëm ekzistojnë 3 opsione kryesore për të përcaktuar mbartësit e të drejtës për ndërhyrje humanitare: [23]

- nuk ekziston asnjë mbajtës i legjitimuar ose ligjor i kësaj të drejte,
- Këshilli i Sigurimit ka të drejtë dhe ai mund të autorizojë ndërhyrjet humanitare dhe
- ndërhyrjet e njëanshme ose të shumëanëshme edhe pa autorizimin e Këshillit të Sigurimit janë të paktën të legjitimuara edhe në qoftë se nuk janë të ligjshme.

Në këto 3 mundësi, mundësia e dytë është edhe më bindëse. Në qoftë se Këshilli i Sigurimit përcakton që ekziston një shkelje, ose kërcënim për paqen dhe sigurinë, Këshilli mund të veprojë sipas pushteteve të Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe përdor forcën ose autorizon përdorimin e forcës. Kështu, ndërhyrja humanitare që nënkupton përfshirjen e përdorimit të forcës, kërkon interpretimin e Këshillit të Sigurimit mbi ekzistencën e shkeljes ose kërcënimit të paqes dhe sigurisë

ndërkombëtare për të qenë e ligjshme. Kohë më parë Këshilli i Sigurimit ka autorizuar ndërhyrje humanitare të cilat u konsideruan të legjitimuara dhe ligjore.[24]

22. Ken Roth, War in Iraq: Not a Humanitarian Intervention, http://hrw.org/wr2k4/3.htm
23. Hannes Peltonen, Right and Responsibility What Kind of Right is the Right of Humanitarian Intervention? mars 2006,p.23.
24. Në praktikën e tij Këshilli i Sigurimit ka kërkuar që Sekretari i Përgjithshëm dhe shtetet përkatëse t'i raportojnë rregullisht Këshillit për zbatimin e rezolutave dhe arritjen e objektivave të kërkuara. Kjo bëhet e qartë në rezolutën e Këshillit të Sigurimit me të cilën autorizohet operacioni i krijimit të një mjedisi të sigurt në Somali, (UNITAF, SC res. 794, 1992),operacioni i krijimit të sigurisë dhe mbrojtjes së personave të zhvendosur, refugjatëve dhe civilëve të rrezikuar në Ruanda "Operation Turquoise", SC res 929, 19940, dhe operacioni për rindërtimin e demokracisë në Haiti, SC res. 940, 1994.

Rasti i parë më i qartë i autorizimit të Këshillit të Sigurimit ishte Somalia, në vitin 1992 me Rezolutën 794. Në këtë Rezolutë, sipas Mandatit të kapitullit VII, Shteteve të Bashkuara iu dha autorizimi për veprim ushtarak ne Somali. Shembull tjetër është në vitin 1994 Rezoluta 929 e cila autorizoi forcat franceze për të përdorur "të gjitha mënyrat e nevojshme për të arritur objektivat ushtarake" në Ruanda.[25]

Në dritën e Kartës së Kombeve të Bashkuara një argument i fortë mund të nxirret që një krizë e rëndë humanitare mund të lejojë që Këshilli i Sigurimit të ndërhyjë për çuarjen përpara dhe respektimin e të drejtave njerëzore, pavarësisht nga parashikimet mbrojtëse. Për më tepër Këshilli i Sigurimit mund të përdorë pushtetet e kapitullit VII të Kartës, që përfshijnë: përdorimin e forcës në situata në të cilat Këshilli ka vendosur "ekzistencën e ndonjë kërcënimi për paqen, shkeljen e paqes ose akt agresioni".[26]

Megjithëse në të shkuarën shkelja e të drejtave të njeriut nuk konsiderohej si shkak për kërcënim të paqes, kjo sot po bëhet evidente nga pohimet dhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit. Për shembull, është pohuar që "zhvendosjet masive të popullsisë civile në situata konflikti mund të shkaktojnë një sfidë serioze për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare" dhe se Këshilli i Sigurimit "ka përgjegjësi për çështjet humanitare që shfaqen në situata konflikti dhe duhet të ndërmarrë veprimet e duhura".[27]

Në të kundërt, kapërcimi i Këshillit të Sigurimit është konsideruar jo ligjor. Çështja më e debatueshme është ajo e Kosovës. Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar mbi Kosovën konkludoi që veprim i NATO-s ishte legjitim por jo ligjor.[28]

Komisioni gjithashtu theksoi se ndërhyrja e NATO-s ishte jo ligjore sepse ajo nuk mori më parë autorizimin e Këshillit të Sigurimit, por ishte legjitime sepse justifikohej nga shterimi i të gjitha mjeteve diplomatike dhe rezultoi në zhbllokimin e pjesës më të madhe të popullsisë së Kosovës nga shtypja serbe.

6.2.1 Ndryshimi mes akteve ligjore dhe legjitime

Çështja e Kosovës nxori në plan të parë dallimin ndërmjet akteve ligjore dhe legjitime. Me gjuhë të zakonshme ato shpesh konsiderohen si sinonime, ndërsa një ekzaminim më i hollësishëm nxjerr në pah se ata ndryshojnë dukshëm.[29] Dy termat lidhen në sensin që në pjesën më të madhe të rasteve aktet ligjore janë gjithashtu legjitime. Në të kundërt, aktet legjitime nuk janë domosdoshmërisht ligjore. Dallimi qëndron në ndryshimin e pikës së referencës për secilin term. Për aktet ligjore autoriteti dhe pika e referencës është ligji ekzistues, ndërsa legjitimiteti i një akti vendoset me ndihmën e normave dhe standarteve subjektive pa ndonjë referencë të nevojshme në ligj. Për më tepër, ky ndryshim midis

ligjores dhe legjitimes mund të lidhet me ndryshimin ndërmjet të pasurit të një të drejte dhe të qënit e diçkaje e drejtë. Pasja e një të drejte lidhet me formën ligjore, ndërsa që diçka të jetë e drejtë i përket sferës së moralit.

25. "Operations Turquoise" u autorizua nga rezoluta 929, 1994 e Këshillit të Sigurimit.
26. Green, L.C. 1993, The Contemporary Law of Armed Conflict, Manchester University Press, Manchester.
27. United Nations Security Council Maintaining Peace and Security: Humanitarian aspects of Issues before the Security Council (S/PV. 4109/2000).
28. Independent International Commission on Kosovo, The Kosovo Report: Conflict International Responses, Lessons Learned (Oxford: Oxford University Press, 2000).
29. Hannes Peltonen, Right And Responsibility, What Kind Of Right Is The Right Of Humanitarian, Intervention? EUI Working Papers, SPS No. 2006/03, p.10, cadmus.eui.eu/bitstream/handle/1814/4357/SPS%202006.03.pdf?...

Kështu rasti i Kosovës duket që e bën ndërhyrjen humanitare të paautorizuar nga Këshilli i Sigurimit legjitime, ose të drejtë, në kuptimin që ajo përputhet me ndërgjegjen tonë. Me fjalë të tjera zbatimi i masave te veçanta gjatë krizave mund të jetë i justifikueshëm dhe nuk mund të dënohet pavarësisht paligjshmërisë së tyre, por është lënë në zgjidhjen morale të vendimmarrësve marrja e vendimeve të tilla, dhe gjetja e mbështetjes për zgjedhjet e tyre. Mundet që të jetë një karakteristikë themelore e akteve legjitime marrja e legjitimitetit të plotë aposteriori.

Në vendosjen e legjitimitetit të një ndërhyrjeje të paautorizuar argumentet në mbështetje të ndërhyrjes si dhe mënyra në të cilën është kryer akti janë elementët më të rëndësishëm.

Si përfundim mund të themi se Këshilli i Sigurimit[30] ka të drejtën ligjore për ndërhyrje humanitare dhe ndërhyrjet pa autorizimin e Këshillit të Sigurimit janë jo ligjore dhe rrezikojnë të jenë jolegjitime. Kështu, pavarësisht mundësisë që ndërhyrjet e paautorizuara mund të jenë legjitime, çështja se çfarëlloj e drejte është e drejta për ndërhyrje humanitare duhet të kufizohet në konsiderimin e Këshillit të Sigurimit si mbartësi i vërtetë i kësaj të drejte.

Ndërhyrjet e paautorizuara mund të jenë legjitime por jo ligjore, dhe kështu nuk mund të konkludohet që ekziston një e drejtë ligjore për ndërhyrje humanitare pa autorizimin e Këshillit të Sigurimit.

Të drejtat e Këshillit të Sigurimit nuk janë shtrirë mbi anëtarët individualë të tij, por qëndrojnë në nivel kolektiv. Këshilli i Sigurimit shpesh nuk është më shumë se tërësia e anëtarëve të tij, aq më tepër që vetëm duke vepruar si një njësi kolektive Këshilli i Sigurimit mund të ushtrojë të drejtat dhe pushtetet e tij.[31]

6.2.2 E drejta e Këshillit të Sigurimit për të autorizuar ndërhyrjet humanitare

Ligjërisht, përdorimi i forcës për të penguar dhunën është legjitim vetëm nëse të gjithë anëtarët e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara i miratojnë këto veprime. Nuk mund të veprohet pa këtë miratim edhe kur mosveprimi nënkupton se dhunimet e të drejtave njerëzore do të vazhdojnë.

Moralisht, por edhe nga fryma e përgjithshme e të drejtës dhe drejtësisë, komuniteti ndërkombëtar duhet të jetë i përgatitur të angazhohet në luftën humanitare për të mbrojtur të drejtat njerëzore.

Sot, komuniteti ndërkombëtar përballet me një dilemë të dhimbshme. Ngandonjëherë, të respektosh sovranitetin do të thotë të bëhesh bashkëpunëtor në dhunimin e të drejtave njerëzore. Të bazohesh në sanksione ekonomike dhe presion diplomatik dhe të argumentosh që Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara duhet të japë pëlqimin për luftë humanitare, do të thotë se ke dështuar në ushtrimin e dhunës kundër regjimeve të dhunës. Të përdorësh forcë në mënyrë të njëanshme, do të thotë të akuzohesh për shkeljen e të drejtës ndërkombëtare.

30. UN Charter, articles 1, para. 1, and 24, para 1.
31. Chris Abbott, Rights and Responsibilities. Resolving the Dilemma of Humanitarian Intervention, September 2005, p.7, sites.tufts.edu/jha/files/2011/04/a180.pdf

Përsa i përket çështjes së një të drejte morale të shteteve për të ndërhyrë në situata të tilla, kur Këshilli i Sigurimit është i paaftë të veprojë, vendet anëtare të NATO-s janë të mendimit se ekziston një justifikim moral dhe politik për të ndërmarrë aksione të tilla. Gjuha e përdorur nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Havier Solana,[32] në kohën e ndërhyrjes së Kosovës, justifikon ndërhyrjen humanitare. Në kohën kur filloi bombardimi në Serbi, Solana pohoi: "Ky veprim ushtarak ka për qëllim të mbështesë qëllimet politike të komunitetit ndërkombëtar. Ne duhet të ndalojmë dhunën dhe t'i japim fund katastrofës humanitare, që tani po shpaloset në Kosovë. Ne kemi një detyrë morale për të vepruar kështu. Përgjegjësia është e jona dhe ne do ta përmbushim atë."

6.3 NDËRHYRJET E NDËRMARRA JASHTË SISTEMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA

Një pyetje që është ngritur shpesh është ajo se a duhet një vend të rrijë duarkryq dhe të lejojë që të kryhet genocid, sepse Këshilli i Sigurimit është i bllokuar, ose a ka ai të drejtë dhe për më tepër detyrim të ndërhyjë pa një mandat të Kombeve të Bashkuara? [33] Sigurisht çështja e genocidit nganjëherë nuk është aspak e qartë. Gjatë gjysmës së parë të 2004, debati vazhdoi për muaj mbi të qenit apo jo të genocidit në rajonin Darfur të Sudanit edhe pse dhjetëra mijëra njerëz ishin vrarë dhe mbi një milion njerëz ishin zhvendosur.

Komisioni Ndërkombëtar mbi Ndërhyrjen dhe Sovranitetin Shtetëror, i krijuar gjatë Samitit të Mileniumit të Kombeve të Bashkuara në shtator 2000 konkludoi se organi më i përshtatshëm për të autorizuar ndërhyrje të tilla ushtarake është Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara dhe se detyra më e ngutshme është që të sigurohet një punë më e mirë e Këshillit të Sigurimit se në të shkuarën. Aty u argumentua se pesë Anëtarët e Përhershëm të Këshillit të Sigurimit nuk duhet të aplikojnë fuqinë e tyre të vetos, veçse në raste kur interesat vitale të shtetit implikohen, për të penguar kalimin e rezolutave që autorizojnë ndërhyje ushtarake për qëllime të mbrojtjes humane për të cilat ekziston mbështetja e shumicës.

Një nga gjërat më të rëndësishme që kanë bërë Kombet e Bashkuara në pak vitet e fundit ka qenë adoptimi nga Asambleja e Përgjithshme e asaj që u quajt Përgjegjësia për të Mbrojtur. Ajo pohon jo vetëm që shtetet kanë për detyrë të mbrojnë banorët e tyre nga genocidi dhe krimet kundër njerëzimit, por nëse ata dështojnë në përmbushjen e këtij angazhimi shtetet e tjera kanë përgjegjësi për mbrojtjen e popullsisë së kërcënuar.[34]

A mundet në rrjedhën e këtyre zhvillimeve të krijohet një doktrinë universalisht e pranuar e ndërhyrjes humanitare mbi bazën e të cilës të veprojë komuniteti i gjerë ndërkombëtar? Po t'i biem shkurt, përgjigjja do të ishte mundet, sepse duhet bërë kështu.

---

32. NATO 1999, "Press Statement by Javier Solana, Secretary General of NATO," NATO Press Release No. 040, 1999, 23 March. Available from http://www.nato.int/docu/pr/1999/p99-040e.htm.
33. Guicherd, Catherine 1999, "The International Law and the War in Kosovo," Survival 41(2),19-34.
34. Morton H. Halperin, Iraq and Responsibility to Protect, 29 may 2007, p.1, www.americanprogress.org/issues/2007/07/halperin_testimony.html

Megjithatë ka rezistencë brenda qarqeve qeveritare mbi zhvillimin e një kornize brenda të cilës mund të vendosen ndërhyrjet, megjithëse ekziston vërtet nevoja e një kornize të qartë në qoftë se duam që ndërhyrjet të jenë dhe të shihen si legjitime nga sytë e atyre vendeve në çështjet e të cilëve tenton të ndërhyjë komuniteti ndërkombëtar.[35]

Shtetet politikisht dhe ushtarakisht më të dobëta të Afrikës dhe shtetet me rëndësi strategjike të Lindjes së Mesme ka më shumë të ngjarë që të përballen me "kërcënimin" e ndërhyrjeve humanitare në të ardhmen. Në mënyrë që këto ndërhyrje të shihen si legjitime nga sytë e të gjithë shteteve, ata duhet të zhvillohen brenda një kornize për të cilën është rënë dakort ndërkombëtarisht.

Fatmirësisht, në formën e Kombeve të Bashkuara, bota tashmë ka një organizatë diplomatike dhe ushtarake me aftësi potenciale për t'u marrë me të gjitha çështjet e paqes, sigurisë dhe mbrojtjes njerëzore.[36] Ndërhyrja kolektive e aprovuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara është parë nga shumica si legjitime sepse ajo autorizohet nga një organ ndërkombëtar përfaqësues. Ndërhyrjet e ndërmarra jashtë sistemit të Kombeve të Bashkuara janë parë shpesh si jolegjitime sepse ato mund të bëhen për interesa vetjake, me arsye humanitare të ofruara si justifikim dytësor për veprimin ushtarak.

Për më tepër, mund të thuhet se ekziston tashmë një doktrinë e fuqishme dhe progresive e ndërhyrjes humanitare, në formën e kornizës dhe rekomandimeve të vendosura në raportin e Komisionit Ndërkombëtar mbi ndërhyrjen dhe sovranitetin shtetëror, "Përgjegjësia për të Mbrojtur". [37]

6.3.1 Nevoja e arritjes së një konsensusi ndërkombëtar mbi kriteret e zhvillimit të ndërhyrjeve humanitare.

Mendimi i sotëm, i shumë studiuesve është që ndërhyrja e paautorizuar nga Këshilli i Sigurimit, nga një shtet, ose grup shtetesh është e paligjshme.[38] Sidoqoftë nuk mund të mohohet mundësia e zhvillimit në të ardhmen të një rregulli zakonor, i cili lejon ndërhyrjen e paautorizuar.

Duke analizuar veprimin e NATO-s në Kosovë, Antonio Cassese pohon: "Ky moment i veçantë, i shkeljes së të drejtës ndërkombëtare, mund të çojë gradualisht në kristalizimin e një rregulli të përgjithshëm të së drejtës ndërkombëtare, që autorizon përdorimin e forcës së armatosur, me qëllimin e vetëm për t'i dhënë fund barbarizmave e krimeve kundër njerëzimit, të cilat përbëjnë një kërcënim për paqen." [39]

35. Falk, Richard 1999, 'Kosovo, World Order, and the Future of International Law, "American Journal of International Law 93, 847-857.
36. H.P. Gasser, ICRC (ed.), Report on the Symposium on humanitarian action and peace-keeping operations (1994), pp. 443-473.
37. The Responsibility to Protect, December 2001, Report of the International Commission on Intervention and State Sovereignty. http://en.wikipedia.org/wiki/Responsibility_to_protect
38. Murphy, Sean d. 1996, Humanitarian Intervention: the United Nations in an Evolving World Order, University of Pennsylvania Press, Philadelphia.
39. Antonio Cassese, Human rights in a changing world, (Philadelphia; Temple University Press 1999).

Për të parandaluar tragjeditë, si ajo e Kosovës dhe Ruandës, është e nevojshme që komuniteti ndërkombëtar të arrijë konsensus, jo vetëm mbi pohimin që shkeljet masive dhe sistematike të të drejtave të njeriut duhen kontrolluar, kudo që të ndodhin, por gjithashtu mbi mënyrat, kohën dhe vendin e marrjes së vendimit për veprimet e nevojshme.

Sipas shumë studiuesve të së drejtës humanitare duhet të ekzistojnë dy kushte që të konsiderohet një ndërhyrje si humanitare:[40]

a. Qeveria duhet të jetë duke kryer ose mbështetur kryerjen e shkeljeve të të drejtave të njohura njerëzore.

b. Duhet të këtë pasur shkelje të shumta të së drejtës, që rezultojnë në të tilla privime masive të të drejtave njerëzore, të cilat qeveria e shtetit në fjalë është e paaftë t'i ndalojë.

Sidoqoftë duhet të jepet një përkufizim i saktë i këtyre shkeljeve, që justifikojnë ndërhyrjen humanitare, me qëllim që të evitohen abuzimet.[41]

Qeveria e shtetit ku kryhen shkeljet e të drejtave të njeriut duhet të paralajmërohet nga Komuniteti Ndërkombëtar që të ndalojë shkeljet e të drejtave themelore humane.

Në situata ku veprimet e dhunshme nuk kryhen nga autoritetet qendrore, qeverisë së shtetit në fjalë duhet t'i kërkohet të marrë masa për të ndaluar kryerjen e shkeljeve, ose të lejojë organizata ndërkombëtare që të asistojnë në parandalimin e akteve të tilla dhe të zgjidhin krizat humanitare.

6.3.2 Organizmi i cili do të marrë vendimin për fillimin e një ndërhyrje humanitare të armatosur.

Një çështje tjetër, shumë e debatueshme, në kuadrin e ndërhyrjeve të armatosura, është përcaktimi i organizmit i cili do të marrë vendimin për fillimin e një ndërhyrje të armatosur.

Veprime të tilla duhet të ndërmerren nga një grup shtetesh dhe jo nga një "fuqi e vetme hegjemonike".

Charney,[42] sugjeron se ndërhyrja e paautorizuar duhet të ndërmerret nga organizatat rajonale përkatëse. Organizatat rajonale, të themeluara sipas kapitullit VIII të Kartës, janë

të ndaluara të ndërmarrin veprime të dhunshme, pa autorizimin e Këshillit të Sigurimit, (neni 53/1).

---

40. Stefan Kirchner, The Human Rights Dimensions of International Peace and Security: Humanitarian Intervention after 9/11, 15 Oct 2003, p.6, www.ssrn.com/abstract=445124
41. Penelope C.Simons, Humanitarian Intervention, A Review of Literature, f. 21, www.ploughshares.ca/libraries/Working Papers/wp012.html
42. Jonathan I. Charney , Anticipatory humanitarian intervention in Kosovo, p.6, http://www.questia.com/googleScholar.qst?docId=5001866798

Sidoqoftë, meqë ata kanë një mandat për t'u marrë me çështje të tilla, të cilat kanë të bëjnë me ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, aq sa është e përshtatshme për veprim rajonal, implikimi i organizatave rajonale respektive si aktor kryesor në një ndërhyrje humanitare të paautorizuar do të rriste legjitimitetin e ndërhyrjes.Megjithatë, praktikisht pjesa më e madhe e rajoneve nuk kanë aftësitë e mjaftueshme dhe organizata sigurimi të afta për të zbatuar një operacion paqeruajtje dhe operacion zbatimi të paqes.[43]

Autorë të tjerë argumentojnë se ndërhyrja humanitare duhet drejtuar nga shtete, të cilat nuk kanë përfitime politike dhe ekonomike nga ndërhyrja. Sidoqoftë, të pranosh idenë e një ndërhyrje thjesht humanitare është të kërkosh idealen. Shtetet praktikisht duhet të kenë motive të tjera, përveç humanizmit, për të qenë të gatshëm për të ndërhyrë, qoftë kjo dëshirë për të penguar fluksin e kalimit të refugjatëve në kufirin e shtetit ku bëhet ndërhyrja, ose për interesa strategjike dhe ekonomike në rivendosjen e rendit, në shtetin ku ndërhyhet.[44]

Vendimi për të ndërhyrë ose jo, mundet gjithashtu të merret nga një organizatë që është e hapur, e përgjegjshme dhe përfaqësuese.

Asnjë ndërhyrje nuk do të konsiderohet e ligjshme kur shtetet nuk i përmbahen në mënyrë strikte të drejtës së konfliktit të armatosur dhe në veçanti parimeve dhe rregullave të së drejtës ndërkombëtare humanitare.[45] Përdorimi i forcës për qëllime humanitare duhet të kufizohet brenda këtij qëllimi. Në rastin e ndërhyrjes humanitare të paautorizuar, forca e armatosur duhet përdorur vetëm për ndalimin e barbarizmave dhe për të rivendosur respektin për të drejtat njerëzore dhe jo për qëllim tjetër. Si rrjedhojë përdorimi i forcës duhet të ndërpritet sapo të jetë arritur qëllimi.

Një numër autorësh argumentojnë se, meqë qëllimi i ndërhyrjes humanitare është që t'i japë fund privimeve masive të të drejtave njerëzore, ndërhyrja nuk duhet të prekë, ose të paktën të ketë efekt minimal ndaj strukturave politike të shtetit në fjalë, si dhe duhet ruajtur integriteti territorial i shtetit në të cilin kryhet ndërhyrja.

Doktrina e "të drejtës për të ndërhyrë" është një përpjekje për të sfiduar strukturën tradicionale ligjore, duke vënë në pikëpyetje vetë konceptin e sovranitetit, në të cilin ajo është bazuar. Pushteti i një shteti, thotë ajo, duhet t'i nënshtrohet "parimit të urgjencës ekstreme", nevojave për një mbrojtje minimale të të drejtave të njeriut.[46]

43. Niko Krisch, Legality, morality and dilemma of humanitarian Intervention after Kosovo, April 02, p.7, gupea.ub.gu.se/bitstream/2077/2013/1/200422.pdf
44. O' Connell, Mary Ellen 2000, "The UN, NATO, and International law After Kosovo," Human Rights Quarterly 22, 57-89.
45. Smith, Michael J. 1999, " Humanitarian Intervention; An Overview of the Ethical Issues,' pp.271-295 in ethics and International affairs; a reader, ed. Joel H. Rosenthal, Georgetown University Press, Washington, DC.
46. Oliver Corten, Humanitarian Intervention, a controversial right, f. 9, www.jag.navy.mil/documents/navylawreview/NLRVolume59.pdf

"Detyrimi për ndërhyrje" ishte një term i krijuar për herë të parë në fund të viteve 1980, nga Profesor Mario Bettati dhe politikani francez Bernard Kushner. Ata u shtynë nga përdorimi i konceptit të sovranitetit shtetëror, si mbrojtje për shkeljet e mëdha që një shtet i bënte të drejtave bazë humane të popullsisë së tij. Duke ndjekur operacionin kurd të Sadam Hussein në vitin 1991, Kushner dhe të tjerë në qeverinë e Miteranit kërkuan "të drejtën e ndërhyrjes humanitare", të drejtën për të ndërhyrë kur shtetet shtypin qytetarët e tyre. Kushneri, (i cili ishte bashkëthemelues i Medicin Sans Frontieres, në vitin 1971), argumentoi që ekzistonin disa të ashtuquajtura kriza humanitare, të cilat ishin të motivuara politikisht, kështu që mund t'iu drejtoheshe vetëm me ushtrim vendimtar të fuqisë shtetërore.[47]

Nocioni i Kushnerit mbi të drejtën për të ndërhyrë në baza humanitare u përdor nga Kombet e Bashkuara në Irak në 1991, në Haiti[48] në 1994, në në Somali në 1992, si dhe nga Franca në Ruandë në 1994.

Në kohën e ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, Kryeministri Toni Bler argumentoi se problemi më i madh i politikës së jashtme ishte të identifikoheshin rrethanat në të cilat shtetet duhet të implikohen aktivisht në konfliktet e popujve të tjerë. Ai shpalosi për herë të parë doktrinën e tij mbi komunitetin ndërkombëtar në një fjalim të mbajtur në Çikago, në 22 prill 1999. Bler bëri thirrje për idenë e një lufte të drejtë, bazuar jo në ambiciet territoriale, por në vlera.[49] Ai propozoi pesë konsiderata kryesore, para se të vendoset se ku dhe kur mund të ndërhyhet.

a) A jemi të sigurt për çështjen tonë?
b) A i kemi shteruar të gjitha mjetet diplomatike?
c) A ekzistojnë veprime ushtarake, të cilat mund të ndërmerren në mënyrë të matur dhe sensibël?
d) A jemi të përgatitur për një kohëzgjatje të madhe?
e) A kemi interesa kombëtare të implikuar?

Toni Bler nuk i sugjeroi këto pika si absolute, por si të nevojshme për t'u marrë në konsideratë, në momentet e vendosjes se kur dhe ku duhet ndërhyrë. Ai argumentoi se këto rregulla do të funksiononin vetëm në qoftë se do të gjendej një rrugë e re për t'i bërë Kombet e Bashkuara vepruese dhe kështu të shmanget dështimi i plotë, i cili kishte minuar efektivitetin e Këshillit të Sigurimit gjatë Luftës së Ftohtë.

Doktrinës së Blerit mbi komunitetin ndërkombëtar iu ngritën disa pikëpyetje, si p.sh.:

47. Chris Abbott, Rights and Responsibilities. Resolving the Dilemma of Humanitarian Intervention, September 2005, p.2, sites.tufts.edu/jha/files/2011/04/a180.pdf
48. M. Bothe & R.Siekmann, "Restoring democracy and human rights in Haiti: Whose peace?", 1 International Peacekeeping (1994), no 3, p.101.
49. Chris Abbott, Rights and Responsibilities. Resolving the Dilemma of Humanitarian Intervention, September 2005, p.5, sites.tufts.edu/jha/files/2011/04/a180.pdf

- Kush është komuniteti ndërkombëtar? (Një serb nga një fshat i Kosovës mund të mendonte se në fakt po bombardoheshin nga një grup i vogël kombesh perëndimore, të cilët kishin vendosur ta quanin veten "komunitet ndërkombëtar".)
- Cilat vlera po mbrojmë?
- Kush vendos se cila palë është "e mirë" dhe cila palë është "e keqe" në një konflikt?

Çdo forcë e fuqishme për të ndërhyrë jashtë Kombeve të Bashkuara, duhet të ketë interesa që kapërcejnë interesin e pushimit të genocidit dhe çlirimit nga shtypja. Siç e pohoi edhe Bler, ka gjithashtu masa politike, diplomatike, ekonomike dhe financiare që mund të përdoren.

Pak pas fjalimit të Blerit, në Çikago, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara Kofi Annan ngriti dilemën e ndërhyrjes, në fjalimin e tij në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, në vitin 1999 dhe përsëri në vitin 2002. Ai i kërkoi komunitetit ndërkombëtar të arrinte një konsensus të ri mbi gjetjen e një zgjidhjeje për këto çështje dhe të rriste unitetin rreth parimeve bazë e proceseve të implikuar. Ai ngriti pyetjen: "Në qoftë se ndërhyrja humanitare është vërtetë një sulm i papranueshëm ndaj sovranitetit, si duhet t'i përgjigjemi Ruandës, Serbrenicës dhe dhunimeve të mëdha dhe sistematike të të drejtave njerëzore, të cilat ofendojnë çdo udhëzim të sjelljes sonë të përbashkët njerëzore?"

Nga njëra anë, a është e ligjshme që një organizatë rajonale të përdorë forcën pa një mandat të Kombeve të Bashkuara? Nga ana tjetër, a është e lejueshme të lejosh shkelje të mëdha dhe sistematike të të drejtave njerëzore, me pasoja të rënda humanitare dhe në mënyrë të pakontrolluar?[50] Duke kërkuar përgjigjen e këtyre pyetjeve, Annan diskutoi katër aspekte të ndërhyrjes, të cilat sipas tij duheshin marrë në konsideratë me kujdes.

a) "Ndërhyrja" nuk duhet kuptuar sikur i referohet vetëm përdorimit të forcës. Angazhimi i botës në paqeruajtje, asistenca humanitare, rehabilitimi dhe rindërtimi ndryshon shumë nga një rajon në tjetrin.

b) Nocionet tradicionale të sovranitetit nuk janë pengesa e vetme për aksion efektiv në krizë humanitare. Jo më pak të dukshme janë mënyrat me të cilat shtetet i përkufizojnë interesat e tyre kombëtare. Nevojitet një përkufizim i ri, më i gjerë i interesit kombëtar, që t'i shtyjë shtetet të gjejnë unitet më të madh në ndjekjen e qëllimeve dhe vlerave të përbashkëta, si dhe të kuptojnë se interesi kolektiv është interes kombëtar.

c) Në rastet kur ndërhyrja me forcë bëhet e nevojshme, Këshilli i Sigurimit duhet të jetë në gjendje të ngrihet ndaj kësaj sfide. Kombet e Bashkuara duhet të jenë në gjendje të gjejnë bazë të përbashkët në ruajtjen e parimeve të Kartës dhe të veprojnë në mbrojtje të njerëzimit tonë të përbashkët.

d) Kur luftimi mbaron angazhimi ndërkombëtar në paqe duhet të jetë po aq i fortë sa dhe angazhimi në luftë.

---

50. Annan, Kofi 1999, "Two Concepts of Sovereignty", The Economist, 18 September, www.un.org/Overview/SG/kaecon.htm

Pas kësaj sfide së shtruar nga Kofi Annan[51], kryeministri i atëhershëm i Kanadasë Jean Chretien, gjatë samitit të Mileniumit të Kombeve të Bashkuara, në shtator 2000, shpalli krijimin e Komisionit Ndërkombëtar mbi Ndërhyrjen dhe Sovranitetin Shtetëror. Mandati i këtij komisioni të pavarur ishte promovimi i debatit të gjithanshëm global mbi marrëdhënien ndërmjet ndërhyrjes dhe sovranitetit shtetëror.

Pas një viti, komisioni publikoi raportin e tij "Përgjegjësia për të mbrojtur" dhe ia paraqiti atë formalisht Kofi Annanit, në dhjetor 2001. Tema kryesore e raportit ishte ideja që shtetet sovrane kanë përgjegjësi për të mbrojtur qytetarët e tyre nga katastrofat e pashmangshme, nga vrasjet masive dhe përdhunimi, nga vdekja prej urisë. Kur ata nuk kanë vullnet, ose nuk janë në gjendje ta bëjnë këtë, atëherë përgjegjësia duhet t'u mbetet shteteve të komunitetit të gjerë. [52]

Pra, raporti nxiti një ripërcaktim të konceptit të sovranitetit si përgjegjësi. Ai vlerësoi se të drejtat që ju takojnë shteteve sovrane janë në balancë me përgjegjësitë. Raporti argumentoi se kur një popullsi civile vuan nga abuzimet serioze me të drejtat njerëzore dhe shteti në fjalë është i pavullnetshëm ose i paaftë t'i shmangë ato, parimi i mosndërhyrjes duhet t'i nënshtrohet përgjegjësisë ndërkombëtare për të mbrojtur atë popullsi.

6.4 NDËRHYRJET HUMANITARE NË TË SHKUARËN

Doktrina e ndërhyrjes humanitare ka tërhequr vëmendjen veçanërisht pas krizës së Kosovës dhe luftës së NATO-s kundër Jugosllavisë. Megjithatë ideja e saj është shumë më e vjetër. Një prej themeluesve të së Drejtës Ndërkombëtare, Hugo de Groot[53], qysh në fillim të shekullit të shtatëmbëdhjetë, mbrojti të drejtën e shteteve për të ndërhyrë, në qoftë se trajtimi që një shtet i bënte qytetarëve të tij do të shokonte ndërgjegjen e njerëzimit. Sipas Grocit, "Qytetarët kanë të drejtë për revolucion në rastet ekstreme të tiranisë."

Ndërsa këto të drejta do të ushtroheshin së pari nga qytetarët e kombit në fjalë, shtetet e tjera lejoheshin të mbështesnin qytetarët e shtypur, në qoftë se ata i kërkonin ndihmë fuqive të huaja.

---

51. Annan, Koffi 2000, "We the Peoples':The role of the United Nations in the 21st Century,".United Nations, International Peacekeeping 2, 140-156.
52. Responsibility to Protect, from Wikipedia, the free encyclopedia, The responsibility to protect (R2P or R to P) is a United Nations initiative established in 2005., en.wikipedia.org/wiki/Responsibility_to_protect
53. Hugo Grotius, http://en.wikipedia.org/wiki/Hugo_Grotius

Mbrojtja që Groci[54] i bënte ndërhyrjes humanitare lidhej me doktrinën e rezistencës legjitime ndaj represionit. Ideja e Grocit ndihmohej nga fakti që në atë kohë e drejta ndërkombëtare nuk kishte vendosur ende një ndalim absolut të përdorimit të forcës, si e drejta ndërkombëtare moderne, që njohu Paktin Briand – Kellog, në vitin 1928 dhe tashmë në nenin 2(4) të Kartës së Kombeve të Bashkuara mbi ndalimin e luftës. Ideja e nxjerrë nga Groci u mbështet nga pjesa më e madhe e juristëve deri në fund të shekullit të 19 – të.

Ndërhyrje humanitare kanë ndodhur edhe në të shkuarën.

Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe Rusia, ndërhynë në Greqi, në vitet 1927 – 1930, për të ndaluar masakrat turke dhe shtypjen e popullsisë civile greke.

Austria, Franca Italia, Prusia dhe Rusia ndërhynë në Kretë, në vitet 1866 – 1868, për të mbrojtur popullsinë kristiane, e cila shtypej nga turqit.

Fuqitë evropiane ndërhynë kolektivisht në Ballkan, në vitet 1875 – 1878, në mbështetje të kryengritësve kristianë në Bosnjë & Hercegovinë dhe Bullgari, të cilët kishin qenë subjekt i masakrave turke.

Fuqitë evropiane ndërhynë në Turqi, në vitet 1903 – 1908, për të mbrojtur popullsinë e shtypur kristiane maqedonase.

Duhet theksuar se jo konsideratat mbi të drejtat humane, por ndryshimet themelore fetare ndërmjet fuqive evropiane dhe Perandorisë Otomane ishin shkaku i ndërhyrjeve nga Perëndimi.

Pas Luftës së Parë Botërore përdorimi legjitim i forcës u kufizua në rastet e vetëmbrojtjes, mbrojtjes së paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Kjo vlen edhe sot, kur Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara ka mundësinë e mbrojtjes së të drejtave njerëzore përmes masave sipas kapitullit VII, i cili fillimisht nënkuptonte "vetëm mbrojtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare", veçanërisht kur shkeljet masive dhe sistematike të të drejtave njerëzore kanë potencial për të kërcënuar paqen[55] dhe sigurinë ndërkombëtare dhe në rastet kur duhet përballur me një numër të madh refugjatësh, me shkelje të të drejtave humane lidhur me etnicitetin, (si në Kosovë) dhe angazhimin e kombeve fqinjë (si në luftën e Kongos).

---

54. Hugo Grotius (10 prill 1583-28 gusht 1645) ka punuar si jurist në Republikën Hollandeze. Grotius ishte shumë i interesuar për çështjet që lidheshin me konfliktet ndërmjet kombeve dhe besimeve. Ai shkruante: Kam parë një mungesë kufizimi në lidhje me luftën. Kam vënë re se njerëzit i drejtohen armëve për arsye të thjeshta ose pa asnjë arsye dhe sapo rrëmbehen armët nuk ka më respekt për ligjin hyjnor ose njerëzor. Tërbimi është lënë haptazi i lirë për kryerjen e të gjitha krimeve. Libri "Mbi të Drejtën e Luftës dhe Paqes: tre librat" u publikua për herë të parë në vitin 1625. Ky libër mbështetej në një sistem të parimeve të së drejtës natyrore, të cilat mund të shtrihen si të detyrueshme mbi të gjithë njerëzit dhe kombet pavarësisht zakonit lokal. Libri i I-rë avancon konceptin e tij të luftës dhe të drejtësisë natyrore, duke argumentuar se ekzistojnë disa rrethana në të cilat lufta është e justifikueshme. Libri i II-të identifikon tre "shkaqe të drejta" për luftë: vetëmbrojtja, riparimi i dëmit, dhe ndëshkimi. Libri i III-të merret me çështjen se cilat rregulla drejtojnë sjelljen në luftë pasi lufta ka filluar; Grotius argumenton se të gjitha palët në luftë janë të lidhura me këto rregulla, pavarësisht faktit se çështja e tyre është e drejtë ose jo.

55. R. Siekmann, "No doubts about the legality of NATO action in Bosnia", 2 International Peacekeeping (1995), n° 5, at p. 121.

Gjatë Luftës së Ftohtë, në një kohë kur Këshilli i Sigurimit kishte shumë mundësi të dështonte plotësisht për shkak të faktit që si SHBA dhe BS kishin të drejtën e vetos, ndërhyrja nuk mund të ndodhte meqë nuk ekzistonte vullneti dhe as mundësia për të ndërhyrë kolektivisht për qëllime humanitare, veçanërisht lidhur me vendet në sferën e influencës të njërës apo tjetrës palë në Luftën e Ftohtë.

Frika e një Lufte të Tretë Botërore në atë kohe ndalonte mbrojtjen me forcë të të drejtave njerëzore.[56] Për më tepër, pjesa më e madhe e anëtarëve të Kombeve te Bashkuara, të cilët nga viti 1960 përbëheshin nga kombe jo perëndimore dhe ish–koloni, e konsideronin nocionin e ndërhyrjes humanitare si një relike të kolonializmit dhe shkelje të doktrinës themelore të barazisë sovrane të shteteve, gjë që çonte në heshtje të shumë kombeve përballë shkeljeve masive të të drejtave njerëzore në atë kohë.

Vetëm pasi Luftës së Ftohtë i erdhi fundi me revolucionet paqësore të vitit 1989, ideja e mbrojtjes së detyrueshme të të drejtave njerëzore ishte në gjendje të fitonte përsëri terren.[57] Në vitet 1990 u bë e mundur, për herë të parë në historinë moderne, që komuniteti ndërkombëtar të ndërmerrte aksione të përbashkëta për mbrojtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, si dhe të të drejtave njerëzore. Por edhe pas përfundimit të Luftës së Ftohtë ndërhyrja humanitare nuk fitoi mbështetje të gjerë menjëherë. Shumë shkelje masive të të drejtave njerëzore mbetën pa përgjigje nga komuniteti ndërkombëtar, për shkak se fuqitë që ishin në gjendje të vepronin nuk kishin vullnetin për të vepruar, sidomos pas fatkeqësisë ose dështimit të Shteteve të Bashkuara në Somali.

6.5 NEVOJA PËR NDRYSHIM

Ndërhyrja e NATO–s, e vitit 1999 kundër ish–Jugosllavisë, pati kritika të ashpra nga Rusia dhe Kina, por u mbështet më pas nga Kombet e Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara Kofi Annan, duke iu drejtuar Komisionit të Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat humanitare, theksonte: "Për vrasësit masivë, për spastruesit etnikë, për ata që janë fajtorë për shkelje të mëdha dhe shokuese të të drejtave njerëzore, pandëshkueshmëria është e papranueshme. Kombet e Bashkuara nuk do të jenë kurrë streha e tyre. Karta e Kombeve të Bashkuara nuk do të jetë kurrë burim qetësie ose justifikimi. Ngadalë, por patjetër do të ndodhë që një normë ndërkombëtare kundër represionit të minoriteteve do të fitojë epërsi mbi sovranitetin shtetëror."

Një shtet sovran, sipas të drejtës ndërkombëtare, ka të drejtën e ushtrimit të një juridiksioni total brenda kufijve të tij territorialë. Shtetet e tjera kanë detyrimin për të mos ndërhyrë në çështjet e brendshme të një shteti sovran. Ky parim postkolonial është mbështetur dhe mbrojtur më shumë nga shtetet e dobëta, meqë atyre ju ofron mbrojtjen e fundit përballë presionit të shteteve më të fuqishme, veçanërisht në botën e sotme të globalizuar.

Por, a dëshiron sot komuniteti ndërkombëtar të autorizojë shtetet, ose grupet e shteteve të përdorin forcë kundër një shteti që nuk respekton të drejtat e shtetasve të tij?

---

56. A. Rupp, C. E. Philipp. "Conflicts, Cambodia/Kampuchea", in R. Wolfrum, C. Philipp (ed.), op. cit. note 5, p.200 et seq.
57. Wheeler, Nicholas J. and Morris, Justin 1996, "Humanitarian Intervention and State Practice at the End of the Cold War,' pp. 135-177, in International Society after the Cold War,eds.Rick Fawn and Jeremy Larkins, St. Martins Press, New York.

Ende nuk ekziston një konsensus në komunitetin ndërkombëtar për zhvillimin dhe formalizimin e kritereve për ndërhyrje humanitare, megjithëse pranohet mundësia e vendosjes së kritereve të tilla.

Përdorimi i forcës për të ndaluar privimet masive të të drejtave të njeriut është një çështje e kontestuar në shumë nivele. Arritja e konsensusit ndërkombëtar mbi kriteret e ndërhyrjeve të tilla dhe në veçanti për ndërhyrjet e paautorizuara, do të kërkojë diskutime dhe debate ndërmjet akademikëve dhe organizatave joqeveritare eksperte në këtë fushë.

Është e vështirë të gjesh një konsensus ndërkombëtar, madje edhe ndërmjet shteteve të NATO-s, për të mbështetur këtë ide. Nuk ekziston ndonjë praktikë shumë e përhapur shtetërore që të mbështesë këtë pikëpamje.[58] Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme, që dënojnë ndërhyrjet specifike, përdorimin e forcës në mbrojtje të të drejtave të njeriut, demonstrojnë kundërshtimin ndërkombëtar për një rregull të tillë. Për më tepër statutet e asnjë prej Gjykatave Penale Ndërkombëtare ekzistuese nuk autorizojnë ndërhyrje të tilla. (Gjykata për ish- Jugosllavinë, Ruandën dhe Gjykata Penale Ndërkombëtare).

Në rastin e Kosovës, Rusia dhe Kina kritikuan hapur faktin që NATO veproi pa autorizimin e Këshillit të Sigurimit.Në mungesë të autorizimit nga ana e Këshillit të Sigurimit, NATO nuk kishte të drejtë të përdorte forcën, sepse anëtarët e kësaj organizate individualisht ose kolektivisht kanë të drejtë për vetëmbrojtje kur përballen me sulme të armatosura nga shtete të tjera. Gjithashtu, pjesa më e madhe e shteteve anëtare të NATO-s, të cilat morën pjesë në ndërhyrjen e Kosovës, kanë theksuar se përdorimi i paautorizuar i forcës në këtë rast ishte një incident i vetëm dhe nuk duhet parë si përpjekje për të modifikuar regjimin e përdorimit të forcës.[59] Deklarime të tilla kanë bërë disa shtete anëtare të NATO-s, përfshirë Shtetet e Bashkuara, Francën, Gjermaninë dhe Belgjikën.

A mundet e drejta ndërkombëtare ta legalizojë ndërhyrjen humanitare?

Mund të argumentohet se ky hap është moralisht i kërkuar edhe nga ana etike. E drejta ndërkombëtare publike, si të gjitha te drejtat, duhet t'i përshtatet idealeve më të larta.[60] Ndërhyrja humanitare mund të mbrojë të drejtat e njeriut, shkelja e të cilave mund të shkaktojë rreziqe për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, por nga ana tjetër ndërhyrja humanitare paraqet rrezik për abuzim. Nëse një e drejtë e tillë do të pranohet, ajo do të jetë praktikisht e vështirë për t'u kontrolluar.

Përdorimi i forcës jashtë Kombeve të Bashkuara krijon mundësinë e keqpërdorimit të konceptit të ndërhyrjes humanitare nga vende të ndryshme. Ne nuk duhet të harrojmë se në vitin 1939 Gjermania Naziste përdori arsyet humanitare për të legjitimuar pushtimin e Çekosllovakisë, duke deklaruar se gjermanët etnikë po keqtrajtoheshin në Sudetenland.[61] Pra ndërhyrja humanitare paraqet vështirësi serioze, pavarësisht nga qëllimi i saj fisnik.

---

58. Chris Abbott, Rights and Responsibilities. Resolving the Dilemma of Humanitarian Intervention, September 2005, p.9, sites.tufts.edu/jha/files/2011/04/a180.pdf
59. Roberts, Adam 1999, "NATO's 'Humanitarian War' over Kosovo," Survival 41(3), 102-123.
60. William, John1999, "The Ethical Basis of Humanitarian Intervention, the Security Council and Yugoslavia, "International Peacekeeping 6(2), 1-23.
61. Chris Abbott, Rights and Responsibilities. Resolving the Dilemma of Humanitarian Intervention, September 2005, p.4, sites.tufts.edu/jha/files/2011/04/a180.pdf

Pavarësisht nga këto pengesa, mbështetja për doktrinën e ndërhyrjes humanitare mund të vijë duke u rritur. Në se komuniteti ndërkombëtar dëshiron të vendosë një ligj të ri, i cili të lejojë ndërhyrjen humanitare, ai duhet të zbatohet në ato situata kur ka shkelje të rënda dhe masive të të drejtave të njeriut. Mënyra më e përshtatshme, por gjithashtu edhe më e vështirë për t'u realizuar me qëllim që të përmbushet objektivi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut por pa kaluar në abuzime, do të ishte amendimi i Kartës së Kombeve të Bashkuara.[62]
Zhvillimi i normës ndërkombëtare në favor të ndërhyrjes për mbrojtjen e civilëve do vazhdojë, pavarësisht nga vështirësitë e vënies së saj në zbatim, sepse njerëzimi sot është më pak i gatshëm se në të kaluarën për të toleruar vuajtjet dhe më i gatshëm për të zgjidhur këtë problem.

Ndoshta ndërhyrja në Kosovë vendos një precedent të ri për zhvillimin e të drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Mbi të gjitha, e drejta ndërkombëtare e përgjithshme mund të ndryshohet përmes identifikimit të mangësive të saj dhe zhvillimit të një politike të re të shteteve.

6.6 PERFUNDIME

Të drejtat njerëzore nuk mund të konsiderohen më thjesht si një çështje e brendshme dhe koncepti i sovranitetit nuk mund të përdoret nga qeveritë për të mbrojtur veten nga përgjegjësia për shkelje të mëdha të këtyre të drejtave, ose nga shmangia e detyrimeve lidhur me mbrojtjen dhe trajtimin e civilëve në situatat e konfliktit ndërshtetëror.

Parimisht, kushdo është dakord me ndryshimet që sjellin ndërhyrjet humanitare në fatin e viktimave të konflikteve në vende të ndryshme të botës. Është diçka e virtytshme të rrezikosh jetën për të shpëtuar njerëz të largët nga masakra. Por, shihen dallime të dukshme ndërmjet ndërhyrjeve humanitare të zhvilluara. Disa janë të motivuara nga dëshira për të ndaluar masakrat që kryhen. Përkundrazi, disa të tjera kryhen mbi baza të ndryshme dhe vetëm një arsye e vogël është arsyeja humanitare.

Dikush mund të përdorë forcën ushtarake kur një qeveri, e cila përballet me abuzime serioze në territorin e saj, kërkon asistencë ushtarake nga të tjerët. Por ndërhyrja ushtarake mbi baza humanitare pa pëlqimin e qeverisë së vendit ku do kryhet ndërhyrja duhet përdorur me një kujdes ekstrem.

Ndërhyrja humanitare, që kryhet pa pëlqimin e qeverisë përkatëse, mund të justifikohet mbi bazën e genocidit që vazhdon, ose masakrave masive të krahasueshme me të, ose humbjet e jetës.

Ndërhyrja humanitare në një vend, veçanërisht pa aprovimin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, dëmton rregullin ligjor ndërkombëtar i cili është i rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të shteteve. Prandaj ndërhyrjet ushtarake humanitare duhet të kryhen në situata që përfshijnë vrasje masive.

---

62. Jonathan I. Charney , Anticipatory humanitarian intervention in Kosovo, p.4, http://www.questia.com/googleScholar.qst?docId=5001866798

Barbarizmat që kryhen në kurriz të një populli duhet të përballen me presion publik, diplomatik dhe ekonomik. Kjo nuk nënkupton se Human Rights Watch është indiferente ndaj vuajtjeve të popujve por sipas saj, para se të ndërmerret rreziku themelor i jetës që është në natyrën e çdo lufte duhen përdorur opsione të tjera.

Megjithatë, duhet pranuar se në qoftë se një situatë e caktuar justifikon ndërhyrjen ushtarake nuk do ishte e drejtë të shpërfillej vuajtja e viktimave thjesht për faktin se viktima të tjera u neglizhuan më parë. Çështja është që ndërhyrja të inkurajohet në të gjitha vendet ku kryhen shkelje të rënda të të drejtave njerëzore dhe qeveria e vendit është e paaftë t'i ndalojë ato, ose ajo vetë është përgjegjëse për këto shkelje dhe jo t'i mohohet njërit vend për shkak se nuk është ndërhyrë më parë në tjetrin.

Ndërhyrja ushtarake kryhet jo vetëm për të ndaluar masakrat që po kryhen, por edhe për të penguar kryerjen e tyre në të ardhmen, por kjo e ardhme duhet të jetë e dukshme. Pra, duhet të ketë të dhëna se një masakër e gjerë po përgatitet në mënyrë që të ndërhyhet, për të mos lejuar që të ndodhin kriza të rënda humanitare.

Hapi ekstrem i ndërhyrjes ushtarake duhet ndërmarrë vetëm për të ndaluar masakrat e dukshme dhe jo për të ndëshkuar abuzimet e të shkuarës. Kjo nuk do të thotë se barbarizmat e të shkuarës duhen injoruar. Përkundrazi, ato që kryejnë barbarizma duhen ndëshkuar. Akt padi mund të ngrihen, të dyshuarit mund të arrestohen në qoftë se ato rrezikojnë të ikin jashtë shtetit, por ndërhyrja humanitare nuk mund të përdoret thjesht për të siguruar drejtësi për krimet e të shkuarës.

Një tjetër opsion që mund të ndërmerret për të ndaluar vrasjet masive, përpara se të ndërhyhet ushtarakisht mund të jetë akuzimi i personave përgjegjës për shkelje të rënda.

Këto opsione duhen provuar, sepse siç theksuam më lart, një ndërhyrje do të klasifikohej si ndërhyrje humanitare vetëm në qoftë se është opsioni i fundit, i arsyeshëm për ndalimin e vrasjeve masive.

Dihet që ndërhyrje ushtarake mbi baza thjesht humanitare nuk mund të gjenden. Por një motiv humanitar dominant është i rëndësishëm sepse ndikon në shumë vendime që bëhen në lidhje me ndërhyrjen dhe si pasojë mund të shpëtohen njerëzit nga vuajtja.

Theksi duhet vënë tek parandalimi i krizave humanitare. Hapa progresive dhe radikale duhen ndërmarrë në drejtim të përgjegjësisë botërore për të parandaluar, duke iu drejtuar shkaqeve themelore në të cilat i ka rrënjët konflikti, duke përfshirë varfërinë dhe pasigurinë humane.

7. ANGAZHIMI NDËRKOMBËTAR NË KRIZAT HUMANITARE PAS LUFTËS SË FTOHTË

7.1 NDËRHYRJA NË IRAK NË VITIN 1991

Pas përfundimit të Luftës së Golfit[1] filluan revoltat e dhunshme kundër regjimit shtypës të Sadam Huseinit në veriun kurd dhe jugun Shiit të Irakut. Kryengritja kurde shpejt përfundoi e shtypur dhe bëri që rreth një milion civilë të largoheshin nga njësitë e armatosura irakiane drejt Turqisë përmes maleve të mbuluara me borë të Irakut Verior. Forcat irakiane duke u drejtuar në veri filluan të ndjekin dhe sulmojnë karvanët e civilëve që largoheshin. Zyrtarët e Kombeve të Bashkuara raportuan se në fillim të prillit 1991 rreth 280.000 refugjatë ishin futur në Turqi, 700.000 të tjerë kishin mbetur rrugëve në dëborën që mbulonte malet, ndërsa qeveria turke e mbylli kufirin e saj. Ushqimi, streha, kujdesi mjekësor dhe siguria u bënë problematike dhe një shkatërrim humanitar po përvijohej.

Gjendja e vështirë e refugjatëve kurdë që largoheshin nga forcat e Sadamit u bë një çështje ndërkombëtare serioze, ndërsa media sillte imazhe të fëmijëve që vdisnin nga uria. Në 5 prill 1991 Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara u përgjigj me Rezolutën 688, e cila i kërkonte Irakut të ndërpriste sulmet dhe të lejonte aktorët e ndihmës humanitare për një asistencë të shpejtë të kurdëve. Ajo gjithashtu iu bënte apel shteteve anëtare dhe organizatave ndërkombëtare të ndihmës që të kontribuonin në përpjekjet për ndihmën e nevojshme. Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara e deklaroi situatën si një kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

Megjithëse fillimisht mjaft hezitues për rifillimin e implikimit në punët e brendshme të Irakut dhe duke pasur frikë për potencialin e përshkallëzimit, Shtetet e Bashkuara të Amerikës shumë shpejt e kuptuan se imazhet e medias të pothuajse një milion kurdëve që vdisnin nga uria dhe ngrinin deri në vdekje përgjatë kufijve të Irakut, kërcënonte të prishte imazhin moral të Luftës së Gjirit.[2]

Të vendosur për të mos lejuar krizën humanitare që të errësonte kujtimin e suksesit të saj historik, SHBA shumë shpejt filluan Operacionin Joint Task Force Provide Comfort për të rregulluar tragjedinë që ishte shpalosur në male. Operacioni u prezantua si një masë për të mbrojtur kurdët, të cilët po shtypeshin ashpër nga autoritetet irakiane.[3]

Ky operacion filloi si operacion i SHBA, sidoqoftë me forcat e SHBA shumë shpejt u bashkuan 12 partnerë të tjerë të koalicionit dhe me mbi 50 agjenci ndihme në një përpjekje të vërtetë ndihme shumëkombëshe, e cila u quajt tashmë "Combined Task Force Provide Comfort".

---

1. P. Rose (ed.), The Gulf War, 1990, in International and English Law, London (1993); and G. Girod, Bruxelles (1994).
2. Benedikt F.Franke, The use of sustained coercive air power in humanitarian interventions Journal of Humanitarian Assistance www.jha.ac/articles/a170. pdfposted on 30 Dec 04, p.17.
3. Oliver Corten, Humanitarian Intervention, a controversial right, p. 9, www.jag.navy.mil/documents/navylawreview/NLRVolume59.pdf

SHBA më 6 prill deklaruan një zonë jo fluturuese në Irakun Verior dhe ndaluan të gjithë aktivitetin ajror të Irakut. SHBA gjithashtu paralajmëruan Irakun që të mos ndërmerrte asnjë veprim kundër refugjatëve të tij kurdë, aktorëve ndërkombëtarë të mbështetjes humanitare ose trupave të koalicionit, por Bagdadi deklaroi se do t'i bënte rezistencë kësaj shkelje të sovranitetit me të gjitha mënyrat e nevojshme dhe vazhdoi sulmet e tij kundër popullsisë kurde që largohej.

Operacioni i shpërndarjes së ndihmës humanitare filloi më 7 prill. SHBA u ndihmuan në këtë operacion nga Britania, Gjermania, Spanja dhe Italia. Pavarësisht nga suksesi i këtij lëshimi ajror, situata në kampe mbeti e rrezikshme. Qeveria e SHBA e kreu operacionin në të gjitha 43 zonat ekzistuese të refugjatëve me qëllim për të "ndaluar vdekjen dhe vuajtjen", duke asistuar me lëshimin e ndihmave nga ajri, organizimin e kampeve dhe duke ndihmuar në sigurimin e kujdesit mjekësor dhe përmirësimit të shërbimit sanitar. Sidoqoftë, shumë shpejt u bë e qartë se popullsia refugjate kurde nuk mund të mbështetej në male. Në mënyrë që kurdët e vendosur në male të mos vdisnin, duhej ose turqit t'i linin kurdët të zbrisnin nga malet ose kurdët të ktheheshin mbrapsht në Irak.

Duke qenë se opsioni i parë u kundërshtua fort nga qeveria turke e cila frikësohej për krijimin faktik të një Kurdistani në tokën turke, Presidenti Bush nuk kishte zgjidhje tjetër veçse të shpallte se koalicioni do krijonte zona të sigurta[4] për kurdët në Irakun Verior, dhe t'i mbronte ata me forcë ushtarake po të ishte e nevojshme meqë "Ne, tha ai nuk mund të lejojmë që 500 000 deri në një milion njerëz të vdesin atje lart në male".

Pas kësaj, trupa nga SHBA, Franca, Britania, Spanja, Italia dhe Holanda hynë në Irakun Verior dhe siguruan një rajon 30 milje të thellë. Këto forca ngritën 6 kampe brenda dhe rreth Zahko-s dhe lehtësuan kthimin e refugjatëve në fshatrat e tyre përmes këtyre kampeve tranziti. Irakianët u detyruan të ndalonin përparimin e tyre në veri dhe kështu kurdët u kthyen të sigurt brenda Irakut Verior. Misioni ishte aq i suksesshëm saqë me 8 qershor forcat aleate shpallën përmbushjen e tij.

Në qershor elementët tokësor të koalicionit u tërhoqën nga zonat e sigurta kurde, ndërsa një numër trupash të Kombeve të Bashkuara vazhduan të ruajnë sigurinë e kurdëve deri në vitin 1996.

Natyra e krizës humanitare në Irakun Verior paraqiti shumë mundësi unike për një ndërhyrje ushtarake të suksesshme ajrore.

Së pari, Iraku shihej si një agresor që shkaktoi krizën. Polarizimi i padyshimtë ndërmjet refugjatëve kurdë dhe ushtrisë irakene i dha planifikuesve ushtarakë mundësinë për të identifikuar qartë armikun dhe për të fokusuar përpjekjet e tyre. Për më tepër, ndarja gjeografike e palëve të konfliktit përpara ndërhyrjes e lehtësoi së tepërmi krijimin e një zone të sigurt dhe e lejoi koalicionin të përqendrohej në një vijë fronti dhe jo të merrej me një numër të madh forcash të shpërndara brenda zonës së tij të përgjegjësisë.

4. Konventa IV e Gjenevës për Mbrojtjen e Personave Civilë në Kohë Lufte,12 gusht 1949, neni 15.

Së dyti dhe ndoshta më e rëndësishme fushata "Desert Storm" që i parapriu operacionit kishte demonstruar aftësitë e koalicionit në dëmtimin e sistemeve të vlerës strategjike të Irakut. Kështu, Iraku duhej t'i merrte seriozisht kërcënimet për goditje ajrore në qoftë se nuk bashkëpunonte me kërkesat e koalicionit. Si një shtet relativisht modern dhe i centralizuar, Iraku paraqiste mjaft shenja strategjike potenciale për goditje të tilla.

Ndërsa u planifikua sulmi ndaj objekteve kryesore ushtarake, për të ndëshkuar dhunimet e mundshme të zonave të sigurta, ose për t'u përgjigjur në rast të rritjes së luftimeve, sulmi ndaj shtabit qendror të Irakut në Bagdad dhe kompleksit industrial në Zaafaraniya ishin indikacione të qarta që objekte të tjera mund të sulmoheshin nga aleatët po të ishte e nevojshme.

Së treti, mjedisi i shkretë dhe terreni i Irakut Verior paraqisnin pak kufizime për operacionet ajrore dhe siguronin pak mundësi fshehjeje ose mbulimi për forcat e mekanizuara kundër sulmit ajror. Gjithashtu, kushtet e favorshme të motit lejuan pamje të mirë gjatë gjithë operacionit.

Këta faktorë si dhe fakti që vendosja strategjike e zonës së sigurt nënkuptonte që trupat e Irakut duhet të kapërcenin shumë tokë të hapur për të kryer një sulm, i vunë forcat e koalicionit në një pozitë të favorshme për të pritur dhe për të parë.

Së fundi, por më e rëndësishmja, situata politike që ndoqi mbarimin e suksesshëm të Luftës së Gjirit[5] dhe shkalla e një fatkeqësie potenciale humanitare lejuan vendosjen dhe kohezionin e nevojshëm. Vullneti për të parë misionin të përfunduar me sukses ishte më i madh se debatet e brendshme që zakonisht e dëmtojnë efektivitetin e një lufte të tillë.

Veprimi ushtarak që u ndërmor kundër Irakut nga vende të ndryshme perëndimore në prill 1991 solli në vëmendjen e publikut "të drejtën e ndërhyrjes". Respekti për të drejtat e njeriut tashmë do të ishte i detyrueshëm për t'u zbatuar nëpërmjet veprimit të komunitetit ndërkombëtar, nga institucione të përshtatshme ose nga disa shtete që u përgatitën për të mbrojtur këtë parim.

7.2 NDËRHYRJA E KOMBEVE TË BASHKUARA NË SOMALI

Koncepti i "të drejtës për të ndërhyrë" në mbrojtje të të drejtave njerëzore ishte arsyeja që Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara përdori për të justifikuar ndërhyrjen humanitare në Somali në vitin 1992. Zyrtarisht operacioni kishte si qëllim t'i jepte fund anarkisë dhe të krijonte kushtet në të cilat njerëzit mund të mbijetonin.[6]

5. P. Rose (ed.), The Gulf War 1990 in International and English Law, London (1993); and G. Girod, Bruxelles (1994).
6. Operacioni Kombeve të Bashkuara u quajt UNOSOM I dhe u krijua nga Këshilli i Sigurimit me Rezolutën751(1992).

“E drejta e ndërhyrjes” kishte ardhur në vëmendjen e publikut kur u ndërmor veprimi ushtarak kundër Irakut në prill 1991, nga vende të ndryshme perëndimore.

Në përpjekje për të stabilizuar situatën e rëndë të krijuar në Somali nga lufta civile, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara në 23 janar 1992 adaptoi Rezolutën 733. Rezoluta bënte thirrje për një embargo armësh dhe pajisjesh ushtarake që dërgoheshin në Somali. Ndërkohë Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara Butros – Butros Gali vazhdoi dialogun e tij personal me të gjitha “partitë, lëvizjet dhe fraksionet” somaleze, duke u përpjekur që t’i bindte të mblidheshin në një konferencë për pajtim dhe bashkim kombëtar.

Ai paraqiti një plan 90 ditor për veprime emergjente humanitare në Somali që do të përfshinte vendosjen e 500 trupave të sigurisë për të asistuar shpërndarjen e ndihmës humanitare.

Në 24 prill 1992 Këshilli i Sigurimit unanimisht adaptoi Rezolutën 751(1992), “Për të lehtësuar ndërprerjen e veprimeve të mëtejshme armiqësore dhe ruajtjen e pushimit të zjarrit në vend dhe për të çuar përpara procesin e pajtimit dhe zgjidhjes politike”.

Rezoluta 751 bënte thirrje për vendosjen imediate të 50 vëzhguesve të Kombeve të Bashkuara për të monitoruar pushimin e zjarrit në Mogadisho dhe aprovoi në parim planin e Butros – Butros Galit.

Kjo zgjidhje fillestare në lidhje me Somalinë ishte modeste në qëllimin e saj me vetëm 50 vëzhgues të Kombeve të Bashkuara dhe 500 forca sigurie. Pushimi i brishtë i zjarrit vetëm në kryeqytetin Mogadisho, (i deklaruar në mars 1992), dhe vazhdimi i luftimeve në veri dhe në jug, bënë që të rritej numri i forcave të misionit. Tonelata me ushqim filluan të hynin në vend dhe shumë organizata joqeveritare me personelin e tyre u përpoqën t’i shpërndanin në masat që po vuanin urie.

Në një kohë të shkurtër u bë e qartë që banditë të armatosur dhe grabitës po përfitonin nga ndihma shumë më tepër se sa kishin nevojë për veten e tyre.

Vëzhguesit e Kombeve të Bashkuara nuk bënë shumë progres në zvogëlimin e konfliktit ose sigurimin e ndihmës prandaj në qershor Kombet e Bashkuara kërkuan shpërndarjen nga ajri të ushqimit.

Në përgjigje të kërkesave të Kombeve të Bashkuara Presidenti Xhorxh Bush urdhëroi fillimin e operacionit të sigurimit të ndihmës, në 15 gusht 1992, me qëllim “sigurimin e asistencës ushtarake në mbrojtjen e ndihmës emergjente humanitare në Kenia dhe Somali.”

Pjesëmarrja ushtarake e SHBA në këtë moment kishte thjesht natyrë logjistike, megjithatë SHBA vendosën një njësi të ekspeditës së marinës në brigjet e Somalisë për të mbështetur veprimet ajrore. Megjithëse operacioni i sigurimit të ndihmës me shumë

sukses shpërndau më shumë se 28.000 ton pajisje mbështetëse në Somali, situata në tokë u përkeqësua. Luftimet vazhdonin.

Në 3 dhjetor 1992, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara aprovoi një rezolutë ku autorizonte shtetet anëtare të vendosnin trupa luftuese "për të krijuar një mjedis të sigurt për kryerjen e operacioneve humanitare në Somali".[7]

Presidenti Xhorxh Bush publikisht deklaroi se SHBA ishin i vetmi komb që mund të ndërmerrte shumë shpejt një operacion ushtarak me qëllim lehtësimin e përpjekjes humanitare në Somali.

Në 4 dhjetor 1992 Presidenti Bush shpalli se do të vendoste mijëra trupa amerikane në Somali sipas kushteve të Rezolutës 749 të Kombeve të Bashkuara. Forca e Bashkuar do të ishte një koalicion multinacional i drejtuar nga SHBA, si një masë ndaluese për të siguruar shpërndarjen e ndihmës në Somali, derisa një forcë paqeruajtëse permanente e Kombeve të Bashkuara të merrte përsipër këtë përgjegjësi. Rezoluta 749 i referohej kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, e cila bën fjalë për zbatimin e paqes.

Qëllimet e Presidentit Bush dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara Butros–Butros Gali kishin ndryshime të dukshme. Presidenti Bush kishte për qëllim të dërgonte në Somali "një forcë të gjerë për të zhvilluar misionin në një kohë të shkurtër". Butros Gali, nga ana tjetër, donte që SHBA të qëndronin derisa vendi të stabilizohej. Sekretari i Përgjithshëm e informoi Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara se ai dëshironte që forca ndërhyrëse të çarmatoste somalezët dhe të konfiskonte armatimet e tyre të rënda.[8] Zyrtarët e Uashingtonit e quajtën këtë detyrë si të parealizueshme dhe refuzuan të angazhoheshin në kryerjen e saj. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së mandatit të tij zyrtar Presidenti Bush nuk hoqi dorë nga pozicioni i tij se SHBA ishin në Somali vetëm për arsye humanitare dhe se ai do të sillte trupat e tij në shtëpi së shpejti.

Pozicioni i Butros Galit mund të kuptohet më mirë në qoftë se kemi parasysh dokumentin e tij të titulluar një axhendë për paqen. Sekretari i Përgjithshëm kërkonte krijimin e një force permanente nga shtetet anëtare ndaj Këshillit të Sigurimit për t'i dhënë Kombeve të Bashkuara kredibilitetin e "garantuesit të sigurisë ndërkombëtare".

Çështja e çarmatimit të plotë nga Kombet e Bashkuara nuk u realizua plotësisht. Megjithëse të armatosur me pajisjet më moderne luftarake trupat e koalicionit të dominuar nga amerikanët, nuk mundën të kryenin çarmatimin e somalezëve.[9]

---

7. Luigi Condorelli, Anne-Marie La Rosa, Sylvie Scherrer, 'The United Nations and International Humanitarian Law", Actes du Colloque international A l'occasion du cinquantieme anniversaire de l'ONU, Editions Pedone, Paris, 1996. p 76.
8. UNOSOM I u zëvendësua nga UNITAF "Unified Task Force", i autorizuar nga Këshilli i Sigurimit me Rezolutën 794 (1992).
9. Major L.M.Martin,United States Marine Corps, Humanitarian Success And Political/Military Failure, http://www.globalsecurity.org/military/library/report/1995/MLM.htm, p.31

Në përfundimin e mandatit të tij Presidenti Bush ritheksoi qëndrimin e tij se operacione të zgjatura nuk do ishin të nevojshme dhe se amerikanët do të qëndronin në Somali "vetëm për aq kohë sa do kërkohej për të krijuar një mjedis të sigurt".[10]

Butros Gali kërkoi ndërkohë që "para se të kthеheshin në shtëpi trupat amerikane jo vetëm të konfiskonin arsenalet e klaneve somaleze, por gjithashtu të hiqnin minat qe ishin vendosur në veri të vendit dhe të krijonin një forcë policore ushtarake për të vendosur rregullin. Vetëm në këto kushte paqeruajtësit e Kombeve të Bashkuara mund ta përfundonin misionin.[11]

Në vigjilje të vendosjes së Bill Klintonit si president, SHBA tërhoqën më shumë se 1.000 marinsa nga Somalia. Kjo u pa nga disa si përpjekje për të realizuar vendimin e Bushit, por gjithashtu edhe si një mënyrë për të nxitur Kombet e Bashkuara në krijimin e një force të rregullt paqeruajtëse.

Më 26 mars 1993, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara kaloi rezolutën 814 (1992), që krijonte një mision të dytë.

Rezoluta 814 përmbante parashikime të tilla si: i jepte mandat një operacioni paqeruajtës sipas kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe përfshinte kërkesën për çarmatim të të gjitha klaneve në Somali. Në mënyrë specifike e drejtonte objektivin politik në rindërtimin e një strukture politike dhe ekonomike të një shteti anëtar dhe drejtonte krijimin e një mjedisi të sigurt përmes Somalisë për të përfshirë rajonin verior, i cili kishte deklaruar pavarësi. Për të zbatuar këtë rezolutë, Kombet e Bashkuara krijuan një strukturë të plotë paqeruajtëse në Somali.

Kritikat ndërkombëtare për Shtetet e Bashkuara të Amerikës u rritën. Drejtuesit somalezë bënë përgjegjës SHBA për ndryshimin dramatik në fokusin e operacionit. U shkaktuan shumë viktima civile.[12] Pas vrasjeve të ushtarëve amerikanë në gusht 1993, presidenti Klinton kërcënoi me tërheqje.

Me 31 mars 1994 Presidenti Klinton vendosi tërheqjen e të gjitha forcave amerikane. Partnerë të tjerë të koalicionit filluan tërheqjen nga Somalia, gjithashtu.

Operacioni që përfundoi ishte i brishtë që në fillimet e tij. Presidenti Bush kishte si qëllim primar që operacioni të ishte humanitar. Në janar 1993, para largimit të tij nga zyra Presidenti Bush nënshkroi një strategji të re për sigurinë kombëtare. Në këtë dokument, lidhur me Afrikën, pohohej: "Operacioni ynë në Operacionin e Ndërtimit të Shpresës është ideuar për të inkurajuar kombet e tjera që të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve njerëzore atje, duke krijuar mundësi për progres politik dhe ekonomik në vazhdimësi".

10. Një operacion i zgjeruar i Kombeve të Bashkuara në Somali (UNOSOM II), u krijua nga Këshilli i Sigurimit sipas Kapitullit VII të Kartës me Rezolutën 814 (1993).
11. Human Rights Watch/Africa, 7 Somalia faces the Future: Human Rights in a Fragmented Society (April 1995), n° 2, pp.56-57; Human Rights Watch, The Lost Agenda: Human Rights and UN Field Operations (1993), pp.126-127; contrast African Rights, Somalia – Operation Restore Hope: A preliminary Assessment (1993), pp. 20-27.
12. African Rights, op. cit. note 70, pp. 35-41; African Rights, Somalia – Human Rights Abuses by the United Nations Forces (July 1993), pp. 16-17 and 28-29.

Siç u dizenjua qysh në fillim, Operacioni i Rindërtimit të Shpresës kishte pak shanse për t'i dhënë fund luftës civile në Somali.[13]

Zbatimi i paqes dhe krijimi i demokracisë kërkojnë dekada dhe nuk mund të përmbushen në një periudhë shumë të shkurtër kohore.

Butros-Gali besonte që ishte i mundshëm një çarmatim total në një komb që kishte qenë në luftë me veten e tij për shekuj. Në një komb kur fraksionet refuzojnë të çarmatosen në mënyrë vullnetare dhe paqebërësit duhet të qëndrojnë neutral me ndërhyrje të kufizuar, paqja nuk mund të vendoset kurrë. Ndërhyrja e kufizuar mund të ketë sukses, në qoftë se paqebërësit mbështesin njërin ndërluftues në mposhtjen e tjetrit.

Ndërhyrja e paanshme mund të ketë sukses në qoftë se paqebërësit marrin kontrollin total të situatës dhe forcërisht imponojnë një zgjidhje.[14]

Me të gjitha palët që kryenin barbarizma në Somali,[15] dhe me struktura klanore komplekse dhe të ngatërruara, të ndihmoje një palë që të mposhte tjetrën nuk përbënte një opsion të vlefshëm.

Me dështimin në Somali, Kombet e Bashkuara pësuan sforcime të dukshme financiare dhe humbën kredibilitetin. Sipas Kofi Anan, Nën Sekretar i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara për Paqeruajtjen, "Ajo i shkaktoi mjaft dëme Kombeve të Bashkuara. Dhe për këtë nuk ka asnjë dyshim".

Media luajti një rol të dukshëm në Operacionin e Rindërtimit të Shpresës. Paraqitja nga Media e skamjes dhe vdekjes nga uria në Somali luajti rol kryesor në vendimin e Presidentit Bush për të marrë drejtimin e ndërhyrjes humanitare.

Si përfundim mund të themi se, megjithëse Kombet e Bashkuara morën përsipër kontrollin e operacionit në Somali, në mars 1993, SHBA vazhduan të luajnë rol kryesor në operacionet ushtarake dhe në negociatat e Kombeve të Bashkuara. Përpjekja humanitare pati sukses në shpëtimin e jetëve, por operacioni politiko – ushtarak dështoi në arritjen e misionit të tij për shkak të mungesës së një objektivi të arritshëm ushtarak dhe politik dhe të mungesës së një politike të jashtme të përcaktuar qartë ndaj Somalisë.

Operacioni i Rindërtimit të Shpresës ishte një sukses si përpjekje humanitare, por ai ishte një dështim i mjerueshëm përsa i përket paqebërjes.[16]

---

13. Further report of the Secretary-General submitted in pursuance of paragraph 18 of Security Council resolution 814 (1993), UN Doc. S/26317 of 13 August 1993; further report of the Secretary-General submitted in pursuance of paragraph 19 of Security Council resolution 814 (1993) and paragraph A5 of Security Council resolution 865 (1993), UN Doc. S/26738 of 12 November 1993.
14. Major L.M.Martin,United States Marine Corps, Humanitarian Success And Political/Military Failure http://www.globalsecurity.org/military/library/report/1995/MLM.htm, p. 24.
15. Human Rights Watch/Africa, op. cit. note 70, pp. 56-61; African Rights, op. cit. note 73, pp. 5-7 (Abdi Abdiid's house); pp.7-11 (attack on Digfer hospital).
16. The Clinton Administration's Policy on Reforming Multilateral Peace Operations, May 1994; "Department of Defence Statement on Peacekeeping", 33 ILM (1994) 705 and 814.

Në mars 1995 kontingjentet e fundit të forcave të Kombeve të Bashkuara u larguan nga Somalia me mbështetjen e një force shumëkombëshe.

7.3 RASTI I NDËRHYRJES HUMANITARE NË SUDAN

Sudani është vendi më i madh në Afrikë dhe gjithashtu një nga më tragjikët.

Në 1996 situata në Sudanin jugor ishte shumë e ngjashme si në shkaqe dhe në efekte me krizën humanitare në Sudanin Verior, e cila kishte nxitur Operation Provide Comfort në prill 1991.[17] Në të dy rastet qeveria qendrore e një shteti sovran vendosi të përdorte forcën për të shtypur një grup etnik i cili përbën një pjesë substanciale të popullsisë së tij. Në të dy rastet qeveria u mbështet në përdorimin e mjeteve ajrore dhe në një ushtri të centralizuar për të zhvilluar fushatën e spastrimit etnik. Ajo shkaktoi një fatkeqësi humanitare e cila kërcënoi jetët e miliona qytetarëve dhe çoi në emigrimin masiv të detyruar. Në të dy rastet grupi etnik i shtypur kishte jetuar në ndarje gjeografike nga grupi shtypës për një kohë të gjatë dhe kishte kërkuar aktivisht shkëputje.

Në 1996 filloi ndërhyrja. Në marrjen e vendimit për fillimin e kësaj ndërhyrje ndikoi dështimi për ndërhyrje në Ruanda në vitin 1994,[18] si dhe aplikimi i suksesshëm i fuqisë ajrore në Bosnjë që çoi në marrëveshjet e Dejtonit.

Fillimi i vitit 1996 ishte zgjedhur për një numër arsyesh praktike:

Së pari, kjo datë do të kishte lejuar forcat ndërhyrëse për më shumë se 5 muaj për të kryer misionin e tyre përpara se të fillonte stina e shirave, e cila do t'i kishte bërë rrugët e jugut të papërshtatshme të paktën për dy muaj.

Së dyti, në këtë kohë pajisjet ajrore të përdorura gjatë fushatës së vitit 1995 në Bosnjë do ishin të lira dhe të vlefshme për një mision të ri.[19]

Pavarësisht nga efekti pozitiv, ky operacion u bë shënjestër e kritikave të shumta, pjesa më e madhe e të cilave u fokusuan në shkeljen e qartë të parimit të sovranitetit.

7.4 KONFLIKTI I VITIT 1998 NË REPUBLIKËN DEMOKRATIKE TË KONGOS

Luftërat e njëanshme në Republikën Demokratike të Kongos, në vitin 1996 dhe përsëri në vitin 1998 çuan në një prej krizave më të rënda humanitare. Më shumë njerëz kanë vdekur si rezultat i konfliktit të armatosur në Republikën Demokratike të Kongos se sa në ndonjë shtet tjetër Afrikan dhe në çdo luftë tjetër që nga Lufta II-të Botërore.[20] Marrëveshjet e paqes të nënshkruara në vitin 2002 i dhanë fund armiqësive më të mëdha. Në korrik 2003 u vendos një qeveri e përkohshme.

---

17. U.S. Central Command History http://www.centcom.mil/en/about-centcom/our-history/
18. Security Council resolution 812 (1993) and subsequent resolutions.
19. Benedikt F.Franke The use of sustained coercive air power in humanitarian interventions Journal of Humanitarian Assistance on 30 Dec 04, www.jha.ac/articles/a170.pdfposted , p.16.
20. Damian Lilly, No war, no peace: a protection crisis continues in the DRC, November 2005, sites.tufts.edu/jha/files/2011/04/a182.pdf

Shkeljet masive të të drejtave njerëzore kanë qenë aspekti kryesor i konfliktit të armatosur në Republikën Demokratike të Kongos. Vrasjet, përdhunimet, grabitjet dhe shkelje të tjera kundër civilëve ishin tiparet e konfliktit të armatosur në Republikën Demokratike të Kongos.[21] Edhe në zonat që i shpëtuan luftimeve serioze dhe ishin relativisht stabël pas marrëveshjeve paqësore, periudha e tranzicionit kishte nivel të ulët sigurie. Ka pasur gjithashtu raporte për rritje të dhunës lidhur me zgjedhjet që po afroheshin, duke përfshirë arrestime arbitrare dhe arrestime të anëtarëve të partive politike.

Një tipar veçanërisht i dukshëm në konfliktin e Republikën Demokratike të Kongos ka qenë mbizotërimi i dhunës seksuale. Në mars 2004 Kombet e Bashkuara raportuan se nga viti 1998 deri në vitin 2004, 40.000 gra ishin përdhunuar. Pjesa më e madhe e përdhunimeve ishin kryer nga luftuesit e armatosur dhe përdhunimi ishte përdorur si një strategji ushtarake ose "mjet lufte" në konflikt. Një numër i madh luftuesish në Republikën Demokratike të Kongos ishin fëmijë. Veçanërisht në rajonin Ituri të provincës orientale drejtuesit lokalë të luftës dhe forcat ushtarake rezerviste kanë detyruar, armatosur dhe përdorur fëmijë në mosmarrëveshjet e atjeshme. Një program vullnetar çarmatimi filloi në shtator 2004 në Ituri për të çmobilizuar 15.000 luftues, shumë prej të cilëve ishin ushtarë fëmijë. Programi përfundoi në 25 qershor 2005 me 15.607 luftues, përfshirë 4395 fëmijë të çarmatosur, (prej të cilëve 840 ishin vajza). Megjithatë është bërë pak për t'iu siguruar asistencë të çmobilizuarve dhe për t'i riintegruar ata në shoqëri.

Përveç dhunës së qëllimshme personale, popullsia civile në Republikën Demokratike të Kongos është privuar nga mjetet ekonomike. Ajo ka përjetuar grabitjen, plaçkitjen nga grupet e armatosura dhe gjithashtu i është mohuar mundësia për shërbime bazë si ujë, shëndetësi dhe arsim. Luftuesit e armatosur vazhdonin të vinin në shënjestër popullsinë civile dhe një dhunë e tillë normalisht shoqërohej me shkatërrime të shtëpive, vjedhje dhe grabitje. E zhvendosur nga shtëpitë popullsia civile bëhej gjithnjë e më e dobët. Sipas Komitetit Ndërkombëtar të Shpëtimit pjesa më e madhe e vdekjeve kanë ndodhur për shkak të sëmundjes dhe urisë, se sa prej dhunës direkt.

Për vite, gjatë luftës së Republikën Demokratike të Kongos, pjesë të mëdha të vendit mbetën të paarritshme për agjencitë e ndihmës dhe asistenca humanitare mbuloi shumë pak nga nevojat e popullsisë civile.[22]

Përgjigja më direkt ndaj dhunës kundër civilëve në Republikën Demokratike të Kongos është dhënë nga MONUC dhe paqeruajtësit e tij. Pasi u krijua si mision monitorues në vitin 1998 dhe vitet që pasuan me kritika për mosbërje të asgjëje në mbrojtje të civilëve, mandati i MONUC u ngrit në Kapitullin VII, në vitin 2003 si rezultat i krizës. MONUC përveç përgjegjësisë për mbështetjen e procesit të tranzicionit, iu dha mandati nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për të përdorur forcën ushtarake në rastet kur civilët të jenë "në rrezik të dukshëm të dhunës civile".

21. Security Council Resolution 169 (1961) of 24 November 1961, Un Doc. S/5002.
22. Un Doc. S/5003/Add.15; see R. Higgins, United Nations Peacekeeping, 1947-1967, III Africa, oxford (1980), pp. 37-48.

Kur konflikti i armatosur shpërtheu në Bukavu, në qershor 2004, MONUC veproi për të penguar gjakderdhjen civile. Sidoqoftë, zyrtarët e Kombeve të Bashkuara shumë shpejt thanë se për shkak të fillimit të luftimit nga grupet e armatosura, paqja kishte marrë fund dhe kështu roli i tyre si paqeruajtës ishte shuar.

Në gusht 2004 Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara bëri një sërë rekomandimesh për të forcuar mandatin e MONUC dhe kërkoi që të vendoseshin më shumë paqeruajtës.

7.5 NDËRHYRJA E KOALICIONIT NË AFGANISTAN NË VITIN 2001

Historia e abuzimeve me të drejtat njerëzore në Afganistan

Afganistani ka vuajtur shkelje të shumta të të drejtave njerëzore në 30 vitet e fundit. Afganistani ishte pushtuar fillimisht nga Bashkimi Sovjetik, në vitin 1979, i cili u tërhoq në vitin1989, pas një dekade luftimesh me anti komunistët muxhahidin. Pushtimi sovjetik i Afganistanit solli vrasje masive, tortura dhe një pejzash të shtruar me mina tokësore.

Lufta civile pasuese solli shkelje të shumta nga fraksionet e armatosura që konkurronin për pushtet. Talebanët u ngritën në pushtet në vitin1996 dhe e qeverisën Afganistanin deri në sulmet e SHBA në vitin 2001. Talebanët u fuqizuan duke kontrolluar rreth 90% të territorit afgan dhe duke lejuar Al–Qaedën të vepronte lirisht, derisa ndërhynë SHBA dhe aleatët me veprime ushtarake pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit.

Në vitin 2006 prodhimi i opiumit në Afganistan u rrit me 50%, gjë që siguron një burim kryesor financimi për talebanët. Talebanët ishin famëkeq për abuzimet e tyre me të drejtat njerëzore kundër grave. Rritja e pushtetit të talebanëve ka çuar në rritje të shkeljes së të drejtave njerëzore kundër grave në Afganistan. Sipas Amnesty International, Talibanët kryejnë krime lufte duke vënë në shënjestër civilët, përfshirë vrasjen e mësuesve, rrëmbimin e punonjësve të ndihmës dhe djegien e shkollave. Më se 756 civilë u vranë në vitin 2006 nga bombat e vendosura në rrugë ose të mbajtura nga sulmuesit vetëvrasës të palës talebane.

Lufta në Afganistan filloi në 7 tetor 2001, si përgjigje ndaj sulmeve të 11 shtatorit 2001 në SHBA. Kjo shënoi fillimin e fushatës së administratës së Bushit të njohur si Lufta ndaj Terrorizmit. Qëllimi i pohuar i pushtimit ishte kapja e Osama Bin Laden, shkatërrimi i Al–Qaedës dhe heqja e regjimit Taliban, i cili i kishte siguruar mbështetje dhe strehë të sigurt për Al–Qaedën.

Ndërhyrja e SHBA – ve në Afganistan[23] për të mënjanuar nga pushteti talebanët dhe Al – Qaedën ishte shfaqja më e fundit e një konflikti që vazhdonte prej pothuajse tri dekadash.

23. Në Afganistan nuk janë dy shtete që luftojnë njëri-tjetrin. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar dhe shtetet e tjera të NATO-s po i luftojnë talebanët - një aktor jo shtetëror, në bashkëpunim me qeverinë e Afganistanit. Në fakt, ato veprojnë për llogari të Afganistanit, me pëlqimin e tij, dhe në aleancë me të. Ky konflikt nuk mund të jetë ndërkombëtar, sepse po të ishte, talebanët do të kishin të drejtë të luftonin dhe në këtë mënyrë nëse ato respektonin rregullat e të drejtës ndërkombëtare humanitare, ata nuk mund të ndëshkoheshin vetëm për rebelim kundër qeverisë së ligjshme të Afganistanit.
Konfliktet në Irak dhe Afganistan, pas përmbysjes së Sadamit dhe talebanëve, mund të konsiderohen si konflikte të armatosura të brendshme, sepse nuk ka dy shtete kundërshtare.

SHBA dhe Mbretëria e Bashkuar udhëhoqën fushatën e bombardimit ajror, me forca tokësore të siguruara kryesisht nga Afgan Northern Alliance. Në vitin 2002, këmbësoria britanike dhe e SHBA iu bashkuan sulmit. Më vonë u shtuan edhe trupat e NATO–s. Ky operacion u quajt Operation Enduring Freedom.

Në dhjetor 2001 udhëheqës nga opozita afgane dhe diaspora u takuan në Bon të Gjermanisë dhe përpiluan plane për një ndryshim politik duke filluar me një strukturë qeveritare të përkohshme, që çoi në emërimin e Hamid Karzai si kryetar të Afgan Internim Authority, në dhjetor 2001. Më vonë, pas Asamblesë së madhe kombëtare të mbajtur në qershor 2002, Karzai u zgjodh President i Shtetit të Përkohshëm Islamik të Afganistanit. Në dhjetor 2003, autoriteti i përkohshëm mbajti një asamble të dytë mbarë kombëtare në Kabul për të debatuar mbi një draft kushtetutë, e cila u adaptua përfundimisht në janar 2004.

Lufta i hoqi talebanët nga pushteti për disa kohë, por ndodhi një ripërtëritje në forcat Talebane. Lufta ishte më pak e suksesshme në arritjen e qëllimit të kufizimit të lëvizjes së Al – Qaedës. Që nga koha e pushtimit, Afganistani është bërë më pak i qëndrueshëm për shkak të rritjes së prodhimit ilegal të drogës dhe një qeverie të brishtë me kontroll të kufizuar jashtë Kabulit.[24]

7.5.1 Krimet që talebanët kryejnë ndaj afganëve

Civilët në Afganistan gjithnjë e më shumë po përballen me sulme vetëvrasëse, rrëmbime dhe prerje kokash.

Një raport nga Amnesty International thotë se sulmet ndaj civilëve janë sistematike dhe të shumëpërhapura dhe përdoren nga rebelët Talebanë për të shkaktuar frikë.

Raporti thekson që shumë civilë janë vrarë me paramendim nga talebanët vitet e fundit. Talebanët akuzohen për "krime lufte dhe krime kundër njerëzimit".

Në shënjestër, ndërmjet janarit 2005 dhe marsit 2007 kanë qënë aktivistët e të drejtave të grave, kandidatët në zgjedhje, klerikët, punonjës të qeverisë e shëndetësisë, si dhe mësuesit.

Të paktën 183 shkolla janë djegur në sulme zjarrvënëse në të gjithë vendin, ndërmjet viteve 2005 – 2006. Pjesa më e madhe e viktimave të dhunës talebane janë cilësuar si "spiunë" ose "bashkëpunëtorë".

Rregullorja ushtarake talebane ose Laheya, ka sanksionuar në mënyrë të qartë vënien në shënjestër dhe vrasjen e civilëve. Rregulli 25 i kësaj Rregulloreje pohon se një mësues që vazhdon të mësojë pas paralajmërimeve nga talebanët duhet të rrihet dhe në qoftë se përsëri vazhdojnë të japin mësim "në kundërshtim me parimet e Islamit", ata duhet të vriten.

24. Wikipedia, The war in Afghanistan, en.wikipedia.org/wiki/Category:War_in_Afghanistan
www.icrc.org/eng/resources/documents/misc/57jq32.htm

Në mënyrë të ngjashme, një dekret fetar urdhëron vdekjen e kujtdo që mbështet ndërhyrjen e udhëhequr nga SHBA. Sulmet e dhunshme drejtuar kundër sistemit arsimor në vend u rritën në mënyrë dramatike, gjatë vitit 2006.

Talebanët përveç sulmeve me bomba dhe zjarrvënie, përdorin kërcënimet me forcën e "letrave të natës", zakonisht shënimet ngjiten nëpër pemë, xhami ose shkolla, në errësirë dhe paralajmërojnë sulmet kundër mësuesve dhe studentëve.

Prindërit në rajone të ndryshme e kanë me mëdyshje dërgimin e fëmijëve të tyre në shkollë dhe klima e frikës po minon të drejtën e arsimimit të mijëra fëmijëve, veçanërisht vajzave. Qëndrimi Taleban ndaj civilëve është shumë larg obligimeve sipas të drejtës ndërkombëtare, që qartësisht ndalon grupet e armatosura që të venë në shënjestër civilët.

Sipas drejtuesit të kërkimeve të Amnesty International, afganët janë në mes të luftimeve ndërmjet talebanëve, forcave qeveritare afgane, forcave të SHBA dhe forcave nga vende të tjera të NATO–s. Por janë Talebanët ata që ndjekin politikën e vënies në shënjestër të civilëve. Ata vrasin mësues, rrëmbejnë punonjës ndihme dhe djegin ndërtesat e shkollave.

Talebanët përveç sulmeve të qëllimshme kundër civilëve, kanë vrarë ose plagosur qindra njerëz në sulme që nuk bëjnë dallim. Të paktën 756 civilë janë vrarë në 2006 në sulme me bomba të vendosura në rrugë dhe sulme vetëvrasëse, sipas shifrave të Kombeve të Bashkuara dhe NATO–s.[25]
Talebanët janë famëkeq gjithashtu për zhvillim gjyqesh në zonat e kontrolluara prej tyre. Pjesa më e madhe e njerëzve që nxirren përpara këtyre gjyqeve janë akuzuar për "spiunazh". Shumë prej tyre për t'u nxjerrë në gjyq janë rrëmbyer nga Talebanët. Në shumë raste janë dhënë dënime me vdekje dhe janë ekzekutuar.

Afganistani konsiderohet si një fushëbetejë qendrore në luftën kundër terrorizmit global. Nuk duhet harruar se në Afganistan Osama Bin Laden dhe Al Qaeda planifikuan dhe përgatitën sulmet e tyre të 11 Shtatorit. Taliban – qeveria ekstremiste e Afganistanit i dha Osama Bin Ladenit dhe organizatës së tij një strehë të sigurt brenda kufijve të saj, që nga viti 1996 deri në tetor 2001, kur kjo qeveri u spostua nga një ndërhyrje e udhëhequr nga SHBA.

Talibani dhe Al Qaeda i kanë rimarrë aftësitë e tyre dhe strukturën komanduese përgjatë kufirit afgano – pakistanez. Këto forca kanë avantazh dobësinë e qeverive afgane dhe pakistaneze në këto zona, numrin e vogël të forcave ndërkombëtare në Afganistan, mungesën e progresit në rindërtim dhe një shpërthim të tregtisë së drogës në Afganistan.

25. Taleban "war crimes" on Afgans, http://newsvote.bbc.co.uk/mpapps/pagetools/email/news.bbc.co.uk/2/hi/south_asia/6568561.stm, p.26

Përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar për të asistuar në rindërtimin dhe fuqizimin e Afganistanit ndeshin në vështirësi të shumta. Talibanët po bëhen gjithnjë e më shumë të fuqishëm në Afganistan, të ushqyer nga rritja e hyrjes së parave prej tregtisë së opiumit dhe nga një strehë e sigurt në Pakistan. Qëllimet e rindërtimit gjithashtu nuk kanë mundur të arrihen dhe pjesa më e madhe e afganëve nuk kanë parë përmirësime në jetën e tyre të përditshme.

Brenda Pakistanit, Talibanët kanë marrë kontrollin efektiv të shumë territoreve fisnore dhe mungesa e sigurisë dhe autoritetit qeveritar në rajon e ka kthyer atë në një strehë të sigurt për terroristët e Al Qaedës. Kryengritësit afganë janë tashmë de facto autoriteti në Afganistanin Jugor dhe sulmet kundër koalicionit dhe forcave të NATO–s janë rritur në mënyrë dramatike vitet e fundit.

Presidenti Musharaf ka siguruar asistencë të dukshme në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar, por ai nuk ka qenë i vendosur në masat kundër ekstremistëve në zonat kufitare.

Afganistani ka një qeveri demokratike që nuk është e ndarë në vija sektare. Forcat e tij të sigurisë, (veçanërisht Ushtria Kombëtare Afgane), janë besnikë të qeverisë dhe po forcohen çdo dite. Ka një popullsi që e mbështet koalicionin ndërkombëtar dhe dëshiron që të qëndrojnë trupat amerikane. Me një angazhim të rinovuar, SHBA dhe aleatët e tyre mund të ndihmojnë që Afganistani të bëhet një shtet i qëndrueshëm, i cili kurrë më nuk do të jetë një strehë e sigurt për terroristët.

Stabiliteti i Afganistanit do të kërkonte një angazhim masiv, të rinovuar. Afganistani ka nevojë që të marrë më shumë ndihma, që të rritet niveli i trupave dhe të zhvendoset fokusi në ndërtimin shtetëror, veçanërisht të krijohet një qeveri kompetente dhe e përgjegjshme.

Shumë prej problemeve në Afganistan, nuk do të zgjidhen vetëm ushtarakisht. Investime më të mëdha në ekonominë e Afganistanit dhe rindërtimin e tij janë esenciale në krijimin e një shteti të qëndrueshëm. SHBA dhe komuniteti ndërkombëtar duhet të angazhohen në përpjekje afatgjata të zhvillimit ekonomik, të cilat duhet të përcaktohen dhe të menaxhohen mirë.[26] Qeveria afgane duhet të marrë drejtimin e këtij zhvillimi ekonomik, por mbikëqyrja ndërkombëtare do të siguronte zvogëlimin e korrupsionit dhe rindërtimin e legjimitetit të qeverisë, në mënyrë që kjo e fundit të merrte më mirë përsipër detyrën e rindërtimit.

Duke marrë në konsideratë situatën e rëndë humanitare në Afganistan u hartua një axhendë humanitare për Afganistanin, me përmbajtje:

- Afganistani është tashmë në një krizë humanitare. Shkalla e kësaj krize është e pamasë. Qeveritë donatore dhe institucionet duhet që shumë shpejt të sigurojnë burime më të mëdha për t'ju përgjigjur kësaj krize. Duke qenë se ka paqartësi të konsiderueshme përsa i përket magnitudës dhe drejtimit të lëvizjeve të popullsisë, donatorët dhe agjencitë humanitare duhet të jenë fleksibël në vlerësimin e zonave ku drejtohen ushqimi dhe pajisjet e tjera mbështetëse.

26. Caroline Wyatt, Afgan burden tasks NATO allies, BBC News, Noordwijk, www.afghanistannewscenter.com/news/2007/.../nov202007.html

- Është e detyrueshme që komuniteti ndërkombëtar të krijoje hapësirë humanitare të sigurt për vazhdimin e operacionave humanitare në shkallë të madhe brenda Afganistanit. Që kjo të bëhet e mundur, duhet që kushtet nën të cilat organizatat humanitare mund të veprojnë në Afganistan të përmirësohen gjerësisht, duke siguruar kështu siguri më të madhe për punonjësit humanitarë. Hapa të tillë janë të nevojshëm si për përmirësimin e sigurisë së punonjësve të ndihmës, ashtu dhe për çuarjen përpara të aftësive të organizatave humanitare për të punuar në mënyrë të pavarur.

- Nëqoftëse kushtet e sigurisë nuk lejojnë kryerjen e operacioneve humanitare normale për të ndihmuar numrin e madh të personave të prekur nga konflikti, atëherë duhen marrë masa të jashtëzakonshme të përkohshme, (si lëshimi i ndihmave nga ajri etj).

- Në mënyrë që të shpërndahet ndihma në Afganistan, duhen bërë përpjekje maksimale për të përcaktuar ata persona që kanë më shumë nevojë për asistencë. Situata duhet monitoruar me kujdes dhe në rast se gjykohet se ndihma nuk po shkon te ata përfitues ku duhet të shkonte në çdo zonë, ajo duhet të mbetet pezull ose të përfundojë menjëherë shpërndarja e saj.

- Ndihma humanitare duhet dhënë në përputhje me parimin e paanësisë. Civilëve të pafajshëm, në të gjitha anët e vendit, pavarësisht dallimeve etnike, gjinore, fetare etj u duhet shërbyer. Çdo përpjekje duhet bërë që ndihma të arrijë te personat në nevojë, si në zonat e kontrolluara nga talebanët, ashtu dhe në zonat e tjera.

- Shtetet fqinjë duhet të hapin kufijtë për refugjatët, të cilët kanë nevojë të largohen nga kriza në Afganistan.

- Të gjithë refugjatët kanë të drejtë që t'iu sigurohen standarde të përshtatshme mbrojtjeje, ushqimi, uji, strehimi dhe nevojash të tjera bazë. Të gjitha kampet e refugjatëve duhet të krijohen dhe të menaxhohen në përputhje me konventat ndërkombëtare dhe standardet humanitare.

- Çdo përpjekje duhet bërë nga komuniteti ndërkombëtar dhe vendet partnere që të ndjekin politikat më të mira në menaxhimin e kampeve të refugjatëve dhe të nxjerrin mësime nga krizat e mëparshme të refugjatëve.

- Thelbësore në krijimin e një klime shprese për të ardhmen në mes afganëve është angazhimi ndërkombëtar në dhënien e ndihmës për rindërtimin dhe zhvillimin e Afganistanit – një vend i shkatërruar nga një konflikt më se 30 vjeçar. Ndërmjet kushteve minimale për një program afatgjatë asistence të Afganistanit duhet të jetë respekti për të drejtat e qytetarëve të tij, duke përshirë gratë, minoritetet dhe grupet e tjera të dobëta, si dhe në aderimin në normat e rëndësishme ligjore dhe diplomatike të vendeve që kanë hyrë në marrëveshje me pjesën tjetër të komunitetit ndërkombëtar.[30]

30. Humanitarian agenda for Afghanistan; A Care International Policy Paper, Final draft October 9, 2001, p.44, www.care.org/.../afghanistan/AfghanistanHumanitarianAgenda.pdf

Duke folur në një takim të ministrave të Mbrojtjes së NATO–s, në Nordwijk[31] Sekretari i Përgjithshëm Jaap de Hoop Scheffer mohoi idenë se misioni i NATO–s në Afganistan po përballej me një krizë dhe theksoi që disa vende te NATO–s kanë ofruar kontribut më të madh.

Pavarësisht nga një rigjallërim i talebanëve dhe presionit ndaj disa qeverive të NATO – s, si Holandës dhe Kanadasë për të tërhequr trupat e tyre nga Afganistani, Shefi i NATO – s insistoi që aleanca të vazhdojë më tej.

Ajo që u premtua në këtë takim ishin më shumë ushtarë në mbështetje të trajnimit të Ushtrisë Kombëtare Afgane, se sa në mbështetje të luftimeve kundër Talibanëve.

Disa vende anëtare si Gjermania, Franca, Spanja janë të kufizuar nga të ashtuquajturat paralajmërime kombëtare për mosaktivitet, të cilët kufizojnë vendin e dislokimit të forcave të tyre, si dhe përcaktojnë nëse lejohen apo jo të luftojnë.

Trupat gjermane p.sh. janë izoluar në veriun relativisht paqësor në një rol jo luftues.

Ministri gjerman i mbrojtjes Franz Josef Jung refuzoi kërkesën e SHBA për trajnues gjermanë që të shoqërojnë njësitë afgane në jug dhe e kritikoi kërkesën e SHBA për të siguruar më shumë trupa nga aleatët e NATO–s. "Ne kemi nevojë për siguri, rindërtim dhe zhvillim, ai është koncept më i gjerë" tha Jung. "Prandaj, mendoj – shtoi ai – që këto thirrje për më shumë angazhim ushtarak janë të gabuara".

Jaap de Hoop Scheffer insistoi që britanikët dhe amerikanët po mbajnë peshën kryesore të këtij misioni, meqë pjesa jugore e Afganistanit ku ata janë të përqendruar është më e vështira. Sipas tij do ishte më mirë të bënim sa më pak paralajmërime kombëtare për mosaktivitet dhe të solidarizoheshim më shumë financiarisht dhe ushtarakisht. Britania dha një mesazh të fortë në takim, duke thënë që vendet e NATO – s duhet të vepronin së bashku si një aleancë, në qoftë se nuk dëshironin të humbitnin kredibilitetin dhe kombet që hezitojnë për një angazhim afatgjatë duhet të mbështeten.

Sipas Dr, Paul Corrish, ekspert i sigurisë në Royal Institute of International Affairs at Chatham House, ajo çfarë po shohim është se disa shtete anëtare të NATO – s thonë, "ne jemi pjesë e këtij misioni…, por ne nuk marrim përsipër rreziqet që po marrin të tjerët". Sipas tij, ky mision është një test vendimtar i vullnetit të NATO–s.

Pavarësisht nga tensionet, aleatët e NATO–s janë dakord në një gjë: Misioni në Afganistan nuk duhet të dështojë, sepse ashtu si e ardhmja e Afganistanit, kredibiliteti i NATO – s gjithashtu është në provë.

A mund të fitohet lufta në Afganistan?

---

31. Caroline Wyatt, Afgan burden tasks NATO allies, BBC News, Noordwijk, p.12. www.afghanistannewscenter.com/news/2007/.../nov202007.html

Talebanët kanë besim se çdo gjë do të shkojë mirë dhe përdorin taktika të reja. Fushata e tyre kundër qeverisë dhe mbështetësve të NATO–s ka qenë gjithnjë e më e suksesshme.

Taktikat e talebanëve janë të tilla që i bëjnë njerëzit atje të mos ndihen të sigurt në asnjë vend. Talebanët janë veçanërisht kundërshtarë të arsimimit të grave.

Për disa vite, pasi Talebanët u hoqën nga pushteti, u duk sikur ata mbaruan. Vajzat u kthyen në shkollat e mbyllura prej talebanëve, grupet e grave filluan aktivitetin dhe gratë u shfaqën në televizione si drejtuese lajmesh.

Tashti ka filluar një fushatë e re vrasjesh kundër grave të shquara. Me trupat e NATO–s, të vendosura kryesisht në pjesën jugore të vendit, policia dhe ushtria afgane e kanë të vështirë të veprojnë në pjesët e tjera të vendit. Rekrutë të rinj, armë të reja dhe taktika të reja vijnë nga jashtë vendit në ndihmë të talebanëve.[32]

Talebanët duhet të pajtohen me rregullat e së drejtës ndërkombëtare humanitare, me të cilat ata janë të lidhur. Ata duhet t'i japin fund sulmeve që nuk bëjnë dallim, siç janë sulmet vetëvrasëse në vende publike dhe të ndalojnë vënien e qëllimshme në shënjestër të punonjësve civilë, të cilët punojnë për qeverinë, ose me organizatat e huaja.

7.5.2 Grupi ndërkombëtar i krizave për Afganistanin

Grupi i krizave është krijuar në vitin 1995 nga një grup qytetarësh të shquar ndërkombëtar dhe specialistësh të huaj politikë të cilët ishin të tmerruar nga dështimi i komunitetit ndërkombëtar për të vepruar me efektivitet në përgjigje të krizave në Somali, Bosnjë dhe Ruanda. Qëllimi i tyre ishte të krijonin një organizatë të re, tërësisht të pavarur nga çdo qeveri, e cila do t'i ndihmonte qeveritë, organizmat ndërqeveritare dhe komunitetin ndërkombëtar për të parandaluar konfliktin vdekjeprurës dhe në qoftë se dështojnë në parandalimin e konfliktit, të përpiqen ta zgjidhin atë. Qëllimi i tyre primar është parandalimi t'i bindin ata që janë në gjendje të ndryshojnë rrjedhën e ngjarjeve që të veprojnë në mënyrë që të parandalojnë tensionet dhe fatkeqësitë, në vend që t'i lenë ato të shpërthejnë në konflikt të dhunshëm.

Grupi ndërkombëtar i krizave është konsideruar si drejtuesi i pavarur i botës, burim i analizave dhe këshillave ndaj qeverive dhe organizmave ndërqeveritare si Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Banka Botërore, në parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit vdekjeprurës.[33] Shtabi i Grupit Ndërkombëtar të Krizave është në Bruksel dhe ka zyra në Uashington DC, Nju York, Londër dhe Moskë.

Grupi ndërkombëtar i krizave i cili përkrah zgjidhjet politike të drejtuesve politikëbërës të botës në zonat me konflikt aktual ose potencial përmes katër kontinenteve në nëntor 2006 bëri këto rekomandime:

32. Caroline Wyatt, Afgan burden tasks NATO allies, BBC News, Noordwijk, www.afghanistannewscenter.com/news/2007/.../nov202007.html
33. International Crisis Group 2008 annual report review of 2007 plans for 2008, www.crisisgroup.org

Qeveria e Afganistanit duhet:

- Të fillojë një fushatë antikorrupsion, të drejtuar nga Presidenti, që përfshin në shënjestrat e saj ata që janë të implikuar në tregtinë e narkotikëve.
- Të ringjallë dhe të çojë përpara Planin e Veprimit për Paqe, Pajtim e Drejtësi.
- Të zbulojë se pse ushtria afgane ka vështirësi në marrjen e personelit dhe të merren masa, duke përfshirë përmirësimin e mirëqënies të anëtarëve të familjeve të ushtarakëve.
- T'i japë prioritet policisë, nëpërmjet reformës së pagave, gradave dhe një disipline më strikte të brendshme në rastet e abuzimit ose moskryerjes së rregullt të detyrave.
- Të lehtësojë hyrjen e grupeve të pavarura të monitorimit, për të marrë informacion mbi fatkeqësitë civile, të ndaluarit dhe personat e zhvendosur.

SHBA, aleatët e tjerë dhe qeveritë demokratike:

- të sigurojnë më shumë fonde për sektorin juridik dhe të shtojnë aftësinë ndërtuese të institucioneve të reja përfaqësuese, duke siguruar që zëri i tyre të dëgjohet në vendimmarrje.

Qeveritë e vendeve të NATO – s:

- Të sigurojnë presion diplomatik mbi Pakistanin, për të gjykuar ose dorëzuar udhëheqësit Talebanë, për t'i dhënë fund vendeve të shenjta politike dhe ushtarake të kryengritësve.
- Të heqin pengesat kombëtare që pengojnë ndërveprimin, në mënyrë që të gjitha trupat ndërkombëtare në Afganistan të mund të përdoren ku dhe si të jetë e nevojshme në vend.
- Të koordinojnë operacionet anti terroriste me operacionet kundër kryengritësve dhe t'i zhvillojnë të gjitha këto operacione në konsultim me autoritetet afgane.
- T'i japin autoriteteve përkatëse afgane dhe autoriteteve ndërkombëtare të gjithë informacionin e nevojshëm mbi kultivimin dhe tregtimin e narkotikëve, duke përfshirë informacionin që lidhet me aktivitetin e grupeve aleate afgane dhe t'i lehtësojë institucioneve afgane dhe forcave afgane të sigurisë përmbushjen e strategjisë kombëtare kundër narkotikëve.

Zyrat kryesore të Grupit të Krizave, në Bruksel, Uashington DC dhe Nju York vazhdojnë të japin siguri se Grupi i Krizave ka akses dhe influencë në nivelet më të larta të qeverive të SHBA–ve dhe Evropiane, Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian dhe NATO–s. Zyrat në Londër dhe Moskë punojnë për të kufizuar profilin e Grupit të krizave dhe për të përmirësuar aksesin në politikë bërësit e Mbretërisë së Bashkuar dhe rusë, ndërsa Brukseli është përgjegjës për anëtarin tjetër evropian, "të pesë anëtarëve të përhershëm", Francën.

Ndërsa kryengritja e cila po rritet gjithnjë e më shumë po tërheq vëmendjen, kërkesat për përpjekje afatgjatë për të ndërtuar institucione qeveritare solide në Afganistan, po dështojnë.

Nevojitet ushtrimi i një presioni diplomatik ndaj Pakistanit dhe qeveria e Presidentit Karzai duhet të tregojë vullnet politik për t'iu përgjigjur pakënaqësisë së brendshme me përpjekje serioze në luftën kundër korrupsionit, të punojë me Asamblenë Kombëtare të zgjedhur dhe të zgjedhë shtetin e së drejtës duke i dhënë fund kulturës së pandëshkueshmërisë. Afganistani ka nevojë për një përpjekje të rinovuar, afatgjatë për të ngritur një qeveri efektive, e cila të sigurojë sigurinë reale të popullit të saj.

Çelësi i rindërtimit të paqes dhe stabilitetit në Afganistan nuk është hyrja në bisedime me ekstremistët e dhunshëm, por përballja me ankesat legjitime të popullsisë, të cilët në pjesën më të madhe kanë mbështetur demokratizimin.

Për t'i shërbyer më mirë interesave të veta dhe atyre të popullit afgan, komuniteti ndërkombëtar duhet t'i kërkojë hapa serioze qeverisë së Karzait për të hequr zyrtarët e korruptuar dhe të krijojë axhenda më të qarta veprimi, si dhe duhet të jetë i përgatitur për të ndëshkuar dështimet e qeverisë në përmbushjen e angazhimeve për t'i dhënë fund pandëshkueshmërisë. Edhe në qoftë se kostoja do të jetë një dhimbje afatshkurtër, fokusi duhet të ngelet te qëllimi afatgjatë i krijimit të një shteti demokratik, paqësor, pluralist dhe të begatë.

7.6 NDËRHYRJA HUMANITARE NË BOSNJË & HERCEGOVINË

Bosnjë & Hercegovina është një vend që ka përjetuar një konflikt shkatërrues me shkelje të frikshme të të drejtave njerëzore dhe të së drejtës ndërkombëtare.

Lufta në Bosnjë & Hercegovinë, e njohur përgjithësisht si Lufta e Bosnjës, ishte një konflikt i armatosur ndërkombëtar që u zhvillua nga marsi 1992 deri në nëntor 1995. Në luftë u implikuan palë të ndryshme. Lufta në Bosnjë & Hercegovinë filloi si rezultat i shpërbërjes së Jugosllavisë. Në 1989 Sllobodan Millosheviç u bë president i Serbisë. Me dobësimin e sistemit komunist në fund të Luftës së Ftohtë në Jugosllavi filloi të shfaqej kriza.

Për shkak se lufta në Bosnjë & Hercegovinë ishte pasojë e paqëndrueshmërisë në rajonin më të gjerë të ish-Jugosllavisë dhe për shkak të implikimit të vendeve fqinje Kroacisë dhe Malit të Zi, ka ekzistuar një debat i gjatë nëse konflikti ishte një luftë civile apo një luftë pushtuese.

Pasi Sllovenia dhe Kroacia deklaruan pavarësinë nga Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë në vitin 1991, Bosnjë & Hercegovina organizoi gjithashtu një referendum për pavarësinë. Pavarësia u shpall më 5 Mars 1992 nga parlamenti. Njohja ndërkombëtare e Bosnjë & Hercegovinës rriti presioni diplomatik për Ushtrinë Popullore Jugosllave që të tërhiqej nga territori i republikës. Ushtria popullore jugosllave zyrtarisht u largua nga Bosnjë & Hercegovina më 12 maj 1992, shumë shpejt pas shpalljes së pavarësisë në prill 1992. Sidoqoftë, në fakt, anëtarët serbë të Bosnjës në Ushtrinë Popullore Jugosllave thjesht ndërruan vendin, formuan Ushtrinë e Republikës Serbe dhe vazhduan luftimin.[34]

34. Report of the Secretary-General of 30 May 1995 on the situation in Bosnia and Herzegovina (UN Doc. S/1995/444), especially at para. 60 et seq.; letter dated 18 September 1995from the Secretary-General addresses to the President of the Security Council (UN Doc. S/1995/804); S. Jacobi, loc. cit. note 26.

Pjesa më e madhe e zinxhirit të komandimit, armatimi dhe personeli ushtarak i gradave të larta, përfshirë gjeneralin Ratko Mlladiç, qëndruan në Bosnjë & Hercegovinë në Ushtrinë e Republikës Serbe.

E armatosur dhe e paisur nga stoqet e Ushtrisë Popullore Jugosllave në Bosnjë, e mbështetur nga forca vullnetare dhe paramilitare të ndryshme nga Serbia, dhe duke marrë mbështetje të madhe humanitare, logjistike dhe financiare nga Republika Federative e Jugosllavisë, serbët sulmuan pjesë të ndryshme të vendit. Ofensivat e Republikës Serbe në 1992 arritën që të vinin pjesën më të madhe të vendit nën kontrollin e tyre.

Administrata shtetërore e Bosnjë & Hercegovinës[35] efektivisht pushoi së funksionuari duke humbur kontrollin mbi të gjithë territorin. Serbët donin të gjitha tokat ku serbët përbënin pjesën më të madhe, Bosnjën perëndimore dhe lindore. Kroatët dhe drejtuesi i tyre Franjo Tuxhman gjithashtu kishin qëllim të siguronin pjesë të Bosnjës & Hercegovinës.

Bosnjë & Hercegovina historikisht ka qenë një shtet multietnik. Në 1990 popullsia e saj përbëhej efektivisht nga 43% boshnjakë, 31 % serbë dhe 17% kroatë.

Konflikti në Bosnjë & Hercegovinë, i cili zgjati më shumë se 3 vjet, ishte konflikti më i përgjakshëm në Evropë, qysh prej Luftës së Dytë Botërore.

Spastrimi etnik ishte një fenomen i zakonshëm në luftë. Kjo përfshinte frikësimin, dëbimin e detyruar ose vrasje të grupit etnik të padëshiruar si dhe shkatërrimin e shenjave fizike të grupit etnik, si dhe vendet e adhurimit, varrezat dhe ndërtesat historike e kulturore. Për më tepër, forcat serbe kryen genocid në Serbrenicë në përfundim të luftës.

Praktika e spastrimit etnik u përdor nga të tre palët në konfliktin e Bosnjës, megjithatë shumë grupe dhe vëzhgues vlerësojnë se Serbia ka qenë ajo e cila ka filluar dhe e ka kryer në përmasa më të mëdha spastrimin etnik.

Megjithëse nuk patën sukses në mbrojtjen e civilëve nga sulmet, Kombet e Bashkuara u angazhuan seriozisht në hetimin e krimeve të luftës, genocidit dhe krimeve kundër njerëzimit në ish-Jugosllavi dhe themeluan Gjykatën Ndërkombëtare Penale.

Genocidi është krimi më serioz i luftës për të cilin u dënuan serbët, krimet kundër njerëzimit për kroatët dhe shkelje të konventave të Gjenevës për boshnjakët.

Sllobodan Milloshevic u akuzua nga Gjykata Penale Ndërkombëtare e Jugosllavisë për krime që përfshinin genocidin në Bosnjë, Kroaci dhe Kosovë.

---

35. Lidhur me Jugosllavinë, Kapitulli VII u përdor me qëllim që të siguohej shpërndarja e ndihmës humanitare, (SC res. 770 (1992), të ndaloheshin fluturimet në hapësirën ajrore të Republikës së Bosnjë - Herzegovinës,dhe për të siguruar zbatimin e këtij ndalimi (SC res. 816 (1993), të deklaroheshin "zona të sigurta" ku nuk mund të kishte sulme të armatosura dhe akte të tjera armiqësore (SC res. 824 (1993),si dhe të autorizohej UNPROFOR –I në zbatimin e përdorimit të forcës, në përgjigje të bombardimeve kundër zonave të sigurta(SC res. 836 (1993) and 958 (1994).

Qeveria e Bosnjës e akuzoi Serbinë për bashkëpunim në genocid në Bosnjë gjatë luftës, në Gjykatën Ndërkombëtare Penale. Gjykata Ndërkombëtare Penale në 26 shkurt 2007 vendosi që natyra e luftës ishte ndërkombëtare, megjithatë e çliroi Serbinë nga përgjegjësia direkte për genocidin e kryer nga forcat serbe të Bosnjës dhe dështoi në ndëshkimin e atyre që kryen genocid, veçanërisht gjeneral Ratko Mlladic.

7.6.1 Mbështetja ndërkombëtare për luftën e Bosnjë-Hercegovinës

Kombet e Bashkuara kishin ndërkohë trupat e UNPROFOR, (Forca Mbrojtëse e Kombeve të Bashkuara), në Sarajevë që në fillim të luftës në Bosnjë sepse ajo ishte baza e tyre e veprimit për misionin e Kombeve të Bashkuara në Kroaci. Kombet e Bashkuara shpresonin që prezenca e tyre do të shkurajonte përhapjen e konfliktit nga Kroacia në Bosnjë. Por kur Sarajeva u sulmua nga artilieria serbe në prill 1992, forcat e Kombeve të Bashkuara u tërhoqën për të shmangur fatkeqësitë, duke lënë pas vetëm një kontigjent të vogël dhe të armatosur lehtë të "paqeruajtësve" për të shkurajuar sulmet nga nacionalistët serbë. Por në këtë rast nuk ishte momenti për paqeruajtje. Ndërsa situata u përkeqësua, duke krijuar një tmerr humanitar, Kombet e Bashkuara bënë një marrëveshje me serbët që të kontrollonin aeroportin e Sarajevës.

Në qershor 1992, Forca Mbrojtëse e Kombeve të Bashkuara e cila siç e përmendëm më lart ishte vendosur fillimisht në Kroaci kishte mandat mbi Bosnjë & Hercegovinën fillimisht të mbronte aeroportin ndërkombëtar të Sarajevës. Në fakt, serbët i lejuan Kombet e Bashkuara vetëm të përdornin aeroportin nën kontrollin serb. Në shtator, roli i UNPROFOR-it u zgjerua me qëllim që të mbrohej ndihma humanitare dhe të asistohej në shpërndarjen e saj në të gjithë Bosnjë & Hercegovinën, si dhe ndihma në mbrojtjen e refugjatëve civilë kur kërkohej nga Kryqi i Kuq.

Në përpjekje për të mbrojtur civilët roli i UNPROFOR-it u zgjerua më tej në 1993 për të mbrojtur "zonat e sigurta"[36] që ishin deklaruar rreth Sarajevës, Serbrenicës, Tuzlës, Zepës, Gorazdes dhe Bihacit. Këto "zona të sigurta" ishin deklaruar nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në prill-maj 1993.

Në gusht 1993, NATO deklaroi gatishmërinë e saj për t'u përgjigjur me goditje ajrore, në bashkëpunim me Kombet e Bashkuara, në rast se rrethoheshin zonat e sigurta të Kombeve të Bashkuara, përfshirë Sarajevën në Bosnjë.[37]

Në 1994, NATO-ja u implikua aktivisht, kur aeroplanët e saj qëlluan katër avionë serbë mbi Bosnjën qendrore në 28 shkurt 1994 të cilët po shkelnin zonën jofluturuese të Kombeve të Bashkuara.[38]

36. Security Council Resolution 824 of 6 May 1993.
37. NATO Involvement in the Balkan Crisis, U.S. Dept. Of State Geographic Bureaus, U.S. Department of State, http://dosfan.lib.uic.edu/ERC/bureaus/eur/releases/951101Bosnia Chronology.html, p. 7
38. Security Council resolution 816 of 31 March 1993.

Ndërhyrja humanitare në Bosnjë u zbatua në formën e operacioneve UNPROFOR, (the United Nations Protection Force), në vitet 1994-1995. Funksioni i UNPROFORIT-it ishte të shpërndante ndihma humanitare tek refugjatët dhe popullsia civile në qytetet e rrethuara si Sarajeva. Sidoqoftë, dobësia themelore e kësaj ndërmarrjeje ishte se ndërhyrja nuk kishte për qëllim të ndalonte luftimin aktual që shkaktonte krizën humanitare. Trupat e Kombeve të Bashkuara lejoheshin vetëm të vetëmbroheshin ose të mbronin punonjësit humanitarë që shpërndanin ndihmën. Ata mund të bënin pak, p.sh. kur trupat serbe, nën drejtimin e Gjeneralit Ratko Mlladiç, pushtuan "zonat e sigurta" të Kombeve të Bashkuara në Serbenicë, në Bosnjën Lindore, ku u masakruan 7.000 burra dhe djem në korrik 1995.

Lufta Kroato-Boshnjake zyrtarisht përfundoi në 23 shkurt 1994, kur u nënshkrua marrëveshja e armëpushimit në Zagreb. Në mars 1994 një marrëveshje paqeje e ndërmjetësuar nga SHBA ndërmjet kroatëve dhe Republikës së Bosnjë & Hercegovinës u nënshkrua në Uashington dhe Vienë, e cila njihet si marrëveshja e Uashingtonit. Tashmë mbetën vetëm dy palë në konflikt.

Lufta vazhdoi gjatë gjithë vitit 1995. Trupat serbe gjatë vitit 1995 kryen masakra të shumta: Masakrën e parë të Markalesë, masakrën e Tuzlës (25 maj 1995), masakrën e dytë të Markalesë (28 gusht 1995) dhe masakrën e Serbenicës. Pas masakrës së dytë në Markale, NATO u përgjigj me goditje të gjera ajrore kundër infrastrukturës dhe njësive serbe të Bosnjës në shtator.

Megjithëse u planifikua dhe u aprovua nga Këshilli i Atlantikut Verior në korrik 1995, operacioni filloi si përgjigje direkte e masakrës së dytë të Markalesë të 28 gusht, 1995.

Në gusht 1995, kur serbët e Bosnjës sulmuan "zonën e sigurt"[39] të Sarajevës dhe refuzuan kushtet e NATO – s e të Kombeve të Bashkuara për tërheqjen e armatimeve të rënda, NATO ndërmori fushatën e saj ajrore. Bombardimi i NATO – s në vitin 1995 ishte një fushatë ajrore për të minuar aftësitë ushtarake të Ushtrisë Serbe të Bosnjës, e cila kërcënoi dhe sulmoi zonat e përcaktuara si të sigurta nga Kombet e Bashkuara në Bosnjë. Operacioni u zhvillua nga 30 gusht deri më 20 shtator 1995.[40]
Kombet e Bashkuara autorizuan NATO-n të kryente aktivitete dhune në Bosnjë & Hercegovinë brenda kontekstit të një mandati nga Kombet e Bashkuara.

Angazhimi i NATO-s gjatë Operacionit Deliberate Force në 1995 kundër pozicioneve të Ushtrisë së Republikës Serbe e institucionalizoi konfliktin, por vetëm në fazat e tij të fundit.

Ndërhyrja e NATO-s në Bosnjë i dha fund politikës së spastrimit etnik që nacionalistët serbë dhe Ushtria serbe e Bosnjës po zhvillonin përmes Bosnjës.

39. Security Council Resolution 770 of 13 August 1992.
40. 1995 NATO bombing of Bosnia & Herzegovina, http://en.wikipedia.org/wiki/1995_NATO_bombing_of_Bosnia_and_Herzegovina, p. 5

Fushata e Aleatëve u bëri të qartë serbëve të Bosnjës se komuniteti ndërkombëtar nuk bën tolerime për shkeljen e rezolutave të Kombeve të Bashkuara.

Sulmet ajrore rritën presionin ndërkombëtar mbi Jugosllavinë e Millosheviçit për të marrë pjesë në bisedimet që rezultuan në marrëveshjen e Paqes së Dejtonit.

Sulmet ajrore të NATO-s i detyruan serbët të binin dakord që të negocionin për t'i dhënë fund luftës.

Në këtë moment, komuniteti ndërkombëtar shtyu Millosheviçin, Tuxhmanin dhe Izetbegoviçin të bisedonin për t'i dhënë fund luftës. Gjatë shtatorit dhe tetorit 1995, shumë prej fuqive të botës, (veçanërisht SHBA dhe Rusia), ushtruan presion të vazhdueshëm ndaj udhëheqësve të të treja palëve për të marrë pjesë në bisedimet që do zhvilloheshin në Dejton, Ohaio.

Konferenca u zhvillua nga 1 nëntori deri në 21 nëntor 1995. Pjesëmarrësit kryesorë nga rajoni ishin presidenti serb Sllobodan Millosheviç, (që përfaqësonte interesat e serbëve të Bosnjës për shkak të mungesës së Karaxhiçit), Presidenti kroat Franjo Tuxhman dhe Presidenti i Bosnjës Alija Izetbegoviç me ministrin e jashtëm boshnjak.

Luftës i erdhi fundi pas nënshkrimit të kornizës së përgjithshme të Marrëveshjes për Paqe në Bosnjë & Hercegovinë në Paris në 14 Dhjetor 1995. Bisedimet e paqes u mbajtën në Dejton, Ohaio dhe u finalizuan më 21 Dhjetor 1995. Marrëveshjet njihen me emrin Marrëveshja e Dejtonit.

Marrëveshja e Paqes, e Dejtonit bëri të mundur që në Bosnjë[41] të zbatoheshin mbrojtjet e të drejtave njerëzore të njohura ndërkombëtarisht të nivelit më të lartë, duke e bërë Konventën Evropiane të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore drejtpërdrejt të zbatueshme.

Për më tepër Marrëveshja e Dejtonit i dha mandat në një shkallë të gjerë agjencive ndërkombëtare për të asistuar në realizimin e qëllimeve të saj, duke krijuar Zyrën e Përfaqësuesit të Lartë për të mbikëqyrur zbatimin e saj.[42]

Aleatët luajtën rol kryesor në zbatimin e Marrëveshjes së Paqes të Dejtonit në Bosnjë & Hercegovinë, si dhe në sigurimin e kësaj paqeje përmes misioneve paqeruajtëse në një periudhë 9-vjeçare, nga dhjetori 1995 deri në dhjetor 2004.

Menjëherë pas nënshkrimit të akordeve, Forca Ndërkombëtare e Implementimit, (IFOR), një forcë paqeruajtëse e drejtuar nga NATO, arriti në Bosnjë.

Forca Zbatuese (IFOR) e drejtuar nga NATO ishte përgjegjëse për zbatimin e aspekteve ushtarake të marrëveshjes dhe u vendos në 20 Dhjetor 1995, duke zëvendësuar forcat e UNPROFOR – it. IFOR, misioni i parë paqeruajtës i NATO-s me një shkallë të gjerë veprimi, u zëvendësua një vit më vonë nga Forca Stabilizuese, SFOR.

41. The Dayton Peace Accords on Bosnia. Ohio on November 21, 1995 and signed in Paris on December 14, 1995. http://www1.umn.edu/humanrts/icty/dayton/daytonaccord.html
42. Ms.Madaleine Rees Chief of Mission OHCHR BiH, Human Rights Field Presence in Bosnia and Hercegovina, mrees@ohchr.org

Detyra kryesore e SFOR–it ishte të kontribuonte në krijimin e një mjedisi të sigurt, i cili do të ndihmonte rindërtimin civil dhe politik. Veçanërisht SFOR kishte për detyrë të

parandalonte rifillimin e armiqësive, të nxiste krijimin e një klime në të cilën procesi i paqes mund të vazhdonte të ecte përpara.

Operacioni ushtarak paqeruajtës në Bosnjë u krye me sukses. Ai krijoi një paqe afatgjatë dhe të qëndrueshme, si dhe një mjedis të sigurt.

Misioni i SFOR–it përfundoi në dhjetor 2004, kur përgjegjësia për ruajtjen e paqes i kaloi Bashkimit Evropian.

NATO megjithatë mbajti një shtab ushtarak në Sarajevë për të asistuar autoritetet boshnjake në reformën e mbrojtjes, kundër terrorizmit, si dhe në sigurimin e informacioneve dhe arrestimin e të dyshuarve për krime lufte.

Tashmë Bosnja ka një demokraci funksionale. Bosnjë & Hercegovina po përpiqet të përshtatet me standardet dhe institucionet euro–atlantike. Në prill 2008 Bosnjë & Hercegovina u ftua të fillonte dialogun intensiv me NATO–n, në lidhje me aspiratat e saj për anëtarësim dhe për reformat përkatëse.

7.6.2 Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli i Sigurimit për Bosnjë & Hercegovinën.

Situata e rëndë në Republikën e Bosnjës & Hercegovinës u konsiderua nga Asambleja e Përgjithshme si një kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

Asambleja e Përgjithshme u kërkoi palëve të vepronin me mirëbesim, të pushonin zjarrin dhe të binin dakord që t'i jepnin fund armiqësive përmes Bosnjë & Hercegovinës, me qëllim që të krijohej një atmosferë që bënte të mundur rifillimin e bisedimeve për paqe brenda kuadrit të Konferencës Ndërkombëtare mbi ish Jugosllavinë.

Rezoluta 48/88 e datës 20 dhjetor 1993 e Asamblesë së OKB – së mbi situatën në Bosnjë & Hercegovinë dënonte veprimet e vazhdueshme armiqësore të serbëve të Bosnjës, veçanërisht politikën e ulët të spastrimit etnik.[43]

Ajo riafirmoi vendosmërinë e saj që Republika e Bosnjë & Hercegovinës të ruajë pavarësinë e saj dhe integritetin territorial dhe vuri në dukje, në përputhje me nenin 24 të Kartës, përgjegjësinë e Këshillit të Sigurimit në këtë drejtim.

Asambleja e Përgjithshme riafirmoi vendosmërinë e saj për të penguar aktet e genocidit dhe krimet kundër njerëzimit, si dhe kundërshtimin e saj të plotë për përvetësimin e territorit përmes përdorimit të forcës dhe praktikës së ulët të spastrimit etnik.

---

43. United Nations Distr.General A/RES/48/88 29 December 1993, The situation in Bosnia & Hercegovina, General Assembly resolution 48/88 of 20 December 1993.

E ndërgjegjshme për karakterin e Sarajevës si multikulturore, multietnike dhe një qendër multireligjioze, Asambleja e Përgjithshme theksoi nevojën e pengimit të shkatërrimit të

mëtejshëm. Rrethimi i Sarajevës dhe qyteteve të tjera boshnjake dhe "zonave të sigurta", rrezikonte mirëqenien dhe sigurinë e banorëve.

Asambleja e Përgjithshme bëri thirrje që t'i jepej fund veprimeve armiqësore dhe të lehtësohej shpërndarja e asistencës humanitare, në përputhje me paragrafin 5 dhe 9 të Rezolutës 836 të Këshillit të Sigurimit të 4 qershorit 1993, që serbët e Bosnjës të tërhiqnin artilerinë e rëndë dhe forcat jashtë qytetit të Sarajevës dhe "zonave të tjera të sigurta" në një distancë ku të mos përbënte më rrezik për sigurinë e tyre dhe të banorëve të tyre dhe ku mund të monitoroheshin nga vëzhguesit ushtarakë të Kombeve të Bashkuara.

Ajo i kërkoi Këshillit të Sigurimit të vepronte menjëherë për mbylljen e të gjitha kampeve të ndalimit në Bosnjë & Hercegovinë dhe derisa kjo të arrihej, të vendoste vëzhgues ndërkombëtarë në këto kampe.

Në Rezolutën 1034 (1995), Këshilli i Sigurimit dënonte shkeljet e të drejtës ndërkombëtare humanitare në Bosnjë & Hercegovinë si: ekzekutimet, përdhunimet, shpërnguljet masive, arrestimet arbitrare, punën e detyruar dhe shkeljet në shkallë të gjerë të kryera nga serbët e Bosnjës dhe forcat ushtarake rezerviste.

Në muajin tetor 1996, Këshilli i Sigurimit, në një njoftim për shtyp shprehte shqetësimin për mungesën e progresit të investigimeve mbi të drejtën ndërkombëtare humanitare në Bosnjë & Hercegovinë.

Këshilli i Sigurimit dënonte të gjitha përpjekjet për të penguar hetimin, ose për të shkatërruar, fshehur dhe dëmtuar çdo lloj informacioni. Këshilli përsëriste detyrimet e të gjitha palëve për të bashkëpunuar tërësisht dhe pa kushte me autoritetet ndërkombëtare përkatëse dhe me njëra – tjetrën, në lidhje me këto hetime dhe u rikujtonte palëve angazhimin e tyre, sipas kornizës së përgjithshme të Marrëveshjes për Paqen në Bosnjë & Hercegovinë.[44]

7.7 NDËRHYRJA USHTARAKE NË IRAK, 2003

Në 20 mars 2003, Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar dhe një koalicion aleatësh ndërhynë në Irak dhe përmbysën qeverinë e Sadam Huseinit. Ata pretenduan se do të sillnin paqe, begati dhe demokraci.[45]

Sadam Husein ishte një tiran që la pas një shoqëri të thyer dhe të dobësuar. Lufta shumë e gjatë me Iranin, (1980-1988) dhe 13 vitet ndëshkuese të sanksioneve të Kombeve të Bashkuara pa dyshim patën taksën e tyre.

---

44. Press Release SC/6276 10 October 1996 Security Council expresses concern over lack of progress on investigations of international humanitarian law in Bosnia & Hercegovina

45. War and Occupation in Iraq - Pakistan Defence Forum, Chapter 1, http://www.google.com/search?q=War+and+Occupation+in+Iraq%2C+Chapter+1&

Përpara ndërhyrjes, SHBA dhe Mbretëria e Bashkuar i kërkuan me ngulm Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të autorizonte "përdorimin e forcës kundër Irakut".

Ato argumentuan se forca ishte e nevojshme për të penguar qeverinë irakiane që të zhvillonte ose përdorte armët e shkatërrimit në masë që mund të vinin në shënjestër kombe të tjera. Në shkurt 2003, Sekretari i shtetit Kolin Pauell tha: "Ne po ju japim fakte dhe konkluzione të bazuara në shërbime zbulimi solide." Por, pjesa më e madhe e anëtarëve të Këshillit të Sigurimit ishin skeptikë dhe në fund të takimit Këshilli nuk autorizoi veprim ushtarak[46]

Me insistimin e SHBA dhe Mbretërisë së Bashkuar, Këshilli i Sigurimit i OKB kaloi Rezolutën 1511, në tetor 2003, duke i dhënë koalicionit të drejtuar nga SHBA në Irak një mandat të Kombeve të Bashkuara, si një "forcë shumëkombëshe" dhe duke e autorizuar atë të merrte "të gjitha masat e nevojshme për të kontribuar në ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit në vend". Këshilli ka rinovuar mandatin në mënyrë të përsëritur në rezolutat 1546 (8.6.2004), 1637 (8.11.2005) dhe 1723 (18.11.2006).[47]

Në qershor 2006 Iraku ka njoftuar Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara që ai dëshiron që forca shumëkombëshe e udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara të mbetet në vend për tani meqë policia dhe trupat e Irakut nuk janë akoma gati për të siguruar siguri vetë. "Ndërsa janë shënuar arritje të mëdha nga populli i Irakut në sferën e zhvillimit politik, vazhdimi i mandatit të forcës shumëkombëshe në Irak mbetet i nevojshëm dhe thelbësor për sigurinë tonë", tha në një letër drejtuar Kombeve të Bashkuara në 9 qershor Ministri i Jashtëm Hoshiyar Zebari.

Një rezolutë e adoptuar nga 15 kombe të Këshillit të Sigurimit në nëntor e zgjati mandatin e forcës shumëkombëshe deri në fund të 2006, por kërkoi një rishikim në 15 qershor. Sipas rezolutës Këshilli do t'i jepte fund mandatit në çdo kohë po të kërkohej kjo nga qeveria e Irakut.[48]

Në 2007, Uashingtoni dhe Londra përsëri i kërkuan Këshillit të Sigurimit që të rinovojë edhe për një vit mandatin e Forcës Shumëkombëshe.

SHBA dhe Mbretëria e Bashkuar duke justifikuar ndërhyrjen në Irak pretenduan se vepruan në"vetëmbrojtje" të ligjshme sipas nenit 51 të Kartës së OKB-së. Të dy vendet e sipërpërmendura nxorën argumente humanitare, siç është çlirimi I popullit Irakian nga diktatura e Sadam Huseinit dhe abuzimet e tij të frikshme me të drejtat humane.

---

46. War and Occupation in Iraq - Pakistan Defence Forum, Chapter 1, http://www.google.com/search?q=War+and+Occupation+in+Iraq%2C+Chapter+1&
47. Multinational Force Mandate Renewal, http://www.globalpolicy.org/security/issues/iraq/mnfindex.htm
48. Irwin Arieff, Iraq Tells UN it Wants Multinational Force to Stay, Reuters, June 13, 2006, http://www.globalpolicy.org/security/issues/iraq/unrole/2006

Në vend të shtetit të Irakut, Shtetet e Bashkuara krijuan Autoritetin e Përkohshëm të Koalicionit një trup qeverisës pa pjesëmarrjen e Irakut të kryesuar nga Paul Bremer, një i emëruar i Pentagonit. Bremer i vendosi zyrat e tij në ish Pallatin Republikan të Sadamit. Bremer organizoi, një zonë sigurie, shumë të kontrolluar në mes të Bagdadit të njohur si "zona e gjelbër" ku Autoriteti i Përkohshëm i Koalicionit dhe Komanda e Lartë Ushtarake mund të jetonte dhe të punonte në siguri.[49]

Shpejt, pas marrjes së Bagdadit, drejtuesit ushtarakë dhe udhëheqësit politikë të SHBA shpallën një program masiv rikonstruksioni për të rindërtuar Bagdadin dhe për ta sjellë vendin në një nivel të ri prosperiteti. Presidenti Bush madje e krahasoi përpjekjen me Planin Marshall në Evropë pa Luftës së Dytë Botërore.

Në 22 maj 2003, pikërisht tre muaj pas ndërhyrjes, Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara themeloi Fondin e Zhvillimit për Irakun për të menaxhuar në të ardhmen të ardhurat e naftës. Fondi iu dorëzua Autoritetit të Përkohshëm të koalicionit, të dominuar nga SHBA.[50]

Që nga fillimi, SHBA dhe partnerët e tyre insistuan se ato po themelonin një Irak demokratik që shpejt do të bëhej një model për të gjithë rajonin.

"Ne po ndërhyjmë në rindërtimin e Irakut, ku diktatori ndërtoi pallate për veten, në vend të spitaleve dhe shkollave. Ne do të qëndrojmë me udhëheqësit e rinj të Irakut", premtoi Bush, "ndërsa ata themelojnë një qeveri të popullit te Irakut, nga populli i Irakut dhe për popullin e Irakut".[51] Bush insistoi, "Burrat dhe gratë në çdo kulturë kanë nevojë për liri, siç ata kanë nevojë për ushqim, ujë dhe ajër. Kudo ku arrin liria, njerëzimi gëzohet dhe kudo ku liria lëviz, le të frikësohen tiranët".

"Ne do t'i ndihmojmë irakianët të ndërtojnë një Irak të lirë, në paqe me veten dhe me fqinjët e tij…që respekton të drejtat e popullit Irakian dhe shtetin e së drejtës dhe që është në shtegun e demokracisë." tha Condoleza Rice.

Në shtator 2007 Bush mbajti një fjalim mbi rishikimin e progresit ushtarak të bërë në Irak. Pjesa më e madhe e fjalimit të tij u fokusua në arritjet shumë të vështira të sigurisë brenda Irakut, veçanërisht në rajonet ku ishte përqendruar sulmi: në Bagdad dhe në zonat përreth, si dhe në provincën Anbar – një ish mbrojtëse e fortë e kryengritjes.

Bush theksoi: "Drejtuesit tanë ushtarakë besojnë në suksesin tonë. Diplomatët besojnë që ne do të kemi sukses. Dhe për sigurinë e brezave të ardhshëm amerikanë, ne duhet të kemi sukses. "Dështimi në Irak mund të jetë një fitore për Al – Qaedën dhe Irakun, si dhe një katastrofë humanitare për popullin e Irakut. Dështimi do të krijonte forca të rrezikshme që do të kërcënonin sigurinë e Amerikës dhe aleatëve të saj.[52]

---

49. War and Occupation in Iraq - Pakistan Defence Forum, Chapter 1, http://www.google.com/search?q=War+and+Occupation+in+Iraq%2C+Chapter+1&
50. War and Occupation in Iraq - Pakistan Defence Forum, Chapter 9, http://www.google.com/search?q=War+and+Occupation+in+Iraq%2C+Chapter+1&
51. Juan Cole, Bush's Napoleonic Folly, August 24, 2007, http://www.thenation.com/doc/20070910/cole

52. James Phillips, Bush on Iraq: U.S. Troops "Return on Success", September 14, 2007, www.heritage.org/Research/middleeast/upload/wm

"Një Irak i lirë – shpjegoi Presidenti Bush, do t'i mohonte Al–Qaedës një strehë të sigurt" dhe do të ishte një partner i SHBA në luftën ndaj terrorizmit. Ai i bëri apel "fqinjëve paqësorë" të Irakut, (ku përfshin Iranin, Sirinë, si dhe komunitetit ndërkombëtar të bënin më shumë për të ndihmuar irakianët e rrethuar.

Bush e përfundoi fjalimin e tij duke thënë: "Disa mendojnë se arritjet që po bëjmë në Irak ishin të vonuara, por ata gabojnë. Nuk është kurrë vonë të merresh me një goditje të Al – Qaedës. Nuk është kurrë vonë të përparosh drejt lirisë. Dhe nuk është kurrë vonë të mbështetësh trupat tona në një luftë që ata mund ta fitojnë."

Por, në fund të fundit, suksesi varet nga ndryshimet e politikës së Irakut. N.q.s. drejtuesit politikë të Irakut vazhdojnë të humbin kohën kot, militantët fanatikë Sunni dhe Shia do të rindezin shkrirjen sektariane të përgjakshme.

7.7.1 Debatet që shoqëruan ndërhyrjen e koalicionit në Irak

Ndërhyrja në Irak, angazhimi në të i superfuqisë botërore u shoqëruan me debate të shumta. Armët e shkatërrimit në masë nuk u gjetën dhe nuk u zbulua asnjë lidhje e dukshme e paraluftës ndërmjet Sadam Husein dhe terrorizmit ndërkombëtar.[53] Justifikimet kryesore të ofruara në prag të ndërhyrjes në Irak ishin, posedimi nga ana e qeverisë irakene i armëve të shkatërrimit në masë dhe lidhjet e deklaruara me rrjetet terroriste. Ndërmjet motiveve përmendej edhe mizoria e Sadam Husenit ndaj njerëzve të tij. Sipas administratës së Bushit Sadam Husein ishte një tiran që meritonte të përmbysej.

SHBA duke dhënë arsye për luftë kundër Irakut ka pretenduar se Sadam Hysein ishte një kërcënim për SHBA, aleatët e tyre, Kombet e Bashkuara dhe për të gjithë botën. N.q.s. Kombet e Bashkuara dhe SHBA nuk merren me kërcënimin që shkakton ky njeri i nxjerrë jashtë ligjit ndërkombëtar dhe regjimi i tij, ata do të përballen me pasoja katastrofike.

Bush pretendoi se Iraku ishte aleat me armikun kryesor të SHBA dhe kështu që përbënte një rrezik urgjent për sigurinë e tij.

Kritikët, përfshirë këtu aleatët e SHBA kanë ngritur pyetjen nëse veprimi ushtarak parandalues kundër Irakut është i ligjshëm sipas të drejtës Ndërkombëtare.[54] Zëvendës Presidenti Dick Cheney pohoi se në rastin kundër Irakut, një veprim i tillë ushtarak është i justifikuar. "N.q.s. ne kemi arsye të besojmë se dikush po përgatit një sulm kundër SHBA, i ka zhvilluar mundësitë, fsheh këto aspirata, atëherë unë mendoj se SHBA kanë të drejtë të merren me këtë çështje, n.q.s. është e nevojshme edhe me forcën ushtarake " – pohoi Cheney.

Sipas administratës së Bushit një sulm parandalues kundër Irakut është i justifikuar mbi bazën e kundërshtimit që Sadami i ka bërë çdo rezolute të Kombeve të Bashkuara, qysh nga përfundimi i Luftës së Gjirit.

53. Ken Roth, War in Iraq: Not a humanitarian intervention, 2004, p 5, www.unhcr.org/refworld/pdfid/402ba99f4.pdf

54. David Bruno and Brennan Howell, United States gives reason for war against Iraq, Tiger Times, Issue One, http://www.google.com/search?q=David+Bruno+and+Brennan+Howell

Sadami ka shkelur rezolutat e Kombeve të Bashkuara, të cilat kërkojnë që ai të ndërpresë represionin ndaj popullit të tij, të heqë dorë nga implikimi me terrorizmin, të lirojë më shumë se 600 të burgosur të kapur gjatë Luftës së Gjirit dhe të ndërpresë zhvillimin e armëve të shkatërrimit në masë.[55]

Eshtë krejt e qartë që tashmë është koha për të vepruar kundër Irakut. Pas 11 vitesh të gjata mashtrimi ndaj Kombeve të Bashkuara regjimi i Sadam Hyseinit duhet të përmbyset. "Pra, Amerika duhet të veprojë kundër këtyre kërcënimeve përpara se ato të realizohen plotësisht", ka thënë Bush. "Historia, logjika dhe faktet çojnë në një konkluzion: regjimi i Sadam Huseinit është një kërcënim i madh".

Human Rights Watch në vitin 2004, konkludonte se pavarësisht nga tmerret e udhëheqjes së Sadam Huseinit ndërhyrja në Irak nuk mund të konsiderohej si një ndërhyrje humanitare.

Masakrat e kryera nga Sadam Husein ishin të padiskutueshme, por në kohën e ndërhyrjes në mars 2003, vrasjet e kryera nga ai ishin në rënie.

Sipas Human Rights Watch vrasjet e asaj kohe në Irak nuk mund të justifikonin një ndërhyrje të tillë. Ndërhyrja nuk ishte opsioni i fundit i arsyeshëm për të ndaluar barbarizmat në Irak. Ndërhyrja nuk ishte motivuar nga arsye humanitare dominuese. Ajo nuk u zhvillua në mënyrë që të pajtohej maksimalisht me të drejtën e konfliktit të armatosur. Ndërhyrja nuk ishte aprovuar nga Këshilli i Sigurimit.[56]

Në afrimin e konfliktit, Instituti Arkeologjik i Amerikës, Këshilli Ndërkombëtar i Muzeve, Komiteti Ndërkombëtar i Blue Shield, (mburojës blu) dhe organizata të tjera profesioniste bënë publike paralajmërimet dhe dhanë informacione më të specifikuara rreth thesareve kulturore që ato të mbroheshin. Ato i kujtuan SHBA dhe Mbretërisë së Bashkuar përgjegjësitë e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare, veçanërisht Konventën e Hagës të vitit 1954 "Për Mbrojtjen e Pasurisë Kulturore në Rast Konflikti të Armatosur". Ato ngulën këmbë se mbrojtja e vendeve dhe institucioneve kulturore të Irakut, të ishte një prioritet i lartë për ta.

Këshilli Amerikan për Pasurinë Kulturore, i themeluar në vitin 2002 dhe i fokusuar në artin dhe antikitetin e Lindjes së Mesme, e pa luftën si diçka që ofronte mundësi që trashëgimia e Irakut të gjente blerës ndërkombëtar. Por shumë dijetarë dhe organizata u alarmuan nga kjo ide dhe ishin kundër saj.[57]

---

55. David Bruno and Brennan Howell, United States gives reason for war against Iraq, Tiger Times, Issue One, http://www.google.com/search?q=David+Bruno+and+Brennan+Howell

56. Ken Roth, War in Iraq: Not a humanitarian intervention, 2004, f 5, www.unhcr.org/refworld/pdfid/402ba99f4.pdf
57. War and Occupation in Iraq - Pakistan Defence Forum, Chapter 2, http://www.google.com/search?q=War+and+Occupation+in+Iraq%2C+Chapter+1&

7.7.2 Përdorimi i kontraktuesve privatë

Koalicioni solli në Irak një numër të madh kontraktuesish privat ushtarakë, që shpejt arritën në dhjetëra mijë. Disa, si të punësuarit në Blackëater, Dyncorp dhe CACI International, ishin ish ushtarë të forcave speciale të SHBA, oficerë policie, personel të shërbimit të zbulimit dhe të tjerë me aftësi të veçanta në luftën klandestine. Të armatosur rëndë dhe të përjashtuar nga çdo përgjegjësi, madje dhe nga sistemi ushtarak i drejtësisë, këta ushtarë ishin shumë të paguar dhe të tërhequr nga shumë vende përveçse SHBA dhe Mbretëri e Bashkuar. Ato u punësuan si marrës në pyetje në burgjet e Koalicionit, truproja të zyrtarëve të Koalicionit në Zonën e Gjelbër, njësi të "mbrojtjes së detyruar", skuadra speciale lufte, trajnues të njësive Komando Irakiane etj.[58]

Përdorimi i kontraktuesve privatë nga ushtria e SHBA dhe qeveritë e mbarë botës filloi shumë më parë se SHBA të ndërhynin në Afganistan dhe Irak, por u rrit shumë shpejt përdorimi i tyre vitet e fundit. Pavarësisht se me kundërshtime të vogla, kontraktuesit kanë marrë përsipër gjithnjë e më shumë detyra të mbështetjes dhe logjistikës, që tradicionalisht janë kryer nga Forcat e Armatosura, siç është mbrojtja e diplomatëve brenda një zone luftimi.

Rritja e përdorimit të forcës së përdorur në Irak nga firmat e sigurisë, ka ngritur pikëpyetje. Ishin juristët qeveritarë të implikuar në këtë çështje, që ngritën të parët çështjen rreth statusit ligjor të kontraktuesve privatë të sigurisë, sipas parashikimeve të Konventës së Gjenevës duke qenë se përcaktimi i luftuesve të ligjshëm dhe të paligjshëm është bërë në konventën e Gjenevës . Luftuesit e ligjshëm janë personeli jo ushtarak që vepron nën zinxhirin e tyre ushtarak të komandimit. Të tjerët mund të mbajnë armë në një zonë luftimi, por nuk mund të përdorin forcë sulmuese. Sipas marrëveshjeve ndërkombëtare, ata vetëm mund të mbrojnë veten e tyre.

Por ka debate ndërmjet atyre që e studiojnë këtë çështje.[59] Ekspertët ligjorë kanë rënë dakord që kontraktuesit privatë lejohen të përdorin forcën për vetëmbrojtje. Por kufiri ndërmjet forcës mbrojtëse dhe sulmuese nuk është i përcaktuar mirë. Është gjithmonë e vërtetë që njerëzit mund të mbrojnë veten. Çështja shtrohet: në çfarë pike një kontraktues që siguron mbrojtje e kapërcen këtë detyrë?

Interpretimet variojnë gjithashtu në qarqet akademike, ku çështja ka qenë objekt artikujsh dhe diskutimesh. Për një roje, i cili lejohet të përdorë forcë për vetëmbrojtje, vrasja e civilëve prej tij bën që ai të shkelë ligjin e luftës, tha Michael N. Schmitt, një profesor i të drejtës ndërkombëtare në Naval Ëar College dhe një ish jurist i Forcave Ajrore. "Eshtë krim lufte të vrasësh në mënyrë të paligjshme civilët në një konflikt të armatosur", thekson ai.

58. War and Occupation in Iraq - Pakistan Defence Forum, Chapter 1, http://www.google.com/search?q=War+and+Occupation+in+Iraq%2C+Chapter+1&
59. *Julian E Barnes, America's Own Unlawful Combatants?, Los Angeles Times, October 15, 2007,* gpf@globalpolicy.org

Scott Sillivan, një jurist në pension i Forcave Ajrore dhe profesor në Duke University tha se kontraktuesit mund të pretendojnë vetëmbrojtje vetëm nëse hapet zjarr ndaj tyre. "E vetmja forcë që ata mund të përdorin është forca mbrojtëse, tha Sillivan.

Kontraktuesit në Irak veprojnë nën imunitet nga ligji irakian, imunitet që u dha nga zyrtarët e SHBA në 2004 .

Imuniteti që fituan rojet private në 2004 nuk e lejon Irakun që të ndjekë penalisht këto roje, sipas ligjit irakian.

Anëtarët e koalicionit të Kombeve të Bashkuara kanë imunitet ndaj ndjekjes penale sipas ligjit penal dhe civil Irakian, sipas përcaktimit të rezolutës 1546 të Këshillit të Sigurimit, kështu që e vetmja mundësi për ndjekje penale janë gjykatat kombëtare të anëtarëve të Koalicionit.[60]

Gjenerali amerikan Caldëell, gjatë një brifingu të mbajtur në Bagdad e quajti çështjen e imunitetit një çështje ligjore dhe tha se do konsultohej me juristët ushtarakë përpara se të artikulonte një pozicion. Të lejosh autoritetet e Irakut të gjykojnë trupat e Shteteve të Bashkuara,të cilët ndryshe nga kontraktuesit janë subjekte të gjyqeve ushtarake kur akuzohen për krime lufte, do ishte e pamundur, në qoftë se jo e paprecedent, thanë ekspertët ligjorë. Imuniteti nga ndjekja penale është një përcaktim ligjor i zakonshëm kur forcat e SHBA dërgohen jashtë shtetit. Një ligj i kaluar nga Kongresi në vitin 2002 kufizon angazhimin amerikan në misionet paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara në qoftë se forcat amerikane nuk konsiderohen imune nga ndjekja penale.[61]

7.7.3 Abuzimet me të drejtat e njeriut në Irak

Ndërhyrja në Irak në mars 2003 nuk krijoi një krizë të madhe humanitare ose shtegtim masiv por duke filluar nga 2006, përplasjet sektariane u përkeqësuan.[62]

Dhjetëra mijëra civilë u vranë ose u plagosën në dhunën e përditshme dhe shumë të përhapur që vazhdonte të shkallëzohej gjatë 2006. Shumë prej vrasjeve ishin rezultat i sulmeve të qëllimshme nga grupet e armatosura Sunni dhe Shia, ndërsa konflikti po polarizohej gjithnjë e më shumë. Forcat irakiane të sigurisë kryen shkelje të shumëpërhapura të të drejtave njerëzore, duke përfshirë vrasjet e civilëve, torturën dhe të tjera keqtrajtime të të ndaluarve, si dhe dyshohej se ishin implikuar në vrasjet sektare. Ushtarët që i përkisnin forcës shumëkombëshe të udhëhequr nga SHBA, kryen gjithashtu shkelje të rënda dhe disa prej tyre u ndoqën penalisht me akuzat e vrasjes, përdhunimit ose trajtimit johuman të civilëve. Anëtarë të grupeve më të dobëta të Irakut, duke përfshirë të miturit dhe gratë, vazhduan të ishin shënjestër për abuzime. Dhuna bëri që disa mijëra njerëz të zhvendoseshin nga shtëpitë e tyre, ndërsa Bagdadi dhe disa qendra të tjera po ndikoheshin gjithnjë e më shumë nga një rritje e sektarizmit. Qindra mijëra irakianë u larguan nga vendi dhe kërkuan strehë jashtë.

60. War and Occupation in Iraq - Pakistan Defence Forum, Chapter 5, http://www.google.com/search?q=War+and+Occupation+in+Iraq%2C+Chapter+1&
61. Jonathan Finer and Joshua Partlow, Iraqi Leaders Question US Troop's Immunity, Washington Post, July6, 2006, http://www.globalpolicy.org/security/issues/iraq/attack/law/2006
62. War and Occupation in Iraq, Chapter 8, Displacement and Mortality, http://www.globalpolicy.org/security/issues/iraq/occupation/report/humanitarian.htm

Një qeveri e përkohshme irakiane u vendos në 22 maj, diku rreth 3 vjet pas ndërhyrjes në Irak nga koalicioni i udhëhequr nga SHBA. Shpresa që vendosja e një qeverie të zgjedhur nga populli do të sillte paqe dhe stabilitet u thye faktikisht që nga fillimi dhe viti 2006 u dallua nga dhuna sektare e pabazuar dhe në rritje.[63]

Sipas misionit të Asistencës së Kombeve të Bashkuara për Irakun, 34. 452 njerëz u vranë gjatë vitit 2006 dhe mijëra të tjerë u plagosën. Kushtet në Bagdad dhe në qendra të tjera u bënë gjithnjë e më të këqija, ku bombat filluan të shpërthejnë në dyqane ose vende të tjera grumbullimi dhe pranë radhëve të njerëzve që kërkonin rekrutim në polici ose punë të tjera të paguara.

Përveç kësaj, grupe të armatosura kryenin rrëmbime në masë në komunitetet që vinin në shënjestër për arsye sektariane. Nganjëherë viktimat e tyre liroheshin, por në shumë raste ata gjendeshin të vrarë, të gjymtuar dhe trupat e tyre të flakur në rrugë.

Ndërsa ekonomia vazhdoi të zhytej në mes të një shumëzimi armësh, rrëmbimi për arsye të lirimit me shpërblim nga bandat kriminale u bë i zakonshëm. Nga fundi i vitit 2006, më shumë se 400.000 njerëz i kishin lënë shtëpitë e tyre për të gjetur vendbanime të tjera brenda Irakut, kryesisht për shkak të dhunës sektariane. UNHCR, agjencia e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët, vlerësoi se numri i irakianëve që jetojnë si refugjatë në vendet fqinje, kryesisht në Siri dhe Jordani, ka arritur në 1.8 milion.[64]

Forcat irakiane të sigurisë nën kontrollin e ministrit të brendshëm kryen shkelje të përhapura të të drejtave njerëzore duke përfshirë angazhimin në vrasjet e civilëve, torturën e keqtrajtime të tjera të të burgosurve. Ata mbanin lidhje të ngushta me dy grupet e armatosura Shia dhe akuzoheshin për mbështetje të angazhimeve të kryera nga këto grupe.

Shumë profesionistë dhe mbrojtës të të drejtave njerëzore u vunë në shënjestër për abuzime në lidhje me punën e tyre. Shumë gjykatës ose juristë u vranë ose u kërcënuan, veçanërisht ata që implikoheshin në rastet që lidheshin me terrorizmin. Shumë juristë refuzuan të mbronin të akuzuarit për terrorizëm në mënyrë që të shmangnin të qenit në shënjestër. Më shumë se 60 gazetarë dhe punonjës të medies u raportuan të vrarë në Irak në 2006. Akademikë, mësues dhe mjekë u rrëmbyen për t'u liruar kundrejt shpërblimit. Kjo i nxiti shumë profesionistë të tjerë që të largoheshin nga Iraku.

Situata e grave vazhdoi të keqësohej. U rrit dhuna kundrejt grave, duke përfshirë rrëmbimet dhe "vrasjet për nder" nga të afërmit meshkuj. Gratë aktive politikisht, ato që nuk ndiqnin një kod strikt veshjeje gjithnjë e më shumë ekspozoheshin ndaj rrezikut të abuzimeve, si nga grupet e armatosura ashtu dhe nga ekstremistët religjiozë.

63. Amnesty International, Public Statement, AI Index: ASA 11/013/2007 (Public), new Service No:200, 3 October 2007
64. Po aty.

Rajoni i madh autonom kurd ishte shumë më i stabilizuar se pjesa tjetër e vendit në 2006, megjithëse u raportuan disa shkelje të të drejtave njerëzore. Dy partitë kryesore, partia Demokratike e Kurdistanit dhe Bashkimi Patriotik i Kurdistanit, ranë dakord të firmosnin një qeveri të bashkuar për rajonin, Qeverinë Rajonale Kurde, e cila u emërua në maj.

Në fillim të 2006, ndërsa operacionet ushtarake vazhdonin të detyronin njerëz të largoheshin nga shtëpitë e tyre, dhuna sektariane u bë shkaku kryesor për shpërnguljet, veçanërisht në Bagdad. UNHCR vlerësoi që dhuna sektariane ka shpërngulur rreth 730.000 njerëz pas sulmit në faltoren Al – Askari, ndërmjet shkurtit 2006 dhe marsit 2007. Forcat rezerviste sektariane dhe grupet e armatosura kanë sulmuar xhamitë, pazaret dhe fshatrat e rivalëve. Lagjet me popullsi të përzier janë polarizuar gjithnjë e më shumë.

Minoritetet janë veçanërisht të rrezikuar. Persekutimi fetar ka çuar në shpërngulje të kristianëve, turqve dhe sirianëve, ndërmjet të tjerëve. Refugjatët palestinezë në Irak u përballën me kushte të vështira janë subjekte të kërcënimeve dhe sulmeve të përsëritura.

Shumë palestinezë janë vënë në shënjestër për shkak të punës së tyre. Këtu përfshihen akademikët, mësuesit, profesorët, doktorët, gazetarët, politikanët, juristët dhe gjyqtarët. Shumë prej tyre janë arrestuar, rrëmbyer, vrarë ose detyruar të largohen në mënyrë që të mbrojnë jetët e tyre dhe familjet.

Efekti negativ i dhunës ndaj profesionistëve ka ndikuar në arsim, drejtësi dhe në sistemin e kujdesit shëndetësor në vend. Pjesa më e madhe e personave të zhvendosur brenda vendit, kanë kërkuar strehim tek të afërmit, ose nëpër xhami, në ndërtesa publike që janë bosh, ose në kampe me çadra.

Përveç 1.9 milion të zhvendosurve brenda vendit, mbi 2.2 milion irakianë kanë kërkuar strehim në vende të tjera. Së paku 1.2 milion irakianë kanë mërguar në Siri dhe rreth 750 mijë në Jordani. Për më tepër gjenden më shumë se 100 mijë Irakianë refugjatë në Egjipt, 54 mijë në Iran, 40 mijë në Liban, 10 mijë në Turqi dhe rreth 200 mijë janë larguar për në Evropë, në Amerikën e Veriut dhe në Zelandën e Re.[65]

Shpërbërja e sistemit shëndetësor mjekësor në Irak ka qenë një faktor rëndues. Shërbimi mjekësor irakian që dikur ishte ndër më të mirët në rajon, ka rënë aq shumë sa që nuk mund të plotësojë nevojat e popullsisë. Për shkak të mungesës së sigurisë, specialistët janë larguar jashtë vendit dhe spitalet kanë mbetur pa personel ose me personel që nuk ka përvojën dhe aftësitë e mjaftueshme në menaxhimin e rasteve të emergjencës.

Ndërsa pjesa mbizotëruese e irakianëve janë viktima të pafajshme të gjakderdhjes dhe dhunës, disa irakianë janë përgjegjës për ngjarjet e kohëve të fundit. Disa kanë marrë pjesë në akte të dhunshme duke vënë bomba në rrugët plot njerëz të qyteteve, duke sulmuar vendet e besimit, duke vrarë civilë të pafajshëm dhe duke krijuar banda për

grabitje, rrëmbim personash, rrëmbim me forcë dhe vrasje. Irakianë brenda dhe jashtë qeverisë janë implikuar në mosmarrëveshje sektariane, forca rezerviste, vrasje, vënie bombash dhe skuadra vdekjeje, si dhe në korrupsion masiv.

---

65. War and Occupation in Iraq, Chapter 8, Displacement and Mortality, http://www.globalpolicy.org/security/issues/iraq/occupation/report/humanitarian.htm

Qeveria e Irakut i ka përdorur njerëzit si mburojë në të shkuarën. Që në vitin 1991, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka dënuar përdorimin e deklaruar të njerëzve si mburojë nga Iraku, duke thënë në veçanti…se përdorimi i personave si "mburojë njerëzore" [66] është shkelja më e rëndë e detyrimeve që ka Iraku sipas të drejtës ndërkombëtare. Iraku është palë në Konventat e Gjenevës të vitit 1949, megjithëse nuk është palë e Protokollit të I.

Iraku ka marrë pengje në të shkuarën duke shkelur Konventat e Gjenevës. Gjatë pushtimit të Kuvajtit në gusht 1990, Iraku kapte perëndimorë dhe ofronte lirimin e tyre me kusht që Shtetet e Bashkuara të tërhiqnin forcat e tyre ushtarake nga rajoni. Për më tepër ai kërcënonte ti përdorte këto pengje si mburojë njerëzore. Në 6 dhjetor 1990,Iraku deklaroi lirimin e të gjithë njerëzve të marrë peng. Rezoluta 687 e 3 prillit 1991 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara e dënoi Irakun për marrjen e pengjeve. Marrja e pengjeve është e ndaluar në mënyrë strikte dhe përbën një krim lufte sipas të drejtës ndërkombëtare.[67]

Megjithëse Iraku ka përsëritur vazhdimisht se ai nuk ka armë të shkatërrimit në masë, ai ka përdorur armë kimike kundër civilëve kurdë në Halabja në 1988, duke vrarë mbi 5.000 njerëz. Këto përdorime të armëve kimike shkelin Protokollin e Gjenevës të 1925 që ndalon përdorimin e armëve kimike. Çdo përdorim i armëve kimike nga cilado palë do të shkelte jo vetëm Protokollin e Gjenevës të 1925 por gjithashtu Konventën e 1993 mbi Armët Kimike dhe të drejtën ndërkombëtare zakonore.[68]

Në mënyrë të ngjashme, çdo përdorim i armëve biologjike nga cilado palë në konflikt shkel të drejtën ndërkombëtare. Konventa mbi Armët Biologjike e vitit 1972 ndalon zhvillimin, prodhimin, përvetësimin dhe grumbullimin e armëve biologjike.[69]

Një kryeprokuror i krimeve naziste të luftës në Nuremberg Benjamin Ferenccz, i cili siguroi dënimet e 22 oficerëve nazistë për punën e tyre në drejtimin e skuadrave të vdekjes që vranë më se 1 milion njerëz, tha në 2006 se Sadami duhet të gjykohet për sulmin e tij ndaj Kuvajtit në vitin1990.

"Nurembergu deklaroi se lufta agresive është krimi ndërkombëtar suprem" tha nga shtëpia e tij në Nju York për One World, 87 vjeçari Ferenccz. Ai tha se Karta e Kombeve të Bashkuara, që u shkrua pas masakrës së Luftës II Botërore, përmban një parashikim që asnjë komb nuk mund të përdorë forcën pa lejen e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Ferenccz beson se zhvillimi më i rëndësishëm për t'i dhënë fund këtyre fatkeqësive do të ishte angazhimi efektiv i Gjykatës Penale Ndërkombëtare në Hagë. Gjykata është krijuar në vitin 2002 dhe është ratifikuar nga më se 100 vende. Ajo është përdorur për të gjykuar rastet që burojnë nga konflikti në Darfur, Sudan dhe luftërat civile në Uganda dhe në Republikën Demokratike të Kongos.

66. Protokolli i I-rë Shtesë i Konventave të Gjenevës, 12 gushtit 1949, që lidhet me Mbrojtjen e Viktimave të Konflikteve të Armatosura Ndërkombëtare, 8 qershor 1977, neni 51, para 7&8.
67. KGJ IV, nenet 34, 147; PGJ I, neni 75(2); KGJ I, II, III, IV, neni i përbashkët 3.
68. Human Rights Watch Briefing Paper, *International Humanitarian Law Issues In A Potential War In Iraq, February 20, 2003,* http://www.hrw.org/backgrounder/arms/iraq0202003.htm
69. Konventa mbi Ndalimin e Zhvillimit, Prodhimit dhe Magazinimit të Armëve Baktereologjike dhe Helmuese, si dhe mbi Shkatërrimin e Tyre, 10 prill 1972.

Ferenccz[70] ishte i kënaqur që Sadam Husein ndodhej në proces gjyqësor dhe se qeveria e Irakut filloi të gjykojë ish diktatorin për krime lidhur me fushatën e tij të spastrimit etnik kundër kurdëve. Sipas Human Rights Watch, regjimi i Sadamit ka vrarë me dashje dhe sistematikisht të paktën 50.000 dhe ka mundësi 100.000 kurdë në një periudhë 6 mujore në 1988.
Të gjithë e dinë për fshatrat e panumërta të bombarduara. Banorët që kanë arritur të mbijetojnë janë çuar në qendra ndalimi dhe janë ekzekutuar në zona të largëta, nganjëherë duke i zhveshur dhe duke i qëlluar nga prapa në mënyrë që të binin të zhveshur në hendekë. Në mbrojtjen e tij, Sadam Husein ka kundërshtuar gjerësinë e vrasjeve dhe ka pohuar se ato ishin të justifikuara sepse ai po zhvillonte një operacion kundër kryengritjes së separatistëve kurd aleatë me Iranin. Ferenccz tha se cilatdo të kenë qenë arsyet e Sadamit, asgjë nuk mund të justifikojë vrasjen masive të të pafajshmëve. ”Shkeljet që i atribuohen ish Presidentit Husein që kur ai erdhi në pushtet variojnë nga krimi suprem ndërkombëtar i agresionit deri tek një llojshmëri e gjerë krimesh kundër njerëzimit,” shkroi Ferenccz, pasi Sadami u hoq nga froni në vitin 2003. ”Një gjykim i drejtë do të arrijë shumë qëllime. Viktimat do të mund të gjejnë pak kënaqësi kur të mësojnë se viktimizuesi i tyre është thirrur për të dhënë llogari dhe se nuk mund të jetë më i imunizuar nga ndëshkimi për krimet e tij. Plagët mund të fillojnë të mbyllen. Faktet historike mund të konfirmohen pa dyshim. krime të ngjashme nga diktatorë të tjerë mund të shkurajohen ose të pengohen në të ardhmen. Procesi i dhënies së drejtësisë përmes ligjit, mbi të cilin bazohet siguria e njerëzimit, mund të forcohet.”

Gjyqi i parë përpara Gjykatës Supreme Penale të Irakut u mbyll në korrik 2006. Ish presidenti Sadam Hysein dhe shtatë ish zyrtarë u gjykuan për shkelje të drejtave njerëzore në lidhje me vrasjen e 148 njerëzve nga fshati i madh Shia i Al Dujail, pas një përpjekje për vrasje të Sadam Hyseinit në vitin 1982.

Sadam Hysein dhe ish kreu i shërbimit sekret Barzan al Tikriti, si dhe Awad al Bandar ish kreu i Gjykatës Revolucionare, u dënuan me vdekje në nëntor. Këto dënime me vdekje u miratuan nga Dhoma e Apelit me 26 dhjetor 2006 dhe 4 ditë më vonë Sadam Hysein u ekzekutua.

Forcat e koalicionit u tërhoqën nga Iraku në 31 gusht 2010.

70. Vicky Short, Spanish Judge Calls for Architects of Iraq Invasion to be Tried for War Crimes, World Socialist Web Site, March 27, 2007, http://www.wsws.org/articles/2007/mar2007/garz-m27.shtml

7.8 MËSIMET QË KOMUNITETI NDËRKOMBËTAR NXORI NGA SUKSESET DHE DËSHTIMET E NDËRHYRJEVE NDËRKOMBËTARE

Paqeruajtja e Kombeve të Bashkuara tradicionalisht është bazuar në doktrinën e paanësisë, por operacionet e ndërmarra që nga fillimi i viteve 1990 kanë demonstruar limitet e një strategjie të tillë. Mund të përmendim operacionin fatkeq të Kombeve të Bashkuara në Bosnjë, në të cilin u zbatua kjo strategji, pavarësisht nga agresioni i hapur dhe shkeljet e shumta të pushimeve të zjarrit nga Serbia dhe luftuesit e saj të autorizuar. Në të u demonstruan të metat e paanësisë së një operacioni që kishte filluar gjatë zhvillimit të konfliktit. Rezultati i mosmbajtjes së anës ndaj një pale të konfliktit nuk ishte dhënia fund e dhunës, "por vite të një loje ushtarake dhe gjakderdhje e ngadalshme". Dështimi i kësaj strategjie u përmend në mënyrë specifike në një raport mbi Operacionet e Paqes të Kombeve të Bashkuara, i cili tërhiqte vëmendjen se "paanësia nuk është e njëjtë me neutralitetin" dhe se misionet duhet të jenë të përgatitura për të vepruar kundër atyre palëve ndaj të cilave është e nevojshme të luftosh me qëllim që të përmbushet mandati.

Një vlerësim i tillë është i mirëpritur dhe i nevojshëm për të parandaluar dështimet e së kaluarës. Në rastet e ardhshme të përdorimit të operacioneve të "zbatimit te paqes", të cilat kanë për qëllim dhënien fund të një krize humanitare duhen bërë hapa të rëndësishme përpara. Në disa situata, ndërhyrësit ndërkombëtarë duhet të jenë të përgatitur të zgjedhin që të mbajnë anën e një pale të konfliktit dhe duhet të kenë si qëllim të ndihmojnë në mposhtjen ushtarake të luftuesve të tjerë.

Një rast tipik i zbatimit të kësaj ideje ishte ndërhyrja britanike në Sierra Leone, e cila ishte padyshim e anshme. Lufta civile shpërtheu në Sierra Leone në vitin 1991, kur Fronti i Bashkuar Revolucionar filloi Kryengritjen kundër Presidentit Joseph Monoh. Vitet 1990 shënuan përhapjen e dhunës, goditjeve të befasishme, dhe përdorimin e forcave mercenare për të mposhtur rebelët. Marrëveshja e Paqes në qershor 1999 kërkoi t'i jepej fund luftimeve dhe Këshilli i Sigurimit autorizoi Misionin e Kombeve të Bashkuara në Sierra Leone për të monitoruar procesin e marrëveshjes dhe carmatimit. Pavarësisht nga mandati që i jepte Kapitulli VII, operacioni i Kombeve të Bashkuara nuk kishte burimet as fuqinë e mjaftueshme për të ndërmarrë veprime kur Fronti i Bashkuar i Revolucionit e shkeli Marrëveshjen dhe rifilloi luftën në shkallë të gjerë. Rebelët u sollën si të tërbuar në kryeqytet, mbajtën peng paqeruajtësit e Kombeve të Bashkuara[71] dhe filluan një valë brutaliteti kundër popullsisë.

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara iu bëri apel shteteve anëtare që të reagojnë. Në maj 2000, Britania filloi operacionin. Një batalion me 800 trupa u vendos në vend, siguroi aeroportin dhe arriti "rezultate të shpejta kundër Frontit të Bashkuar

Revolucionar". Pas ndërhyrjes të Britanisë së Madhe, operacioni i Kombeve të Bashkuara u zgjerua në përmasa dhe u bë forca paqeruajtëse më e madhe në botë. Dy vitet pasuese dëshmuan pushimin e armiqësive, çarmatosjen e mbi 45 000 forcave ushtarake rezerviste dhe zgjedhje demokratike në vitin 2002.

71. Articles 8 and 9 of the Convention on the Safety of United Nations and Associated Personnel (A/RES/49/59); M. Bothe, "Peace Keepers – What kind of hostages?", 2 International Peacekeeping (1995), n° 2/3, p. 59.

Mbretëria e Bashkuar e kuptoi që Fronti i Bashkuar Revolucionar dhe udhëheqja e tij nuk kishin vullnetin për të punuar drejt zgjidhjes së konfliktit, meqë shkelnin vazhdimisht pushimet e zjarrit dhe kryenin krime lufte duke terrorizuar popullsinë. Mbretëria e Bashkuar u angazhua ushtarakisht kundër rebelëve. Britanikët u angazhuan për të mbështetur qeverinë, siç u evidentua nga stërvitja e tyre intensive e ushtrisë së re të Sierra Leones. Ky aksion vendimtar i britanikëve është vlerësuar gjerësisht si pika e kthesës e operacionit në Sierra Leone.

Në mënyrë të ngjashme, operacioni në Timorin Lindor kishte një objektiv të qartë të siguronte dhe t'i jepte fund dhunës në përfundim të zgjedhjeve. Meqë dhuna shkaktohej nga forcat ushtarake rezerviste pro-indoneziane, misioni kishte një armik të dallueshëm qartë: forcat ushtarake rezerviste. Ky operacion u bë krahu ushtarak i lëvizjes për pavarësi në një mision për të mbikqyrur ndarjen e Timorit Lindor nga Indonezia.

Konflikti në Timorin Lindor filloi në fillimin e viteve '70 ndërsa grupet kërkonin pavarësi nga sundimi kolonial portugez. Kur Portugalia filloi të ndërmerrte hapa për të rregulluar administrimin e territorit nga një qeveri e përkohëshme, filloi lufta civile ndërmjet atyre që kërkonin pavarësi dhe atyre që donin të integroheshin në Indonezi. Indonezia ndërhyri dhe forcërisht e integroi Timorin Lindor si provincën e 27-të të saj në vitin 1976.

Pak më shumë se dy dekada diplomacie ndërkombëtare dhe dhune të vazhdueshme ndërmjet ushtrisë indoneziane dhe lëvizjes për pavarësi, u arrit një marrëveshje, në vitin 1998, që lejonte një referendum popullor për të vendosur në se populli i ishullit kërkonte autonomi më të madhe brenda Indonezisë apo pavarësi të plotë. Marrëveshja lejonte vendosjen e një misioni të Kombeve të Bashkuara (të autorizuar nga Këshilli i Sigurimit në qershor 1999), për të organizuar dhe mbikqyrur votimin, megjithëse ushtria indoneziane ishte përgjegjëse për ruajtjen e sigurisë gjatë zhvillimit të zgjedhjeve. Pavarësisht nga pasiguria dhe raportet e dhunës, referendumi u zhvillua më 30 gusht dhe rezultati (80% vota për pavarësinë), u shpall më 4 shtator. Sapo u shpall rezultati, forcat rezerviste pro-Indoneziane filluan një valë dhune dhe shkatërrimi në të gjithë territorin, duke zhvendosur mijëra njerëz dhe duke vrarë shumë të tjerë. Forcat ushtarake indoneziane nuk vepruan për t'i dhënë fund dhunës, por siç dëshironin shumë persona ata bashkëpunuan në shkatërrimin e vendit.

Një raund intensiv presioni diplomatik që i kërkonte Presidentit indonezian të lejonte vendosjen e një force ndërhyrëse shumëkombëshe pasoi kërkesat e përsëritura që ushtria indoneziane duhet të ndalonte dhunën. Presidenti u bind më 12 shtator dhe Këshilli i Sigurimit autorizoi vendosjen e Forcës Shumëkombëshe për Timorin Lindor, që do udhëhiqej nga Australia më 15 shtator, përmes Rezolutës 1265. Misioni u autorizua sipas

Kapitullit VII, që e lejonte atë të merrte "të gjitha masat e nevojshme" për të plotësuar mandatin e tij. Ky mision filloi vendosjen vetëm pesë ditë më vonë dhe përfshiu 10.000 trupa. Misioni vendosi sigurinë dhe rregullin publik në rajon si dhe siguroi kthimin e refugjatëve. Megjithëse operacioni u përball me rezistencë të vogël të forcave ushtarake rezerviste, dhe pësoi pak fatkeqësi, ky mision po vepronte në një mjedis të hapur armiqësor dhe demonstroi aftësitë e tij të fuqishme përmes patrullimit të zonës.
Pasi u vendos siguria, misioni mori pushtetin e një Administrate të Përkohëshme të Kombeve të Bashkuara në Timorin Lindor në shkurt 2000. Ky operacion u vlerësua gjerësisht si "ndërhyrje e suksesshme" krahasuar me rastet e tjera në periudhën e pas Luftës së Ftohtë".

Operacioni në Timorin Lindor në të cilin u bënë përpjekje të konsiderueshme për të siguruar bashkëpunimin me forcat e armatosura indoneziane, në mënyrë që ai të mos kthehej në një konflikt më të gjerë ngriti një çështje të rëndësishme lidhur me strategjinë e mbështetjes së njërës palë. Ajo është vetëm një strategji e zgjuar kur forca ndërhyrëse është dukshëm më e fortë ushtarakisht se luftuesit që cilësohen si "armiq".

Kështu, ndërsa nganjëherë është e domosdoshme që një ndërhyrje të angazhohet në betejë kundër njërës palë të konfliktit, një kërkesë e domosdoshme e kësaj strategjie është të sigurojë se "armiku" i zgjedhur nuk është aq i fortë sa ta kthejë misionin në një luftë në shkallë të plotë. Ndërsa do të jetë ndonjëherë e nevojshme për një ndërhyrje që të njohë nevojën e pozicionimit në një konflikt dhe të ndihmojë në lehtësimin e një fitoreje vendimtare të njërës palë ka anë të tjera të dukshme të një strategjie të tillë. Një nga këto anë, bile më e rëndësishmja, është se ajo rrezikon përkohësisht rritjen e dhunës, fatkeqësive dhe shkatërrimit me qëllim që të arrihet një paqe afatgjatë.

Konkluzioni që del nga analiza e sukseseve dhe dështimeve të misioneve të mëparshme të zbatimit të paqes është se nganjëherë do të jetë e nevojshme të kërkosh aktivisht mposhtjen ushtarake të njërës palë të konfliktit. Pozicionimi në njërën anë mund të ndihmojë në lehtësimin e pakësimit të rezistencës nga luftëtarët armiq, por vetëm në qoftë se ndërhyrja është e gatshme dhe në gjendje të përdorë forcën për të arritur qëllimet e saj.

Mësimi i dytë që del nga analiza e ndërhyrjeve të suksesshme dhe jo të suksesshme të së kaluarës është që operacioneve të zbatimit të paqes duhet t'iu jepen mjetet dhe autorizimi për të zbatuar forcën në rast nevoje. Në rastin e zbatimeve të paqes[72] të ndërmarra në mes të konfliktit, nevoja e rregullave të angazhimit që lejojnë forcën vdekjeprurëse është absolutisht vendimtare për suksesin e operacionit.

Ndërsa mospërdorimi i forcës[73] ishte normë për operacionet e Kombeve të Bashkuara gjatë Luftës së Ftohtë (me përjashtim të operacionit në Kongo në vitin 1964), dështimet e ndërhyrjeve humanitare në fillim të viteve 1990 çuan në njohjen e faktit se mandatet e forta të kapitullit VII janë të nevojshme në misionet ku kërcënimi për rifillimin e dhunës ose vazhdimin e konfliktit është i qartë. Le të përmendim "Spastrimin etnik", që u bë kundër myslimanëve në Bosnjë & Hercegovinë, i cili sigurisht që cilësohet si genocid. Përgjigjja ndaj tij ka qënë përgjithësisht e heshtur. Disa mijëra paqeruajtës të Kombeve të Bashkuara u vendosën për të mbrojtur karvanet e ndihmave e megjithatë paqeruajtësit kishin një mandat shumë të kufizuar përsa i përket përdorimit të forcës. Kjo kishte

kuptimin që drejtuesit në tokë duhet të bazoheshin pothuajse krejtësisht në bisedime për t'u ndihmuar ku kishin nevojë, gjë që rezultonte në vonesa javore ose mujore.

72. C. Allen, The savage wars of peace, Futura (1990), Part 1.
73. Mungesa e qartësisë ndërmjet operacioneve është përmendur gjithashtu nga Sekretari i Përgjithshëm në suplementin e "Axhendës për Paqe". Ai theksoi në atë raport se "operacioneve paqeruajtëse ekzistuese u ishin dhënë mandate shtesë që kërkonin përdorimin e forcës dhe kështu që nuk mund të kombinoheshin me mandatet ekzistuese që kërkojnë pëlqimin e palëve, paanshmëri dhe mospërdorim të forcës". Shih UN Doc. A/50/60-S/1995/1, para.35.

Kombet e Bashkuara dhe NATO - ja herë pas here bënin deklarata në të cilat shprehej nevoja e përdorimit të forcës për të siguruar që ndihmat mund të shkonin aty ku ishin të nevojshme në disa raste për t'i dhënë fund sulmit serb të myslimanëve duke përfshirë edhe Sarajevën. Sidoqoftë megjithë bombardimet e shumta, që rezultuan në qindra mijëra të vdekur dhe dy milion refugjatë, komuniteti ndërkombëtar nuk ndërmori veprime të dhunshme për të zgjidhur situatën. Të vetmet përjashtime kanë qënë disa raste kur forcat e NATO-s bombarduan forcat sllave, të cilat po preknin edhe ato që quheshin "zona të sigurta".

Mandati i dobët i UNPROFOR - it në Bosnjë[74] dhe mungesa e kapacitetit dhe vullnetit për t'iu përgjigjur shkeljeve të shumta të marrëveshjeve rezultuan në pandëshkueshmëri për luftuesit serbë dhe i lanë pa bërë asgjë Kombet e Bashkuara. Marrja strategjike serbe e Srebrenicës dhe vrasja pasuese e 7.000 myslimanëve, demonstroi qartë kotësinë e mospërdorimit të forcës. Ndërsa është e pamundur të thuhet me siguri se çfarë efekti do të kishte patur përdorimi më i hershëm i forcës në konflikt mbi sjelljen serbe, mungesa e përdorimit të hershëm të forcës u siguroi serbëve kurajo për të vazhduar me sjelljen e tyre agresive.

Deri në pranverën dhe verën e vitit 1995 më shumë se tre vjet pasi genocidi ishte bërë i dukshëm në të gjithë botën, nuk pati rezultate të përmirësimit të situatës dhe veprimet ishin të kufizuara. Vetëm atëhere NATO-ja i zgjeroi sulmet ajrore në një shkallë të tillë saqë serbët ranë dakort të negocionin për t'i dhënë fund luftës. Përdorimi i fundit i forcës ndryshoi rrjedhën e konfliktit. Kjo tregon se kursi i gjithë konfliktit mund të kishte ndryshuar nëse forca do të ishte përdorur 3 vjet më parë.[75]

Një operacion që meriton vëmendje për vullnetin e tij për të përdorur forcën vendimtare ushtarake është operacioni i udhëhequr nga francezët në qershor 2003 për të shtypur dhunën në Bunil në Republikën Demokratike të Kongos. Ai është i shquar për angazhimin e fuqishëm të luftuesve. Megjithëse operacioni zgjodhi të mbetej teknikisht i paanshëm, kjo nuk u barazua me pasivitetin. Operacioni ishte autorizuar sipas Kapitullit VII me detyrën e stabilizimit të situatës së sigurisë në qytet dhe mbrojtjen e civilëve. Operacioni ishte i suksesshëm në kthimin e sigurisë dhe stabilitetit në qytet, megjithëse u kritikua për qëllimin e kufizuar në fokusin e tij gjeografik dhe për faktin që pjesa më e madhe e forcave ushtarake rezerviste thjesht u tërhoq në zonat jashtë juridiksionit të Bashkimit Europian.

Shumë studiues sygjerojnë që modeli i drejtimit nga një komb përbën opsionin më të mirë për operacionet e zbatimit të paqes. Kjo argumentohet me vështirësinë kronike që kanë përjetuar Kombet e Bashkuara për vendosjen e shpejtë të forcave në raste emergjencash humanitare gjë që buron nga natyra ad hoc e paqeruajtjes (duke përfshirë

mungesën e një force të qëndrueshme) dhe kundërshtimin e shteteve anëtare për të siguruar trupa dhe materiale në kohën e duhur.

74. Letter dated 9 June 1995 from the Secretary-General addresses to the President of the Security Council, Un Doc. S/1995/470 of 9 June 1995.
75. S. Jacobi, loc.cit. note 26; R Siekmann, "The five main mistakes regarding Bosnia in retrospect", 1 International Peacekeeping (1994), n° 4, p. 118; A. Roberts, "Communal conflict as a challenge to international organization: the case of former Yugoslavia", 21 Review of International Studies (1995), p. 389, See generally, B. Cohen & G. Stamkoski (ed.), op. cit. note 26.

Të metat e vonesës së vendosjes së trupave u panë më qartë në Ruanda, por kjo është një komponent i përhershëm i pjesës më të madhe të ndërhyrjeve të Kombeve të Bashkuara.

Në krizat humanitare, të cilat kërkojnë ndërhyrje të llojit të zbatimit të paqes, përgjigja në kohën e duhur është një përbërës kryesor për suksesin e operacionit. Në rastin e Timorit Lindor, trupat e para arritën atje pesë ditë pasi Këshilli i Sigurimit autorizoi misionin. Për britanikët në Sierra Leone, që ishin urdhëruar të vendoseshin në Freetoën në 5 maj trupat e para speciale arritën brenda 36 orëve, dhe morën kontrollin e aeroportit ndërkombëtar. Për operacionin në Bunil Këshilli i Sigurimit e urdhëroi misionin më 30 maj, njëqind trupa franceze arritën në Bunil në 6 qershor, përpara fillimit formal të misionit nga Bashkimi Europian. Në mes të qershorit, forca ishte angazhuar në luftim dhe arriti fuqinë e plotë nga java e parë e korrikut. Mbështetja logjistike dhe vlefshmëria imediate e trupave e bëjnë ndërhyrjen e udhëhequr nga një komb më të përshtatshme për krizën humanitare.

Kombet e Bashkuara mbështeten në forca të marra nga vende të ndryshme, gjë që krijon sfida të vështira për komunikimin, marrjen e pajisjeve, rregullimet e komandimit dhe kontrollit. Ndërsa këto sfida janë produkte të një strukture ad hoc, ato nuk janë të përshtatshme për ato lloj operacionesh ku kërkohet veprimi i shpejtë dhe i koordinuar.

Një tjetër mësim që nxirret nga një survejim i sukseseve dhe dështimeve të fundit në ndërhyrjet ushtarake humanitare është që përpjekjet për të ndërtuar një paqe afatgjatë dhe që ruhet vetë në vendet që dalin nga konflikti, kërkohen përpjekje afatgjata. Ndërsa tre mësimet e nxjerra më parë lidheshin në mënyre specifike me strategjitë për ndërmarrjen e zbatimit të forcës, nevoja për një angazhim afatgjatë me qëllim rindërtimin e shteteve të shkatërruara është vitale. Ndërsa ky kriter mund të lihet jashtë fokusit të ndërhyrjes ushtarake meqë përbën një komponent që pason zbatimin e suksesshëm të paqes, ai meriton të përmendet meqë është ndër faktorët më vendimtarë për të klasifikuar një operacion të suksesshëm apo të dështuar.[76]

Çdo operacion i cili i jep përkohësisht fund me sukses dhunës, por dështon në dhënien e ndihmës për një zgjidhje afatgjatë ka shumë mundësi të jetë i pavlerë, sepse janë të larta shanset për rishfaqjen e dhunës. Në qoftë se komuniteti ndërkombëtar e konsideron një situatë aq serioze sa që vendos të ndërhyjë ushtarakisht, ai duhet të angazhohet duke siguruar energji, vëmendje dhe burime të nevojshme për të ndihmuar rindërtimin e shoqërisë pasi dhuna është shtypur. Në mungesë të këtij angazhimi, konflikti ka shumë mundësi që të rishfaqet.

76. M. Sahnoun, Somalia – The Missed Opportunities, United States Institute of Peace Press (1994); African Rights, Somalia, Operation Restore Hope: A Preliminary Assessment, London (1992); Human Rights Watch/Africa, Somalia Faces the Future, vol.7, n° 2, New York (1995).

7.9 BASHKËPUNIMI CIVILO–USHTARAK NË NDËRHYRJET HUMANITARE

Në kundërshtim me çfarë pritej, fundi i Luftës së Ftohtë dhe politikat globale bipolare nuk shënuan fillimin e një ere paqeje dhe zhvillimi. Përkundrazi, në periudhën nga vitet 1980 deri më sot, bota ka përjetuar një rritje dramatike të konflikteve të brendshme, të cilat më shumë se çdo gjë tjetër mund të karakterizohen nga kostot e larta sociale dhe humane në formën e fatkeqësive, zhvendosjes, shpronësimit dhe shkatërrimit të mundësive të jetesës.

Një nga pasojat e këtij kthimi prapa në histori ka qënë rritja e angazhimit humanitar në situatat e konfliktit nga komuniteti ndërkombëtar, duke përfshirë agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara, organizatat jo-qeveritare ndërkombëtare, organizatat jo-qeveritare kombëtare, organizatat humanitare ndërkombëtare, variante të forcave të Kombeve të Bashkuara dhe aleancash ushtarake rajonale si NATO dhe departamentet e shtetit veprimet e të cilave janë zgjeruar.[77]
Organizatat ushtarake dhe ato humanitare kanë qëllime të përbashkëta në luftë. Në të vërtetë, humanitarizmi modern u krijua në fushën e betejës. Komiteti Ndërkombëtar I Kryqit të Kuq u krijua pas betejës së Solferinos, në shekullin e XIX, ndërsa Lufta e Parë Botërore, Lufta Civile dhe uria, të cilat e pasuan atë në Rusi ndikuan në ngritjen e "Save the Children Fund" dhe "American Relief Assocciation". Në mënyrë të ngjashme Lufta e Dytë Botërore prodhoi një numur agjencish humanitare, përfshirë Oxfam dhe CARE. Siç theksoi Slim, "në 100 vitet e fundit, anët ushtarake dhe humanitare kanë përfaqësuar dy anë të së njëjtës monedhë – paaftësinë e njerëzimit për të menaxhuar konfliktin në mënyrë paqësore". Prezenca e tyre e përbashkët në fushën e betejës, ka bërë që të ketë gjithmonë kontakt ndërmjet forcave ushtarake dhe organizatave humanitare, por kjo gjithmonë ka qënë qartësisht e përcaktuar dhe e kufizuar nga rolet e tyre të ndryshme.

Ushtria tradicionalisht ka qënë dizenjuar për luftë, në ndjekje të interesave politike, nacionale ose kolektive. Forcat janë paguar e stërvitur për të përdorur dhunën në përmbushje të objektivave të vendosura nga qeveritë. Kështu që aksioni ushtarak është gjithmonë politik në natyrën e tij, megjithëse mund të deklarohen qëllime humanitare "neutrale" për një mision të caktuar. Përkundrazi, një prej qëllimeve kryesore të organizatave humanitare civile është të lehtësojë vuajtjen në mënyrë të barabartë për të gjithë, mbi bazën e nevojës.

Organizatat humanitare vlerësohen përgjithësisht si organizata që zhvillojnë aktivitete bamirësie në favor të njerëzve në nevojë, kur fatkeqësia e tyre është rezultat i natyrës ose shkaktohet nga njerëzit dhe përfshin disa forma dhune.

77. Birgitte Refslund Sorensen, Violence and humanitarian assistance: Reflections on an intricate relationship, p. 1, sites.tufts.edu/jha/files/2011/04/a194.pdf

Komiteti Ndërkombetar i Kryqit të Kuq është një organizatë e cila ndoshta më shumë se asnjë organizatë tjetër është e ndërgjegjshme për identitetin dhe origjinën e saj e cila daton pothuajse 150 vjet më parë. Eshtë padyshim e vetmja organizatë humanitare që ka një origjinë të shkruar dhe të mirëpublikuar, të përkthyer në shumë gjuhë, që përdoret gjerësisht për të krijuar ndërgjegje globale, legjitimitet dhe mbështetje. Ky mit i saj luan gjithashtu rol të rëndësishëm në marrëdhëniet profesionale të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq me aktorët e tjerë humanitarë në skenën globale, dhe e ka ndihmuar Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq të marrë përsipër një pozicion hegjemonik, por jo të pakundërshtueshëm në botën e agjencive humanitare me një përgjegjësi të veçantë për të drejtuar vendosjen e standarteve humanitare.[78]

Ndryshimi thelbësor ndërmjet forcave ushtarake dhe organizatave humanitare rezulton në një tension të paevitueshëm ndërmjet ushtrisë dhe punës humanitare civile. Bashkëpunimi civilo – ushtarak[79] varet nga politizimi i misionit ushtarak, si dhe nga niveli i pëlqimit që gëzon nga palët e implikuara. Kur niveli i pëlqimit në mes popullsive lokale është i ulët, ose kur ushtria perceptohet si palë në konflikt, marrëdhënia civilo – ushtarake kufizohet dhe civilët distancohen nga ushtria.

Kosova ofron një shembull ekstrem të asaj se si politizimi mund të infiltrojë neutralitetin e aktiviteteve humanitare në mënyra të ndryshme. Një studim i gjithanshëm i veprimit të NATO – s dhe atij humanitar në krizën e Kosovës do të vinte në dukje që veprimi ushtarak i NATO – s dhe aktivitetet ushtarake në tokë në Republikën Federale të Jugosllavisë bënë që faktikisht i tërë komuniteti humanitar të largohej nga fusha e betejës, ndërsa filloi fushata ajrore. Për më tepër "përpjekjet e disa agjensive humanitare për t'u distancuar nga konflikti politik i angazhimit të NATO – s ishin shumë të pasuksesshme". Për shembull, disa agjensi, si Medecins Sans Frontieres zgjodhën që të mos pranonin të financoheshin nga shtetet e NATO – s, ndërsa të tjera u përpoqën të demonstronin se ato punonin me të dyja palët në konflikt, duke krijuar zyra me përgjegjësi të gjëra rajonale.

Pavarësisht nga përpjekjet e tyre, këto agjensi nuk u mirëpritën nga autoritetet serbe. Efektet e politizimit të ndërhyrjes humanitare në Kosovë ndjehen edhe sot me rezultatin që organizatat jo qeveritare me më shumë akses në Serbi, janë tashmë greke, ruse dhe polake.

Si organizatat ushtarake, ashtu dhe ato civile po përpiqen të njohin më mirë njëra – tjetrën, në mënyrë që të krijojnë hapësira bashkëpunimi.[80] Kjo ka qënë një metodë e njohur brenda konteksit të Kombeve të Bashkuara, por është relativisht e re për strukturat e NATO – s. P.sh. stafi ushtarak nga shtabi suprem i Fuqive Aleate të Europës dhe përfaqësues të organizatave të mëdha humanitare kanë rënë dakord, kohët e fundit, të vizitojnë shtabet e njëri – tjetrit dhe të familjarizohen me metodat e punës të njëri – tjetrit.

78. Y. Sandoz, "A Consideration of the Implementation of International Humanitarian Law and the Role of the ICRC in the former Yugoslavia", ICRC (1993); ICRC, Signatures, Ratifications, Accessions and Successions as at 31 December 1993.
79. Weiss, Thomas 1999, Military Civilian Interactions: Intervening in Humanitarian Crisis, Rowman and Littlefield, Publishers Inc., Lanham, Maryland.
80. Catriona Gourlay, Partners Apart: Managing Civil-Military Co-operation in Humanitarian Interventions, 2000, f.5, www.certi.org/themes/Civil_military_coll.htm

NATO është në një proces rishikimi të programeve të saj të trajnimit për paqeruajtjen, që zhvillohen nga shkolla e NATO–s në Oberamergau, (për pjesëmarrës civilë e ushtarakë), për të përmirësuar njohjen civile dhe ushtarake të politikave të njëri – tjetrit. Aleanca ka njohur gjithashtu dobësinë e implikimit të aktorëve civilë në procesin e planifikimit. Hapat politikë për të arritur këtë kufizohen nga sekreti ushtarak, por përfshijnë angazhimin e agjensive civile në zhvillimin e stërvitjeve ushtarake. Iniciativa të tilla mund të përmirësojnë shanset për bashkëpunim, por ato nuk mund të zhdukin ndryshimet ndërmjet tyre.

Kombet e Bashkuara kanë patur një eksperiencë të gjerë në punën me aktorët civilë dhe kanë përdorur shumëllojshmëri mekanizmash në përpjekje për të zgjidhur vështirësitë e koordinimit të aktiviteteve ushtarake, policore dhe civile në tokë. Megjithëse çdo operacion është ndryshe nga të tjerët, janë nxjerrë mësime, por megjithatë nuk janë zbatuar në krizën tjetër.

NATO gjithashtu ka nxjerrë një numur mësimesh përmes eksperiencës në Bosnjë dhe në Kosovë. Ndryshe nga Kombet e Bashkuara, ndërveprimi i saj civilo – ushtarak ka një emër të vetëm: Bashkëpunimi civilo – ushtarak,[81] (CIMIC). Kjo është përkufizuar si burim që mbështet marrëdhënien ndërmjet drejtuesve të NATO–s dhe autoriteteve kombëtare, rajonale, ose lokale, civile e ushtarake, si dhe popullsisë civile në një zonë ku forcat ushtarake të NATO – s janë të vendosura ose kanë planifkuar të vendosen. Marrëveshje të tilla përfshijnë bashkëpunimin dhe bashkëveprimin me agjensitë, organizatat dhe autoritetet jo qeveritare ose ndërkombëtare.

Gjatë 10 viteve të kaluar NATO ka reformuar dhe rregulluar konceptin e CIMIC – ut, në mënyrë që të përfshijë të gjithë elementët e ndërveprimit civilo – ushtarak. Ndërsa zhvillimi i CIMIC – ut brenda NATO – s reflekton një vlerësim në rritje të rëndësisë së bashkëpunimit civilo – ushtarak, kjo nuk reflektohet shpesh në strukturat ushtarake më të gjëra.

81. Conflict, Peace And Development Co-Operation, Report No. I, Civilian And Military Means Of Providing And Supporting Humanitarian Assistance During Conflict, Paris 1998, www.pdtglobal.org/.../Economic%20Impact%20of%20Peacekeeping

7.10 PËRFUNDIME

1. Natyra e krizës humanitare në Irakun Verior në vitin 1991, paraqiti shumë mundësi unike për një ndërhyrje ushtarake të suksesshme ajrore.

- Iraku shihej si një agresor që shkaktoi krizën. Polarizimi i padyshimtë ndërmjet refugjatëve kurdë dhe ushtrisë irakene i dha planifikuesve ushtarakë mundësinë për të identifikuar qartë armikun dhe për të fokusuar përpjekjet e tyre. Për më tepër, ndarja gjeografike e palëve të konfliktit përpara ndërhyrjes e lehtësoi së tepërmi krijimin e një zone të sigurt dhe e lejoi koalicionin të përqendrohej në një vijë fronti dhe jo të merrej me një numër të madh forcash të shpërndara brenda zonës së tij të përgjegjësisë.

- Fushata "Desert Storm" që i parapriu operacionit kishte demonstruar aftësitë e koalicionit në dëmtimin e sistemeve të vlerës strategjike të Irakut. Kështu, Iraku duhej t'i merrte seriozisht kërcënimet për goditje ajrore në qoftë se nuk bashkëpunonte me kërkesat e koalicionit. Si një shtet relativisht modern dhe i centralizuar, Iraku paraqiste mjaft shenja strategjike potenciale për goditje të tilla.

- Situata politike që ndoqi mbarimin e suksesshëm të Luftës së Gjirit dhe shkalla e një fatkeqësie potenciale humanitare lejuan vendosjen dhe kohezionin e nevojshëm. Vullneti për të parë misionin të përfunduar me sukses ishte më i madh se debatet e brendshme që zakonisht e dëmtojnë efektivitetin e një lufte të tillë.

2. Veprimi ushtarak që u ndërmor kundër Irakut nga vende të ndryshme perëndimore në prill 1991 solli në vëmendjen e publikut "të drejtën e ndërhyrjes". Respekti për të drejtat e njeriut tashmë do të ishte i detyrueshëm për t'u zbatuar nëpërmjet veprimit të komunitetit ndërkombëtar, nga institucione të përshtatshme, ose nga disa shtete që u përgatitën për të mbrojtur këtë parim.

3. Kombet e Bashkuara pretenduan të realizonin çarmatimin e plotë të somalezëve, por kjo nuk u realizua plotësisht, megjithëse trupat e koalicionit të dominuar nga amerikanët, ishin të armatosur me pajisjet më moderne luftarake. Ata nuk mundën të kryenin çarmatimin, sepse bëhej fjalë për një shtet që kishte qenë në luftë për një kohë të gjatë. Zbatimi i paqes dhe krijimi i demokracisë kërkojnë dekada dhe nuk mund të përmbushen në një periudhë shumë të shkurtër kohore.

4. Në një shtet, kur fraksionet refuzojnë të çarmatosen në mënyrë vullnetare dhe paqebërësit duhet të qëndrojnë neutral me ndërhyrje të kufizuar, paqja nuk mund të vendoset kurrë. Ndërhyrja e kufizuar mund të ketë sukses, në qoftë se paqebërësit mbështesin njërin ndërluftues në mposhtjen e tjetrit.

5. Ndërhyrja e paanshme mund të ketë sukses në qoftë se paqebërësit marrin kontrollin total të situatës dhe forcërisht imponojnë një zgjidhje. Në Somali, ku ekzistonin struktura klanore komplekse dhe të ngatërruara dhe ku të gjitha palët

kryenin barbarizma. Të ndihmoje një palë që të mposhte tjetrën nuk përbënte një opsion të vlefshëm.

6. Përpjekja humanitare në Somali, pati sukses në shpëtimin e jetëve, por operacioni politiko–ushtarak dështoi në arritjen e misionit të tij, për shkak të mungesës së një objektivi të arritshëm ushtarak dhe politik dhe të mungesës së një politike të jashtme të përcaktuar qartë ndaj Somalisë. Operacioni i Rindërtimit të Shpresës ishte në fakt një sukses si përpjekje humanitare, por ai ishte dështim përsa i përket paqebërjes.

7. Çelësi i rindërtimit të paqes dhe stabilitetit në Afganistan nuk është hyrja në bisedime me ekstremistët e dhunshëm, por përballja me ankesat legjitime të popullsisë, të cilët në pjesën më të madhe kanë mbështetur demokratizimin. Qeveria duhet të tregojë vullnet politik për t'iu përgjigjur pakënaqësive së brendshme, me përpjekje serioze në luftën kundër korrupsionit. Afganistani ka nevojë për përpjekje afatgjata për të patur një qeveri efektive, e cila të mundësojë sigurinë reale të popullit të saj.

8. Për t'i shërbyer më mirë interesave të veta dhe atyre të popullit afgan, qeveria e Afganistanit duhet të krijojë axhenda më të qarta veprimi, të heqë zyrtarët e korruptuar, të jetë në gjendje të përmbushë angazhimet dhe t'i japë fund pandëshkueshmërisë. Fokusi duhet të ngelet te qëllimi afatgjatë i krijimit të një shteti demokratik, paqësor, pluralist dhe të begatë.

9. Kombet e Bashkuara autorizuan NATO-n të kryente aktivitete dhune në Bosnjë & Hercegovinë brenda kontekstit të një mandati nga Kombet e Bashkuara. Angazhimi i NATO-s gjatë Operacionit Deliberate Force në vitin 1995 kundër pozicioneve të ushtrisë së Republikës Serbe e institucionalizoi konfliktin, por vetëm në fazat e tij të fundit.

10. Sulmet ajrore rritën presionin ndërkombëtar mbi Jugosllavinë e Millosheviçit për të marrë pjesë në bisedimet që rezultuan në marrëveshjen e Paqes së Dejtonit. Sulmet ajrore të NATO-s i detyruan serbët të binin dakord që të negocionin për t'i dhënë fund luftës.

11. Ndërhyrja e NATO-s në Bosnjë i dha fund politikës së spastrimit etnik që nacionalistët serbë dhe ushtria serbe e Bosnjës po zhvillonin përmes Bosnjës. Fushata e Aleatëve u bëri të qartë serbëve të Bosnjës se komuniteti ndërkombëtar nuk bën tolerime për shkeljen e rezolutave të Kombeve të Bashkuara.

12. Operacioni ushtarak paqeruajtës në Bosnjë u krye me sukses. Ai krijoi një paqe afatgjatë dhe të qëndrueshme, si dhe një mjedis të sigurt.

13. Ndërhyrja në Irak në vitin 2003, si dhe angazhimi në të i superfuqisë botërore u shoqëruan me debate të shumta, kryesisht lidhur me ligjshmërinë e një sulmi parandalues kundër Irakut nën pretekstin e kundërshtimit që Sadam Hysein i

kishte bërë çdo rezolute të Kombeve të Bashkuara, qysh nga përfundimi i Luftës së Gjirit, si dhe bazuar në arsyetimin se regjimi i tij përbënte kërcënim për SHBA dhe mund t'i përballte ato me pasoja katastrofike.

14. Koalicioni ka përdorur në Irak një numër të madh kontraktuesish privat ushtarakë, të cilët kanë marrë përsipër detyra të mbështetjes dhe logjistikës, që tradicionalisht janë kryer nga Forcat e Armatosura, siç është mbrojtja e diplomatëve brenda një zone luftimi. Rritja e përdorimit të forcës së përdorur në Irak nga firmat e sigurisë, ka ngritur pikëpyetje lidhur me statusin ligjor të kontraktuesve privatë të sigurisë, mbi të drejtën e tyre për të marrë pjesë në luftime dhe për të përdorur armët, duke qenë se ata nuk përfshihen në kategorinë e luftuesve sipas Konventave të Gjenevës.

15. Nga studimi i ngjarjeve që kanë ndodhur në Irak gjatë periudhës së luftës rezulton se pjesa mbizotëruese e irakianëve janë viktima të pafajshme të gjakderdhjes dhe dhunës, por disa irakianë janë përgjegjës për ngjarjet, sepse kanë marrë pjesë në akte të dhunshme duke vënë bomba në rrugët plot njerëz të qyteteve, duke sulmuar vendet e besimit, duke vrarë civilë të pafajshëm dhe duke krijuar banda për grabitje, rrëmbim personash, rrëmbim me forcë dhe vrasje. Irakianë brenda dhe jashtë qeverisë janë implikuar në mosmarrëveshje sektariane, forca rezerviste, vrasje, vënie bombash dhe skuadra vdekjeje, si dhe në korrupsion masiv.

8. DEBATET NË DOKTRINËN E TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE HUMANITARE PËR NDËRHYRJEN HUMANITARE NË KOSOVË

8.1 HISTORIKU I KONFLIKTIT TË KOSOVËS

Konflikti i Kosovës i ka rrënjët në fillim të shekullit XX. Ai është bazuar mbi pretendimet e shqiptarëve dhe serbëve për të drejta historike mbi Kosovën. Konflikti u shkallëzua në një nivel të ri pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe anullimit të autonomisë së Kosovës në vitin 1989.

Deri nga fundi i viteve 1980 Kosova kishte statusin e krahinës autonome brenda Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe ushtronte funksione të rëndësishme vetëqeverisëse.

Statusi i rajonit të Kosovës u ndryshua nga drejtuesi serb Sllobodan Milosheviç, i cili anulloi autonominë e Kosovës dhe e vuri atë nën kontrollin serb. Kosova u bë një koloni serbe ku shqiptarët etnikë, që përbënin 90% të popullsisë së Kosovës, qeveriseshin nga pakica serbe. Shqiptarët u privuan nga të drejta të rëndësishme civile dhe politike.[1]

Të prekur nga politika e Milosheviçit, shqiptarët u përpoqën që t'i jepnin një zgjidhje marrëdhënieve të Kosovës me Serbinë. Në mes të viteve '90 në Kosovë filloi një lëvizje popullore kundër shtypjes serbe, e organizuar në grupe guerile. Aktet fillimisht ishin të izoluara dhe askush nuk e kishte të qartë se kush i organizonte.

Në fillim të vitit 1996 u përdor për herë të parë emri "Ushtria Çlirimtare e Kosovës". Ekzistenca e UÇK-së ishte fillimisht e dyshimtë, por shumë shpejt u bë e qartë se ajo ekzistonte vërtetë. Autoritetet jugosllave e cilësuan UÇK-në si një organizatë terroriste dhe pretenduan se ajo përbëhej vetëm nga disa qindra radikalë. Në të vërtetë për numrin e saktë të pjesëtarëve të saj nuk mund të flitet me saktësi, pasi pretendimet nga palë të ndryshme ishin të ndryshme.[2]
UÇK-ja filloi të rritej në numër gjatë 1997 dhe në fillim të vitit 1998 sulmet e saj u intensifikuan dhe kredibiliteti i saj në popull po rritej. Në shkurt 1998, policia serbe filloi masakrat ndaj shqiptarëve të Kosovës në përgjigje të akteve të UÇK-së. Nga shkurti 1998 e më tej, konflikti ndërmjet UÇK-së dhe forcave jugosllave në Kosovë u kthye në një luftë të egër.

Konflikti i hapur ndërmjet UÇK-së dhe forcave ushtarake e policore serbe në Kosovë, çoi në vdekje të mbi 15.000 shqiptarëve të Kosovës dhe detyroi 400.000 njerëz të largoheshin nga shtëpitë e tyre, për të shpëtuar duke u fshehur në male e pyje.[3]

1. Milena Sterio, The Kosovar Declaration of Independence: "Botching the Balkans" or Respecting International Law?, Georgia, 21 Sep.2008, papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=1270637
2. Kosovo Liberation Army, http://en.wikipedia.org/wiki/Kosovo _liberation_Army, March 2008
3. NATO's role in relation to the conflict in Kosovo, http://www.nato.int/kosovo/history.htm

8.1.1. Ndërmjetësimi ndërkombëtar për zgjidhjen e krizës në Kosovë

Komuniteti ndërkombëtar reagoi ndaj konfliktit që përshkallëzohej, sepse pasojat humanitare të tij ishin shumë të rënda dhe ekzistonte rreziku i përhapjes së konfliktit në vende të tjera.[4] U kërkua që serbët t'i jepnin fund sulmeve kundër UÇK-së, Milosheviçi të tërhiqte trupat ushtarake nga Kosova dhe të lejonte vendosjen e një prezence të NATO-s në Kosovë.
Përpjekjet diplomatike vazhduan me vizitën në Beograd të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Havier Solana, të të dërguarve amerikan Holbrooke dhe Gjeneralit Michael Short, të cilët arritën deri në kërcënim për të shkatërruar Beogradin në se Milosheviçi nuk bindej. Në Beograd shkoi Kryetari i Komunitetit Ushtarak të NATO-s Gjenerali Naumann, si dhe drejtuesi suprem i Aleancës për Evropën Gjenerali Klark.[5]

Përpjekjet diplomatike u pasuan nga kërcënimi i NATO – s për goditje ajrore më 13 tetor 1998. Këto goditje nuk u zbatuan sepse më në fund Milosheviçi pranoi të bashkëpunonte. Pas bisedimesh të gjata e të vështira ndërmjet të dërguarit të SHBA për Ballkanin Richard Holbrooke dhe Miloshevicit u arritën marrëveshjet e 15 – 18 tetorit 1998, të cilat sollën një tërheqje të pjesshme të forcave serbe të sigurisë nga Kosova dhe siguruan vendosjen e monitoruesve të OSBE – së në Kosovë, për të vëzhguar zbatimin e marrëveshjes në tokë, si dhe u krijua misioni i survejimit ajror të NATO – s.

Pavarësisht nga këto arritje sulmet e UÇK – së dhe reprezaljet serbe vazhduan gjatë dimrit të vitit 1998 – 1999.[6] Situata u përkeqësua në fillim të vitit 1999, kur serbët vunë në veprim një numër të madh forcash ushtarake dhe policore.

Më 15 janar të vitit 1999 u vranë 45 shqiptarë etnikë në fshatin Raçak, 18 milje në jug – perëndim të Prishtinës. Masakra e Raçakut u konsiderua si simboli i shkeljes së marrëveshjes së tetorit.

Grupi i Kontaktit, i përbërë nga gjashtë kombe dhe i krijuar nga Konferenca e Londrës e vitit 1992 mbi ish - Jugosllavinë, në takimin e 29 janarit 1999 u përpoq përsëri që t'i jepte një shtytje politike gjetjes së një zgjidhjeje paqësore.

Këto përpjekje u mbështetën nga NATO, e cila paralajmëroi mundësinë e përdorimit të goditjeve ajrore, për të bindur Miloshevicin që të negocionte nën ndërmjetësimin e Grupit të Kontaktit.

Në 29 janar, në Londër ish Sekretarja Amerikane e Shtetit Madlin Albright, e cila ka drejtuar procesin diplomatik që çoi në ndërhyrjen ushtarake kundër trupave ushtarake të Miloshevicit në vitin 1999,[7] deklaroi publikisht mbajtjen e Konferencës në Rambuje të Francës, më 6 shkurt 1999.

---

4. M.Weller, "The International Response to the Dissolution of the Socialist Federal Republic of Yugoslavia", 86 AJIL (1992), p.569.
5. NATO's role in relation to the conflict in Kosovo, http://www.nato.int/kosovo/history.htm
6. Kosovo War, http://en.wikipedia.org/wiki/Kosovo_War April 2008
7. Medllin Ollbrajt dhe Lidershipi nga Kosova, Politika Shqiptare, http://www.zeriyt.com/historia-shqiptare/medlin-ollbrajt

Si serbët dhe shqiptarët pranuan të merrnin pjesë në këtë Konferencë paqeje. Delegacioni shqiptar insistoi për një referendum mbi pavarësinë, ndërsa delegacioni serb i rezistoi tezës së një prezence të NATO - s në provincë dhe pavarësisë së Kosovës.[8]

Në 18 mars 1999, delegacioni shqiptar, amerikan dhe britanik nënshkruan marrëveshjen e Rambujesë[9], ndërsa delegacioni serb dhe rus refuzuan.

Pas kësaj ngjarjeje eksodi kosovar drejt Shqipërisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi rifilloi për shkak të futjes së trupave të tjera ushtarake serbe në Kosovë. Pjesëtarët e organizatave humanitare dhe përfaqësuesit e misionit verifikues të OSBE – së filluan të tërhiqen nga rajoni për shkak të veprimeve ekstreme serbe ndaj tyre

Në këtë situatë SHBA, që ka meritat më të mëdha historike për përfundimin e luftërave të Serbisë së Miloshevicit në Kroaci, Bosnjë dhe Kosovë, të drejtuar nga ish Presidenti Bill Klinton, bëri edhe një përpjekje tjetër për të bindur Presidentin Miloshevic që të tërhiqej.[10]

Ambasadori i SHBA Holbrooke shkoi në Beograd, por përpjekja e tij dështoi. Presidenti Klinton deklaroi publikisht: "Me diktatorët e Ballkanit, nëse heziton u jep atyre licencën për të vrarë".

Në mbrëmjen e 23 marsit 1999, Sekretari i Përgjithshëm i NATO – s Havier Solana urdhëroi Gjeneralin Klark të nisë operacionet ushtarake. Më 24 mars filloi bombardimi i NATO – s.

Periudha e bombardimit zgjati 77 ditë. Në mbrëmjen e 9 qershorit u arrit përfundimi i një marrëveshjeje tekniko - ushtarake ndërmjet NATO – s dhe Republikës Federative të Jugosllavisë. Sipas kësaj marrëveshjeje RFJ pranonte zgjidhjen politike të krizës në Kosovë dhe dhënien fund në mënyrë të menjëherëshme të dhunës. Forcat e saj ushtarake, policore dhe paramilitare do të tërhiqeshin menjëherë nga Kosova dhe rajoni do të vihej nën kujdestarinë e Kombeve të Bashkuara.

8.1.2 Këshilli i Sigurimit për konfliktin në ish-Jugosllavi

Çështja e Kosovës u bë objekt diskutimi edhe në KS të Kombeve të Bashkuara. Ai adoptoi disa rezoluta, para bombardimeve të NATO – s, në të cilat shprehej shqetësimi i thellë për dhunimet e të drejtave njerëzore.[11]

Këshilli i Sigurimit kërkoi nëpërmjet rezolutave të tij të ndalohej përdorimi i dhunës dhe i shkeljeve të të drejtave njerëzore. Reagimi i KS ndaj shkeljes së të drejtave njerëzore në Kosovë tregoi që KS është një organ që njeh dhe mbron të drejtat ndërkombëtare njerëzore dhe e konsideron respektimin e këtyre të drejtave si kusht të domosdoshëm për ruajtjen e paqes dhe sigurisë botërore.[12]

8. Kosovo And The Challenge Of Humanitarian Intervention: Selective Indignation, Collective Action, And International Citizenship, http://books.rediff.com/bookshop/bkproductdisplay.jsp
9. Rambouillet Agreement, Interim Agreement for Peace and Self-Government in Kosovo, of 18 March 1999, ht tp://www.state.gov/www/regions/eur/ksvo_rambouillet_text.html
10. "Platforma amerikane ne paralelizmat negative te diplomacies, http://www.vendlindja.com/forum/showthread.php
11. Security Council resolution 771 (1992) of 13 August 1992.
12. Penelope C. Simons, Humanitarian Intervention: A Review of Literature, http://www.ploughshares.ca/libraries/WorkingPapers/wp012.html

Rezolutat e KS nuk autorizuan përdorimin e forcës për zgjidhjen e konfliktit, pavarësisht kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm që kërkonte përgjigje më të forta për të gjitha shkeljet e ligjit dhe të politikës së spastrimit etnik në veçanti.[13] Shkaku kryesor i këtij mosveprimi të KS ishte qëndrimi i vendosur i dy anëtarëve të përhershëm të KS, Rusisë dhe Kinës, për të vënë veton ndaj çdo propozimi për veprime ushtarake kundër Jugosllavisë.

Në 26 mars 1999, dy ditë pasi kishin filluar bombardimet e NATO–s, Rusia e mbështetur nga India dhe Bjellorusia paraqiti në KS një projekt rezolutë, në të cilën kërkohej ndërprerja e menjëhershme e përdorimit të forcës kundër RFJ. Kjo projekt rezolutë u pranua nga 3 shtete, (Rusia, Kina dhe Namibia), kurse 12 shtete të tjera votuan kundër. Rrëzimi i kësaj projekt rezolute ishte e vetmja mbështetje ligjore që KS i dha veprimit të NATO - s.[14] Për shkak të mungesës së vullnetit politik, reagimi i KS në krizën e Kosovës ishte shumë i dobët, po të kihen parasysh krimet e rënda të kryera në kurriz të shqiptarëve etnikë në Kosovë, nga shkurti 1998 deri në mars 1999.

8.2 VLERËSIMI JURIDIK-NDËRKOMBËTAR PËR NDËRHYRJEN E NATO-S NË KOSOVË

Ndërhyrja e NATO – s në Kosovë vuri në pikëpyetje konceptin e sovranitetit shtetëror dhe rriti vlerësimin ndërkombëtar për të drejtat njerëzore. Fakti që të gjithë shtetet anëtare të NATO – s ishin pro ndërhyrjes, konfirmon se ky veprim ushtarak përfaqësonte një interes ndërkombëtar. Ndërhyrja e NATO – s në ngjarjet e Kosovës tregoi se komuniteti ndërkombëtar mund të imponojë opsionet e tij.

Megjithatë mund të thuhet se veprimet e NATO – s kundër Jugosllavisë shkaktuan reagime të ndryshme. Legjitimiteti i fushatës bombarduese të NATO – s u bë objekt i shumë debateve.

8.2.1 Ndërhyrje e paligjshme, agresion i armatosur, cënim i tërësisë territoriale dhe sovranitetit shtetëror

Argumentet që u përdorën për të kritikuar ndërhyrjen ishin të shumta. Sipas kundërshtarëve të ndërhyrjes humanitare në Kosovë, neni 2/4 i Kartës së OKB – së, ndalon ndërhyrjet ushtarake në vendet e tjera sovrane. Edhe në qoftë se ndonjëherë ka ekzistuar një e drejtë e ndërhyrjes së paautorizuar, ajo është hequr nga Karta e OKB-së.[15] Në hartën politike Kosova ishte pjesë e Serbisë dhe bazuar në parimet e sovranitetit dhe mosndërhyrjes asnjë fuqi e jashtme nuk kishte të drejtë të ndërhynte në atë që Beogradi e quante "Çështje të brendshme".

---

13. Noelle Quenivet, Humanitarian assistance: a right or a policy?, 3 June 2000, http://www.jha.ac/articles/a030.htm
14. Larry Minear, Ted van Baarda, and Marc Sommers, NATO and Humanitarian Action in the Kosovo Crisis, Watson Institute, 2000, www.ipb.org/.../militarisation%20of%20aid/.
15. Penelope C. Simons, Humanitarian Intervention: A Review of Literature, http://www.ploughshares.ca/libraries/Working Papers/wp012.html

Ndërhyrjet në shtetet sovrane lejohen vetëm kur vendos KS i OKB – së. Autorizimi i KS për përdorimin e forcës për qëllime humanitare është diçka e pranuar nga komuniteti ndërkombëtar. Ky ishte argumenti që u përdor veçanërisht nga Kina dhe Rusia, të cilat u përpoqën të argumentonin se përdorimi i forcës ndaj Jugosllavisë do përbënte një shkelje të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Një tjetër argument që u përdor nga ata që nuk janë në favor të ndërhyrjes humanitare të paautorizuar nga KS ishte se NATO nuk kishte të drejtë të ndërhynte pa siguruar më parë autorizimin e KS. NATO është një organizatë e krijuar për mbrojtjen e anëtarëve të saj, kur ata bëhen objekt i ndonjë sulmi. Në rastin e konfliktit të Kosovës nuk kërcënohej drejtpërdrejt ndonjë shtet anëtar i NATO–s.[16] Dihet që Karta e OKB – së nuk përjashton mundësinë e veprimit të organizatave rajonale në ruajtjen e paqes dhe sigurimit ndërkombëtar. Sipas nenit 53 të Kartës, organizatat rajonale mund të ndërmarrin aksione të zbatimit të paqes, por duke marrë më parë autorizimin e KS.[17] Pa këtë autorizim asnjë aksion force nuk mund të ndërmerret nga organizatat rajonale.

Veprimet e NATO–s nuk u legalizuan nga KS sepse përdorimet e lejueshme të forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare, sipas Kartës së OKB – së nuk i justifikonin ligjërisht aksionet e NATO–s.

Kritikët e ndërhyrjes së NATO–s në Kosovë pretendojnë se bombardimi i NATO–s përshpejtoi dhe ashpërsoi "spastrimin etnik", që ishte planifikuar nga Milosheviçi, por që nuk kishte filluar të zbatohej. Sipas tyre lufta dhe urrejtja që ajo shkaktoi, siguruan kushtet për kryerjen e mizorive masive. NATO dështoi në mbrojtjen e shqiptarëve etnikë të Kosovës, pavarësisht se fitoi luftën kundër serbëve.[18] Këta kritikë hedhin poshtë pretendimet e qeverive të shteteve anëtare të NATO–s se vrasjet dhe shpërnguljet e popullsisë kishin filluar para bombardimit dhe se ndërhyrja e NATO–s i dha fund politikës së spastrimit etnik dhe ndihmoi në kthimin e sigurt të refugjatëve në shtëpitë e tyre.

Kritika u bënë edhe në drejtim të mënyrës së zhvillimit të fushatës bombarduese të NATO–s. Pretendohet se zgjedhja e shënjestrave nuk ishte e saktë, meqë u bombarduan objekte civile. Në se në fushatën e NATO–s do të ishin përdorur metoda lufte të cilat do kishin arritur të mbronin popullsinë dhe do kursenin infrastrukturën civile, ndërhyrja nuk do të shihej krejt si e paligjshme.[19]

---

16. Kosovo War, http://en.wikipedia.org/wiki/Kosovo_War , April 2008
17. Schmitt, Michael N."The use of force in International Law". The JAG Warrior, June 1999, pp.3-4.or College of International And Security Studies Elective Seminar - 6265 (S) International Law and Military Operations; Principles, Application and Enforcment
18. Larry Minear, Ted van Baarda, and Marc Sommers, NATO and Humanitarian Action in the Kosovo Crisis, Watson Institute, 2000, www.ipb.org/.../militarisation%20of%20aid/.
19. Hannes Peltonen, Right And Responsibility, What Kind Of Right Is The Right Of Humanitarian Intervention? EUI Working Papers, SPS No. 2006/03, cadmus.eui.eu/bitstream/handle/1814/4357/SPS%202006.03.pdf?

Sipas të drejtës ndërkombëtare humanitare, përdorimi i forcës për qëllime humanitare, është apo nuk është i autorizuar nga KS, duhet të zbatojë rregullat e së drejtës humanitare dhe parimet e së drejtës ndërkombëtare. Kështu kur një forcë e jashtme ndërhyn pa autorizimin e KS, përveç justifikimit moral ose politik të veprimeve të saj, kërkohet që ajo të ndjekë parimet e ligjit ndërkombëtar si domosdoshmëria dhe proporcionaliteti.[20]

Pra ndërhyrja në Kosovë, edhe pse u motivua nga pikëpamja morale dhe u paraqitën argumente periferike - juridike, ndeshi në mjaft kritika nga ana e juristëve skrupulozë. Duke operuar me nocione formalo – juridike dhe duke abstraguar nga realiteti tragjik, i cili imponoi ndërhyrjen në Kosovë, nga pozita e njëanshmërie teoriko – akademike, ata kanë formuluar rezerva dhe madje akuza ndaj NATO–s.

Kush janë ata që janë kundër ndërhyrjes së NATO–s në ish Jugosllavi?

Në radhë të parë janë një grup juristësh proserbë, të paguar apo të indokrinuar nga Beogradi, të cilët operojnë me interpretime statike të konceptit të sovranitetit shtetëror.

Grupi i dytë përbëhet nga juristë thellësisht dogmatikë, të cilët interesohen vetëm për gërmën e dispozitës juridike, duke neglizhuar frymën e përgjithshme dhe përmbajtjen e kësaj dispozite.

Grupi i tretë i juristëve përbëhet nga ata që nuk e kanë njohur realitetin në ish - Jugosllavi dhe mund të konsiderohen edhe si pjesë përbërëse e grupit të dytë.

Duke e konsideruar aksionin e NATO–s si një ndërhyrje të paligjshme, si një agresion të armatosur dhe cenim të territorit dhe sovranitetit të saj shtetëror, Jugosllavia ngriti një padi në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë kundër dhjetë shteteve anëtare të NATO – s, (Belgjikë, Gjermani, Francë, Britani e Madhe, Itali, Kanada, Holandë, Portugali, Spanjë dhe SHBA), më 28 prill 1999.[21] Gjykata iu shmang dhënies së një vendimi, duke pretenduar se Jugosllavia nuk ishte anëtare e Kombeve të Bashkuara.

8.2.2 Ndërhyrje humanitare e motivuar juridikisht

Vendimi i NATO–s për të përdorur forcën e armatosur, për t'i dhënë fund spastrimit etnik, që serbët po zbatonin ndaj shqiptarëve të Kosovës, nuk gjeti një mbështetje ligjore krejt të saktë, gjë që do të preferohej nga pjesa më e madhe e njerëzve në botë, nga juristët, politikanët dhe qeveritë. Megjithatë ajo u motivua politikisht dhe u justifikua ligjërisht nga ajo pjesë e njerëzve që nuk pranuan ta konsideronin ndërhyrjen humanitare në Kosovë si shkelje të së drejtës ndërkombëtare.[22]

---

20. Penelope C. Simons, Humanitarian Intervention: A Review of Literature, http://www.ploughshares.ca/libraries/WorkingPapers/wp012.html

21. Kosovo War, http://en.wikipedia.org/wiki/Kosovo_War , April 2008

22. Simma, Bruno 1999, "NATO, the UN and the Use of Force: Legal Aspects, "The Europian Journal of International Law 10, 1-22.

Ndërhyrja ushtarake në Kosovë, në mars 1999, përfaqëson një përdorim madhështor të forcës ndërkombëtare për t'i thënë "ndal" abuzimit me të drejtat njerëzore.[23] Ajo ishte fushata bombarduese më e madhe e përdorur ndonjëherë, me qëllimin e dhënies fund të krimeve kundër njerëzimit, të kryera nga një shtet brenda kufijve të tij.

Mediatori amerikan Richard Holbrooke e quajti veprimin e NATO–s si një precedent. "Rasti i parë në histori që një organizatë ushtarake i njohu vetes të drejtën e ndërhyrjes në një vend sovran kundër udhëheqjes së tij."

Ndërhyrja humanitare[24] është një prej koncepteve më të debatueshme në botën e politikës meqë bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me parimin e sovranitetit shtetëror. Megjithatë ajo konsiderohet nga shumë ekspertë ligjorë si një lloj i luftës së drejtë.

Komuniteti ndërkombëtar nuk mund të heshtë përpara shkeljeve të të drejtave njerëzore brenda një shteti. Kur sovraniteti i shtetit vihet në balancë me të drejtat njerëzore, këto të fundit duhet të kenë prioritet. Respektimi i sovranitetit edhe në raste kur qeveria e një shteti po abuzon me të drejtat e qytetarëve të saj, e bën komunitetin ndërkombëtar në njëfarë mënyre bashkëpunëtor në dhunimin e të drejtave njerëzore. Mosushtrimi i dhunës ndaj regjimeve të dhunës nënkupton dështimin e komunitetit ndërkombëtar në respektimin e të drejtave ndërkombëtare njerëzore që tashmë janë të gjithëpranuara.[25]

Drejtuesit politikë të Perëndimit pretenduan se ata kishin një përgjegjësi morale për të ndaluar barbarizmat e tmerrshme që po kryheshin në Kosovë. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Kofi Annan, pohonte se veprimi i NATO-s ishte i ligjshëm dhe se një normë e re e ndërhyrjes po shfaqej - për rastet që përfshinin shtypje të dhunshme të minoriteteve - që duhet dhe do të marrë precedencë ndaj parashikimeve të tjera të së drejtës së shteteve.[26]

Në kohën kur filloi bombardimi Sekretari i Përgjithshëm i NATO–s Havier Solana justifikoi ndërhyrjen duke thënë: "Ne duhet të ndalojmë dhunën dhe t'i japim fund katastrofës humanitare që tani po shpaloset në Kosovë. Ne kemi një detyrë morale për të vepruar kështu. Përgjegjësia është e jona dhe ne do ta përmbushim atë."

Në mbështetje të ligjshmërisë së veprimit ushtarak të NATO – s në Kosovë, Presidenti Bill Klinton dhe Kryeministri Toni Bler në fjalimet e tyre kryesore për luftën argumentuan se situata në Kosovë përbënte një kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Ata theksuan se numri i madh i refugjatëve që largoheshin nga Kosova mund të krijonte destabilizim në vendet fqinjë dhe të çonte në një zgjerim të luftës.[27]

---

23. J. A. Frowein, "Art. 39 MN 7 et seq., 16 et seq.", in B. Simma (ed.), op. cit. Note 3,pp. 8 and 610 et seq.
24. Ndërhyrja humanitare nënkupton përdorimin e forcës në një shtet nga një shtet tjetër (ose një grup shtetesh si koalicion ose një organizatë ndërkombëtare) me qëllimin e parandalimit ose dhënies fund të një krize të rëndë humanitare të individëve në shtetin tjetër, pa lejen e shtetit brenda të cilit do kryhet ndërhyrja, dhe në një mënyrë të pajtueshme me qëllimet humanitare të ndërhyrjes.
25. Jonathan I. Charney, Anticipatory humanitarian intervention in Kosovo, http://www.questia.com/googleScholar.qst?docId=5001866798

26. See SG/SM/6949-HR/CN/898:"Emerging slowly,but believe surely, is an international norm against the violent repression of minorities that will and must take precedence over concerns of State sovereignty."
27. Larry Minear, Ted van Baarda, and Marc Sommers, NATO and Humanitarian Action in the Kosovo Crisis, Watson Institute, 2000, www.ipb.org/.../militarisation%20of%20aid/

Arsyeja tjetër shumë e rëndësishme për të ndërhyrë në Kosovë ishte kredibiliteti i NATO–s. Sipas Robin Kuk, ish Sekretar i Jashtëm i Mbretërisë së Bashkuar: "Arsyeja e parë sepse ne ndërmorëm aksionin ishte që ne ishim të ndërgjegjshëm për barbarizmat që po kryheshin dhe ne kishim mundësi të ndërhynim, por kjo nuk është e vetmja arsye. Besimi ynë në paqen dhe sigurinë varet nga kredibiliteti i NATO–s."

NATO ishte implikuar në diplomacinë ndërkombëtare gjatë vitit 1998 për të zgjidhur konfliktin e Kosovës. Ajo arriti deri në kërcënime ushtarake ndaj Beogradit.

Kur Presidenti Milosheviç shkeli marrëveshjet e tetorit 1998, të garantuara nga NATO, pasojat e mosveprimit të NATO–s do ishin shumë të rënda për kredibilitetin e NATO-s.[28]

Shqiptarët ishin viktimat kryesore të luftës në Kosovë. Çmimi që ata paguan ishte shumë i madh, megjithatë, sipas opinionit të shqiptarëve, NATO po zhvillonte një luftë të drejtë, një luftë që ishte e vetmja përgjigje e drejtë që mund t'i jepte komuniteti ndërkombëtar çështjes së Kosovës. Për t'u çliruar nga regjimi serb dhe për të vënë në jetë aspiratat e tyre për pavarësi, shqiptarët e Kosovës ishin gati të paguanin çdo çmim.

Një çështje tjetër shumë e rëndësishme që u ngrit pas veprimit të NATO–s kundër Jugosllavisë ishte arritja e një konsensusi ndërkombëtar për përdorimin e ndërhyrjes humanitare në të ardhmen dhe krijimi i një doktrine të përgjithshme të ndërhyrjes, ku të përcaktoheshin kushtet në të cilat mund të lejohet ndërhyrja humanitare, organizmi që do të merrte vendimin për fillimin e një ndërhyrje humanitare etj.

Në vitin 1999, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara shtroi pyetjen para atyre për të cilët veprimi në Kosovë përbënte një premisë për ndryshim të së drejtës humanitare në drejtim të mbrojtjes së të drejtave njerëzore jashtë mekanizmave ekzistuese:

"A nuk ekziston rreziku që ndërhyrje të tilla të minojnë sistemin e sigurisë së krijuar pas Luftës së Dytë Botërore dhe rreziku i vendosjes së precedentëve të rrezikshëm për ndërhyrjet e ardhshme pa një kriter të qartë?"[29]

Toni Bler, në fjalimin e tij në Çikago, më 22 prill 1999 përcaktoi pesë konsiderata kryesore, të cilat mund të ndihmojnë në marrjen e vendimit se "a duhet ndërhyrë dhe kur duhet ndërhyrë", të cilat përmblidhen si më poshtë:[30]

- A jemi të sigurt për çështjen tonë, duke qenë se lufta nuk është një instrument perfekt i zgjidhjes së fatkeqësive humanitare, megjithëse është nganjëherë e vetmja mënyrë për t'iu përgjigjur diktatorëve?

- A janë ezauruar të gjitha shanset paqësore të zgjidhjes së konfliktit?

- A kemi mundësi në një situatë konkrete që të ndërmarrim operacione ushtarake të matura?

28. Larry Minear, Ted van Baarda, and Marc Sommers, NATO and Humanitarian Action in the Kosovo Crisis, Watson Institute, 2000, www.ipb.org/.../militarisation%20of%20aid/
29. Annan, Kofi 1999, "Two Concepts of Sovereignty", The Economist, 18 September, www.un.org/Overview/SG/kaecon.htm
30. Chris Abbott, Oxfort Research Group, September 2005, http://www.scribd.com/doc/2554697/Rights-and-Responsibilities-Resolving-the-Dilemma-of- Humanitarian-Intervention

- A jemi të përgatitur që të vazhdojmë të qëndrojmë për të ruajtur qetësinë, edhe pasi lufta përfundon?

- A kemi interesa kombëtare të implikuara?

Autorë të ndryshëm kanë argumentuar se në rastin e ndërhyrjes humanitare të paautorizuar nga KS, forca duhet përdorur vetëm për arritjen e qëllimit, që është vënia në vend e të drejtave njerëzore dhe sapo ky qëllim të arrihet duhet të ndërpritet.

Debate të ndryshme janë bërë edhe përsa i përket organizmit që do të marrë vendimin për fillimin e një ndërhyrje humanitare, në mënyrë që marrja e vendimit të mos diktohet nga interesa të tjera të shteteve, por vetëm nga qëllime thjesht humanitare.

Përcaktimi i kritereve për ndërhyrjet humanitare është i domosdoshëm, në mënyrë që të mos abuzohet me këto ndërhyrje dhe të mos krijohet rreziku i minimit të normave ndërkombëtare kundër përdorimit të forcës.

8.3 KOSOVA E PAVARUR

Rezoluta 1244,[31] (10 qershori 1999), e KS të Kombeve të Bashkuara, e cila pasoi ndërhyrjen e NATO-s të vitit 1999 për t'i thënë ndal shtypjes brutale që Beogradi po u bënte shqiptarëve etnikë, parashikon kornizën ligjore ndërkombëtare për Kosovën. Ajo parashikon vendosjen e një prezence civile dhe ushtarake në Kosovë, nën kujdestarinë e Kombeve të Bashkuara dhe autorizon Sekretarin e Përgjithshëm të OKB – së të krijojë një prezencë civile ndërkombëtare për të siguruar një administratë të përkohshme për Kosovën.

Sipas kësaj rezolute, Kosova u vu efektivisht nën mbikëqyrjen e Kombeve të Bashkuara.[32] Ajo do të administrohej nga një autoritet i përkohshëm i Kombeve të Bashkuara, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, ndërsa siguria e saj do të realizohej nga një forcë ushtarake e drejtuar nga NATO, KFOR.[33]

KFOR – i si forcë shumëkombëshe do të vepronte nën një komandë të unifikuar dhe do të përbëhej nga 50.000 trupa, që do të siguronin mbështetje të përgjithshme për sigurinë dhe riatdhesimin e refugjatëve. Statusi përfundimtar i Kosovës do të vendosej me bisedime që do të zhvilloheshin në të ardhmen.

Bisedimet ndërkombëtare për të vendosur statusin final të Kosovës filluan në vitin 2006. Në shkurt 2007, i dërguari special i Kombeve të Bashkuara Ahtisari paraqiti një projekt me propozime për zgjidhje, që përbënte bazën e një projekt rezolute të KS të Kombeve të Bashkuara. Rusia i kundërshtoi propozimet e Ahtisarit dhe bisedimet përfundimtare për të arritur një marrëveshje për statusin final të Kosovës dështuan.

31. Security Council, Resolution 1244. Adopted by the Security Council at its 4011th meeting, on 10 June 1999, http://www.un.org/docs/scres/1999/sc99.htm

32. Dragan Lozancic, Kosovo: Adjusting to a "New Reality", George C. Marshall, Center for Security Studies, ISSN 1867-4119, www.marshallcenter.org/mcpublicweb/.../F.../SecurityInsight_02.pdf

33. Milena Sterio, The Kosovar Declaration of Indipendence: "Botching the Balkans" or Respecting International Law?, Georgia Journal of International and Comparative Law, Forthcoming, Cleveland-Marshall Legal Studies, 21 Sep.08, papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=1270637/handle/1814/4357/SPS%202006.03.pdf?

Në 17 shkurt 2008, qeveria kosovare e dominuar nga shqiptarët, shpalli në mënyrë të njëanshme pavarësinë nga Serbia, duke pasur edhe mbështetjen e shteteve si SHBA, Mbretëria e Bashkuar dhe Franca. Shpallja e pavarësisë u pasua nga njohja e menjëhershme e Kosovës si shtet nga SHBA dhe nga rreth 20 vende të Bashkimit Evropian.

Pavarësia e Kosovës është njohur tashmë nga 87 vende, 22 prej të cilave janë shtete anëtare të BE. Asambleja gjithashtu adaptoi flamurin dhe himnin e Republikës së Kosovës.[34]

Në 9 prill Asambleja adaptoi Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila hyri në fuqi më 15 qershor 2008. Kushtetuta parashikon një rol të dukshëm të BE–së në Kosovë. Ajo gjithashtu parashikon një përfaqësi civile ndërkombëtare si i vetmi autoritet mbikëqyrës.

Deklarata e pavarësisë së Kosovës dhe hyrja në fuqi e kushtetutës ka krijuar një realitet të ri në Kosovë. Procesi i shpërbërjes së Trupave Mbrojtëse të Kosovës, (TMK) dhe krijimi i një Force të Re Sigurie të Kosovës, e parashikuar në kushtetutë, filloi në shtator 2008 dhe përfundoi në janar 2009. Kushtetuta bazohet në propozimin e gjithanshëm për zgjidhjen e statusit të Kosovës, të përgatitur nga i Dërguari Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisari.

Në 16 shkurt 2008 Këshilli i BE – së vendosi të dërgonte EULEX Kosova, (Europian Union Rule of Law Mission in Kosovo). Ky mision është projektuar si një vazhdim i prezencës civile ndërkombëtare në Kosovë e parashikuar nga Rezoluta 1244 e KS të OKB – së. Qëllimi i tij është të asistojë dhe mbështesë autoritetet kosovare në fushën e shtetit të së drejtës, veçanërisht në fushën e policisë, gjyqësisë dhe doganave. Misioni nuk ka për qëllim që të qeverisë Kosovën. Ai është një mision teknik, i cili do të monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë, ndërsa do të mbajë një numër të kufizuar kompetencash ekzekutive.

Vendosja e EULEX do të ndihmojë vendosjen dhe funksionimin e shtetit ligjor në të gjithë Kosovën, duke përfshirë edhe veriun e Kosovës.

Ndërkohë misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, (UNMIK) është akoma present në Kosovë derisa pushtetet e tij t'iu transferohen krejtësisht institucioneve të Kosovës.
Në 7 shkurt 2008, Ives de Kermabon u emërua kryetar i Misionit EULEX.

Ai tha:"Qëllimi është që të përmirësojmë në mënyrë të dukshme situatën e shtetit ligjor në të mirë të të gjitha komuniteteve të Kosovës. Qëllimet tona nuk do të arrihen brenda një nate. Njerëzit duhet të ruajnë qetësinë. Por unë ju siguroj se ne jemi të vendosur dhe do të arrijmë të realizojmë ndryshimin."

Rusia dhe Kina e konsiderojnë misionin si jo ligjor dhe që pret zgjidhje në një vendim të ri të KS të OKB-së.

---

34. Kosovo (Under UNSCR 1244/99) 2008 Progress Report, Brussels, 05.11.2008, SEC(2008)2697 final

Sipas Përfaqësuesit të BE-së për Politikën dhe Sigurinë e Jashtme Havier Solana, -"Misioni do të jetë vendimtar për konsolidimin e shtetit ligjor në Kosovë. Vendosja e shtetit të së drejtës dhe fuqizimi i institucioneve multi-etnike do të jetë në të mirë të të gjitha komuniteteve në Kosovë. Misioni dëshmon angazhimin e fortë të BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor."

KFOR – i, prezenca ushtarake ndërkombëtare e udhëhequr nga NATO, në Kosovë, vazhdon të jetë përgjegjës për sigurinë e përgjithshme.

9. PERFUNDIME

Punimi analizon gjerësisht legjislacionin ndërkombëtar, që rregullon marrëdhëniet mes palëve në situata konflikti të armatosur, ndërkombëtar dhe jondërkombëtar.

Në seksione të veçanta janë analizuar të drejtat dhe detyrimet e palëve ndërluftuese, e drejta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për marrjen e masave konkrete, të parashikuara në nenet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, me qëllim që të mos lejohet prishja e ekuilibrave ndërkombëtar dhe të mos cënohët sistemi ndërkombëtar i sigurisë, i vendosur nga Karta e Kombeve të Bashkuara, pas Luftës së II-të Botërore.

Është analizuar gjithashtu e drejta e organizatave rajonale, për të vepruar në mbrojtje të të drejtave njerëzore, me autorizimin e Këshillit të Sigurimit, si dhe tendencat aktuale të zhvillimit të së drejtës ndërkombëtare humanitare, nëpërmjet identifikimit të mangësive që ajo paraqet, kryesisht në drejtim të zbatimit të saj.

Megjithatë, në mbyllje të punimit, do të doja të theksoja disa përfundime kryesore që sintetizojnë analizën në secilin prej seksioneve, e në mënyrë të veçantë disa përfundime dhe rekomandime për mundësinë dhe mënyrat e përdorimit të **ndërhyrjeve humanitare** nga shtete të ndryshme, me ose pa autorizimin e Këshillit të Sigurimit, me qëllimin fisnik të zgjidhjes së krizave humanitare dhe të vendosjes së respektit për të drejtat njerëzore të dhunuara, si dhe mbi parimet e strategjitë që duhen përdorur për planifikimin dhe zhvillimin e **operacioneve paqeruajtëse** të Kombeve të Bashkuara, në mënyrë që ato të kenë rezultate pozitive gjatë përmbushjes së mandatit.

1. Shkeljet masive dhe sistematike të të drejtave njerëzore, që ndodhin në vende të ndryshme, duhen kontrolluar jo vetëm se ato mund të shkaktojnë rreziqe për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, por edhe për faktin se është detyrim njerëzor mbrojtja e individëve të dhunuar.

2. Komuniteti ndërkombëtar nuk mund të qëndrojë indiferent kur shkelen të drejtat njerëzore brenda një shteti. Ai duhet të angazhohet në mbrojtjen e këtyre të drejtave, pavarësisht parimit të sovranitetit shtetëror.

3. Megjithëse sovraniteti dhe mosndërhyrja janë parime bazë të marrëdhënieve ndërkombëtare, kur ndodhin abuzime serioze me të drejtat njerëzore brenda një shteti, vëmendja duhet drejtuar tek përgjegjësia ndërkombëtare në mbrojtjen e të drejtave individuale. Shtetet nuk mund të lejohen të fshihen pas konceptit të sovranitetit dhe të shkatërrojnë të drejtat e qytetarëve të tyre, sepse kjo do të

nënkuptonte dështimin e komunitetit ndërkombëtar në mbrojtjen e të drejtave njerëzore të gjithëpranuara.

4. Shkeljet e rënda që kryhen në kurriz të një popullsie, duhet të përballen fillimisht me alternativa paqësore, si presion publik, ndjekje penale për personat përgjegjës, sanksione ekonomike dhe diplomatike.

5. Në disa raste ndodhin shkelje të të drejtave njerëzore aq të rënda saqë përdorimi i forcës është opsioni i vetëm, i arsyeshëm për të ndalur këto shkelje dhe se koncepti i mosndërhyrjes duhet nganjëherë të dorëzohet para përgjegjësive ndërkombëtare për të mbrojtur popullsinë e dhunuar.

6. Në situata krizash të rënda humanitare, të cilat bëjnë të domosdoshëm përdorimin e ndërhyrjes humanitare, duhen bërë përpjekje që shkeljet e të drejtave njerëzore dhe vuajtjet e popullsisë të mos shtohen. Duhet siguruar pra, që ndërhyrja të ketë efekte pozitive më shumë se negative dhe të ndikojë në përmirësimin e situatës humanitare.

7. Që një ndërhyrje të karakterizohet si humanitare duhet të ekzistojnë këto faktorë:

   - Duke qenë se lufta përmban në vetvete rrezikun për jetën dhe në disa raste mund të shkaktojë fatkeqësi të tjera, forca ushtarake duhet të jetë opsioni i fundit që mund të përdoret për qëllime humanitare.

   - Duhen bërë përpjekje për të siguruar, që mënyrat e përdorura për të ndërhyrë, të respektojnë të drejtat njerëzore ndërkombëtare dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare. Pra, të mos kryhen shkelje të reja, duke u përpjekur të shtypen shkeljet e mëparshme, ose ato që janë duke u kryer.

   - Ndërhyrja humanitare nuk ka arsye për t'u zbatuar, në qoftë se parashikohet, sipas rrethanave konkrete, se ajo mund t'i shtojë vuajtjet.

   - Më e preferuar do të ishte përkrahja e ndërhyrjes humanitare nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, ose organizmat e tjerë, me autoritet të dukshëm multilateral. Megjithatë, në dritën e një natyre joperfekte të qeverisjes ndërkombëtare të sotme, nuk do të kërkohej aprovimi multilateral në një rast emergjence.

8. Zhvillimi i ndërhyrjeve humanitare pa autorizimin e Këshillit të Sigurimit, me qëllimin e dhënies fund të shkeljeve masive dhe sistematike të të drejtave njerëzore, është i domosdoshëm në rastet kur përdorimi i forcës mbetet opsioni i fundit i arsyeshëm dhe Këshilli i Sigurimit nuk është në gjendje të veprojë.

9. Ndërhyrja mbi baza humanitare, pa pëlqimin e qeverisë së vendit ku do kryhet ndërhyrja, duhet përdorur me shumë kujdes, sepse ekziston rreziku që forca të

përdoret për interesa vetjake, duke përdorur arsyet humanitare vetëm si justifikim për veprimin ushtarak.

10. Një tjetër kërkesë e domosdoshme lidhur me ndërhyrjet humanitare është që shtetet që ndërhyjnë nuk duhet të kenë motive të tjera politike dhe ekonomike, përveç atyre humanitare për të realizuar ndërhyrjen. Megjithatë, është pranuar se gjetja e arsyeve thjesht humanitare është e vështirë. Ndërhyrjet e zhvilluara vitet e fundit kanë treguar se kanë ekzistuar edhe motive të tjera, përveç atyre humanitare, si p.sh. nevoja për pengimin e fluksit të refugjatëve, ose interesat strategjike dhe ekonomike në shtetin ku ndërhyhet.

11. Shkeljet e të drejtave njerëzore, që ndodhin në vende të ndryshme duhet të vlerësohen nga komuniteti ndërkombëtar në mënyrë të barabartë, me qëllim që të mos krijohet ideja se të drejtat e disa popujve janë më të rëndësishme se të disa të tjerëve. Megjithatë, në qoftë se një situatë e caktuar justifikon përdorimin e forcës ndërkombëtare, nuk do ishte e drejtë të pretendohej për mosndërhyrje në mbrojtje të të drejtave njerëzore, thjesht për faktin se barbarizma të tjera u neglizhuan më parë. Çështja është që ndërhyrja të inkurajohet në të gjitha vendet ku është e nevojshme dhe jo t'i mohohet njërit vend për shkak se nuk është ndërhyrë më parë në tjetrin.

12. Hapi ekstrem i ndërhyrjes ushtarake duhet ndërmarrë vetëm për të ndaluar masakrat e dukshme dhe jo për të ndëshkuar abuzimet e të shkuarës. Kjo nuk do të thotë se barbarizmat e të shkuarës duhen injoruar.

13. Në rastin e ndërhyrjes humanitare të paautorizuar, forca e armatosur duhet përdorur vetëm për ndalimin e barbarizmave dhe për të rivendosur respektin për të drejtat njerëzore dhe jo për qëllim tjetër. Në këtë kuptim mund të themi se përdorimi i forcës duhet të ndërpritet sapo të jetë arritur qëllimi i aksionit ndërkombëtar sipas mandatit që ka.

14. Ndërhyrja humanitare në emër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, shkelja e të cilave mund të shkaktojë rreziqe për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare ka padyshim anët e saj pozitive, por megjithatë ekziston rreziku i abuzimit me përdorimin e ndërhyrjes humanitare. Nëse e drejta për të ndërhyrë në një shtet, në emër të mbrojtjes së të drejtave njerëzore, kur qeveria është e paaftë, ose vetë ajo shkel të drejtat e qytetarëve të saj, do të pranohet, ajo do të jetë praktikisht e vështirë për t'u kontrolluar.

15. Përdorimi i forcës jashtë sistemit të Kombeve të Bashkuara mund të krijojë mundësinë e abuzimit me konceptin e ndërhyrjes, duke vendosur precedentë të rrezikshëm ndërhyrjesh, të zhvilluara pa kritere të përcaktuara qartë dhe mund të rrezikojë kështu sistemin e sigurisë të krijuar pas Luftës së Dytë Botërore. Nuk

duhet të harrojmë se në vitin 1939 Gjermania Naziste përdori arsyet humanitare për të legjitimuar pushtimin e Çekosllovakisë, duke deklaruar se gjermanët etnikë po keqtrajtoheshin në Sudetenland.

16. Për të shmangur rrezikun e abuzimit me përdorimin e forcës nga ana e shteteve më të fuqishme dhe me qëllim që ndërhyrjet humanitare të jenë të ligjshme e të kufizohen vetëm në përmbushjen e misionit të tyre fisnik të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve, duhet të kristalizohet një rregull i përgjithshëm i së drejtës ndërkombëtare, i cili të lejojë përdorimin e forcës së armatosur.

17. Krijimi i një kornize ligjore, brenda të cilës të mund të vendoseshin ndërhyrjet humanitare, do t'i siguronte komunitetit ndërkombëtar një bazë ligjore mbi të cilën të vepronte, me qëllim që t'i japë fund barbarizmave e krimeve kundër njerëzimit, të cilat përbëjnë kërcënim për paqen. Këtu do të përfshihej përcaktimi i qartë i situatave dhe i shkeljeve që e bëjnë të domosdoshme ndërhyrjen. Përcaktimi i mënyrës së marrjes së vendimit që përfshin caktimin e organizmit që do ketë të drejtë të marrë vendimin për fillimin e ndërhyrjes, në mënyrë që të shmanget mundësia e ndërhyrjes për motive të ndryshme nga ato humanitare. Me rëndësi do të ishte edhe përcaktimi i kohës së marrjes së vendimit dhe kohëzgjatjes së përdorimit të forcës, në mënyrë që të mos kapërcehet qëllimi i ndërhyrjes, që është vetëm rivendosja e respektit për të drejtat njerëzore.

18. Për të shmangur sa më shumë abuzimet me përdorimin e ndërhyrjeve humanitare do të ishte më e arsyeshme që veprime të tilla të ndërmerreshin nga një grup shtetesh dhe jo nga një fuqi e vetme. Ndërhyrja e paautorizuar mund të ndërmerret gjithashtu nga organizatat rajonale përkatëse. Organizatat rajonale, të themeluara sipas kapitullit VIII të Kartës, janë të ndaluara të ndërmarrin veprime të dhunshme, pa autorizimin e Këshillit të Sigurimit, (neni 53/1). Sidoqoftë, meqë ato kanë një mandat për t'u marrë me çështje të tilla, të cilat kanë të bëjnë me ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, aq sa është e përshtatshme për veprim rajonal, implikimi i organizatave rajonale respektive si aktor kryesor në një ndërhyrje humanitare të paautorizuar do të rriste legjitimitetin e ndërhyrjes.

Konkluzione mbi zhvillimin e operacioneve paqeruajtëse

19. E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut është një pjesë integrale e kornizës normative për operacionet paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara. Deklarata Universale e të drejtave të njeriut, e cila vendos themelin e standardeve të të drejtave njerëzore ndërkombëtare, thekson se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore janë universale dhe të garantuara për çdo njeri. Operacionet paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara duhet të zhvillohen në respekt të plotë të

të drejtave njerëzore dhe duhet të kërkojnë çuarjen përpara të të drejtave njerëzore përmes përmbushjes së mandatit të tyre.

20. E drejta ndërkombëtare humanitare është krijuar për të mbrojtur personat që nuk marrin pjesë, ose nuk marrin më pjesë në veprime dhe ruan të drejtat themelore të civilëve, viktimave dhe jo luftueseve në një konflikt të armatosur. Ajo ka lidhje me operacionet paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara, sepse këto misione shpesh kryhen në mjediset e pas konfliktit ku dhuna mund të jetë duke vijuar, ose konflikti mund të sundojë. Paqeruajësit e Kombeve të Bashkuara duhet të kenë një kuptim të qartë të parimeve dhe rregullave të së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe t'i zbatojnë ato në situatat e duhura.

21. Operacionet paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara vendosen mbi bazën e një mandati të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Detyrat që një operacioni paqeruajtës të Kombeve të Bashkuara do t'i kërkohet të kryejë, janë të vendosura në mandatin e Këshillit të Sigurimit. Mandatet e Këshillit të Sigurimit ndryshojnë nga një situatë në tjetrën, në varësi të natyrës së konfliktit dhe sfidave specifike që ai përfaqëson.

22. Tradicionalisht, roli "paqeruajtës" është konsideruar si i Kombeve të Bashkuara. Kaskat Blu të Kombeve të Bashkuara, duke vepruar sipas kapitullit VI të Kartës së Kombeve të Bashkuara, janë autorizuar të promovojnë zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve përmes negociatave. Me pëlqimin e të gjitha palëve në konflikt, trupat paqeruajtëse mund të pozicionohen ndërmjet vijave të frontit, me qëllim që të garantojnë një pushim zjarri, derisa të arrihet marrëveshja e paqes.

23. Mospërdorimi i forcës ishte një parim i operacioneve të Kombeve të Bashkuara, që është zbatuar sidomos gjatë Luftës së Ftohtë. Por nëse kujtojmë konfliktin në Bosnjë & Hercegovinë, i cili ishte konflikti më i përgjakshëm në Evropë, qysh prej Luftës së Dytë Botërore, mund të arrijmë në përfundimin se **mandatet e fuqishme** të kapitullit VII janë të nevojshme për t'u zbatuar në disa misione. Mandati i dobët i UNPROFOR-it në Bosnjë rezultoi në pandëshkueshmëri për luftuesit serbë. Deri në pranverën dhe verën e vitit 1995, më shumë se tre vjet pasi genocidi ishte bërë i dukshëm në të gjithë botën, nuk pati rezultate të përmirësimit të situatës. Përdorimi i forcës nga NATO ndryshoi rrjedhën e konfliktit, gjë që tregoi se kursi i gjithë konfliktit mund të kishte ndryshuar nëse forca do të ishte përdorur 3 vjet më parë.

24. Paqeruajtja e fuqishme përfshin përdorimin e forcës me autorizimin e Këshillit të Sigurimit dhe pëlqimin e kombit pritës, ose pëlqimin e palëve kryesore në konflikt. Ajo nuk është e njëjtë me zbatimin e paqes, siç parashikohet në kapitullin VII të Kartës. **Zbatimi i paqes,** që realizohet në përputhje me

parashikimet e kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, ka karakter shtrëngues dhe nënkupton përdorimin e forcës ushtarake me autorizimin e Këshillit të Sigurimit, pa pëlqimin e palëve në konflikt. Mandatet e forta të kapitullit VII janë të nevojshme në misionet ku kërcënimi për rifillimin e dhunës, ose vijimin e konfliktit është i qartë.

25. Nisur nga limitet e doktrinës së paanësisë, të përdorur tradicionalisht në operacionet paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara, si dhe nga mandatet e fuqishme që ka dhënë Këshilli i Sigurimit, mund të konkludojmë se, pavarësisht se një prej parimeve bazë të operacioneve paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara tradicionalisht ka qenë paanësia, operacionet paqeruajtëse duhet të jenë të përgatitura për të vepruar kundër atyre palëve ndaj të cilave është e nevojshme të luftohet me qëllim që të përmbushet mandati. Nevoja e mbajtjes së anës ndaj një pale të konfliktit, me qëllim që t'i jepet fund dhunës u demonstrua në operacionin e Kombeve të Bashkuara në Bosnjë.

26. Në të njëjtën mënyrë, në rastet e përdorimit të operacioneve të "zbatimit të paqes", të cilat kanë për qëllim dhënien fund të një krize humanitare, ndërhyrësit ndërkombëtarë duhet të jenë të përgatitur të zgjedhin që të mbajnë anën e një pale të konfliktit dhe duhet të kenë si qëllim të ndihmojnë në mposhtjen ushtarake të luftuesve të tjerë.

27. Në qoftë se do të pranojmë, se në disa raste është e domosdoshme për një operacion paqeruajtës, të angazhohet në betejë kundër njërës palë të konfliktit, me qëllim që të përmbushet mandati, duhet të cilësojmë gjithashtu se paqeruajtësit duhet të jenë të bindur se pala që ato kanë zgjedhur si "armike" të mos jetë aq e fortë sa ta kthejë misionin në një luftë në shkallë të plotë. Ndërsa është ndonjëherë e nevojshme për një ndërhyrje që të pozicionohet në një konflikt dhe të ndihmojë në lehtësimin e një fitoreje vendimtare të njërës palë, ekziston edhe rreziku i rritjes së dhunës fatkeqësive dhe shkatërrimit.

28. Prandaj, **pozicionimi në njërën anë të konfliktit** mund të konsiderohet si një strategji "e zgjuar" dhe mund të ndihmojë në lehtësimin e pakësimit të rezistencës nga pala kundërshtare, vetëm në qoftë se forca ndërhyrëse është dukshëm më e fortë ushtarakisht se luftuesit që cilësohen si "armiq" dhe vetëm në qoftë se operacioni është i gatshëm dhe në gjendje të përdorë forcën vendimtare për të arritur qëllimin për të cilin është mandatuar.

29. Në veçanti, operacioneve të zbatimit të paqes duhet t'iu jepen mjetet dhe autorizimi i nevojshëm për të zbatuar forcën në rast nevoje. Në rastin e operacioneve të zbatimit të paqes është e domosdoshme vendosja e **rregullave të**

angazhimit, të cilat lejojnë përdorimin e forcës me qëllim që të arrihet suksesi i operacionit.

30. Operacionet e zbatimit të paqes autorizohen atëherë kur Këshilli i Sigurimit ka vendosur për ekzistencën e një kërcënimi të paqes, shkelje të paqes, ose akt agresioni dhe kanë për qëllim të mbrojnë, ose rindërtojnë paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Operacioni i zbatimit të paqes është një ndërhyrje e armatosur dhe forcat pjesëmarrëse mund të mos jenë nën komandën e Kombeve të Bashkuara. Modeli i drejtimit nga një komb përbën opsionin më të mirë për operacionet e zbatimit të paqes, për faktin se Organizata e Kombeve të Bashkuara nuk ka ndonjë kapacitet efektiv për të kryer ndërhyrje të tilla.

31. Në krizat humanitare, të cilat kërkojnë ndërhyrje të llojit të zbatimit të paqes, **përgjigja në kohën e duhur** është një nga elementët kryesor për suksesin e operacionit. Vonesa e shteteve në vënien në dispozicion të Këshillit të Sigurimit ka nxjerrë në pah nevojën për zhvillimin e një ushtrie të qëndrueshme të Kombeve të Bashkuara, si një forcë ndërkombëtare permanente, e aftë për t'iu përgjigjur shpejt krizave humanitare dhe në gjendje për t'u vendosur brenda një kohe të kufizuar.

32. Misionet e zbatimit të paqes, veçanërisht në konfliktet brenda shtetit, influencojnë në konceptin tradicional të sovranitetit absolut kombëtar. Ajo që mund të përkufizohet si "ndërhyrje humanitare" nga Kombet e Bashkuara dhe disa kombe të tjerë, mund të konsiderohet si ndërhyrje në punët e brendshme të atij kombi nga shumë vende të tjera.

33. Vlerësimi i ndërhyrjeve humanitare varet jo vetëm nga çfarë ndodh gjatë dhe menjëherë pas ndërhyrjes, por gjithashtu nga rezultatet afatgjata që ajo krijon. Po të analizojmë veprimet e NATO-s në zgjidhjen e konflikteve në Bosnjë dhe Kosovë mund të themi se ato kontribuan në arritjen e rezultateve efektive dhe të qëndrueshme. Në Bosnjë dhe Kosovë, Aleanca ndërhyri me forcë për t'i dhënë fund konflikteve dhe më pas vendosi trupa për të parandaluar një rikthim të armiqësive, si dhe për të krijuar kushtet në të cilat mund të fillonte procesi i paqes. Praktika e operacioneve ushtarake, të kryera pas viteve '90, të çon në përfundimin se, për të siguruar një paqe të qëndrueshme dhe me qëllim që të rindërtohen shtetet e shkatërruara, është i nevojshëm një **angazhim afatgjatë.** Operacionet paqeruajtëse përgjithësisht i japin fund me sukses dhunës, por shanset për rishfaqjen e konfliktit do të jenë të larta në qoftë se nuk punohet për një zgjidhje afatgjatë. Në rastet kur komuniteti ndërkombëtar e konsideron një situatë aq serioze sa që vendos të ndërhyjë ushtarakisht, ai duhet të angazhohet për të ndihmuar rindërtimin e shoqërisë pas përfundimit të dhunës.

34. Historikisht ka ekzistuar një lidhje mes organizatave civile dhe ushtarake, por në operacionet e mbështetjes së paqes ajo kthehet në një tipar qendror. Bashkëpunimi civilo - ushtarak merret me harmonizimin e marrëdhënieve mes civilëve dhe ushtarakëve, në një hapësirë të caktuar të zonës së operacioneve, me koordinimin e maksimizimin e përdorimit të burimeve të projektuara për të ndaluar mohimin e të drejtave dhe vuajtjet e popullatës, njëkohësisht edhe me veprimtaritë e rindërtimit. Bashkëpunimi Civilo - Ushtarak është projektuar për të rritur besueshmërinë e forcës së operacioneve të mbështetjes së paqes, për të promovuar bashkëpunim e mirëkuptim për operacionin dhe për të bindur palët në konflikt dhe anëtarët e paangazhuar të vendit pritës se interesat e tyre më të mira lidhen me paqen.

35. **Operacionet e ndërtimit të paqes,** që pasojnë zbatimin e paqes, synojnë eleminimin e shkaqeve të një konflikti, si dhe konsolidimin dhe fuqizimin e zgjidhjes politike.

10. BIBLIOGRAFIA

10.1 AKTET BURIMORE

10.1.1 Legjislacioni ndërkombëtar

1. Deklarata lidhur me ndalimin e përdorimit të plumbave që zgjerohen, ose rrafshohen lehtë në trupin e njeriut, Hagë, 29 korrik 1899.
2. Deklarata në lidhje me plumbat shpërthyes (plumbat dum-dum), Hagë, 29 Qershor 1899.
3. Deklarata që ndalon përdorimin në kohë lufte të predhave shpërthyese nën peshën 400 gram, Shën Petërsburg, 29 nëntor/11 dhjetor 1868.
4. Deklarata universale e të drejtave të njeriut, Nju Jork, 10 dhjetor 1948.
5. Instructions for the Government of Armies of the United States in the Field, Prepared by Francis Lieber and revised by a board of officers, Washington, April 1863.
6. Karta e Kombeve të Bashkuara, 26 qershor 1945.
7. Konventa (I) e Gjenevës për përmirësimin e fatit të të plagosurve dhe të sëmurëve të forcave të armatosura në fushën e betejës, 12 gusht 1949.
8. Konventa (II) e Gjenevës për përmirësimin e fatit të të plagosurve, të sëmurëve dhe të anijembyturve të forcave të armatosura në det, 12 gusht 1949.
9. Konventa (III) e Gjenevës për trajtimin e robërve të luftës, 12 gusht 1949.
10. Konventa (IV) e Gjenevës për mbrojtjen e personave civilë në kohë lufte, 12 gusht 1949.
11. Konventa e Gjenevës, për përmirësimin e fatit të të plagosurve dhe të sëmurëve të forcave të armatosura në fushën e betejës, 6 korrik 1906.
12. Konventa e Gjenevës, për përmirësimin e fatit të të plagosurve dhe të sëmurëve të forcave të armatosura në fushën e betejës, 27 Korrik 1929.
13. Konventa e Gjenevës, për trajtimin e robërve të luftës, 27 korrik 1929.
14. Konventa e Vjenës për të drejtën e traktateve, 1969.
15. Konventa europiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, Romë, 4 nëntor 1950.
16. Konventa kundër torturës dhe trajtimeve të tjera, ose dënimeve çnjerëzore, johumane dhe degraduese, 1984.
17. Konventa lidhur me bombardimin nga forcat detare në kohë lufte, Hagë, 18 tetor 1907.
18. Konventa lidhur me disa kufizime përsa i përket ushtrimit të së drejtës së kapjes në det në luftën detare, Hagë, 18 tetor 1907.

19. Konventa lidhur me kthimin e anijeve tregtare në anije lufte, Hagë, 18 tetor 1907.
20. Konventa lidhur me përshtatjen në kushtet e luftës detare të parimeve të Konventës së Gjenevës, të datës 6 korrik 1906, Hagë, 18 tetor 1907. Kjo Konventë u zvendësua me Konventën e dytë të Gjenevës, të vitit 1949, siç shpallet në nenin 58 të kësaj të fundit.
21. Konventa lidhur me statusin e anijeve tregtare, armike në momentin e shpërthimit të luftës, Hagë, 18 tetor 1907.
22. Konventa mbi mbrojtjen e pasurisë kulturore në rast konflikti të armatosur, Hagë, 14 Maj 1954.
23. Konventa mbi ndalimin e çdo përdorimi të dëmshëm të teknikave modifikuese mjedisore, 10 dhjetor 1976.
24. Konventa mbi ndalimin e zhvillimit, prodhimit dhe magazinimit të armëve baktereologjike dhe helmuese, si dhe mbi shkatërrimin e tyre, 10 Prill 1972.
25. Konventa mbi ndalimin, ose kufizimin e përdorimit të disa armëve konvencionale, të cilat gjykohen të jenë jashtëzakonisht të dëmshme, ose shkaktojnë pasoja pa bërë dallim, Gjenevë, 10 Tetor 1980.
26. Konventa mbi parandalimin dhe ndëshkimin e krimit të genocidit, rezoluta 260 (III) e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, 9 dhjetor 1948.
27. Konventa mbi respektimin e të drejtave dhe detyrimeve të fuqive dhe personave neutralë në rastet e luftës në tokë, Hagë, 18 tetor 1907.
28. Konventa ndërkombëtare kundër marrjes peng. Rezoluta 34/146 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, 17 dhjetor 1979.
29. Konventa ndërkombëtare për eleminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial, 1966.
30. Konventa ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike, 1966.
31. Konventa ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, 1966.
32. Konventa në lidhje me respektimin e ligjeve dhe zakoneve të luftës në tokë, Hagë, 18 tetor 1907.
33. Konventa për eleminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas, 1979.
34. Konventa për ndalimin e akteve të paligjshme, kundër sigurisë së aviacionit civil, Montreal, 23 shtator 1971.
35. Parimet bazë për përdorimin e forcës dhe të armëve të zjarrit. Miratuar nga kongresi i tetë i Kombeve të Bashkuara mbi parandalimin e krimit dhe trajtimit të kriminelëve, Havanë, Kubë, 27 gusht-7 shtator 1990.
36. Parimet e bashkëpunimit ndërkombëtar në zbulimin, arrestimin, ekstradimin dhe ndëshkimin e personave fajtorë për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Rezoluta 3074 (XXVIII) e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, 3 dhjetor 1973.
37. Protokolli mbi mbrojtjen e pasurisë kulturore në rast konflikti të armatosur, Hagë, 14 Maj 1954.
38. Protokolli për ciflat e pazbulueshme, (Protokolli I), Gjenevë, 10 tetor 1980.
39. Protokolli mbi armët verbuese me rreze lazer, (Protokolli IV i Konventës së Gjenevës të vitit 1980), 13 Tetor 1995.
40. Protokolli mbi ndalimin, ose kufizimin e përdorimit të armëvë zjarrvënëse, (Protokolli III).
41. Protokolli fakultativ i Konventës kundër torturës, 2002.

42. Protokolli fakultativ i Konventës për eleminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas, 1999.
43. Protokolli i dytë i Konventës së Hagës të vitit 1954 mbi mbrojtjen e pasurisë kulturore në rast konflikti të armatosur, Hagë, 14 maj 1954.
44. Protokolli i II-të shtesë i konventave të Gjenevës të12 gushtit 1949 që lidhet me mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura jondërkombëtare, 8 qershor 1977.
45. Protokolli i I-rë shtesë i konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 që lidhet me mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura ndërkombëtare, 8 qershor 1977.
46. Protokolli mbi ndalimin, ose kufizimin e përdorimit të minave, minave-surprizë dhe mjeteve të tjera shpërthyese, (Protokolli II i Konventës së vitit 1980 i ndryshuar në datë 3 maj 1996).
47. Protokolli për ndalimin dhe përdorimit në luftë të lëndëve mbytëse, helmuese, ose gazrave të tjera dhe të metodave bakteriologjike të luftës, Gjenevë, 17 qershor 1925.
48. Resolution 1329 (2000) Adopted by the Security Council at its 4240th meeting, on 30 November 2000.
49. Respektimi i të drejtave të njeriut në konfliktet e armatosura. Rezoluta 2444 (XXIII) e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, 19 dhjetor 1968.
50. Rezoluta 307 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, 21 dhjetor 1971, (Bangladesh)
51. Rezoluta 764 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, 13 korrik 1992, (Yugoslavia).
52. Rezoluta 780 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, 6 tetor 1992, (Yugoslavia).
53. Rezoluta 827 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, 25 maj 1993.
54. Rezoluta 864 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, 15 shtator 1995 (Angola).
55. Rezoluta 872 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, 5 tetor 1993.
56. Rezoluta 912 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, prill 1994 (Ruanda).
57. Rezoluta 918 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, 1 korrik 1994.
58. Rezoluta 941 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, 23 shtator 1994 (Tribunal).
59. Rezoluta 995 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, 8 nëntorit 1994.
60. Rregullat e luftës ajrore, Hagë, dhjetor 1922–shkurt 1923.
61. Rregullat në lidhje me respektimin e ligjeve dhe zakoneve të luftës në tokë, Hagë, 18 tetor 1907.
62. Rregullat për zbatimin e Konventës mbi mbrojtjen e pasurisë kulturore në rast konflikti të armatosur, Hagë, 14 maj 1954.
63. Security Council resolution 169 of 24 November 1961, Un Doc. S/5002.
64. Security Council resolution 666 of 13 September 1990, (embargo against Iraq).
65. Security Council resolution 770 of 13 August 1992.
66. Security Council resolution 771 of 13 August 1992.

67. Security Council resolution 787 of 16 November 1992, (embargo against former Yugoslavia).
68. Security Council resolution 808 of 22 February 1993.
69. Security Council resolution 816 of 31 March 1993, (no flight zones over Bosnia and Herzegovina).
70. Security Council resolution 816 of 31 March 1993.
71. Security Council resolution 827 of 25 May 1993.
72. Security Council resolution 836 of 4 June 1993.
73. Statute of the International Criminal Court, done at Rome on 17 July 1998.
74. Statute of the International Criminal Tribunal for the Prosecution of Persons Responsible for Serious Violations of International Humanitarian Law Committed in the Territory of the Former Yugoslavia since 1991.
75. Statute of the International Criminal Tribunal for the Prosecution of Persons Responsible for Genocide and Other Serious Violations of International Humanitarian Law Committed in the Territory of Rwanda and Rwandan Citizens Responsible for Genocide and Other Such Violations Committed in the Territory of Neighbouring States between 1 January and 31 December 1994.
76. Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, 26 qershor 1945.
77. Traktati i Otavës, mbi ndalimin e përdorimit, magazinimit, prodhimit dhe transferimit të minave anti-personeli, si dhe mbi asgjësimin e tyre, 1997.

10.1.2 Botime/studime/raporte

1. Arben Puto, "E Drejta Ndërkombëtare Publike", botuar nga Marin Barleti 2009.
2. Bazat themelore të ligjit të luftës, botim i Ministrisë së Mbrojtjes në bashkëpunim me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, Tiranë, tetor 2001.
3. Dr.Andre Soubiran, 'Napoleoni dhe një milion të vdekurit', Paris, 1969.
4. Fehmi Baftiu, "Mjegullat e diplomacisë shqiptare', Prishtinë, maj 2005.
5. Francoise Bory, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, 'Origjina dhe zhvillimi i të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare', Tiranë, 2000.
6. Hans Peter Gasser, "E Drejta Ndërkombëtare Humanitare", Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, dhjetor 2000.
7. Jarosllav Anders, 'Krijimi i forces ushtarake kunder genocidit', 19 mars 2005.
8. Jean Pictet, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, "Zhvillimi dhe parimet e së drejtës ndërkombëtare humanitare", Tiranë 2001.
9. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, 'E Drejta e Konfliktit të Armatosur', Tiranë, qershor 2002.

10. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, 'Parimet themelore të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe', Tiranë, qershor 2002.

11. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, 'Kuptimi i së drejtës humanitare, rregullat themelore të konventave të Gjenevës dhe të protokolleve të tyre shtesë', Tiranë, dhjetor 2000.

12. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, 'Për Forcat e Armatosura', manual model mbi të drejtën e konfliktit të armatosur, dhjetor 2003.

13. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, 'Disa konventa të Hagës dhe traktate të tjera', Tiranë, shtator 2001.

14. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, 'E drejta ndërkombëtare humanitare, përgjigje pyetjeve tuaja', Tiranë, tetor 2002.

15. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, 'Të zbulosh KNKK', Tiranë, shkurt 2002.

16. Marrëveshjet dhe konventat për Forcat e Armatosura, Qendra e shtypit, botimeve dhe përkthimeve ushtarake, Tiranë 2005.

17. N.Marika & Xhezair Zaganjori "Gjykata Penale Ndërkombëtare si zhvillim i rëndësishëm pozitiv në kuadër të përgjegjësisë penale ndërkombëtare", "Jeta Juridike" 1/2002.

18. NATO në një vështrim, një analizë faktike e çështjeve dhe sfidave me të cilat ballafaqohet Aleanca në fund të viteve '90', Zyra e Informacionit dhe shtypit të NATO-s, Bruksel, Belgjikë, 1996.

19. Pietro Verri, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, 'Fjalor i së Drejtës Ndërkombëtare të Konfliktit të Armatosur', Tiranë 2001.

20. 'Roja Bregdetare', Ministria e Mbrojtjes, Qendra e shtypit dhe botimeve ushtarake, Tiranë 2003.

21. Tetis Lubonja "Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë", Tribuna Juridike, 46/2004.

22. Të drejtat e njeriut në të drejtën ndërkombëtare, botim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Tiranë, qershor 1994.

10.1.3 Botime në gjuhë të huaj

1. African Rights, Somalia, Operation Restore Hope: A Preliminary Assessment, London (1992).
2. Agreement for the Prosecution and Punishment of the Major War Criminals of the European Axis, Charter of the International Military Tribunal, 8 August 1945, 82 UNTS.
3. A. James, "Is there a second generation of peacekeeping?", 1 International Peacekeeping (1994), n° 4.
4. Annan, Koffi 2000, "We the Peoples': The role of the United Nations in the 21st Century, "United Nations, International Peacekeeping 2, 140-156.
5. A. Roberts, "Communal conflict as a challenge to international organization: the case of former Yugoslavia", 21 Review of International Studies (1995).
6. A. Roberts, "What is Military Occupation?", 55 BYIL (1984).
7. Both, K.J. Partsch and W.Solf, New Rules for Victims of Armed Conflicts, Nijhoff (1982);
8. Bothe & C. Jury, "Rwanda: A creeping sense of security", 1. International Peacekeeping (1994), n° 3, p.100.
9. Cassese, "The Geneva Protocols of 1977 on the Humanitarian Law of Armed Conflict and Customary International Law", 3 UCLA Pacific Basin Law Journal (1984).
10. C. Allen, The savage wars of peace, Future (1990), Part 1.
11. C.de Rover, To Serve and to Protect, Human Rights and Humanitarian Law for Police and Security Forces, International Committee of the Red Cross, Geneva , February 1998.
12. C. Sommaruga, "Assistance to victims of war in international humanitarian law and humanitarian practice", 289 ICRC (1992).
13. D. Fleck, "The protocols Additional to the Geneva Conventions and Customary International Law", 29 RDMDG (1990).
14. C. Greenwood, "Customary Law Status of the 1977 Geneva Protocols" in A.J.M. Delissen & G.J. Tanja (ed.), Humanitarian Law of Armed Conflict: Challenges Ahead, Nijhoff (1991).
15. D U. Palwankar, "Applicability of International Humanitarian Law to United Nations Peace-keeping Forces", 294 IRCC (1993).
16. D. Plattner, "Assistance to the civilian population: the development and present state of international humanitarian law", 288 ICRC (1992).
17. D. Schindler and J. Toman, 'The Laws of Armed Conflicts', Geneva, 1981.
18. D. Schindler, "The different types of armed conflicts according to the Geneva Conventions and Protocols", RCADI, vol. 163 (1979-II).
19. Defense Institute of International Legal Studies, Executive Program for Albania, Phase 5, Quality Force Management, December 1994.
20. Defense Institute of International Legal Studies, Executive Program for Albania, Phase 7, Quality Force Management, December 1995.
21. Doswald-Beck (ed.), "The San Remo Manual on International Law applicable to Armed Conflicts at sea", 89 AJIL (1995).
22. Doswald-Beck (ed.), San Remo Manual on international law applicable to armed conflicts at sea, Cambridge, 1995 (with commentary).
23. E. Benvenisti, The International Law of Occupation, Princeton (1993).

24. F.J. Hampson, "Proportionality and Necessity in the Gulf Conflict", American Society of International Law, Proceedings of the 86th Annual Meeting, Washington, 1992.
25. Falk, Richard 1999, 'Kosovo, World Order, and the Future of International Law', American Journal of International Law 93, 847-857.
26. Frederic De Mulinen, International Committee of the Red Cross, Handbook on the Law of War for Armed Forces, Geneva 1987.
27. Frits Kalshoven, Belligerent reprisals, Leiden, 1971.
28. Frits Kalshoven, The Laws of Warfare, Leiden and Geneva, 1973.
29. George C. Marshall Center, College of International and Security Studies, Elective Seminar-6294, Human Rights, 2004.
30. George C. Marshall Center, College of International and Security Studies, Human Rights Manual, Major International Human Rights Instruments, 2004.
31. George C. Marshall Center, College of International and Security Studies, The Executive Program in International and Security Affairs, Module 4, International Law, 2004.
32. George C. Marshall Center, College of International and Security Studies, Elective Seminar Program -6265 (S), International Law and Military Operations; Principles, Application and Enforcement, 2004.
33. Green, L.C. 1993, 'The Contemporary Law of Armed Conflict', Manchester University Press, Manchester.
34. Guicherd, Catherine 1999, "The International Law and the War in Kosovo," Survival 41(2).
35. H.P. Gasser, "For better protection of the natural environment in armed conflict: a proposal for action", 89 AJIL (1995).
36. H.P. Gasser, "Internationalized non-international armed conflict", 33 Am. Univ. L. Rev. (1983), p.145; Y. Sandoz, loc. Cit. note 11, section 2.4.1.
37. H.P. Gasser, ICRC (ed.), Report on the Symposium on Humanitarian Action and Peace-keeping Operations (1994).
38. Henry Dunant, 'A Memory of Solferino', Published by the International Committee of the Red Cross, Geneva 1986.
39. Human Rights Watch/Africa, Somalia Faces the Future, vol.7, n° 2, New York (1995).
40. Humanitarian Law in Armed Conflicts, Edited by The Federal Ministry of Defense of the Federal Republic of Germany, VR II 3, August 1992.
41. ICRC (ed.), Blinding Weapons, Reports of the meetings of experts convened by the International Committee of the Red Cross on battlefield laser weapons 1989-1991, Geneva (1993); ICRC (ed.).
42. ICRC, "Report of the International Committee of the Red Cross for the Review Conference of the 1980 United Nations Convention on Prohibitions or Restrictions on the Use of Certain Conventional Weapons which may be Deemed to be Excessively Injurious or to Have Indiscriminate Effects", (1994).
43. Jean-Marie Henckaerts and Louise Doswald-Beck, Customary International Humanitarian Law, Volume I: Rules, International Committee of the Red Cross, Cambridge University Press 2009.

44. J. S. Pictet (dir.), Commentary: Geneva Convention for the Amelioration of the Condition of the Wounded and Sick in Armed Forces in the Field, Genève, CICR (1952).
45. Judgment of the International Military Tribunal at Nuremberg in Nazi Conspiracy and Aggression, Opinion and Judgment (1947).
46. L.R. Penna, "Customary International Law and Protocol I" in C. Swinarski (ed.), Studies and Essays on International Humanitarian Law and Red Cross Principles, ICRC (1984).
47. Luigi Condorelli, Anne-Marie La Rosa, Sylvie Scherrer, 'The United Nations and International Humanitarian Law", Actes du Colloque international A l'occasion du cinquantieme anniversaire de l'ONU, Editions Pedone, Paris, 1996
48. M. Bothe, "Peace Keepers – What kind of hostages?", 2 International Peacekeeping (1995), n° 2/3.
49. M. Sahnoun, Somalia – The Missed Opportunities, United States Institute of Peace Press (1994).
50. M. Weller, "The International Response to the Dissolution of the Socialist Federal Republic of Yugoslavia", 86 AJIL (1992).
51. Mackinlay & J. Chopra, "Second Generation Multinational Operations", 15 Washington Quarterly (1992).
52. Michael N.Schmitt, "Counter-Terrorism and the Use of Force in International Law", George C. Marshall European Center For Security Studies, The Marshall Center Papers, No.5, 2002.
53. Murphy, Sean D. 1996, Humanitarian Intervention: the United Nations in an Evolving World Order, University of Pennsylvania Press, Philadelphia.
54. O' Connell, Mary Ellen 2000, "The UN, NATO, and International law After Kosovo," Human Rights Quarterly 22, 57-89.
55. Pasic, Amir and Weiss, Thomas 1999, "The Politics of Rescue: Yugoslavia's Wars and the Humanitarian Impulse," pp.296-333 in Ethics and International Affairs, ed. Joel H. Rosenthal, 2nd ed., Georgetown University Press, Washington, DC.
56. Patricia Chilton, Dan Plesch, Jamie Patten, 'NATO, peacekeeping and the United Nations', (1994).
57. Quincy Wright, A Study of War, London, 1942.
58. Rabinder Singh QC, Alison Macdonald, "Legality of the use of force against Iraq" Opinion, Public Interest Lawyers on behalf of Peacerights, 10 September, 2002.
59. R. Higgins, United Nations Peacekeeping, 1947-1967, III Africa, oxford (1980).
60. R. Siekmann, "The five main mistakes regarding Bosnia in retrospect", 1 International Peacekeeping (1994), n° 4.
61. R. Siekmann, "No doubts about the legality of NATO action in Bosnia", 2 International Peacekeeping (1995).
62. Roberts, Adam 1999, "NATO's 'Humanitarian War' over Kosovo," Survival 41(3).
63. Rose (ed.), The Gulf War 1990-9 in international and English Law, London (1993).
64. Rosemary ABI-SAAB, "Droit Humanitaire et Conflits Internes, Origines et évolution de la réglementation internationale, Editions A. Pedone Paris 1986.

65. S. Jacobi, "UNPROFOR – Mission impossible", 2. International Peacekeeping (1995), n° 2/3.
66. Simma, Bruno 1999, "NATO, the UN and the Use of Force: Legal Aspects, "The European Journal of International Law'.
67. Smith, Michael J. 1999, "Humanitarian Intervention; An Overview of the Ethical Issues,' pp.271-295 in ethics and International affairs; a reader, ed. Joel H. Rosenthal, Georgetown University Press, Washington, DC.
68. The Hague Conventions and Declarations of 1899 and 1907, New York, Oxford University Press (1915).
69. The NATO Handbook, 50th Anniversary Edition, Office of Information and Press, Brussels, Belgium, 1999.
70. Turkish General Staff Ankara, Partnership for Peace Training Center Command, Guide to the Law of Armed Conflict of Armed Forces, Ankara, Turkey, July 2001.
71. U. Pawlankar (ed.), Symposium on Humanitarian Action and Peace-keeping Operations, ICRC (1994).
72. United Nations, Department of Peacekeeping Operations, Department of Field Support United Nations Peacekeeping Operations. Principles and Guidelines, (2008).
73. V. Gowlland-Debbas, H.P. Gasser and K. Wellens, in H.H.G. Post (ed.), International Economic Law and Armed Conflict, Dordrecht/Boston/London (1994).
74. Von-Glahn, 'The Occupation of Enemy Territory', Minneapolis (1957).
75. W. Kalin, "Situations of human rights in occupied Kuwait", Report of 16 January 1992, E/CN.4/1992/26.
76. Weiss, Thomas 1999, Military Civilian Interactions: 'Intervening in Humanitarian Crisis, Rowman and Littlefield', Publishers Inc., Lanham, Maryland.
77. Wheeler, Nicholas J. and Morris, Justin 1996, "Humanitarian Intervention and State Practice at the End of the Cold War,' pp. 135-177 in International Society after the Cold War, eds. Rick Fawn and Jeremy Larkins, St. Martins Press, New York.
78. William, John1999, "The Ethical Basis of Humanitarian Intervention, the Security Council and Yugoslavia, "International Peacekeeping 6(2).
79. Y Sandoz, "The Establishment of Safety Zones for Persons Displaced within their Country of Origin", Conference on International Legal Issues arising under the United Nations Decade of International Law, Qatar, march 1994.
80. Y. Sandoz, "A Consideration of the Implementation of International Humanitarian Law and the Role of the ICRC in the former Yugoslavia", ICRC (1993).
81. Y. Sandoz, "A new step forward in international law: prohibitions or restrictions on the use of certain conventional weapons", IRRC (1981).
82. Y. Sandoz, C. Swinarski & B. Zimmermann (ed.), Commentary on the Additional Protocols, ICRC (1987).

10.1.4 Botime online

1. African Review, vol. 7, no.5. Institute for security Studies, 1998, www.iss.co.za/pubs/asr/7no5/Contents.html
2. Amnesty International, Public Statement, AI Index: ASA 11/013/2007 (Public), new Service No:200, 3 October 2007, www.amnesty.org/en/node/1401?page=15
3. Antonio Cassese, Human Rights in a changing world, (Philadelphia: Temple University Press, October 1, 1999, beyondintractability.colorado.edu/essay/*human_rights_protect/*
4. B. B. Ferenez, The development of International Law and Human Rights Law, hdr.undp.org/
5. Benedikt F.Franke The use of sustained coercive air power in humanitarian interventions Journal of Humanitarian Assistance on 30 Dec 04, www.jha.ac/articles/a170.pdfposted
6. Birgitte Refslund Sorensen, Violence and humanitarian assistance: Reflections on an intricate relationship, f. 1, sites.tufts.edu/jha/files/2011/04/a194.pdf
7. Caroline Wyatt, Afgan burden tasks NATO allies, BBC News, Noordwijk, www.afghanistannewscenter.com/news/2007/.../nov202007.html
8. Catriona Gourlay, Partners Apart: Managing Civil-Military Co-operation in Humanitarian Interventions, 2000, www.certi.org/themes/Civil_military_coll.htm
9. Chris Abbott, Rights and Responsibilities. Resolving the Dilemma of Humanitarian Intervention, September 2005, sites.tufts.edu/jha/files/2011/04/a180.pdf
10. Christa Rottensteiner, The denial of humanitarian assistance as a crime under international law, IRRC September 1999, No.835,
11. Conflict, peace and development co–operation, Report Nr.1, Civilian and military means of providing and supporting humanitarian assistance during conflict, Paris 1998, maic.jmu.edu/journal/8.**1**/focus/maxwell2/maxwell2.htm
12. Dajena Kumbaro "The Kosovo Crisis in an International Law Perspective: Self Determination, Territorial Integrity and the NATO Intervention",
13. Damian Lilly, No war, no peace: a protection crisis continues in the DRC, November 2005, sites.tufts.edu/jha/files/2011/04/a182.pdf
14. David Bruno and Brennan Howell, United States gives reason for war against Iraq, Tiger Times, Issue One, http://www.google.com/search?q=David+Bruno+and+Brennan+Howell
15. Declaration on Principles of International Law Concerning Friendly Relations and Co-operation among States in accordance with the Charter of the United Nations, G.A. res. 2625, Annex, 25 UN GAOR, Supp. (No. 28), U.N. Doc. A/5217 at 121 (1970).
16. Don Hubert and Thomas G. Weiss, The responsibility to protect, 2001, web.idrc.ca › Publications › IDRC Books › All our books
17. Dragan Lozancic, Kosovo: Adjusting to a "New Reality", George C. Marshall, Center for Security Studies, ISSN 1867-4119, www.marshallcenter.org/mcpublicweb/.../F.../SecurityInsight_02.pdf
18. Eric Walberg, Peacemaker or Puppet?, August 2007, 22 August 2007, www.oocities.org/walberg2002/Egypt/articles.html
19. F. J. Leon Diaz, Humanitarian Intervention issues, 2002, www.javier-leon-diaz.com/docs/humanIntervIssues.htm
20. Gender, Human Rights and International Law, ICRC, 2003, DP Forsythe - 2006 - books.google.com
21. George Foulkes, Questions for a new humanitarism, 12 March 1998. www.odi.org.uk/events/docs/4031.pdf

22. Hannes Peltonen, Right And Responsibility, What Kind Of Right Is The Right Of Humanitarian, Intervention? EUI Working Papers, SPS No. 2006/03, cadmus.eui.eu/bitstream/handle/1814/4357/SPS%202006.03.pdf?.
23. Helena Kennedy, "Conflict Resolution and Human Rights: Contradictory or Complementary?", May 23, 2001, www.beyondintractability.org/bi-essay/human-rights-violations
24. Hugo Slim, Military humanitarianism and the new peace keeping. An agenda for peace? IDS Bulletin Vol. 27 No 3 1996, onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1111/j.1759-5436.1996...x/pdf
25. Human Rights Legislation, Wikipedia, the free encyclopedia, 2007, en.*wikipedia.org/wiki/International_human_rights_law*
26. Humanitarian agenda for Afghanistan; A Care International Policy Paper, Final draft October 9, 2001, f.44, www.care.org/.../afghanistan/AfghanistanHumanitarianAgenda.pdf
27. Independent International Commission on Kosovo, The Kosovo Report: Conflict International Responses, Lessons Learned (Oxford: Oxford University Press, October 2000), www.kulturserver-hamburg.de/.../kosovocommission.org_report_en.
28. International Crisis Group 2008 annual report review of 2007 plans for 2008, www.crisisgroup.org
29. International Humanitarian Law Issues In A Potential War In Iraq, Human Rights Watch Briefing Paper, February 20, 2003, http://www.hrw.org/backgrounder/arms/iraq0202003.htm
30. Irwin Arieff, Iraq Tells UN it Wants Multinational Force to Stay, Reuters, June 13, 2006, http://www.globalpolicy.org/security/issues/iraq/unrole/2006
31. James Phillips, Bush on Iraq: U.S. Troops "Return on Success", September 14, 2007, www.heritage.org/Research/middleeast/upload/wm
32. Jonathan Finer and Joshua Partlow, Iraqi Leaders Question US Troop's Immunity, Washington Post, July6, 2006, http://www.globalpolicy.org/security/issues/iraq/attack/law/2006
33. Jonathan I. Charney, Anticipatory humanitarian intervention in Kosovo, http://www.questia.com/googleScholar.qst?docId=5001866798
34. Joshua G. Smith, The Responsibility to reflect. Learning lessons from past Humanitarian, Military Interventions, 2007, www.stimson.org/.../Biblio__Authors_The_Impossible_Mandate_Hol.
35. Journal of International and Comparative Law, Forthcoming, Cleveland-Marshall Legal Studies, 21 Sep.2008, papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=1270637
36. Juan Cole, Bush's Napoleonic Folly, August 24, 2007, http://www.thenation.com/doc/20070910/cole
37. Julian E Barnes, America's Own Unlawful Combatants?, Los Angeles Times, October 15, 2007, gpf@globalpolicy.org
38. K. Mills, The legitimacy of humanitarian access and intervention, Published July 4, 1997, sites.tufts.edu/jha/archives/tag/*intervention*
39. Kate Mackintosh, How far can humanitarian organizations control co-operation with international tribunals? March 2004, sites.tufts.edu/jha/files/2011/04/a175.pdf
40. Ken Roth, War in Iraq: Not a humanitarian intervention, 2004, f 5, www.unhcr.org/refworld/pdfid/402ba99f4.pdf

41. Kofi Annan, Two concepts of sovereignty, New York for the annual session of the UN General Assembly, Sep 16th 1999, www.economist.com/node/324795/comments
42. Kosovo (Under UNSCR 1244/99) 2008 Progress Report, Brussels, 05.11.2008, SEC(2008)2697, ec.europa.eu/.../reports_nov_2008/kosovo_progress_report_en.pdf
43. Kosovo And The Challenge Of Humanitarian Intervention: Selective Indignation, Collective Action, And International Citizenship, http://books.rediff.com/bookshop/bkproductdisplay.jsp
44. Kosovo Liberation Army, http://en.wikipedia.org/wiki/Kosovo_liberation_Army, March 2008
45. Kosovo War, http://en.wikipedia.org/wiki/Kosovo_War, April 2008
46. L.M.Martin,United States Marine Corps, Humanitarian Success And Political/Military Failure, http://www.globalsecurity.org/military/library/report/1995/MLM.htm
47. Larry Minear, Ted van Baarda, and Marc Sommers, NATO and Humanitarian Action in the Kosovo Crisis, Watson Institute, 2000, www.ipb.org/.../militarisation%20of%20aid/.
48. Laws of war-Wikipedia, the free encyclopedia, en.*wikipedia.org/wiki/Laws_of_war*
49. Matt Fawkner, Michael Schmitt, International Military Course on the Law of Armed Conflict, 2000, csis.org/images/stories/hrs/counterterrorismbibliography.pdf
50. Medllin Ollbrajt dhe Lidershipi nga Kosova, Politika Shqiptare, http://www.zeriyt.com/historia-shqiptare/medlin-ollbrajt
51. Mehdi Hyseni, "OKB-ja e reformuar dhe problemi kolonial shqiptar nw Ballkan" http://lajmet.com/Njohtime/arkivi/Mehdi-May-31-03.htm
52. Mehdi Hyseni,"UÇK-ja nuk e rrezikon Ballkanin, por aleanca "e moderuar" sllave", Analizë, http://lajmet.com/Njohtime/arkivi/Mehdi-May-31-03.htm
53. Michael Venthey, "International Humanitarian Law and the Restoration and Maintenance of Peace", the Preamble to Additional Protocol 1 of 1977, lup.lub.lu.se/luur/download?func=downloadFile&recordOId.
54. Michelle Maiese, Human Rights Violations, July 2003, www.beyondintractability.org/bi-essay/human-rights-violations
55. Milena Sterio, The Kosovar Declaration of Independence: "Botching the Balkans" or Respecting International Law?, Georgia, 21 Sep 2008, papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=1270637
56. Morton H. Halperin, Iraq and Responsibility to Protect, 29 may 2007, f.1, www.americanprogress.org/issues/2007/07/halperin_testimony.html
57. Ms.Madaleine Rees Chief of Mission OHCHR BiH, Human Rights Field Presence in Bosnia and Hercegovina, mrees@ohchr.org
58. Multinational Force Mandate Renewal, http://www.globalpolicy.org/security/issues/iraq/mnfindex.htm
59. NATO 1999, "Press Statement by Javier Solana, Secretary General of NATO," NATO Press Release No. (1999)040, 23 March.Available from http://www.nato.int/docu/pr/1999/p99-040e.htm.
60. NATO bombing of Bosnia & Herzegovina, 1995, (http://www.nato.int/acad/fellow/99-01/f99-01.htm).
61. NATO Involvement in the Balkan Crisis, U.S. Dept. Of State Geographic Bureaus, U.S. Department of State, http://dosfan.lib.uic.edu/ERC/bureaus/eur/releases/951101BosniaNATO.html

62. NATO's role in relation to the conflict in Kosovo, http://www.nato.int/kosovo/history.htm
63. Niko Krisch, Legality, morality and dilemma of humanitarian Intervention after Kosovo, April 02, gupea.ub.gu.se/bitstream/2077/2013/1/200422.pdf
64. Noelle Quenivet, Humanitarian assistance: a right or a policy?, 3 June 2000, http://www.jha.ac/articles/a030.htm
65. Oliver Corten, Humanitarian Intervention, a controversial right, www.jag.navy.mil/documents/navylawreview/NLRVolume59.pdf
66. Platforma amerikane në paralelizmat negative të diplomacies, http://www.vendlindja.com/forum/showthread.php
67. Press Release SC/6276 10 October 1996 Security Council expresses concern over lack of progress on investigations of international humanitarian law in Bosnia & Herzegovina, www.un.org/News/Press/docs/1996/19961010.sc6276.html
68. Raport i Sekretarit të Përgjithshëm, 3 maj 1993, (S/25704),
69. Responsibility to Protect, from Wikipedia, the free encyclopedia, The responsibility to protect (R2P or R to P) is a United Nations initiative established in 2005., en.wikipedia.org/wiki/Responsibility to_protect
70. Roopam Verma, Humanitarian Laws and Human Rights Law, 2006, law.*bepress.com/cgi/viewcontent.cgi?article=4770&context.*
71. Stefan Kirchner, The Human Rights Dimensions of International Peace and Security: Humanitarian Intervention after 9/11, 15 Oct 2003, www.ssrn.com/abstract=445124
72. Taleban "war crimes" on Afgans, http://newsvote.bbc.co.uk/mpapps/pagetools/email/news.bbc.co.uk/2/hi/south_asia/6568561.stm

73. United Nations Distr.General A/RES/48/88 29 December 1993, The situation in Bosnia & Hercegovina, General Assembly resolution 48/88 of 20 December 1993, www.un.org/documents/ga/res/48/a48r088.htm
74. United Nations Security Council Maintaining Peace and Security: Humanitarian aspects of Issues before the Security Council (S/PV. 4109/2000), 9 March 2000, www.undemocracy.com/securitycouncil/meeting_4109
75. Vicky Short, Spanish Judge Calls for Architects of Iraq Invasion to be Tried for War Crimes, World Socialist Web Site, March 27, 2007, http://www.wsws.org/articles/2007/mar2007/garz-m27.shtml
76. War and Occupation in Iraq - Pakistan Defence Forum, Chapter 1, http://www.google.com/search?q=War+and+Occupation+in+Iraq%2C+Chapter+1&
77. War and Occupation in Iraq - Pakistan Defence Forum, Chapter 1-9, http://www.google.com/search?q=War+and+Occupation+in+Iraq%2C+Chapter+1&
78. War and Occupation in Iraq, Chapter 8, Displacement and Mortality, http://www.globalpolicy.org/security/issues/iraq/occupation/report/humanitarian.htm
79. What is International Humanitarian Law? Advisory service ICRC 2004, www.icrc.org/eng/assets/files/other/kit_national_enforcement.pdf
80. Wikipedia, The war in Afghanistan,en.wikipedia.org/wiki/Category:War_in_Afghanistan www.icrc.org/eng/resources/documents/misc/57jq32.htm

81. Yoram Dinstein. (From the Naval War College Review, autumn 2000. The Right to Humanitarian Assistance | IHL Research, ihl.ihlresearch.org/index.cfm?fuseaction=page.view

Abstrakt

Respektimi i të drejtave njerëzore konsiderohet nga e drejta ndërkombëtare e sotme si kusht për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Përgjegjësia për mbrojtjen e të drejtave njerëzore i takon në radhë të parë çdo shteti sovran. Megjithatë, mbrojtja e të drejtave njerëzore është një çështje që mbetet jashtë juridiksionit ekskluziv të shteteve. Komuniteti ndërkombëtar nuk mund të qëndrojë indiferent kur shkelen të drejtat njerëzore brenda një shteti. Kur një popullsi civile vuan nga abuzimet serioze me të drejtat njerëzore dhe qeveria është e paaftë t'i ndalojë këto abuzime, ose ajo vetë është shkaktare e tyre, atëherë kjo përgjegjësi i kalon komunitetit ndërkombëtar.

Komuniteti ndërkombëtar duhet të përdorë të gjitha mënyrat e mundshme për të siguruar respektimin e të drejtave njerëzore në të gjitha vendet ku kryhen shkelje masive dhe sistematike të këtyre të drejtave që mund të përbëjnë rrezik për paqen.

Shkeljet e rënda që kryhen në kurriz të një popullsie duhet të përballen fillimisht me alternativa paqësore, si presion publik, ndjekje penale për personat përgjegjës, sanksione ekonomike dhe diplomatike. Rëndësi të madhe paraqet arritja e një konsensusi ndërkombëtar në drejtim të parandalimit të barbarizmave masive që shkaktojnë kriza humanitare.

Në disa raste abuzimi me të drejtat e popullsisë ka qenë në nivele të tilla saqë është gjykuar i nevojshëm përdorimi i forcës si mundësi e vetme për t'i ndaluar këto abuzime. Por, duke qenë se lufta përmban në vetvete rrezikun për jetën dhe mund të shkaktojë fatkeqësi të tjera, forca ushtarake duhet të jetë opsioni i fundit që mund të përdoret për qëllime humanitare.

Në mënyrë që ndërhyrja humanitare të jetë efektive dhe të përdoret thjesht për motive humanitare, pa abuzime nga ana e shteteve më të fuqishme, ajo duhet vendosur brenda një kornize ligjore.

Arritja e një konsensusi ndërkombëtar, për një bazë ligjore të ndërhyrjeve humanitare do të lehtësonte mundësinë e komunitetit ndërkombëtar për të vepruar në situata krizash humanitare dhe do të shmangte çdo mundësi të përdorimit të ndërhyrjeve humanitare për interesa vetjake të shteteve, duke përdorur arsyet humanitare si justifikim.

Fjalët çelës: ndërhyrje humanitare, komunitet ndërkombëtar, krizë humanitare, sistem ndërkombëtar sigurie, sovranitet shtetëror, të drejta njerëzore.

Abstract

Respect of human rights is considered from the actual international law as a condition ensuring peace and international security. The responsibility to provide human rights protection lies in first hand with every single Sovran country. Nevertheless, protection of human rights remains an external issue outside of countries exclusive jurisdiction. International community cannot indifferently stand to human rights violation in a country. When civilian population suffers serious abusing of human rights either because the government fails to bring it to an end, or is the reason of the abusing, then it becomes an international community responsibility.

International community must make use of all available means to ensure human rights respect in all countries where massive and systematic violations of these rights may represent a threat against peace.

Violations initially have to face peaceful alternatives i.e. public pressure, legal actions to responsible individuals, economical and diplomatic sanctions. A great importance is achieving an international consensus toward massive atrocities prevention which cause humanitarian crisis.

In some of the cases, abusement of human rights has been at a level where use of force was seen as the only possibility to end the abusings. But since war itself represents a threat to life and could probably bring further casualties, military force must be the last resort to be used in humanitarian cases.

In order for humanitarian intervention to be effective and used only for humanitarian reasons without misuse from powerful contries, it must be framed within a legal outline.

Achieving an international consensus for a legal bases of humanitarian interventions, would facilitate and abilitate international community to appropriately act in humanitarian crisis situations and would avert possibilities for countries' individual interests use by exploiting humanitarian intervention as pretext.

Key words: humanitarian intervention, international community, humanitarian crisis, international security system, state sovranity, human rights.